



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



DORACAK I GJYQTARËVE PËR SHKRIMIN DHE ARSYETIMIN LIGJOR

Autorët:
Bashkim Hyseni, Albert Zogaj dhe Fejzullah Hasani

**DORACAK I GJYQTARËVE
PËR SHKRIMIN DHE ARSYETIMIN
LIGJOR**

Përgatitur nga Bashkim Hyseni, Albert Zogaj dhe
Fejzullah Hasani

I publikuar nga:

Akademia e Drejtësisë dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID) përmes Programit për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP).

Autorët:

Bashkim Hyseni, Pjesa e Përgjithshme.

Albert Zogaj, Shkrimi dhe Arsytimi i Vendimeve Gjyqësore – Puna e Gjykatave Lidhur më Zbatimin Adekuat të Lpk-së.

Fejzullah Hasani, Praktika Penale.

© 2017 Bashkim Hyseni, Albert Zogaj, Fejzullah Hasani, Akademia e Drejtësisë dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID).

Mohim:

Këndvështrimet e shprehura në këtë publikim, jo domosdoshmërisht reflektojnë këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Të drejtat e autorit:

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi i materialit pa pëlqimin Akademisë së Drejtësisë dhe autorëve. Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Korrik 2017

Prishtinë

Parathënie

Të nderuar,

Është synim i Akademisë së Drejtësisë se përveç trajnimeve, të ofroj edhe botime të ndryshme që i përgjigjen nevojave të sistemit të drejtësisë. Duke u nisur nga kjo, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim të ngushtë me Programin e USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë ka mbështetur hartimin dhe publikimin e këtij doracaku, i cili ka për qëllim të zhvillojë shkathtësitë e gjyqtarëve në shkrimin ligjor si dhe në përpilimin e vendimeve gjyqësore.

Ndryshimet e shpeshta në legjislacion dhe rekrutimi i një numri relativisht të madh të gjyqtarëve të rinj, ka ndikuar që sistemi gjyqësor të përballët me sfida që i referohen nevojës për ngritje të shkathtësive për shkrimin dhe arsyetimin ligjor. Nga monitorimi i vazhdueshëm i sistemit të drejtësisë, e në veçanti sistemit gjyqësor që i është bërë nga organizata të ndryshme në Kosovë, përmes raporteve të monitorimit vazhdimisht është theksuar nevoja e ngritjes së kapaciteteve sa i përket shkrimit dhe arsyetimit ligjor.

Për secilën çështje apo situatë të trajtuar brenda këtij doracaku janë identifikuar me hollësi praktikatat më të mira gjyqësore, përfshirë edhe praktikën e Gjykatës Supreme, dhe mbi këtë bazë janë dhënë udhëzimet për shkrimin dhe arsyetimin ligjor. Janë hulumtuar me hollësi të gjitha paqartësitë dhe format e ndryshme të veprimeve për secilën çështje të identifikuar për tu trajtuar dhe mbi këto të gjetura, janë dhënë udhëzimet adekuate.

Andaj, me synimin që gjyqtarëve dhe profesionistëve tjerë në fushën e drejtësisë të ju ofrojmë sa më shumë burime për avancimin e tyre profesional, ne shpresojmë që ky doracak do të jetë një vlerë e shtuar që do ta lehtësoj punën praktike në përpilimin e shkresave të ndryshme që përgatiten në procedurë civile dhe atë penale.

Falënderojmë autorët e këtij doracaku për përkushtimin dhe ofrimin e ekspertizës së tyre në dhënien e udhëzimeve shumë të rëndësishme për gjyqtarët, duke ndjekur parime standarde të shkrimit ligjor, si dhe përpilimin e vendimeve sipas praktikave më të mira.

Me respekt,

Besim Morina

U.d. Drejtor i Akademisë së Drejtësisë

Përmbajtja

PJESA E PËRGJITHSHME	1
HYRJE E SHKURTËR - RËNDËSIA E SHKRIMIT LIGJOR	1
I. UDHËZIMET E SHKRIMIT LIGJOR	2
II. SHKRIMI LIGJOR DHE METODOLOGJIA E PËRDORIMIT TË FORMULËS IRAC	5
1. Çka paraqet IRAC?	6
2. Identifikimi i Çështjes (Problemit)	7
3. Ligji: Cili është ligji (norma) që rregullon çështjen në fjalë?	8
4. Analiza: A aplikohet rregulli i mësipërm në faktet që lidhen me çështjen?	9
5. Konkluzioni	10
III. ARSYETIMI LIGJOR	10
1. E drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor	10
2. Funkcioni dhe përmbajtja arsyetimit të vendimit gjyqësor	12
3. Struktura e vendimit gjyqësor	15
4. Përdorimi dhe përshtatja e metodologjisë IRAC në të shkruarit ligjor në strukturën e vendimit gjyqësorë sipas legjislacionit tonë	18
4.1 Struktura e vendimeve sipas legjislacionit tonë	19
4.2 Arsyet e vendimit apo ratio decidendi	20
4.3 Analiza e duhur e provave është thelbësore për një aktgjykim cilësor	22
4.4 Përballja me argumentet e kundërta	25
5. Redaktimi i Vendimit Gjyqësor	27
6. Roli dhe Rëndësia e Mendimit Mospajtues dhe Konkurrues	27
SHKRIMI DHE ARSYETIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE – PUNA E GJYKATAVE LIDHUR ME ZBATIMIN ADEKUAT TË LPK-SË	30
HYRJE	30
PJESA E PARË	30
I. ARSYETIMI LIGJOR	30
1. Arsyetimi ligjor me analogji	30
II. PROCESI I TË SHKRUARIT	33
1. Studimi i rastit	33
2. Organizimi	34
3. Drafti fillestar	34
4. Drafti përfundimtar (vendimi)	35
III. PARIMET E TË SHKRUARIT LIGJOR TË MIRË	36

1.	Bëje të lehtë për lexuesin	36
2.	Shkruaj si njeri, jo si jurist	36
3.	Organizohu dhe skico çështjen	37
4.	Përdorë tituj dhe pika referuese	37
5.	Shkruaj paragraf të shkurtër.....	38
6.	Shkruaj fjali të shkurtra dhe të qarta	39
IV.	GJUHA E PËRDORUR NË TEKSTIN E SHKRUAR	41
V.	STRUKTURA DHE RAPORTET E FJALIVE.....	42
VI.	STRUKTURA DHE VEÇORITË E PARAGRAFIT	43
1.	Uniteti i paragrafit.....	43
2.	Segmentimi i paragrafit.....	44
3.	Përcaktimi i qëllimit të paragrafit që në fillim të tij	45
4.	Llojet e paragrafëve sipas karakterit	45
4.1	Paragrafi rrëfyes	45
4.2	Paragrafët përshkrues.....	45
4.3	Paragrafi shpjegues.....	45
4.4	Paragrafi retorik-bindës	46
4.5	Paragrafi dialogues	46
4.6	Paragrafët parashikues	46
VII.	STRUKTURA E FJALISË, KORREKTËSIA GRAMATIKORE DHE DREJTSHKRIMORE	46
	PJESA E DYTË	48
I.	SHKRIMI DHE ARSYETIMI LIGJOR PËRMES METODËS IRAC	48
1.	Metoda “IRAC”	48
2.	Pyetje të Strukturuar.....	48
3.	Procesi Analitik.....	50
4.	Rëndësia dhe nevoja për procesin analitik	53
5.	Sfidat analitike	55
6.	Analiza e Shkruar Ligjore.....	59
II.	ANALIZË PËR MUNDËSINË E ZBATIMIT TË METODOLOGJISË “IRAC” NË HARTIMIN E AKTGJYKIMIT NË LËNDËT CIVILE	64
	PJESA E TRETË	68
I.	E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT GJYQËSOR, PARAKUSHT PËR NJË VENDIM TË DREJTË DHE TË LIGJSHËM	68
1.	Gjykata e pavarur dhe e paanshme	68
1.2.	Gjykata e pavarur	68
1.3.	1.Gjykata e paanshme.....	70

2. Procesi brenda një afati të arsyeshëm	77
3.E drejta për një gjykim (vendim) të arsyetuar	80
II. PARIMET THEMELORE TË PROCEDURËS KONTETSIMORE DHE RELACIONI I TYRE ME TË DREJTËN PËR NJË PROCES TË RREGULLT GJYQËSOR SIPAS NENIT 6 TË KONVENTËS	81
1. Parimet dhe rregullat e procedurës kontestimore (disa nga parimet më të rëndësishme)	82
1.1. Parimi i kushtetutshmërisë	83
1.2. Parimi i ligjshmërisë.....	83
1.3. Parimi i disponibilitetit	84
1.4. Parimi i dëgjimit të palëve.....	84
1.5. Parimi i publicitetit	86
1.6. Parimi i shqyrtimit dhe i hetimit.....	87
1.7. Parimi i së vërtetës materiale.....	87
1.8. Parimi i vlerësimit lirisht të provave	88
1.9. Parimi i pandërmjetësisë.....	89
1.10.Parimi i shfrytëzimit me mirëbesim i të drejtave procedurale	89
1.11.Parimi i oralitetit.....	89
1.12.Parimi i dhënies së ndihmës juridike palës së paudhëzuar	90
1.13.Parimi i ekonomisë së gjyqimit	90
1.14.Gjuha në procedurën kontestimore	91
III. Disa Çështje me Rëndësi për Procesin e Rregullt Gjyqësor e Rrjedhimisht edhe për Vendimin Gjyqësor	91
1. Vlerësimet e gjykatës.....	92
2. Mbrojtja e të paditurit nga padia.....	97
2.1. Mbrojtja e të paditurit nga padia me mjete juridike	97
2.1.1Mbrojtja me anë të mjeteve proceduralo-juridike.....	97
2.1.2Mbrojtja me anë të mjeteve materialo-juridike.....	98
3. Shkathësitë e gjyqtarit/ës për zhvillimin e seancës përgatitore.....	99
4. Konvokimi i seancës për shqyrtim kryesor të çështjes	100
5. Zhvillimi i shqyrtimit kryesor.....	100
6. Zhvillimi i shqyrtimit kryesor në rastet kur nuk është mbajtur seanca përgatitore	102
7. Drejtimi i shqyrtimit kryesor	103
8. Zhvillimi i procedurës në shqyrtim kryesor.....	103
9. Mundësia e paraqitjes së fakteve të reja dhe propozimit të provave të reja në këtë fazë të procedurës.....	104
10. Mënyra e marrjes në pyetje të palëve në shqyrtim kryesor.....	105
11. Rrjedha e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve në shqyrtim kryesor	105
PJESA E KATËRT	107
I. INTERPRETIMI SI KOMPONENTË E RËNDËSISHME PËR SHKRIMIN DHE ARSYETIMIN LIGJOR	107

1.	Llojet e interpretimit	108
2.	Metodat e interpretimit	109
2.1	Interpretimi gjuhësor (sipas tekstit)	110
2.2	Interpretimi logjik	112
2.3	Interpretimi sistematik (sipas kontekstit)	113
2.4	Interpretimi historik (sipas historisë së krijimit)	115
2.5	Interpretimi qëllimor	115
2.6	Analogjia	116
II.	PËRFUNDIMI I PROCEDURËS ME VENDIM TË GJYKATËS	117
1.	Aktgjykimi	118
2.	Udhëzime për Shkrimin dhe Arsyetimin e Aktgjykimit Sipas Strukturës Formale të Aktgjyqimit	120
3.	Disa Udhëzime Lidhur me Pjesën Përmbajtësore të Arsyetimit të Aktgjykimit	126
3.1	_Kërkesat e palëve (si pjesë e përmbajtjes së arsyetimit të aktgjykimit)	126
3.2	Faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët	127
3.3	Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte	128
3.4	Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato	129
3.5	Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit	131
3.6	Deklarimi për pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë...132	
4.	Llojet e Aktgjyqimeve	133
4.1	Llojet e aktgjykimit sipas mbrojtjes juridike që jepet:	133
4.2	Aktgjykimi detyrues (dënues, kondemnator)	133
4.3	Aktgjykimi vërtetues (deklarativ)	133
4.4	Aktgjykimi transformues (konstitutiv, ndryshues)	133
5.	Llojet e aktgjyqimeve sipas LPK-së	134
5.1	Aktgjykimi i pjesshëm	134
5.2	Aktgjykimi në bazë të pohimit	135
5.3	Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia	137
5.4	Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë	139
5.5	Aktgjykimi për shkak të mungesës	140
5.6	Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes	142
5.7	Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitës së nenit 398 të LPK-së	143
6.	Aktgjykimi plotësues	145
7.	Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit	146
8.	Korrigjimi i aktgjykimit	147

9. Forma e prerë e aktgjykimit.....	148
10. Udhëzime për përmbajtjen e të dhënave në vendimet gjyqësore për shkak të anonimizimit dhe publikimit	149
PJESA E PESTË	151
I. NGA PRAKTIKA E GJYKATËS KUSHTETUESE PËR ARSYETIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE	151
II. NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ARSYETIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE.....	156
III. NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SË APELIT PËR ARSYETIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE	157
IV. NGA PRAKTIKA GJYQËSORE PËR SHKRIMIN DHE ARSYETIMIN E VENDIMEVE MERITORE	160
PRAKTIKA PENALE.....	214
1. Vendimet Gjyqësore	214
2. Urdhëresat gjyqësore	214
3. Aktvendimet gjyqësore	215
4. Aktgjykimet	219
<i>Baza e aktgjykimit</i>	219
Aktgjykimet në procedurën e shkallës së pare.....	220
<i>Llojet e aktgjykimev</i>	220
<i>Aktgjykimi refuzues</i>	220
<i>Aktgjykimi lirues</i>	221
AKTVENDIM PËR BASHKIMIN E PROCEDURËS	222
AKTVENDIM PËR VEÇIMINE PROCEDUËRS	224
RAPORTI DHE PROPOZIMI GJYKATËS PËR DELEGIMIN E KOMPENTENCËS TERRITORIALE	225
AKTVENDIM PËR DELEGIMIN E KOMPENTENCËS TERRITORIALE	226
AKTVENDIM PËR DELEGIMIN E KOMEPTENCËS TERRITORIALE	228
AKTVENDIM ME TË CILËN GJYKATA SHPALLET JO KOMPETENTE TERRITORIALE	230
AKTVENDIM ME TË CILIN GJYKATA SHPALLET JO KOMPETNENTE LËNDORE	231
AKTVENDIM PËR KONFLIKT KOMPETENCE	233
KËRKESË PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARËVE	236
AKTVENDIM ME TË CILIN APROVOHET KËKRESA PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT.....	237
AKTVENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT	238
AKTVENDIM PËR CAKTIMIN E MBROJTËSIT SIPAS DETRËS ZYRTARE	240
AKTVENDIMPËR SHKARKIMIN E MBROJTËSIT PËR SHKAK TË USHTRIMIT JO TË RREGULLT TË DETYRSË SË MBROJTËSIT	241
AKTVENDIM ME TË CILIN MBROJTËSIT PËRKOHËSISHT I MOHOHET E DREJTA E SHIKIMIT TË SHKRESAVE TË CAKTUARA DHE PREZENCA NË MARRJEN E VEPRIMEVE TË CAKTUARA HETIMORE	243
AKTVENDIM MBI VEÇIMIN E PROCESVERBALIT NGA SHKRESA.....	245

PROCESVERBAL MBI KËSHILLIMIN DHE VOTIMIN.....	246
PROCESVERBAL MBI KËSHILLIMIN DHE VOTIMIN SHKALLË TË DYTË	248
AKTVENDIM ME TË CILIN TË PANDEHURIT NUK I LEJOHET KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME	250
VENDIM I POSAÇËM PËR SHPENZIMET E PROCEDURËS	251
AKTVENDIM PËR SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE TË SHKAKTUARA ME FAJIN E PERSONAVE TË CAKTUAR.....	253
PROPOZIMI I TË DËMTUARIT PËR REALIZIMIN E KËRKESËS PASURORO JURIDIKE	255
PROZIM PËR DHËNIEN E MASËS SË PËRKOZHME TË SIGURISË SË KËRKESËS PASURORO JURIDIKE	256
VENDIM MBI ZËVENËDSIMIN E DËNMIT ME GJOBË ME DËNIM ME BURGIM	257
AKTVENDIM PËR MARRJEN E PATENT SHOFERIT.....	259
AKTVENDIM MBI KTHYERJEN E PATENTË SHOFERIT.....	261
AKTVENDIM PËR DËNIMIN E MBROJTËSIT PËR SHKAK TË ZVARRITJES SË RPROCEDURËS PENALE	262
KALLXIMI PENAL I POLICISË PROKURORIT SHTETËROR.....	265
KALLXIMI PENAL I TË DËMTUARIT PARAQITUR ORGANEVE POLICORE KUNDËR KRYERËSIT TË PANJOHUR PËR SHKAK TË VEPRËS PENALE E CILA NDIQET SIPAS DETYRËS ZYRTARE	266
AKTVENDIM PËR HEDHJEN E KALLËZIMIT PENAL.....	267
KËRKESË PËR MBLEDHJEN E INFORMATAVE TË NEVOJSHME.....	269
AKTVENDIM I PROKURORIT TË SHTETIT PËR ZBATIMIN E HETIMEVE	270
AKTVENDIM I PROKURORIT PUBLIK PËR AUTORIZIMIN E ZBATIMIT TË HETIMEVE TË CAKTUARA	272
AKTVENDIM PËR PEZULLIMIN E HETIMEVE	273
AKTVENDIM PËR PUSHIMIN E HETIMEVE.....	274
OFRIMI I DORZANISË	275
AKTVENDIM PËR PRANIMIN E DORZANISË	276
AKTVENDIM PËR HUMBJEN E DORZANISË DHE DERDHJA NË BUGJET	278
AKTVENDIM PËR KTHYERJEN E DORËZANISË	279
AKTVENDIMI I GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT.....	281
PROPOZIMI I PROKURORIT PËR VAZHDIMIN E PARABURGIMIT NDAJ TË PANDEHURIT	282
AKTVENDIM PËR VAZHDIMIN E PARABURGIMIT	284
PROPOZIM I MBROJTËSIT PËR NDËRPREJRENE PARABURGIMIT TË PANDEHURIT	285
AKTVENDIMI I GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE PËR NDËRPREJEN E PARABURGIMIT ..	286
AKTVENDIM I GJYQTARIT PËR HEQJEN E PARABURGIMIT	288
AKTVENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESES PËR HEQJEN E PARABURGIMIT.....	289
AKTVENDIM PËR DËNIM DISIPLINOR TË PARABURGOSURIT	291
URDHËRESË PËR KONTROLLIN E BANESËS	293

PROCESVERBAL PËR KONTROLLIMIN E BANESËS DHE PERSONAVE	294
URDHËRESA PËR MARRJEN E PËRKOSHME TË SENDEVE	296
URDHËRESA E GJYQTARIT PROCEDURËS PARAPRAKE PËR MBAJTJEN E LETRËS, TELEGRAMIT DHE DËRGESAVE TJERA	297
PROCESVERBAL MBI MARRJEN NË PYETJE TË PANDEHURIN	298
PROCESVERBAL MBI DËGJIMIN E DËSHMITARIT	300
AKTVENDIM PËR DËNIMIN E DËSHMITARIT	302
PROCESVERBAL PËR KËQYRJEN E VENDIT TË NGJARRJES	303
PROCESVERBAL PËR REKONSTRUIMIN E VENDIT TË NGJARJES	307
URDHËRESA PËR EKSPERTIM DHE CAKTIMI I EKSPERTIT	309
URDHËRESA PËR EKSPERTIM ME RASTIN E AKSIDENTIT NË TRAFIK	311
URDHËRESË PËR KONTROLLIMIN E BANESËS	312
RAPORTI I EKSPERTIT LIDHUR ME EKSPERTIZËN E KRYER	313
(DEKLARATË PËR TË HYRË NË NEGOCIATA PËR PRANIMIN E FAJËSISË)	316
MARRVESHJE PËR PRANIMIN E FAJËSISË	319
DËRGIMI I MARRVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË GJYKATËS	321
AKTAKUZË KUNDËR NJË PERSONI PËR NJË VEPËR PENALE	322
AKTAKUZË PËR SHUMË PERSONA PËR NJË VEPËR PENALE	325
AKTAKUZË PËR SHUMË PERSONA DHE DISA VEPRA PENALE	327
AKTAKUZË KUNDËR TRE PERSONA DY VEPRA PENALE	330
FORMË E AKTAKUZËS E NGRITUR NGA PROKURORJA E TRIBUNALIT TË HAGËS, NDAJ FUNKSIONARËVE CIVIL DHE USHTARAK TË SERBISË PËR KRIMET E KRYERA NË KOSOVË	335
AKTVENDIM PËR KTHYERJEN E AKTAKUZËS PËR TA PLOTSUAR	360
PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT FILLESTAR-KUR TË AKUZUARIT NUK KANË PRANUAR FAJËSINË	362
PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT TË DYTË FILLESTAR-KUR TË AKUZUARIT NUK KANË PRANUAR FAJËSINË	366
PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT TË PARË FILLESTAR, KUR I AKUZUARI E KA PRANUAR FAJËSINË	369
NJË FORMË E AKTVENDIMIT ME TË CILIN REFUZOHET KUNDËRSHTIMI I PALËVE PËR PAPRANUESHMËRINË E PROVAVE	372
AKTVENDIM PËR HEDHJEN E AKTAKUZËS	374
URDHËRESË PËR SJELLJE ME DHUNË E TË PANDEHURIT	376
AKTVENDIM PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT ME QËLLIM TË SIGURIMIT TË PREZENCËS SË TË AKUZUARIT NË SHQYRTIMIN GJYQËSOR	377
AKTVENDIM PËR DËNIMIN E DËSHMITARIT PËR SHKAK TË MUNGESËS GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR	378
PROCESVERBALI MBI SHQYRTIMIN GJYQËSOR	380

AKTGJYKIM ME TË CILËN AKUZA REFUZOHE	387
AKTGJYKIM ME TË CILIN I AKUZUARI LIROHET NGA AKUZA	389
AKTGJYKIMI ME TË CILIN SHQIPTOHET DËNIMI ME KUSHT(NENI 51 I KPK-s) , NË SHQYRTIMIN E PARË FILLESTAR, KUR I AKUZUARI KA PRANUAR FAJËSINË	392
NJË FORMË E AKTGJYKIMIT KUR I PANDEHURI LIROHET NGA DËNIMI (Neni 77.i KPK-s)GJATË SHQYRTIMIT TË PARË FILLESTAR ,KUR I PANDEHURI KA PRANUAR FAJËSINË	396
AKTGJYKIM ME TË CILIN I PANDEHURI SHPALLET FAJTOR	403
PËR NJË PERSON – PËR DISA VEPRA PENALE(VETËM DISPOZITIVI)	409
PËR DISA PERSONA, PËR DISA VEPRA PENALE(VETËM DISPOZITIVI)	411
ME LLOJET E NDRYSHME TË VENDIMEVE (VETËM DISPOZITIVI)	413
AKTVENDIM PËR PËRMIRËSIMIN E AKTGJYKIMIT	415
ANKESA E TË AKUZUARIT KUNDËR AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR TË GJITHA BAZAT LIGJORE	417
PËRGJIGJA NË ANKESËN KUNDËR AKTGJYKIMIT	421
AKTVENDIM PËR HEDHJEN E ANKESËS SI TË PASAFATSHME	423
AKTGJYKIMI ME TË CILIN ANKESA REFUZOHE SI E PABAZUAR	425
AKTVENDIM ME TË CILIN AKTGJYKIMI I SHKALLËS SË PARË ANULOHE	433
AKTGJYKIMI I SHKALLËS SË PARË NDRYSHOHET	438
ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT TË SHKALLËS SË DYTË	443
VENDIM I GJYKATËS SUPREME, LIDHUR ME ANKESËN KUNDËR AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË DYTË	445
RISHIKIMI I PROCEDURËS	454
NJË FORMË E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN NDRYSHOHEN AKTGJYKIMET E PLOTFUQISHME PA RISHIKIMIN E PROCEDURËS	454
KËRKESA PËR RISHIKIMIN E PROCEDURËS	455
KËRKESË PËR RISHIKIMIN E PROCEDURËS PENALE	457
NJË FORMË E AKTVENDIMIT ME TË CILIN KËRKESA PËR RISHIKIMIN E PROCEDURËS HEDHET	459
AKTVENDIMI ME TË CILIN REFUZOHE PROPOZIMI PËR PËRSËRITJEN E PROCEDURËS	460
AKTVENDIMI ME TË CILIN LEJOHE PËRSËRITJA E PROCEDURËS PENALE	462
DISPOZITIVET E NDRYSHME TË AKTGJYKIMIT NË PROCEDURËN E RISHIKIMIT TË DREJTË	465
KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT	468
AKTVENDIM ME TË CLIN APROVOHE KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT	470
AKTVENDIM ME TË CILIN REFUZOHE KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT	473
AKTVENDIM PËR REVOKIMIN E AKTVENDIMIT ME TË CILIN ËSHTË APROVUAR KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT	476
KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË	478

KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË	479
AKTGJYKIM ME TË CILIN KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË REFUZOEHT SI E PABAZUAR	490
AKTGJYKIM ME TË CILIN KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË APROVOHET SI E BAZUAR	492
AKTGJYKIM ME TË CILIN KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË APROVOHET SI E BAZUAR ANULOHEN AKTGJYKIMET E GJYKATAVE TË ULËTA).....	494
PROCEDURA PENALE NDAJ TË MITURVE	496
AKTVENDIM PËR BASHKIMIN E PROCEDURËS NDAJ TË MITURIT DHE MADHORIT	496
INFORMATA E PROKURORIT PUBLIK SE NUK DO E FILLOJ PROCEDURËN PENALE KUNDËR TË MITURIT	498
KALLZIM PENAL PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PREGADITORE NDAJ TË MITURIT	499
AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASAVE TË DIVERSITET NDAJ TË MITURIT	500
AKTVENDIM PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PREGADITORE NDAJ TË MITURIT	502
PROPOZIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKUESE TË MBYKËQYRJES NGA ANA E PRINDIT	504
AKTVENDIM I GJYQTARIT PËR TË MTIUR PËR PUSHIM TË PROCEDURËS NDAJ TË MITURIT.....	506
AKTVENDIMI I TRUPIT GJYKUES PËR TË MITUR PËR PUSHIMIN E PROCEDURËS PENALE NDAJ TË MITURIT	507
AKTVENDIMI I TRUPIT GJYKUES PËR TË MITUR PËR PUSHIMIN E PROCEDURËS PENALE NDAJ TË MITURIT, KUR NUK ËSHTË PROVUAR SE I MITURI KA KRYER VEPRËN PENALE	509
AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKUESE NDAJ TË MITURIT.....	512
AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKUESE NDAJ TË MITURIT DËRGIMI NË ENTIN EDUKUES KORREKTUES	515
AKTVENDIM PËR ZAVENDËSIMIN E MASËS EDUKUESE	520
AKTVENDIM PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT TË MASËS EDUKATIVE	522
PROPOZIM PËR DËNIM NDAJ TË MITURIT	523
AKTGJYKIM ME TË CILIN TË MITURIT I SHQIPTOHET DËNIMI	526
PROCEDURAT E VEÇANTA	531
NJË FORMË E AKTGJYKIMIT PËR DHËNIEN E URDHRI TË NDËSHKIMOR.....	531
AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E VËREJTJES GJYQËSORE.....	534
PROPOZIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK ME NDALIM NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR	536
AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK ME NDALIM NË INSTITUCIONIN SHËNDETËSOR.....	540
SHQIPTIMI I DËNIMIT DHE MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK, TË PANDEHURIT I CILI VEPRËN PENALE E KA KRYER NË GJENDJE TË PËRGJEGJËSISË ESENCIALISHT TË ZVOGËLUAR	544
AKTVENDIM PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT TË MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR	548

PROCEDURA E EKSTRADIMIT	551
AKTVENDIM ME TË CILIN REFUZOHET KËRKESA PËR EKSTRADIM.....	551
AKTVENDIM ME TË CILIN VËRTETOHET EKZISTIMI I SUPOZIMEVE LIGJORE PËR EKSTRADIMIN E SHTETASIT TË KOSOVËS.....	553
PROCEDURA PËR REVOKIMIN E DËNIMEVE ALTERNATIVE	555
NJË FORMË E DISPOZITIVIT TË AKTVENDIMIT PËR PUSHIMIN E PROCEDURËS PËR REVOKIMIN E DËNIMIT ME KUSHT.....	555
NJË FORMË E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN ÇAKTOHET AFAT I RI PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE.....	557
NJË FORMË E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN HIQET KUSHTI.....	559
NJË KOPJE E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN REVOKOHET GJYKIMI ME KUSHT.....	561
NJË FORMË E AKTVENDIMIT PËR SHLYERJEN E DËNIMIT ALTERNATIV- DËNIMIT ME KUSHT SIPAS DETYRËS ZYRTARE.....	563
NJË FORMË E KËRKESËS PËR SHLYERJEN E DËNIMIT NGA EVIDENCA.....	565
NJË FORMË E AKTVENDIMIT PËR SHLYRJEN E DËNIMIT NGA EVIDENCA ME KËRKESËN E TË DËNUARIT.....	566
PROCEDURA PËR KOMPENSIM PËR SHKAK TË PARABURGIMIT OSE DËNIMIT TË PALIGJSHËM	568
PROCEDURA PËR DHËNIEN E LETËRSHTIMIT	570
URDHËRESË PËR DHËNIEN E LETËRSHTIMIT.....	570
PROCEDURA PËR DHËNIEN E SHPALLJES	572
URDHËRESË PËR DHËNIEN E SHPALLJES.....	572
PROCEDURA E EKZEKUTIMIT TË SANKSIONIT PENAL	573
LUTJA PËR SHTYERJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNIMIT ME BURG.....	573
NJË FORMË E AKTVENDIMME TË CILIN REFUZOHET LUTJA PËR SHTYERJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNIMIT ME BURGIM.....	574
AKTVENDIM MBI SHTYERJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNËMIT ME BURGIM.....	576
ANKESA NDAJ AKTVENDIMIT ME TË CILIN ËSHTË REFUZUAR LUTJA PËR SHTYERJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNIMIT.....	577
AKTVENDIM I KRYETARIT TË GJYKATËS SË APELIT LIDHUR ME ANKESËN.....	579
PROCEDURA PËR FALJE	580
LUTJE PËR FALJE.....	580
PROCEDURA PËR KTHYERJEN E SENDIT	582
AKTVENDIM PËR KTHYERJEN E PASAPORTËS.....	582
LITERATURA.....	584

PJESA E PËRGGJITHSHME

HYRJE E SHKURTËR - RËNDËSIA E SHKRIMIT LIGJOR

Të mësuarit e të shkruarit si jurist, është një mënyrë tjetër për të mësuar e të menduarit si jurist

— *Terrill Pollman*

Shkrimi ligjor paraqet një prej faktorëve kryesor për cilësinë e procesit të drejtësi bërjes. Mbështetur, në rëndësinë domethënëse që paraqet, meriton t'i kushtohet vëmendje e veçantë nga të gjithë profesionistët ligjor, në veçanti nga gjyqtarë, prokurorë dhe avokatë të cilët luajnë rol thelbësor në sistemin e drejtësisë në një shoqëri demokratike.

Shkrimi ligjor në sistemin tonë karakterizohet në përgjithësi me shkrimin tradicional, që është përdorë më parë në vendet e sistemit kontinental, dhe kjo metodologji e të shkruarit ende është dominuese. Megjithatë, në vitet e fundit, sikur edhe shumë vende të cilat kanë filluar të përdorin metodologjinë e të shkruarit ligjor, e cila aplikohet tradicionalisht në vendet e common law, edhe tek ne ka lëvizje në këtë drejtim, por ende është shkallë të ulët.

Shkrimi ligjor pavarësisht se cilit sistem të të shkruarit i përket, duhet karakterizuar nga disa tipare që e bëjnë të qëndrueshëm, siç janë: qartësia, saktësia, konciziteti dhe komponenti analitik. Të shkruarit ligjor pa dyshim se kërkon disiplinë dhe ndjekjen e një strukturë të caktuar, në mënyrë që të bëjë të mundur paraqitjen dhe shqyrtimin në mënyrë të duhur si nga aspekti kronologjik, faktik ashtu dhe legal i çështjes ligjore. Nuk ekzistojnë norma ligjore që formalizojnë mënyrën e shprehjes së opinionëve, argumenteve, teorive dhe se udhëzimet nga ky doracak duhet të konceptohen si të tilla. Shkrimi ligjor duhet të paraqes pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejt dhe të plotë të çështjes, shkrimi i mirë e bënë aktin të qëndrueshëm dhe të pakontestueshëm në raport me mjetet juridike si në sistemin nacional ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Shkrimet e mira janë lehtësisht të dallueshme dhe të vlerësuara. Gjatë shkrimit ligjor është e rëndësishme që të jeni vetvetja, pasi do të i'u ndihmoj të shpreheni lirshëm, natyrshëm dhe të jeni më të drejtpërdrejtë me realitetin.

Vendimi gjyqësor nuk mund të dominohet nga përshkrimet e deklaratave të palëve, dëshmitarëve, ekspertizave dhe provave. Është e rëndësishme që gjyqtari të shpjegoj pse dhe si ka arritur në përfundimin për të cilën ka vendosur, pse i'u ka besuar dëshmitarëve apo jo, pse i konsideron se provat e caktuara janë të sakta, të vërteta dhe të besueshme apo nuk janë të tilla. Mos e shmangeni trajtimin e pretendimeve të ngritura nga palët, vetëm pse i'u duken të vështira, është pikërisht detyrë e gjyqtarit që të përgjigjeni në pretendimet e tilla. Mos harroni, gjyqtarët janë për të vlerësuar, analizuar, gjykuar, nuk janë për të përshkruar.

Prandaj, sasia e arsytimit pikërisht duhet të mbizotërohet nga pjesa analitike, nuk është e rëndësishme të jenë zgjatura, e rëndësishme është të jenë koncize dhe t'i trajtojë çështjet thelbësore. Vetëm një vendim i tillë do të plotësoj standardin për vendim kualitativ dhe të arsytuar mirë.

I. UDHËZIMET E SHKRIMIT LIGJOR

Shkrimi ligjor tradicionalisht ka identifikuar disa rregulla, të cilat tani më konsiderohen si udhëzime të konsoliduara të shkruarit mirë ligjor, siç janë: të shkruarit lehtë për lexuesin, të shkruarit jo si jurist, organizimi dhe skicimi i çështjeve, shkrimi i drejtpërdrejt në temë, përdorimi i titujve dhe pikave referuese, paragrafë të shkurtër, fjali tematike, fjali të shkurta dhe të qarta, lidhja e ideve me fraza të ndryshueshme, shmangia e paqartësive, përdorimi i formës aktive.¹

Përzgjedhja dhe përdorimi i duhur i fjalëve janë shumë të rëndësishme për një shkrim cilësor. Foljet veprorë e fuqizojnë dhe stimulojnë shkrimin. Përdorimi i gabuar i fjalëve e ulë vlerën e shkrimit ligjor.²

Me rastin e të shkruarit duhet të kihet parasysh lexuesi, a mund të kuptohet me lehtësi vendimi; a e justifikon plotësisht rezultatin; a i përmbush vendimi rregullat procedurale për një vendim të tillë; çështjet e rëndësishme të shqyrtohen të parat dhe shkrimi duhet të jetë i organizuar dhe i kuptueshëm. Po ashtu gjatë të shkruarit duhet të shmangeni të shkruarit vetëm si jurist, por duhet të shkruani natyrshëm, në mënyrë që shkrimi të mos jetë teknokratik. Përdorimi i skicave do të ndihmon në përcaktimin e çështjeve, skica mund të jetë çdo gjë që funksionon si formale me shkrim, një skemë e fakteve të rëndësishme, çështjeve dhe pikave të diskutimit dhe shtjellimi, një

¹ Mirela Bogdani “ Shkrimi & Arsyetimi Ligjor (cikël leksionesh -Tiranë, 2015)

² Sokol Berberi “Arsyetimi dhe Shkrimi Ligjor (Ribotim- Tiranë, 2012), fq. 124.

listë e plotë me pika, ndoshta vetëm një kuadër mendimi, madje edhe një skicë pa vija apo diagram.³ Shkrimi i mirë ligjor të çon drejtë në temë. Përdorimi i një paragrafi prezantues për të përmbledhur çështjen dhe duke kaluar drejtpërdrejtë në temë, duke i bërë të ditur lexuesit se për çfarë bën fjalë çështja dhe se cili është vendimi i juaj.

Përdorimi i titujve dhe pikave referuese do të ishte i dobishëm dhe kjo i mundëson lexuesit lexim të organizuar dhe ofron kalime nga njëri tek tjetri në mënyrë strukturore dhe logjike. Pikat referuese përmbledhin atë që do të diskutohet. Përdorimi i tyre, veçanërisht në fillim të secilës pjesë kryesore të analizës gjyqësore. Shërbejnë si hartë dhe e ndihmojnë lexuesin të shqyrtojnë argumentin. Po ashtu, ato ndihmojnë në organizimin e mendimeve të autorit si dhe në testimin e logjikës së vendimit, bënë kalimin në mënyrë logjike nga njëra pjesë tek tjetra, ndihmojnë lexuesin të kuptojë vendimin që po shtjellon autori.

Titujt e seksioneve nuk janë të vetmet mjete për organizimin e argumenteve. Në çdo seksion paragrafët luajnë të njëjtin funksion.⁴ Paragrafët organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e materialit, duke e ndarë atë në njësi më të thjeshtë. Është e vështirë të kuptohet tema kur nuk ka ndarje në paragraf. Çdo fillim i një ide apo temë të re, duhet të filloj me një paragraf të ri. Paragrafët duhet të jenë të shkurtër, shënojnë zhvillimin e plotë të një mendimi të vetëm, zhvillon një njësi mendimi që e dërgon lexuesin drejt një fjali tematike. Fjalja tematike, e cila shpreh temën qendrore të paragrafit, është zakonisht fjalia e parë e paragrafit dhe prezanton një çështje të re ose një mendim të ri.

Përdorimi i fjalive të shkurta dhe të qarta është esencial për një shkrim efektiv ligjor, fjalitë duhet të jenë të shkurta dhe të qarta. Pohimi kryesor duhet të vendoset sa më herët në fjali që të jetë e mundur, nuk duhet të ketë shumë koncepte në një fjali. Përshkrim i kësaj vështirësive në këtë segment shprehen përmes thënies së shkrimtarit të njohur *Arthur Koestler*, "*Në çdo gjuhë, është vështirë të bësh një fjali të thotë pikërisht atë që nënkuptoni ju*". Andaj procesi i transformimit të ideve dhe mendimeve në fjali të cilat pasqyrojnë saktë kuptimin tuaj, kërkon një qasje analitike, të kujdesshme dhe të mundimshme.

³ Id.

⁴ Making Your Case: The Art of Persuading Judges, Justice Antonin Scalia and Bryan E. Garner, Thomson West, May 2008, p.109.

Idetë duhet të lidhen dhe dokumenti duhet të lexohet lehtësisht nga një fjali në tjetrën, dhe nga një paragraf në tjetrin. Kalimet (shprehjet kalimtare nga një ide tek tjetra) lidhin idetë nga një paragraf në tjetrin, idenë nga një fjali në tjetrën. Përdorimi i shprehjeve lidhëse (kalimtare) për të sinjalizuar lidhjen midis fjalive apo paragrafëve. Përdorni përemra si 'ky', 'ajo', 'këto', dhe të tilla për të sinjalizuar lidhjen me fjalinë tjetër. Krijò rrjedhshmëri duke përdorur shprehjet lidhëse për të lidhur paragrafët.

Për të sinjalizuar kontrastin apo për të dalluar, të përdoret: *megjithatë, por, pavarësisht, ndryshe nga, gjithsesi, qoftë edhe, për kontrast, përkundër, edhe pse, ndonëse, sidoqoftë*, për alternativë, *ndërkohë*. Për të sinjalizuar analogji apo krahasim: *njësoj si, ashtu si, në të njëjtën mënyrë përsëri, gjithashtu, njëlloj, po ashtu*. Ilustruese (për të prezantuar një shembull) për *shembull, si shembull, në veçanti, veçanërisht, për të ilustruar*. Për të sjellë një rezultat: *sepse, prandaj, rrjedhimisht, si rezultat, përderisa, përfundimisht*.⁵

Në shkrime duhet të hiqen fjalitë e tepërta, të përdoret forma aktive në vend të asaj pasive, pasi me formën aktive të foljes, autori është kryefjala e fjalisë. Me formën pasive të foljes humb autori, rezultati është i ngathtë dhe me shumë fjalë. Fjalët të cilat shkruhen në fjali, duhet të jenë të peshuara, të përdorura në vendin e duhur, duhet pasur kujdes që të mos përdoren detaje të cilat konsiderohen jo të domosdoshme. Vëmendja e lexuesit është e çmuar, prandaj nuk duhet të shpërdoret me formën pasive të foljeve dhe me rrëmujë fjalie. Në këtë aspekt e pasqyron thënia e ish gjyqtarit të Gjykatës Supreme të SHBA-së Benjamin Cardozo, “...ka një saktësi që dëmton vetveten me theksim të tepruar të hollësive... fjalìa mund të jetë kaq e mbingarkuar me të gjitha atributet e mundshme, sa që ajo do të shembet nga pesha e saj”, në veprën “Law and Literatura”.

Paqartësitë në shkrim duhet bërë përpjekje të konsiderueshme të evitohen, në veçanti fjalët që përmbajnë dy kuptime apo më shumë kuptime, duhet zëvendësuar me fjalë më të qarta dhe më të thjeshta që shprehin qartazi kuptime më koncize, e cila arrihet duke përdorur fjalë të zakonshme dhe aktuale. Si rrjedhojë, shkrimi ligjor nuk nënkupton që të përdoren legalizma⁶ të panevojshme andaj, përdorni gjuhë të thjeshtë dhe rezistoni dëshirës për të tingëlluar si shumë legalistë, pa thënë asgjë domethënëse. Shmangni fjalët *siç u tha, e tillë, njëjtë, duke qenë, të lartpërmendurit,*

⁵ Mirela Bogdani “Shkrimi & Arsytimi Ligjor (cikël leksionesh -Tiranë, 2015)

⁶ Legalizmat janë gjuhe e juristëve, që përmbajnë fjalë të cilat nuk paraqiten jashtë profesionit ligjor. Alifya V. and Solomon, Lisa and Lebovits, Gerald, Ethical Judicial Opinion Writing (Spring 2008). Georgetown Journal of Legal Ethics, Vol. 21, p. 237, 2008.

këtu e tutje, po ashtu evitoni latinizmat e panevojshme. Gjithashtu duhet të evitoni shprehjet e panevojshme si: *rastin në fjalë, në rastin konkret, domethënë* etj. Legalizmat janë shenja të juristit llafazan dhe të pa eksperiencë, i cili përpiqet të duket si një dijetar. Zgjidhja është? Përdorni gjuhë të thjeshtë. Shkrimi në gjuhë të thjeshtë, nuk nënkupton përdorimin e gjuhës së folur ose shprehjeve jo formale (slange), dhe të cilat janë të kufizuara në një kontekst të caktuar ose nga një grup i njerëzve. Si jurist, shprehjet e tilla janë të papërshtatshme për shkrim ligjor. Të shkruarit në gjuhë të thjeshtë, nënkupton përdorimin e fjalëve të përditshme, se sa ti zbukuroj apo ti errësoj ato.⁷

Eliminoni gjuhën e nxitëse, shkrimi do të ketë më shumë fuqi nëse evitoni përdorimin e shprehjeve si *i egër, mizor, shokues, shqetësues*, për t'i përshkruar veprimet e të akuzuarit. Retorika e fryrë do ta minojë kredibilitetin dhe do t'i dobësojë argumentet tuaja. Në vend që të shkruani se i akuzuari është i egër dhe mizor, përshkruani se çka ka bërë i akuzuari, me fjalë të tjera provoni, e mos thuani.⁸

I. SHKRIMI LIGJOR DHE METODOLOGJIA E PËRDORIMIT TË FORMULËS IRAC

Shkrimi ligjor me përdorimin e metodës IRAC, përmes së cilës adresohen problemet ligjore.

Të gjitha shkrimet ligjore kane tre qëllime:

- a. të parashikojnë pasojën ligjore të veprimit juridik;
- b. të bindin adresantin (personi të cilit i drejtohet juridik apo fizik);
- c. të krijojnë obligime ligjore ose të parandalojnë kontestet në të ardhmen.⁹

Lloji i parë i të shkruarit quhet: objektiv ose të shkruarit parashikues; shkrim bindës; dhe shkrim preventiv (parandalues)

Shkrimi objektiv apo parashikues zakonisht është në formë të memorandumëve ose artikujve shkencor. Zyrat ligjore përpilojnë memorandumë të cilat janë dokumente që ndihmojnë të analizojnë përparësitë dhe dobësitë e rasteve të palëve të tyre. Dokument i cili përmban një

⁷ Effective Lawyering - A Checklist Approach to Legal Writing & Oral Argument ch.1(2d ed. Carolina Academic Press 2012).

⁸ Id.

⁹ Nadia E. Nedzel, "Legal Reasoning, and Writing for International Graduate Students, ch. 3 (3d. Wolters Kluwer Law Business in New York 2012), p.81.

analizë objektive në fushën e ngushtë të së drejtës dhe pastaj analiza për parashikimin, nëse gjykata do të vendos në favor të palës së tyre. Shumë artikuj shkencor analizojnë fushën e ngushtë të së drejtës, objektivisht dhe shpjegojnë se si gjykata ka vendosur, mënyrën se si e bëjnë duke komentuar dhe analizuar.

Shkrimi për të bindur, zakonisht përdoret për të bindur gjykatën për të vendosur në favor të palëve që ata prezantojnë, dhe përfshinë dokumentet siç janë kërkesat, memorandumet dhe të shkruarit në mënyre përmbledhëse.

Lloji i tretë i të shkruarit, apo shkrimi parandalues përdoret në draftimin e kontratave dhe dokumenteve analoge, qëllimi i së cilës është parandalimi i problemeve ligjore ose zgjidhja e tyre paraprakisht.¹⁰

1. Çka paraqet IRAC?

IRAC paraqet (Issue, Rule, Application, Conclusion - Çështja, Rregulla, Analiza/Aplikimi, Konkluzioni/Përfundimi), mënyrën e strukturuar dhe të organizuar të të shkruarit ligjor. Kjo metodë përdoret në mënyrë masovike në të shkruarit ligjor në SHBA, duke përfshirë fakultetet juridike, në hartimin e kërkesave, memorandumëve, akteve akuzuese, ankesave dhe vendimet gjyqësore.¹¹

Rrjedhimisht analiza IRAC, është një mjet mendimi, po ashtu mjet i të shkruarit. Përmes së cilës ekziston mundësia që problemi të trajtohet në mënyrë logjike, konsistente dhe të plotë (gjithëpërfshirëse). IRAC paraqet akronim (shkurtesë) e cila është standard i zhvillimit të argumenteve të silogjizmit në të dy aspektet, si në atë objektiv, ashtu edhe në atë bindës. Me përdorimin e metodës IRAC, çështjet ligjore adresohet si vijon,

- a. Identifikimin e problemit ligjor dhe normës ligjore;
- b. Shqyrtimi në detaje i komponentëve të normës (arsyetimi deduktiv);
- c. Analiza se si precedentët e mëparshme kanë definuar dhe shpjeguar këto komponentë, në dritën e fakteve të këtyre rasteve (arsyetimi induktiv);

¹⁰ Id.

¹¹ Nadia E. Nedzel, "Legal Reasoning, and Writing for International Graduate Students, ch. 3 (3d. Wolters Kluwer Law Business in New York 2012) p.83.

- d. Krahasimi i fakteve në rastin prezent me faktet e precedentëve, analizohet nëse secili komponent ose rregulle janë plotësuar ose themeluar (analogjia);
- e. Konkluzioni, nëse rregulla aplikohet

Në të drejtën zakonore (common law), arsyetimi përfshinë arsyetimin deduktiv, induktiv dhe analogjik. Nga aspekti praktik, një jurist hulumton problemin duke identifikuar në fillim normën ligjore e cila aplikohet, pastaj mbledh rastet që kanë interpretuar elemente të ndryshme të këtij ligji. Më pas duke përdorur metodën IRAC, në mënyrë të organizuar ekspansionon silogizimin, respektivisht arsyetimin deduktiv. Arsyetimi induktiv, është inkorporuar në hapin e tretë, kur juristët analizojnë çfarë kanë qene rastet e mëparshme rreth ligjit.

Arsyetimi analogjik, apo në bazë të ngjashmërisë inkorporohet në hapin e katërt, kur krahasohen faktet e këtij rasti me faktet e rasteve të mëparshme, që të shohin nëse mund të nxjerret analogji. Nëse rasti është i ngjashëm, nën parimin *stare decisis*. Nëse faktet e çështjes janë të ndryshme në mënyrë relevante nga ato të mëparshme, rasti dallohet nga rastet e mëparshme, arsyetimi duhet të jete se rezultati do të jetë ndryshe.

Metoda IRAC, në përdorimin e kulturave të ndryshme juridike mund të kërkoj disa adaptime, këtu njëkohësisht reflekton dallimi në mes të së drejtës civile asaj zakonore. Në të drejtën zakonore arsyetimi ligjor është përdorimi i analogjisë dhe fokusimi në faktet e veçanta, ndërsa në sistemin e të drejtës civile (kontinentale) nuk është edhe aq theksuar.

2. Identifikimi i Çështjes (Problemit)

Të mësuarit se si të përcaktohet problemi ligjor, është një detyre komplekse. Palët në përgjithësi në zyrë paraqiten me disa pyetje ligjore ose me rrëfime se diçka ka ndodhur. Pala mund të besoj se problemi është i thjeshtë, por pas ekzaminimit, mund të kuptohet se implikon një numër të fushave të ndryshme ligjore, secila prej tyre kërkon hulumtim të kujdesshëm dhe analizë. Problemi ligjor, mund të përkufizohet në mënyra të ndryshme, por vetëm me një ose dy fjali mund të jenë produktiv për hulumtim, i përshtatshëm për situatën ose në gjykatën e caktuar, për shkak se juridiksionet e ndryshme përdorin terme të ndryshme, madje edhe rregulla të ndryshme. Prandaj, detyrë kryesore e juristëve është të përkufizojnë problemin sa më saktë dhe në mënyrë sa më precize që është e mundur. Në përgjithësi, në fillim me një pyetje në tentativë e më vonë

ndryshon pas hulumtimit dhe analizës së zhvilluar. Pyetja zakonisht fokusohet në një ose më shumë komponentë të rregullës ligjore.

Formulimi kërkon identifikimin dhe ekzaminimin e rregullës së caktuar juridike, pastaj deshifrimin e saj në komponentë dhe në fund vendoset se si të përkufizohet pyetja. Rrjedhimisht, e para është çështja që duhet të përcaktohet si një çështje praktike, një jurist duhet të kuptoj normën ligjore që do të aplikohet para se ta përkufizoj problemin ligjor.

3. Ligji: Cili është ligji (norma) që rregullon çështjen në fjalë?

Paraqitja e rregullës (normës) trajton çështjen që i paraprin analizës, me paraqitjen e kësaj rregulle e cila duhet të analizoj duke identifikuar elementet përbërëse të saj, për të arritur konkluzionin.¹² Identifikimi i rregullës sipas formulës IRAC, është përshkrim i saktë dhe shpjegim i rregullës ligjore ose parimeve, që fokusohet në një rregull/dispozitë (ose rregulla/dispozita) kushtetuese, ligjore apo ndonjë rregull tjetër (ose rregulla të tjera) që është (ose janë) të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes. Në përgjithësi, përbëhet prej dy hapave. E para, rregulla zbërthehet në pjesë përbërëse dhe lidhet me njëra tjetrën. Pastaj çdo komponent analizohet duke përdorur referenca të autoriteteve të duhura. Për shembull, në analizën e ligjit duhet të konsiderohet jo vetëm gjuha e ligjit, por edhe se si gjykatat kanë interpretuar pjesë (segmente) të ndryshme të tij, respektivisht qëndrimet që praktika gjyqësore ka pasur në lidhje me interpretimin e normës së caktuar.¹³ Procesi i të shkruarit zhvillohet duke ndjekur hapat, pas përcaktimit të çështjes duhet të artikulohet rregulla. Rregulla dhe faktet janë ngushtësisht të lidhura. Analiza e fakteve nuk do të ketë kuptim, përderisa nuk identifikohet së pari rregulla që përcakton kuptimin ligjor që duhet t'i atribuohet këtyre fakteve.

Me qëllim të shpjegimit më të saktë dhe të qartë të rregullës, ndarja në komponentë përbërës konsiderohet e dobishme: a) Përkufizimet; b) Elementet; c) Përjashtimet nga rregulla e përgjithshme; d) Kufizimet e rregullës etj. Në këtë aspekt është e rëndësishme të ndiqet një hierarki e koncepteve nga e përgjithshmja në atë specifike. Pastaj përkufizimi i secilës shprehje ligjore të rëndësishme për shpjegimin e rregullës, identifikimi i pasojave të zbatimit të rregullës

¹² Sokol Berberi “Arsyetimi dhe Shkrimi Ligjor (Ribotim- Tiranë, 2012) fq. 101.

¹³ Nadia E. Nedzel, “ Legal Reasoning, and Writing for International Graduate Students, ch. 3 (3d. Wolters Kluwer Law Busines in New York 2012) p.86.

dhe çfarë janë konsekuencat e kësaj rregulle në situatën specifike.¹⁴ Prandaj kredibiliteti këtij seksioni mvaret nga shpjegimi i plotë, i qartë, konciz dhe i arsyetuar mirë i rregullave të obligueshme si dhe burimeve sekondare relevante, të cilat mund të hedhin dritë mbi kuptimin e drejtë të rregullës (normës).

4. Analiza: A aplikohet rregulli i mësipërm në faktet që lidhen me çështjen?

Në këtë seksion, duhet dhënë përgjigjen “*Si zbatohen rregullat e ligjit në faktet dhe rrethanat e veçanta të rastit konkret?*”¹⁵, respektivisht në këtë seksion aplikohet norma mbi faktet e rastit, dhe tregohet se si zbatohet në situatën e përcaktuar konkrete.

Analiza përfshin përcaktimin nëse çdo element i normës (apo normave) përkatëse, aplikohet ndaj fakteve për të konstatuar nëse çdo element thelbësor i normës, është (ose, nuk është) plotësuar me aspekte të veçanta të të dhënave faktike. Shpjegohet lidhshmëria e fakteve të çështjes me normën ligjore. Potencohen provat dhe dëshmitë, shpjegohet se si është arritur deri tek konkluzioni. Në të drejtën zakonore, zakonisht në këtë seksion vend të veçantë i kushtohet arsytimit mbi bazën e analogjisë, nëse është identifikuar një ose më shumë raste, të cilat janë mjaftueshëm të afërt me rastin aktual, analizohen ngjashmëritë dhe dallimet që ekzistojnë mes tyre. Potencohen precedentët, diskutohen qëndrimet juridike dhe precedentët të cilët garojnë me konkluzionin e arritur. Duhet të sigurohet se janë peshuar dhe vlerësuar argumentet e të dyja palëve, duke përfshirë edhe kundër argumentet.¹⁶ Përfundimisht, analiza përmban një përshkrim mbi normën ligjore, shpjegimin e saj, pastaj rregullat aplikohen te faktet e dhëna në rastin konkret. Adresimi i secilit element të normës, do të tregojë nëse janë ose nuk janë konstatuar lidhshmëritë e normës ligjore me faktet e situatës konkrete.¹⁷

¹⁴ missourilawyershelp.org/wp-content/uploads/2015/06/What-is-IRAC.pdf.

¹⁵ Trautman, Lawrence J. and Taylor, Cathy L. and Ford, Janet, *Irac! Irac! Irac!: How to Brief a Supreme Court Opinion* (August 21, 2016). Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2827285>

¹⁶ [IRAC/CRAC - Berkeley Law](https://www.law.berkeley.edu/files/IRAC_handout.doc) https://www.law.berkeley.edu/files/IRAC_handout.doc

¹⁷ Nadia E. Nedzel, “Legal Reasoning, and Writing for International Graduate Students, ch. 3 (3d. Wolters Kluwer Law Busines in New York 2012) p.92.

5. Konkluzioni

Është hapi përfundimtar në procesin e arsyetimit dhe përbëhet nga një deklaratë përfundimtare, mbi atë se si kjo çështje është zgjidhur (pjesërisht ose plotësisht) nga rezultatet e analizës.

Përfundimisht formula IRAC (Problemi/Çështja, Rregulli, Analiza dhe Përfundimi), përbënë elementë themelorë të analizës ligjore. Është proces përmes të cilit të gjithë juristët mendojnë rreth çdo problemi ligjor. Përmes kësaj formule reduktohet kompleksiteti i ligjit në një ekuacion të thjeshtë, panorama e së cilës duket:

- a. Problemi/ Çështja: Cilat janë faktet dhe rrethanat që shkaktuan konfliktin mes palëve?;
- b. Ligji: Cili është ligji (norma) që rregullon çështjen në fjalë?;
- c. Analiza: A aplikohet rregulli i mësipërm në faktet që lidhen me çështjen?;
- d. Konkluzioni/Përfundimi: Në vartësi nga fakti që ligji aplikohet apo jo në faktet e çështjes, personi do të akuzohet për kryerjen e veprës penale apo jo.¹⁸

II. ARSYETIMI LIGJOR

1. E drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor

Instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, nuk përmendin shprehimisht të drejtën për vendim gjyqësor të kuptueshëm dhe të arsyetuar. Megjithatë Teoria dhe praktika e GJEDNJ-së e konsideron si pjesë përbërëse të së drejtës për një gjykim të drejtë, të përcaktuar në dispozitën e nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane mbi Liritë dhe të Drejtat e Njeriut. Kjo rezulton nga një numër i vendimeve gjyqësore të GJEDNJ-së, të cilët shprehin qëndrimin juridik mbi të drejtën për një vendim gjyqësor të arsyetuar, por njëkohësisht edhe për një standard të përgjithshëm për arsyetimin e vendimeve. Rrjedhimisht, çështja e arsyetimi të vendimeve, paraqet një standard tani më të konceptuar si pjesë e të drejtës, për një proces të rregullt gjyqësor mbizotëron mendimi se interesat e drejtësisë, nuk mund të arrihen nëse vendimi gjyqësor nuk është në tërësi i arsyetuar. Çështjen e vëllimit dhe përfshirjes së arsyetimit, GJEDNJ-së e trajton në këtë mënyrë, duke ri-përsëritur se neni 6 § 1 obligon gjykatën të jap arsye për vendimet e tyre, nuk mund të nënkuptohet si kërkesë për një përgjigje të

¹⁸ Fejzullah Hasani, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Prof. James Moliterno, Prof. As. Dr. Valentina Hoxha, USAID, Projekti për Mbështetjen e Drejtësisë në Kosovë “Shkrimi, Arsyetimi dhe Hulumtimi Ligjor” – Instituti Gjyqësor i Kosovës - Prishtinë, 2008.

detajuar të çdo argumenti. Por, gjykata kërkon që të ekzaminoj nëse janë plotësuar argumentet e mjaftueshme dhe të duhura. Gjykata duhet të i'u përgjigjet palëve me argument esenciale, por se deri në çfarë shkalle duhet të aplikohet, varet nga natyra e vendimit dhe të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes.¹⁹

Shteteve i'u është lënë ne disponim që me rregullativën e tyre ligjore, të vendosin në mënyrë autonome se si të hartojnë aktgjykimet e tyre dhe si të rregullojnë procesin e nxjerrjes së vendimeve gjyqësore, diskrecioni i tyre nuk është absolut. Ekziston gjithnjë e më shume prirje që të sigurohet kualitet i lart i vendimeve gjyqësore, si dhe forcimi i mekanizmave për vlerësimin dhe përmirësimin e kualitetit të tyre.

Për rrjedhojë, arsyetimi i vendimeve gjyqësore është obligim ligjor i përcaktuar edhe në kodet e natyrës procedurale në legjislacionin tonë. Në lëmin penale, kjo është përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), ndërsa në lëmit e tjera në ligjet e tilla analoge. Sipas KPPRK-s në mënyrë eksplicite, parashihet obligimi që vendimet gjyqësore të jenë të arsyetuara, neni 370 paragrafi 1 i këtij Kodi, arsyetimin e përcakton si pjesë përbërëse të aktgjykimit. Ndërsa në dispozitat e tjera të këtij neni, përcaktohet në mënyrë specifike se çka duhet të përmbaj arsyetimi. *Inter alia*, gjykata është e obliguar që në arsyetimin e aktgjykimit të paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit, në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Ndërsa një obligim të veçantë për gjykatën, është të paraqes arsyet kur kemi të bëjmë me vlerësimin dhe saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij. Gjithashtu Ligji i Procedurës Kontestimore, përcakton se arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka

¹⁹ Van de Hurk v. the Netherlands, judgment of 19 April 1994, Series A no. 288, p. 20, § 61; Immeubles Groupe Kossier v. France (dec.), no. 38748/97, 9 March 1999; and Latournerie v. France (dec.), no. 50321/99, 10 December 2002).

shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato. Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve.²⁰

2. Funkzioni dhe përmbajtja arsyetimit të vendimit gjyqësor

Funksioni i një vendimi të arsyetuar, është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, duke i dhënë njëkohësisht mundësinë për të kundërshtuar atë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë, sipas procedurave përkatëse (përfshirë dhe Gjykatën Kushtetuese) dhe, që kjo të bëhet e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit në të cilin gjykata tregon me qartësi faktet, ligjin e zbatueshëm dhe arsyet që e kanë shtyrë për të bërë zgjedhjen ndërmjet disa mundësive. Para së gjithash, ajo duhet t'i japë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në proces, pavarësisht se në kuptimin kushtetues një përgjigje e detajuar nuk është në çdo rast e domosdoshme.²¹

Vendimet gjyqësore, në parim duhet të jenë të arsyetuara. Kualiteti i vendimeve gjyqësore kryesisht varet nga kualiteti i arsyetimit, arsyetimi adekuat është absolutisht i domosdoshëm në të cilën nuk duhet të ndikoj kërkesa për zgjidhje të shpejt. Arsyetimi i duhur nënkupton që gjyqtarët të kenë kohë të mjaftueshme për të përgatitur vendimet e tyre. Arsyetimi i vendimeve, jo vetëm se ju mundëson palëve që lehtësisht ti kuptojnë dhe ti pranojnë vendimet, por para se gjithash paraqet mbrojtje nga arbitrariteti. Në rend të parë, arsyetimi i obligon gjyqtarët të përgjigjen në pretendimet e palëve, ti paraqesin qëndrimet të cilat justifikojnë vendimin dhe e bëjnë të ligjshëm, i mundësojnë shoqërisë të kuptoj funksionimin e sistemit gjyqësor. Arsyetimet e vendimeve gjyqësore duhet me qenë konsistente, të qarta, jo të dy kuptueshme, nuk duhet të jenë kontradiktore ato duhet të mundësojnë lexuesit të përcjell argumentimin, të cilin gjyqtarin e ka ndjekur dhe e ka sjell deri te ky vendim.²²

Po ashtu, autorët modern të shkrimit ligjor i japin prioritet qartësisë, mbi të gjitha aspektet e tjera të të shkruarit ligjor, profesori i njohur Brian Garner dhe Antonin Scalia (ish gjyqtar i Gjykatës Supreme të SHBA-së), në librin e tyre *“Making Your Case”*, pretendojnë se cilësitë e shkrimit të

²⁰ Neni 160 paragrafi 4 dhe 5 i Ligjit të Procedurës Kontestimore

²¹ Shih vendimi nr.4, datë 05.02.2014, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

²² Article 36 of the Opinion No.11 (2008) of the Consultative Council of European Judges (CCJ) to the attention of the Committee of Ministers of the Council of Europe on the Quality of Judicial Decisions

mirë siç janë: eleganca e të shkruarit, shprehjet e sofistikuara, shkencore, këto dhe të gjitha kualitetet e tjera të të shkruarit, duhet të sakrifikohen nëse pakësojnë vlerën e qartësisë.²³

Arsyetimi duhet të përmbajë përgjigjet e ngritura nga palët në procedurë, në argumentet kryesore të akuzës apo të mbrojtjes së tyre. Ky është mekanizëm i domosdoshëm mbrojtës, pasi që ju mundëson palëve të jenë të sigurt, se pretendimet e tyre janë shqyrtuar dhe gjyqtari i ka marrë parasysh. Pa marrë parasysh në mundësinë ose detyrimin e gjyqtarit që në raste të caktuara të veprojnë me vetë iniciativë, gjyqtari duhet të përgjigjet në argumentet relevante të cilat mund të ndikojnë në zgjidhjen e kontestit. Arsyetimi, nuk duhet nënkuptuar se duhet të jetë i gjatë, por duhet të ekzistojë një baraspeshë mes koncizitetit dhe kuptimit adekuat të vendimit. Obligimi i gjykatave që t'i paraqes arsyet e vendimit, nuk nënkupton përgjigjen në çdo argument, të cilin mbrojtja e ka ngritur në pretendimin e saj. Ky obligim mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit. Arsyetimi varet nga argumentet e ndryshme të cilat i paraqesin palët, si dhe nga dispozitat e ndryshme ligjore, zakonet dhe parimet doktrinare, po ashtu edhe nga praktikata e ndryshme në hartimin dhe përpilimin e vendimeve në vende të ndryshme.

Kur shkruhet një vendim i arsyetuar, gjyqtari i çështjes, duhet të përshtatë një qasje e cila do të minimizojë mundësitë e apelimit. Vendimet e shkruara dobët, konfuze, jo logjike ose thjesht të pambështetura nga faktet legale dhe faktike, jo vetëm që mund të rrisin mundësinë që vendimi të anulohet, por do t'i bëjë palët më shumë të prira për të apeluar vendimin. Vendimi i mirë-shkruar do të lehtësojë procesin e apelit, duke u kufizuar në çështjet e kontestueshme.²⁴ Edhe nëse vendimi përfshin një çështje në të cilën ankesa është e mundshme (për shkak të natyrës së dispozitës), një vendim i shkruar mirë, mund të lehtësojë procesin e apelit duke kufizuar gamën e çështjeve të diskutueshme. Prandaj Gjykata e Apelit, do të ketë më lehtë për të zgjidhur një çështje që është formuluar ngushtësisht, se sa kur është dizajnuar gjerësisht, gjykatat e faktit kanë për detyrë të hartojnë aktgjykime të arsyetuara mirë dhe kjo konsiderohet si një aspekt i efikasitetit gjyqësor. Ndërsa kur hartohet një vendim, gjyqtarët e apelit duhet të kenë parasysh disa qëllime në mendjet e tyre. E para, është nevojë jo vetëm në aspektin konkret të çështjeve të caktuara, por edhe në nivel shoqëror, veçanërisht kanë obligim të arrijnë në rezultatin i cili është i përshtatshëm jo vetëm në çështjen konkrete (justice in personam) por, gjithashtu, edhe për rastet

²³ Antonin Scalia & Bryan A. Garner, *Making Your Case: The Art Of Persuading Judges* 107 (2008).

²⁴ S. I. Strong, *Writing Reasoned Decisions and Opinions: A Guide for Novice, Experienced, and Foreign Judges*, 2015 *J. Disp. Resol.* (2015) Available at: <http://scholarship.law.missouri.edu/jdr/vol2015/iss1/7>.

e ngjashme të cilat mund të arrijnë në të ardhmen (justice in rem). Pothuajse, kjo detyrë është mjaftë e dukshme në juridiksionet *common law*, si rezultat i aftësisë së *common law* që të zhvillojë parimet ligjore përmes precedentit. Në vendet me tradita civile gjykatat përpiqen të lëvizin në drejtim të konsistencës së praktikës gjyqësore, veçanërisht duke pasur në konsideratë vendimet gjyqësore të gjykatave më të larta.

Kur është në pyetje përmbajtja e vendimit gjyqësor, duhet të përmbajë shqyrtimin faktik dhe juridik të çështjes e cila është objekt i kontestit. Më rastin e shqyrtimit faktik te pyetjeve, gjyqtari nganjëherë do të përgjigjet në kundërshtimet e provave, veçanërisht në aspektin e pranueshmerisë së provave. Gjyqtari do të vlerësoj vlerën faktike të provave për të cilat pritet që të jenë relevante për zgjidhjen e çështjes.

Detyrimi i gjykatave për arsyetimin e vendimeve, nuk nënkupton se duhet përgjigjur çdo argumenti apo pretendimi të ngritur. Korniza e kësaj detyre mund të ndryshojë në harmoni me natyrën e vendimit. Vëllimi i arsyetimit në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, varet nga argumentet e ndryshme të secilës palë, si dhe në dispozitat e ndryshme ligjore, zakonet dhe parimet doktrinare dhe praktikave të ndryshme të shteteve të ndryshme në lidhje me prezantimin dhe hartimin e aktgjykimeve. Në harmoni me parimin e gjykimit të drejtë, arsyetimi duhet të demonstroj, se gjyqtari ka shqyrtuar me të vërtetë të gjitha çështjet kryesore të cilat janë paraqitur.²⁵

Në vendet e *common law*, vendimet e gjykatave të larta trajtojnë disa çështje juridike, të cilat shërbejnë si precedent detyrues në kontestet e ngjashme pas kësaj. Në vendet me tradita të së drejtës civile (kontinentale), vendimet nuk kanë këtë efekt, megjithatë mund të shërbejnë si udhëzime të rëndësishme për gjyqtarët të cilët merren me lëndë dhe pyetje të ngjashme, kur bëhet fjalë për lëndët të cilat kanë një rëndësi të madhe shoqërore dhe që hapin pyetje juridike. Arsyetimi i cili rezulton pas shqyrtimit detaj të pyetjeve juridike, në këto raste duhet të përgatitet me kujdes te posaçëm, në mënyrë që të plotësohen pritshmërit e palëve në procedurë dhe shoqërisë në përgjithësi.²⁶

²⁵ See in particular ECr.HR : *Boldea vs Romania*, 15 February 2007, § 29; *Helle vs Finland*, 19 February 1997, § 60.

²⁶ See Opinion No. 11 (2008), p. 45 of the CCJE.

Përderisa është pranuar kompetenca e gjyqtarëve në interpretimin e ligjit, gjithashtu duhet të përkujtohet obligimi i gjyqtarëve që të promovojnë sigurinë juridike. Në të vërtetë siguria juridike garanton parashikueshmërinë e aplikimit dhe përmbajtjes së normave ligjore, të cilat kontribuojnë në sigurimin e kualitetit të lartë të sistemit gjyqësor.²⁷

Gjyqtarët zakonisht në mënyrë konsistente zbatojnë ligjin. Megjithatë, kur gjykata vendos të devijojë nga praktika gjyqësore e mëparshme, duhet të përcaktoj në mënyrë të qartë në vendim. Në rrethana përjashtuese, për gjykatën ndoshta do të jetë më e përshtatshme të specifikoj se ky interpretim i ri, zbatohet nga data e nxjerrjes së vendimit në lëndë ose datës së përcaktuar në atë vendim.²⁸

3. Struktura e vendimit gjyqësor

Një vendim gjyqësor është një dokument zyrtar i fakteve thelbësore, i cili paraqet zbatimin e ligjit përkatës dhe vendimin mbi një padi (akuzë).²⁹ Profesori i jurisprudencës Orin Kerr thekson se "vendimi gjyqësor shpjegon se çfarë është rasti, shqyrton parimet përkatëse ligjore, dhe pastaj e zbaton ligjin në fakte për të arritur një vendim në favor të njëjës anë dhe kundër tjetrës".³⁰ Vendimi gjyqësor duhet të identifikojë çështjet e paraqitura, të përcaktojë faktet relevante dhe të zbatojë normën e duhur ligjore, me qëllim të marrjes së një vendimi të arsyetuar mirë për çështjet e zgjidhura.³¹ Kjo përmbajtje është e nevojshme, pasi vendimi gjyqësor është përgjigje autoritative për çështjet e ngritura nga palët, dhe duhet të shpjegoj arsyet mbi bazën e të cilave mbështetet vendimi gjyqësor.³² Modeli i të shkruarit përmban pesë seksione të përcaktuara si tituj të veçantë.

Pesë seksionet përfshijnë :

- a) paragrafin hyrës ose orientues;
- b) përmbledhjen e çështjeve që duhet të vendosen;

²⁷ Id. p.47.

²⁸ Id. p.49.

²⁹ Trautman, Lawrence J. and Taylor, Cathy L. and Ford, Janet, Irac! Irac! Irac!: How to Brief a Supreme Court Opinion (August 21, 2016). Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2827285>

³⁰ Orin S. Kerr, How to Read a Legal Opinion, 11 GREEN BAG 2d 51 (2007)

³¹ <http://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/judicial-writing-manual-2d-fjc-2013.pdf>

³² S. I. Strong, Writing Reasoned Decisions and Opinions: A Guide for Novice, Experienced, and Foreign Judges, 2015 J. Disp. Resol. (2015) Available at: <http://scholarship.law.missouri.edu/jdr/vol2015/iss1/7>

- c) përshkrimi i fakteve materiale;
- d) analiza e çështjeve ligjore dhe
- e) konkluzion.

Një vendim preferohet të ndjekë këtë strukturë, e cila në mënyrë të diferencuar ndan vendimin në komponent përbërës, mbi bazën e së cilës gjyqtarët trajton çështjet në mënyrë të organizuar.

a) Paragrafi hyrës - qëllimi i këtij paragrafi është ta orientojë lexuesin dhe të theksojë shkurtimisht se çka është rasti, çështja ligjore dhe rezultati. Gjithashtu mund të mbulojë edhe disa çështje në vijim:

- a. Palët duhet të identifikohen, nëse jo në hyrje, pastaj në fillim të vendimit mundësisht me emër, të cilat duhet të përdoren vazhdimisht, pasi që përdorimi i termeve ligjore, si "paditësi, i pandehuri" dhe " i padituri", duken të jenë konfuze, veçanërisht në rastet me shumë palë.
- b. Statusi procedural dhe juridiksioni: Baza e juridiksionit, procedurat përkatëse paraprake dhe mënyra se si është paraqitur lënda para gjykatës shpjegohen.
- c. Çështja (çështjet) - që do të vendosen duhet të identifikohen, përveç nëse janë të komplikuar, është më mirë të trajtohen në seksione të veçanta. Përmbledhja e epilogut në fillim mund të kursej kohën lexuesit, veçanërisht studiuesit që do të jenë në gjendje të përcaktojnë menjëherë nëse do të lexojnë pjesën tjetër të vendimit. Sigurimi i një përmbledhjeje të shkurtër të rezultatit në fillim të vendimit, gjithashtu i ndihmon gjyqtarët të deklarojë atë saktësisht dhe në mënyrë të përmbledhur. Versioni përfundimtar i hyrjes, mund të shkruhet më mirë pas përfundimit të vendimit, kur gjyqtari ka përpunuar çështjet, konkluzionet dhe analizën mbështetëse. Disa gjyqtarë preferojnë të vendosin zgjidhjen në fund, duke besuar se një vendim do të jetë më bindës nëse lexuesi duhet ta lexojë atë para se të mësojë rezultatin.

b) Përshkrimi çështjeve është gur themeli i vendimit, mënyra si janë formuluar përcakton cilat fakte janë materiale (relevante) dhe cilat parime ligjore rregullojnë çështjen e caktuar.³³ Përshkrimi i çështjeve duhet të jetë i shkurtër. Pothuajse një çështje ose dy mundet mjaftueshëm të identifikohen në hyrje, numri ose kompleksiteti, në disa raste mund të kërkojë të trajtohen në

³³ [http://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/\\$file/JudicialWritingManual.pdf](http://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/$file/JudicialWritingManual.pdf).

seksione të veçanta. Përshkrimi i çështjeve mund të vijë para ose pas përshkrimit të fakteve. Përcaktimi i çështjeve së pari do të bëjë përshkrimin e fakteve më kuptimplotë për lexuesin dhe do të ndihmojë në përqendrimin në faktet materiale. Sidoqoftë, në disa raste mund të jetë e vështirë të qartësohen, përveç nëse lexuesi është i njohur me faktet materiale. Kjo mund të jetë e vërtetë, për shembull, kur problemi është procedural dhe kërkon një shpjegim të kontekstit. Përshkrimi i çështjeve nuk duhet të ngatërrohet me theksimet e pretendimeve të palëve. Gjithashtu deklaratimet e gjata të kontestimeve të palëve, të gjetura në vendime, nuk janë zëvendësim i analizës dhe arsyetimit dhe si të tilla duhet të shmangen.³⁴

c) Përshkrimi i fakteve - Në rastin e një çështjeje, faktet mund të parashtrohen në fillim të vendimit, por kur kemi të bëjmë me disa fakte të caktuara, mund të mos jenë relevante për të gjitha çështjet. Kjo situatë ballafaqon gjyqtarin me detyrën e vështirë të paraqitjes së fakteve të mjaftueshme në fillim, për ta bërë vendimin e kuptueshëm, pa përsëritur më vonë fakte kur diskutohen problemet e veçanta që kërkojnë elaborim të mëtejshëm. Në një rast të tillë, përshkrimi fillestar i fakteve mund të kufizohet në sfondin e domosdoshëm historik dhe faktet vendimtare të vendimmarrjes, mund të inkorporohen në analizën e çështjeve që janë bërë.³⁵

Duhet të përfshihen vetëm faktet që janë të nevojshme për të shpjeguar vendimin, por ajo që është e nevojshme për të shpjeguar vendimin, nuk është gjithmonë e dukshme dhe mund të ndryshojë në varësi të audiencës. Vendimi duhet vetëm të identifikojë faktet që mbështesin përfundimin. Megjithatë, faktet historike nganjëherë mund të jenë të dobishme në dhënien e kontekstit të një vendimi dhe shpjegimin e arsyetimit të tij. Vendimet që mund të lexohen nga audienca të ndryshme përveç palëve, mund të kërkojnë përshkrime më të gjata të fakteve, për të siguruar kontekstin e vendimit dhe për të përcaktuar fushëveprimin e tyre.

Detajet e tepërta faktike mund të jenë konfuze, si psh: datat, kanë tendencë të ngatërrojnë lexuesit dhe nuk duhet të përfshihen, nëse ato nuk janë të rëndësishme për vendimin ose të dobishme për kuptimin e tij. Edhe pse shkurtësia dhe thjeshtësia janë gjithmonë të dëshirueshme, ato janë dytësore me nevojën për një përshkrim të plotë, të saktë dhe të drejtë të fakteve. Fakte të rëndësishme për palën e kundërt nuk duhet të hiqen. Mbi të gjitha, përshkrimi i fakteve duhet të

³⁴ Id.

³⁵ [https://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/\\$file/JudicialWritingManual.pdf](https://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/$file/JudicialWritingManual.pdf)

jetë i saktë. Gjyqtari nuk duhet të supozojë se faktet e theksuara në parashtresa nga palët janë të sakta, por duhet të bëjë gjithmonë verifikimin e saktë të tyre.³⁶

d) Analiza e çështjeve ligjore - Është thelbi i vendimit, duhet të tregojë se përfundimi i gjykatës bazohet në arsye dhe logjikë.³⁷ Ky seksion ofron një analizë të detajuar të çështjeve ligjore dhe paraqet arsyen e cila ka arritur rezultatin e çështjes. Është vetëm një detyrim për të përshkruar saktë argumentet në mbështetje të pozicionit të secilës palë në çdo çështje, dhe për të dhënë arsye të qarta që justifikojnë rezultatin.³⁸ Duhet të bindë lexuesin për korrektësinë e vendimit me fuqinë e arsyetimit. Gjyqtari duhet të merret me autoritetet kundërshtuese, argumentet e kundërta, dhe duhet të përballlet me to në mënyrë të hapur. Megjithëse vendimi nuk duhet të trajtojë çdo pretendim, diskutimi i normës ligjore duhet të jetë i mjaftueshëm për t'i demonstruar palës humbëse, se gjykata i ka konsideruar plotësisht aspektet kryesore të pozicionit të saj.³⁹

e) Konkluzioni - Seksioni i fundit i një vendimi të arsyetuar përfshin konkluzionin apo zgjidhjen e çështjes, zakonisht përbëhet nga një paragraf i vetëm ose një fjali në fund të vendimit. Përmbajtja e këtij seksioni ndryshon në varësi të llojit të gjykatës. Gjykatat duhet të jenë të sigurta se kanë trajtuar të gjitha pretendimet e palëve (paditësit) dhe mbrojtjes që të mos lënë zbrazëtirë që më vonë do të ankimohet.⁴⁰

4. Përdorimi dhe përshtatja e metodologjisë IRAC në të shkruarit ligjor në strukturën e vendimit gjyqësor sipas legjislacionit tonë

Metodologjia e të shkruarit ligjor IRAC, përdoret në shumë vende e posaçërisht në vendet e të drejtës anglosaksone, por edhe në gjykatat ndërkombëtare siç janë: Gjykata Penale Ndërkombëtare (ICC), Gjykata Penale Ndërkombëtare për Territorin e ish Jugosllavisë (ICTY), Gjykata Penale Ndërkombëtare për Ruandë (ICTR), Gjykata Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut (ECHR-GJEDNj), Gjykata Evropiane e Drejtësisë (ECJ), gjithashtu edhe në vendet me tradita civile, sidomos nga gjykatat kushtetuese dhe të larta të këtyre vendeve ka filluar dhe zbatohen metodologjitë e tilla të të shkruarit. Prandaj aplikimi i metodologjisë së të shkruarit

³⁶ Judicial Writing Manual 1991, Federal Judicial Center.

³⁷ [https://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/\\$file/JudicialWritingManual.pdf](https://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/$file/JudicialWritingManual.pdf).

³⁸ S. I. Strong, Writing Reasoned Decisions and Opinions: A Guide for Novice, Experienced, and Foreign Judges, 2015 J. Disp. Resol. (2015) Available at: <http://scholarship.law.missouri.edu/jdr/vol2015/iss1/7>.

³⁹ [https://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/\\$file/JudicialWritingManual.pdf](https://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/JudicialWritingManual.pdf/$file/JudicialWritingManual.pdf)

⁴⁰ Id.

ligjor duke e ndjekur metodën e njohur IRAC, kërkon fleksibilitet dhe adaptim me kërkesat imperative të legjislationit të vendit.

4.1 Struktura e vendimeve sipas legjislationit tonë

Struktura e vendimeve sipas legjislationit përmban pjesët kryesore të cilat janë edhe kërkesa imperative ligjore siç janë hyrja, dispozitivi dhe arsyetimi.

Pjesa hyrëse zakonisht identifikon palët, objektin e kontestit, respektivisht akuzën në çështjet penale, përfaqësuesit e palëve dhe të dhëna të tjera të natyrës teknike, që kanë të bëjnë me emrin e gjykatës, kohën, datën e mbajtje së seancës, emrin e gjyqtarëve të trupit gjykues apo kolegjit etj.

Dispozitivi përmban pjesën e kryesore të vendimit dhe përshkruhet se si dhe çka është vendos në çështjen konkrete. Në praktikë ndodhë që pikërisht pjesa urdhëruese të mos jetë mjaftueshmërisht e qartë dhe të krijoj konfuzitet në fazat e mëvonshme, madje edhe me rastin e ekzekutimit. Praktika gjyqësore, tregon se ekzistojnë vendime që anulohen, pikërisht për shkak të gabimeve në pjesën e dispozitivit, si për shkak të gabimeve përmbajtësore apo për shkak të jo koncizitetit. Mungesat dhe paqartësitë e tilla, bëjnë që vendimet të jenë të paqëndrueshme, të cilat rezultojnë me anulime dhe rigjykime të serishme dhe të njëjtat kanë efekt negativ në besueshmërinë dhe profesionalizmin tek gjykatat në opinionin publik.

Një mundësi për gabime tek gjyqtarët është, se nganjëherë gabimet kanë gjenezën që në aktin i cili shqyrtohet para gjykatës, dhe vëmendja jo e mjaftueshme dhe shqyrtimi jo-kritik, bënë që këto gabime dhe lëshime të barten edhe tek vendimet gjyqësore, shembull i tillë është kur në aktakuzë nuk përshkruhen veprimet inkriminuese të akuzuarit, respektivisht nuk qartësohet se cili është *actus reus (veprimi inkriminues)*, apo përshkruhen në mënyrë abstrakte pa e specifikuar saktësisht se për cilin veprim dyshohet se i pandehuri ka kryer. Nuk subsumohen në mënyrën e duhur veprimet e të pandehurit me normën ligjore që sanksionon veprën penale, përkatësisht nuk bëhet integrimi i veprimeve faktike inkriminuese i të pandehurit me tiparet e veprës penale. Sidomos mos konkretizimi i veprimeve inkriminuese ndodhë, tek rastet që kanë të bëjnë me shumë kryes të veprës penale, të cilët kanë vepruar në bashkëkryerje, zakonisht bëhet një përshkrim i përgjithshëm dhe i paspecifikuar se cilët veprime apo çfarë kontributi ka dhënë secili nga bashkë kryesit në arritjen e rezultatit të përbashkët kriminal. Vetëm pas vlerësimit të secilit

kontribut, gjykata do të vlerësoj nëse një kontribut i tillë ka qenë i asaj rëndësie dhe kualiteti, që ka ndikuar në mënyrë thelbësore në kryerjen e veprës penale, në të kundërtën bëhet fjalë për ndonjë formë tjetër të bashkëpunimit, por jo edhe të formës më të rëndë të bashkëkryerjes. Pasi që varësisht nga roli i secilit të pandehur përcaktohet edhe shkalla e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Në veçanti, duhet pasur kujdes kur kemi të bëjmë me çështje më të komplikuar, për shkak të numrit të madh të palëve, veprave penale, disa objekte të kontestit ose vendosjes ndryshe, gjegjësisht dispozitiv me vendime si dënues, lirues, refuzues, ndërsa në çështjet civile kërkesë padi të aprovuara, të refuzuara, preferohen të përdoren nën ndarje si në numra romak, apo në shkronja, nga e cila do të rezultonte qartë dallueshmëria mes këtyre pjesëve dhe do të ruhet konsistenca dhe qartësia.

Rrjedhimisht, pjesa e dispozitivit duhet të shkruhet në gjuhë të thjeshtë, të rëndomtë, pa komplikime dhe legalizma të panevojshëm, është me rëndësi që të kuptohet nga çdo lexues, pa qenë e nevojshme të posedoj arsimim juridik. Shkurtësia, konciziteti, kuptueshmëria, duhet të jenë tipare përshkruese dhe thelbësore të një dispozitivi të qëndrueshëm dhe të mirë punuar, ngase vetëm një i tillë garanton ekzekutim të saktë, profesional dhe siguri të lartë juridike.

4.2 Arsyet e vendimit apo ratio decidendi

Si shkruet profesionist, gjyqtarët duhet të posedojnë aftësi të mira të të shkruarit. Aftësitë e tilla nuk janë të natyrshme, ato fitohen përmes procesit të mësuarit. Nëse një gjyqtar do të shkruajë në mënyrë të duhur, duhet së pari të mendojë në mënyrë të qartë dhe mendime qartësisht të përcaktuara. Për të bërë këtë, nevojitet njohuri për elementet e të menduarit reflektues dhe rregullat e logjikës deduktive dhe induktive. Çdo gjyqtar i cili është jo i gatshëm ose i paaftë për të bërë këtë, do të sjellë lexuesin në konfuzion, dhe nuk mund të kryej detyrën e tij gjyqësore në mënyrë profesionale.

Arsyet e vendimit na shpjegojnë pse dhe si është arritur tek vendimi i caktuar. Procesi gjyqësor është i ndarë në dy pjesë të veçanta. E para është procesi i marrjes së vendimit, e dyta është procesi i arsyetimit - shpjegimi dhe analiza, që justifikon përfundimin në të cilin gjykata ka arritur. Kritikat më të mëdha janë drejtuar pikërisht në arsyetimin e vendimeve. Gjyqtarët duhet të demonstrojnë shkrim superior dhe aftësi të mira shpjeguese. Qëllimi i arsyetimit të një

vendimi gjyqësor është për të bindur çdo lexues, që logjika e shëndoshë mbështet vendimin e gjykatës dhe se arsyetimi duhet të ofrojë qartësinë e mjaftueshme. Struktura e vendimeve gjyqësore paraqet një çështje mjaft të rëndësishme, për faktin se aktualisht vendimet karakterizohen me metodologji, stile të ndryshme dhe dallueshmëri, sa i përket cilësisë së vendimeve gjyqësore. Qasja e standardizuar e vendimeve gjyqësore mund të jetë dobiprurëse në kuptimin e avancimit të kualitetit.

Arsyetimi është pjesa më e vështirë e vendimit, në të cilën gjyqtarët duhet të shpjegojnë arsyet se pse kanë marrë një vendim të caktuar. Një pjesë e arsyetimit në fillim është e nevojshme të përshkruaj historikun e çështjes. Qëllimi i pjesës hyrëse është të orientoj lexuesin në çështje, si ka filluar dhe paraqitur para gjykatës për të trajtuar si çështje, mund të bëjë fjalë edhe për aspekte të juridiksionit, përshkruan mbajtjen e seancave dhe aktivitetet e gjykatës në drejtim të përfundimit të lëndës.

Më pastaj paraqitet një prezantim më i saktë i çështjes, i cili përbëhet nga përshkrimi i fakteve dhe rrethanave të rastit, duke bërë që të kuptohet thelbi i çështjes që është objekt për t'u vendosur. Çështjet që do të vendosen, përderisa ato janë komplekse, do të ishte më mirë të trajtohen në seksione të veçanta, paraqitja e tyre është themeli i vendimit, andaj edhe mënyra se si janë formuluar përcaktohen, se cilat fakte janë materiale dhe çfarë parime ligjore zbatohen. Çështja e ngritur nga palët, nuk do të thotë se ajo duhet të trajtohet në vendim nëse nuk është materiale – relevante për epilogun. Vetëm faktet që janë të nevojshme për të shpjeguar vendimin, duhet të përfshihen por ajo që është e nevojshme për të shpjeguar vendimin, nuk është gjithmonë e qartë dhe mund të ndryshojë në varësi të audiencës. Faktet historike, nganjëherë mund të jenë të dobishme në dhënien e kontekstit të vendimit, shpjegimin dhe arsyetimin e saj. Përderisa shkurtësia dhe thjeshtësia, janë gjithmonë të dëshirueshme, ato janë sekondare krahasuar me nevojën për një përshkrim të plotë dhe të drejtë.⁴¹

Diskutimi i dispozitës ligjore materiale dhe i parimeve ligjore është thelbi i vendimit. Gjyqtari duhet të shpjegoj normën ligjore, se si rregullohet çështja, duhet të tregojë se përfundimi i gjykatës është i bazuar në arsyen dhe logjikën, e cila duhet të bindë lexuesin për korrektësinë e vendimit nga fuqia e arsyetimit të saj. Nëse bëhet fjalë për vendosje në çështje penale, është e domosdoshme të sqarohen mjaftueshëm tiparet e veprës penale, si nga pikëpamja objektive ashtu

⁴¹ <http://www2.fjc.gov/sites/default/files/2014/Judicial-Writing-Manual-2D-FJC-2013.pdf>

edhe nga pikëpamja subjektive, se çfarë forme fajësie kërkohet apo është e nevojshme për të ekzistuar vepra e caktuar penale. Nëse bëhet fjalë për kontest të natyrës civile me objekt kontesti fitimin e pronësisë mbi baza të ndryshme, të shpjegohet ligji material, si psh: fitimi i pronësisë, konkurrencën e bazave të fitimit të pronësisë dhe cila pre tyre është prevalente.

Pas kësaj të kaloj në pjesën e analizës së fakteve, nëse faktet konkrete të çështjes janë të asaj natyre, kualiteti dhe të tilla çfarë kërkohet nga dispozitat e ligjit material, andaj edhe prodhojnë pasojën e caktuar juridike.

4.3 Analiza e duhur e provave është thelbësore për një aktgjykim cilësor

Praktika gjyqësore është e mbushur me vendime gjyqësore të karakterit përshkruar dhe voluminoz, përshkrimi i ekzagjeruar i deklaratave të dëshmitarëve dhe provave është i panevojshëm dhe i shkakton dëm komponentës analitike të vendimit. Prandaj njohja e cilësisë së provave, është fundamentale për një vlerësim të saktë dhe objektiv të tyre, për prova të tilla siç janë dokumentet, fotografitë, provat mjeko-ligjore apo provat tjera materiale, ka tre faktorë të rëndësishëm lidhur me besueshmërinë e tyre: autenticiteti, saktësia dhe mbështetshmëria.⁴² Autenticiteti tregon se prova nuk është falsifikuar, nuk është e gabuar dhe nuk është dëmtuar. Saktësia nënkupton se procesi që ka rezultuar në prova apo vetë prova është e vërtetë. Kjo mund të nënkuptojë që të dhënat bankare, janë krijuar përmes praktikave të rregullta bankare, prandaj ato janë të sakta. Gjithashtu mund të nënkuptojë që fotografia e cila shfaq një imazh të deformuar dhe çorientues është e pasaktë. Provave shpesh i'u mungon besueshmëria sepse janë të pasakta. Mbështetshmëria tregon nëse procesi është i besueshëm dhe konsistent. Pajisjet laboratorike në gjendje jo të rregullt, mund të prodhojnë rezultate të pasakta të testeve mjekësore, pasi që ato pajisje nuk janë kalibruar apo testuar.⁴³

Shqyrtimi i besueshmërisë dhe kredibilitetit të dëshmitarëve, është i një rëndësie të veçantë, është e nevojshme që detajisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, të analizohet pse dëshmia e një dëshmitari është e besueshme apo nuk është, si në aspektin material të dëshmisë, ashtu edhe në aspektin e personalitetit të dëshmitarit. Nëse kemi të bëjmë me një dëshmitar tërësisht të pavarur, objektiv dhe të pa-interesuar për epilogun, apo kemi të bëjmë me një dëshmitar për të cilën

⁴² T. Anderson, D. Schum and William Twining, *Analysis of Evidence*, p. 60-62 (Second Edition Cambridge 2005).

⁴³ http://www.oak-ks.org/repository/docs/Udhezues_i_Kodit_te_Procedures_Penale_976264.pdf

ekziston ndonjë rrethanë subjektive apo objektive, që do ta vinte në pyetje kredibilitetin e tij dhe rrjedhimisht edhe besueshmërinë e dëshmisë. Nëse dëshmia është konsistente me dëshminë e dhënë më parë gjatë procedurës hetimore apo deklaratimet në procedurat tjera, nëse dallimet janë relevante dhe thelbësore, apo bëhet fjalë për mospërputhje periferike, të parëndësishme dhe që mund të jenë edhe rezultat i natyrshëm i procesit të harresës me kalimin e kohës, nëse dëshmia është e pasaktë, në pikëpamje objektive por nga aspekti subjektiv dëshmitari është i ndershëm, përpiqet të thotë të vërtetën, nëse dëshmia është kontaminuar nga mendimet dhe opinionet e tjera madje, edhe jo qëllimisht por spontanisht, shpjegimet dhe arsyet që ka dhënë dëshmitari gjatë pyetjeve gjatë gjithë fazave të procedurës penale.

Faktorët e tillë duhet trajtuar dhe pasur në konsideratë para nxjerrjes së konkluzionit për përcaktimin e vërtetësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së dëshmisë së dëshmitarit. Në këtë kontekst, dyshimet e ngritura për dëshmi të rrejshme, duhet trajtuar me kujdes për të ardhur në një përfundim nëse kemi të bëjmë me një dëshmi të tillë, është e domosdoshme një analizë e hollësishme e dëshmisë. Për të nxjerrë përfundim nga çdo kontradiktë dhe pasaktësi, se kemi të bëjmë me dëshmi të rrejshme, do të ishte e ngjashme me kriminalizimin e dobësisë së perceptimit njerëzor. Për më tepër pasaktësitë dhe kundërthëniet, në mes deklaratimeve të bëra më parë gjatë procedurës dhe dëshmisë së dhënë para gjykatës, janë edhe rezultat i kalimit të kohës (sidomos tek proceset gjyqësore që zhvillohen pas kalimit të një kohe të gjatë). Memoria njerëzore me kalimin e kohës zbehet, andaj do të ishte gabim të trajtohet harresa, si të jetë sinonim i dhënies së dëshmisë së rrejshme. Për më tepër, dëshmia e rrejshme kërkon domosdoshmëri *mens rea*, se sa thjeshte një deklaratë të gabuar.⁴⁴ Por duhet të ekzistojnë arsye të fuqishme për të besuar se dëshmitari kishte njohuri dhe qëllimisht jep dëshmi të rrejshme, me qëllim të pengojë procesin e drejtë gjyqësor.

Është e ditur se nuk ekzistojnë rregulla për vlerësimin dhe peshimin e provave, që nënkupton se ligji nuk përshkruan një normë të përgjithshme lidhur me peshën dhe bindshmërinë e provave, megjithatë lloje të caktuara të dëshmive, siç është pranimi, identifikimi pamor ose gjurmët e gishtërinjve, në një farë mënyre ekziston një kontroll i kufizuar mbi vlerësimin e dëshmive të tilla. Psh: në shumë vende të juridiksionit të common law, gjyqtari ka për detyrë të paralajmëroj mbi veçorit e faktit, për mundësitë pasigurisë së identifikimit nga dëshmitarët. Në Angli, udhëzimet për jurinë mund të përfshijnë këshilla mbi vlerësimin e fazës së caktuar të dëshmive,

⁴⁴ The Prosecutor Versus Jean-Paul Akayesu Case No. Ictr-96-4-T, Judgement 2 September 1998, par.140.

dhe këto udhëzime nganjëherë përfshihen në udhëzimet specifike të përgatitura nga Bordi për Studime Gjyqësore (Judicial Studies Board). Gjyqtarët mund të tërheqin rastin nga juria mbi bazën e arsyes, se nuk ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme.⁴⁵ Në legjislacionin tonë përkatësisht Kodi i Procedurës i Republikës së Kosovës, nuk parasheh ndonjë kufizim të tillë dhe ekziston në trajtën e plotë ajo që njihet si çmuarja e lirë e provave.⁴⁶

Njëra prej çështjeve problematike në praktikën gjyqësore penale është identifikimi pamor nga dëshmitarët okular, sidomos të personave që nuk i kanë njohur më parë. Kjo tregon një situatë e cila kërkon kujdes të shtuar të gjyqtarëve me rastin e nxjerrjes së konkluzionit, se dëshmitari ka identifikuar të pandehurin në mënyrë të sigurt. Jurisprudenca ka treguar se gabimet ndodhin, madje edhe tek dëshmitarët shumë të ndershëm dhe në dukje mbresëlënëse, dhe kjo thjeshtë reflekton perceptimin jo perfekt njerëzor që duhet marrë me rezerva dhe shumë maturi. Në SHBA identifikimi i gabuar nga dëshmitarët, trajtohet si shkaktari kryesor i dënimeve të gabuara.⁴⁷ Komuniteti legal në këtë vend që një kohë të gjatë ka pranuar, se dobësitë e identifikimit nga dëshmitari, janë mirë të njohura. Gjykata Supreme e Austrisë, ka theksuar se kur identifikimi i të akuzuarit mvaret nga një dëshmitar i vetëm, autoritetet duhet të jenë skajshmërisht të kujdesshëm në adresimin e argumenteve specifike, të ngritura nga i pandehuri rreth kredibilitetit të dëshmitarit⁴⁸.

Gjykatat në interes të drejtësisë, procedojnë me kujdes të lartë, me rastin e vlerësimit të identifikimit nga dëshmitarët të bërë në rrethana të vështira. Derisa gjykata e faktit nuk është e obliguar ti referohet çdo pjese të dëshmisë në shqyrtim gjyqësor në aktgjykim, me të cilën është gjetur fajtor mbi bazën e identifikimit pamor, dëshmia e dhënë nga dëshmitari nën rrethana të vështirësuar, gjykata, duhet në mënyrë të përpiktë të zbatojë obligimin për një “vendim të arsyetuar”. Në veçanti vendimi i arsyetuar duhet kujdesshëm të artikulojë faktorët të cilët mbështesin identifikimin e të akuzuarit, dhe të adresojnë në mënyrë të duhur çdo faktor

⁴⁵ Anderson, D. Schum and W. Twining, *Analysis of Evidence*, Pg 227(2d Ed. Cambridge 2005).

⁴⁶ Neni 361 par. 2. të KPPRK-së Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

⁴⁷ See C. Ronald Huff Et Al., *Convicted but Innocent: Wrongful Conviction And Public Policy* 66 (1996) ("We believe that the single most important factor leading to wrongful conviction in the United States... is eye witness misidentification."); see also David L. Feige, "I'll Never Forget that Face": The Science and Law of the Double-Blind Sequential Lineup, *CHAMPION*, Jan./Feb. 2002, at 28("Mistaken identification is a leading cause of unjust incarceration.").

⁴⁸ See, e.g., *Oberster Gerichtshof*, 10 December 1992, 15 Os 150 / 92; 4 June 1996, 11 Os 59 / 96 and 20 March 2001, 11 Os 141 / 00.

domethënës të cilët ndikojnë negativisht në besueshmërinë dhe vërtetësinë e dëshmisë. Gjykata e Apelit të Kanadasë në rastin R. v Harper:

*“Kur të dhënat, duke përfshirë edhe arsyet për aktgjykimin, zbulojnë një mungesë të vlerësimit të provave relevante dhe veçanërisht mospërfillje të plotë të këtyre provave, atëherë i takon gjykatës së rishikimi të ndërhyjë”.*⁴⁹

Janë identifikuar një sërë faktorësh, por jo të gjithë, të cilët mund të bëjnë të pasigurt një vendim për përdorimin e dëshmisë identifikuese: *“identifikime të të akuzuarve nga dëshmitarët të cilët e kanë parë të dyshuarin kalimthi ose me një pamje të penguar; identifikime në errësi dhe si pasojë e një ngjarjeje traumatike të përjetuar nga dëshmitari; dëshmi mospërputhëse apo të pasakta për tiparet fizike të të dyshuarit në kohën e ngjarjes; identifikimi i gabuar apo një dëshmitar i cili mohon aftësinë e tij për të identifikuar të akuzuarin dhe pastaj e identifikon; ekzistenca e dëshmime mospërputhëse të dëshmitarit; dhe pretendimi i vonuar i rikujtimit prej dëshmitarit për të dyshuarin bashkë me “mundësinë e qartë” nga rrethanat se dëshmitari u ndikua nga sugjerimet e të tjerëve”.*⁵⁰ Prandaj është e dobishme që në rastet e identifikimit të merren parasysh faktorët e cekur më lartë, të cilët mund të shërbejnë si ndihmesë me rastin e çmuarjes, nëse kemi të bëjmë me një identifikim të saktë, të sigurt dhe të besueshëm apo jo.

4.4 Përballja me argumentet e kundërta

Vendimi i shkruar dhe i arsyetuar, pikërisht është dizajnuar për të shmangur arbitraritetin e pushtetit gjyqësor, si i tillë i'u shpjegon arsyet palëve, veçanërisht palës e cila ka humbur kontestin. Pala humbëse duhet të jetë e vetëdijshme dhe e kënaqur se argumentet e saj janë marrë në konsideratë, dhe janë vlerësuar në mënyrë të drejtë. Vendimi i shkruar gjyqësor, gjithashtu siguron publikun se vendimi është produkt i aktgjykimit të arsyetuar dhe analizës së kujdesshme, se sa një ushtrim arbitrar i autoritetit gjyqësor.⁵¹ Gjyqtarët duhet të merren me argumentet e kundërta, dhe duhet të përballen me çështje krejt haptazi. Edhe pse vendimi nuk duhet të trajtojë çdo kontestim, diskutimi i parimeve ligjore duhet të jetë i mjaftueshëm për të demonstruar palës

⁴⁹ R. v Harper, [1982] 1 S.C.R. 2.

⁵⁰ Prosecutor v. Kupreskic et al. (Appeal Judgement), IT-95-16-A, International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY), 23 October 2001, par.40.

⁵¹ Curtin, Alifya V. and Solomon, Lisa and Lebovits, Gerald, Ethical Judicial Opinion Writing (Spring 2008). Georgetown Journal of Legal Ethics, Vol. 21, p. 237, 2008.

humbëse se gjykata i ka konsideruar plotësisht bazat e pozicionit të saj.⁵² Nëse pala e humbur ka ngritur kundërshtime të konsiderueshme, vendimi duhet të shpjegojë pse janë refuzuar. Por vendimi nuk duhet hedhur poshtë argumentet e palës me një ton kontestimor ose armiqësorë, prej gjyqtarëve kërkohet të jenë profesionistë, të qetë, të durueshëm, dinjitoz dhe të sjellshëm. Është e rëndësishme për gjyqtarët të tregojnë pse gjykata ka vepruar drejt, e jo pse pala humbëse ishte gabim.⁵³

Shqyrtimi i argumenteve të kundërta, është njëra prej pjesëve mjaftë të rëndësishme të vendimit, gjyqtarët nuk kanë alternativë tjetër përpos që duhet të ballafaqohen patjetër me trajtimin e këtyre argumenteve, ngase kjo edhe karakterizon tipin, thelbin dhe natyrën e punës gjyqësore. Shmangia nga kjo pjesë, tregon se vendimi ka dobësi, është i paqëndrueshëm dhe mungesë profesionalizmi tek gjyqtarët. Gjykata duhet të bëjë të qartë qëndrimin sa i përket argumenteve të kundërta, përveç faktit se do të tregojnë se të njëjtat janë vlerësuar dhe shqyrtuar me vëmendjen e duhur, dhënia e shpjegimeve të plota, të mjaftueshme dhe në mënyrë të qartë i tregon audiencës dhe çdo lexuesi të interesuar, se pse argumentet e tilla nuk kanë pasur relevancën e duhur nga aspekti i ligjit material, apo çështjet faktike respektivisht, kanë shfaqur mungesë besueshmërie apo saktësisë së nevojshme për të mbështetur zgjidhjen alternative ligjore. Përgjigja në këto pretendime, bënë vendimin më të konsoliduar, ngritë autoritetin e gjykatave, tregon se gjyqtarët detajisht, objektivisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse, i kanë vlerësuar të gjitha faktet dhe bëjnë analizën e duhur ligjore të çështjes.

Për më tepër vendimet gjyqësore, duhet të karakterizohen nga bindshmëria e lartë, andaj me qëllim të rritjes së bindshmërisë dhe fuqizimit të arsytimit, citimi i precedentëve konsiderohet më se i dobishëm. E drejta jonë nuk bazohet në doktrinën e precedentit, megjithatë citimi i vendimeve të Gjykatave më të larta apo të Gjykatës së Strasburgut, do të jetë i mirëseardhur, përderisa ofron mbështetje të fuqishme arsytimit të vendosjes së çështjes, dhe një garanci se vendimi është konsistent me praktikën gjyqësore të ndjekur deri më tani.

Po ashtu në këtë aspekt shërbejnë edhe burimet dytësore siç janë: komentaret ligjor, artikuj të shqyrtimeve ligjore, traktatet, tekste shkencore, burimet jo ligjore, duhet të citohen me masë dhe vetëm të shërbejnë për një qëllim. Ky qëllim mund të jetë për t'iu referuar një analizë të shëndoshë

⁵² <http://www2.fjc.gov/sites/default/files/2014/Judicial-Writing-Manual-2D-FJC-2013.pdf>

⁵³ Timothy P. Terrell, Organizing Clear Opinions: Beyond Logic to Coherence and Character, 38 JUDGES' J., Spring 1999, at 4, 38

që mbështet arsyetimin e mendimit. Rrjedhimisht, disa autorë janë të respektuar në fushat e tyre të studimeve dhe opinionet e tyre shkencor janë bindëse, si të tilla mund të ofrojnë mbështetje të konsoliduar pikëpamjes së vendimeve.

4.5 Redaktimi i Vendimit Gjyqësor

Në fund është me rëndësi që vendimi të rilexohet, rishikohet dhe redaktohet, duke i kushtuar vëmendje të veçantë dhe eliminuar fjalët e panevojshme, rishkrimin e fjalive të paqarta, shmangien e përsëritjeve, riorganizim më të mirë, dhe duke e bërë të pastër dhe më të përpunuar mendimin.

Në redaktimet e vendimeve të tyre, gjyqtarët nuk duhet të fokusohen vetëm në gjuhën, gramatikën dhe stilin. Duhet të kontrollojnë për konsistencë të brendshme, analizën për të parë nëse vendimi ka adresuar të gjitha çështjet. Rishikoni diskutimin ligjor për të parë nëse vendimi i ka adresuar në mënyrë logjike çështjet që duhet të adresohen, dhe të shqyrtojnë nëse përfundimi ndjekë shqyrtimin e zhvilluar.

4.6 Roli dhe Rëndësia e Mendimit Mospajtues dhe Konkurrues

Në disa vende gjyqtarët në mënyrë të shprehur mund të japin mendimin pajtues ose mospajtues. Në këto raste mendimi i ndarë duhet të jete i publikuar së bashku me mendimin e shumicës. Gjyqtarët, në këtë mënyrë paraqesin plotësisht ose pjesërisht, mospajtim me vendimin të cilin e ka nxjerrë shumica, dhe gjyqtari jep arsyet për mospajtim, ose paraqet pretendimet se vendimin të cilin e kanë marrë shumica, mundet ose duhet të jetë i bazuar në arsye të tjera nga ato të cilat janë adoptuar (mendimi konkurrues).⁵⁴ Kjo mund t'i kontribuoj përmirësimit të përmbajtjes së vendimit dhe të ndihmojë se si të kuptohet vendimi, gjithashtu edhe evoluimi i të drejtës determinon mendime të cilat mund ti paralajmëron ndryshimet e ardhshme, ose botëkuptime të cilat ruajnë traditën koncepteve interpretuese.

Mendimi konkurrues dhe mospajtues, nuk duhet të shkruhen, përderisa gjyqtarët nuk kanë diçka domethënëse për të shtuar përtej pakënaqësisë personale me epilogun e rastit.⁵⁵ Pranimi i

⁵⁴ See Opinion No. 11 (2008) p.51 of the CCJE

⁵⁵ See generally Ruth Bader Ginsburg, Remarks On Writing Separately, 65 WASH L. REV. 133 (1990); Alex Simpson, Jr., Dissenting Opinions, 71 U. PA. L. REV. 205, 216 (1923) (“[N]o dissent should be filed unless it is reasonably certain a public gain, as distinguished from a private one, will result.”).

opinionëve mospajtuëse brenda kuadrit të vendimmarrjes gjyqësore, mund të varet më shumë në miratimin e tre hipotezave në vijim se sa në traditën dhe kulturën në vetvete ligjore.

Hipoteza e parë është se opinionet mospajtuëse nuk rrezikojnë koherencën e ligjit, me kusht që ligji kuptohet për të mundësuar ekzistencën e disa zgjidhjeve të mundshme për një pyetje të vetme, të paktën në mungesë të dispozitave të qarta dhe të sakta ligjore. E dyta është se legjitimiteti institucional i gjykatave, është në përputhje me pavarësinë individuale dhe paanshmërinë e gjyqtarëve. Hipoteza e tretë, në thelb paraqet një konkluzion i dy hipotezave fillestare, është se në një vendim gjyqësor shumica do të shihet si e mjaftueshme për t'iu dhënë autoritet vendimet gjyqësore. Me fjalë të tjera unanimiteti nuk është *condicio sine qua non* i legjitimitetit gjyqësor ose stabilitetit juridik.⁵⁶

Mendimi i ndarë duhet të jetë i argumentuar në mënyrë të duhur, në aspektin i cili reflekton se si gjyqtari pas vlerësimi të kujdesshëm, i ka kuptuar çështjet faktike dhe juridike. Mendimi mospajtuës dhe konkurrues, i ndihmojnë përmirësimit dhe cilësisë së vendimeve gjyqësore, për faktin se ofrojnë argumente alternative juridike rreth zgjidhjes së çështjes. Përderisa mendimi mospajtuës paraqet alternativën, duke përfshirë edhe interpretimin e ndryshëm dhe sa i përket bazës ligjore e cila udhëzon për një epilog të ndryshëm nga ajo çfarë është vendosur. Ndërsa mendimi konkurrues nuk konteston epilogun e çështjes, por bëhet fjalë për një interpretim të ndryshëm të bazave ligjore.

Në këtë botë polifonike (**shumëzërash**), është e rëndësishme për të njohur vlerën e të gjitha burimeve të mundshme të zërave të rinj. Përvojat kanadeze dhe amerikane, tregojnë se mendimet mospajtuëse në vendimet, kanë pasur rëndësi të madhe për shoqërinë civile, duke ngritur çështje të amandementimeve ligjore, të lejojë që ligji për t'iu përshtatur vlerave të rrjedhë realiteteve të shoqërisë. Kjo përshtatje ndodh gradualisht, përmes hulumtimeve, shpjegimeve dhe qasjeve të ndryshme të mundshme për një problem të vetëm, së bashku me përpjekjet e mendjet ligjore të tashme dhe të ardhmen e gjyqtarëve.⁵⁷

Mendimet mospajtuëse, kanë tendencë për të forcuar legjitimitetin e institucioneve gjyqësore, duke përforcuar paanshmërinë gjyqësore dhe kolegjalitetin, duke rritur koherencën e vendimeve

⁵⁶ L'Heureux-Dube, Claire. "The Dissenting Opinion: Voice of the Future?." *Osgoode Hall Law Journal* 38.3 (2000) : 495-517. <http://digitalcommons.osgoode.yorku.ca/ohlj/vol38/iss3/4>

⁵⁷ Id.

gjyqësore. Në të drejtën kushtetuese, opinionet mospajtuese, mund të luajnë një rol veçanërisht të dobishëm në lidhje me çështjet e të drejtave të njeriut, për shembull, si kundërshtimet kanë tendencë për të lehtësuar zhvillimin e një jurisprudencë të pasur, të aftë për të evoluar me kalimin e kohës.

Sigurisht, mendimet mospajtuese jo gjithmonë do të kontribuojnë në mënyrë domethënëse në ligj. Shpesh bëhen të vjetruara dhe të momentit që janë të publikuara, që nga gjykatat më të ulëta në përgjithësi përmendin vetëm mendimin e shumicës, duke pasur parasysh se vendimet mospajtuese në përgjithësi kanë pak vlera precedenciale. Ndonjëherë, megjithatë mendimet mospajtuese ruajnë forcën e tyre të plotë, dhe janë transformuar në fund të fundit në parime themelore ligjore, që nuk mund të kenë parë dritën e ditës nëse mendimet mospajtuese kishin qenë të ndaluara. Në të vërtetë, në këtë pasiguri qëndron një nga justifikimet më bindëse për të lejuar mendimin oponent, duke lejuar mendimet mospajtuese është siguruar që fara e inovacionit nuk janë shtypur nën peshën e mendimit të shumicës, madje edhe para se ato të jenë në gjendje të vendosin rrënjë në frymën e ligjit.⁵⁸

Rrjedhimisht, mendimet e tilla konsiderojmë se avancojnë mënyrën e të kuptuarit dhe interpretuarit të drejt të normave ligjore, njëkohësisht ofrojnë një studim të gjithanshëm të problemeve dhe ofron mundësinë që të peshojë në mënyrën e duhur konkurrencën e argumenteve juridike, andaj si e tillë do të avancojnë cilësinë e arsytimit, duke e bërë me tepër analitik dhe justifikues.

⁵⁸ Id.

SHKRIMI DHE ARSYETIMI I VENDIMEVE GJYQËSORE – PUNA E GJYKATAVE LIDHUR ME ZBATIMIN ADEKUAT TË LPK-SË

HYRJE

PJESA E PARË

I. ARSYETIMI LIGJOR

Arsyetimi ligjor është procesi i të menduarit nëpërmjet të cilit juristët argumentojnë dhe gjyqtarët vendosin për çështjet.

Në vijim do të flasim për arsyetimin me analogji dhe arsyetimin deduktiv

1. Arsyetimi ligjor me analogji

Është metoda më e zakonshme e arsyetimit e përdorur nga profesioni ligjor. Ajo ka të bëjë me gjetjen e rasteve ose parimeve që gjykatat kanë vendosur për çështje të mëparshme dhe argumentimi se çështja në fjalë është e ngjashme me rastin apo parimin e mëparshëm. Arsyetimi ligjor me analogji përdoret në sistemin “Common laë”. Common laë është ligji i krijuar nga gjyqtarët, nëpërmjet vendimeve të tyre, në çështjet brenda kompetencave të tyre. Bërja e këtij ligji bazohet në modelin rast pas rasti.

Parimi qendror i common laë-it është parimi i “stare decisis”: çështjet ligjore të vendosur njëherë në një rast të duhur, nuk duhet të rihapen në raste të tjera, duke përfshirë të njëjtën çështje brenda të njëjtit juridiksion (derisa të ketë ndryshuar diçka që e justifikon ndryshimin e ligjit). Prandaj, pikat/çështjet e ligjit, të gjykuara tashmë, janë si rregull “detyruese ose autoritare” dhe ju referohen si autoritet ligjor. Parimi i “stare decisis” e mbështet doktrinën e common laë-it mbi precedentin që i trajton rastet e gjykuara më parë si autoritete për marrjen e vendimeve në rastet/çështjet e mëvonshme.

Arsyetimi nën doktrinën e precedentit bëhet, kryesisht, me anë të analogjisë, e cila në thelb kërkon që për rastet e ngjashme të merret vendimi i ngjashëm.

Në lidhje me sistemin “Common laë” duhet theksuar se pas teknikës, ideve dhe doktrinës karakteristike të juristëve të këtij sistemi ekziston një kuadër mendor i rëndësishëm. Ky është një kuadër mendor i cili zakonisht shikon konkréten tek sendet, jo abstrakten; i cili vendos besimin në praktikë më tepër se në abstraksion. Ky është një kuadër mendor i cili parapëlqen të shkojë përpara me kujdes duke u mbështetur në përvojën e këtij apo atij rasti për një rast tjetër në mënyrë që për çdo rast të zbatohet drejtësia e kërkuar, në vend që t’i referohet çdo gjëje të mëparshme ndaj një rasti universal të supozuar. Ky është një kuadër mendor i cili që qëndron pas

hapi të hedhur me siguri nga tradita anglo-sankone që merret me rastet ashtu siç dalin në vend që t'i paragjykojnë ato me formulime abstrakte universale.

Në arsyetimin ligjor me analogji duhet të ndiqen disa hapa në arsyetim.

Hapi i parë në arsyetimin me analogji është identifikimi i një pike bazë të saktë. Në ligj, “doktrina e precedentit” u jep një status të veçantë pikave bazë të çështjeve ligjore, mbi të cilat në të kaluarën është marrë një vendim nga gjykata më e lartë në juridiksionin përkatës. Çështjet e gjykuara në të shkuarën nga këto gjykata janë precedentët me autoritarë për të vendosur mbi çështjet e ardhshme, brenda juridiksioneve përkatëse. Natyrisht në këtë sistem ekziston mundësia që gjykata më e lartë të anuloj precedentët e vet dhe pastaj çështja që anulon zëvendëson çështjen që u anulua, si pikë bazë kompetente për çështjet e ardhshme të atij lloji.

Hapi i dytë në arsyetimin ligjor me analogji është identifikimi i ngjashmërive dhe i ndryshimeve konkrete në mes situatës së pikës bazë dhe një situatë problematike. Arsyetimi ligjor me anë të analogjisë përdorë një fjalor dhe një retorikë që thekson nevojën për një vëmendje rigoroze tek të dyja marrëdhëniet. Nëpërmjet analizës rigoroze të fakteve dhe rasteve, ju duhet procedoni për të identifikuar më shumë pikat e besueshme të ngjashmërive dhe të ndryshimit konkret.

Një gjyqtar apo vendimi ndjek precedentë, kur faktet e një precedenti janë kaq të ngjashme me ato të një rasti problematik, sa që kërkohet një rezultat i njëjtë (derisa çështja e mëhershme të anulohet). Një gjykatës ose rast dallon precedentin, kur faktet e një precedenti janë kaq të ndryshme, sa që kërkohet një rezultat i ndryshëm.

“Stare decisis” u kërkon gjykatësve që të dallojnë precedentë të pangjashëm, sikurse ju kërkon që të ndjekin precedentët e ngjashëm.

Në qoftë se një rast precedent duhet të ndiqet apo të dallohet, varet pjesërisht nga analiza e kujdeshme e fakteve të rastit precedent dhe nga analiza e fakteve të rastit problematik.

Duke punuar me anë të analogjisë, ju duhet të mblidhni faktet e rastit problematik, ashtu siç ato kanë qenë apo siç mund të jepen si provë në gjykatë. Analizojini ato, derisa t'i kuptoni në detaje. Përvetësimi i fakteve të vërtetueshme ligjërisht është vendimtar. Prezenca apo mungesa e një fakti të veçantë mund të bëhet pika, për të cilën një precedent përcaktohet si i ngjashëm apo jo i ngjashëm në një aspekt të rëndësishëm.

Hapi i tretë i arsyetimit ligjor me analogji është përcaktimi, nëse ngjashmëritë dhe dallimet faktike në mes të dy situatave janë më të rëndësishme në këto rrethana. Në ligj forma me analogji kërkon një gjykim, nëse një rast precedent do të ndiqet apo do të dallohet (duke hequr çdo pyetje mbizotëruese).

Në të vërtetë kur një gjyqtar gjen një apo më shumë vendime të një gjykate të lartë, një ligj që ati i duket i përshtatshëm për vendimin për rastin konkret, ai do të ndjekë ato vendime dhe ligje që përmbajnë ato njësoj si për shembull në “Gjermani” vend që nuk i përket sistemit të vendosjes

me analogji. Sigurisht për të qenë në gjendje të ndiqet një ligj, gjyqtari në fillim duhet ta ketë nxjerr atë nga praktika gjyqësore.

Teknika e gjyqtarëve që i përkasin këtij sistemi të së drejtës për shfrytëzimin e praktikës gjyqësore dhe nxjerrjes prej saj të ligjeve e parimeve është produkt i një tradite të vjetër të “arsyetimit nga rasti në rast”.

Në fakt në këtë sistem ekziston një mënyrë induktive e të menduarit, e mbështetur në problemin e veçantë të rastit, dhe trajtimi i gjerë i precedentëve që e shoqërojnë atë nuk gjendet në të drejtën kontinentale ose të paktën nuk gjendet në këtë masë.

Arsyetimi ligjor deduktiv

Arsyetimi ligjor në formën deduktive lidhet ngushtë me arsyetimin që rrjedhë nga ligji i miratuar, i cili zakonisht konsiston në rregullat të përgjithshme. Kjo ndodhë për arsye se gjyqtarët kontinental, janë ende të mbajtur me idenë e vjetër pozitiviste se të vendosësh për një rast do të thotë jo më shumë se të “zbatosh” një ligj të veçantë duke marrë parasysh faktet e çështjes në fjalë me anë të një akti kategorizimi; shpesh ata kanë parasysh supozimin se në mënyrë ideale ligjet e së drejtës që do të “zbatohen” janë përmbledhje e vendimeve gjyqësore dhe se për kontrast ligjet dhe parimet e zhvilluara nga ana juridike mund të pranohen zyrtarisht në qoftë se ato janë “ngurtësuar në të drejtën zakonore” duke tërhequr në njëfarë mënyrë një “pëlqim të përbashkët të vlefshmërisë së tyre të evidentuar nga praktika”.

Arsyetimi ligjor deduktiv ndryshon nga arsyetimi ligjor me analogji në shumë aspekte kyqe. Së pari, arsyetimi fillon nga një rregull, jo nga një rast. Rregullat miratohen para se rastet e drejtuara nga rregulli materializohen. Së dyti, parimi i supërmacisë së legjislativit kërkon, në përgjithësi, që gjyqtarët të luajnë një rol vartës ndaj degëve me demokratike të qeverisjes. Si pasojë, deklarimi autoritar i një rregulli të miratuar mbetet strikt, sikur të ishte miratuar, derisa ligjbërësit jo gjyqësor ta amendojnë apo shfuqizojnë atë. Në këtë lojë të arsyetimit gjykata nuk ka kompetencë të riformulojë rregullat e miratuara, sikurse na shtjellojnë çështjet ligjore që interpretojnë rregullat. Por, as gjykata nuk mundet të injorojë një rregull të miratuar të zbatueshëm, i cili normalisht ka autoritet superior ndaj çdo pjese të paqëndrueshme të “common law-it”. Së treti, situata strikte e rregullave të miratuara e drejton arsyetimin ligjor nga këto rregulla që të përqendrohet shumë mbi problemet e interpretimit të rregullit. Detyra gjyqësore është që të klasifikohen raste problemore në kategori rastesh të përcaktuara nga rregullat.

Një vështrim i shpejt në sistemin e arsyetimit ligjor me deduksion, tregon se përveç doktrinës që gjykatat janë të detyruara nga vendimet e tyre, në këtë pozicion nuk ndryshojnë shumë. Është e vërtetë se nuk ka asnjëherë ndonjë ligj që e detyron gjyqtarin të ndjekë vendimet e një gjykate më të lartë në kuptimin e “bindjes se në rastin konkret duhet të vendoset sipas vendimit të gjykatës më të lartë”, por realiteti është ndryshe. Në praktikë një vendim i Gjykatës Supreme të Kosovës, mund të përsëritet nga gjykatat më të ulëta ashtu si një vendim i një Gjykate të Apelit në Angli apo një Gjykatë të Lartë në SHBA.

Edhe në arsyetimin ligjor deduktiv duhet të ndiqen disa hapa sikurse të arsyetimi me analogji. Në arsyetimin ligjor deduktiv hapi i parë është identifikimi i premisë kryesore të përshtatshme, hapi i dytë është dhënia e fakteve në një mënyrë që lejon një hipotezë/parashikim për të quar në një konkluzion të vlefshëm dhe hapi i tretë është interpretimi i rregullit ligjor që duhet aplikuar. Për shkak se në pjesën tjetër të këtij materiali trajtohet shkrimi dhe arsyetimi ligjor me specifika edhe sipas legjislacionit pozitiv në vendin tonë, në këtë pjesë nuk është trajtuar me gjerësisht arsyetimi ligjor deduktiv.

II. PROCESI I TË SHKRUARIT

Shkrimi ligjor është mbi të gjitha shkrim i mirë. Është një komunikim i asaj që është menduar të përcillet tek të tjerët. Sigurisht cilësia e një materiali të shkruar varet nga aftësia e të shkruarit. Si përfundim puna e secilit gjyqtar do të shikohet nga procesi i të shkruarit nga ana e tij, sepse në fund të fundit çdo çështje e ngritur në gjykata në fakt nënkupton nevojën për një procedurë dhe zhvillimi i një procedure pastaj materializohet me një vendim gjyqësor. Qëllimi kryesor i shkrimit ligjor është përcjellja e informacionit në mënyrë të saktë, të përpiktë dhe të plotë.

Përmbajtja e këtij doracaku lidhur me procesin e shkrimit dhe arsyetimit ligjor është i konceptuar në formën e dhënies së disa këshillave që të ndihmojnë secilit gjyqtar gjatë punës së tyre për të qenë me të organizuar, më të strukturuar, më efikas, më përmbajtësor, më të saktë, më profesional dhe më bindës.

Procesi i shkrimit ju ndihmon që të zhvilloni aftësitë e të shkruarit. Ky e bënë shkrimin ligjor më të thjeshtë, më të organizuar dhe më të strukturuar.

Shkrimi ligjor duhet të paraqes pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes.

Në vijim paraqitet një vështrim i përgjithshëm i procesit të shkruarit si përpjekje për të bërë të lehtë shkrimin ligjor duke vënë theksin tek disa faza të shkrimit ligjor.

1. Studimi i rastit

Studimi i rastit përfshin analizimin e çështjes dhe materialeve që duhet të përdoren për t'a zgjidhur atë. Gjatë kësaj faze juve do t'u duhet të lexoni ligje apo norma të tjera juridike të cilat mendoni, gjykoni dhe vlerësoni se janë të dobishme në zgjidhjen e rastit tuaj, gjithashtu mund të kërkonte të lexoni edhe raste të tjera të ngjashme për të krijuar një pamje të qartë të situatës.

Realisht kjo është një faza para-shkrimore e cila përfshinë planin e shkruarjes së një shkrimi-vendimi. Kjo fazë përfshin kërkimin shkencor, analizën, të menduarit në lidhje me organizimin e pjesës.

Në këtë fazë të shkruarit zakonisht shtrohen disa pyetje logjike të cilat ndihmojnë në procesin e të shkruarit.

Pyetje që shtrohen në këtë fazë janë:

- cili është konflikti/konfliktet që duhet zgjedhur?
- cilat janë faktet?
- cilat janë faktet vendimtare që përcaktojnë përfundimin e çështjes?
- cilat janë argumentet, interpretimet apo analogjitë që mund të përdoren në rastin konkret?
- cili mund të jetë interpretimi që mund të bëjë gjykata, etj.

Gjatë procesit të të shkruarit zakonisht dalin disa “*pengesa*” lidhur me atë që ju mund të arrini ndërsa hartoni një dokument ligjor. Rregulli i përgjithshëm është që ju duhet të kuptoni këto pengesa para se të filloni të shkruani dokumentin.

2. Organizimi

Faza tjetër e procesit të të shkruarit është organizimi. Kjo fazë e procesit të të shkruarit nënkupton organizimin e materialeve, ligjit/ligjeve të aplikueshme, argumenteve, konkluzioneve etj. Mënyra se si organizohen, renditen e në fund si perceptohen idetë që ju kërkoni të transmetoni është një fazë thelbësore e shkrimit. Të shkruarit përfiton nga organizimi i mirë, njëlloj si çdo punë a veprimtari tjetër njerëzore. Planifikimi i një shkrimi ndihmon si shkruasin ashtu edhe lexuesin. Një shkrim me strukturë të qartë dhe logjike thithet me lehtë nga lexuesi se sa një shkrim i rrëmujshtëm, me përsëritje ose i ndërthuar në një mënyrë të tillë që të ketë kuptim për shkruasin, por jo për lexuesin.

Për të pasur një shkrim që ka kuptim jo vetëm për shkruasin por edhe për lexuesin atëherë duhet të ndiqet me korrektësi faza e organizimit të procesit të të shkruarit. Një komponent e rëndësishme në këtë fazë është organizimi i materialeve i cili bëhet duke ndjekur disa qëllime/ide. Në këtë fazë duhet të përcaktohet qëllimi për të cilin po shkruani dhe rezultati që kërkoni të arrini. Pastaj bëni një ndarje të shkrimit tuaj në pjesë duke e përshtatur edhe me kërkesat e “ligjit përkatës” për shkrimin e vendimit gjyqësor. Një ndarje në pjesë mund të jetë:

- përshkruani kërkesat dhe kundërshtimet e paraqitura;
- përshkruani faktet e prezantuara;
- paraqitni provat e administruara;
- përcaktoni bazën ligjore, respektivisht ligjin e aplikueshëm për rastin konkret;
- parashtroni argumente në një analizë krahasuese duke vlerësuar dhe peshuar vlerën e fakteve vendimtare dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese të secilës palë për secilin fakt;
- Parashtroni konkluzionet për mënyrën e kualifikimit të fakteve dhe për përfundimin e arritur.

3. Drafti fillestar

Mbani mend faktin se një shkrim i mirë ligjor nuk mund të jetë cilësor nëse shkruhet vetëm një herë e nuk ripunohet.

Shumë persona e kanë të vështirë të bëjnë kalimin nga faza kërkimore në të hartimit dhe nga faza e parashkrimit në fazën e shkrimit. Disa prej pengesave që shpesh e bëjnë të vështirë nisjen e shkrimit janë të lidhura me organizimin e kërkimit dhe me përcaktimin se ku duhet sistemuar secilën prej pjesëve, si lidhen ato me njëra tjetrën dhe si bëhen një e tërë.

Një prej hapave më të vështirë është fillimi. Mos e shtyjeni për më vonë! Filloni të shkruani dhe mos prisni që fjalitë e para të jenë të shkëlqyeshme.

Rekomandohet që të mos jeni tmerrësisht kërkues që në fillim të shkrimit tuaj. Kjo nuk do të thotë që juve të mos keni pritshmëri nga shkrimi apo arsyetimi për t'i realizuar gjatë tij, por vetëm të jeni të duruar deri në fund. Kjo për faktin se mund të ndodh që për shkak të pritshmërive të mëdha, juve të mos jeni asnjëherë të kënaqur që në fillim të shkrimit e për rrjedhojë të bllokoni ose të mos shkruani fare duke pritur perfeksionin. Kujtoni se drafti i parë është pjesa më pak e rëndësishme e shkrimit tuaj e për rrjedhojë mund të jetë pjesa e shkruar më keq! Do të kemi mundësi ta rishikojmë në hapin tjetër atë draftit përfundimtar.

4. Drafti përfundimtar (vendimi)

Draftin fillestar në këtë fazë të shkrimit ligjor do të kemi mundësi ta rishikojmë duke e përmirësuar të njëjtën derisa të arrijmë të shprehim atë që kërkojmë dhe që e kemi në mendje duke krijuar kështu versionin përfundimtar të shkrimit. Kështu materiali i dorës së parë nuk do të jetë drafti përfundimtar. Të gjitha projektet fillestare duhet të rishikohen duke pasur në mendje përmirësimin e cilësisë dhe të qartësisë. Në disa raste madje është e nevojshme të rishikohet disa herë draftin fillestar.

Gjatë rishikimit të draftit fillestar qëllimi duhet të jetë produkti përfundimtarë. Është e rëndësishme për secilin gjyqtarë që në draftin përfundimtarë të vendimeve gjyqësore të materializoj me saktësi përfundimet e tij për çështjen duke shprehur në mënyrë koncize bindjen e tij për përfundimet faktike dhe ligjore, gjithsesi në variantin që të jenë të kuptueshme për të tretë. Sugjerohet që gjyqtarët gjatë rishikimit të draftit fillestarë ta vendosin veten në pozicionin e kundërt dhe të shikojë nëse vendimi i tyre është i realizuar në mënyrë profesionale.

Është e rëndësishme të shikohen në këndvështrimin e kundërt pikat e dobëta të vendimit ose të bëhen përpjekje për të gjetur pikat e dobëta të vendimit dhe pas identifikimit të tyre në procesin e rishikimit të draftit fillestarë të bëhet përpjekje për evitimin e defekteve apo edhe për ngritjen e cilësisë/argumenteve në pjesën ku vërehen pikat e dobëta.

Në këtë fazë secili gjyqtarë duhet të rishikojë listën e kërkesave të ligjit pozitat për strukturën dhe përmbajtjen e vendimit gjyqësorë dhe sipas një liste kontrolluese e cila mund të jetë edhe në mendjen e gjyqtarit të verifikojë secilën kërkesë të ligjit për shkrimin dhe arsyetimin e vendimit gjyqësor.

Vendimi përfundimtar duhet të jetë i rregullt në strukturë dhe përmbajtje, i saktë, konciz, koherent dhe ligjor.

III. PARIMET E TË SHKRUARIT LIGJOR TË MIRË

Lidhur me të shkruarit ligjor të mirë autorët që trajtojnë këtë temë nuk kanë një praktikë për të gjitha parimet bazë që një shkrim ligjor e bëjnë shkrim të mirë, megjithatë në vija të trashë mund të themi se ekzistojnë disa parime bazë për shkrimin ligjor. Disa nga parimet e shkrimit ligjor janë trajtuar në vijim.

1. Bëje të lehtë për lexuesin

Për kë po shkruani? (*gjykatësit kanë të paktën dy auditor-palët kundërshtare*). Në këtë parim të shkrimit të mirë ligjor kërkohet që shkruesi/gjykatësi të vërë vetën në vendin e lexuesit dhe të provoj:

- nëse mund të kuptohet me lehtësi vendimi?
- a e justifikon plotësisht rezultatin vendimi?
- a i përmban vendimi rregullat procedurale për një vendim të tillë?

Nuk është e pazakontë që shpesh juristët pushtohen nga ndjesia që të impresionojnë të tjerët me stilin e shkrimit të tyre i cili mund të jetë i përshkruar nga nocione abstrakte dhe vështirë të kuptueshëm. Duhet që të kihen në konsideratë që parimisht shkrimi i juristëve u dedikohet jo juristeve.

Jo rastësisht thuhet se shkrimi i mirë ligjor është thjeshtë shkrim i mirë. Shkrimi i mirë është komunikimi i saktë ai asaj që është menduar të përcillet tek të tretët. Shkrimet e dobëta dëmtojnë statusin e së drejtës në po atë mënyrë që ju preokupojnë juve kur përpiqeni t'i interpretoni ato ashtu siç duhet.

Parimi që shkrimi i mirë të qon drejtë e në temë na udhëzon që kur shkruajmë vlerësojmë pritjet e lexuesit.

Çfarë pret lexuesi?

- rregullin 90 sekonda (koment)
- çështjet e rëndësishme të shqyrtohen të parat
- shkrimi duhet të rrjedhë-të jetë i organizuar dhe i kuptueshëm.

2. Shkruaj si njeri, jo si jurist

Shkrimi ligjor i gjyqtarëve në parim lidhet më shkrimin e vendimeve gjyqësore të cilat u dedikohen palëve të përfshira në procedura gjyqësore që kryesisht janë jo jurist dhe laik të

drejtësisë, prandaj secili gjyqtar gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore duhet të ketë në konsideratë nevojën për shkrim të thjeshtë dhe të kuptueshëm.

Secili gjyqtar operon në një mjedis ku dominohet nga: gjuha me terminologji juridike, diskutimet profesionale, literatura me përmbajtje teorike/abstrakte, nocionet me përmbajtje filozofike e të përgjithësuara, gjë që ndikon vetvetiu që gjyqtarët të mendohen, të flasin dhe të shkruajnë vetëm si jurist, megjithatë secili gjyqtar duhet të ketë në konsideratë se e tërë dija e tij profesionale do të ketë vlerë nëse vendimi i tyre është i hartuar në gjuhë të thjeshtëzuar dhe të kuptueshme.

E kemi theksuar se nuk përmbushet drejtësia në një çështje të ngritur në gjykata vetëm nga fakti se gjykata ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe sipas ligjit, por do të konsiderohet se drejtësia është përmbushur respektivisht qëllimi i drejtësisë është arritur kur gjykata të ketë arritur ti bind palët se ajo ka vendosur drejtë. Këtu shtrohet pyetja se si ka mundësi gjykata ti bindë palët nëse ato nuk e kuptojnë vendimin e gjykatës?

3. Organizohu dhe skico çështjen

Skica ndihmon në përcaktimin e çështjeve dhe çështjet formojnë bazën e skicës. Skicë mund të jetë çdo gjë që funksionon, p.sh., një skemë e fakteve (qoftë edhe në mendjen e gjyqtarit). Si do të mund të shtrohej një skemë e fakteve?

Për shembull: Nëse kemi në shqyrtim një çështje të ngritur në gjykatë me padi sipas bazës së kompensimit të dëmit nga auto-përgjegjësia.

Një skemë e fakteve në rastin e kompensimit të dëmit nga auto-përgjegjësia do të mund të ishte në këtë mënyrë:

- faktet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë objektive;
- faktet që kanë të bëjnë me natyrën e lëndimit;
- faktet që kanë të bëjnë me kategoritë e dëmit;
- faktet që kanë të bëjnë me përcaktimin e lartësisë së kompensimit.

Në formën e njëjtë siç është paraqitur skema e fakteve mund të jetë ta zëmë edhe skema e provave.

4. Përdorë tituj dhe pika referuese

Pikat referuese përmbledhin atë që do të diskutohet. Përdorimi ato veçanërisht në fillim të secilës pjesë kryesore të analizës gjyqësore. Ato veprojnë si hartë dhe e ndihmojnë lexuesin të shqyrtoj argumentin.

Përdorimi i pikave referuese është në harmoni dhe me përdorimin e metodologjisë së shkrimit dhe arsytimit ligjor IRAC- e cila e udhëzon gjyqtarin të ndjekë një skemë e cila ka për bazë procedura gjyqësore të strukturuar, pyetje gjyqësore të strukturuar që mbështesin idenë e

vendimit gjyqësor të strukturuar. Domosdoshmërisht një vendim gjyqësor i strukturuar mbi çfarëdo metodologjie të shkrimit ligjor e aq më tepër sipas metodologjisë IRAC kërkon përdorimin e titujve dhe pikave referuese. Përmes titujve e bëjmë të ditur organizmin tek lexuesi dhe ofrojmë kalimin nga njëri tek tjetri në mënyrë logjike, ndërsa përmes pikave referuese përmbledhim atë që do të diskutohet.

Për shembull: Në një arsyetim të aktgjykimit mund të kemi këto tituj:

- historiku i çështjes;
- faktet e çështjes;
- provat e çështjes;
- baza ligjore;
- analiza ligjore;
- përfundimi.

Pikat referuese në parim mund të jenë në përdorim në tekstin e shkruar brenda një titulli.

Për shembull: Në pjesën e arsyetimit të vendimit ku është përdor titulli “historiku i çështjes” mund të përdoren këto pika referuese:

-pretendimet e paditësit (*kërkesat e parashtruara, faktet e propozuara, provat e propozuara për faktet vendimtare, pretendimet procedurale, etj*),..

-pretendimet e të paditurit: (*kundërshtimet e paraqitura, faktet për ti mbështetur kundërshtimet, provat e propozuara për vërtetimin e fakteve, etj*).

5. Shkruaj paragraf të shkurtër

Paragrafët janë të rëndësishëm, sepse e organizojnë shkrimin sipas ideve; ata ja lehtësojnë lexuesit të kuptuarit e materialit, duke e ndarë atë në njësi më të thjeshta.

Paragrafi i gjatë:

“Me dispozitën e nenit 67 al. 2, të LMD-ës (1978), përcaktohet së “kërkesat nga ligji që kontratat të lidhet në një formë të caktuar vlen edhe për të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e më vonshme të kontratës”, mirëpo sipas dispozitës së nenit 67 al. 3 të LMD-ës, parashihet së” të plotfuqishme janë plotësimet e më vonshme verbale mbi pikat sekondare për të cilat në kontratë formale nuk është thënë asgjë, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma”. Në rastin konkret përveç fakti se palët kontraktuese kanë përcaktuar se ndryshimet e kontratës duhet të bëhen në formë të shkruar, ky detyrim për palët rrjedhë edhe sipas kërkesave të ligjit. Gjykata vlerëson se nuk mund të pranohet kërkesëpadia për punët shtesë edhe për arsyen ato punë do të duhej të kontraktohen me aneks kontratë, amendamente/klauzola shtesë apo forme tjetër të ndryshimit të kontratës, por gjithsesi me qenë

formë e shkruar, gjë që në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ka ndodhur pas kontratës bazë. Gjykata nuk ka mundur ta trajtojë dhe pranojë kërkesëpadinë as sipas përcaktimit që bënë dispozita e nenit 67 al 3 të LMD-së, pasi që kjo do të ishte në kundërshtim me qëllimin që është parashikuar për formën e kontratës dhe gjithashtu në këtë rast nuk mund të flitet për ujdë mes palëve pasi që çështja është shtruar para gjykatës dhe kundërshtimet e palës së paditur janë të natyrës materialo-juridike”.

Paragrafët e shkurtër:

“Me dispozitën e nenit 67 al. 2, të LMD-ës (1978), përcaktohet se “ kërkesat nga ligji që kontratat të lidhet në një formë të caktuar vlen edhe për të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e më vonshme të kontratës”, mirëpo sipas dispozitës së nenit 67 al. 3 të LMD-ës, parashihet së” të plotfuqishme janë plotësimet e mëvonshme verbale mbi pikat sekondare për të cilat në kontratë formale nuk është thënë asgjë, në qoftë se kjo nuk është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është parashikuar forma”.

Në rastin konkret përveç faktit se palët kontraktuese kanë përcaktuar se ndryshimet e kontratës duhet të bëhen në formë të shkruar, ky detyrim për palët rrjedh edhe sipas kërkesave të ligjit.

Gjykata vlerëson se nuk mund të pranohet kërkesëpadia për punët shtesë edhe për arsyen së ato punë do të duhej të kontraktohen me aneks kontratë, amendamente/klauzola shtesë apo formë tjetër të ndryshimit të kontratës, por gjithsesi me qenë formë e shkruar, gjë që në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ka ndodhur pas kontratës bazë.

Gjykata nuk ka mundur ta trajtojë dhe pranojë kërkesëpadinë as sipas përcaktimit që bënë dispozita e nenit 67 al 3 të LMD-së, pasi që kjo do të ishte në kundërshtim me qëllimin që është parashikuar për formën e kontratës dhe gjithashtu në këtë rast nuk mund të flitet për ujdë mes palëve pasi që çështja është shtruar para gjykatës dhe kundërshtimet e palës së paditur janë të natyrës materialo-juridike”.

6. Shkruaj fjali të shkurtra dhe të qarta

Fjalja është njësia më e vogël kuptimplotë e organizimit të mendimit dhe rrjedhimisht, struktura qendrore gjuhësore përmes së cilës i organizojmë dhe i shprehim mendimet e tona.

Fjalitë e shkurtra dhe të qarta janë në funksion të shkrimit të paragrafëve të shkurtër, unik dhe koherent, e rrjedhimisht e bëjnë tekstin të lehtë për tu kuptuar pa pasur nevojë që lexuesi gjatë leximit të bëjë edhe “interpretim” si nevojë për gjetjen e kuptimit.

Elementet kryesore të cilat duhet rishikuar nga aspekti i qartësisë janë elementet gjuhësore dhe semantike (përmbajtja kuptimore e njëhesisë të gjuhës, kuptimi leksikor i fjalëve dhe shprehjeve) të tij, pra fjalitë dhe paragrafët, si dhe lidhjen në mes tyre. Nëse fjalitë dhe paragrafët

janë shumë të qartë dhe nëse lidhja mes tyre është e mirë, atëherë mund të flasim për qartësi teksti. Me “lidhje” këtu nënkuptojmë para se gjithash përcjelljen e idesë themelore në të gjitha pjesët e tij, deri në përfundim.

Fjalë e gjatë:

“Pazitësi nuk ka mundur që të argumentojë se veprimet e të paditurit kualifikohen në grupin e veprimeve të cilat e bëjnë përgjegjës të njëjtin për shkaktimin e dëmit sipas fajit, sepse me provat e administruara në shqyrtimin kryesor rezultoi se i njëjti nuk është kontribuues me veprimet e tij në shkaktimin e aksidentit”.

Fjalë e shkurtër:

“Nga provat e administruara në shqyrtimin u provuar se i padituri nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit”.

Lidhi idetë tuaja me fraza të ndryshëm:

Për të sinjalizuar kontrastin apo për të dalluar: megjithatë, por, pavarësisht, ndryshe nga, gjithsesi, qoftë edhe, përkundër, edhe pse, ndërkohë, etj.

Për të sinjalizuar analogji apo krahasim: njësoj si, ashtu si, në të njëjtën mënyrë, përsëri, gjithashtu, njëlloj, po ashtu, etj.

Ilustruese (për të prezantuar një shembull): për shembull, në veçanti, veçanërisht, specifikisht, në rastin konkret, etj.

Për të sjell një rezultat: sepse, prandaj, kështu që, rrjedhimisht, si rezultat, ndaj, përderisa, përfundimisht, del se, nëse, atëherë, etj.

Rend: së pari, së dyti, pastaj, së fundi, më pas, paraprak, pasuesi, et.

Për të sinjalizuar theks apo për të shtuar: për më tepër, gjithashtu, veç kësaj, më pas, përveç kësaj jo vetëm, në të gjitha, etj.

Për të sinjalizuar një lëshim: edhe pse, edhe nëse, ndonëse, megjithatë, etj.

Për të vendosur një përfundim: rrjedhimisht, kështu, prandaj, për ta përmbledhur, etj.

IV. GJUHA E PËRDORUR NË TEKSTIN E SHKRUAR

Fjalët janë mjeti më i rëndësishëm në punën e juristëve. Puna ligjore lidhet me të lexuarit, të shkruarit e për më tepër me faktin se fjalitë janë mjeti me thelbësor nëpërmjet përdorimit të të cilave juristët apo avokatët arrijnë të përfitojnë avantazhe për palët e tyre.

Stili është ai që i jep përmbajtjes jetë dhe rrjedhshmëri, ai që vë “vulën” e autorit dhe që përshtat mjetet e ndryshme gjuhësore dhe gramatikore me temën e shkrimit. Të kesh ‘*stil të mirë*’ do të thotë të shkruash qartë dhe saktë; të shprehesh shkurt kur kërkohet koncizitet; thjeshtë, kur kërkohet thjeshtësi; shprehje në mënyrë të figurshme, kur kërkohet bukuri estetike.

Fjalët janë, siç është e njohur, mediumi kryesor më anë të të cilave i’ a komunikojmë lexuesit faktet dhe mendimet, sikurse që me anë të fjalëve e mësojmë pjesën më të madhe të asaj që dimë. Është e rëndësishme zgjedhja e fjalëve me rastin e të shkruarit. Kjo zgjidhje duhet të jetë e tillë që me fjalët e zgjedhura në mënyrë me ekspresive, më efikase, mund të komunikohet ajo që dëshirohet. Zgjedhja e fjalëve varet, në pajtim me këtë nga disa faktorë; nga lloji i shkrimit, nga lexuesi për të cilin shkruhet, nga rastin në të cilin shkruhet.

Në shkrimin ligjor duhet pasur kujdes që të përdoren fjalët që me saktësi shprehin atë që dëshirojmë të themi. Në disa raste nga shumë sinonime të mundshme të ndonjë nocioni duhet zgjedhur atë me të përshtatshmin, atë që mendimeve u përgjigjet më së miri.

Në lidhje me veçoritë në të cilën po ashtu duhet pasur kujdes, kur është në pyetje zgjedhja e fjalëve, është lloj-llojshmëria: autori duhet të ketë në vetëdijen e vet, edhe në disponim, fond të pasur të fjalëve, shprehjeve, kthesave me të cilat do të mund të shërbehet gjatë të shkruarit. Në lidhje me këtë ai duhet të mënjanojë sidomos përsëritjen e fjalëve të njëjta, sikurse edhe të formave të njëjta gramatikore.

Shkrimi ligjor duhet të paraqes pa ndërprerje një pamje të qartë, të shpejtë dhe të plotë të çështjes. Të shkruarit e keq nuk është i lexueshëm; mund të ndodhë që lexuesi të lodhet e të mos arrij kurr deri në fund të shkrimit tuaj. Në procesin e bërjes dhe dhënies së drejtësisë, të shkruarit e mirë është ‘*fuqi*’. Kjo ka sidomos rëndësi kur të merret në konsideratë fakti se gjykata përveç detyrës që të vendosë drejtë dhe ligjshëm në çdo çështje ka po ashtu detyrë të bind të tjerët se vendimi i saj është i drejtë dhe i ligjshëm. Bindshmëria e të tjerëve në një vendim gjyqësor do të mund të arrihet nëse gjykata arrin të përdorë mirë gjuhën, mjetin me të cilin transmeton për të tjerët bindjet e saj.

Tiparet e një shkrimi të mirë parimisht njihen si:

- qartësia,
- thjeshtësia dhe ekonomia,
- përshtatshmëria,
- shumëllojshmëria dhe gjallëria

Qartësia-lidhet me tri aspekte kryesore: njohuri të sakta për përmbajtjen e shkrimit, përdorimin e strukturave të qarta gramatikore dhe zgjedhjen e përshtatshme të fjalëve. Të tre elementet shkojnë krah për krah me njëri-tjetrin. Një përmbajtje e shëndoshë e shprehur me fjalë të papërshtatshme dhe me strukturë gramatikore të rrëmujshme, humbet nga ana tjetër, përdorimi i një gramatike të saktë dhe fjalori të zgjedhur nuk do të vlente aspak nëse përmbajtja nuk do të ishte e logjikshme.

Thjeshtësia dhe ekonomia e shprehjeve-në të shkruar fjalët e shumta tregojnë varfëri mendimi. Të qenët i thjeshtë dhe i kursyer nuk do të thotë të shprehesh shkurt dhe thatë, por që të shprehesh mendimin në mënyrë efektive, pa fjalë boshe dhe ndërlikime të tepruara.

Përshtatshmëria-është gjithashtu një virtut i shkrimit cilësor. Mënyra e të shkruarit duhet t'i përshtatet fushës së caktuar. Një shkruar i mirë duhet të dijë të zgjedh fjalët që shprehin me saktësi qëndrimin dhe bindjet e tij në mënyrë sa më të përshtatshme për atë/ata që u dedikohet shkrimi.

Shumëllojshmëria dhe gjallëria- janë mjeti për të mbajtur gjallë interesin e lexuesit për këtë shkruar duhet të ketë një njohje të mirë të gjuhës dhe mjeteve të saj shprehisë, duke i përdorë ato në vendin dhe masën e duhur. Një shkruar i mirë është ai që balancon të shprehurit e thjeshtë dhe të kursyer me një përdorim të gjallë dhe të zhdërvjelltë të gjuhës. Shkrimi zyrtar/ligjor nuk jep shumë hapësirë shkruarit për shprehur individualitetin e tij, megjithatë nga mënyra e të shprehurit secili do të shfaqë stilin e tij nga i cili edhe do të kategorizohet si shkruar i mirë apo i dobët.

V. STRUKTURA DHE RAPORTET E FJALIVE

Fjalja është njësi stilistike me anë të së cilës komunikohet mendimi (në kuptimin e gjerë të fjalës). Cilësitë e saj kanë rëndësi të madhe, në radhë të parë struktura e saj, sikurse edhe raporti dhe lidhjet e ndërsjellta me fjalitë tjera.

Veçoritë kryesore të fjalisë janë: koherenca e fjalisë dhe llojshmëria e fjalisë

Fjalja është koherente nëse raporti ndërmjet disa pjesëve dhe fjalëve në të është logjik: përmbajtjen e një fjalisë të tillë e kupton lexuesi, rregullisht, shpejt, pa përpjekje të mëdha dhe nuk ka nevojë që ta lexojë dy ose ma shumë herë.

Gabimet kundër koherencës së fjalisë mund të jenë të llojllojshme si: fjalja dykuptimshme, idetë paralele nuk janë shprehur me konstrukione paralele gramatikore, gjatë tërë fjalisë nuk është ruajtur pikëpamja e njëjtë, ndonjë fjalë ose grup fjalësh nuk kanë të bëjnë me fjalinë e parë, përzjerja e konstrukioneve të ndryshëm rrënon koherencën e fjalisë, konstrukionet jo të plotë e rrënojnë koherencën e fjalisë, etj.

Llojshmëria e fjalisë që t'i shmangemi monotonisë së stilit, autori në fjalitë e veta kyç llojllojshmërinë. Fjalitë duhet ndryshuar edhe në aspekt të gjatësisë: në mënyrë monotone, edhe bezdisshëm vepron përdorimi i përhershëm i fjalive vetëm të shkurtra ose vetëm të gjata. Gjithsesi, më së miri është të kombinohen të dy llojet, aq më tepër që “diversteti në gjatësi të fjalive mundëson diversitetin në strukturë, në harmoni me idetë që duhet komunikuar”.

VI. STRUKTURA DHE VEÇORITË E PARAGRAFIT

Paragrafi është njësi ideore që përbëhet prej një varg fjalish të lidhura në mënyrë të ndërsjellët ashtu që përbëjnë tërësi të gjerë koherente dhe shërben, njëkohësisht, si pjesë e tërësisë më të madhe (nën pjesës, pjesës, kaptinës, kreut, etj). Paragrafi përcakton pjesët e një teksti të shkruar, që përfshijnë fjalitë nga njëra kryeradhë te tjetra dhe shpreh një mendim pak a shumë të plotë e të pavarur, por që nënkupton nëndarjen e një kreu, ligji, etj. Siç shihet paragrafi paraqet njësi strukturore dhe si i tillë ai do të jetë i mirë, efikas, nëse do të jetë i fortë, “i shëndoshë” struktura e tij e brendshme.

Si rregull i përgjithshëm, çdo paragraf shpreh një ide, një çështje, një problematikë të veçantë nga të tjerat. Paragrafi shërben për të ndarë idetë nga njëra-tjetra e për ti bërë ato me të kuptueshme për lexuesin. Nëse idetë do të transmetoheshin në tërësi e të pandara, do të ishte shumë e vështirë për lexuesin t'i “përtypë” apo asimilonte ato. Ndërkohë paragrafët i shërbejnë juristëve për të disiplinuar dhe organizuar shkrimin e tyre; nëpërmjet paragrafëve juve mund t'i tregoni lexuesit idetë dhe pikëpamjet tuaja lidhur me një çështje të caktuar, mund të parashtroni argumentet dhe kundër argumentet, mund të përshkruani faktet e një ngjarje dhe çdo fenomen tjetër që ju intereson.

Teoricienët përcaktojnë disa kushte për vlefshmërinë e një paragrafi: uniteti i paragrafit, argumentimi i plotë, koherenca, segmentimi i paragrafit dhe përcaktimi i qëllimit të paragrafit që në fillim të tij.

1. Uniteti i paragrafit

Një paragraf si rregull i përgjithshëm duhet të përmbajë apo provojë vetëm një ide, plan apo sugjerim apo trajton vetëm një çështje. Materialet apo pjesët që nuk janë të nevojshme dhe në funksion të këtyre ideve, mund të vendosen në një paragraf tjetër. Me fjalë të tjera uniteti i paragrafit do të arrihet nëse të gjitha pjesët e tij, të gjitha fjalitë, janë orientuar drejt një teme themelore që zhvillohet. Ky mendim qendror duhet jetë menjëherë i qartë dhe evident. Paragrafi nuk guxon të ketë, nga një anë, fakte dhe mendime që dalin nga suazat e temës së tij, që nuk janë në lidhje të drejtpërdrejt me të (*uniteti i paragrafit rrënohet posa në të të futët çdo temë e re, ose pikëpamje e re*), kurse në anën tjetër, në të nuk guxojnë të mungojnë disa fakte dhe ide që janë me rëndësi thelbësore për vetë temën e paragrafit. Që të arrihet dhe zbatohet me lehtë uniteti i paragrafit, preferohet që në fillim të jepet shenjë në cakun e tij me një fjali të shkurtër, të

përgjithshëm (fjalja tematike), e cila në një mënyrë e përgatitë lexuesin, duke rezumuar përmbajtjen themelore, temën e paragrafit.

1.1 Argumentimi i plotë

Një paragraf duhet të përmbajë çdo element të nevojshëm që provon idenë e paraqitur apo mbron qëndrimin e deklaruar.

1.2 Koherenca e paragrafit

Që të jetë koherent, paragrafi medoemos duhet ti plotësojë dy kushte themelore: 1) të gjitha pjesët e tij të përbëjnë tërësinë e fortë logjike, organike, d.m.th., fjalitë në të duhet të radhitën me ndonjë radhë (logjik), respektivisht ashtu të organizuara që ndërmjet tyre ekziston ndonjë lidhje-kronologjike, kausale e të ngjashme; 2) fjalitë nga të cilat përbëhet paragrafi të përbëjnë atë tërësinë e fortë logjike, organike, të qartë dhe evidente për lexuesin. Kjo arrihet në mënyrë të ngjashme: me organizimin sistematik të ideve, me kalimet e përshtatshme nga një ide në tjetrën, me përpikërinë e strukturës gramatikore e të ngjashme.

Në një paragraf, mendimet duhet të shprehen në mënyrë logjike, në mënyrë që lexuesi të ketë mundësi t'i ndjekë dhe t'i lexojë ato pa pasur nevojë që t'i parafranojë apo korrektoj me mendje, gjatë leximit.

2. Segmentimi i paragrafit

Një paragraf duhet të ketë një gjatësi normale. Paragrafi duhet të jetë i gjatë aq sa lexuesi të mos humbas në leximin e tij, e i shkurtër deri në nivelin që argumentimi dhe zhvillimi i idesë së tij të paraqitet i plotë. Disa pjesëve të një paragrafi do t'u jepet aq vend dhe aq hapësirë sa është e domosdoshme dhe e përshtatshme që lexuesit t'i komunikohet tërë përmbajtja, mendimi i tërësishëm i paragrafit. Kjo do të sendërtohet “me përshtatjen e fjalive kyç ose të sintagmave frazeologjike”, në përpjesëtim me hapësirën: disa ideve u jepet aq hapësirë sa ato, sipas rëndësisë së vet relative e meritojnë, d.m.th., në vendet më të rëndësishme më gjatë ndalemi, në vendet me pak të rëndësishme- më shkurt.

Sa i përket gjatësisë së paragrafit, ajo konsiderueshëm mund të ndryshoj, që varët nga “qëllimi i paragrafit dhe metoda e zhvillimit”. Duhet t'ju shmangemi skajshmërive: të mos ndërtohen paragrafët as shumë të shkurtra, prej një ose dy fjalive, prej një ose dy fjalive, përveç nëse ky është paragraf me karakter hyrës, përfundimtar ose kalues. Paragrafët tepër të shkurtra e të shpeshhta janë dëshmi e qartë e “dobësisë së sintezës”, mirëpo, paragrafët nuk guxojnë të jenë as tepër të gjata, sepse rregullisht ndikojnë bezdisshëm. Lexuesi mund të ketë vështirësi për të kuptuar apo mund të ngatërrohet nga paragrafët jashtëzakonisht të gjatë.

3. Përcaktimi i qëllimit të paragrafit që në fillim të tij

Një paragraf efektiv, paraqet idenë që në fillim të tij. Fjali e parë ose e dytë e tij, deklaron tezën, idenë apo çështjen dhe nëse është e nevojshme bën kalimin nga njëri paragraf tek tjetri, nga një ide tek tjetra. Megjithatë duhet theksuar se sikurse brenda një paragrafi që duhet të ekzistojë lidhshmëria e fortë e fjalive, po ashtu duhet të ekzistojë lidhja e fortë ndërmjet disa paragrafëve. Në asnjë rast nuk guxohet që nga një paragraf të kalohet me shpejtësi në tjetrin paragraf, të flitet në të për gjera krejtësisht të llojllojshme duke i lidhur ato vetëm me lidhje e jashtme-me ndonjë lidhëse, ndajfolje, fjalë parentetike-përkundër kërcimeve të qarta logjike. Çdo paragraf i ri paraqet një lloj shkalle, që lexuesin e shpie më tej caktut, e sjell më afër tek ai. Krahas kësaj, çdo paragrafi d.m.th., pushim i llojit të vet: i dëfton lexuesit se me të fillon diçka e re-zhvillimi i mendimit të ri, temës së re.

4. Llojet e paragrafëve sipas karakterit

Paragrafët sipas karakterit të tyre: paragrafi rrëfyes, paragrafi shpjegues, paragrafi përshkrues, paragrafi retorik-bindës, paragrafi dialogues, paragrafi parashikues, etj.

4.1 Paragrafi rrëfyes

Nëse autori rrëfen për ngjarje të ndryshme, por që janë të ndërlidhura ndërmjet tyre sipas disa marrëdhëniesh të caktuara, karakteri i tekstit do të jetë rrëfyes-narrativ.

4.2 Paragrafët përshkrues

Paragrafët përshkrues- përshkruajnë, portretizojnë apo ilustruojnë ngjarje, rrethana, kushte. Këta lloj paragrafësh transmetojnë materiale, pa u ndalur në analiza të thella. Ndërkohë që në shkrimet ligjore, paragrafët priten të bëhen shumë më tepër se të përshkruajnë ngjarje, situata, rrethana etj.

4.3 Paragrafi shpjegues

Për ndryshim nga paragrafi rrëfyes (narrativ) i cili i rendit njërën pas tjetrës ngjarjet, përkatësisht dukuritë, ose nga paragrafi përshkrues, i cili u'a mvesh atyre një dozë emotiviteti, duke i përshkruar jo më ngjarjet por "efektet e saj", paragrafi shpjegues mëton të mbetet i lidhur me to, por jo t'i përshkruajë ato, as të kritikoj efektet përmes përshkrimit të ndjenjave që mund të kenë ngjallur tek autori, por të shpjegoj me në detaje ndonjë element i cili, sado jo drejtpërdrejt, është i lidhur me to, ngase ofron mundësi të kuptimit të tyre. Pra një paragraf shpjegues ofron elemente të rëndësishme për rrëfimin, duke e specifikuar ndonjë dukuri, pa kuptimin e së cilës vazhdimi i ngjarjeve dhe sidomos të kuptuarit e tyre bëhet gjithnjë e më i vështirë.

4.4 Paragrafi retorik-bindës

Përmes këtij paragrafi autori synon të promovoj idenë e tij si të drejtë respektivisht si bindëse. Të tilla janë tekstet të cilat shfaqin një qëllim të theksuar në raport me lexuesin: ky qëllim mund të jetë të bindurit e tij për vërtetësinë e argumenteve të përfshira në tekst, të nxiturit për të besuar në qëllimin e shprehur si porosi të tekstit, ose për të ndërmarrë ndonjë veprim të caktuar, si rezultat i besimit të plotë në vërtetësinë e fateve të ofruara nga teksti.

4.5 Paragrafi dialogues

Themi se lexuesi merr pjesë aktive në lexim, nëse ai dialogun me tekstin, me strategjinë e tij dhe të autorit, se hap dilema për mënyrën e trajtimit, si dhe nëse e aprovon ose e refuzon një mënyrë të shtimit të tekstit.

4.6 Paragrafët parashikues

Paragrafët parashikues- jo vetëm që japin informacione për ngjarjen dhe situatën, por edhe bëhen parashikime ligjore, hamendësime, paraqesin argumente për të mbrojtur idenë që prezantohet që në fillim të tij.

VII. STRUKTURA E FJALISË, KORREKTËSIA GRAMATIKORE DHE DREJTSHKRIMORE

Teksti i organizon mendimet në strukturë gjyqësore, kuptimisht të plota. Fjalja është njësia më e vogël kuptimplotë e organizimit të mendimit dhe rrjedhimisht, struktura gjuhësore përmes së cilës i organizojmë dhe shprehim mendimet tona. Njohja dhe përdorimi i veçantë i saj, prandaj, ndikon shumëfish në mënyrën se si ne do të shprehim dhe sa bindës do të jemi.

Fjalitë e thjeshta

Fjalitë më të zakonshëm janë ato që e përmbajnë së paku një kryefjalë dhe një kallëzues dhe të cilat përcjellin një kuptim ose një ide.

Për shembull:

- dëshmitari i pohojë faktet e çështjes;
- padia është e parregullt;
- nuk u pranuan pretendimet e paditësit;
- baza juridike ishte kontestuese;

Fjalitë e përbëra

Krahas fjalive të thjeshta, mund të përdorën edhe fjali të përbëra. Të tilla quhen fjalitë të cilat përbëhen nga së paku dy qendra komunikuese, ose dy fjali të pavarura. Ekzistojnë llojet të ndryshme të tyre, por fjalitë më të zakonshme janë ato që përbëhen nga dy fjali të pavarura dhe një “koordinues”, i cili mund të jetë ndajfolje, mbiemër etj.

Për shembull:

-gjkata i shqyrtojë të gjitha pretendimet e të paditurit, por nuk gjeti se ekzistojnë pengesa procedurale nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor.

-gjkata i administrojë të gjitha provat e paraqitura nga pala ndërgjyqësore, prandaj vendosi ta përfundojë shqyrtimin kryesor.

-faktet e provuara me provat e administruara janë të pamjaftueshme për themelësinë e kërkesëpadisë, prandaj gjykata vendosi që ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Në lidhje me korrektësinë gramatikore dhe drejtshkrimore është e domosdoshme që secili që shkruan të njohë gramatikën dhe drejtshkrimin e gjuhës në të cilën shkruan.

Sa varet nganjëherë qartësia e tekstit të shkruar prej “gjërave të vogla” në dukje tregon, përveç tjerash, përdorimi i shenjave të pikësimit: me shenjat e pikësimit nuancohen domethëniet e disa fjalive, grumbullimit të fjalëve dhe fjalive dhe qëllimi i tyre është të kuptuarit më i mirë, “të paraqiturit më i qartë i asaj që dëshirohet të thuhet”.

PJESA E DYTË

I. SHKRIMI DHE ARSYETIMI LIGJOR PËRMES METODËS IRAC

Objektivi kryesor i kësaj pjese të doracakut trajtimi i metodologjisë së shkrimit dhe arsyetimit ligjor përmes metodës "IRAC".

1. Metoda "IRAC"

Metoda "IRAC" është një shkurtesë në gjuhën angleze për një proces analitik katër-hapësh, i cili është ilustruar më poshtë:

- **Identifikimi i çështjes**, që fokusohet vetëm në çështjet që potencialisht zgjidhin të gjitha ose një pjesë të kontestit (kundërshtive/polemikave) para gjykatës.
- **Identifikimi i rregullës**, që fokusohet në një rregull (ose rregulla) kushtetuese, ligjor, apo ndonjë rregull tjetër (ose rregulla të tjera) që është (ose janë) të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.
- **Analiza** përfshinë përcaktimin nëse çdo element i rregullës (apo rregullave) përkatëse aplikohet ndaj fakteve, të cilat shpesh përfshijnë përdorimin e fjalëve "këtu" dhe "sepse" si pjesë kyçe të analizës për të parë nëse çdo element thelbësor i rregullës është (ose, nuk është) përmbushur nga aspekte të veçanta të të dhënave faktike.
- **Konkluzioni** është hapi përfundimtar në procesin e arsyetimit, dhe përbëhet nga një deklaratë përfundimtare mbi atë se si kjo çështje është zgjidhur (pjesërisht ose plotësisht) nga rezultatet e analizës.

Le të fillojmë diskutimin tonë në lidhje me një metodë të arsyetimit dhe shkrimit ligjor duke konsideruar disa pyetje primare të cilat i kanë bërë gjyqtarët gjatë shumë viteve, atëherë kur janë duke dëgjuar një argument verbal në sallën e gjykimeve.

- Ky vlerësim i pyetjeve kryesore të cilat i bëjnë gjyqtarët, do të përforcojë propozimin tonë për miratimin e metodës IRAC në arsyetimin dhe shkrimin ligjor.

-

2. Pyetje të Strukturuar

Ekziston një pyetje primare të cilën e bën gjykatësi kur është duke e konsideruar një argument ligjor të njërës palë në rastin e caktuar.

- *“Cilat çështje ligjore duhet të vendosen ashtu që të zgjidhet ky rast ?*
- *“Kur i përgjigjeni pyetjes time, ju lutem limitojeni përgjigjen vetëm në çështjet relevante ligjore.”*
 - *“Ju nuk duheni të diskutoni rreth çështjeve të cilat nuk janë drejtpërdrejt relevante për zgjidhjen e rastit.”*

Ekziston edhe një pyetje primare të cilën e bën gjyqtari kur është duke e konsideruar një argument ligjor të njërit palë në një rast të caktuar.

- *“Pa u futur në diskutimin e rrethanave të këtij rasti , cilat janë elementet specifike ligjore të cilat duhet të provohen në mënyrë që të përmbushen kërkesat e çdo ligji që ju po i përshkruani si relevante për zgjidhjen e këtij rasti?”*

Në vazhdim, gjyqtari shumë shpesh pyet se si aplikohet ligji ndaj fakteve të rastit.

- *“Duke pasur parasysh çdo çështje ligjore të cilën ju e keni identifikuar, ju lutem shpjegoni se si faktet dhe rrethanat e këtij rasti i përmbushin kërkesat e ligjit apo ligjeve të cilat ju i keni cituar.”*
- *“Ju lutem shpjegoni se si tërësia e analizës suaj ligjore e mbështet përfundimin e juaj final se si ky kontest duhet të zgjidhet.*

Ka një numër të madh të pyetjeve të rëndësishme të cilat një gjyqtar ia bën avokatit të palës kundërshtare, kur është duke konsideruar propozimin e palës kundërshtare për zgjidhjen e rastit.

- *“A e kundërshtoni ju identifikimin nga ana e palës kundërshtare, të çështjeve ligjore relevante të cilat duhet të zgjidhen në këtë rast?*
 - *“Nëse nuk jeni i pajtimt me kundërshtarin e juaj, ju lutem përshkruani specifikisht bazën për mospajtimin tuaj”.*
- *“A nuk pajtoheni ju me identifikimin nga ana e kundërshtarit tuaj të çështjeve ligjore relevante, që duhen aplikuar për zgjidhjen e kësaj (këtyre) çështjeve(s) specifike ligjore ?*
 - *“Nëse ju nuk pajtoheni me kundërshtarin tuaj, ju lutem specifikoni bazën për mospajtimin tuaj”.*

- *“A nuk pajtoheni ju me përshkrimin nga ana e kundërshtarit të elementeve të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që të ketë pajtueshmëri me çdo dispozitë relevante ligjore?*
 - *“Nëse ju nuk pajtoheni me kundërshtarin tuaj, ju lutem specifikoni bazën e kundërshtimit tuaj”.*
- *“A nuk pajtoheni ju me analizën e kundërshtarit tuaj se si faktet dhe rrethanat e këtij rasti aplikohen ndaj ligjit të aplikueshëm ?*
 - *Nëse nuk pajtoheni me palën kundërshtare, ju lutem përshkruani në mënyrë specifike bazën e mospajtimit tuaj.*
 -
- *“A nuk pajtoheni ju me përfundimin(et) e kundërshtarit tuaj, se si ky rast duhet të zgjidhet?*
 - *Nëse nuk pajtoheni me kundërshtarin tuaj, ju lutem përshkruani në mënyrë specifike bazën e mospajtimit tuaj.*

Pse duhet të përdoren pyetjet e strukturuar nga ana e gjyqtarit kur është duke dëgjuar një argument ligjor nga palët ?

- Pyetjet e strukturuar e detyrojnë gjyqtarin dhe palët që të mendojnë logjikisht rreth zgjidhjes së rastit.
- Gjyqtarët dhe palët të cilat operojnë në një mjedis të pyetjeve të strukturuar shkojnë në drejtim të “procedurave të strukturuar” të cilat do të ndihmojnë aktivitetet përgatitore nga gjyqtari dhe nga palët.
- Pyetjet e strukturuar krijojnë një procesverbal zyrtar të procedurës i cili është i rregulluar logjikisht, i cili në të njëjtën kohë i ndihmon gjyqtarit dhe palëve të organizojnë analizën e tyre të shkruar ligjore.

3. Procesi Analitik

Tani, pasi që kemi dëshmuar se një analizë e strukturuar ligjore shërben për qëllime të nevojshme, le të diskutojmë për një kornizë të duhur.

IRAC është një shkurtesë në gjuhën angleze për një proces analitik katër-hapësh

- Identifikimi i çështjes
- Identifikimi i rregullës
- Analizimi

- Përfundimi

Le të diskutojmë dhe të ilustrojmë secilin hap nga katër hapat e këtij procesi analitik.

- **Identifikimi i çështjes**, që fokusohet vetëm në çështjet që potencialisht zgjidhin të gjithë ose një pjesë të kontestit para gjykatës.
 - **Shembull:** Një gjyqtar, një palës, apo një avokat i palës mund të formojë një çështje duke deklaruar se, “Çështja në këtë rast është nëse shteti e ka të ndaluar me kushtetutë të bëjë shpronësimin e pronës, nëse shpronësimi nuk është i autorizuar nga ligji, nëse nuk është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik dhe nëse nuk pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat pronat e të cilëve shpronësohet.”
- **Identifikimi i rregullës**, që fokusohet në një rregull kushtetuese, ligjor, apo rregull tjetër që është (ose janë) të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.
 - **Shembull:** Në rastin hipotetik të përshkruar më sipër, gjyqtari, pala apo përfaqësuesi i palës mund të cekin se, “Neni 46 (3) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron se “[as] njëri nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet.”
 - Për arsye që mund të diskutohen më poshtë, identifikimi i elementeve/kushteve thelbësore për “shpronësimin “ janë relevante.
 - Për më tepër, identifikimi i rasteve precedent (*procedurë për një rast ku elementet e çështjes mbështeten në rrethana esencialisht të njëjta dhe për të cilin rast çështja ka kaluar në tri instanca gjyqësore*) në të cilat koncepti i një rasti të “shpronësimit” u interpretua në kontekstin e klauzolës kushtetuese të gjykimit të dyfishtë do të jetë i rëndësishëm.
- **Analiza** përfshinë përcaktimin nëse çdo element i rregullës (apo rregullave) përkatëse aplikohet ndaj fakteve, të cilat shpesh përfshijnë përdorimin e fjalëve “këtu” dhe “sepse” si pjesë kyçe të analizës për të parë nëse çdo element thelbësor i rregullës është (ose, nuk është) i kënaqur me aspekte të veçanta të dhënave faktike.

- **Shembull:** Avokati i palës së paditur mund të pohojë se: “Ky rregull kushtetues për elementet/kushtet e shpronësimit konsumohet dhe konsiderohet i përmbushur me vet faktin se procedurën e shpronësimit e ka filluar një organ publik, për një interes publik dhe për të shpronësuarin është siguruar kompensimi. Në rastin konkret elementi/kushti për “interesin publik” nuk është i nevojshëm të provohet ngase konsumohet me vet faktin se shpronësimin e ka filluar organi publik.”
 - Nga ana tjetër, avokati i palës paditëse mund të pretendojë se: “Kushtetuta i jep i jap mbrojtje/garancion secilit pronar prona e të cilit mund të jetë objekt i shpronësimit se nuk do të shpronësohet pa u përmbushur kumulativisht kushtet e kërkuara nga norma kushtetuese. Në rastin konkret kushtet që duhet të plotësohen kumulativisht janë që shpronësuesi të jetë “*organ publik i autorizuar nga ligji*” për fillimin e shpronësimit, nevoja për shpronësimin e pronës së caktuar domosdoshmërisht të justifikohet me nevojën e “*interesit publik*” dhe për personin e shpronësuar të sigurohet “*kompensimi adekuat*” menjëherë”.
- Duke pranuar se zgjidhja e kontestit varet nga një interpretimi i normës kushtetuese respektivisht shprehjeve “ *organ publik i autorizuar nga ligji*”, “*interes publik*” dhe “*kompensimi adekuat*”, gjyqtari do të shqyrtojë nëse elementet/kushtet e e shpronësimit si “ organ publik i autorizuar nga ligji”, “interes publik” dhe “kompensimi adekuat” janë përmbushur kumulativisht në rastin konkret dhe specifikisht do të vlerësojë elementi/kushti i shpronësimit “*interes publik*” duhet të provohet për në vijen e shpronësimit apo është i konsumuar me vet faktin se shpronësimin e ka filluar “organi publik” i autorizuar sipas ligjit.
- Gjyqtari mund krahasojë elementet/kushte për procedurën e shpronësimit duke krahasuar procedurat për rastet e mëparshme por të cilat janë të verifikuara (*kanë kaluar të gjitha instancat gjyqësore nëse rrethanat faktike janë esencialisht të njëjta*), dhe ose mund të ketë një interpretim specifik të gjykatës vetëm për rastin konkret dhe rrjedhimisht një vlerësim të kushteve vetëm për atë rast duhet marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqësore si për rrethanat faktike ashtu edhe ligjore”.
- **Përfundimi** është hap përfundimtar në procesin e arsyetimit dhe përbëhet nga një deklaratë përfundimtare mbi atë se si është zgjedhur kjo çështje (pjesërisht ose plotësisht) nga rezultatet e mbështetura në analizë.
- **Shembull:** Avokati i palës paditëse mund të pohojë se: “Kushtetuta i jep mbajtje/garancion secilit pronar për pronën e tij dhe sipas kësaj norme kushtetuese procedura e shpronësimit kushtet për shpronësim duhet të

përmbushën në mënyrë komulative. Nuk mjafton që të plotësohet vetëm kushti që organi shpronësues të jetë organ publik dhe i autorizuar nga ligji dhe për pronarin e shpronësuar të sigurohet kompensimi. Përveç këtyre dy kushteve duhet të plotësohet kushti tjetër i cili është përcaktues për realizimin e shpronësimit e që është “interesi publik”. Në rastin konkret ky kusht nuk është plotësuar sepse qëllimi për të cilin do të përdoret prona e shpronësuar nuk është e nevojshme dhe rrjedhimisht as i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesave publike”.

- Avokati i palës së paditur mund të pohojë se: “Ky rregull kushtetues për elementet/kushtet e shpronësimit konsumohet dhe konsiderohet i përmbushur me vet faktin se procedurën e shpronësimit e ka filluar një organ publik, për një interes publik dhe për të shpronësuarin është siguruar kompensimi. Në çdo rast kur të shpronësuarit i sigurohet “*kompensimi adekuat*” nga organi shpronësuesi për të njëjtin rregull kushtetuese dhe garancioni kushtetues konsiderohen të përmbushur.
- Përfundimi i gjyqtarit do të varet nga gjetjet e tij/saj në lidhje me nevojën që kushtet për procedurën e shpronësimit duhet të përmbushen kumulativisht dhe në këtë rast kushti për “interesi publik” duhet të provohet, apo i njëjti si kushte nuk ka nevojë të provohet nga shpronësuesi pasi që justifikohet nga vet fakti se shpronësimin e ka filluar organi i autorizuar nga ligji për shpronësim”.

4. Rëndësia dhe nevoja për procesin analitik

Një objektiv i rëndësishëm është që pjesëmarrësit në mësim të zgjidhin pyetjet e nënkuptuara në pika të ndryshme në procesin e arsytimit.

- Testet e tilla janë të nevojshme pavarësisht nëse ai që përgjigjet është ithtar ose jo i një përfundimi të caktuar juridik.

Fillimisht, pyetjet provë fillojnë me “çfarë” dhe duhet të jenë të formuluar me saktësi.

- Për shembull, një pyetje e rëndësishme është “Cila është çështja?” Më saktë, “Cila është çështja relevante – çështja që do të zgjedh kontestin?”

Ky trajnim duhet të mësojë pjesëmarrësit për të zhvilluar një progresion logjik i cili do ta zgjidh kontestin.

Gjatë angazhimit në arsyetimin ligjor, një gjyqtar, prokuror apo mbrojtës, duhet të identifikojë çështjen relevante, rregullën përkatëse dhe faktet relevante, dhe pastaj të kryejë një analizë përkatëse.

Përfundimi duhet të përmbajë një shpjegim se si një aplikim i rregullave ndaj fakteve zgjidh këtë çështje.

- Me fjalë të tjera, pyetja përfundimtare duhet të jetë, “Cili është justifikimi për një përfundim se faktet këtu përshtaten me elementet thelbësore të rregullës në fuqi, duke kërkuar prandaj një zgjidhje të këtillë të kontestit?” Dhe përgjigja ndaj kësaj pyetjeje duhet të përmbajë fjalën “sepse.”
 - Për shembull, “Ky rast i shpronësimit duhet të anulohet sepse organi i shpronësimit nuk i ka përmbushur kushtet për të shpronësuar (pronën e caktuar) ngase nuk ka provuar në asnjë fakt nga i cili do të rrjedhë nevoja dhe përshtatshmëria e shpronësimit për interes publik. Në këtë rast norma kushtetuese nga neni 46 (3) nuk lejon privim arbitrar të askujt nga prona e tij.

Forcimi i aftësive organizative është një tjetër objektiv kryesor i modulit trajnues, i cili përfshinë vëmendje ndaj arsyetimit me gojë dhe me shkrim, në atë radhë.

Ne do të përqendrohemi së pari në arsyetimin me gojë, sepse dialogu do të përqendrohet në aftësitë kolektive të pjesëmarrësve për të arsyetuar duke përdorur metodologjinë IRAC nëpërmjet pyetjeve, reflektimit të moderuar, dhe diskutimit.

- Komponenti i arsyetimit me gojë do të shërbejë gjithashtu si një hyrje në përshkrimin oral bazuar në IRAC.

Qëllimi i kësaj faze është të trajnojë pjesëmarrësit për të parashtruar (dhe përgjigjur) pyetjet përkatëse... të organizojnë informacionin e duhur në mënyrë të qartë dhe logjikisht...dhe të bëjnë analiza relevante dhe më pastaj për të shprehur përfundimet që dalin nga kjo shkurtimisht (por me arsyetim të mjaftueshëm).

Duke vazhduar nga ushtrimet e arsyetimit oral, një qëllim i aktiviteteve të arsyetimit të shkruar do të jetë orientimi drejt formulimit të dokumenteve ligjore të qarta, logjike dhe të qëlluara që shfrytëzojnë konceptin IRAC.

Orientimi do të përqendrohet në përdorimin e një formati të lehtë për tu përcjellë që... drejton lexuesin nga një hap logjik tek tjetri... duke shfrytëzuar një fjalor të kuptueshëm dhe jo-teknik çdoherë kur është e mundur.

Një qëllim i ndërlidhur i këtij kursi është përvetësimi i shablloneve bazike për hartimin e vendimeve gjyqësore apo dokumenteve të tjera gjyqësore.

Standardizimi i formateve të shkrimit ligjor do të përmirësojë dukshëm cilësinë e arsytimit ligjor në gjithë sistemin e drejtësisë.

Shfrytëzimi i shabllonëve do të mundësojë që ky synim të arrihet në mënyrë efektive përmes vetë-udhëzimit.

5. Sfidat analitike

Edhe pse renditja e tyre mund të ndryshojë, aktivitetet e gjykatësve dhe e avokatëve në thelb janë mjaft të ngjashme.

Më saktësisht, gjykatësit dhe avokatët kryejnë aktivitete reciproke.

- Avokati në avokaturë private i menaxhon këto aktivitete me qëllim që të avancojë pikësynimet e palës.
- Prokurori avokon interesin publik, duke u kujdesur që procedurat kundër të pandehurit të kenë bazë në fakte dhe në ligj.
- Gjykatësi lehtëson procedurën ashtu që nxit paraqitjen e fakteve dhe argumenteve ligjore të palëve të cilat do të bëhen pjesë bazë apo themel i aktgjykimit, e plotësuar me hulumtim ligjor.

Sfidat analitike

Ekzistojnë hapa identik në procedurën ligjore, çdonjëri prej të cilave përfaqëson një sfidë:

- Gjykatësi dhe avokati duhet t'i identifikojnë dhe t'i organizojnë të gjitha faktet e dëshmuar relevante nga dosja e lëndës.
- Gjykatësi dhe avokati duhet t'i identifikojnë dhe t'i zbatojnë të gjitha të drejtat e mundshme të aplikueshme kushtetuese, statutet, rregulloret, rregullat dhe jurisprudencën, duke iu kushtuar vëmendje të veçantë standardeve ligjore të cilat duhet të përmbushen (apo të kundërshtohen) nga palët.

Sfidat analitike

Pas shqyrtimit të fakteve relevante dhe dispozitave të mundshme ligjore që vlejnë për rastin, gjykatësi dhe avokatët duhet t'i identifikojnë të gjitha çështjet relevante, me potencial të zgjidhjes që rrjedhin nga rrethanat e kundërthënies të ngritura.

Gjykatësi dhe avokatët duhet t'i identifikojnë dhe t'i shqyrtojnë të gjitha pengesat procedurat të zgjidhjes së kundërthënies apo rastit.

Kontesti duhet të ndërlihdë ligjin në fuqi me faktet relevante dhe atë në mënyrën e cila mbështet një përfundim të arsyeshëm përkitazi me zgjidhjen e kërkesave preliminare të cilat mund të parashtrihen nga avokatët kundërshtarë të të dyja palëve.

- Në këtë fazë, shqyrtimi i gjykatësit është më shumë i natyrës tentative pasi që gjykatësi thjesht shqyrton standardet ligjore të aplikueshme, si dhe faktet potencialisht të dëshmueshme të cilat mund të mbështesin, apo të hedhin poshtë argumentet e palëve gjatë kryerjes së procedurës.
- Shqyrtimi i këtyre çështjeve nga gjykatësi ndihmon në njohjen dhe rafinimin më të mirë të peshës relative të argumenteve të palëve.

Sfidat analitike

Pas një periudhe të shqyrtimit dhe hulumtimit, avokatët duhet të bëjnë apo të mbrohen nga kërkesat preliminare të cilat kërkojnë përjashtimin e provave gjatë gjykimit – nëse ligji dhe rrethanat arsyetojnë veprime të tilla.

- Gjykatësi shqyrton dhe vendos mbi kërkesat preliminare të palëve.

Sfidat analitike

Gjykatësi dhe avokatët përgatiten për dëgjime apo gjykime duke organizuar materiale dhe informata të grumbulluara gjatë fazave të mëhershme të procedurës.

- Gjykatësi duhet të përgatitet t'iu parashtrijë pyetje direkte avokatëve të palëve me synim ngushtimin e fakteve relevante dhe ligjit të aplikueshëm, por në veçanti të fitojë një njohuri të qartë të argumenteve të palëve.
- Gjithashtu, gjykatësi përdor pyetjet e drejtuara palëve për t'iu përgjigjur (në kuptim të zhvillimit) të argumenteve të palëve, teksa argumentet shpalosen gjatë diskutimeve gojore.

- Gjykatësi gjithashtu duhet të dëgjojë dhe të zgjidhë vërejtjet ndaj pranimit të fakteve të parashtruara gjatë dëgjimeve dhe gjykimeve.
- Në fund, gjykatësi organizon dhe prezanton faktet, si dhe arsyetimin e aplikueshëm ligjor, në një mënyrë të kuptueshme të shkruar me të cilën zgjidhen të gjitha kundërthëniet relevante ligjore të rastit.
 - Në të njëjtën kohë, avokatët duhet të hartojnë deklarata dhe dëshmi relevante gjatë dëgjimeve të cilat ofrojnë mbështetje faktike për argumentet apo pohimet e tij/saj për zgjidhjen e rastit.

Sfidat analitike

Avokatët duhet të jenë të përgatitur për të kundërshtuar dëshmitë e papranueshme të parashtruara nga avokati kundërshtues.

- Në anën tjetër, propozuesi i dëshmisë duhet të përgatitet t'i kundërshtojë vërejtjet apo kundërshtimet e parashtruara nga avokati kundërshtues gjatë dëgjimeve dhe seancave të gjykimit.

Avokatët duhet të përgatiten për t'i prezantuar gjykatësit faktet relevante dhe ligjin në fuqi si dhe gojë ashtu edhe me shkrim në formatin narrativ, t'iu përgjigjet pohimeve të avokatit kundërshtues të prezantuar gjatë argumentit gojor, si dhe pyetjeve të parashtruara nga gjykatësi.

- Në anën tjetër, gjykatësi duhet të përgatitet të dëgjojë dëshmitë, dhe të ndihmojë në hartimin e procesverbalit përmes pyetjeve apo aktiviteteve të tjera, në diskrecion të vet gjykatësit.

Sfidat analitike

Gjykatësi dhe avokatët duhet të marrin parasysh kundërshtimet e pranueshme ndaj pranimit të deklaratave të dëshmitarëve apo provave materiale gjatë vetë gjykimit.

Avokatët duhet të parashtrorjnë, apo të mbrohen nga, kundërshtimet ndaj pranimit të deklaratave të dëshmitarëve apo provave materiale gjatë gjykimit.

Gjykatësi shqyrton dhe merr vendim lidhur me kundërshtimet e pranueshmërisë së provave të parashtruara gjatë gjykimit.

Avokatët duhet të parashtrojnë, apo t’iu përgjigjen, pohimeve gojore lidhur me vërejtjet gjatë gjykimit, dhe/ose kërkesave gjatë gjykimit.

Gjykatësi duhet të merr parasysh dhe të vendos lidhur me kundërshtimet gjatë gjykimit, dhe/ose kërkesat apo propozimet gjatë gjykimit.

Sfidat analitike

- Sipas udhëzimeve të gjykatësit, avokatët duhet të parashtrojnë argumente të shkruara në mbështetje apo kundërshtim të ndonjë zgjidhjeje të caktuar të rastit, dhe atë në mënyrën e cila qartazi i parashtron çështjet, faktet, ligjin në fuqi si dhe përfundimin e mbështetur.
 - Gjykatësi duhet të dijë se kur është e qëlluar një kërkesë apo propozim i tillë.
 - Gjykatësi duhet të lëshojë një vendim të shkruar ku qartazi ceken çështjet, faktet, ligji në fuqi, si dhe përfundimin e mbështetur me të cilin zgjidhen të gjitha kontestet e palëve.

Sfidat analitike

Ekziston të paktën edhe një qasje madhore për zgjidhjen e sfidave me të cilat përballen gjykatësit gjatë procedurave ligjore.

- Organizimi
 - Parashtrësar gojore dhe të shkruara për gjykatën organizohen në mënyrën e cila është e kuptueshme, logjike, dhe mbështetëse të cilat ndihmojnë gjykatësin në zgjidhjen efikase dhe efektive të rastit.
 - Ngjashëm, aktgjykimet e gjykatave të cilat janë të kuptueshme, logjike dhe të bazuara mirë, të cilat komunikojnë rezultatet e rastit në mënyrë efikase dhe efektive.
 - Aktgjykimet e tilla do ta lehtësojnë edhe shqyrtimin gjatë procedurës së apelit.

Zgjidhja

Metoda katër-hapëshe e arsyetimit ligjor e njohur si “IRAC” është një sistem organizimi, i cili, nëse aplikohet nga gjykatësit dhe të gjitha palët në rast, nxit një nivel organizimi i cili përmirëson efikasitet dhe efektivitet të shërbimeve gjyqësore.

- SHËNIM: Gjykatësit kanë diskrecion t’u kërkojnë palëve që të pasojnë këtë metodë me mjete të ndryshme.

6. Analiza e Shkruar Ligjore

Konceptualisht, një parashtrësë ligjore e arsyetuar mirë do të ketë pesë komponentë:

- Titullin
- Qëndrimet Procedurale
- Faktet
- Shqyrtimi/analiza
- Përfundimin

Titulli

Është një titulli i standardizuar në një dokument ligjor që përmban emrin e gjykatës, emrat e palëve, numrin e rastit, dhe qëllimin e paraqitjes ose lëshimit të dokumentit.

Qëndrimi Procedural

Qëndrimi procedural është një deklaratë hyrëse që e vë dokumentin ligjor në kontekstin e rastit të përgjithshëm, dhe identifikon qëllimin e dokumentit.

Faktet

- Seksioni i fakteve shërben për dy qëllime.

Së pari, ky seksion duhet të përmbajë fakte të mjaftueshme në mënyrë që lexuesi mund të kuptojë natyrën e çështjes, por jo më shumë se është e nevojshme për të vendosur faktet materiale në kontekst.

Së dyti, ky seksion duhet të lidhet me faktet që janë material për një zgjidhje të çështjes, së bashku me një tregues të burimit të fakteve. Mund të jetë i dobishëm për të dalluar faktet e pakontestueshme nga ato të kontestueshmet.

Shqyrtimi

Seksioni i shqyrtimit përmban arsyetimin të cilin autori e ka ndjekur gjatë paraqitjes (ose, në rastin e një gjyqtari, gjatë të vendosurit) që një zgjidhje e veçantë e një çështjeje kërkohet sipas aplikimit të ligjit ndaj fakteve dhe rrethanave që janë relevante për kontroversën.

Në mënyrë tipike, çështja më e rëndësishme (në qoftë se ka më shumë se një çështje) është trajtuar së pari, dhe shqyrtimi lidhur me çdo çështje ndjek një progresion logjik duke përdorur metodologjinë IRAC.

Ndonjëherë, një dokument identifikon disa çështje që janë të ndërvarura, dhe dokumenti adreson çështjet në një radhitje përkatëse.

- **Shembull:** Një paditës i cili e ka humbur kontestin për kompensimin për shkak të mos përmbushjes së kontratës mund të bëjë përpjekje që për çështjen e njëjtte të paraqes një padi të dytë me pretendimin se objekt i kontestit nuk është kompensimi për shkak të mos përmbushjes së kontratës por kompensimi për shkak të pasurimit pabazë. Në këtë mënyrë do të provoj ta bind gjykatën se nuk është fjala për çështje të gjykuar, por për rast të ri i cili duhet të shqyrtohet pavarësisht nga rasti i mëparshëm.

Pas dëgjimit të argumenteve dhe / ose pranimit të parashtresave me shkrim nga palët, gjyqtari mund të hedh poshtë padinë si të palejuar për shkak çështja e ngritur përfaqëson çështje të gjykuar. Gjykata do ta hedh poshtë padinë si të palejuar me arsyetimin se ka identifikuar/ka gjetur të gjitha elementet të cilat e kualifikojnë rastin si çështje të gjykuara dhe atë: subjektet e njëjtë, objekti i kontestit i njëjtë, rrethanat e njëjta, procedura e njëjtë dhe vendimin paraprak të formës së prerë.

Nga pikëpamja praktike, praktika më e mirë është që të seksioni i diskutimit të organizohet duke përdorur titujt në mënyrë që palët kundërshtare dhe gjyqtarët janë në gjendje për të ndjekur dokumentin.

Për më tepër, dokumenti duhet t'i shmanget gjuhës teknike juridike, dhe në vend të kësaj të përdor fjalë të thjeshta dhe fjalor në masën që është e mundur.

Me fjalë të tjera, një dokument juridik duhet të jetë më shumë si një artikull reviste i shkruar mirë se sa një botim shkencor.

Çështja Nr. 1

Në këtë nën-seksion, autori identifikon një çështje që duhet të zgjidhet në mënyrë që të zgjidhet i gjithë ose një pjesë e rastit. Çështja duhet të identifikohen me saktësi, dhe ajo duhet të thjeshtohet në atë masë që është e mundur – dhe duhet të jetë relevante.

Shembulli i Çështjes: “Në mënyrë që të zgjidhë parashtresën e të paditurit për të hedhur poshtë padinë mbi baza ligjore, gjykata duhet të përcaktojë nëse shqyrtimi i çështjes në pritje do të rezultojë në një gjykim të dytë për të njëjtën çështje, në shkelje të Ligjit për gjykimin e dyfishtë.”

Sigurisht, mund të ketë një ose më shumë alternativa për mënyrën në të cilën kjo çështje është parashtruar, por çështja është e qartë. Megjithatë, a është ky përshkrim i çështjes adekuat?

- **Shembulli i Rregullës 1:** “Ligji për Procedurën Kontestimore përcakton se” *Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.* Ligji për Procedurën Kontestimore. Ky detyrim për gjykatën përcaktohet me dispozitën e nenit 166 paragrafi 2, i Ligjit për Procedurën Kontestimore.”
- **Shembulli i Rregullës 2:** “Neni 166.2 i Ligji për Procedurën Kontestimore siguron se gjykata do të kujdeset nëse çështja është e gjykuar dhe nëse gjen se çështja është e gjykuar do ta hedh poshtë padinë, sepse nuk lejohet që një çështje të gjykohej dy here”.
- **Shembulli i Rregullës 3:** “Ligji për Procedurën Kontestimore e ndalon shqyrtimin/gjykimin e çështjes për të dytën herë. Ligji për Procedurën Kontestimore, neni 166.2.”
- **Shembulli i Rregullës 4:** “Ligji për Procedurën Kontestimore nuk e lejon shqyrtimin/gjykimin e çështjes për të dytën here”
- **Shembulli i Rregullës 5:** “Gjykatës nuk i lejohet që të shqyrtoj/gjykoj çështjen që është gjykuar më parë.”
- **Shembulli i Rregullës 6:** “Do të ishte e padrejtë nëse do ti lejohej gjykatës që të gjykojë çështjen që është gjykuar më parë.”

Cilat, nëse ka ndonjë, prej këtyre shembujve i shërben qëllimeve të metodologjisë IRAC?

- Në dy shembujt e parë, rregulli citohet tekstualisht, ndjekur nga një citim i autoritetit ligjor. Citatet e ligjit në dy shembujt e parë i mundësojnë lexuesit të mendojë mbi rregullën- duke supozuar se ishte cituar saktë-pa iu referuar një dokumenti tjetër (p.sh., Ligjit për Procedurën Kontestimore). Secila prej këtyre dy qasjeve është efektive.
- Në shembullin e tretë, pretendimi duket autoritativ, dhe është pasuar nga një citim i Ligjit për Procedurën Kontestimore. Kjo qasje është më pak efektive për shkak se një lexues mund të detyrohet për të verifikuar karakterizimin e rregullës, edhe pse ekzistenca e citimit mund të jetë e mjaftueshme.

- Qasja e marrë në shembullin e katërt, gjithashtu duket autoritative, por është dobësuar nga mungesa e një citimi të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Një lexues ka të ngjarë të jetë i motivuar për të verifikuar karakterizimin e ndalimit kushtetues.
- Sa për shembullin e pestë, kjo qasje është edhe më e dobët, sepse ajo nuk ia atribuon të drejtën për të shmangur gjykimin e dyfishtë ndonjë autoriteti të veçantë ligjor.
- Shembulli i gjashtë është argumentues dhe nuk është me çdo kusht identifikim i një rregulli të veçantë që mund të jetë i rëndësishëm për zgjidhjen e çështjes.
- Në fund, është e qartë se praktika më e mirë është që rregulla të citohet tekstualisht, dhe të sigurohet një citim i autoritetit ligjor.

Analiza

- Në këtë seksion, autori duhet të aplikojë rregullin përkatës ndaj fakteve relevante, dhe të bëjë një vendim në lidhje me rezultatin.
- Rregulli i aplikueshëm që është themeluar më lart, faktet relevante që zgjidhin problemin duhet të identifikohen (dhe ti atribuohen një burimi të dëshmive të pranueshme, ose dëshmisë që është lejuar ndryshe për qëllime të kësaj analize), dhe marrëdhëniet ndërmjet rregullës dhe fakteve duhet të hulumtohen në mënyrë efikase, kështu që një rezultat mund të mbështetet.
- Mund të jetë e nevojshme për të futur vendime nga gjykatat që kanë interpretuar në rregull në rrethana të ngjashme, edhe pse autori duhet të bëjë dallime të duhura në mes të rastit në pritje dhe rasteve precedent.
- Këtu kemi një analizë hipotetike:
 - **Shembulli 1**: Ky shembull supozon se padia në pritje dhe padia e mëparshme për të cilën është vendosur me aktgjykim të formës së prerë janë identike për shkak të subjekteve, objektit të kontestit, rrethanave faktike dhe procedurës respektivisht ekzistimit të aktgjykimit të formës së prerë. Rasti është shtruar nën supozimin se kërkesëpadia e paditësit është refuzuar si e pabazuar në rastin e parë.
- “Ligji për Procedurën Kontestimore përcakton se” *Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme..’* Ky detyrim për gjykatën përcaktohet me dispozitën e nenit 166 paragrafi 2, i Ligjit për Procedurën Kontestimore. Këtu, paditësi ka paraqitur padi për të cilën gjykata e shkallës së parë më aktgjykimin C.nr....., i datëska vendosur që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar

kërkesëpadinë e paditësit, ndaj të paditurit. Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin Ac.nr....., të datës....., ka vendosur që ta refuzoj ankesën dhe ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Pasi që gjykata konstatoi rrethanat nga të cilat rrjedh se rasti i ngritur sipas padisë në pritje është identik me rastin e gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, vendosi ta hedh poshtë padinë si të palejuar për shkak të gjësë së gjykuara.

Duket se kjo analizë është e drejtë, dhe se rezultati është i pashmangshëm.

- **Shembulli 2:** Ky shembull supozon se padia në pritje është paraqitur ndaj të paditurit për kompensimin e dëmit që i ka shkaktuar i padituri paditësi në lokalit e tij gjatë kohës që e ka mbajtur me qiranë (në periudhën që nuk ka qenë kontestuese pagesa e qirasë dhe në periudhën pasuese), ndërsa padia e mëparshme ka qenë për kompensimin e dëmit për shkak se për një periudhë të caktuar i padituri e ka shfrytëzuar lokalit pa marrëveshje (e njëjta ishte refuzuar e pabazuar).
- “Ligji për Procedurën Kontestimore përcakton se” *Gjykata gjatë gjithë procedimit të çështjes kujdeset sipas detyrës zyrtare se a mos është gjë e gjykuar çështja e ngritur me padi dhe nëse konstaton se procedura është iniciuar për kërkesën për të cilën ekziston vendimi i formës së prerë, padia duhet të hedhet poshtë si e palejueshme..’* Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr....., i datëska vendosur që ta refuzoj në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndaj të paditurit, me të cilën ka kërkuar kompensimin si pasurim pabazë për shkak të shfrytëzimit të lokalit të paditësit i cili ndodhet në Prishtinë, dhe atë në periudhën 01.07.2015 deri me 31.12.2015. Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin Ac.nr....., të datës....., ka vendosur që ta refuzoj ankesën dhe ta vërtetojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa padia në pritje ka për objekt kontesti kompensimin e dëmit që është shkaktuar nga shfrytëzimi i lokalit si shtëpiak jo i mirë për të dy periudhat edhe atë që nuk ka qenë kontestuese pagesa e qirasë dhe periudha pasuese për të cilën është vendosur paraprakisht. I autorizuari i të paditurit mund të ngre pretendimin se aktgjykimi i formës së prerë me të cilin është vendosur për kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kërkesën e kompensimit të dëmit për shkak të pasurimit pabazë përfaqëson çështje të gjykuar edhe për kërkesëpadinë në pritje për kompensimin e dëmit për shkak të shfrytëzimit të lokalit si shtëpiak jo i mirë. I autorizuari i paditësit mundet të mbetet pranë pretendimit se aktgjykimi i formës së prerë e ka konsumuar vetëm kërkesën e paditësi për kompensimin për shkak të pasurimit pa bazë e që është kërkesa ekuivalente me të drejtën e qirasë, ndërsa kërkesëpadia në pritje i referohet një baze tjetër e që specifikisht ka të bëjë me shfrytëzimin si shtëpiak jo i mirë.

Analiza e Gjykatës është se: “..... “

Kjo është një analizë më komplekse se shembulli i parë. Në këtë rast gjykatës i duhet një analizë e hollësishme e rrethanave të rastit të gjykuara dhe rastit në pritje në mënyrë që të nxjerrë përfundimin për çështjen e gjykuara.

Përfundimi

- Seksioni i përfundimit është përgjithësisht i drejtpërdrejtë, dhe duhet të zgjidh kontroversën me një ose dy fjali, të cilat duhet të jenë një pasojë logjike e konsideratave të shprehura më parë gjatë hapave të procesit IRAC.
- Këtu janë disa përfundime të mundshme në lidhje me dy rastet hipotetike të përshkruara më lart:
 - **Shembulli 1**: “Për shkak të palëve të njëjta, objektit të njëjtë, rrethanat faktike të njëjtat, ekzistimit të vendimit të formës së prerë për rastin e njëjtë, padi në pritje duhet të hedhet poshtë.”
 - **Shembulli 2 (Opsioni 1)**: “Për shkak të palëve të njëjta, objektit të njëjtë, rrethanat faktike të njëjtat, ekzistimit të vendimit të formës së prerë për rastin e njëjtë, padi në pritje duhet të hedhet poshtë.”
 - **Shembulli 2 (Opsioni 2)**: “Për shkak se rrethanat faktike nuk janë të njëjta si në rastin e gjykuar dhe rastin në pritje, pavarësisht se subjektet janë të njëjtë dhe pavarësisht se ekziston vendimi i formës së prerë për subjektet e njëjtë, padia e paditësit nuk duhet të hedhet poshtë por duhet të vendoset në mënyrë meritorë”.

II. ANALIZË PËR MUNDËSINË E ZBATIMIT TË METODOLOGJISË “IRAC” NË HARTIMIN E AKTGJYKIMIT NË LËNDËT CIVILE

Ne duhet të kemi parasysh se përmes aktgjykimit të shkruar gjykata vendosë për kërkesëpadinë, përderisa IRAC paraqet një metodë për të perfeksionuar të shkruarit dhe arsyetimit ligjor. Aktgjykimi i shkruar është akt që lëshohet nga gjykata kur ajo e zgjidh një çështje. Metodologjia IRAC është një vegël që ndihmon gjykatën në arsyetimin e vendimit i cili përshkruhet në aktgjykimin e shkruar.

LPK e përshkruan formën, strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit të shkruar të cilën duhet ta përdorë gjykata. Në anën tjetër, metoda IRAC përmban procedurën me katër faza, e cila siguron që aktgjykimi i shkruar të ketë përmbajtje cilësore, analizë të strukturuar të fakteve, dhe analizë të arsyeshme ligjore.

Ne mund të vërejmë dallime strukturore në mes të aktgjykimit të shkruar dhe metodës IRAC. Aktgjykimi i shkruar strukturohet bazuar në pjesët e tij integrale duke filluar me hyrjen, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimet për të drejtën për parashtrimin e ankesës kundër aktgjykimit. Metoda IRAC paraqet një proces analitik me katër faza: faza e parë është identifikimi i çështjes duke u fokusuar vetëm në çështjet që potencialisht zgjidhin tërë ose një pjesë të kontestit në gjykatë. Faza e dytë është identifikimi i rregullës, që fokusohet në rregullat kushtetuese, ligjore ose rregulla të tjera që janë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës. Faza e tretë përfshinë analizën dhe përfshinë përcaktimin e secilit element të një rregulle të caktuar e cila mund të aplikohet për faktet. Kjo fazë shpesh përfshinë edhe përdorimin fjalëve “këtu” dhe “për arsye se” si pjesë kyçe të analizës; për të parë se a është përmbushur (apo jo) secili element thelbësor i rregullës me aspektet e caktuara të informatave faktike. Faza e katërt dhe përfundimtare në procesin e arsyetimit është përfundimi (konkluzioni) dhe ai përbëhet nga deklarimi përfundimtar i cili sqaron se si janë zgjidhur “çështjet” (pjesërisht ose tërësisht) si rezultat i analizës.

Pjesa e arsyetimit të aktgjykimit të shkruar është pjesë në të cilin mund të zbatohen hapat e arsyetimit sipas procesit analitik të metodës IRAC – analizës.

Arsyetimi i aktgjykimit të shkruar në një lëndë civile duhet të përshkruajë kërkesat/prendimet e palëve, të numërojë faktet që palët theksojnë se mbështesin pretendimin dhe dëshmitë e propozuara nga ta.

Gjykata duhet të përshkruajë pretendimet përfundimtare të palëve në kontest, pretendimet që duhet të paraqiten si sintezë e kërkesave të parashtruesit të kërkesës ose vërejtjet e palës së paditur, bazuar në analizën e dëshmive të secilës palë.

Pretendimet përfundimtare të paraqitura nga palët në kontest, të cilat duhet të përshkruhen në arsyetimin e aktgjykimit, duhet të synojnë që të krijojnë një opinion të brendshëm ligjor brenda gjykatës i cili do të jetë sa më afër të vërtetës që të jetë e mundur, në mënyrë që vendimi i gjykatës të jetë ligjërisht i qëndrueshëm, i drejtë, i paanshëm dhe bindës për palët në kontest.

Arsyetimi duhet të përshkruajë gjetjet faktike të gjykatës në mënyrën e cila është në përputhje me kushtet që duhet të përmbush arsyetimi. Kur të bëj këtë, gjykata duhet të theksojë në mënyrë të qartë dhe shteruese se cilat fakte ajo mendon se janë vërtetuar e cilat jo, si dhe arsyet për ato përcaktime. Në fakt, pjesa e arsyetimit e aktgjykimit të shkruar, elementet subjektive dhe objektive të kontestit duhet të jenë të qarta, si dhe arsyet që kanë bërë që gjykata të marrë vendimet e paraqitura në dispozitivin e aktgjykimit të shkruar.

Arsyetimi i aktgjykimit të shkruar duhet të ketë një sqarim kronologjik dhe vlerësim si të analizës së fakteve ashtu edhe analizës së zbatueshmërisë së normave ligjore. Në këtë aspekt aktgjykimi duhet të përshkruajë veprimet procedurale të ndërmarra gjatë gjykimit, qëndrimet dhe vendimet procedurale lidhur me çështjet paraprake dhe procedurale, mocionet (kërkesat) e aprovuara dhe të refuzuara të palëve, përfshirë edhe sqarimet se cilat rrethana kanë ndikuar në

aprovimin apo refuzimin e kërkesave të tilla. Gjykata duhet të sqarojë rrethanat e rastit ashtu siç janë pranuar (në proces kronologjik) dhe, bazuar në rrethana, gjykata duhet të sqarojë përfundimin (konkluzionin) që e ka sjell ajo.

Përveç kësaj, gjykata duhet të dëshmojë saktësinë faktike me referenca në dëshmitë që ajo i ka pranuar gjatë gjykimit. Gjatë tërë kohës gjykata duhet të shmang arsyetimin jo të plotë dhe të pabazuar. Për shembull, duhet të shmangen deklaratat si më poshtë: “nga ajo që u tha më lartë rezultojnë se..., pastaj bazuar në deklaratat e dëshmitarëve..., pa sqaruar, analizuar dhe dëshmuar saktësinë e deklaratave...,” e kështu me radhë).

Përshkrimet e dëshmive duhet të jenë të arsyetuara dhe të strukturuar në mënyrë që të tregojnë se gjykata i konsideron ato bindëse, bashkë me arsyet për një përfundim të tillë. Për shembull, kur gjykata të konstatojë se pretendimi i një pale nuk është i pranueshëm, ajo duhet të arsyetojë vendimin duke cituar dëshmi konkrete, duke paraqitur referenca për kundërthëniet në mes të dëshmitarëve dhe dëshmitë e tjera materiale të cilat kanë çuar gjykatën deri te një përfundim i caktuar. Në këtë mënyrë, gjykata po ashtu bën një vlerësim të dëshmive të pranuar. Gjykata po ashtu, në mënyrë të veçantë do të vlerësojë besueshmërinë e dëshmive kundërthënëse, arsyet për mos aprovimin e kërkesave individuale të palëve dhe arsyet me të cilat është udhëhequr gjykata në përcaktimin e pikave të ligjit e veçanërisht, në përcaktimin se a ekziston detyrimi ligjor.

Gjykata nuk do të krijojë besimin thjeshtë duke përshkruar arsyetimin e saj për pranimin e dëshmive ose argumenteve pa sqaruar se pse dëshmitë ose argumentet kundërthënëse nuk kanë qenë bindëse. Arsyetimi i vendimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë paanshmërinë e gjykatës kur ajo sjell përfundimet e veta. Një prej standardeve të procesit racional ligjor përfshinë respektimin e parimit të barazisë që aplikohet për ty palët në një kontest. Rrjedhimisht, ky standard është i lidhur ngushtë me paanshmërinë dhe objektivitetin e gjykatës, dhe duhet të pasqyrohet jo vetëm në procedurat gjyqësore por edhe në arsyetimin e vendimit përfundimtar të gjykatës.

Aktgjykimi i shkruar duhet të citoj dhe interpretojë normat ligjore të aplikuara në zgjidhjen e kundërthënieve që janë ngritur në një rast të caktuar. Kur e bënë këtë, gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, e pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Në këtë aspekt, aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesës e të drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtat subjektive të parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi i aktgjykimit lidhur me aplikimin e ndonjë norme të veçantë duhet të shërbej si argument i fuqishëm dhe bindës se vendimi i gjykatës është i drejtë sepse do të jetë e qartë se ai është i bazuar në ligj.

Vendimi i gjykatës në çdo rast duhet të jetë logjik, me formë të duhur dhe me përmbajtje të qartë. Argumentet dhe pjesët e arsyetimit duhet të jenë të bazuara dhe të kenë lidhje logjike dhe në të njëjtën kohë të respektojnë rregullat dhe ligjet. Ato duhet të krijojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, e cila përjashton çdo mospërputhje ose kundërthënie të drejtpërdrejtë apo të

nënkuptuar. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme në mënyrë që të mbështesin dispozitivin e aktgjykimit të shkruar.

Në këtë mënyrë mund të zbatohet metodologjia IRAC në arsyetimin e aktgjykimit pa cenuar kërkesat e LPK-së, për arsyetimin e aktgjykimit. Sipas metodologjisë IRAC gjykata në arsyetimin e aktgjykimit do të arrijë që kërkesat e LPK-së, për arsyetimin e aktgjykimit ti paraqes në një rrjedhë logjike duke siguruar një përmbajtje koherente, logjike dhe juridike të arsyetimit. Sigurisht brenda kësaj përmbajtje koherente do të pasqyrohen më së miri kërkesat e LPK-së, për përmbajtjen e arsyetimit e gjithashtu do të jetësohet metodologjia IRAC. Edhe kërkesat e LPK-së, për arsyetimin e aktgjykimit edhe metodologjia IRAC ndikuan qëllimin e njëjtë përveç në këtë rast metodologjia IRAC e ndihmon gjyqtarin/gjykatën të përmbush me lehtësi dhe siguri detyrën për një vendim të ligjshëm të drejtë dhe të besueshëm.

PJESA E TRETË

I. E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT GJYQËSOR, PARAKUSHT PËR NJË VENDIM TË DREJTË DHE TË LIGJSHËM

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut “Gjithkush ka të drejtën që çështja e tij të shqyrtohet me drejtësi, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht”

1. Gjykata e pavarur dhe e paanshme

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në dispozitë e nenit 102 (2) përcakton së: *“Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, apolitik e i paanshme dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”.*

1.1 Gjykata e pavarur

Koncepti “gjykatë” karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, pra nga zgjidhja e çështjeve që janë në kompetencë të saj, në pajtim me parimin e rendit të së drejtës dhe në një proces, të zhvilluar në pajtim me një procedurë ligjërisht të përcaktuar.

Pavarësi është një koncept me rëndësi të madhe që do ta udhëheq gjyqësorin në përgjithësi dhe gjyqtarët individualisht në veçanti. Pavarësia e gjyqtarit nuk duhet kuptuar asesi si një privilegj i funksionit gjyqësor, por si një detyrim që gjyqtari ka në raport me shoqërinë. Respektimi i këtij detyrimi nga ana e gjyqtarit, e bën të mundur që ai të vendos për çështjen në gjykim në mënyrë të ndershme e të paanshme, bazuar ekskluzivisht në ligj.

Kur merret vendimi nëse një gjykatë është e pavarur, Gjykata Evropiane merr në konsideratë:

- Mënyrën e emërimit të anëtarëve të saj;
- Kohëzgjatjen e detyrës së tyre;
- Ekzistencën e garancive kundrejt presioneve të jashtme dhe
- Çështjen nëse organi përfaqëson një dukje të pavarësisë objektive

Pavarësi tekstualisht do të thotë mungesë e varësisë, që do të thotë autonomi e plotë dhe paprekshmëri ndaj urdhrave të jashtme, ndikimit ose kontrollit. Kur jemi tek ky koncept i pavarësisë do të themi se ekzistojnë dy koncepte themelore të pavarësisë dhe atë:

- pavarësia institucionale dhe
- pavarësia funksionale.

Pavarësia në kuptimin institucional, kërkon që gjyqësia e përbërë nga zyrtarë të vetëm, në ushtrimin e detyrës së tyre dhe përgjegjësisë disiplinore të gëzon një autonomi efektive institucionale. Në këtë drejtim shumë me rëndësi është procedura e emërimit dhe e zgjedhjes së

gjqqtarëve, në përputhje me garantitë dhe standardet e gjyqësisë së pavarur. Në të vërtetë pavarësia e gjyqësisë në kuptimin institucional të saj do të thotë që funksionet ekskluzive të gjyqësisë ushtrohen nga bartësit e funksioneve të cilët gëzojnë garanci të gjerë dhe të definuar mirë përkitazi me emërtimin dhe largimin nga funksioni, përgjegjësi disiplinore dhe rregulla për caktimin e lëndëve.

Sa i përket procedurës së selektimit gjyqësor, sisteme të ndryshme ligjore ofrojnë modele të ndryshme si zgjedhja e drejtpërdrejtë, e deri tek emërimi nga parlamenti apo qeveria.

Pa marrë parasysh se cila procedurë përdoret është me rëndësi që zyrtarët gjyqësor të jenë të pavarur nga organi apo personi që i zgjedhë apo i emëron ata. Duhet theksuar se Gjykata Evropiane ka mbajtur qëndrim se, nominimi për funksionet gjyqësore i bërë nga vet qeveria vetvetiu nuk ndikon mbi pavarësinë e gjykatave, me arsytim se ajo që është vendimtare është që të mos ketë çfarëdo kontrolli apo mbikëqyrje nga ekzekutivi pas nominimit.

Kur flasim për rregullat e caktimit të lëndëve për një gjykatës apo për kolegjin, sisteme të ndryshme gjyqësore përdorin mekanizma të ndryshëm për të realizuar një gjë të tillë. Karakteristika e përbashkët e të gjitha sistemeve që garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e sistemit gjyqësor është se rastet-(lëndët), caktohen rastësisht dhe se asnjë palë, organ apo trup ekzekutiv nuk mund të ndërhyjë duke bërë ndarjen apo caktimin e një lënde të caktuar tek një gjyqtar i caktuar.

Garant tjetër i pavarësisë institucionale të sistemit gjyqësor është metoda e mbajtjes së gjyqtarëve, përgjegjës për veprimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre gjyqësore. Rrjedhimisht një rëndësi të caktuar ka edhe çështja e mandateve të gjyqtarëve dhe kohëzgjatja e mandateve.

Pavarësia funksionale si parim është i bazuar në idenë se organet e ndryshme shtetërore posedojnë kompetenca specifike dhe ekskluzive, prandaj si të tilla as nuk mund të ushtrojnë e as të ndërhyjnë në funksionet gjyqësore. Testi i parë për konstatimin e masës së autonomisë gjyqësore në një sistem ligjor të caktuar është që ta plotësojë kushtin për pavarësinë e legjislativës në fjalë. Në këtë drejtim shumica e kushtetutave nacionale ofrojnë garanca për pavarësinë gjyqësore duke kërkuar që gjykatat të jenë themeluar në bazë të ligjit dhe se gjykatësit duhet të jenë të udhëhequr vetëm nga ligji dhe të mbajnë përgjegjësi vetëm para ligjit. Testi më real i pavarësisë do të ishte raporti praktik ndërmjet organeve ekzekutive apo legjislative dhe gjykatave. Liria nga ndërhyrja në procedurat gjyqësore paraqet një garanci themelore në kuadër të konceptit të pavarësisë gjyqësore funksionale që në radhë të parë kërkon që autoritetet ekzekutive apo legjislative nuk mund të japin instruksione të natyrës detyruese gjykatave gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Ndikimet e brendshme dhe të jashtme-veprimet e një gjykatësi rrjedhimisht do të ndikojnë në të drejta dhe interesat e qytetarëve, të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë çfarëdo ndërhyrje nga jashtë. Prandaj sjellja e gjyqtarëve duhet të korrespondojë me parimet dhe normat e moralit që të sigurojë një perceptim pozitiv për sistemin gjyqësor e rrjedhimisht të ndikojë në rritjen e besimit të opinionit publik në raport me sistemin gjyqësor. Në këtë kuptim një gjykatës nuk ka të drejtë dhe nuk guxon të pranojë ndikimet e brendshme apo të jashtme ose të udhëzohet nga instruksione të palëve të jashtme pa marrë parasysh pozicionin e tyre.

Në mesin e shumë pengesave për ta quajtur një gjyqësor të pavarur janë:

- influenca e ushtruar nga ekzekutivi,
- presioni i ushtruar nga legjislativi,
- lidhjet e mëparshme politike,
- ndërhyrjet nga koleget më të lartë në detyrë/ ndikimi i brendshëm,
- ndikimi i personave të tretë apo i sektorit të biznesit/ ndikimi i jashtëm,
- ndikimi i familjes apo i marrëdhënieve shoqërore, etj.

1.2 Gjykata e paanshme

Paanësia konsiderohet një parim i rëndësishëm, që garanton rendin e së drejtës dhe mundëson krijimin e besimit, që gjykata duhet të gëzojë në një shoqëri demokratike. Kjo nënkupton mungesën e paragjyqimeve apo të paanshmërisë. Kjo duhet të vlerësohet sipas kriterëve subjektive dhe objektive, të rëndësishme mund të jenë edhe karakteristikat e jashtme. Paanshmëria është cilësi themelore që duhet ta karakterizojë punën e një gjyqtari. Supozohet se gjyqtari është personalisht i paanshëm me përjashtim të rasteve kur dalin prova të kundërta. Paanësia është gurthemeli i vendim-marrjes gjyqësore. Paanësia do të thotë liri nga ndikimet që tentohen të bëhen në personalitetin e një gjyqtari. Pavarësia gjyqësore është e lidhur ngushtë me paanësinë por konceptet dallojnë. Pavarësia i kontribuon paanësisë. Me të drejtë thuhet se gjyqtarët mundën me qenë të paanshëm edhe pa pavarësi strukturale. Paanësia ka të bëjë me mendjen e drejtë, vendim-marrje neutrale. Paanësia në mënyrë parësore krijohet nga struktura e procesit të zgjedhjes së mosmarrëveshjeve dhe nga vetë karakteri i gjyqtarit. Koncepti i paanësisë mund të rrezikohet nga veprimi i shumë faktorëve të brendshëm ose të jashtëm, siç janë:

- ndjenja të forta personale mbi çështjen apo palët,
- interesa financiare të familjes,
- njohje personale,
- urdhrat dhe komunikimet ex parte,
- deklaratat publike,
- ofertat për punësim dhe privilegjet tjera pas largimit nga detyra,
- aplikacione për përjashtimin e gjyqtarit etj.

Me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, i Ligjit për Gjykatat parashihet se: “Gjykatat trajtojnë të gjithë personat në mënyrë të barabartë, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”. Megjithatë, pavarësisht këtij detyrimi të gjykatës, ekzistojnë situata praktike kur mund të vije në pikëpyetje pavarësia, paanësia, objektiviteti dhe besimi i publikut në gjykatë, për shkak të rrethanave që mund ta ndikojnë gjyqtarin apo që mund të krijojnë përshtypjen se gjyqtari është i ndikuar apo i njëanshëm.

Me qëllim që të sigurohet sidomos paanësia e gjykatës LPK ka rregulluar çështjen e përjashtimit të gjyqtarit apo të rekuizimit të gjyqtarit nga gjykimi.

Gjykata e Strasburgut, u shpreh në Piersack kundër Belgjikës (1 Tetor 1984) se: Ndërsa normalisht paanshmëria nënkupton mungesën e paragjykimave ose anshmërisë, ekzistenca e saj ose mos ekzistenca në mënyrë të dukshme në bazë të nenit 6 (1) të Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut do të testohet në mënyra të ndryshme. Mund të bëhet një dallim në këtë kontekst midis një mënyre subjektive që përbën përpjekjen për të siguruar dënimin personal të një gjyqtari të caktuar në një çështje të caktuar, dhe një mënyrë objektive që nënkupton përcaktimin nëse ai ofron garanci të mjaftueshme për përjashtuar ndonjë dyshim legjitim në këtë kuadër.

Për sa i përket paanshmërisë subjektive gjykata kërkon prova të anshmërisë aktuale. Paanshmëria personale e një gjyqtari të duhur të emëruar prozhmohet derisa të ketë prova për të kundërtën.

Për sa i përket testit të objektivitetit Gjykata deklaroi në Fye kundër Austrisë (24.Shkurt 1993, par.30) së: Në bazë të testit të objektivitetit duhet të përcaktohet nëse, përveç faktit të sjelljes personale të gjyqtarit, ekzistojnë fakte të vërtetueshme që mund të ngrenë dyshime për sa i përket paanshmërisë së tij. Në këtë kuadër edhe dukja e pavarësisë objektive mund të ketë rëndësinë e vet. Ajo që është në rrezik ka të bëjë me besueshmërinë që duhet të nxisin gjykatat në një shoqëri demokratike në publik dhe mbi të gjitha për sa i përket ndjekjeve penale në të akuzuarin. Kjo nënkupton që në marrjen e vendimit nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye legjitime për të pasur frikë se një gjyqtari të caktuar i mungon paanshmëria, këndvështrimi i të akuzuarit është i rëndësishme por jo vendimtar. Ai që është vendimtar është fakti nëse kjo frikë mund të justifikohet në mënyrë objektive.

Gjykata e ka bërë të qartë që cilido gjyqtar në lidhje me të cilin ekziston një arsye legjitime oër të pasur frikë se i mungon paanshmëria duhet të tërhiqet.

1.2.1 Përjashtimi dhe rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi

Përveç dispozitave të LPK-së, për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi, një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për sigurimin e paanshësisë së gjykatës e ka edhe Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe Rregullorja për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme.

Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtar, me dispozitën e nenit 2, përcakton se: “*Gjyqtari gjatë ushtrimit të funksionit të tij i trajton të gjitha palët në procedurë në mënyrë të barabartë pa favorizime, anime dhe paragjykimë. Gjatë gjithë kohës gjyqtari duhet të jetë dhe duhet të duket i paanshëm. Paanshmëria ka të bëjë jo vetëm me vendimin, por edhe në procedurën e marrjes së vendimit*”. Ndërsa me dispozitën e nenit 2.5 përcaktohet se: “*Gjyqtari do të kërkojë përjashtimin e tij nëse te publiku mund të krijojë përshtypjen, ose kur e vlerëson vetë, se nuk është në gjendje të vendosë në lidhje me lëndën në mënyrë të paanshme*”. Përveç që përcaktohet detyrimi i gjyqtarit për të kërkuar përjashtimin e tij, në rast se gjyqtari nuk e kërkon përjashtimin parashihen edhe sanksione disiplinore ndaj tij/saj.

Me dispozitat e nenit 5 të Rregullores për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme përcaktohen shkeljet e rënda, ndërsa në mënyrë specifike me dispozitën e nenit 5.1.9 përcaktohet si shkelje e rëndë e gjyqtarit : “*Nëse nuk kërkon që të përjashtohet nga lëndët në të cilat ekzistojnë arsytet që vënë në dyshim mundësinë e vendimeve të njëanshme gjyqësore që nënkuptojnë lidhjet familjare, miqësore, afariste, sociale dhe lidhjet tjera me palët dhe përfaqësuesit e tyre*”.

Qëllimi i përcaktimit si shkelje e rëndë nga ana e gjyqtarit në rast se nuk kërkon përjashtimin e tij, nën konditat e përcaktuara me dispozitën e sipërcituar, është që gjyqtarët të kenë kujdesin e duhur në ruajtjen e paanësisë. Paanësia e gjykatës është mekanizimi kryesor i nxitjes së besimit të publikut në sistemin gjyqësor.

1.2.2 Rrethanat të cilat qojnë deri te përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi

LPK-ja, i ka numëruar në mënyrë taksative rrethanat që përbëjnë shkak që gjyqtari të përjashtohet domosdoshmërisht. Rrethanat të cilat qojnë deri te përjashtimi i gjyqtarit nga gjykimi janë përcaktuar me nenin 67 të LPK-së.

Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

- a) *nëse është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo nëse me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo nëse në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;*
- b) *nëse pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo nëse është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;*
- c) *nëse është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;*

- d) *nëse në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose të organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimi;*
- e) *në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;*
- f) *nëse është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;*
- g) *Nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.*

Këto janë rrethana të cilat sipas dispozitës ligjore të lartshënuar janë numëruar shprehimisht dhe taksativisht e që duhen të merren për bazë me rastin e përjashtimit të një gjyqtari nga një rast konkret. Për këto rrethana pika a)-f), është detyrë e gjyqtarit të çështjes që t'i paraqesë me kërkesë për përjashtimin e tij nga gjykimi para kryetarit të gjykatës.

Rrethanat nga neni 67 pika g), i referohen rrethanave që nuk janë të numëruara por që në procedurë mund të paraqiten në forma të ndryshme, andaj ndryshe njihen si rrethana që qojnë deri te rekuizimi i gjyqtarit.

Përveç këtyre rasteve të numëruara në mënyrë taksative kur gjyqtari duhet përjashtuar nga gjykimi, me dispozitat e LPK-së, ekziston edhe një situatë kur parashihet përjashtimi gjyqtarit në mënyrë taksative, e që i referohet rastit kur lejohet përsëritja e procedurës. Sipas dispozitës së nenit 241 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: “*Në procedurën e përsëritur në gjykatën e shkallë së parë nuk mund të veprojnë gjyqtari që ka dhënë vendimin në procedurën e mëparshme*”.

Rast praktik i një shtate të tillë: Në qoftë se në gjykatën e shkallës së parë gjyqtari “X”, e ka shqyrtuar dhe e ka vendosur në mënyrë meritore një çështje juridike kontestuese me palën paditëse subjektin “AA” dhe të paditur subjektin “BB”, nën supozimin se vendimi ka marrë formën e prerë dhe ndaj të njëjtit gjykata e shkallës së dytë e ka lejuar përsëritjen e procedurës sipas kërkesës së njëres prej palëve ndërgjyqësore, atëherë në rishqyrtim në shkallë të parë këtë çështje nuk mund ta vendosë gjyqtari “X (që ka vendosë më herët).

1.2.3 Rrethanat të cilat qojnë deri te rekuizimi i gjyqtarit nga gjykimi

Paragrafi g) i nenit 67 të LPK, nuk ka rregulluar as shprehimisht as taksativisht rastet e rekuizimit të gjyqtarit, por vetëm ka përmendur faktin nëse ekzistojnë rrethana të tjera që e vënë në dyshim paanësinë e gjyqtarit në vendosjen e çështjes të shtruar para tij.

Mund të ekzistojnë rrethana të tjera të cilat nuk klasifikohen si shkaqe që në mënyrë automatike gjyqtari të përjashtohet nga gjykimi (rrethanat e parapara nga paragrafi a) deri te paragrafi f), të

nenit 67 të LPK), por janë rrethana të tilla që mund të sjellin në dyshim paanësinë dhe jo objektivitetin e tij në proces gjyqësor. Në këto raste, nëse gjyqtari i çështjes vlerëson se janë paraqitur rrethana për të cilat duhet të përjashtohet gjyqtari, gjithmonë duke e pasur në vëmendje edhe standardin e kodit të etikës, përmes kërkesës së arsyetuar duhet të kërkojë nga Kryetari i Gjykatës përjashtimin e vet nga gjykimi.

Nga praktika gjyqësore: Për rrethanat që njihen si rrethana për rekuizim të gjyqtarit, në praktikën gjyqësore ka një standard sipas të cilit në mënyrë parimore dihet se kur do të përjashtohet një gjyqtar nga gjykimi dhe kur nuk do të përjashtohet. Në këtë kuptim gjyqtarët asnjëherë nuk guxojnë ta përdorin mundësinë e përjashtimit të gjyqtarit nga gjykimi me qëllim që tu shmangën dosjeve komplekse, por mundësia e përjashtimit të gjyqtarit gjithmonë duhet të vijë në shprehje në rastet kur ekzistojnë arsye të vërteta që e sjellin në dyshim paanësinë dhe objektivitetin e gjykatës.

Si rrethana të cilat mund të vlerësohen si të mjaftueshme për rekuizimin e gjyqtarit nga një proces, mund të jenë:

- Fakti se kryetari i asaj gjykate ka një çështje në gjykatë;
- Fakti se një gjyqtar i asaj gjykate ka rastin e tij në gjykatë,
- Fakti që gjyqtari qëndron në miqësi apo armiqësi me palën;
- Fakti që gjyqtari ka shprehur mendimin e tij se si do të përfundojë procesi para gjykatës (këtu duhet të përfshihet edhe mendimi i dhënë në ambientet private);
- Fakti që gjyqtari më herët ka marrë pjesë në negociim në mes të palëve, lidhur me të njëjtën çështje që është objekt shqyrtimi në procesin konkret;
- Shoqëria shumë e ngushtë në mes të gjyqtarit dhe personit, i cili ka vendosur lidhur me të njëjtën çështje juridike.

Këto janë disa nga rrethanat të cilat me ligj nuk janë paraparë shprehimisht dhe taksativisht por si të tilla u japin mundësi palëve në procedurë që të kërkojnë rekuizimin e gjyqtarit nga procesi gjyqësor.

1.2.4 E drejta e aksesit në gjykatë

Nuk ka një garantim të shprehur mbi të drejtën e aksesit në gjykatë në tekstin e Nenit (6) të Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, por Gjykata Evropiane është shprehur se kjo dispozitë siguron për këdo të drejtën për të bërë çdo lloj pretendimi në lidhje me të drejtat e tij/saj civile dhe detyrimet përpara një gjykate apo tribunali.

Neni 6 përfshin të drejtën për të paraqitur në gjykatë, në të cilën e drejta për akses, që do të thotë e drejta për të filluar seancat gjyqësore përpara gjykatës në çështje civile përbën vetëm një aspekt.

Pra, Neni 6, paragrafi 1, i Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, i garanton secilit të drejtën për t'i parashtruar gjykatës për gjykim çfarëdo pretendimi, që u referohet "të drejtave dhe detyrimeve me karakter civil".

Gjykata u shpreh në *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*. 21.Shkurt 1995, par 35), se: nëse Neni 6 (1) do të kuptohej se kishte lidhje ekskluzivisht me drejtimin e një veprimi të caktuar që ka filluar përpara një gjykate, një shtet kontraktues, pa vepruar në kundërshtim me atë dokument, duhet të eliminojnë gjykatat ose t'ia heqin juridiksionin atyre duke u kufizuar në marrjen e vendimeve për disa veprime civile dhe t'ia besojnë të tjerat organeve që varën nga qeveria. Do të ishte e paimagjinueshme sipas mendimit të gjykatës që neni 6 (1) të përshkruaj në detaje garancitë procedurale që i jepen palëve në një ndjekje gjyqësore dhe nuk duhet të mbrojtë së pari atë që është e mundur të përfitohet nga garancitë e dhëna, d.m.tj., aksesit në gjykatë. Karakteristikat e një procesi gjyqësor të drejtë, të hapur dhe të shpejt nuk do të kenë vlerë fare nëse nuk do të ketë procedim gjyqësor.

Megjithatë, **e drejta për akses ne gjykate nuk është një e drejte absolute**. Gjykata vijoi duke deklaruar ne *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar* se vete natyra e saj kërkon rregullore përkatëse (që mund të ndryshojë në kohë dhe vëndndodhje sipas nevojave dhe burimeve të komunitetit dhe të individëve) të hartuara nga Shteti, megjithëse rregullore të tilla nuk duhet të cenojnë aspak thelbin e se drejtës as të hyjë në konflikt me të drejtat e tjera të mishëruara në Konvente. Në precedentin e saj Gjykata është shprehur me tej se çdo lloj kufizimi do të jete në pajtim me Nenin 6:

- nëse ndjek një synim legjitim dhe
- nëse ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të përmbushet.

Në *Airey kundër Irlandës* një bashkëshorteje iu refuzua **ndihma ligjore** për të ndjekur procedime gjyqësore për tu ndare nga bashkëshorti. Gjykata u shpreh se *Neni 6 (1) ndonjëherë mund të detyrojë Shtetin që të parashikojë asistencë për një avokat kur një asistencë e tillë del se është e domosdoshme për akses efektiv në gjykate ose sepse përfaqësimi ligjor behet i detyrueshëm duke qene se zbatohet kështu nga legjislacionet kombëtare të disa Shteteve Kontraktuese për lloje të ndryshme ndergjyqësore, ose për shkak të arsyes së kompleksitetit të procedurës apo të çështjes*. Gjykata konstatoi se kërkuesi në këtë çështje nuk gëzonte një të drejtë efektive për akses në Gjykatën e Lartë për qëllime të nxjerrjes së një peticioni për një dekret për ndarje gjyqësore. E drejta për akses në gjykate ndonjëherë mund të shkelet kur ekziston një **imunitet** që efektivisht ndalon një veprim që të ndodhe.

Siç kemi theksuar edhe më lartë edhe Kushtetuta me dispozitën e nenit 54 përcakton së: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar më këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

Kushtetuta në mënyrë primare e garanton mbrojtjen në gjykatë, si formën më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën e brendshme. Të drejtën e mbrojtjes në gjykatë e ka çdo kush, të cilit i është shkelur ose mohuar e drejta e garantuar me kushtetutë. Kushtetuta përmban dispozitën e cila ia garanton çdo individit edhe të drejtën për masa efektive juridike, nëse konstatohet se e drejta i është shkelur. Nga kjo del se secilit i është garantuar e drejta për gjykim të pavarur, të paanshëm dhe të bazuar në ligj, që do të thotë se në këtë mënyrë është garantuar e drejta për gjykim të drejtë dhe e drejta për mbrojtje të barabartë në gjykatë.

Në lidhje me të drejtën e aksesit të secilit në gjykatë edhe Ligji i Procedurës Kontestimore, me dispozitën e nenit 2 paragrafi 3, përcakton se: *“Gjykata nuk mund të refuzoj shqyrtimin dhe vendosjen mbi kërkesat që janë në kompetencën e saj”*. Kjo dispozitë paraqet një ndër dispozitat më të rëndësishme të një procesi gjyqësor sepse i mohon gjykatës mundësinë që të heqë dorë nga detyrimi i ofrimit të mbrojtjes gjyqësore për subjektin e kërkesës dhe rrjedhimisht i pamundëson qasjen selektive. Pra në çdo rast kur gjykata para së cilës është kërkuar mbrojtja gjyqësore vlerëson se ka kompetencë për çështjen e njëjtë është e detyruar të fillojë shqyrtimin. Ky detyrim i gjykatës për të vendosur në çështje për të cilat ka kompetencë është i ndërlidhur me të drejtat elementare të njeriut dhe është një e drejtë e mbrojtur në të gjitha sistemet juridike.

Detyrimi i gjykatës për të shqyrtuar dhe vendosur në çdo çështje për të cilën ka kompetencë është në frymën e nenit 6 të Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, me të cilën përcaktohet se: *“Gjithkush ka të drejtën që çështja e tij të shqyrtohet me drejtësi, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar ligjërisht, e cila vendosë qoftë për kundërshtimet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil,.....”*.

Në lidhje me të drejtën e aksesit të secilit në gjykatë lidhur me kërkesat e natyrës civilo-juridike në vijim në pika të shkurtra janë paraqitur disa veprime-detyrime të gjykatës të cilat rrjedhin nga dispozitat e LPK-së, e të cilat janë në frymën e nenit 6 të Konventës Evropiane.

Praktika gjyqësore e Strasburgut vazhdimisht deklaroi se neni 6.1 shtrihet vetëm deri të grindjet mbi të drejtat dhe obligimet civile “të pranuar/njohura sipas ligjit vendor”, mirëpo kjo përfshin edhe grindjet “në të cilat është në pyetje ekzistenca e “së drejtës civile”. Veç kësaj neni 6.1 “nuk garanton asnjë përmbajtje të veçantë për ‘të drejta dhe obligimet’ në ligjin përmbajtjesor kombëtar – dhe është e qartë se organet e Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, nuk mund të krijojnë sipas mënyrës së interpretimit të nenit 6.1 një të drejtë përmbajtësore, e cila nuk ka fare baza juridike në shtetin përkatës.

E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk ka karakter absolut, ajo mund të ketë kufizime, por ato nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit për individin në një mënyrë të tillë sa e drejta të preket në thelbin e saj.

2. Procesi brenda një afati të arsyeshëm

Neni 6 paragrafi 1, i Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, i ngarkon shtetet me detyrimin e organizimit të sistemeve juridike, në mënyrë që t'u mundësojnë gjykatave të realizojnë të gjitha kushtet që burojnë prej tij, duke përfshirë shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Sistemi i drejtësisë nuk mund të zhvillohet me vonesa që çojnë në dobësimin e rolit të gjykatave dhe të besimit në to. Në çështje civile periudha, që merret në konsideratë, fillon zakonisht me ngritjen e padisë. Ushtrimi i së drejtës për shqyrtimin e çështjes në një afat të arsyeshëm varet në mënyrë të dukshëm nga përpjekjet e palëve si dhe nga veprimet e ndërmarra prej tyre për përshpejtimin e procesit. Pala duhet jo vetëm të rezervohen nga paraqitja e kërkesave apo resurseve, që çojnë në zgjatjen e afateve, por gjithashtu, të ndërmarrë hapa, që çojnë në zhvillimin e saj më të zhdërvjellët.

LPK-me përcaktimin e disa afateve brenda të cilave duhet të veprojë gjykata ka bërë përpjekje që të respektohet fryma e konventës për procesin gjyqësor të zhvilluar në një afat të arsyeshëm.

Për secilën fazë të shqyrtimit respektivisht të ndërmarrjes së veprimeve nga ana e gjykatës e të cilat veprime në mënyrë specifike janë përcaktuar në dispozitën e nenit 286 të LPK-së, dhe atë në paragrafin 1, me përmbajtje: “*Gjykata menjëherë pasi ti arrijë padia i fillon përgatitjet për shqyrtim kryesor të çështjes*”, dhe në paragrafin 2 me përmbajtje: “*Përgatitjet e tilla përfshijnë ekzaminimin paraprak të padisë, dërgimin e padisë palës së paditur për përgjigje të domosdoshme, mbajtjen e seancës përgatitore dhe caktimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes*”, parashihen afate ligjore brenda të cilave gjykata duhet të veprojë në mënyrë që të sigurohet procesi brenda një afati të arsyeshëm.

Me dispozitën e nenit 394 të LPK-së, është përcaktuar se” *Gjykata, padinë, me shkresat e bashkangjitura, ia dërgon të paditurit për përgjigje brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është paraqitur në gjykatë padia e rregullt dhe e plotë*”.

Nga dispozita e cituar rrjedh se ligdhënësi ka bërë përpjekje që të detyrojë gjykatën në respektimin e një afati të arsyeshëm për ndërmarrjen e veprimit të parë pas shqyrtimit paraprak për përgatitjen e shqyrtimit kryesor. Ky është një afat ligjor i cili duhet të respektohet sepse në të kundërtën do të cenohet fryma e procesit gjyqësor në një afat të arsyeshëm.

Edhe pse me dispozitën konkrete nuk është përcaktuar se në çfarë afati duhet të bëhet shqyrtimi paraprak i padisë, në mënyrë indirekte rrjedh se shqyrtimi paraprak i padisë duhet të kryhet brenda një afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, sepse dispozita e nenit 394 e LPK-së, përcakton

detyrimin e gjykatës që palës së paditur të ia dërgojë padinë për përgjigje brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është pranuar padia. Pra faza e shqyrtimit paraprak duhet të kryhet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh. Sigurisht kjo nuk vlen nëse gjykata gjatë fazës së shqyrtimit paraprak konstaton se ekzistojnë të meta nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor e të cilat duhet evituar në atë fazë të procedurës.

Me dispozitën e nenit 395 paragrafi 1, të LPK-së, është përcaktuar se: *“I padituri, pasi t’i dorëzohet padia, me shkresat e bashkangjitura eventualisht, ka për detyrë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të përgjigjet me shkrim në padi”*. Ligdhënësi përveç se ka përcaktuar një afat ligjor për të ndërmarrë veprimet e para nga gjykata lidhur me përgatitjen e shqyrtimit kryesor, ka përcaktuar një afat ligjor edhe për të paditurin brenda të cilit i njëjti ka mundësi të paraqesë mbrojtjen/kundërshtimet eventuale të tij në gjykatë përmes përgjigjes në padi.

Në lidhje me efikasitetin respektivisht procesin gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm ligdhënësi është treguar shumë i kujdesshëm sepse nuk e ka lënë në diskrecionin e gjykatës ndërmarrjen e veprimeve por ka përcaktuar afate ligjore edhe për caktimin e seancës së shqyrtimit gjyqësor. Kështu me dispozitën e nenit 400 paragrafi 4, i LPK-së, është përcaktuar se: *“Seanca përgatitore mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën gjykatës i ka arritur përgjigja në padi e të paditurit”*, ndërsa me dispozitën e nenit 420 paragrafi 2, përcaktohet se: *“Seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore”*. Nga dispozitat e cituara na rezulton se ligdhënësi nuk i ka dhënë fare hapësirë gjykatës që të ushtrojë ndonjë lloj diskrecioni për të ndryshuar apo zgatur afate sepse për secilin veprim ka përcaktuar me dispozitë ligjore afatin brenda të cili duhet të veprojë gjykata.

Logjikën e përcaktimit të aftësive që garantojnë procesin gjyqësor *“në afat të arsyeshëm”* ligdhënësin nuk e ka ndjekur vetëm për veprimet e para të gjykatës në një çështje kontestuese, por në formë e njëjtë ka përcaktuar afatet edhe për veprimet tjera të gjykatës apo palëve deri në përfundimin e shqyrtimit respektivisht deri në dhënien e vendimit meritot.

Kështu me dispozitën e nenit 401, të LPK-së, është përcaktuar se: *“Seanca përgatitore është e detyrueshme, përveçse në rastet në të cilat gjykata, pasi t’i ketë arritur përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese (neni 403 i këtij ligji) apo kur, nga shkak i pandërlikueshmërisë së kontestit, vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgatitore”*. Në këtë rast nëse gjykata konstaton së nuk është e nevojshëm mbajtja e seancës përgatitore atëherë seanca e shqyrtimit kryesor do të mbahet brenda afatit ligjor për seancën përgatitore. Pra në çdo rast kur seanca përgatitore nuk është e nevojshme, seanca e parë e shqyrtimit kryesor do të mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita kur gjykatës i ka arritur përgjigja në padi e të paditurit, apo pasi të ketë kaluar afati për përgjigje, nën supozimin se nuk plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë.

Me dispozitën e nenit 420 paragrafi 3, i LPK-së, përcaktohet se: *“Gjykata mund të vendosë që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas asaj përgatitore”*, ndërsa në

paragrafin 4 të nenit të njëjtë përcaktohet se:” *Po që se gjykata çmon se shqyrtimi kryesor do të zgjatë më tepër se një ditë, seanca do të konvokohet për aq ditë me radhë sa është e domosdoshme që shqyrtimi të bëhet në vazhdimësi*”.

Në funksion të zhvillimit të procedurës me efikasitet ligjdhënësi i ka dhënë diskrecion gjykatës që nëse gjykata vlerëson se ka kushte, të kalojë nga seanca përgatitore në seancën e shqyrtimit kryesor dhe eventualisht edhe ta përfundojë shqyrtimin e çështjes, apo nëse gjykata ka pasur mundësinë që të përgatit si duhet shqyrtimin kryesor nën supozimin se nuk do të ketë mundësi që shqyrtimi të përfundohet për një ditë, atëherë i është dhënë mundësia ligjore që shqyrtimi kryesor të caktohet në disa ditë radhazi.

Si do që të jetë edhe nëse gjykata nuk do të veproj apo nuk do të mund të veprojë sipas mundësisë ligjore nga neni 420 paragrafi 3 dhe 4, të LPK-së, atëherë ligjdhënësi ka përcaktuar kufizimin tjetër për gjykatën sa i përket afatit, kështu me dispozitën e nenit 441 paragrafi 2, është përcaktuar se:” *Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, përveç rasteve të përcaktuara me ligj*”. Pra në çdo rast kur shqyrtimi kryesor nuk mund të përfundojë në një termin të seancës kryesore dhe nën supozimin se gjykata nuk ka mundur të planifikojë një shqyrtim në disa termine/ditë radhazi, atëherë gjykatës i është kufizuar mundësia që shqyrtimi i radhës të caktohet më larg se tridhjetë (30) ditë. Kjo vlen edhe në rastet kur është caktuar shqyrtimi kryesor dhe nuk plotësohen kushtet për mbajtjen e shqyrtimit kryesor që nënkuptohet caktimi i një termini tjetër për shqyrtimin kryesor.

Efikasiteti i procedurës kontestimore nuk rrjedhë vetëm nga afatet e përcaktuara për ndërmarrjen e veprimeve nga ana e gjykatës apo palëve por edhe dispozita tjera të cilat u japin mundësinë palëve që vetëm në fazë të caktuar të ndërmerrë veprimet e caktuara. Kështu me dispozitën e nenit 405 të LPK-së, përcaktohet se: “*Gjatë procedimit të mëtejshëm në seancën përgatitore bisedohet për propozimet e palëve dhe për faktet mbi të cilat mbështesin propozimet e tyre*”, ndërsa me dispozitën e nenit 406 paragrafi 1, përcaktohet se: “*Varësisht nga rezultati i shqyrtimit në seancën përgatitore gjykata do të vendosë se çka do të jetë objekt shqyrtimi dhe cilat prova do të merren, në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes*”. Në kuptimin e dispozitave të cituara rrjedhë se palët ndërgjyqësore kanë mundësi që të paraqesin të gjitha faktet dhe provat për vërtetimin e fakteve deri në përfundimin e seancës përgatitore, sepse një mundësi e tillë pas përfundimit të seancës përgatitore është e kufizuar, respektivisht vlen vetëm si përjashtim. Pamundësia që palët ndërgjyqësore pas përfundimit të seancës përgatitore të paraqesin fakte dhe prova të reja përcaktohet me dispozitën e nenit 428 paragrafi 2, i LPK-së: “*Palët gjatë zhvillimit të shqyrtimit kryesor mund të paraqesin fakte të reja, dhe të propozojnë prova të reja, vetëm po që se e bëjnë të besueshme rrethanën se pa fajin e tyre nuk kanë mundur t’i paraqesin, respektivisht propozojnë në seancën përgatitore*”.

Ky kufizim ligjor kufizon mundësinë që palët të japin propozime të tilla që tejkalojnë shfrytëzimin e të drejtave të tyre në procedurë sipas parimit të shfrytëzimit të të drejtave me mirëbesim.

Logjika e zhvillimit të procedurës dhe e përfundimit të saj sipas disa afateve ligjore që garantojnë procesin gjyqësor në afat të arsyeshëm është ndjekur nga ligjdhënësi edhe sa i përket nxjerrjes së vendimit pas përfundimit të shqyrtimit kryesor. Kështu me dispozitën e nenit 436 paragrafi 1, i LPK-së, është përcaktuar se:

“Pasi të përfundojnë të gjitha fazat e shqyrtimit kryesor dhe pasi të jetë i gatshëm për zgjidhje kontesti, gjykata e shpallë të mbyllur shqyrtimin kryesor” ndërsa me dispozitën e nenit 153 paragrafi 1, përcaktohet se: *“Gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Koha në të cilën jepet aktgjykimi quhet dita në të cilën ai hartohet me shkrim”*.

Për shkak të natyrës së këtij punimi jemi kufizuar në trajtimin e mëtejshëm të procedurës sipas afateve ligjore lidhur me procedurën sipas mjeteve të goditjes, të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Megjithatë duhet theksuar se ligjdhënësi ka përcaktuar afate edhe në procedurën pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të cilat në esencë i kontribuojnë procesit në afat të arsyeshëm.

3. E drejta për një gjykim (vendim) të arsyetuar

Megjithëse nuk përmendet shprehimisht në katër traktatet kryesore për të drejta e njeriut, e drejta për gjykim të arsyetuar është pjesë përbërëse e dispozitave në lidhje me një “gjykim të drejtë”, përfshirë të drejtën për gjykim publik. Nenet 22 (2) dhe 23 (3) të Statuteve përkatëse të Tribunaleve për Ruandën dhe ish Jugosllavin që të dyja përcaktojnë së gjykimet e këtyre tribunaleve “duhet të jenë të shoqëruara më një mendim mbi arsyetimin në formën me shkrim, të cilit gjithashtu mund t’i bashkëngjiten mendime të ndara apo të papajtueshme.

Në bazë të praktikës gjyqësore të krijuar, të Gjykatës Evropiane për të Drejta e Njeriut e cila reflekton “ një parim të lidhur me administrimin e duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave dhe tribunaleve duhet të deklarohen në mënyrë adekuate arsyet në të cilat janë bazuara ato, “sidoqoftë” shkalla në të cilën kjo detyrë për të dhënë arsye, zbatohet dhe mund të ndryshoj në bazë të natyrës së vendimit duhet të përcaktohet në bazë të rrethanave të rastit.

Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, kërkon që gjykatat vendase të japin arsye mbi vendimet e tyre si në ndjekjet civile, ashtu edhe në ato penale. Gjykatat nuk janë të detyruara të japin përgjigje të detajuara për çdo pyetje, por nëse një kërkesë është thelbësore për rezultatet e çështjes, gjykata atëherë duhet që specififikisht t’a trajtojë atë në gjykimin e tij.

Gjykata kushtetuese e Kosovës, në Rastin nr. KI72/12, e ka bërë të qartë se:

“E drejta për një gjykim të drejte përfshin të drejtën për një aktgjykim të arsyetuar. GJEDNJ-ja konsideron se, derisa autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6(1) të Konventës, gjykatat e tyre duhet "t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat mbi të cilat e kishin bazuar vendimin e tyre". (Shih, *Hadjianastassiou vs. Greqise, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33*).

Ne një aktgjykim të kohës së fundit, GJEDNJ përsëriti se "aktgjykimet e gjykatave dhe të tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsye në të cilat ata Bazohen". (Shih, *Tatishvili vs. Rusise, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58*). Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës i obligojnë gjykatat të japin arsye për aktgjykimet e tyre. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton të kërkuarit e përgjigjes së detajuar në çdo argument apo pyetje (Shih, *Van de Hurk vs. Holandes, 19 prill 1994, paragrafi 61*). Masa deri në të cilën aplikohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit. Megjithatë, nëse parashtrësia është me rëndësi thelbësore për rezultatin e rastit, pasi që është prone në një rast të rrënim, atë here gjykata duhet të merret në mënyrë të veçantë me të në aktgjykimin e saj.

Veç; kësaj, e drejta e marrjes së vendimit gjyqësor në harmoni me ligj, përfshin obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye për aktvendimet e tyre me baza të arsyetuara në nivel procedural dhe material. Sigurimi i arsyeve kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe të ndërtuara mire për vendimin e marre në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë që të dyja: kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit”.

Detyrimi për arsyetimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile përveç se ekziston si detyrim që rrjedh nga Konventa Evropiane, përcaktohet specifikisht edhe me dispozita të LPK-së.

II. PARIMET THEMELORE TË PROCEDURËS KONTETSIMORE DHE RELACIONI I TYRE ME TË DREJTËN PËR NJË PROCES TË RREGULLT GJYQËSOR SIPAS NENIT 6 TË KONVENTËS

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitën e nenit 31 paragrafi 1, përcakton se: “Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike” ndërsa me dispozitën e nenit 54 parasheh Mbrojtjen Gjyqësore të të Drejtave, duke përcaktuar se: “ Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar më këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

Një garanci e rëndësishme kushtetuese që mbron lirinë individuale të individëve që kanë të bëjnë me të drejtë për gjykim të drejtë janë dispozitat e cituara. Edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në nenin 6 i garanton secilit të drejtën

për t'i parashtruar gjykatës për gjykim çfarëdo pretendimi, që u referohet “*të drejtave dhe detyrimeve me karakter civil*”.

Koncepti i “*të drejtave dhe detyrimeve*” me karakter civil është koncept autonom, i cili duhet interpretuar pavarësisht nga e drejta e brendshme e shteteve të Konventës, por duke marrë parasysh parimet e saj të përgjithshme.

E drejta e individit për një proces gjyqësor të rregullt dhe publik, e cila zë vend në një shoqëri demokratike, në kuptimin e Konventës, ka rëndësi tepër të madhe për funksionimin e duhur të mekanizimit të demokracisë dhe si rezultat i kësaj, nuk mund të bëhet një interpretim i ngushtë i saj. Në rast të paqartësive, nëse neni 6 duhet të gjejë zbatim, gjithmonë, atje ku kjo është e mundur-përgjigja duhet të jetë pozitive.

Në vendimin “*Delcourt kundër Belgjikës*” Gjykata theksoi së “*Në shoqëritë demokratike, në kuptimin e Konventës, e drejta për një proces të rregullt gjyqësor zë një vend kaq të rëndësishëm, sa që, çfarëdo interpretimi i ngushtë i nenit 6 paragrafi 1, nuk do ti përgjigjet as qëllimit dhe as karakterit të këtij neni*”. Në çështjen “*Sunday Times (nr.1) kundër Britanisë së Madhe*” Gjykata tërhoqi vëmendjen se neni 6, është pasqyrim i një parimi të rëndësishëm, që shtrihet në themelet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe përkatësisht, parimit të rendit ligjor.

Kushtetua e Republikës së Kosovës në mënyrë primare e garanton mbrojtjen në gjykatë, si formën më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në të drejtën e brendshme.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Konventa Evropiane garantojnë të drejtën e secilit për mbrojtje gjyqësore, në këtë rast në nivel kushtetuese, ndërsa në mënyrë specifike procedurën për mbrojtje gjyqësore e rregullon ligji përkatës-Ligji për Procedurën Kontestimore-(LPK).

Me dispozitën e nenit 1, të LPK-së, përcaktohet se: “*Me ligjin për procedurën kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizik dhe juridik, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe*”.

Procedura kontestimore mbi disa parime bazë që garantojnë ligjshmërinë dhe objektivitetin e zhvillimit të procedurës.

1. Parimet dhe rregullat e procedurës kontestimore (disa nga parimet më të rëndësishme)

Gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore gjykata duhet të kujdeset për zbatimin e parimeve të procedurës. Procedurat civile në vendet bashkëkohore kanë tendencë që të rregullohen në mënyrë sa ma parimore duke shmangur kështu fondin e madh të dispozitave për çështje specifike sepse sa më specifiku është që të rregullohen procedurat civile/kontestimore mundësitë e kolizionit të dispozitave apo të dykuptimësisë janë më të mëdha, prandaj edhe ne duhet tu kushtojmë një vëmendje të veçantë parimeve të procedurës kontestimore të cilat gjejnë zbatim parimisht nga fillimi i procedurës kontestimore e deri në përfundim të procedurës kontestimore. Në procedurën kontestimore me këtë term quhen rregullat themelore, të cilat përshkojnë aktivitetin që e kryejnë

subjektet e procesit me qëllim që të arrihet mbrojtja juridike e së drejtës subjektive apo me qëllim që të konstatohet se për një gjë të tillë nuk ka vend. Parimet e kësaj procedure i caktojnë metodat e veprimit që kryhet gjatë shqyrtimit të çështjes juridike dhe vendosjes mbi të.

1.1 Parimi i kushtetutshmërisë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës me dispozitën e nenit 102 paragrafi 1, përcakton se: *“Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykata”*, me paragrafin 2, përcaktohet se: *“Pushteti gjyqësor është unik, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”*, ndërsa në paragrafin 3, përcaktohet se: *“Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”*.

Kufizimi i gjykatave që të mund të kenë pushtet jashtë kufijve të vendosur nga Kushtetuta dhe ligjet është standard i mbrojtjes nga arbitrariteti i pushtetit gjyqësor, në njërën anë, dhe në anën tjetër, standard themelor i demokracisë i shprehur si kushtetutshmëria dhe ligjshmëria.

Në praktikë, ky paragraf i Kushtetutës i detyron gjykatat që pushteti i tyre të burojë vetëm nga kushtetuta dhe ligjet.

Përveç dispozitave të cituar e të cilat ndërlidhen me parimin e kushtetutshmërisë në procedurën kontestimore, ekziston edhe dispozita e nenit 16 paragrafi 1, në Kushtetutë e cila përcakton se: *“Kushtetuta është akti më i lartë juridik në Republikën e Kosovës, Ligjet dhe aktet tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë”*.

Parimi i kushtetutshmërisë kërkon që normat e sistemit të caktuar juridik të jenë në pajtim me Kushtetutën si dokument juridik kryesor. Ata që kanë për detyrë zbatimin e normave juridike gjatë punës së tyre duhet t'i kenë parasysh rregullat kushtetuese dhe ligjore si dhe ato të akteve të përgjithshme të cilat fuqinë e tyre e nxjerrin nga rregullat kushtetuese dhe ligjore.

1.2 Parimi i ligjshmërisë

Parimi i ligjshmërisë përcakton detyrimin e gjykatës që zhvillimi i shqyrtimit gjyqësor por edhe vendimi meritor të jetë i ndërlidhur me normën juridike. Gjykata është e detyrueshme që kontestin ta zgjidhë ashtu siç e parasheh norma me të cilën është rregulluar raporti materialo-juridik nga i cili ka lindur kontesti.

Parimi i ligjshmërisë në procedurën kontestimore vlen edhe për normat e natyrës materialo-juridike nga të cilat gjykata nxjerrë përfundimin për themelësinë e kërkesëpadisë e po ashtu edhe për normat procedurale mbi bazën e të cilave gjykata e udhëheqë procedurën për vendosjen e çështjes kontestuese.

1.3 Parimi i disponibilitetit

Esenca e këtij parimi është shprehur me maksimën latine *“nemo iudex sine actore”*. Kjo do të thotë se nuk ka proces kontestimor pa kërkesën e personit të autorizuar që gjykata të vendosë mbi kërkesën e caktuar të mbrojtur juridikisht. Në bazë të këtij parimi, paditësit i njihet e drejta që procedurën e inicuar me padi ta përfundojë me veprimin procedural të tërheqjes së padisë (*dispozita e nenit 261 paragrafi 1, i LPK-së*) apo me atë të heqjes dorë nga kërkesëpadia (*dispozita e nenit 149 paragrafi 1, i LPK-së*). Procesi përfundon me veprimet disponibile të palëve edhe atëherë kur ato lidhin pajtim gjyqësor për objektin e kontestit të përcaktuar me padi (*dispozita nga neni 412-419 të LPK-së*). Procedura instancionale gjithashtu mund të përfundojë me anë të veprimit disponibil të tërheqjes së mjetit të goditjes së vendimit (*dispozitat e nenit 177 të LPK-së*).

1.4 Parimi i dëgjimit të palëve

Me dispozitën e nenit 5 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“Gjykata do t’i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet që:

“Vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj gjykata ka të drejtë që të vendosë mbi kërkesën, për të cilën palës kundërshtare nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet”.

Sipas këtij parimi, gjykata ka për detyrë që, para se ta japë vendimin meritore, çdonjëri nga palët t’ia japë mundësinë për të paraqitur mendimin lidhur me çështjen mbi të cilën duhet vendosur, si dhe për t’u deklaruar lidhur me thëniet dhe pretendimet e palës kundërshtare. Ky parim, i cili ndryshe quhet parim i kontradiktorialitetit. Me rregullat mbi këtë parim sigurohet barazia e palëve para gjykatës dhe mbledhja e fakteve relevante për vendosje meritorë, por edhe konstatimi se çka është kontestuese e çka jokontestuese midis palëve. Barazia e dy palëve me interesa të kundërta ndikon që secilës nga to t’i njihet e drejta që të shprehet në lidhje me veprimet procedurale, të cilat i kryen kundërshtari i saj. Duke i vënë në pozita të barabarta, ligji njëkohësisht krijon parakusht për gjykim objektiv. Sepse, gjykata është e detyruar që edhe njëherë e edhe palës tjetër në mënyrë të njëjtë t’ia mundësojë marrjen e qëndrimit në lidhje me veprimin procedural të kundërshtarit, dhe është e detyruar të marrë parasysh gjithë atë që kanë paraqitur të dy palët.

Shkelja e parimit të kontradiktorialitetit, është paraparë si shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të shkeljes së tillë, gjykata e shkallës së dytë e prishë vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lëndën e kthen në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

Sipas interpretimit të Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut e drejta e dëgjimit publik është e garantuara, megjithatë shtypi dhe publiku “mund të

përjashtohen nga të gjitha apo nga një pjesë e 'një gjykimi për disa arsye specifike të caktuara, respektivisht, për interes të moralit, rregullit publik apo sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, në interes të jetës private të palëve, apo kur përndryshe këtë e kërkon interesi i drejtësisë". Konventa Evropiane kësaj i shton edhe "interesin e të miturve" si një arsye për të mbajtur procesin gjyqësor nën kamerë. Sipas konventës Evropiane, procedurat duhet, në përjashtim të asaj të cekur më lartë, të mbahen në publik. Sidoqoftë, zbatimi i kësaj dispozite "në procedurat para gjykatave të apelit, varet nga mënyrat speciale të procedurave të përfshira " dhe "duhet të kihet parasysh procedurat në përgjithësi të rregullit ligjor vendor dhe roli i gjykatave të apelit në to. Kështu gjykata si vazhdimësi ka theksuar se: "nëse ka ekzistuar një dëgjim publik në instancën e parë, mungesa e 'dëgjimit publik' në instancën e dytë ose të tretë mund të arsyetohet me paraqitjen speciale të procedurave për çështjen në fjalë. Kështu, procedurat për lënie të ankesës apo procedurave që përfshijnë vetëm çështje të ligjit, si kundërshtim i çështjes së faktit, mund të jenë në pajtim me kërkesat e nenit 6, madje edhe nëse ankuesit nuk i është dhënë një mundësi që të dëgjohet personalisht nga gjykata e apelit apo kasacionit".

Nga praktika gjyqësore: Sipas dispozitës së nenit 182 paragrafi 2, i LPK-së, përcaktohet se: "Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë: pika i) nëse ndonjëri nga palët me veprimin e paligjshëm, e sidomos me mosdhënien e mundësisë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë".

Me dispozitën e nenit 197 të LPK-së, përcaktohet se: "Gjykata e shkallës së dytë në seancën e kolegjit, apo në bazë të shqyrtimit të çështjes, me aktvendim e prishë aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen ia kthen për rigjykim të njëjtës gjykatë të shkallës së parë, nëse konstaton se ekziston njëri ndër këto shkaqe të përmendura në ankesë: pika) Nëse ndonjëri nga palët me veprim të kundërligjshëm, e sidomos për shkak të mos thirrjes në mënyrë të rregullt, nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes, kurse veprimi i tillë ka pasur ndikim në dhënien e vendimit të ligjshëm dhe të drejtë".

Nga dispozitat e cituara shihet vlera e parimit të kontradiktorialitetit në procedurën kontestimore, prandaj me të drejtë gjykata e shkallës së dytë mbanë qëndrim rigoroz gjatë ekzaminimit të vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me zbatimin e këtij parimi.

Parimi i procesit të rregullt gjyqësor ka si element të vetin edhe të drejtën e secilës palë për të qenë e pranishme në seancë gjyqësore. Praktika e Gjykatës Evropiane, ka përcaktuar standarde edhe për pjesëmarrjen në gjykim me qëllim që t'i krijohen mundësitë secilës palë për tu mbrojtur efektivisht në të drejtën që pretendohet si e shkelur. Gjykata Evropiane, në një çështje të saj shprehet se: "prania e palëve në procedurë civile është karakteristikë e rëndësishme e garancive të parashikuara në nenin 6 të Konventës. Në lidhje me çështjet civile, gjykata ka vendosur se kjo është veçanërisht e rëndësishme kur probleme të natyrës faktike ose personale janë në lojë...".

1.5 Parimi i publicitetit

Ky parim është shprehur në nenin 4 të LPK-ës, sipas të cilit gjykata për kërkesëpadinë zakonisht vendosë në bazë të shqyrtimit të zhvilluar në seanca gjyqësore me dyer të hapura. Është parashikuar mundësia që në rastet në të cilat, me qëllim të ruajtjes së fshehtësisë, moralit, interesit të palës së mitur apo të ndonjë interesi tjetër të posaçëm, të përjashtohet publiciteti. Një gjë e këtillë bëhet me vendim të gjykatës. Mirëpo, në kontestet martesore, si dhe në ato në lidhje me atësinë apo amësinë publiciteti është përjashtuar ex lege.

Nga praktika gjyqësore: Parimi i publicitetit paraqet njërin ndër parimet me fundamentale në procedurë, zbatimi i të cilit shikohet zyrtarisht nga gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesave të palëve kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

Detyrimi që gjykata e shkallës së dytë zyrtarisht të shikojë nëse është cenuar parimi i publicitetit përcaktohet me dispozitën e nenit 194 të LPK-së.

Rëndësia praktike e këtij parimi qëndron në atë se përmes publicitetit nxitet besimi i opinionit në gjykata e rrjedhimisht publiku shërben në njëfarë mënyre si monitorues i pavarësisë, paanësisë, objektivitetit dhe ligjshmërisë, përkritazi me vendosjen nga ana e gjykatës.

Karakterit publik i procesit ka rëndësi shumë të madhe, ai i mbron palët nga sistemi i drejtësisë, i zhvilluar në fshehtësi, pa kontrollin publik. Është, gjithashtu, një nga format e ruajtjes së besimit tek qytetarët, duke bërë që sistemi i drejtësisë të jetë i hapur dhe të synojë drejtë arritjes së qëllimit të nenit 6 paragrafi 1, të Konventës Evropiane, për besueshmërinë e procesit, garancitë e të cilit janë një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike.

Me qëllim që të nxitet besimi ndaj administratës së gjyqësisë dhe të sigurohet dëgjimi i drejtë i palëve, procedurat duhet të jenë të hapura për publikun e gjerë. Sipas maksimës së njohur e cila thotë se drejtësia jo vetëm që duhet të bëhet, por edhe duhet të shihet se si bëhet, publiku ka të drejtë të dijë se si bëhet drejtësia dhe çfarë vendimesh merren. Dëgjimi publik, nënkupton dëgjimin e prezantimeve gojore për bazat e rastit, të cilat duhet të jenë publike dhe të cilat mund të përcjellë publiku dhe shtypi (sipas procedurës). Për këtë arsye, gjykatat duhet të bëjnë publike kohën dhe vendin e dëgjimit të prezantimeve gojore. Parimi i publicitetit duhet të respektohet në tërësi, përveç nëse ekziston ndonjë arsye që lejon përjashtimin e publikut.

Siç është vërejtur nga Gjykata Evropiane, objekt i nenit 6 (1) në lidhje me publikimin e vendimeve gjyqësore është “ të siguroj shqyrtim të gjyqësorit nga ana e publikut me qëllim të garantimit të të drejtës për gjykim të drejtë”. Gjykata nuk ka adaptuar një interpretim literal të fjalës “gjykimi duhet të shpallët publikisht”, por në vend të kësaj në praktikën e saj gjyqësore ka marrë parasysh “traditën e saj jetëgjatë” të shumë shteteve të Këshillit të Evropës gjatë bërjes publike të vendimeve të disa apo të të gjitha gjykatave të tyre; për këtë arsye një traditë e tillë nuk do të thotë domosdoshmërisht lexim me zë të gjykimin në fjalë, por nënkupton ruajtjen e këtyre vendimeve në një regjistër që është i hapur për publikun.

Parimi i publicitetit është duke u zgjeruar në kuptimin që publiku i gjerë të ketë mundësi të shohë drejtësinë se si është duke u bërë. Në këtë kuptim gjyqësori në Kosovë ka filluar me publikimin e vendimeve gjyqësore përfshirë edhe vendimit për çështje civile. Besoj që kjo është një mundësi e mirë e kontrollit nga publiku i gjerë për punën e gjykatave.

1.6 Parimi i shqyrtimit dhe i hetimit

Me rregullat procedurale më këto dy parime caktohet çështja e iniciativës lidhur me grumbullimin e materialit procedural në bazë të të cilit gjykata e nxjerrë vendimin meritore për kërkesëpadinë. Materialin procedural e përbëjnë: materiali faktik, materiali provues dhe rregullat juridike. Në praktikën gjyqësore në vendin tonë nuk ka qëndrim unik sa i përket parimit të hetimit, përkatësisht rolit aktiv apo pasiv që duhet të ketë gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes kontestuese.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: *“Palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e tyre”*.

Nga dispozitat e sipërcituara rrjedh se gjykata e shqyrton çështjen duke e hetuar në masën që e propozojnë palët ndërgjyqësore, gjithmonë duke vlerësuar se cilat prova do të merren për të provuar faktet vendimtare, natyrisht nëse janë propozuar provat. Ka përjashtime nga ky rregull, sepse gjykata merr prova edhe zyrtarisht kur bëhen përpjekje nga palët për të disponuar me kërkesa që nuk mund të disponojnë.

Me Ligjin nr.04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-006, për Procedurën Kontestimore është ndryshuar dispozita e nenit 356 duke i dhënë mundësi gjykatës që zyrtarisht të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës. Ky ndryshim është në kundërshtim të plotë me frymën e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe në tërësi në kundërshtim me parimin e shqyrtimit dhe hetimit sepse bënë përjashtim vetëm për të provuarit me anë të ekspertizës. Ky ndryshim është i palogjikshëm sepse të gjitha mjetet provuese i shërbejnë qëllimit të njëjtë, vërtetimit të gjendjes faktike në çështjen kontestuese, prandaj është e paarsyeshme që të bëhet përjashtim për marrjen e provës me ekspertizë, megjithatë tani gjykata ka mundësi që zyrtarisht të bëjë marrjen e provës me ekspertizë.

1.7 Parimi i së vërtetës materiale

Me nenin 7 të LPK-ës nga gjykata kërkohet që para se të jepet vendimi për kërkesëpadinë, të vërtetohet plotësisht dhe saktësisht gjendja faktike, mbi të cilën mbështetet kërkesëpadia. Cilësia

e njohurive për gjendjen faktike relevante varet nga mënyra e hulumtimit dhe e vlerësimit të materialit faktik të grumbulluar nga gjykata në një proces kontestimor. Ekzistojnë dy sisteme, me të cilat zgjidhet çështja e zgjedhjes, ekzaminimit dhe e fuqisë provuese të mjeteve provuese. I pari quhet sistem i vlerësimit lirisht të provave (i kërkimit të së vërtetës materiale), kurse i dyti sistem i vlerësimit ligjor (legal) të provave (sistem i kërkimit të së vërtetës formale).

Me dispozitën e nenit 8 paragrafi 1, të LPK-së, përcaktohet se: *“Se cilat fakte do t’i konsiderojë të provuara e cilat jo, vendosë vetë gjykata në bazë të çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave, por edhe në bazë të rezultatit të gjithë procedimit”*, ndërsa në paragrafin 2, përcaktohet se: *“Gjykata me ndërgjegje dhe me kujdes e çmon çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku”*.

Nga dispozita e sipërcituar rrjedh së në sistemin tonë është vlerësim i lirë i gjykatës për të vendosur se cilat fakte do ti konsiderojë të provuara e cilat jo, pastaj çmuarjen e provave veç e veç e të gjitha së bashku, e në këtë mënyrë të arrijë në përfundimin e duhur ligjor.

1.8 Parimi i vlerësimit lirisht të provave

Në sistemin e vlerësimit lirisht të provave nuk parashikohen rregulla procedurale për zgjedhjen, shfrytëzimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese. Gjykata, sipas këtij sistemi, nuk është e lidhur e as e kufizuar me rregulla të posaçme formale për të provuarit. Pretendimin e caktuar gjykata e merr si të provuar vetëm pasi të jetë bindur në saktësinë e tij (në bazë të provave të shfrytëzuara dhe të vlerësuar).

Gjykata është e lirë të vlerësojë rezultatit e hetimit gjyqësor dhe të vendos për themelin e çështjes. Vlerësimi i lirë i provave nga gjykata, kërkon një kujdes të veçantë në respektimin e rregullave dhe kufijve të caktuar për këtë qëllim, si dhe përdorimi me efektivitet i eksperiencës. Gjykatësi duhet të ruhet nga ajo që quhet interpretim personal i tij, në drejtim të vlerësimit subjektiv e të njëanshëm të provave dhe të pranimit të konkluzioneve të nxjerra nën influencën e të dhënave të marra privatisht prej tij ose të ofruara nga palët, e që nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Del e domosdoshme formimi i një discipline të fortë juridike në vlerësimin e provave, ku si çështje bazë duhet të jetë formimi dhe konsolidimi i provës në procesin e përpjekjes së dy të kundërtave. Çdo cenim i këtyre rregullave të shpie në varfërimin e vlerës ligjore të gjyqimit.

Sipas Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, vlerësimi i provave u takon, në parim gjykatave vendore. Organet e Konventës mund ta kontrollojnë vetëm mënyrën e administrimit të provave dhe jo vlerësimin e tyre nga gjykata, me përjashtim të rasteve, kur bëhet fjalë për parregullsitë apo për arbitraritet.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, nuk i përmban parimet e pranimit të provave, duke e lënë këtë ekskluzivisht në dorën e ligjeve vendore. Gjykata ka për detyrim shqyrtimin e kujdesshëm të provave dhe të kërkesave të palëve

për paraqitjen e provave, si dhe vlerësimin e rëndësisë së tyre për zgjidhjen e çështjes. Lënia palëve njëfarë iniciative në fushën e provave nuk e liron gjykatën nga detyrimi i respektimit të nenit 6 të Konventës në këtë fushë. E drejta e palëve për të paraqitur argumente sigurohet vetëm në rastin kur ato dëgjohen realisht, pra, kur shqyrtohen nga gjykata në mënyrën e duhur. Nuk mund të thuhet se kjo është bërë në qoftë së është nënvlerësuar një provë më rëndësi esenciale.

1.9 Parimi i pandërmjetësisë

Sipas këtij parimi, gjykata, me anë të shqisave personale, njihet me natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese dhe pa ndërmjetësimin e tjetërkujt, vendos për vlerën provuese të tyre, si dhe merr vendim meritore të bazuar në materialin që ka grumbulluar vetë. Parimi i pandërmjetësisë ka të bëjë me faktin, se gjykata në gjykimin e çështjes civile duhet të jetë prezentë në dëgjimin e palëve, në marrjen e provave, si dëgjimi i dëshmitarëve, provave shkresore, etj.

Ky parim është shprehur në nenin 4 të LPK-ës, sipas të cilit gjykata vendosë për kërkesëpadinë zakonisht në bazë të shqyrtimit të drejtpërdrejtë të çështjes juridike të zhvilluar publikisht dhe gojarisht. Ky parim nuk zbatohet në procedurat instancionale, sepse në to vendoset në bazë të shkresave.

1.10 Parimi i shfrytëzimit me mirëbesim i të drejtave procedurale

Një prej standardeve kryesore në të drejtën bashkëkohore është ai se titullari i një të drejte nuk bënë ta keqpërdorë atë. Atij i njihet një e drejtë me qëllim që të shfrytëzohet për atë që është dedikuar jo për qëllime të tjera. Me LPK (neni 10) kërkohet nga palët që me ndërgjegje t'i shfrytëzojnë të drejtat procedurale, të cilat ua njeh ligji, kurse nga gjykata që ta pamundësojë keqpërdorimin e tyre. Kemi keqpërdorim të autorizimeve procedurale, p.sh., kur një person ngre padi, duke menduar se debitori nuk do të mund ta bindë gjykatën se e ka shlyer borxhin, pasi nuk ka kurrfarë provash për një gjë të tillë.

Suksesi personal, të cilin pala e ka parasysh gjatë aktivitetit të saj procedural, nuk guxon të jetë në kundërshtim me qëllimin objektiv të gjykimin.

Gjykata mund ta dënojë me të holla palën, përfaqësuesin e saj dhe ndërhyrësin, nëse me veprimet procedurale e kanë keqpërdorur rëndë ndonjë të drejtë që u njihet me LPK.

1.11 Parimi i oralitetit

Për komunikimin dhe këmbimin e mendimeve midis njerëzve si dhe midis palëve dhe gjykatës ekzistojnë dy forma: forma gojore, kur gjykata palëve dhe palët gjykatës mendimet ia shprehin gojarisht drejtpërdrejt, dhe forma e shkruar, kur palët kërkesat, propozimet dhe informatat e tjera

i përpilojnë me shkrim dhe shkresat ia dorëzojnë gjykatës. Sipas LPK-ës, veprimet procedurale kryhen me shkrim jashtë seancave dhe gojarisht në seanca. Gjykata e krijon bindjen e saj nëpërmjet dëgjimit të vetë palëve, por në procesin gjyqësor civil shërbejnë edhe materialet e shkruara, të cilat shërbejnë si provë për zgjidhjen e çështjes, por gjithmonë ato lexohen e administrohen drejtpërdrejtë në gjykimin civil. Gjykimi oral, nga një anë ndihmon në zbulimin e së vërtetës dhe nga ana tjetër, kontribuon tek shtetasit pjesëmarrës si dëgjues në gjykim, që të marrin dijeni vetë nga zhvillimi i gjyqit dhe nga mënyra e zgjidhjes së konfliktit në gjykatë. Në fazën përgatitore dhe në atë sipas mjeteve të goditjes së vendimeve, dominon forma e shkruar.

1.12 Parimi i dhënies së ndihmës juridike palës së paudhëzuar

Me qëllim të evitimit të pabarazisë faktike dhe dëmit eventual që mund ta pësojë pala e pa udhëzuar në punët juridike, është parashikuar detyra e gjykatës që atë ta udhëzojë se cilat veprime procedurale duhet t'i kryejë, por edhe ta njohë me pasojat e moskryerjes së veprimeve procedurale. Mirëpo, kjo detyrë e gjykatës ka të bëjë vetëm me udhëzimin për të drejtat procedurale e jo edhe me të drejtat e natyrës materialo-juridike. Gjykata mbetet brenda suazave të detyrës së përmendur, nëse, p.sh., palës ia shpjegon domethënien e instituteve procedurale: ndërprerje e procedurës, pezullim, tërheqje e padisë, heqje dorë nga kërkesëpadija, ndryshimi i padisë etj. Në të kundërtën do të shkelej parimi i paanësisë së gjykimit.

Për disa raste parashihet posaçërisht detyra e gjykatës që palët dhe personat tjerë t'i udhëzojë në lidhje me të drejtat e tyre ose t'i njoftojë me pasojat e mosveprimit të tyre. Kështu, p.sh., pala duhet njoftuar me dëmin që mund t'i shkaktohet për shkak të mosparaqitjes në gjykim. Gjykata është e detyruar që palën ta udhëzojë edhe mbi mënyrën e përmirësimit të gabimeve në aktin e saj të shkruar.

1.13 Parimi i ekonomisë së gjykimit

Sikurse edhe çdo aktivitet tjetër, edhe aktiviteti procedural duhet të kryhet në kohë sa më të shkurtër, me punë sa më të pakët dhe me shpenzime sa më të vogla. Për këtë qëllim është parashikuar, p.sh., marrja e provave nëpërmjet gjykatës së porositur, bashkimi i dy gjykimeve, mos caktimi i seancës përgatitore, bashkimi i kërkesëpadive, përfshirja e dy të paditurve me një padi të vetme etj.

Shembuj tjerë: Palëve prezent gjykata gojarisht ua komunikon vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës së ardhshme; Ekspertët gjykata i detyron që ta paraqesin mendimin e tyre me shkrim para së të filloj seanca e shqyrtimi kryesor i çështjes, më qëllim që palët të përgatitën për të.

1.14 Gjuha në procedurën kontestimore

Bazuar në nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë:

- a) gjuha shqipe, dhe
- b) gjuha serbe,

Gjuha turke, boshnjake dhe ajo rome, kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komunal ose do të mund të jenë në përdorim zyrtar në cilin do nivel në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK) përcakton se pala dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë.

Nëse procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, respektivisht të pjesëmarrësit tjetër në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojari në gjuhën e tyre apo në gjuhën që ata e kuptojnë, i të gjitha parashtrësive dhe provave shkresore si dhe i asaj që parashtrëhet në seancë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë do të njoftohen me të drejtën që procedurën verbale ta ndjekin në gjuhën e tyre me anë të përkthyesit. Ata mund të heqin dorë nga e drejta e përkthimit, nëse deklarojnë se e njohin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Në procesverbal do të shënohet se atyre u është dhënë udhëzimi për të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre, si dhe deklarata e palëve dhe e pjesëmarrësve të tjerë në procedurë lidhur me udhëzimin e dhënë nga gjykata.

Përkthimin e bëjnë përkthyesit, ndërsa shpenzimet e përkthimit mbeten në ngarkim të buxhetit të gjykatës.

Shkelja e rregullave të përdorimit të gjuhës në procedurën kontestimore, paraqet shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (j) të LPK-së, për të cilat gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, ndërsa vendimi i cili bazohet në këto shkelje, duhet të priset.

III. DISA ÇËSHTJE ME RËNDËSI PËR PROCESIN E RREGULLT GJYQËSOR E RRJEDHIMISHT EDHE PËR VENDIMIN GJYQËSOR

Në çdo proces gjyqësor secili gjyqtar është i detyruar të vlerësoj nëse çështja e ngritur pra gjykatës është një rast i mundshëm dhe i lejueshëm për tu shqyrtuar, prandaj nëse konstaton se

rasti është i lejueshëm atëherë duhet të behën përgatitjet për shqyrtim dhe si përfundim edhe të mbahet shqyrtim dhe të sjellët vendimi gjyqësor.

1. Vlerësimet e gjykatës

- ***Çka duhet të bëjë gjyqtar/i/ja sapo të pranojë një padi për shqyrtim?***

Sipas dispozitës së nenit 286 paragrafi 1, i LPK-së parashihet së: “ *Gjykata menjëherë pasi ti arrijë padia i fillon përgatitjet për shqyrtim kryesor të çështjes*”, ndërsa me paragrafin 2 të nenit 286 parashihet së: “ *Përgatitjet e tilla përfshijnë ekzaminimin paraprak të padisë, dërgimin e padisë palës së paditur për përgjigje të domosdoshme, mbajtjen e seancës përgatitore dhe caktimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes*”.

Ky aktivitet përbëhet nga verifikimi se a janë përmbushur prezumimet procedurale, në qoftë se ato mund të konstatohen me vetë leximin e padisë. Ky verifikim bëhet në bazë të të dhënave që i përmbajnë shkresa e padisë, si dhe në bazë të fakteve që i di vetë gjykata siç përcakton dispozita e nenit 17.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

- ***Çfarë vlerësimesh bën gjykata në një çështje juridike kontestimore?***

Gjykata civile në një çështje juridike kontestimore i bënë dy lloj vlerësimesh dhe atë:

- Vlerësimet e rrethanave nga të cilat varët lejueshmëria e procesit gjyqësor (prezumimet procedurale), dhe pastaj
 - Vlerësimet rrethanave nga të cilat varët bazueshmëria e kërkesëpadisë (vendosja meritore).
- ***Çka nënkuptohet me prezumimet procedurale?***

Në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë gjykata e bënë parimisht vetëm vlerësimin e rrethanave/kushteve nga cilat varët lejueshmëria e procesit gjyqësor (prezumimet procedurale).

Prezumimet procedurale, ndryshe rrethanat apo kushtet nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor klasifikohen në disa grupe të prezumimeve procedurale. Duhet kuptuar se të gjitha prezumimet procedurale janë përcaktime të dispozitave ligjore të cilat duhet të zbatohen me korrektësi në mënyrë që të kemi një proces gjyqësor të pranueshëm.

- ***Si klasifikohen prezumimet procedurale?***

- Prezumimet procedurale lidhur me gjykatën,
- Prezumimet procedurale lidhur me palët,
- Prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit,

- Prezumimet procedurale lidhur me padinë.

Prezumimet procedurale lidhur me gjykatën.

Prezumimet procedurale të klasifikuara në grupin e prezumimeve procedurale që lidhën me gjykatën kryesisht janë grupi i dispozitave ligjore që i referohen kompetencës.

Parimisht struktura e dispozitave ligjore që i referohen prezumimeve procedurale që lidhen me gjykatën mund të jetë si në vijim:

- Kompetenca lëndore e gjykatës në raport ndonjë gjykate tjetër,
- Kompetenca e gjykatës në raport me organin administrativ,
- Kompetenca e gjykatës në raport me gjykatën e huaj,
- Kompetenca e gjykatës në raport me kompetencën e arbitrazhit,
- Kompetenca e gjykatës në raportin e procedurës kontestimore me jokontestimore.
- Kompetenca territoriale e gjykatës në raport me gjykatën tjetër.
- Përbërja e rregullt e gjykatës (kompetenca funksionale) dhe
- Detyrimi i përjashtimit të gjyqtarit në raste të caktuara.

Përbërja e rregullt e gjykatës (kompetenca funksionale)

Me përbërje të gjykatës kuptojmë përbërjen në të cilën ajo gjykon, që domethënë vendosë për themelin e kërkesëpadisë, apo për mjetin e goditjes së vendimit gjyqësor.

Përbërjen e gjykatës të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë, për çështje civile përcaktohet me dispozita e Ligjit për Gjykatat, Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Procedurën Përmbarimore dhe Ligjit për Familjen.

Përbërja e gjykatës në shkallë të parë:

Në procedurën e shkallës së parë dhe në procedurën sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, vendos gjyqtari individual (i vetëm).

Në procedurën e shkallës së parë të kontesteve martesore dhe në kontestet e ushqimisë e zhvillon dhe i merr vendimit kolegji i përbërë prej një gjyqtari dhe dy gjyqtarëve porotë, kurse në shkallë të dytë kolegji prej tre gjyqtarëve.

Përbërja e gjykatës në shkallë të dytë:

Në procedurën e shkallës së dytë dhe procedurën sipas revizionit vepron trupi gjykues prej tre gjykatësve.

Përbërja e gjykatës në shkallë të tretë:

Gjykata Supreme shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji me nga tre (3) gjyqtar profesionist, me përjashtim kur me ligj parashihet një numër me i madh i gjyqtarëve.

Prezumimet procedurale lidhur me palët

Prezumimet procedurale lidhur me palët i gjejnë në ato dispozita të LPK-së, që i referohen:

- ekzistimit të palës,
- zotësisë për të qenë palë ndërgjyqëse,
- zotësisë procedurale të palëve,
- përfaqësimi ligjor i rregullt në rast të mungesës së zotësisë procedurale,
- përfaqësimi i rregullt i personit juridik dhe ekzistimi i prokurës së rregullt,
- autorizimi procedural për ndjekjen e çështjes në gjykatë.

Prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit

Prezumimet procedurale lidhur me objektin e kontestit i gjejnë në ato dispozita të LPK-së, që i referohen:

- Mosekzistimit të gjyqëvarësisë (litispencencës) së dyfishtë,
- Mosekzistimit të vendimit të formës së prerë,
- Të mos ketë hequr dorë paditësi nga kërkesëpadia,
- Mosekzistimi i ujdisë procedurale lidhur me objektin e kontestit, dhe
- Ekzistimit të interesit për mbrojtje juridike.

Vështrim i përgjithshëm: LPK-ja, me dispozitat e nenit 391, ka përcaktuar se: “ Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejuar po që se konstaton se: pika- c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispencenca), pika- d) çështja është e gjë e gjykuar (res judicata), pika- e) për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi në gjykatë ka heq dorë nga kërkesëpadia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi”. Nga dispozita e cituar rrjedhë se në çdo rast kur konstatohet se ekziston gjyqëvarësia e dyfishtë, ekziston vendimi i formës së prerë, ekziston ujdia gjyqësore e palëve, paditësi ka heqë dorë nga kërkesëpadia dhe se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi, padia duhet të hedhet si e palejuar.

Nga praktika.

Dispozita e sipërcituar përcakton se vlerësimi i kushteve nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësorë e në mënyrë specifike i kushteve që lidhen me objektin e kontestit bëhen në fazën e shqyrtimit paraprak të padisë. Duhet theksuar se prezumimet procedurale që i referohen objektit të kontestit gjykata praktikisht ka mundësi ti vlerësojë vetëm pas pranimit të përgjigjes në padi, apo në seancën përgatitore kur paraprakisht të paditurit nuk i është dërguar padia për përgjigje, sepse nga leximi i padisë përkatësisht referati apo thëniet në padia gjykata nuk mund

të konstatoj pothuajse asnjërin nga prezumimet e procedurale që i referohen objektit të kontestit përveç paditshmërisë së të drejtës subjektive dhe interesit për mbrojtje juridike.

Rëndom është i padituri ai që e vë gjykatën në dijeni për ndonjërin nga pengesat e mundshme procedurale për shkak të t'cilave nuk mund të zhvillohet procesi gjyqësor, e që në këtë rast kanë të bëjnë me objektin e kontestit.

Prezumimet procedurale lidhur me padinë

Prezumimet procedurale lidhur me padinë i gjejmë në ato dispozita të LPK-së, që i referohen rregullsisë formale të padisë.

Si e vlerëson gjykata rregullsinë formale të padisë?

Padia është veprimi i parë procedural i paditësit më të cilën inicohet fillimi i procedurës kontestimore dhe si e tillë është parashtrësë mjaft formale elementet/përmbajta e të cilës është e përcaktuar nga ligji.

Ashtu siç është përshkruar edhe me parë sipas dispozitës së nenit 253 paragrafi 1, i LPK-së, padia duhet të përmbajë:

- a) kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;
- b) faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;
- c) provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;
- d) vlerën e kontestit;
- e) bazën juridike dhe
- f) të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë (neni 99 i këtij ligji)

Të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtrësë sipas dispozitës së nenit 99 paragrafi 2, të LPK-së, janë:

- Emrin e gjykatës (përfshirë edhe departamentin përkatës, përveç kur padia dorëzohet në degën e ndonjë gjykate me ç'rast në vend të departamentit shënohet emri i degës së gjykatës themelore),
- Emrin dhe mbiemrin (për personin fizik), ndërsa për personin juridik emërtimin e personit juridik,
- Vendbanimin apo vendqëndrimin (për personin fizik), ndërsa për personin juridik (selinë e personit juridik) palëve,
- Vendbanimin apo vendqëndrimin e përfaqësuesve ligjor apo me prokurë, (në qoftë se palët kanë përfaqësues),
- Objektin e kontestit,
- Përmbajtjen e deklaratës dhe

- Firmën e parashtruesit.

Sa i përket prezumimeve për rregullsinë e padisë, gjykata në kuptimin formal padinë duhet ta vlerësoi sipas elementeve që kërkohen për çdo parashtrësë, por edhe sipas elementeve specifike që parashihen për padinë.

Në rastet kur parashtrësja nuk përmban elementet e përcaktuara me ligj atëherë neni 102.1 i LPK-së përcakton se: *“Kur një parashtrësë nuk është e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta kërkojë nga dërguesi që ta korrigjojë ose ta plotësojë. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për kryerjen e korrigjimeve dhe plotësimeve duke i caktuar një afat prej tre (tre) ditësh për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës”.*

Edhe dispozita e nenit 390 e LPK-së, parasheh se: *“Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta iniciojë procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmerrë masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji)”.*

Për mos veprim sipas detyrimit nga dispozita e cituar pasoja juridike për palën parashihet me dispozitën e nenit 102. 3 të LPK-së, ku përcaktohet se: *“Parashtrësja do të konsiderohet e tërhequr nëse nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar në par. 1 të këtij neni, e nëse i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, e njëjta do të hidhet poshtë”.*

Për cilat të meta formale padia kthehet në plotësim/korrigjim?

LPK-ja dhe praktika gjyqësore janë mjaft të qarta dhe pa dilema se padia duhet të kthehet në plotësim gjithmonë kur asaj i mungojnë elementet që duhet të përmbajë padia si çdo parashtrësë (dispozita e nenit 99 paragrafi 2, i LPK-së).

Përveç të metave nga neni 99 paragrafi 2, i LPK-së, gjykata do të veprojë në kuptim të dispozitës së nenit 102, paragrafi 1, të LPK-së, edhe kur padisë i mungon kërkesa e caktuar në pikëpamje të çështje kryesore dhe kërkesave aksesore, (neni 253 paragrafi 1, pika a) e LPK-së.

Sa i përket kërkesës/ave të caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore edhe LPK-ja, edhe praktika gjyqësore janë në harmoni të plotë duke e trajtuar si pengesë formale mos përcaktimin e kërkesave në padi. Në këtë kontekst duhet theksuar së në çdo rast gjyqtari i çështjes nëse konstaton se padisë i mungon elementi i përcaktimit të kërkesës/ave duhet ta kthejë padinë në plotësim/korrigjim, sipas dispozitës së nenit 102 paragrafi 1 i LPK-së.

Është me rëndësi të theksohet se praktika gjyqësore sa i përket këtij elementi të padisë është ma formale se vet LPK-ja, pasi që LPK-ja, formalisht nuk e përcakton se kërkesa e padisë duhet të

formulohet në një formë të caktuar, ndërsa praktika gjyqësore këtë element të padisë e kërkon të jetë i formuluar në formën e një *“petitiumi”* i cili në fakt është propozim për përmbajtjen e dispozitivit të vendimit meritior.

Kjo mënyrë e veprimit në praktikën gjyqësore është në pajtim me logjikën e një procesi gjyqësor civil sepse nuk është kontestuese se procesi kontestimor iniciohet me qëllim që gjykata ti jep paditësit mbrojtje gjyqësore të përmbajtjes së caktuar. Aq më tepër kjo ka kuptim nëse ndërlidhet edhe detyrimi për gjykatën që të vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqësore, (neni 2, paragrafi 1, i LPK-së).

2. Mbrojtja e të paditurit nga padia

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjyqtari i çështjes vlerëson se padia është e rregullt dhe e plotë, atëherë me aktvendim padinë së bashku me shkresat e lëndës do t’ia dërgoj të paditurit për përgjigje në padi brenda 15 ditësh nga dita kur padia është paraqitur në gjykatë. I padituri, pasi t’i dorëzohet padia, me shkresat e bashkëngjitura eventualisht, ka për detyrë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të përgjigjet me shkrim në padi.

2.1 Mbrojtja e të paditurit nga padia me mjete juridike

Mënyra se si palët ndërgjyqësore zgjedhin të përfaqësojnë interesat e tyre në gjykatë është diskrecion i plotë i palëve. Në këtë kontekst mund të konkludohet se mbrojtja e të paditurit nga padia është një e drejtë e të paditurit.

Pavarësisht nga zgjedhja që bënë i padituri sa i përket mënyrës se si zgjedhë ai të mbrohet nga padia është me rëndësi të theksohet se gjykatat në çdo proces gjyqësor duhet t’i japin mundësinë e plotë që ai të mbrohet nga padia. Në çdo rast gjykatat duhet të respektojnë më përpikëri të gjitha të drejtat e palëve që janë të përfshira në procedurë. I padituri mund të mbrohet nga padia në aspektin procedural dhe materialo juridik. Qëllimi i mbrojtjes nga padia është që kërkesëpadia të mos realizohet ndaj tij, prandaj përmes mbrojtjes procedurale juridike i padituri do të bëjë përpjekje ta pengojë zhvillimin e procesit gjyqësor ndaj tij, ndërsa përmes mbrojtjes materialo juridike i padituri do të bëjë përpjekje që padia të tregohet e pathemeltë ndaj tij. Në këtë kontekst rrjedh se mjetet e të paditurit për tu mbrojtur nga padia janë mjetet proceduralo-juridike dhe mjetet materialo-juridike.

2.1.1 Mbrojtja me anë të mjeteve procedurale-juridike.

I padituri mbrohet me anë të mjeteve procedurale duke parashtruar fakte për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, kështu bënë përpjekje që ta bindë gjykatën se ekzistojnë pengesa procedurale për zhvillimin e mëtejshëm të gjykimit.

Prezumimet procedurale janë kushte nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor, e për të cilat kushte kujdeset gjykata ex-officio, por në disa raste nga referati i padisë gjykata nuk ka mundësi ti vlerësojë të gjitha prezumimet procedurale sidomos ato që lidhen me objektin e kontestit. Në këtë kuptim është i padituri që duke u mbrojtur nga padia i paraqet prapësimet procedurale të cilat i referohen pengesave që të zhvillohet procesi kontestimor. Duhet theksuar se i padituri nuk është i kufizuar që të paraqesë vetëm prapësimet procedurale të cilat nuk ka mundur ti vlerësoj gjykata gjatë shqyrtimit paraprak, por i njëjti ka mundësi të paraqesë të gjitha prapësimet procedurale që ai vlerëson se përbëjnë pengesë që procesi të zhvillohet me tutje.

- Disa nga prapësimet procedurale që mund të ngritën nga i padituri

I padituri mund të paraqesë prapësime që i referohen mos kompetencës së gjykatës, pengesave që i referohen përbërjes dhe përjashtimit të gjyqtarit, prapësime që lidhen me palët dhe përfaqësimin e palëve ndërgjyqësore, prapësime që i referohen objektit të kontestit dhe prapësime që i referohen rregullsisë formale të padisë.

2.1.2 Mbrojtja me anë të mjeteve materialo-juridike

I padituri mund të mbrohet nga padia përmes mjeteve materialo-juridike dhe atë duke kontestuar faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia, bazën juridike të kërkesëpadisë, parashtron prapësime materialo-juridike dhe paraqitja e kundërkërkesave.

a) Kontestimi i fakteve në të cilat bazohet kërkesëpadia

Kontestimi i fakteve nga ana e të paditurit mund të bëhet duke i kontestuar faktet të cilat i ka paraqitur paditësi apo duke paraqitur fakte të reja me të cilat tregohet në formë tjetër ngjarja.

b) Kontestimi i bazës juridike

I padituri mund të mbrohet duke kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë me pretendim së nga gjendja faktike e treguar nga paditësi nuk mund të del pasoja juridike e formuluar në padi. Për shembull: ai pretendon të vërtetojë se shkak i përmendur në padi sipas ligjit nuk i jep të drejtë paditësit për denoncimin e kontratës.

c) Prapësimet materialo-juridike

Përmes këtij prapësimi i padituri mbrohet duke u munduar të dëshmojë së rrethanat e caktuara e kanë penguar lindjen e së drejtës së paditësit, ose e kanë shuar atë.

Prapësim i natyrës materialo-juridike është për shembull paraqitja e prapësimi të parashkrimit, etj.

ç) Paraqitja e kundërkërkesave

Paraqitja e kundërkërkesave është prapësim i natyrës materialo-juridike të cilën i padituri e përdorë në rastet kur nuk mund të mbrohet nga kërkesëpadija me mjete tjera mbrojtëse. Me dispozitën e nenit 317 të LMD-së, përcaktohet se: *“Debitori mund ta kompensoi kërkesën që ka ndaj kreditorit me atë që kërkon ky prej tij në qoftë se të dy kërkesat kanë si objekt të hollat ose sendet tjera të zëvendësueshme të të njëjtit lloj ose të së njëjtë cilësi dhe në qoftë se të dyja kanë arritur për pagesë”*. Me këtë dispozitë përcaktohet mundësia e debitorit për kompensimin e kërkesave në të holla dhe sende të zëvendësueshme, por paraqitja e kundërkërkesave mund të vije në shprehje edhe në raste tjera varësisht nga lloji i kundërpadisë.

3. Shkathtësitë e gjyqtarit/ës për zhvillimin e seancës përgatitore

Gjykata gjatë zhvillimit të seancës përgatitore do të vendosë se çka do të jetë objekt shqyrtimi dhe cilat prova do të merren në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Jo gjithmonë palët ndërgjyqësore përkatësisht të autorizuarit e tyre i paraqesin kërkesat apo kundërshtimet në mënyrë të artikuluar, e në lidhshmëri me këtë në shumë raste gjatë seancës përgatitore mund të shfaqen mangësi në prezantimin e fakteve të cilat përbëjnë figurën e çështjes kontestuese dhe rrjedhimisht mangësi në propozimin e provave për të vërtetuar faktet e çështjes. Duke qenë se gjykata udhëhiqet nga parimet e procedurës kontestimore të cilat e diktojnë nevojën që roli i gjykatës të jetë pasiv sidomos përkitazi me hetimin e çështjes, atëherë shtrohet pyetja logjike se si do ta shqyrtojë gjykata çështjen në qoftë se palët nuk arrinë që ta prezantojnë një figurë të qartë të çështjes kontestuese?

Me dispozitën e nenit 403 paragrafi 1, i LPK-së, përcaktohet se: *“Seanca përgatitore fillon me shtjellimin e padisë në mënyrë koncize nga paditësi, e pastaj i padituri në të njëjtën mënyrë e parashtron përgjigjen në padi”*, ndërsa në paragrafin 2, të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Kur është e nevojshme gjykata do të kërkojë nga palët sqarime lidhur me thëniet apo propozimet e tyre”*. Nga dispozitat e cituara rrjedh detyrimi për paditësin që ta shtjelloj padinë në mënyrë koncize, e po ashtu edhe detyrimi i të paditurit që në mënyrë të njëjtë të parashtron përgjigje në padi.

Paragrafi 2, i nenit 403 të LPK-së, i jep gjykatës diskrecion të plotë që në këtë fazë të procedurës tu bëj pyetje palëve përkatësisht përfaqësuesve lidhur me padinë apo përgjigjen në padi. Pyetjet e gjykatës mund të jenë të drejtuara për të sqaruar rrethanat që lidhen me kushtet për lejueshmërinë e procesit kontestimor apo pyetje për merita e rastit.

Rëndomë pyetjet e gjykatës i referohen:

- rrethanave që kanë të bëjnë me prezumimet procedurale përkatësisht nevojën që të vendoset për ndonjë prapësim të natyrës proceduralo-juridike;
- identifikimit të qartë dhe të saktë të objektit të kontestit;
- korpusit të fakteve të paraqitura nga palët dhe në këtë kontekst fakteve jokontestuese të cilat nuk ka nevojë të provohen dhe fakteve kontestuese të cilat duhet të provohen;
- Provave të propozuara për fakte kontestuese; dhe
- Bazës juridike, përkatësisht mënyrës se si palët propozojnë që gjykata të zbatojë qoftë dispozitat procedurale qoftë ato materialo-juridike në raport me rrethanat e çështjes.
-

4. Konvokimi i seancës për shqyrtim kryesor të çështjes

Gjyqtari i çështjes seancën për shqyrtim kryesor të çështjes e konvokon me aktvendim, të cilin e jep në fund të seancës përgatitore, përkatësisht para përfundimit të saj.

Gjyqtari në seancë përgatitore, varësisht nga rezultati i shqyrtimit, do të nxjerrë përfundim se për çfarë do të bisedohet gjatë shqyrtimit kryesor dhe cilat prova do të nxirren në seancën për shqyrtim kryesor.

5. Zhvillimi i shqyrtimit kryesor

Shqyrtimi kryesor është faza qendrore e procedurës kontestimore. Atë e bëjnë veprimet procedurale të gjykatës dhe të palëve, të kryera në një apo më tepër seanca, me qëllim të shoshitjes dhe shqyrtimit të fakteve nga të cilat varet themelësia e kërkesëpadisë.

Hapja e seancës për shqyrtim kryesor

Gjyqtari i çështjes e hap seancën dhe e shpall objektin e shqyrtimit, i cili mund të jetë p.sh. kompensimi i dëmit, përmbushja e kontratës, anulimi i kontratës etj., e pas kësaj konstaton se a kanë ardhur të gjithë personat e thirrur. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastet e kontesteve familjare, kur seanca duhet të mbahet me trup gjykues, por që këtë e bënë kryetari i trupit gjykues.

Pas hapjes së seancës kryesor gjyqtari i çështjes konstaton se a janë plotësuar kushtet për mbajtjen e saj, dhe atë duhet që të verifikohet se:

- a janë prezentë të gjithë personat e ftuar për shqyrtim kryesor (palët, përfaqësuesit e tyre ligjor, përfaqësuesit me prokurë, ndërhyrësit, ekspertet etj.)

- nëse ndonjëri nga personat e ftuar nuk është i pranishëm në shqyrtim kryesor duhet të konstatohen shkaqet e mosparaqitjes, (një verifikim i tillë bëhet në bazë të informatave nga fletë dorëzimet nga përfaqësuesit ligjor dhe personat e tjerë)
- të verifikojë rregullsinë e thirrjeve për ata të cilët nuk kanë prezantuar në seancë.

Cilat janë pasojat juridike të mos paraqitjes së palëve?

Kur paditësi nuk vjen në seancë kryesore, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, konsiderohet se e ka tërhequr padinë. Në këtë rast, nëse pala e paditur nuk propozon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit, gjyqtari i çështjes në procesverbal merrë aktvendim me të cilin konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë. Por një veprim i tillë nuk sjellë humbjen e së drejtës së padisë, që do të thotë se paditësi mund të paraqesë këtë padi përsëri.

Mund të ndodhë që në seancën e shqyrtimit kryesor të mos paraqitet paditësi edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë formë. Në këtë rast gjyqtari mund ta mbajë seancën kryesore në mungesë të paditësit, mirëpo këtë mund ta bëjë vetëm kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të tij.

Nëse në seancën e shqyrtimit kryesor nuk vjen i padituri, i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar në asnjë mënyrë, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes mbahet pa praninë e tij.

Shqyrtimi paraprak i ekzistimit të pengesave procedurale për të proceduar metej

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesor mund të paraqiten pengesa të natyrës procedurale të cilat nuk e lejojnë zhvillimin e mëtejshëm të procesit gjyqësor. *P.sh., pretendimi se kërkesëpadija nuk hynë në kompetencë gjyqësore, çështja e ngritur me padi është e gjykuar; ekzistimi i gjyqëvarësisë (litispdenca) etj.*

Si rregull gjykata lidhur me ekzistimin e pengesave procedurale vendosë në fazën e shqyrtimit paraprak apo në seancë përgatitore, mirëpo mund të ndodhë që në bazë të atyre që palët i kanë ofruar gjykatës në theksimet e tyre dhe për atë që gjykata ka njohuri nuk mund të merret vendim në atë fazë të procedurës, atëherë gjyqtari sipas prapësimit të palës dhe sipas detyrës zyrtare në këtë fazë të shqyrtimit kryesor vendos në lidhje me ekzistimin e pengesave procedurale.

Ka raste kur gjykata dhe palët për ekzistimin e pengesave procedurale mund të mësojnë pas seancës përgatitore, prandaj duhet që tu jepet mundësia palëve që edhe pas seancës përgatitore t'i theksojnë kundërshtimet e tilla dhe gjykata e ka mundësinë që sipas detyrës zyrtare edhe në këtë fazë të procedurës të konstatohej nëse ekzistojnë pengesa të tilla.

Dispozita e nenit 424 të LPK i ka dhënë mundësi gjykatës që nëse konstaton se ekzistojnë pengesa procedurale për procedim të mëtutjeshëm të çështjes atëherë të veprohet sipas nenit 391 të LPK. Nëse ekziston ndonjëra nga kushtet e parapara me këtë nen, ndërsa me dispozitat e këtij ligji nuk është paraparë ndryshe, atëherë gjykata merrë aktvendim me të cilin padinë e hedhë poshtë si të palejueshme.

Rast praktik i veprimit të gjykatës në këtë fazë të procedurës: p.sh., në padinë e paditësit për vërtetim pronësie i padituri bënë përgjigje në padi dhe merr pjesë në seancën përgatitore, mirëpo nuk e paraqet kundërshtimin lidhur me çështjen e gjykuar, pas hapjes së seancës së shqyrtimit kryesor e kundërshton padinë dhe kërkon nga gjykata që ta hedhë poshtë padinë si të palejuar pasi që në këtë fazë të procedurës ka siguruar provë se kjo gjykatë për të njëjtën çështje ka vendosur dhe se tashmë është çështje e gjykuar.

Nëse e marrim shembullin e cekur më lartë, gjykata e vërtetojë se kundërshtimi i të paditurit a është i saktë dhe varësisht nga kjo mundet që ta aprovojë atë kundërshtim dhe të veprojë sipas nenit 391 të LPK, apo ta refuzojë atë.

Nëse në këtë fazë të procedurës refuzohet kundërshtimi i palëve lidhur me pengesat procedurale, vendimin për këtë do të jepet bashkërisht me vendimin për çështjen kryesore. Për këtë vendim gjyqtari i njofton gojarisht palët në seancë, mirëpo atë nuk do ta hartojë në formën e shkruar por do ta përfshijë në aktgjykimin me të cilin vendoset për çështjen kryesore. Kundër këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim i veçantë, por atë mund ta ankimojnë bashkë me vendimin për çështjen kryesore.

6. Zhvillimi i shqyrtimit kryesor në rastet kur nuk është mbajtur seanca përgatitore

Me dispozitën e nenit 425 të LPK është paraparë radha e veprimeve procedurale që merren në shqyrtim kryesor, në rastet kur më parë nuk është mbajtur seanca përgatitore, duke përfshirë edhe radhën e marrjes së provave.

Në këto raste e sipas dispozitës ligjore të lartshënuar shqyrtimi kryesor do të zhvillohet në mënyrën e përcaktuar si më poshtë:

- paditësi jep shpjegime të thukëta rreth kërkesave të parashtruar në padi;
- i padituri në mënyrë të thuktë e paraqet përgjigjen në padi;
- po që se është propozuar marrja e provës me anë të dëgjimit të palëve, së pari pyetet paditësi e mandej i padituri;
- merren në pyetje dëshmitarët, së pari ata të propozuar nga pala paditëse e mandej ata të propozuar nga pala e paditur ;
- merren provat e tjera, përfshirë edhe ekspertimin;
- pas marrjes së të gjitha provave, të dy palët, por së pari paditësi e mandej i padituri, i drejtohen gjykatës me shpjegimet përfundimtare, me të cilat i përmbledhin aspektet faktike dhe juridike të çështjes kryesore;

- gjykata mund t'i lejoj paditësit që shkurtimisht të deklarohet lidhur me fjalën përfundimtare të palës së paditur;
- po që se paditësit i është lejuar deklarimi rreth fjalës së fundit të palës së paditur, atëherë edhe kësaj i lejohet që shkurtimisht të deklarohet rreth thënieve të fundit të palës paditëse.

6.1 Drejtimi i shqyrtimit kryesor

E përbëjnë veprimet procedurale me anë të të cilave gjykata e drejton fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e shqyrtimit kryesor.

Sipas dispozitave ligjore të LPK-së autorizimet për drejtimin e procedurës në shqyrtim kryesor në aspektin proceduralo-juridik dhe materialo-juridik në shkallë të parë i ka gjyqtari i çështjes. Përjashtim nga kjo bën rasti kur kemi të bëjmë për zgjidhjen e martesës dhe në rastet kur objekt shqyrtimi është kërkesa për ruajtje dhe kujdesin ndaj fëmijëve të mitur, në të cilat konteste procedura edhe në shkallë të parë zbatohet nga kolegji (neni 324 i LF).

Shqyrtimi i gjithanshëm i çështjes juridike dhe përfundimi i tij në një seancë gjyqësore është i mundur vetëm nëse gjyqtari i zgjedhë si duhet mjetet dhe mënyrën e drejtimit të gjykimit.

Gjyqtari ka për detyrë që të kujdeset që shqyrtimi kryesor të zhvillohet në mënyrë të rregullt, pa zvarritje dhe pa shtyrje të panevojshme. Këto qëllime mund të arrihen atëherë kur gjyqtari i çështjes kujdeset që në seancën për shqyrtim kryesor të shqyrtohen vetëm çështjet të cilat janë me rëndësi për marrjen e vendimit dhe assesi mos të lejohet që palët me shpjegime dhe parashtrime të panevojshme qoftë gjatë shpjegimeve të padisë apo paraqitjes së përgjigjes në padi, gjatë dëgjimit të dëshmitarëve apo të palëve ose gjatë paraqitjes së fjalës përfundimtare, të ndikojnë në zvarritje të procesit dhe zhvillimit normal të kontestit.

Gjykata ka për detyrë që të kujdeset për mbajtjen e rendit në shqyrtim kryesor që paraqet një nga kushtet për zhvillimin normal të procedurës. Mbajtja e rendit konsiston në pengimin e sjelljeve jo korrekte, jo dinjitoze dhe të pahijshme të secilit që merr pjesë në shqyrtimin kryesor si dhe në ruajtjen e dinjitetit të gjykatës dhe pjesëmarrësve në procedurë. Në këtë fazë të procedurës gjyqtari i çështjes mund të marrë masa ndaj personave të cilët e shkelin rendin në gjykatë ose cenojnë dinjitetin e gjykatës dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë.

6.2 Zhvillimi i procedurës në shqyrtim kryesor

Gjatë shqyrtimit kryesor në përgjithësi veprimet procedurale të palëve dhe të gjykatës ndërmerren gojarisht (palët gojarisht i paraqesin shpjegimet themelore nga padia dhe nga përgjigja në padi, ato gojarisht i paraqesin provat për provimin e fakteve, gojarisht deklarohen lidhur me rezultatin e provave dhe gojarisht e paraqesin fjalën përfundimtare dhe njëkohësisht

edhe gjyqtari i çështjes gojarisht komunikon me palët). Përjashtimisht kur shqyrtimi kryesor nuk zhvillohet gojarisht bëhet në rastet kur personi i shurdhër apo i verbër, për shkak të këtyre hendikepeve duhet që pyetjet apo përgjigjet t'i parashtroj në formë të shkruar.

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesor provat merren drejtpërdrejt para gjykatës përkatësisht para gjyqtarit të çështjes. Përjashtimi nga kjo marrje e drejtpërdrejt e provave bëhet në rastin kur prova është dashur të merret nga gjykata e porositur apo kur është bërë sigurimi i provës para ngritjes së padisë.

Në këto raste prova nuk merret drejtpërdrejt në gjykatë, e cila do të vendosë lidhur me objektin e kontestit por para kësaj gjykate do të lexohen procesverbalet për provat e marra para gjykatës tjetër .

Gjatë fazës së shqyrtimit kryesor palët në shpjegimet e veta duhet t'i parashtrojnë të gjitha faktet në të cilat i mbështesin arsyetimet e propozimeve dhe i propozojnë të gjitha provat me të cilat mendojnë që ti vërtetojnë ato fakte si dhe të deklarohen lidhur me faktet dhe provat e palës tjetër.

6.3 Mundësia e paraqitjes së fakteve të reja dhe propozimit të provave të reja në këtë fazë të procedurës

Ligji i procedurës kontestimore ka paraparë rregullin që faktet të cilat nuk janë theksuar dhe provat të cilat nuk janë propozuar në seancën përgatitore, si rregull, nuk mund të theksohen përkatësisht të propozohen prova të reja.

Përkundër kësaj ky ligj me dispozitën e nenit 428 paragrafi 2 ka paraparë përjashtim nga rregulli i mësipërm. Përjashtime mund të bëhen në rastet kur palët janë në gjendje të provojnë se faktet e reja të cilat i theksojnë dhe provat e reja të cilat i propozojnë në shqyrtim kryesor, pa fajin e tyre nuk kanë mundur ti theksojnë gjegjësisht ti propozojnë në seancë përgatitore.

Disa nga raste të tilla janë paraqit në vijim:

- Pala mund të theksojë faktet e reja nëse kemi të bëjmë me ato fakte të cilat pala nuk e ka ditur dhe nuk ka mundur ti dijë, deri në seancën përgatitore
- Mund të propozoj prova të reja nëse e provon se ato nuk ka mundur ti sigurojë deri në seancën përgatitore (p.sh nëse pala me kohë ka kërkuar nga organi kompetent dokumentin e caktuar apo të dhëna nga regjistri përkatës zyrtar, por të cilat i janë dhënë pas përfundimit të seancës përgatitore).

Në të gjitha rastet gjykata i merr për bazë faktet dhe provat e reja, mirëpo paraprakisht duhet të vërtetohet se pala me fajin e saj faktet dhe provat e reja nuk i ka theksuar më herët. Gjykata nuk ka nevojë që të vërtetojë për këtë dhe nuk ka arsye që faktet dhe provat e reja të mos i merr për bazë me rastin e vendosjes, nëse pala kundërshtarë i pranon faktet e reja dhe nuk i kundërshton ato.

6.4 Mënyra e marrjes në pyetje të palëve në shqyrtim kryesor

Në disa raste paraqitet nevoja që palët të përdoren si mjet i rëndësishëm provues për të vërtetuar ndonjë fakt relevant. Roli udhëheqës në marrjen në pyetje të palëve u jepet përfaqësuesve të tyre (përfaqësuesit me prokurë dhe përfaqësuesit ligjor) si dhe vetë palëve.

Nëse pala ka përfaqësues me prokurë apo përfaqësues ligjor, atë s'ë pari e merr në pyetje përfaqësuesi i saj, e pastaj e pyet pala kundërshtare (neni 430 paragrafi 1 i LPK).

Sipas kësaj rrjedhe ligjore të marrjes në pyetje të palës rezulton që gjykata palën e pyet pasi që ta pyet përfaqësuesi i saj edhe pala tjetër, mirëpo përkundër kësaj gjykata ka autorizime që palën ta pyet në të gjitha fazat e marrjes në pyetjeje (neni 432 LPK).

Në rastet kur pala që dëgjohej nuk ka përfaqësues me prokurë, s'ë pari e pyet gjykata e pastaj pala kundërshtare ose përfaqësuesi i saj. Duhet të kihet parasysh se në të gjitha rastet kur vendoset që të bëhet nxjerrja e provës me dëgjimin e palëve, duhet respektuar rendi ligjor që s'ë pari të pyetet paditësi e mandej i padituri.

Pyetjet palës duhet ti bëhen vetëm në lidhje me çështjen konkrete dhe në rast se pala nuk jep përgjigje në pyetjen konkrete, një sjellje të tillë gjyqtari e vlerëson lirisht. Gjyqtari mund ta ndaloj pyetjen apo përgjigjen në të në qoftë se konstaton se ajo është sugjестive apo nuk ka lidhje me kontestin.

6.5 Rrjedha e marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve në shqyrtim kryesor

Gjyqtari i çështjes së pari ia jep fjalën palës e cila e ka propozuar dëshmitarin apo ekspertin, mandej palës kundërshtare, e më pastaj, po që se ka nevojë, përsëri palës që e ka propozuar.

Palët mundën që personalisht ose përmes të autorizuarve të tyre t'i marrin në pyetje dëshmitarët dhe ekspertët, gjegjësisht t'u bëjnë pyetje dhe të kërkojnë përgjigje nga ta.

Sipas radhës ligjore të përcaktuar me nenin 431 paragrafi 2 të LPK, gjyqtari së pari i jep fjalën palës që e ka propozuar dëshmitarin apo ekspertin, pastaj palës kundërshtare dhe në rast se ka nevojë përsëri palës që e ka propozuar.

Megjithatë, gjykata është ajo që i vërteton faktet vendimtare në të cilat e bazon vendimin e saj dhe për këtë me dispozitën e nenit 432 të LPK-së është paraparë që gjyqtari në të gjitha fazat e marrjes në pyetje mund tu bëjë pyetje palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Përveç autorizimeve nga ky nen, në pikëpamje të marrjes në pyetje të palëve dëshmitarëve dhe ekspertëve, gjyqtari ka autorizim që personave të cilët dëgjohej në këto cilësi tu bëjë pyetje të përgjithshme, tua tërheqë vërejtjen se kanë për detyrë ta thonë të vërteten dhe i pyet palët të cilat nuk kanë përfaqësues me prokurë.

Gjatë drejtimit të shqyrtimit kryesor gjyqtari i çështjes ka këto autorizime ligjore;

- nuk e lejon kryerjen e veprimeve procedurale të cilat nuk janë qenësore për procesin gjyqësor
- nuk lejon të bëhen pyetje në të cilat përmbahen sugjerimet se si duhet dhënë përgjigjja në to (pyetjet sugjestive)
- nuk lejon të bëhen pyetje që janë të parëndësishme për çështjen dhe në të cilat janë dhënë përgjigjet.
- Me kërkesën e palës, në procesverbal regjistrohen pyetjet të cilat nuk i ka lejuar gjyqtari.
- nuk lejon fyerjen dhe shqetësimin e palëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve me rastin e marrjes në pyetje (gjyqtari ka për detyrë ta mbajë rendin në seancën e shqyrtimit kryesor).

Në rastin kur gjyqtari e vlerëson se pyetja e cila bëhet është sugjestive apo e parëndësishme për çështjen nuk e lejon pyetjen, mirëpo nëse ka kërkesë të palës ka për detyrë që atë pyetje ta regjistrojë në procesverbal. Nëse gjyqtari e ndalon pyetjen e tillë apo përgjigjen, për këtë duhet të bjerë vendim. Kjo është bërë me qëllim që gjykata e shkallës së dytë ta vlerësojë arsyeshmërinë e marrjes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë për mos lejimin e bërjes të pyetjes së caktuar dhe nëse ky vendim ka ndikuar në vërtetimin jo të plotë të gjendjes faktike.

6.6 Përfundimi i shqyrtimit kryesor dhe fjala përfundimtare e palëve

Pasi janë shqyrtuar provat e paraqitura nga palët dhe që gjykata ka pranuar marrjen e tyre, gjykata i fton palët për të parashtruar pretendimet e tyre përfundimtare rreth çështjes në gjykim. Në fjalën përfundimtare palët bëjnë vlerësimin e gjithë materialit procedural, e formulojnë kërkesën që gjykata ta jep vendimin përfundimtar dhe arsyetojnë atë në pikëpamje juridike.

Në fjalën përfundimtare palët duhet që vetëm të paraqesin rezyme dhe të nënvizojnë në lidhje me atë që është theksuar gjatë shqyrtimit, dhe në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që të paraqiten fakte apo propozime të reja dhe ndryshim i kërkesëpadisë.

Si rregull fjalën përfundimtare palët e paraqesin gojarisht, por paraqitja në këtë mënyrë nuk përbënë detyrim ligjor për palët. Ngase, siç edhe ndodhë në disa raste në praktikë, me kërkesën e palëve, gjykata mund t'u japë atyre një afat (p.sh, 5 ditë) për të paraqitur fjalën përfundimtare në formën e shkruar.

Në fjalën përfundimtare të palëve në fillim e merr fjalën paditësi dhe pastaj i padituri. Kur merr pjesë ndërhyrësi kryesor, ai e merr fjalën pas të paditurit. Ndërsa kur merr pjesë ndërhyrësi në anën e paditësit ai e merr fjalën pas tij. Po kështu vepron edhe te ndërhyrësi në anën e të paditurit. Të gjithë këtyre u është lënë mundësia që shkurtimisht të deklarohen lidhur me fjalën përfundimtare të njëri tjetrit.

PJESA E KATËRT

I. INTERPRETIMI SI KOMPONENTË E RËNDËSISHME PËR SHKRIMIN DHE ARSYETIMIN LIGJOR

Zbatimi i drejtë i ligjit është bazë për sundimin e ligjit në çdo shtet. Shteti ligjor, konsiderohet ai i cili mundëson që zbatimi i ligjit të jetësohet nga qytetarët dhe të mbrohet nga gjyqësori. Procesi i zbatimit të normës juridike është mjaft i ndërlikuar, sepse përbëhet prej shumë veprimesh psikike dhe fizike (mendore dhe trupore). Nëpërmjet këtij procesi e drejta synon që në radhë të parë të saktësojë normën sipas së cilës subjekti do të sillet dhe pastaj që sjellja përkatëse të zbatohet. Në teorinë juridike ekzistojnë pikëpamje për fazat nëpër të cilat kalon procesi i zbatimit të normës juridike. Sipas një pikëpamje procesi i zbatimit të normës juridike kalon nëpër katër faza: faza e njohjes së normës juridike, faza e interpretimit të normës juridike, faza e kualifikimit të rastit konkret dhe faza e realizimit të normës juridike nëpërmjet veprimeve njerëzore.

Faza e njohjes së normës juridike - përfshinë njohjen me tekstin autentik të normës juridike nga edhe mund të njihemi me dy aspekte të normës, aspektin kohor dhe hapësinor të saj.

Faza e interpretimit të normës juridike - përfshinë njohjen me përmbajtjen-porositë e ligjvënësit, se çfarë kërkon ai-çfarë sjellje duhet parashikuar se çfarë efekti duhet të arrihet më normën përkatëse juridike. Në këtë fazë bëjmë zbulimin e domethënies së normës juridike. Kjo fazë i përket sqarimit të normës duke caktuar sa më afër sjelljen konkrete të subjektit për rastin konkret. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për fushën e së drejtës civile sepse rëndom normat në këtë fushë janë shumë të përgjithshme dhe abstrakte brenda së cilave duhet gjetur zgjidhja e shume rasteve.

Faza e zbatimit të normës juridike - përfshin nevojën që të kemi vlerësim të thuktë lidhur me faktet relevante të rastit konkret dhe natyrisht që të bëhen përpjekje për të gjetur normën juridike e cila do të zgjidhte rastin në mënyrë më të drejtë - pra, norma juridike e cila rastin konkret e rregullon, ose e zgjidhë-paraqet fazën të cilën ne e quajmë kualifikimi i rastit konkret.

Faza e realizimit të normës juridike - përfshinë sjelljen e subjekteve sipas normës-sipas porosisë që norma juridike bartë në vete. Pra, në këtë mënyrë, përfundimisht themi se sjelljet e subjekteve janë në pajtueshmëri apo në kundërshtim me të drejtë në aspektin e zbatimit të akteve juridike dhe të akteve materiale të parapara paraprakisht me normën juridike.

Në procesin e zbatimit të normës juridike interpretimi i normës juridike përbënë një fazë të rëndësishme të zbatimit të normës juridike (fazën e dytë në procesin e zbatimit të normës juridike).

Në plan të parë dhe në rend të parë qëndron interpretimi i ligjit. Me këtë nuk nënkuptohet asgjë tjetër përveç të kuptuarit e teksteve të normave. Interpretimi është kusht i zbatimit të normës, dhe mund të themi se është aktivitet mjaft delikat që i paraprinë aplikimit të së drejtës. Interpretimi është një proces mjaft kompleks, me anën e të cilit bëhet transmetimi i brendisë së vetëdijes e cila mund të mos vërtetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, atëherë domosdoshmërisht duhet të shërbehemi me shenjat materiale të cilat mundësojnë këtë transmetim nëpërmjet Kodit të domethënies (kuptimeve). Gjatë kësaj faze duhet të kemi kujdes në analizimin e tri gjërave të rëndësishme:

- Krijuesi i së drejtës nëpërmjet normës shpreh domethënien të cilën ua dedikon subjekteve tjera, madje, qoftë edhe nëpërmjet shenjave të ndryshme;
- Subjekti i cili ushtron interpretimin-sqarimin e normës duke pranuar apo edhe duke caktuar një domethënie të normës; dhe
- Domethënie të cilin mund ta vërtetojmë apo ta caktojmë në bazë të shenjave ose Kodit të domethënies.

Nga analiza e mësipërme rrjedhë se kemi më shumë domethënie të normës juridike të cilat jo gjithmonë përputhen. Nga kjo rrjedh se është një proces shumë delikat për të vërtetuar saktësinë e domethënies së normës juridike, prandaj ky proces ndihmohet edhe me një mjetesh-metodash vetëm për të vërtetuar brendinë e vetëdijes të cilin krijuesi e ka shprehur në normën juridike.

Në Kosovë vitet e fundit ka ndodhur një ndryshim rrënjësor i legjislacionit në fushën civile e që për pasojë ka ndikuar që praktika gjyqësore të pësojë luhatje në kuptimin mos zbatimit unike të normave juridike.

Secili gjyqtar duhet të njohë mënyra dhe metodat e interpretimit si parakusht për zbatimin e drejtë të normës juridike me të cilën identifikohet ligjshmëria e vendimeve gjyqësore. Nevojën për njohjen e mënyrave dhe metodave të interpretimit përveç se e dikton detyrimi për zbatimin e drejtë të normës juridike, në rastin tonë e dikton edhe nevoja që për shkak të shume ligjeve të reja të vendoset me kohë standardi i zbatimit unik të normave juridike si parakusht për ligjshmërinë vendimeve dhe besimin e publikut në gjyqësorë.

Në teorinë juridike edhe pse pothuajse të gjithë autorët trajtojnë metodat e njëjta të interpretimit, megjithatë ekzistojnë dallim sa i përket metodave të interpretimit dhe rëndësisë së tyre. Ne duhet ta kemi në konsideratë se interpretimi si proces është evolutiv dhe ndikohet nga faktor të ndryshëm që e diktojnë krijimin e së drejtës apo edhe mënyrën e zbatimit të së drejtës.

Në teorinë juridike llojet e interpretimit kryesisht përmenden interpretimi legal, gjyqësor dhe doktrinar.

1. Llojet e interpretimit

Interpretimi legal-Interpretimi legal nënkupton interpretimin që i bëhet normës nga organi që e ka miratuar normën. Duhet theksuar se në sistemin tonë të së drejtës nuk ekziston interpretimi

legal i normës juridike, pra më tepër interpretimi legal është një lloj i interpretimit që i përket të kaluarës.

Interpretimi gjyqësor- është interpretimi që bëjnë gjykatat me rastin e zbatimit të ligjit në rastin për të cilin gjykata vendosë. Ky lloj i interpretimit vlen vetëm për rastin konkret dhe nuk është i obligueshëm për rastet tjera. Për shkak të rasteve të shumta të cilat kërkojnë mbrojtje gjyqësore në gjykata është e rëndësishme që të sigurohemi që gjykatat të bëjnë interpretim të saktë në raste konkrete, e gjithashtu që gjykatat të jenë unike në interpretimin dhe zbatimin e normës. Ka njëfarë dallimi në mes të interpretimit të gabuar gjyqësorë dhe interpretimit jounik në mes të gjykatave, në kuptimin e pasojës që shkaktohet. Në qoftë se nuk sigurohet saktësia e interpretimit gjyqësor do të fitonim interpretim të gabueshëm, që potencialisht përbënë shkelje të së drejtës në një rast konkret, ndërsa në qoftë se nuk sigurohet uniteti i interpretimit gjyqësor bëhet shkelja e barazisë së qytetarëve dhe sigurisë juridike të tyre. Për të evituar mundësinë e interpretimit të jo të saktë dhe jo unik ekziston/parashihet kompetenca e Gjykatës Supreme të Kosovës për të vlerësuar përmes mjeteve të jashtëzakonshme ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të instancave më të ulëta e gjithashtu kompetenca e kësaj gjykate për të përcaktuar qëndrime parimore dhe mendime juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykata në territorin e Kosovës.

Interpretimi doktrinar - ekziston atëherë kur zbulimin e domethënies së vërtetë të normës juridike e bënë shkenca juridike në punimet e tyre shkencore (tekstet, monografi, komentat, komente të vendimeve gjyqësore, etj, dhe ky lloj i interpretimit nuk i obligon të tjerët e as vet gjykatën e cila e zbaton normën juridike. Rëndësia dhe kontributi i shkencës juridike në këtë aspekt është tejet i madh. Edhe pse nuk shërben për ta zbatuar të drejtën në mënyrë të drejtpërdrejtë, interpretimet e saj kanë rëndësi të madhe për shkak se shkenca vepron në mënyrë të pavarur prej çdo zbatimi konkret. Shkenca juridike mund ta bëjë një vështrim me të gjerë e në një mënyrë më të plotë e më të qetë dhe objektive, t'i vërej çështjet përkatëse dhe në këtë drejtim të gjejë zgjidhje më të drejta.

Përveç llojeve të interpretimit gjatë procedurës së interpretimit, interpretuesi përdorë mjete të llojllojshme për të gjetur/përcaktuar kuptimin e vërtetë të normës juridike.

2. Metodat e interpretimit

Lidhur me metodat e interpretimit në teorinë juridike të gjithë autorët u referohen metodave të përafërta por jo sipas një renditje unike. Në vijim paraqiten në pika të shkurtëra disa prej metodave të interpretimit, pa u nisur nga ideja se metodat e paraqitura në vijim janë të vetmet.

2.1 Interpretimi gjuhësor (sipas tekstit)

Interpretimi gjuhësor është interpretim i pakalueshëm për shkak të rëndësisë së madhe dhe i paraprinë çdo lloji tjetër lidhur me vërtetimin e domethënies së drejtë të normës juridike. Të gjitha normat juridike shprehen me anë të gjuhës, d.m.th, me anë të rregullave gjuhësore siç janë: fjalët, grumbullimi i fjalëve, fjalitë dhe shenjat e interpunksionit. Me interpretimin gjuhësor vërtetohen të gjitha domethëniet e mundshme gjuhësore të normës, por me të asnjëherë nuk mund të vërtetohet në mënyrë të besueshme edhe domethënia e drejtë e saj. Me interpretim gjuhësor është i lidhur ngushtë edhe interpretimi logjik, meqë gjuha juridike është edhe gjuhë logjike, për dallim prej asaj poetike, fetare etj.

Gjuha është shpesh e pasaktë dhe përpjekja për zbulimin e kuptimit fillohet nga interpretimi i tekstit, por menjëherë shtrohet çështja e kriterit: a duhet gjatë të kuptuarit të një nocioni juridik (“fëmijë”, “lëndim trupor”, “posedim”, “ndërtesë”) ta marrim si pikënisje gjuhën juridike, gjuhën profesionale përkatëse (për “lëndimin trupor” për shembull atë mjekësor) apo madje edhe gjuhën e përditshme? Nocionet e përdorura në ligj janë nocione juridike. Në këtë rast arrihen suksese, sepse ligjet shpesh përmbajnë të ashtuquajtura defenicione ligjore. Kështu për shembull nga neni 103 i Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore del se me nocionin “posedim” duhet të nënkuptohet pushteti faktik i një subjekti mbi një send. Kurse në jetën e përditshme shpesh fliste për “posedimin” kur është fjala për “pronësinë”. Krahaso kuptimin e nocioneve ligjore në mes të “posedimit” (nenin 103 Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore) dhe “pronësisë” (neni 18 Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore). Kur mungojnë përkufizimet ligjore të nocioneve - edhe elementet e tyre mund të kërkojnë një interpretim!- në rast dyshimi duhet të nisemi nga kuptimi i zakonshëm.

Praktika njeh shumë raste kur një norme i jepet kah tjetër nga ai që është dashur, përdorimi i një shenjë fjalisë ja ndërron kuptimin. Apo, rëndësi të veçantë ka përdorimi i lidhëzave “edhe”, “apo”, “ose”. Nga e tëra kjo del konkluzioni se interpretimi gjuhësor has në vështirësi të mëdha, sepse rrethanat shoqërore ndryshojnë dhe në këtë drejtim kodi i domethënieve nuk mund të jetë i përcaktuar definitivisht, por ai evoluon së bashku me rrethanat shoqërore.

Interpretimi gjuhësor në vetvete bartë shumë elemente të ndërlikuara dhe për këtë arsye mund të bëhet një ndarje të interpretimit në grupe të ndryshme si: interpretimi subjektiv dhe objektiv, i lidhur dhe i lirë, ekstenziv dhe restriktiv dhe interpretim statik dhe evolutiv.

Interpretimi subjektiv- qëndron në ngajshmërinë e kuptimit të drejtë të normës juridike me domethënien të cilën ka dashur t’ia caktojë krijuesi i normës juridike, respektivisht atë që e ka pasur për krijuesin e vet në momentin e krijimit ose atë që e ka në momentin e interpretimit.

Interpretimi subjektiv insiston që interpretuesi të depërtojë në psikikën-vullnetin e krijuesit të normës, çfarë ka dëshiruar ai të shpreh me normën juridike. Vullneti i krijuesit të normës duhet të kërkohet brenda normës juridike. Sipas këtij interpretimi / teorieje me rëndësi është çka ka menduar ligjvënësi e jo çka mendojmë ne sot për atë çështje. Nëse i përmbahemi interpretimit

subjektiv si domethënie të drejtë të normës duhet ta konsiderojmë atë domethënie të cilën krijuesi ka dashur t'ia japë e jo njëres prej atyre që norma e ka. Kjo do të thotë tejkalim i caqeve të interpretimit, sepse interpretimi konsiston në zbulimin e kuptimit të drejtë në mesin e atyre të cilat nga ana gjuhësore janë të mundshme.

Interpretimi subjektiv është i lejueshëm vetëm në suaza të interpretimit objektiv, d.m.th., në suazat e domethënies gjuhësore nga kodi i kuptimeve.

Të interpretimi subjektiv si pyetje kryesore parashtrohet ekzistimi dhe rëndësia e të ashtuquajturit vullnet i krijuesit të normës. Në qoftë se do të merrej se ky vullnet ekziston në atë aspekt që ai ka pasur të njohur të gjitha domethëniet e mundshme gjuhësore të normës të cilën e krijon dhe në mesin e të gjithave ka dashur që ajo të ketë vetëm një domethënie të caktuar, atëherë kjo aprovet pa dyshim si e vërtetë, pa marrë parasysh arsyet të cilat përmendën kundër interpretimit subjektiv dhe në bazë të asaj që krijuesi i normës nuk shpreh vullnetin e vet, por vullnetin e ndonjë subjekti tjetër.

Në qoftë se krijuesi i normës me të vërtetë shprehë vullnetin e vet, e jo të huajin, atëherë domethënia të cilën ai ia jep normës është vendimtare, me disa kufizime të cilat vijnë në shprehje sidomos në interpretimin sistematik.

Interpretimi objektiv- qëndron në drejtim tjetër, në të vërtetuarit e domethënies së drejtë të normës juridike. Ky lloj interpretimi si domethënie të drejtë të normës juridike e konsideron atë domethënie e cila në momentin e interpretimit norma juridike përmbajnë- pra domethënie të cilën e shprehë vetë norma. Një qasje e tillë i përgjigjet edhe ekzistimit të së drejtës, sepse e drejta është produkt i shoqërisë dhe si e kështillë i shërben asaj, natyrisht duke mbrojtur interesat publike- interesat shoqërore në përgjithësi, pastaj e tërë ajo që ka të bëjë në fakt me vullnetin apo dëshirën e krijuesit duhet të vihet në kontekst të përgjithshëm- jo- në aspektin subjektiv, çfarë ka dëshiruar-por- çfarë shprehë dhe mbron norma përkatëse juridike. Një përfaqësues i teorisë objektive të interpretimit thotë: Për interpretimin e përmbajtjes dhe suazat e një norme juridike nuk vjen në shprehjeje ekskluzivisht pasqyrimi mbi qëllimin e saj të cilin ligjvënësi e ka pasur në kohën e nxjerrjes së tij, por detyra e interpretimit është ta kuptojmë normën juridike me realitetin e gjallë me marrëdhëniet empirike dhe idetë e qëllimit të kohës së sotme. Vetëm atëherë norma juridike mbetet në pajtim me idenë e së drejtës, paraqitet si shprehje e të menduarit objektiv.

Interpretimi i lidhur- është atëherë kur interpretuesi është i lidhur në fakt me domethënien e mundshme, domethënë me njërin prej dy domethënieve të mundshme gjuhësore për t'ia caktuar domethënien e drejtë normës juridike, madje, nëse është e mundshme, që në këtë drejtim të bazohet vetëm në njërin domethënie të mundshme gjuhësore.

Interpretimi i lirë- është atëherë kur interpretuesi është i lirë në caktimin e domethënies së drejtë të normës juridike, është i lirë që domethënia e normës juridike ta caktojë pavarësisht prej domethënieve të mundshme gjuhësore. Interpretuesi është i lirë t'ia caktojë normës juridike domethënien të cilën ai mendon se është e nevojshme, pavarësisht se në aspektin gjuhësor është e

pamundur. Kjo mënyrë e interpretimit në fakt nuk paraqet interpretim të normës juridike, por paraqet krijimin e normës së re juridike.

Interpretimi ekstenziv- është njëri ndër interpretimet, i cili për zbulimin e domethënies së vërtetë të normës, kërkon që ajo të sqarohet, duke bërë zgjerimin e normës juridike sepse norma juridike është e paqartë për shkak se është e ngushtë. Në këtë rast, domethënia e vërtetë e normës juridike bëhet duke e zgjeruar kuptimin e saj, p.sh., nëse ligji thotë “*send*” është çdo gjë që mund të preket por jo objekt i të drejtës së pronësisë, p.sh., valët e telefonave, ose rryma, prandaj, në vend të fjalës që preken duhet të jetësohet fjala “*që zotërohen*”. Prandaj, valët e telefonit edhe pse nuk mund të preken ato janë pronësi e personit juridik të caktuar. Interpretimi ekstenziv ka të bëjë me faktin se ligjvënësi i cili ka përdorur shprehjen në normën juridike, e ka përdorë atë shprehje “*të caktuar*” duke menduar që të shprehë atë që edhe e ka dëshiruar, por në të vërtetë nuk ka arritur, sepse shprehja është e mangët. Pra interpretimi i këtillë i normës juridike, ku zgjidhet papërputhshmëria ndërmjet shprehjes së pamjaftueshme dhe domethënies logjike të gjerë të normës, quhet interpretim ekstenziv-i gjerë.

Interpretimi restriktiv- është interpretimi i cili sqarimin e normës juridike e cila është e gjerë, e bënë duke e ngushtuar kuptimin e saj. Kjo ndodhë në rastet, kur një normë është e përgjithshme dhe si e tillë nuk është e qartë me rastin e zbatimit atëherë duhet të fillojë ngushtimi i saj që të del kuptimi i vërtet i normës juridike. P.sh., Kushtetuta thotë “*çdo kush ka të drejtë dhe detyrim, të kryej shërbimin ushtarak*” dhe nëse kjo dispozitë do të interpretohet pa u sqaruar, del se çdo qytetar duhet ta dërgojmë në kazemat ushtarake.

Interpretimi statik- konsideron në vërtetimin e asaj domethënie të normës juridike, të cilën norma e ka pasur që në momentin e krijimit. Sepse, me anë të interpretimit s’mund të ndryshohet norma juridike, andaj interpretimi statik mendohet se garanton sigurinë juridike, sepse nuk e jep domethënien e re dhe nuk krijohen mundësi që normës juridike t’i caktohen domethënie tjetër, që norma juridike nuk e ka.

Interpretimi evolutiv- ekziston atëherë kur si domethënie të drejtë të normës juridike konsiderojnë atë domethënie të cilën norma e ka në momentin e interpretimit. Pra duhet kuptuar se domethënia e normës ka pësuar ndërrime prej momentit të krijimit deri në momentin e interpretimit. Interpretimi evolutiv mund të jetë vetëm në qoftë se domethënia ka ndryshuar me kalimin e kohës. Interpretimi evolutiv shpesh herë keqkuptohet sepse me të nuk ndryshohet norma juridike, ose domethënia e normës juridike, për faktin se janë ndryshuar edhe rrethanat shoqërore. Kjo është e papranueshme, sepse në fakt, do të kishim krijim të së drejtës së re, krijim të normës së re.

2.2 Interpretimi logjik

Interpretimi logjik paraqitet në procesin e interpretimit gjuhësor, sepse përmbajtja gjuhësore në aspektin logjik duhet të jetë e drejtë. Me interpretimin logjik nënkuptojmë caktimin e

domethënies së drejtë të normës juridike më anë të logjikës në domethënien e fituar kryesisht nga interpretimi gjuhësor, por edhe nga llojet tjerat të interpretimit. Me anë të interpretimit logjik arrihen dy rezultate. Së pari, me të përcaktohet se a është i mundshëm kuptimi i fituar me llojet tjera të interpretimeve, në aspektin logjik. Në rast se vërtetohet se në aspektin logjik nuk është i mundshëm, atëherë norma konsiderohet si me pakuptim. E dyta, nga norma nxirret ajo domethënie e cila nuk mund të fitohet me anë të interpretimit gjuhësor apo me ndonjë interpretim tjetër, e veçanërisht me atë gjuhësor, d.m.th. nga norma nxirret me tepër sesa tregon domethënia e saj gjuhësore. Rezultati i parë i interpretimit logjik ka të bëjë me kontrollin e saktësisë së kuptimit të fituar me interpretimet tjera, e sidomos me interpretimin gjuhësor, duke e shqyrtuar rregullsinë logjike të saj, ndërsa rezultati i dytë ka të bëjë me gjetjen e kuptimeve të reja, të cilat nuk mund të fitohen me anë të mjeteve tjera të interpretimit.

Interpretimi logjik ushtrohet me ndihmën e ligjeve të logjikës: ligji i mosekzistimit të kundërthënieve, ligji i identitetit dhe përjashtimi i të tretit. Nëpërmjet këtyre ligjeve logjike arrihet rregullsia gjuhësore dhe saktësia e mendimit tonë. Pra, me ndikimin e ligjeve të logjikës është formuar e ashtuquajtura, logjika juridike, si mjet me anë e secilës, duke medituuar, interpretohen jo vetëm në mënyrë të drejtë të normës juridike –por edhe rastet kur norma juridike nuk ekziston, që nëpërmjet hulumtimeve përkatëse të krijohet dhe nënkuptohet ajo.

Gjatë ushtrimit të interpretimit logjik janë formuar disa parime të logjikës, siç janë: përfundimi nga kundërthëniet, përfundimi nga e vogla në të madhën dhe përfundimi nga e madhja në të voglën.

Përfundimi nga kundërthëniet qëndron në sjelljen tjetër, nga vlerësimi i saktë dhe kategorik nxirret vlerësimi i kundërt-sjellja përkatëse përqendrohet kundër sjelljes e cila është paraparë paraprakisht me normën juridike, p.sh., rregulla e cila e “*ndalon vërtetimin e atësisë*” përfundimi i kundërt do të ishte se: “*lejohet vërtetimi i atësisë*” nga të gjithë të interesuarit, d.m.th., të gjithë subjektet që kanë interes për këtë.

Përfundimi logjik nga e vogla në të madhën do të ishte: “*ndalohet pengimi i shfrytëzimit të pronës*”, nga përfundimi i tillë del mendimi i arsyeshëm se: “*aq më shumë ndalohet uzurpimi i pronës së paluajtshëm*”.

Përfundimi i tretë logjik i përket lëvizjes së arsyeshme nga e madhja në të voglën. Për shembull, “*lejohet ndërtimi i një godine të lartë*” nga përfundimi i këtillë del gjykimi se në vendin përkatës mund të ndërtohet godina edhe më e thjeshtë (e vogël).

2.3 Interpretimi sistematik (sipas kontekstit)

Interpretimi sistematik qëndron në caktimin e domethënies së drejtë të normës juridike me anë e lidhjes së normës me të gjitha normat të cilat si tërësi e përbëjnë sistemin juridik. Metoda sistematike (sistematike logjike) e interpretimit merr në përgjithësi në shqyrtim gjithë rendin juridik dhe përpiket në këtë mënyrë të arrijë te një kuptim i nocionit, i cili përshtatet me ambiguitet sa më të vogël në sistemin e përgjithshëm. Këtë e nënkupton fraza unitet i rendit juridik. Në këtë rast ndihmon shumë krahasimi me normat me përparësi për nga ana formale dhe përmbajtësore. Në këtë mënyrë për secilin duhet të jetë e qartë se gjatë alternativave të shumta e

interpretimit, më parë duhet të zgjidhet ajo që përputhet me një parim themelor të fushës përkatëse ligjore ose me një urdhër kushtetuese (për shembull me parimin e barazisë). Në këtë frymë është edhe propagandimi (me të drejtë) i interpretimit në pajtim me kushtetutën të metodës sistematike: pra, në rast dyshimi nuk mund të pandehimi se ligjvënësi ka miratuar norma ligjore kundër kushtetuese.

Në kuadër të interpretimit në pajtim me kushtetutën, zbatuesi i ligjit duhet t'i marrë parasysh në përputhje me rrethanat veçanërisht edhe të drejtat themelore, p.sh., parimin e barazisë ose garantimin e pronësisë. Vërtetë është e njohur se të drejtat themelore- të cilat në fillim janë konceptuar si mbrojtje ndaj shtetit që vepron si sovran-parimisht nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë horizontal, pra nuk veprojnë në marrëdhëniet civilo-juridike midis njerëzve privat. Për shkak se hapësira e lirisë që është krijuar përmes të drejtave themelore nuk rrezikohet vetëm prej shtetit, por edhe prej qytetarëve të tjerë apo grupeve private, ligjvënësi dhe organet e tjera shtetërore duhet të kujdesen për një ekuilibër të drejtë mes sferave përkatëse të lirisë (i ashtuquajtur i funksion garantues i të drejtave themelore). Prandaj edhe gjykatat duhet t'u kushtojnë vëmendje gjatë interpretimit të normave të së drejtës private) dhe sidomos gjatë konkretizimit të klauzolave të përgjithshme, si p.sh., gjatë gjykimit të shkeljes së parimeve etike-parimet bazë ligjore. Në këtë kontekst flitet për efektin indirekt të të drejtave themelore.

Normat sipas përmbajtjes zënë pozitë e caktuara dhe mund të ushtrojnë ndikim në caktimin e kuptimit të normave të tjera që kanë pozitë më të ulët në hierarkinë e normave juridike. Në këtë mënyrë kemi caktimin e vendit të normës juridike sipas aktit në të cilën gjendet norma dhe vendit që norma ka në aktin juridik. Interpretimi sistematik, duke pasur parasysh këto segmente, mund të ushtrohet në dy mënyra: në bazë të vendit që ka norma dhe sipas lidhshmërisë së përmbajtjes së normës.

Me caktimin e vendit të normës u shmangemi kundërrthëniet në mes të normave dhe akteve të ndryshme, kurse me lidhshmërinë sipas kuptimit më lehtë caktojmë domethënien e normës.

Aktet juridike mund të jenë të llojllojshme dhe të ndërlidhura, duke filluar nga kushtetuta, ligji dhe aktet e tjera, ku gjenden apo kanë pozitë të ndryshme normat juridike, por pjesa më e rëndësishme është përmbajtja e normës, andaj nga interpretimi sistematik ka rëndësi interpretimi i brendshëm i normës në zbulimin e domethënies sipas lidhshmërisë së përmbajtësore.

Lidhshmëria e normave sipas përmbajtjes së vetë varet prej rastit konkret i cili ngjanë në shoqëri, p.sh., nëse interpretojmë ndonjë normë lidhur me martesën apo marrëdhëniet e prindërve dhe fëmijëve, si edhe ato marrëdhënie të cilat janë në lidhje të ngushtë apo me të largët, norma duhet të interpretohet brenda sistemit përkatës- duke i përfshirë normat e akteve më të afërta për nga përmbajtja, aq më tepër nëse ato i ka krijuar subjekti i njëjtë dhe në kushte të përafërta.

Në domethënien e normës juridike në radhë të parë ndikojnë normat të cilat së bashku me të krijojnë aktin juridik, pastaj normat e akteve tjera, të afërta me aktin norma e të cilit interpretohet.

2.4 Interpretimi historik (sipas historisë së krijimit)

Ligjvënësi në çdo normë e ndjekë një qëllim të caktuar (së paku do të duhej të ishte kështu). Nëse konstatohet kjo, atëherë është arritur shumë për kuptimin e së drejtës. Pyetja lidhur me “*pse-n*” e një rregulle konkrete përfshinë dy aspekte të veçanta: këtu bëhet fjalë për qëllimin subjektiv të ligjvënësit (që dallohen prej qëllimeve objektive). Me studimin e tij (qëllimit) merret interpretimi historik. Ndhimesë qendrore gjatë kësaj japin të ashtuquajturat materiale ligjore, të cilat sot gjenden për çdo ligj qoftë përmes komentareve të ndryshëm, raporteve të komisioneve, dhe procesverbalet e mbledhjeve të komisioneve dhe vetë ligjvënësit.

Lidhur me hulumtimin e domethënies së drejtë të normës juridike, interpretimi historik luan rol të rëndësishëm, sepse normat juridike kanë momentin e krijimit, zhvillimit në kushte të caktuara shoqëro-historike dhe si të tilla edhe përmbahen. Interpretimi historik është i rëndësishëm sepse pa të nuk mund të zbulohet domethënia e drejtë e normës juridike, pavarësisht se norma i nënshtrohet interpretimit gjuhësor, logjik, madje edhe ati sistematik.

Të gjitha rrethanat mund të jenë të rëndësishme për caktimin e domethënies së drejtë të normës, e sidomos caktimin e qëllimit dhe të rolit të saj në shoqëri. Por, nuk duhet harruar se historia e normës është diçka në vete, ndërsa e tashmja është diçka tjetër dhe se norma e cila dikur ka pasur një qëllim tani mund të ketë qëllim tjetër, në pajtueshmëri me ndryshimet shoqërore. Sipas kësaj del se interpretimi historik nuk ka përfundim- kur të caktojme se çfarë ka treguar norma për kohën e caktuar, gjithnjë duhet të kontrollojmë saktësinë se a thua edhe sot norma ka mbajtur në vete atë domethënie të cilën e ka pasur apo jo.

2.5 Interpretimi qëllimor

Interpretimi qëllimor në vazhden e interpretimeve me anën e të cilit synohet që të gjendet domethënia e drejtë e normës juridike-nëpërmjet qëllimit, paraqet mjetin e fundit, pra interpretimi qëllimor është përfundimtar. Sipas, kësaj konkludojm se të gjitha llojet e tjera të interpretimeve në zbulimin dhe vërtetimin e domethënies së mundshme të normës juridike janë hyrëse.

Ekzistojnë së paku dy arsyeje të rëndësishme pse qëllimi i ligjvënësit të parë nuk është gjithçka: gjatë procesit ligjvënës nuk vlerësohen të gjitha pasojat tërësisht. Por edhe rrethanat shoqërore apo ekonomike – pra më këtë rregullisht edhe ato juridike- të një dispozite mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Kjo vlen sidomos për ligjet e “*vjetra*”. Prandaj, pikëpamjes se pastër historike i shtohet edhe pikëpamja për të gjetur kuptimin aktual të një rregulli. Kriter gjatë përpjekjeve të këtilla për gjetjen e kuptimit sa më të drejtë është gjithë rendi juridik bashkë me parimet e tij themelore. Kjo pikë referuese dalluese gjatë interpretimit të ligjeve të vjetra mund të

na qojë të përfundimet që largohen nga idetë e ligjvënësit historik. Atëherë vullneti i parë ligjvënës është “*i tejkaluar*”, për këtë arsye edhe nuk ekziston (më) rëndësi qendrore.

Qëllimi objektiv i normës mund të identifikohet kur e vëmë në lidhshmëri me pasojat të cilat norma i nxit në jetën tonë shoqërore, me ndikimin, funksionimin dhe rolin e vet. Pasojat mund të jenë pozitive dhe negative. Detyrë e interpretimit qëllimor është të vërtetojë qëllimin e normës- e ky qëllim ka karakter sociologjik, sepse qëllimi s’është kategori normative –por kategori sociologjike. Meqë norma mbron një vlerë të caktuar, ndërsa në anën tjetër, siç kemi thënë më herët norma në aspektin gjuhësor ka së paku dy domethënie të mundshme, atëherë interpretuesit i ngel për detyrë që të caktojë njëren prej domethënieve të mundshme dhe të bëjë përpjekje që ta caktojë atë domethënie e cila më së miri mbron interesin publik.

2.6 Analogjia

Analogjia paraqet mënyrën kryesore të interpretimit të gjerë, me anën e të cilës plotësohen zbraktësirat juridike. Analogjia paraqet interpretimin sipas ngjashmërisë. Në procesin e interpretimit në kuptimin e gjerë e domosdoshme është të vërtetohet ngjashmëria ndërmjet rasteve, pastaj nëpërmjet interpretimit të normës juridike e cila rregullon rastin e ngjashëm sqarohet domethënia e cila zbatohet apo përdoret për rastin i cili s’është rregulluar me normë juridike. Për shembull, “*prindërve u lejohet mohimi i atësisë sipas ligjit*”, ndërsa për trashëgimtarët s’është thënë asgjë, atëherë sipas analogjisë – edhe – trashëgimtarëve u lejohet mohimi i atësisë, domethënë u lejohet të aplikojnë të njëjtën normë juridike. Kjo do të thotë se edhe fëmijëve u u lejohet mohimi i atësisë-aplikimi i analogjisë. Thënë thjeshtë për aplikimin e analogjisë duhet të plotësohen dy parakushte dhe atë ekzistenca e një zbraktësie në rregullin ligjor dhe shfrytëzimi i rregullit për raste të ngjajshme. A ekziston në të vërtetë një zbraktësi, kjo shpesh duhet të vendoset duke marrë parasysh rregullat interpretuese. Nëse ligjvënësi e ka bërë të qartë dallimin, prej kësaj rezulton moszbatimi përfundimtar i normës së marrë për shqyrtim në bazë të interpretimit anasjelltas (argumentum e contrario): meqë nuk ka gjendje faktike, nuk ka as pasojë ligjore. Vetëm nëse mangësia është e paqëllimtë duhet të merret në shqyrtim analogjia. Kriteret për ngjajshmërinë ligjore duhet të rezultojnë nga tërësia e normave të tjera të rendit juridik.

Analogjia mund të jetë: analogji ligjore dhe analogji juridike.

Analogjia ligjore ka të bëjë me zbatimin e domethënies e cila fitohet me interpretimin e një norme nga akti përkatës që mund të plotësojë zbraktëriten sipas ngjashmërisë së rasteve, ndërsa analogjia juridike ka të bëjë me zbatimin e domethënies e cila gjendet me interpretimin e parimeve të përgjithshme juridike.

Ka edhe mendime sipas të cilave bëhen dallime edhe tjera të analogjisë: analogjia e pjesërishme dhe e plotë. Të analogjia e pjesërishme norma e përgjithshme përbëhet nga normat e veçanta,

kurse analogjia e plotë përfitohet nga “*fryma*” e tërë sistemit juridik dhe paraqet parimin e përgjithshëm juridik.

Gjatë aplikimit të analogjisë ligjore norma e përgjithshme nxirret në bazë të një rasti, analogjia e pjesshme juridike bazohet në shumë raste, ndërsa analogjia e plotë në të gjitha rastet e mundshme të cilat e drejta i rregullon.

Argumentum a Contrario (arsyeja e kundërt)

Analogjia është në lidhje të ngushtë me të ashtuquajturën argumentum a contrario apo arsyen e së kundërtës. Kjo arsyeje na shërben për plotësimin zbraktësirave juridike në mënyrë e cila është e kundërt me analogjinë. Kjo do të thotë se të gjitha rastet të cilat ndonjë normë nuk i përfshinë (e të cilat janë të ngjashme me rastin e përfshirë) aplikohet norma e cila është e kundërt me të.

II. PËRFUNDIMI I PROCEDURËS ME VENDIM TË GJYKATËS

Funksioni gjyqësor qëndron në rendë të parë në zbatimin e normave juridike në situatën konkrete në të cilën ndodhet marrëdhënia shoqërore konkrete. Me vendimin e gjykatës nuk krijohen raporte të reja materialo-juridike në mes të palëve ndërgjyqësore, e as nuk ndryshohen raportet e krijuara më parë në mes të palëve ndërgjyqësore. Në procedurën kontestimore gjykata nuk krijon të drejtat subjektive e as që i ndryshon apo i ndërpretë të drejtat e tilla ekzistuese. Ajo vetëm bënë konkretizimin e së drejtës objektive duke e zbatuar normën juridike abstrakte për ngjarjen ose gjendjen faktike të vërtetuar në procesin kontestimor.

Procesi i krijimit të vendimit kalon nëpër disa hapa të cilët ndiqen njëri pas tjetrit. Së pari, konstatohet gjendja faktike, mandej duhet gjetur rregullën juridike me të cilën është rregulluar marrëdhënia juridike konkrete në lidhje me të cilën ka lindur kontesti, pas kësaj gjendja faktike e konstatuar i nën vihet rregullës juridike dhe së fundi evidentohen pasojat juridike të cilat norma juridike i lidhë për faktet e konstatuara.

Vendimi i gjykatës për themelësinë apo pathemelësinë e kërkesëpadisë manifestohet si përfundim (conclusio) i silogjizmit logjik (gjyqësor) në të cilin premisën e sipërme ose të madhe (praemisa maior) e përbënë normën juridike abstrakte, kurse premisën e poshtme ose të vogël (praemisa minor) gjendja faktike e konstatuar nga gjykata gjatë gjykimit.

Themeli faktik i vendimit gjyqësor- themelin faktik (premisën e poshtme) të vendimit gjyqësor e përbëjnë faktet të cilat gjykata i konstaton gjatë gjykimit dhe për të cilat mendon se janë të rëndësishme për zbatimin e normës me qëllim të dhënies së vendimit.

Cilat fakte do ti konsiderojë relevante gjykata për të vendosur për themelësinë e kërkesëpadisë do të varet vlerësimi që ka gjykata për kualifikimin e fakteve në raport me normën materialo-juridike. Pavarësisht se baza juridike si element i padisë është element fakultativ për të cilin nuk

është e lidhur gjykata, gjithsesi baza e paraqitur nga pala që kërkon mbrojtje gjyqësore apo mundësia që natyra e kërkesës sipas fakteve të paraqitura të kualifikohet në raport me normën apo normat e caktuara materialo-juridike i jep mundësinë gjykatës që të konstatojë se cilat fakte janë relevante.

Në sistemin tonë të procedurës kontestimore barra e të provuarit parimisht u takon palëve. Pra palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla. Është detyrë e gjykatës që të vendosë se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare.

Fondi i fakteve të cilat i merr në vlerësim gjykata me rastin e vendosjes meritore përbëhet nga faktet jokontestuese të paraqitura nga palët, faktet kontestuese por të cilat janë provuara në procedurën e të provuarit, faktet e ditura botërisht (të cilat nuk ka nevojë të provohen) dhe faktet e prezumuara nga ligji, e të cilat provohen vetëm nëse kontestohen.

Faktet vendimtare përbëjnë gjendjen e çështjes dhe gjykata vendimin e saj e mbështet në gjendjen faktike që ekziston në momentin e përfundimit të seancës së fundit të shqyrtimit kryesor.

Themeli juridik i vendimit gjyqësor- themelin juridik të vendimit gjyqësor e përbënë norma juridike e cila duhet të zbatohet, në rastin konkret, për gjendjen faktike të konstatuar gjatë gjykimit.

Është detyrë e gjyqtarit që të konstatojë ekzistimin e normës materialo-juridike që përputhet me gjendjen e çështjes dhe pasi të konstatojë ekzistimin e normës të bëjnë kualifikimin e gjendjes së çështjes në përputhje me normën duke dhënë edhe vlerësimet dhe arsyetimin se si gjykata ka ardhur në përfundimin e tillë. Gjyqtari duhet të thellohet në esencën e raportit kontestues sespe norma juridike me të cilën parashihet se si duhet të sillen subjektet e së drejtës e ka parasysh gjithmonë gjendjen faktike abstrakte dhe hipotetike. Gjyqtari e krahason gjendjen faktike të konstatuar nga gjatë gjykimit me gjendjen faktike hipotetike të normës juridike dhe si përfundim i nxjerrë pasojat juridike për rastin konkret.

1. Aktgjykimi

Me aktgjykim gjykata vendosë për themelësinë e kërkesëpadsisë e cila është objekt i gjykimit. Aktgjykimi është lloj i i vendimit gjyqësor me anë të të cilit vendoset për bazën e kërkesëpadsisë. Në teorinë procedurale aktgjykimi definohet si akt i gjykatës me të cilin, sipas rregullës, pas përfundimit të shqyrtimit vendoset për çështjen kryesore dhe për kërkesat dytësore. Aktgjykimi është vendim përfundimtar, me të cilin, sipas rregullës, përfundon procedura kontestimore e shkallës së parë. Aktgjykimi është vendim meritator sepse me anë të aktgjykimit vendoset se a e meriton pala mbrojtjen juridike që e kërkon nga gjykata. Aktgjykimi është akt individual me të cilin zgjidhet kontesti në atë mënyrë që bëhet konkretimizmi i normës juridike abstrakte mbi

gjendjen faktike individuale të vërtetuar në procedurën kontestimore. Me rastin e vendosjes për çështjen kryesore gjykata është e lidhur me kërkesën e palëve. Ajo nuk mund të vendosë për asgjë tjetër, përveç për atë që ka kërkuar pala. Gjykata me rastin e vendosjes meritore ka për detyrë që të vendosë për të gjitha kërkesat në mënyrë të plotë.

1.1 Përmbajta e aktgjykimit

Aktgjykimi duhet të përmbajë pjesën formale dhe materiale. Përmbajtjen formale e përbëjnë pjesët e aktgjykimit, ndërsa përmbajtjen materiale e përbën PËRMBAJTJA e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet aktgjykimi.

Përmbajtja formale e aktgjykimit

Pjesa Hyrëse

Sipas nenit 160.2 të LPK-së, pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban këto informacione:

- emrin e gjykatës,
- emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit,
- emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve,
- identifikimin e përfaqësuesve ligjorë dhe me prokurë të palëve,
- përshkrimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij,
- ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor,
- përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim,
- ditën kur është dhënë aktgjykimi.

Dispozitivi

Sipas nenit 160.3 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit përmban:

- vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore,
- vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë,
- vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Pjesa e arsyetimit

Në pajtim me nenin 160.4 dhe 5 të LPK-së, në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit, gjykata duhet të përfshijë rezultatet e veprimeve të mëposhtme:

- Kërkesat e palëve;
- Faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët;
- Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte;
- Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato;
- Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit;
- Deklarimi për pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë.

Udhëzimi mbi të drejtën në ankesë

Sipas nenit 160.1 të LPK-së, aktgjykimi duhet të përmbajë udhëzimin mbi të drejtën në ankesë.

Nënshkrimi

Neni 159 i Ligjit për Procedurën Kontestimore përcakton që aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari.

Përmbajtja materiale e aktgjykimit (përmbajtja e vendimit)

Përmbajtjen materiale e përbëjnë pjesët përbërëse të aktgjykimit të përpiluar me shkrim. Përmbajtjen materiale e përbën përmbajtja e vendimit me të cilin pranohet apo refuzohet kërkesëpadia.

2. Udhëzime për Shkrimin dhe Arsyetimin e Aktgjykimit Sipas Strukturës Formale të Aktgjykimit

2.1 Pjesa hyrëse

Në pjesën hyrëse të aktgjykimit nuk ka hapësirë për shfaqje kreative të gjykatës/gjyqtarit, përveç se duhet të ndiqen me korrektësi kërkesat për të dhënat e nevojshme sipas dispozitës së nenit 160.2 të LPK-së.

Numri i lëndës: [...]
Gjykata Themelore e [...] [Emri / mbiemri i gjyqtarit]
[Emri / mbiemri i palëve dhe vendbanimi apo vendqëndrimi i palëve]
[Emri / Mbiemri i përfaqësuesve ligjorë dhe të autorizuar të palëve që janë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor]
[Përshkrimi i objektit të kontestit dhe vlerës së kërkesës]
[Dita e shqyrtimit kryesor]
[Përshkrimin e versionit të palëve lidhur me kontestin dhe të përfaqësuesve të tyre ligjorë dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtim]
[Kohën dhe datën kur është dhënë aktgjykimi]

2.2 Dispozitivi i aktgjykimit

Sipas nenit 160.3 të LPK-së, dispozitivi i aktgjykimit përmban:

- vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore,
- vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë,
- vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Dispozitivi i aktgjykimit është pjesa qendrore dhe kryesore e secilit aktgjykim. Dispozitivi i aktgjykimit përmban vendimin meritor lidhur me kërkesat kryesore dhe aksesore. Dispozita e nenit 160 paragrafi 3, e LPK-së, përcakton me saktësi se gjykata në dispozitivin e aktgjykimit duhet të vendosë për aprovimin apo refuzimin e kërkesave kryesore dhe aksesore, pastaj për kërkesën e parashtruar me qëllim të kompensimit të saj nëse ekziston dhe në fund pjesë e dispozitivit të aktgjykimit është edhe vendimi mbi shpenzimet.

Vlen që të theksohet se dispozitivi i aktgjykimit është përfundimi që ka arritur gjykata sipas vlerësimit të saj mbi themelësinë apo pathemelësinë e kërkesëpadisë. Në fakt dispozitivi i aktgjykimit edhe kur gjykata vendosë për aprovimin apo refuzimin e kërkesave qoftë kryesore apo aksesore është analoge me kërkesëpadinë (petitumin) sipas të cilit është propozuar përmbajtja e mbrojtjes gjyqësore që e kërkon paditësi në gjykatë.

Në çdo rast gjykata gjatë shqyrtimit përgaditor të padisë duhet të sigurohet nëse kërkesëpadia është e artikuluar në formën që sipas saj do të jetë i lejueshëm zhvillimi i shqyrtimit kryesor. Në rast se kërkesëpadia nuk është artikuluar në formë të tillë që procesin gjyqësor do ta bënte të lejueshëm, atëherë gjykata duhet të marrë masa për evitimin e të metave për shkak të t'cilave nuk mund të zhvillohet gjykimi. Në këtë rast kërkesëpadia sidomos ajo detyruese duhet ta saktësoj subjektin e detyruar, për çka detyrohet (me saktësi detyrimi duhet të shënohet sepse në të kundërt do të paraqesë vendim të pa përmbarueshëm) dhe subjektin me cilësi të kreditorit. Nëse procesi gjyqësor është zhvilluar sipas një kërkesë e cila nuk ka saktësuar siç kërkohet për cilin do element që e bënë të pa përmbarueshëm vendimin e gjykatës atëherë në procedurën e ankesës një vendim i tillë do të kualifikohet si vendim i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për shkak të të cilave çështja do të kthehet në rishqyrtim.

Kështu edhe praktika gjyqësore konsideron: (Gjykata e Apelit e Kosovës, me AC.nr.1764/13, përcakton se:

“ Aktgjykimi është i përfshirë edhe në shkelje nga neni 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 102 paragrafi 1, 99 paragrafi 2 dhe 253 paragrafi 1, pika (a) të LPK-së, sepse në çdo rast kur gjykata konstaton se një parashtrësë nuk është e plotë përkatësisht nuk i përmban të dhënat e kërkuara siç përcaktohet me dispozitën e neni 99 paragrafi 2, i LPK-së, të njëjtën duhet të kthejë në plotësim. Në çdo rast elementet përbërëse të parashtrësës sipas neni 99 paragrafi 2, janë objekt i kontestit dhe përmbajtja e deklaratës, të cilat elemente për padinë si parashtrësë janë ekuivalent me kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore, për të cilat elemente nëse mungojnë padia duhet të kthehet në plotësim. Pra në këtë rast kur para gjykatës së shkallës së parë është paraqitur padia pa e specifikuar me saktësi kërkesën, gjykata është dashtë ta kërkojë plotësimin”.

Kuptohet që gjykata dispozitivin e aktgjykimit mund ta strukturojë ndryshe nga petitumi-kërkesëpadia, sepse dispozitivi duhet të jetë i kuptueshëm, i qartë dhe i përmbarueshëm, prandaj gjykata për ta ruajtur harmoninë e dispozitivit në shumë raste përdorë pika, paragraf brenda dispozitivit me të cilat vendos për aprovimin e kërkesave specifike apo refuzimin e tyre. Prandaj kemi theksuar që qysh në fillim të shqyrtimit paraprak të padisë gjykata duhet të kujdeset për rregullsinë formale të padisë veçanërisht të kërkesës-petitumit sepse në mungesë të një kërkesë/ave të qartë do të kemi pastaj edhe një dispozitiv të parregullt.

Dispozitivi duhet të formulohet në formën e një norme juridike por i kufizuar në rastin individual sipas specifikave individuale.

Në rastet kur gjykata vendosë për pranimin e padisë detyruese duhet të shënojë në pjesën urdhëruese në mënyrë të qartë e të saktë, pa lënë shteg për asnjë dyshim se kush detyrohet, për çka detyrohet dhe në dobi të cilit detyrohet. Nëse bëhet fjalë për kërkesë/a të cilat refuzohen tërësisht apo pjesërisht gjykata duhet të shënojë me saktësi pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë në mënyrë që pasi aktgjykimi të bëhet i formës së prerë të kemi mundësi për të identifikuar se çka në fakt përbën çështjen e gjykuar. Gjithmonë edhe kur refuzohet kërkesëpadia apo një pjesë e saj duhet të shënohet se është refuzuar në tërësi duke përkthyer përmbajtjen e kërkesës së refuzuar, apo kur refuzohet pjesërisht të shënohet se është refuzuar pjesërisht duhet e përkthyer edhe përmbajtjen e pjesës së përkthyer.

Në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit kur vendoset për shpenzimet e procedurës në fakt pjesa e aktgjykimit që ka të bëjë me shpenzimet të procedurës është aktvendim sipas dispozitës së nenit 142 paragrafi 6 i LPK-së.

Përveç aktvendimit mbi shpenzimet e procedurës praktika gjyqësore ka lejuar mundësinë që dispozitivi i aktgjykimit të përmbajë edhe ndonjë aktvendim tjetër, për shembull aktvendimin për masat e sigurimit të kërkesëpadisë apo të ndonjë veprimi procedural i cili është marrë nga gjykata në përfundim të shqyrtimit kryesor.

2.3 Arsyetimi i aktgjykimit

Çdo gjykatës duhet të ketë pikësynim që me rastin e vendosjes në një çështje juridike civile përveç se të vendos drejtë dhe ligjshëm vendimi i gjykatës të jetë edhe bindës. Komponent e padiskutueshme për të krijuar besueshmëri në objektivitetin e gjykatës dhe ligjshmërinë e vendimeve të gjykatës është arsyetimi i aktgjykimit. Përmes arsyetimit të aktgjykimit duhet të prezantohet në mënyrë të besueshme një pamje e gjithë procesit gjyqësor duke përfshirë edhe konkludimet e gjykatës.

LPK, me dispozitën e nenit 160 paragrafi 4, përcakton se: *“Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato”*, ndërsa në paragrafin 5 të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë më herët gjatë procesit gjyqësor”*.

Referuar dispozitës së cituar për arsyetimin e aktgjykimit mund të konkludojmë se ligdhënësi përveç strukturës së aktgjykimit apo pjesës formale ka përcaktuar edhe kornizat e përmbajtjes së aktgjykimit veçanërisht të arsyetimit të aktgjykimit. Përmes përmbajtjes së përcaktuar janë saktësuar hapa që duhet të ndjekë gjykata gjatë arsyetimit të aktgjykimit në mënyrë që të

sigurohemi se përmes aktgjykimit përveç se do të vendoset drejtë dhe ligjshëm një çështje kontestuese të sigurohet edhe besimi se gjykata ka vendosur drejtë dhe ligjshëm.

Hapat që duhet ndjekur gjatë arsyetimit të aktgjykimit janë të renditura sipas një kronologjie logjike dhe juridike në mënyrë që përmes arsyetimit të prezantohet figura e plotë e çështjes kontestuese dhe vlerësimet respektivisht përfundimi i gjykatës.

Praktika gjyqësore është e prerë sa i përket arsyetimit të aktgjykimit respektivisht përmbajtjes që duhet të ketë arsyetimi i aktgjykimit sipas dispozitave të cituara nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5 i LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës dhe rrjedhimisht edhe Gjykata Supreme e Kosovës, gjatë vendosjes në procedurën sipas mjeteve të goditjes të rregullta dhe të jashtëzakonshme, duke i ekzaminuar vendimet e gjykatave të instancës më të ulët lidhur me arsyetimin e aktgjykimit sipas pretendimeve ankimore ka raste kur kanë konstatuar shkelje për shkak se arsyetimi i aktgjykimit nuk është në përputhje me dispozitat e LPK-së, për përmbajtjen e arsyetimit. Prandaj për të kaluar testin e vlerësimit nga gjykata e shkallës së dytë dhe gjykata e shkallës së tretë aktgjykimi duhet të jetë i arsyetuar sipas kërkesave të LPK-së.

Praktika gjyqësore konsideron:

(Gjykata Supreme e Kosovës, në vendimin e saj Rev. Nr.15/2015, të datës 11.05.2015, thekson së:

“Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund ta pranoj qëndrimin juridike të gjykatave të instancës më të ultë, si të drejtë dhe të ligjshëm nga së sipas vlerësimit të saj aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuar nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk është vërtetuar gjendja faktike, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara më nenin 182.1, lidhur me nenin 194 të LPK-së, për të cilin shkak të dy aktgjykimi e përmendur u dashtë të prishën.

Shkelej thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin së gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur kronologjinë e provave të administruara dhe faktet me të cilat i ka vërtetuar ato, por nuk ka dhen vlerësimin se cilat fakte vendimtare janë vërtetuar dhe në çka e bazon vlerësimin e saj, kur lidhur me faktet vendimtare ka kundërtënie mes asaj që thuhet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së provës me shkrim, në të cilën mbështet aktgjykimi si dhe mes provave të administruara.....”.

(Gjykata e Apelit e Kosovës, me vendimin AC.nr.3732/13, të datës 16.12.2016, thekson së:

“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë

në shkëlje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 2 të LPK-së.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkëlje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta.

Dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit e rrjedhimisht për faktet vendimtare nuk janë paraqitur arsyeje ose arsyet e paraqitura janë të paqarta. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë përkitazi me arsyetimin e aktgjykimit është dashur ti përmbahet dispozitave të nenit 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së, të cilat përcaktojnë se arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet e parashtruar dhe provat e propozuara, cilat fakte janë vërtetuar, pse dhe si janë vërtetuar e në qoftë se janë vërtetuar me prova, cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato.

Nga arsyet e aktgjykimit nuk mund të kuptohet se mbi bazën e të cilave prova dhe cilave fakte gjykata ka arritur në përfundimin se paditësi është ngarkuar me borxh sipas faturave pa harxhuar energji elektrike. Gjykata e shkallës së parë është mjaftuar me një përshkrim përmbledhës duke specifikuar se cilat prova ka administruar por pa dhënë arsyeje se cilat fakte i ka provuar me provat e tilla dhe si pastaj gjendjen faktike të konstatuar e ka kualifikuar në raport me të drejtën materiale. Referencën në dispozitën e nenit 378 të LMD-së, në kontekstin e rrethanave të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë nuk rezulton se është dispozita materiale e cila do të mund të aplikohet në këtë çështje kontestuese nga arsyeja se baza juridike e kërkesëpadisë është në këtë rast sipas paditësit pasurim i pabazë, ndërsa parashkrimi është prapësim i natyrës materiale që do të kishte kuptim si institut në qoftë se do të zbatohet në kërkesat e kreditorit për detyrimet aktive të debitorit”.

Dispozita e LPK-së, për përmbajtje e arsyetimit të aktgjykimit në fakt vendosin kornizat respektivisht hapa që duhet ndjekur gjatë arsyetimit të aktgjykimit, mirëpo është po ashtu me rëndësi të merret në konsideratë fakti se arsyetimi i aktgjykimit diktohet në një farë mase edhe nga kërkesat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqësore. Prandaj gjykata në arsyetimin e aktgjykimit përveç se duhet të ndjekë secilin hap në procesin e arsyetimit ajo duhet të jep arsyetimin e saj edhe duke u fokusuar në kërkesat respektivisht pretendimet e palëve ndërgjyqësore.

Në qoftë së aktgjykimi i hartuar me shkrim ka mungesa për shkak të të cilave ai nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë së dispozitivi i tij është i pakuptueshëm apo në kundërshtim me vetveten ose me arsyet-kundër tij mund të paraqitet ankesë (neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së. Aktgjykimi mund të jetë i dyshimtë në pikëpamje të kuptimit të tij edhe për shkak të mungesave, te cilat kanë të bëjnë me arsyet e tij: këto mund të jenë të paqarta apo kontradiktore. Aktgjykimi ka mungesa edhe në qapoftë se në të nuk janë paraqitur fare arsye apo kur nuk janë

paraqitur ato në lidhje me faktet vendimtare, ose kur në pikëpamje të fakteve të tilla ekziston mospajtim midis dokumenteve me shkrim apo procesverbalit në një anë, dhe asaj që thuhet në lidhje me dokumente dhe procesverbalin në arsyetimin e aktgjykimit.

Procesi gjyqësor civil ekskluzivisht u referohet kërkesave disponibile të palëve ndërgjyqësore dhe duke qenë se palët disponojnë lirisht me kërkesat e tyre mund të ndodhë që deklaratimet e palëve ose e redukojnë nevojën që gjykata të arsyetojë ndonjë rrethanë të caktuar ose edhe ta paraqesin nevojën që gjykata të arsyetojë një veprim të caktuar.

Shembull për reduktimin e arsyetimit: nëse faktet e çështjes paraqiten jokontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore, atëherë gjykata e redukton arsyetimin e aktgjykimit lidhur me provat që ka adminstruar dhe arsyetimin se cilin fakt e ka vërtetuar me cilën provë.

Shembull për paraqitjen e arsyetimit: nëse pala e paditur ka paraqitur prapësimin e parashkrimit të kërkesës, nën supozimin se gjykata ka konstatuar se në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës ajo duhet të arsyetojë pse në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës nuk ka parashkrim.

3. Disa Udhëzime Lidhur me Pjesën Përmbajtjesore të Arsyetimit të Aktgjykimit

3.1 Kërkesat e palëve (si pjesë e përmbajtjes së arsyetimit të aktgjykimit)

Hapi i parë me të cilin tregohet objektiviteti i gjykatës lidhur me vendosjen e çështjes kontestuese në një farë mënyre është paraqitja e kërkesave të palëve. Në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit që i referohet paraqitjes së kërkesave të palëve gjykata duhet të paraqesë në mënyrë objektive kërkesat e palëve, realisht secilin kërkesë dhe secilin pretendim, sepse nga kërkesat dhe pretendimet e palëve ndërgjyqësore rrjedhë pastaj edhe epilogu i arsyetimit të aktgjykimit.

Sipas dispozitës së nenit 2, paragrafi 2, të LPK-së, përcaktohet se: “*Në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqësore*”. Nga kjo dispozitë rrjedh se gjykata civile është e lidhur me kërkesat e palëve prandaj në fillim të arsyetimit përshkruhen kërkesat e palëve sipas të cilave përcaktohet objekti dhe kufijtë e shqyrtimit dhe vendosjes.

Nuk konsiderohen si të pranueshëm rastet kur gjykata në fillim të arsyetimit të aktgjykimit i përshkruan kërkesat e palëve në tipin e përgjithshëm të përshkrimit si: “*paditësi ka mbetur në tërësi pranë kërkesëpadisë*” ose “*i padituri ka mbetur në tërësi pranë përgjigjes në padi*”.

Gjykata duhet të përshkruaj kërkesat e palëve sepse ato identifikojnë çështjen kontestuese respektivisht përcaktojnë objektin e kontestit dhe orientojnë arsyetimin e aktgjykimit.

3.2 Faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar palët

Në këtë hap të arsyetimit të aktgjykimit gjykata duhet të paraqes faktet që palët i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar për vërtetimin e fakteve të propozuara.

Me dispozitën e nenit 7 paragrafi 1, i LPK-së, është përcaktuar se: “ *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*”, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1, të LPK-së, është përcaktuar se: “*Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta*”. Nga këto dy dispozita rrjedh se në sistemin tonë të procedurës kontestimore dominon sistemi i bazuar në parimin e shqyrtimit sepse palëve u takon e drejta ekskluzive që të parashtrojnë faktet të cilat gjykata do ti merr për në themel të vendimit të saj.

Përfundim nga dispozita e cituar bënë dispozita e nenit 7 paragrafi 2, e LPK-së, me të cilën përcaktohet se: “*Gjykata është e autorizuar ti vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe ti marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3 paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe*”, ndërsa me dispozitën e nenit 356 e ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-118, është përcaktuar se: “*Gjykata ex officio, ose propozimin e palëve mund të bëjë të provuarit me anë të ekspertizës, sa herë që për vërtetimin apo sqarimin e fakteve, apo të rrethanave të caktuara nevojitet dijeni profesionale të cilën nuk e ka gjyqtari i çështjes*”.

Siç vërehet nga dispozita e cituar lidhur me paraqitjen e fakteve të çështjes mund të konkludojm se parimisht vlen parimi i shqyrtimit që nënkupton se përgjegjësia për prezentimin e fakteve u takon palëve, ndërsa si përjashtim gjykatës i është dhënë mundësi e konstatimit të fakteve nëse palët provojnë të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë. Ndryshe qëndron situata sa i përket marrjes së provave për vërtetimin e fakteve sepse edhe marrja e provave do të duhet me qenë analoge me mënyrën e paraqitjes së fakteve, por ligdhënësi ka bërë një përjashtim të dispozita e nenit 356 kur ka përcaktuar marrjen e provës me ekspertizë edhe ex officio, pa e kufizuar marrjen e kësaj prove vetëm për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me kërkesat e padisponueshme.

Pavarësisht nga kundërthënia e mundshme në mes të dispozitave të cituara është detyrim i gjykatës që në këtë hap të arsyetimit të aktgjykimit ti paraqesë në fakte që i kanë paraqitur palët dhe provat që i kanë propozuar për vërtetimin e atyre fakteve. Praktika gjyqësore nuk përcakton nevojën që gjykata të mbajë një dallim në mes të fakteve të paraqitur me padi dhe përgjigje në padi nga ato fakte që mund të paraqitet në seancën përgaditore ose të shqyrtimit kryesor kur nuk është mbajtur seanca përgaditore. Fakte dhe provat e secilës palë paraqiten pa bërë dallim se në cilën fazë të procedurës janë paraqitur.

Ky hap i arsyetimit të aktgjykimit është tejet me rëndësi sepse mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët ndërgjyqësore gjykata do të jep edhe vlerësimin për themelësinë e kërkesëpadisë. Është po ashtu me rëndësi paraqitja e besueshme e fakteve dhe provave të propozuara nga palët ndërgjyqësore sepse nëse gjykata nuk i përshkruan të gjitha faktet e paraqitura nga palët ka gjasa që aktgjykimi të jetë i përfshirë në kontradiksion të fshehtë, çka ndikon drejtpërdrejt në ligjshmërinë e aktgjykimit.

Paraqitja e fakteve me korrektësi nga ana e gjykatës në këtë pjesë të arsyetimit të aktgjykimit pikërisht ashtu siç palët i kanë parashtruar jep një mundësi që lehtësisht të vlerësohet ligjshmëria dhe besueshmëria e aktgjykimit. Kjo për faktin se mbi bazën e fakteve dhe provave të paraqitura nga palët do të pasojnë hapat tjerë të vërtetimit të fakteve vendimtare dhe pastaj të kualifikimit të fakteve vendimtare në raport me normat materialo-juridike të cilat japin e përfundimin për themelësinë e kërkesëpadisë.

3.3 Specifikimi se cilat nga faktet e tilla janë vërtetuar, dhe arsyet përse janë vërtetuar ato fakte

Ka një diferencë në mes të fakteve të paraqitura respektivisht të propozuara nga palët ndërgjyqësore dhe fakteve të vërtetuara, sepse është në diskrecionin e gjykatës të vendos se cilat nga faktet e propozuara kanë peshën e “fakteve vendimtare” e të cilat duhet të vërtetohen.

Gjatë shqyrtimit gjykata varësisht nga vlerësimi i saj bënë një lloj “klasifikimi” të fakteve në mes të atyre që kanë rëndësi për tu provuar dhe atyre jo vendimtare.

Në këtë hap të arsyetimit të aktgjykimit gjykata specifikon se cilat fakte janë vërtetuar dhe rrjedhimisht jep arsyetimin se përse janë vërtetuar ato fakte. Sigurisht për të vlerësuar se cilat fakte duhet të vërtetohen gjykata mbështetet në disa rrethana që kanë të bëjnë me natyrën e çështjes kontestuese, bazës juridike të cilës i është referuar pala, rrethanave kontestuese, etj.

Objekt i të provuarit mund të jetë një fakt ose tërësia e fakteve juridike që janë vendimtare për pranimin e padisë, të prapësimeve ose të kundërpadisë dhe për zgjidhjen e çështjes nga gjykata. Objekti i të provuarit nuk është çdo fakt që pretendohet nga palët, por vetëm ato fakte juridike që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes nga gjykata.

Sipas dispozitës së nenit 319.2 të LPK, duhet të provohen të gjitha faktet të cilat janë të rëndësishme për dhënien e vendimit. Është detyrë e gjyqtarit apo e trupit gjykues që nga një numër i madh i fakteve, të cilat i kanë theksuar palët, t'i ndaj ato të cilat janë të rëndësishme për të vendosur lidhur me çështjen juridike kontestimore. Nga faktet relevante, për të cilat ligji e lidhë pasojnë juridike, objekt i të provuarit bëhen vetëm ato që janë kontestuese midis palëve.

Gjykata është ajo që vendos se cilat fakte duhet provuar dhe cilat prova do merren për vërtetimin e tyre. Kjo i jep mundësinë gjykatës që sipas bindjes së lirë ta caktojë rrethin e fakteve juridike të cilat i konsideron të rëndësishme për marrjen e vendimit dhe të përqendrohet në provimin e tyre. Sipas kësaj gjykata ka mundësi që mos t'i merr për bazë faktet që nuk kanë ndonjë rëndësi

për çështjen dhe me atë rast t'i refuzojë propozimet e palëve me të cilat kërkojnë vërtetimin e këtyre fakteve.

Ekzistojnë raste kur objekt i të provuarit nuk janë drejtpërdrejtë faktet, por janë pretendimet e palëve për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve juridike, nga të cilat varet zbatimi i normave të së drejtës materiale në procesin kontestimor gjyqësor. Ky është quajtur fakt negativ. Vërtetimi i vërtetësisë së pretendimit mohues negativ, mund të bëhet vetëm në mënyrë të tërthortë, me anë të konstatimit të ekzistimit të faktit që e përjashton ekzistimin e përnjëhershëm të faktit të kontestuar.

Pra duke i pasur parasysh të gjitha këto rrethana gjykata gjatë gjykimit ka vlerësuar se cilat fakte duhet të provohen dhe ato fakte i paraqet në arsyetimin e vendimit. Natyrisht gjykata duhet të ketë edhe një arsyetim të veçantë pse disa fakte të paraqitura nga palët ka refuzuar ti provoj.

Përshkrimin se si janë vërtetuar ato fakte, nëse faktet janë vërtetuar me anë të provave, duhet të saktësohet se cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato

Edhe pse në disa raste e përbëjnë thelbin e padisë, të kundërpadisë apo të prapësimeve, disa fakte nuk ka nevojë të provohen, dhe atë: ***Faktet e ditura botërisht dhe ato të vërtetuara nga gjykata në gjykimin e mëhershëm, Faktet e pranuar (pohuara) dhe Faktet e prezumuara me ligj.***

Faktet e njohura botërisht nuk kanë nevojë të provohen, për shkak se ato njihen prej një rrethi të gjerë personash.

Pohimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta për disa apo tërë faktet në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij. Sipas nenit 321 paragrafi 2 të LPK nuk duhet të provohen faktet të cilat i ka pranuar pala para gjykatës gjatë procesit gjyqësor. Motivi i pranimit të fakteve zakonisht është relevant dhe gjykata nuk është e detyruar ta vërtetojë saktësinë e atij fakti, përveç në rastet kur bindet se pranimi i fakteve bëhet me qëllim të disponimit të palejueshëm – zbatimi i nenit 3 paragrafi 3 të LPK. Në këtë rast gjykata vërtetësinë e tyre e bënë me mjetet provuese që i ka në dispozicion.

Objekt i të provuarit nuk mund të jetë as fakti, ekzistimin e të cilit ligji e prezumon. Prezumimi ligjor i fakteve përfaqëson rregullin sipas të cilit gjykata është e detyruar që ta merr si ekzistues një fakt (fakt i prezumuar) nëse vërtetohet se ekziston një fakt tjetër i përcaktuar nga ligji. Ekzistojnë ligje përkatëse që përmbajnë dispozita për faktet e prezumuara. *P.sh., Ligji për Familjen (neni 99)* prezumon se at i fëmijës është personi i cili është në martesë me nënën e fëmijës 300 ditë para lindjes së fëmijës. Në faktet e prezumuara nga ligji barra e të provuarit bien në palën e cila e konteston ekzistimin e fakteve të tilla.

Marrja e provave është veprim procedural i gjykatës me anën e të cilit ajo merr dijeni për bazat e të provuarit nga mjetet provuese. Gjykata cakton rrethin e fakteve që duhet të provohen, lloji i

provave që do të lejohen për vërtetimin e tyre, caktohet mënyra, koha dhe vendin e marrjes së provave.

Vërtetimin e fakteve kontestuese gjykata e bënë përmes mjeteve provuese. Mjet provues (provë) quhet çdo burim nga i cili me anë të organeve të shqisave nxjerrim njohuri për vërtetësinë e thënies se ekziston apo nuk ekziston një fakt për të cilin lidhet pasoja e caktuar juridike.

Mjetet provuese janë të parashikuara në dispozita të veçanta të LPK sipas llojit të tyre. Këto mjete janë: Këqyrja në vend, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe dëgjimi i palëve. Siç shihet lloji i provave varet nga lloji i burimeve të parashikuar në ligj.

Varësisht nga mënyra se si janë vërtetuar faktet do të jetë edhe arsyetimi i aktgjykimit. Posaçërisht të faktet kontestuese të cilat rëndom vërtetohen përmes mjeteve provuese gjykata duhet të ketë një arsyetim të zgjeruar dhe atë duke arsyetuar specifikisht secilin fakt kontestues dhe provën e administruar me të cilin është vërtetuar secili fakt. Gjykata në këtë hap të arsyetimit duhet të ketë edhe një vlerësim/arsyetim për vlerën provuese/fuqinë provuese të secilës provë të administruar dhe rrjedhimisht besueshmërinë e saj.

Sistemi i jonë i procedurës kontestimore i përket sistemeve që çmuarjen e provave e bënë në bazë bindjes se lirë. Në sistemin e vlerësimit lirisht të provave nuk parashikohen rregulla procedurale për zgjedhjen, shfrytëzimin dhe fuqinë provuese të mjeteve provuese. Gjykata, sipas këtij sistemi, nuk është e lidhur e as e kufizuar me rregulla të posaçme formale për të provuarit. Pretendimin e caktuar gjykata e merr si të provuar vetëm pasi të jetë bindur në saktësinë e tij (në bazë të provave të shfrytëzuara dhe të vlerësuara).

Gjykata është e lirë të vlerësojë rezultatin e hetimit gjyqësor dhe të vendos për themelin e çështjes. Vlerësimi i lirë i provave nga gjykata, kërkon një kujdes të veçantë në respektimin e rregullave dhe kufijve të caktuar për këtë qëllim, si dhe përdorimi me efektivitet i eksperiencës. Gjykatësi duhet të ruhet nga ajo që quhet interpretim personal i tij, në drejtim të vlerësimit subjektiv e të njëanshëm të provave dhe të pranimit të konkluzioneve të nxjerra nën influencën e të dhënave të marra privatisht prej tij ose të ofruara nga palët, e që nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor. Del e domosdoshme formimi i një disipline të fortë juridike në vlerësimin e provave, ku si çështje bazë duhet të jetë formimi dhe konsolidimi i provës në procesin e përpjekjes së dy të kundërtave. Çdo cenim i këtyre rregullave të shpie në varfërimin e vlerës ligjore të gjykimit.

Përshkrimet e dëshmive duhet të jenë të arsyetuara dhe të strukturuar në mënyrë që të tregojnë se gjykata i konsideron ato bindëse, bashkë me arsyet për një përfundim të tillë. Për shembull, kur gjykata të konstatojë se pretendimi i një pale nuk është i pranueshëm, ajo duhet të arsyetojë vendimin duke cituar dëshmi konkrete, duke paraqitur referenca për kundërthëniet në mes të dëshmitarëve dhe dëshmitë e tjera materiale të cilat kanë çuar gjykatën deri te një përfundim i caktuar. Në këtë mënyrë, gjykata po ashtu bënë një vlerësim të dëshmive të pranuar. Gjykata po ashtu, në mënyrë të veçantë do të vlerësojë besueshmërinë e dëshmive kundërthënëse, arsyet për

mos aprovimin e kërkesave individuale të palëve dhe arsytet me të cilat është udhëhequr gjykata në përcaktimin e pikave të ligjit e veçanërisht, në përcaktimin se a ekziston detyrimi ligjor.

Gjykata nuk do të krijojë besimin thjeshtë duke përshkruar arsyetimin e saj për pranimin e dëshmimeve ose argumenteve pa sqaruar se pse dëshmitë ose argumentet kundërthënëse nuk kanë qenë bindëse. Arsyetimi i vendimit duhet të pasqyrojë në mënyrë të qartë paanshmërinë e gjykatës kur ajo sjellë përfundimet e veta. Një prej standardeve të procesit racional ligjor përfshinë respektimin e parimit të barazisë që aplikohet për të dy palët në një kontest. Rrjedhimisht, ky standard është i lidhur ngushtë me paanshmërinë dhe objektivitetin e gjykatës, dhe duhet të pasqyrohet jo vetëm në procedurat gjyqësore por edhe në arsyetimin e vendimit përfundimtar të gjykatës.

3.4 Dispozitat e së drejtës materiale të cilat janë zbatuar në nxjerrjen e aktgjykimit

Në pjesën e analizës për përfundimin e gjykatës lidhur me themelin e kërkesëpadisë përveç hapave tjerë ta arsyetimit të përshkruar më lartë, pjesa e përshkrimit të dispozitave materialo-juridike për rastin konkret është tejet e rëndësishme sepse përmes zbatimit të normës materiale do të përcaktohet nëse rrethanat faktike të çështjes kontestuese konsumojnë elementet e normës juridike për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar.

Praktika gjyqësore është mjaft e ashpër në këtë pikë dhe realisht e konsideron si pjesë qenësore të arsyetimit të aktgjykimit referencën e gjykatës në normën materialo-juridike, në të kundërt aktgjykimit do ta kualifikojë në shkelje për të cilat çështja kthehet në rishqyrtim.

Është e domosdoshme referenca në normën materialo-juridike sepse në këtë mënyrë tregohet burimi i së drejtës dhe rrjedhimisht se si gjendja e fakteve të çështjes konkrete ka përmbushur konditat ligjore që gjykata të vendos për mbrojtjen gjyqësore të kërkuar.

Gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e të drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtën subjektive të parashtruesit të kërkesës. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet dhe pjesa arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke respektuar rregullat dhe ligjet. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradikison të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dispozitivin e aktgjykimit.

Aktgjykimi i shkruar duhet të citoj dhe interpretojë normat ligjore të aplikuara në zgjidhjen e kundërthënieve që janë ngritur në një rast të caktuar. Kur e bënë këtë, gjykata duhet të marrë parasysh disa karakteristika të caktuara që kanë të bëjnë me llojin e kërkesës e cila po gjykohet, e pastaj edhe natyrën e raportit ligjor që ka të bëjë me kontestin. Në këtë aspekt, aktgjykimi duhet të jetë specifik sa i përket analizës ligjore që bëhet për normën ligjore si pjesë e të drejtës objektive në të cilën bazohet pretendimi për të drejtat subjektive të parashtruesit të kërkesës. Arsyetimi i aktgjykimit lidhur me aplikimin e ndonjë norme të veçantë duhet të shërbejë si

argument i fuqishëm dhe bindës se vendimi i gjykatës është i drejtë sepse do të jetë e qartë se ai është i bazuar në ligj.

Vendimi i gjykatës në çdo rast duhet të jetë logjik, me formë të duhur dhe me përmbajtje të qartë. Argumentet dhe pjesët e arsytimit duhet të jenë të bazuara dhe të kenë lidhje logjike dhe në të njëjtën kohë të respektojnë rregullat dhe ligjet. Ato duhet të krijojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, e cila përjashton çdo mospërputhje ose kundërthënie të drejtpërdrejtë apo të nënkuptuar. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme në mënyrë që të mbështesin dispozitivin e aktgjykimit të shkruar.

3.5 Deklarimi për pretendimet e palëve lidhur me bazën juridike të kontestit, si dhe propozimet dhe kundërshtimet e tyre për të cilat gjykata nuk ka arsyetuar vendimet e nxjerra më parë në procedurë

Duhet theksuar se gjatë zhvillimit të procedurës gjykata si subjekt kryesor i procedurës e ushtron diskrecionin e saj për zhvillimin e procesit gjyqësor duke marrë një mori veprimesh procedurale për të cilat nuk jep sqarime gjatë shqyrtimit, por është detyrim i gjykatës që në arsyetimin e aktgjykimit ti arsyetojë disa nga veprimet e saj procedurale.

Sigurisht gjykata nuk do të arsyetojë çdo veprim procedural sepse vetë zhvillimi i procesit gjyqësor dhe mënyra e vendosjes me vendimin meritor e konsumon nevojën që të arsyetohet çdo veprim procedural, por sigurisht gjykata duhet të arsyetojë ato veprime procedurale në frymën e përfundimit të saj meritor për çështjen.

Aktgjykimi duhet të përshkruajë veprimet procedurale të ndërmarra gjatë gjykimit, qëndrimet dhe vendimet procedurale lidhur me çështjet paraprake dhe procedurale, mocionet (kërkesat) e aprovuara dhe të refuzuara të palëve, përfshirë edhe sqarimet se cilat rrethana kanë ndikuar në aprovimin apo refuzimin e kërkesave të tilla. Gjykata duhet të sqarojë rrethanat e rastit ashtu siç janë pranuar (në proces kronologjik) dhe bazuar në rrethana, gjykata duhet të sqarojë përfundimin (konkluzionin) që e ka sjellë ajo. Përveç kësaj, gjykata duhet të demonstroj saktësinë faktike me referenca në dëshmitë që ajo i ka pranuar gjatë gjykimit. Gjatë tërë kohës gjykata duhet të shmangë arsytimin jo të plotë dhe të pabazuar. Për shembull, duhet të shmangen deklaratat si më poshtë: *“nga ajo që u tha më lartë rezulton se..., pastaj bazuar në deklaratat e dëshmitarëve..., pa sqaruar, analizuar dhe dëshmuar saktësinë e deklaratave...,”* e kështu me radhë).

Argumentet dhe pjesa arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke respektuar rregullat dhe ligjet. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradikison të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë të mjaftueshme për të mbështetur dispozitivin e aktgjykimit.

4. Llojet e Aktgjytimeve

Ndarja e aktgjytimeve mund të bëhet në bazë të disa kriterëve. Më i rëndësishme është kriteri sipas përmbajtjes së mbrojtjes juridike që jepet me aktgjykim. Sipas këtij kriteri klasifikimi bëhet sipas llojeve të padive respektivisht qëllimit që dëshiron të arrijë paditësi në procedurë gjyqësore. Llojet e aktgjykimit sipas këtij kriteri janë: aktgjykimi detyrues (dënues, kondemnator), aktgjykimi vërtetues (deklarativ) dhe aktgjykimi transformues (konstituv).

Aktgjykimet mund të klasifikohen edhe sipas qëllimit të mbrojtjes juridike që jepet me aktgjykim. Sipas këtij kriteri bëhet dallim në mes të aktgjykimit të pjesëshëm dhe aktgjykimit plotësues.

Aktgjykimet mund të klasifikohen edhe sipas sjelljes së palës së paditur në gjykim. Sipas këtij kriteri aktgjykimi mund të jetë kontradiktor dhe jo kontradiktor.

Për shkak të specifikave që përmban arsyetimi i secilit lloj të aktgjykimit në këtë pjesë do të trajtohen specifikisht llojet e aktgjykimit sipas përmbajtjes së mbrojtjes juridike që jepet me aktgjykim dhe sipas klasifikimit që parashohin dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Llojet e aktgjykimit sipas mbrojtjes juridike që jepet:

4.1 Aktgjykimi detyrues (dënues, kondemnator)

Me këtë aktgjykim gjykata e pranon si të themeltë kërkesëpadinë dhe e urdhëron të paditurin që në dobi të paditësit të jep diçka, të bëjë diçka, të duroj ose pësoj.

4.2 Aktgjykimi vërtetues (deklarativ)

Me këtë aktgjykim deklarator jepet mbrojtje juridike deklaratore në atë mënyrë që vërtetohet ekzistimi, mosekzistimi i ndonjë të drejte ose marrëdhënie juridike, ose vërtetohet vërtetësia respektivisht mos vërtetësia e ndonjë dokumenti.

4.3 Aktgjykimi transformues (konstitutiv, ndryshues)

Me aktgjytime të tilla gjykata e ndryshon ose e anulon raportin juridik nga i cili për palët dalin të drejta dhe detyrime.

Në arsyetimin e aktgjykimit me të cilin pranohet si e themeltë kërkesëpadia, gjykata duhet ti paraqes rrethanat nga të cilat shihet se ekziston raporti juridik dhe autorizimi i paditësit që nga ajo të kërkojë ndryshimin e përmbajtjes së raportit të tillë. Pra, edhe mbrojtjes juridike konstitutive i paraprinë vërtetimi i përmbajtjes së raportit juridik midis palëve.

5. Llojet e aktgjyqimeve sipas LPK-së

5.1 Aktgjykimi i pjesshëm

Aktgjykim i pjesshëm quhet ai aktgjykim me të cilin gjykata vendos vetëm për një pjesë të kërkesëpadiisë, apo për njërën nga disa kërkesat që janë objekt gjykimi. Gjykata e jep këtë aktgjykim kur pjesa e objektit të gjykimit, për shkak të pohimit ose në bazë të shqyrtimit të mjaftueshëm, njëra ose disa sosh, janë pjekur për vendim definitiv dhe meritore, gjykata mundet, në pikëpamje të kërkesave të përgatitura, përkatësisht të pjesës së kërkesës së përgatitur, ta përfundojë shqyrtimin dhe të jep aktgjykim të pjesshëm. Nga kjo, del qartë se nëse disa nga kërkesat e paraqitura të një pjesë të kërkesës, është shqyrtuar në masën që është e mjaftueshëm për sjelljen e vendimit përfundimtar në bazë të shqyrtimit, gjykata ka mundësi, por edhe është e obliguar që të sjellë aktgjykim të pjesshëm.

Rast praktik i një situate të tillë: Në qoftë se paditësi ka paraqitur disa kërkesa kundër të paditurit, si p.sh., dorëzimin e sendit, kompensimin e dëmit dhe kompensimin për pasurim pa bazë, nën supozimin së është përgatitur për vendosje pjesa e kërkesëpadiisë që ka të bëjë me dorëzimin e sendit por jo edhe për kompensimin e dëmit dhe pasurimit pa bazë, atëherë gjykata mund të marrë aktgjykim të pjesshëm me të cilin vendos për dorëzimin e sendit tek paditësi e pastaj të vendos edhe për dy kërkesat tjera. Kjo mund të ndodh për arsye se në këtë rast kërkesa për kompensim dëmi dhe pasurim pa bazë mund të zgjasë për shkak të procesit kompleks të të provuarit të dëmit dhe kompensimit për pasurim pa bazë, pasi që gjykata sigurisht sipas propozimeve të palëve do të nxjerrë ekspertizat përkatëse dhe provat tjera materiale për të provuar faktet e çështjes dhe vlerën e kompensimit.

Gjykata mundet të jep aktgjykim të pjesshëm edhe kur objekt i gjykimit është edhe kundërpadia, por që për vendim është përgatitur vetëm kërkesa e padiisë apo e kundërpadiisë.

Nuk do të lejohet aktgjykimi i pjesshëm në qoftë se në padi apo kundërpadi janë përfshirë me tepër kërkesa vendosja e të cilave nuk mund të bëhet ndaras për shkak të natyrës së raportit kontestues për themelësinë e kërkesave të tilla.

Gjykata e jep ex-officio këtë aktgjykim në qoftë se një gjë të tillë e çmon si të arsyeshme. Gjykata duhet të marrë parasysh me rastin e vendosjes së pjesshme të kërkesëpadiisë madhësinë e kërkesës e cila është përgatitë për vendosje por edhe qëllimet tjera procedurale realizimin e të cilave e mundëson aktgjykimi i pjesshëm.

Gjykata është e obliguar që pa vonesë të sjellë aktgjykim të pjesshëm nëse nga me tepër kërkesa të paraqitura, në bazë të pranimit ose të heqjes dorë vetëm disa janë shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për vendim përfundimtar ose nëse vetëm një pjesë e kërkesës është shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për vendim përfundimtar. Gjithashtu, nëse kërkesëpadiia e cila ka

të bëjë me më tepër bashkëndërgjyqës të thjeshtë është shqyrtuar në masën që është e mjaftueshme për vendim përfundimtar në bazë të pohimit ose të heqjes dorë nga kërkesëpadia vetëm sa i përket ndonjërit nga bashkëndërgjyqësit, ose ndonjëra nga me tepër kërkesëpaditë që ka të bëjë me bashkëndërgjyqës të ndryshëm është shqyrtuar në masë që është mjaftueshme për vendim përfundimtar në bazë të pohimit apo heqjes dorë nga kërkesëpadia, gjykata është e obliguar të sjellë aktgjykim të pjesshëm vetëm ndaj bashkëndërgjyqësit të cilit i përket.

Aktgjykimi i pjesshëm është aktgjykim i pavarur nga aktgjykimi definitiv për pjesën tjetër të kërkesëpadisë si në pikëpamje të mjeteve të goditjes ashtu edhe sa i përket përmbartimit të aktgjykimit.

5.2 Aktgjykimi në bazë të pohimit

Aktgjykimi në bazë të pohimit është vendimi meritator të cilin e jep gjykata në bazë të deklaratës së shprehur të palës së paditur. Me pohimin e kërkesëpadisë, si veprim procedural i njëanshëm i palës së paditur, bëhet i panevojshëm zhvillimi i mëtutjeshëm i procesit kontestimor.

LPK përcakton se në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo në tërësi, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).

Përcaktimi ligjor se i padituri mund të pohojë kërkesëpadinë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor nënkupton se i padituri mund ta pohojë kërkesëpadinë jashtë seancës gjyqësore por edhe në seancë gjyqësore, (shembull mund ta pohojë kërkesëpadinë me përgjigje në padi apo edhe me parashtrësë gjatë zhvillimit të shqyrtimit përgatitor dhe atij kryesor e gjithashtu edhe me pohim të drejtpërdrejtë në seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor).

Zakonisht posa të kryhet veprimi procedural me të cilin pohohet kërkesëpadia, gjykata menjëherë pa e pritur propozimin e palës paditëse e jep aktgjykimin në bazë të pohimit me të cilin e pranon kërkesëpadinë si të themeltë. Pavarësisht se gjykata në rrethana normale duhet që menjëherë posa të pohohet kërkesëpadia të jep aktgjykimin në bazë të pohimit, në qoftë se kërkesa e padisë ka të bëjë me kërkesa me të cilat palët nuk mund të disponojnë lirisht (par.3 i nenit 3 të LPK-së), pavarësisht se plotësohen kushtet që gjykata të jep aktgjykim në bazë të pohimit, të njëjtin nuk do ta jap.

Gjykata nuk do të jep aktgjykim në bazë të pohimit sa herë që konstaton se kërkesa e padisë është kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në baza të pohimit as në konteste martesore.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit - dhënia e aktgjykimit në bazë të pohimit mund të shtyhet për më vonë në qoftë së është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura nëse kërkesa e padisë është kërkesë më të cilën palët mund të disponojnë lirisht apo jo.

Shembull i një situatë praktike mund të jetë: Subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetim të së drejtës së pronësisë lidhur me pronën NN dhe gjatë seancës përgatitore nga ana e subjektit të paditur para gjykatës jepet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë. Në qoftë se gjykata nuk ka dëshmi të mjaftueshme mbi bazën e të cilave mund të konstatojë rrethanën se a është kërkesë e disponueshme për të paditurit objekti i kërkesëpadisë, mund ta shtyjë dhënien e aktgjykimit në bazë të pohimit dhe të ndërmerrë verimet e duhura me të cilat do të konstatojë nëse kërkesa e padisë është e disponueshme ose jo për të paditurin. Në këtë mënyrë ex-officio mund t'i drejtohet organit kompetente në kuptim të dispozitës së nenit 7.2 të LPK-së, me kërkesë që organi përkatës t'i dorëzojë gjykatës në afat të caktuar (afat gjyqësor) certifikatën e pronës dhe informata tjera për historiatin e pronës etj. Pas marrjes së këtyre informatave gjykata do të vendos që të pranohet apo të refuzohet deklarata e pohimit të kërkesëpadisë.

Revokimi i deklaratës mbi pohimin e kërkesëpadisë - I padituri i cili e ka dhënë deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë ka mundësi që ta revokojë deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë. LPK me dispozitën e nenit 148.4 e ka paraparë mundësinë që i padituri ta revokojë deklaratën me të cilën e ka pohuar kërkesën e padisë por vetëm deri në momentin e dhënies së aktgjykimit në bazë të pohimit nga ana e gjykatës.

Për kryerjen e veprimit procedural me të cilin revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur. I padituri nuk ka nevojë që gjykatës t'i paraqes kurrfarë arsytimi për revokimin e deklaratës me të cilën është pohuar kërkesa e padisë, por mjafton vetëm deklarimi se e revokon deklaratën për pohimin e kërkesëpadisë por me kusht që të mos jetë dhënë aktgjykimi.

Posa të revokohet deklarata për pohimin e kërkesëpadisë gjykata duhet të vazhdojë procedurën, një gjë të tillë gjykata do ta bëjë edhe nëse konstaton se kërkesa e padisë nuk është e disponueshme për palët.

Edhe pas revokimit të deklaratës për pohimin e kërkesëpadisë i padituri ka mundësi që ta ripohojë kërkesën e padisë dhe natyrisht kjo deklaratë e ka efektin e plotë në bazë të së cilës gjykata do të jep aktgjykimin në bazë të pohimit nëse konstaton se kërkesa padisë është e disponueshme për palët.

Nëse nxjerrët aktgjykimi në bazë të pohimit i njëjti duhet të përmbajë këtë emërtim “*aktgjykim në bazë të pohimit*”.

Arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit– arsyetimi i aktgjykimit në bazë të pohimit dallon prej arsyetimit të aktgjykimit të zakonshëm sepse tek ky arsyetim gjykata do të kufizohet në dhënien e arsyeve sa i përket vërtetimit të gjendjes së fakteve, analizës së provave dhe aplikueshmërisë së të drejtës materiale. Esenciale është përshkrimi i kërkesëpadsisë, përshkrimi i deklaratës së pohimit të kërkesëpadsisë, konstatimi se kërkesa është e disponueshme për palët dhe referenca në dispozitat e LPK-së, pjesa e aktgjykimit në bazë të pohimit.

Shkaqet e ankimit kundër aktgjykimit në bazë të pohimit- LPK, me dispozitën e nenit 181.2 ka përcaktuar se *”aktgjykimi në bazë të pohimit mund të goditet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit”*.

5.3 Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadi

Me dispozitat e nenit 149 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me anë të veprimeve disponibile të palëve. Për derisa me dispozitat e nenit 148 të LPK-së është paraparë mundësia e përfundimit të procesit gjyqësor me pohimin e kërkesëpadsisë, me dispozitat e nenit 149 të LPK-së procesi gjyqësor mund të përfundojë me heqjen dorë nga kërkesa e padsisë. Në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heq dorë nga një pjesë e kërkesëpadsisë apo nga e gjithë kërkesëpadija, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi.

Edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një veprim procedural të palës paditëse i cili i nënshtrohet rregullave të LPK-së përkatësisht dispozitës nga neni 149 të LPK-së.

Për heqjen dorë nga kërkesa e padsisë palës paditëse nuk i nevojitet pëlqimi i palës së paditur.

Në praktikën gjyqësore gjykatat duhet të qartësojnë situatat kur kemi të bëjmë me tërheqje të padsisë me deklarinimin e palës paditëse dhe heqje dorë nga kërkesa e padsisë.

Qartësimi i këtyre situatave më së lehti bëhet duke i identifikuar dallimet në mes të tërheqjes së padsisë dhe heqjes dorë nga kërkesa e padsisë.

Dallimet në mes të tërheqjes së padsisë dhe heqjes dorë nga kërkesëpadija janë:

- Paditësi mund të heqë dorë nga kërkesëpadija pa pëlqimin e të paditurit deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.

- Në qoftë se paditësi heqë dorë nga kërkesa e padisë atëherë gjykata do të nxjerrë aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, ndërsa në qoftë se paditësi e tërheqë padinë gjykata do të marrë aktvendim me të cilin do ta konsiderojë të tërhequr padinë.
- Kundër aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia në çdo rast mund të paraqitet ankesë drejtuar gjykatës së shkallës së dytë, ndërsa kundër aktvendimit me të cilin konstatohet e tërhequr padia e paditësit nuk lejohet fare ankesë.
- Procesi gjyqësor i përfunduar me aktgjykim të heqjes dorë nga kërkesëpadia konsiderohet çështje e përfunduar me vendim meritot dhe nënkupton pamundësinë që paditësi për çështjen e njëjtë të paraqes përsëri padi pasi që nëse do të paraqiste përsëri padi do të konsiderohej si çështje e gjykuar, ndërsa në qoftë se procesi gjyqësor ka përfunduar me aktvendim me të cilin është konstatuar e tërhequr padia e paditësit i njëjti mund ta përsërisë prapë padinë e tij.

Refuzimi i dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia – Gjkata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme për një gjë të tillë po që se konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk kanë të dejtë të disponojnë lirisht.

Gjkata nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia sa herë që të konstaton se palët nuk mund të disponojnë lirisht me kërkesëpadinë e gjithashtu nuk do të jep aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia as në kontestet martesore.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia - dhënia e aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që të merren njoftimet e duhura, nëse kërkesa e padisë është kërkesë në të cilën palët mund të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të LPK-së).

Shembulli në situatën praktike: *Në qoftë se subjekti X e ka paditur subjektin Y për vërtetimin e të drejtës së pronësisë lidhur me pronën N.N. Supozojmë se në rastin konkret paditësi nuk ka legjitimitet aktiv në këtë çështje juridike - kontestuese për shkak të mungesës së raportit juridik - civil me palën e paditur dhe nën supozimin se i njëjti e deklaron heqjen dorë nga kërkesëpadia, gjykata mund ta shtyjë për më vonë dhënien e aktgjykimit deri sa të sigurojë dëshmi të mjaftueshme në bazë të cilave mund të konstatohet rrethanën se a është kërkesa e disponueshme për palët në këtë rast për paditësin. Në këtë mënyrë gjykata ex officio në kuptim të nenit 7.2 të LPK-së mund të mbledhë të gjitha informacionet e nevojshme për të nxjerrë përfundimin nëse kërkesa është e disponueshme apo jo.*

Revokimi i deklaratës mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia – Paditësi i cili e ka dhënë deklaratën mbi heqjen dorë nga kërkesëpadia gojarisht në seancë gjyqësore ose me anë të

parashtrësës jashtë seancës gjyqësore, mund ta revokojë të njëjtën pa pëlqimin e palës së paditur deri në momentin e dhënies së aktgjykimit.

5.4 Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë

Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë është risi të cilën e ka sjellë LPK-ja aktual. Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë është në funksion të efikasitetit të procedurave gjyqësore dhe shtimit të masave në funksion të parimit të ekonomizimit. LPK me dispozitën e nenit 150 në mënyrë specifike e ka rregulluar mundësinë e marrjes së këtij aktgjykimi.

Është me rëndësi të theksohet për praktiken gjyqësore se ky lloj i aktgjykimit mund të merret vetëm jashtë seancës gjyqësore dhe asnjëherë në seancë gjyqësore.

Sipas dispozitës së nenit 150.1 të LKP-së përcaktohet se: *“në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj nuk paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjykata jep aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë me të cilin aprovon kërkesëpadinë”*.

Aktgjykimin për shkak të padëgjueshmërisë do të mund ta nxjerrë gjykata në qoftë se plotësohen disa kushte kumulative:

- Po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjigjes në padi,
- Po që se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi,
- Po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Kushtet e lartë cituara nga ana e gjykatës duhet të vlerësohen në mënyrë kumulative dhe në mënyrë që e njëjta mund të nxjerrë vendim për shkak të padëgjueshmërisë dhe atë jashtë seancës dhe pa propozimin e palës paditëse. Nga kjo rrjedhë se gjykata kryesisht vlerëson nëse plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Është me rëndësi të theksohet se gjykata përveç kushtit që ndërlidhet me përgjigjen në padi duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadisë e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Kur analizohen me kujdes kushtet kumulative që duhet të plotësohen për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë rezulton se praktika gjyqësore do të jetë e kufizuar në shumë raste për nxjerrjen e këtij aktgjykimi pasi që në të gjitha rastet nga të cilat rrjedh se faktet do të provohen me prova të cilat nuk mund të deponohen së bashku me padinë me rastin e punimit të padisë në gjykatë, ky aktgjykim do të jetë i pamundur të nxirret. Për shembull në qoftë se një fakt do të provohet me dëgjimin e dëshmitarëve, ky aktgjykim nuk mund të nxirret, pastaj në qoftë se

një fakt do të provohet me nxjerrjen e ekspertizës ky aktgjykim gjithashtu nuk mund të nxirret etj.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë - Gjykata nuk do të nxjerrë aktgjykimin për shkak të mosbindjes pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse gjykata konstaton se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht.

Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë (neni 3.3 i LPK).

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë – Gjykata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë në qoftë se ka nevojë të merrë njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët. Gjithmonë kjo shtyrje duhet të ndodhë në periudhën deri sa gjykata nuk u ka dërguar palëve ftesat për seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor në qoftë se nuk cakton seancë përgatitore. Kjo për arsye se siç u theksua gjykata mund të jep këtë aktgjykim vetëm jashtë seancës.

Në çdo rast kur i padituri nuk ka dhënë përgjigje në padi por që nga faktet e treguar në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, gjykata cakton seancën përgatitore dhe po që se në seancën e këtillë paditësi nuk e ndryshon padinë, jep aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë. Kjo situatë ka nevojë të sqarohet për praktiken gjyqësore pasi që në seancën e shqyrtimit kryesor gjykata do të nxjerrë edhe prova tjera me të cilat provohen faktet e padisë e të cilat nuk i ka pasur në disponim gjykata me rastin e vlerësimit të kushteve për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Pra në shqyrtim gjyqësor kërkesëpadija nga provat e administruara mund të del si e bazuar.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin refuzohet propozimi i paditësit që t'i jepet aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë nuk lejohet ankimi. Ky përcaktim ligjor mund të krijojë hamendje në praktiken gjyqësore pasi që mund të interpretohet se është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë. Vlerësojmë se nuk është kusht propozimi i palës paditëse për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë.

5.5 Aktgjykimi për shkak të mungesës

Me aktgjykim për shkak të mungesës kuptojmë atë aktgjykim me të cilin pranohet si e themeltë kërkesëpadija e përmbajtur në padinë e ngritur kundër të paditurit i cili nuk mbrohet nga ajo, nuk e kundërshton kërkesëpadinë me veprim të shkruar dhe mungon në seancën përgatitore, apo në qoftë se nuk është mbajtur kjo, nga seanca e parë për shqyrtim kryesor, e paditësi i pranishëm e propozon dhënien e tij apo gjykata sipas detyrës zyrtare e jep këtë aktgjykim. Aktgjykimi për

shkak të mungesës është paraparë me dispozitat e nenit 151 të LPK-së. Në qoftë se krahasohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës dhe aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë do të vërehen se ekzistojnë disa ngjashmëri por edhe disa dallime esenciale.

Kështu gjykata do të nxjerrë aktgjykim për shkak të mungesës kur të paditurit nuk i është dërguar padia për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për seancë përgatitore apo në seancën e parë të shqyrtimit kryesor në qoftë se seanca përgatitore nuk është caktuar fare, ndërsa i padituri nuk vjen deri në përfundimin e seancës, atëherë gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin e aprovon kërkesëpadinë po që se plotësohen edhe këto kushte:

- nëse i padituri është thirrur rregullisht në seancë;
- nëse i padituri nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë me anë të parashtrësës,
- nëse themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi,
- nëse faktet në të cilat bazohet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat e paraqitura nga vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht,
- nëse nuk ekzistojnë rrethana notore nga të cilat del përfundimi se e kanë penguar të paditurin shkaqe të arsyeshme që të vijë në seancë.

Kushtet për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës duhet të kuptohen si prezumime procedurale dhe materiale që duhet të plotësohen përveç prezumimeve që duhet të plotësohen për çdo aktgjykim.

Është me rëndësi të theksohet se gjykata duhet tu kushtojë vëmendjen e duhur plotësimin të kushteve siç kërkohen e veçanërisht gjykata duhet të bëjë një vlerësim objektiv të themelësisë së kërkesëpadisë e cila gjithsesi duhet të rezultojë si e bazuar duke u mbështetur në faktet e treguara në padi të cilat duhet të jenë të provuara me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në këtë pikë vërehen zakonisht dobësitë e vendimeve të cilat merren për shkak të mungesës.

Mosdhënia e aktgjykimit për shkak të mungesës - Gjukata nuk do të nxjerrë aktgjykimin për shkak të mungesës pavarësisht se plotësohen kushtet, nëse konstatohet se është fjala për kërkesën në të cilën palët nuk kanë të drejtë të disponojnë lirisht. Kjo situatë është identike me të gjitha rastet në të cilat gjykata do të veprojë kryesisht kur konstaton se palët kanë pretendime të disponojnë me kërkesa që nuk mund të disponojnë.

Shtyrja e dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës – Gjukata mund të shtyjë dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës në qoftë se ka nevojë të merrë njoftimet e duhura lidhur me rrethanën nëse kërkesa e palëve është kërkesë e disponueshme për palët.

Gjukata me aktvendim e refuzon propozimin e palës për dhënien e aktgjykimit për shkak të mungesës, kundër të cilit nuk lejohet ankesë.

Duhet theksuar se dispozita e nenit 151 të LPK-së, të cilat parashohin mundësinë e marrjes së aktgjykimit për shkak të mungesës, nuk janë duke gjetur zbatimin e duhur pasi që njëri ndër kushtet për dhënien e këtij aktgjykimi është që gjykata fare mos t'i ketë dërguar të paditurit aktvendim për përgjigje në padi, ndërsa LPK-ja, në ana tjetër parashih detyrimin e gjykatës që palës së paditur t'i dërgoj aktvendimin për përgjigje në padi. LPK-ja nuk ka dispozita me të cilat e qartëson saktësisht se në cilat raste gjykata mundet fare mos t'i dërgojë palës së paditur aktvendimin për përgjigje në padi.

Vlerësojmë se aktgjykimi për shkak të mungesës më së shumti mund të gjej zbatim të kontestet me vlerë të vogël.

5.6 Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes

Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes nuk ka qenë i paraparë më LPK-në e vjetër. Me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, është paraparë mundësia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes. Më këtë dispozitë synohet efikasiteti i procesit gjyqësor civil.

Sipas kësaj dispozite gjykata do të nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të nxjerrë aktgjykim (neni 143 dhe 147 i LPK-së), nëse nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e tij.

Duhet theksuar se dispozita e nenit 152 ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 398 të LPK-së.

Kusht esencial për nxjerrjen e aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së, është që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe më përgjigje në padi t'i ketë pohuar faktet e prezumuara nga ana e palës së paditur. Në këtë rast për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes duhet të plotësohen në mënyrë kumulative kushtet që pala e paditur të ketë dhënë përgjigje në padi dhe gjithashtu t'i ketë pohuar faktet e çështjes të prezumuara nga paditësi.

Në çdo rast për praktikën gjyqësore duhet të jetë e qartë se aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes mund të nxirret vetëm jashtë seancës gjyqësore, çka do të thotë se për nxjerrjen e këtij aktgjykimi nuk do të caktohet as seancë përgatitore dhe as e shqyrtimit kryesor.

Në çdo rast nëse gjykata vlerëson se plotësohen kushtet për nxjerrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes atëherë mundet vetëm ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit por jo edhe ta refuzojë. Kjo nënkupton se nëse është dhënë përgjigje në padi, janë pohuar edhe faktet e prezumuara nga paditësi, por megjithatë pavarësisht së janë pohuar fakte nuk del themelësia e

kërkesëpadi së apo nëse kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht atëherë gjykata nuk e nxjerrë aktgjykimin pa shqyrtim kryesor të çështjes por e cakton seancën përgatitore apo të shqyrtimit kryesor.

5.7 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitës së nenit 398 të LPK-së

Dispozita e nenit 398 e LPK-së, ka ngjashmëri substanciale me dispozitën e nenit 152 të LPK-së, pasi që në të dy rastet gjykata pasi t'i arrijë përgjigja në padi pa shqyrtim kryesor do të nxjerrë aktgjykim me të cilin do ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Me dispozitën e nenit 398 parashihet se: *“kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, dhe konstaton së ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të jep aktgjykim me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.*

Edhe sipas kësaj dispozite rrjedhë se njëri ndër kushtet substanciale për dhënien e këtij aktgjykimi është dhënia e përgjigjes në padi nga ana e të paditurit. Kusht tjetër esencial është edhe vlerësimi i gjykatës përkatësisht konstatimi i gjykatës se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor. Dhënia e përgjigjes në padi është me rëndësi edhe te ky aktgjykim pasi që gjykata nga padia dhe përgjigja në padi do të mund të konstatojë, se cilat fakte në mes të palëve janë kontestuese e cilat jo dhe në bazë të kësaj të vendos për veprimet e mëtutjeshme.

Dallimet në mes të aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152) dhe aktgjykimit sipas dispozitës së nenit 398 janë:

- aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes do të emërtohet “aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, ndërsa aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 vetëm “aktgjykim” por në hyrje të aktgjykimit do të shënohet data e nxjerrjes dhe konstatimi se është vendosur jashtë seancës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), domosdoshmërisht duhet të ketë pohim të fakteve të çështjes nga ana e të paditurit, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 nuk është e domosdoshme të ketë pohim të fakteve të prezumuara nga paditësi, por vlerësimi se gjendja faktike nuk është kontestuese në mes të palëve duhet të jetë vlerësim i gjykatës.
- te aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes (neni 152), arsyetimi i aktgjykimit sa i përket analizës dhe përfundimit për gjendjen e fakteve në të cilat mbështetet

kërkesëpadia është fare i shkurtër, ndërsa te aktgjykimi sipas dispozitës së nenit 398 arsyetimi i aktgjykimit për faktet e çështjes dhe përfundimi i gjykatës lidhur me konstatimin se nuk është kontestuese gjendja faktike në mes të palëve duhet të jetë analizë e mirëfilltë, vlerësim logjik e objektiv se si gjykata ka konstatuar se nuk është kontestuese gjendja e fakteve.

5.8 Nxjerrja e aktgjykimit pa caktuar seancë gjyqësore sipas dispozitave nga neni 399 i LPK-së.

Dispozita e nenit 399 janë risi në LPK-në aktual, pasi që LPK-ja e vjetër nuk i ka përmbajtur këto dispozita.

Qëllimi i këtyre dispozitave është në funksion të parimit të ekonomizimit dhe efikasitetit të procesit gjyqësor.

Sipas dispozitës së nenit 399.1 është përcaktuar se: *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendim meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Sipas dispozitës nga paragrafi 2 i nenit 399 parashihet se: *“kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të nenit 399, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo po që se faktet mbi të cilat mbështet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Për dallim nga dispozitat e nenit 152 dhe 398 me të cilat është paraparë mundësia që gjykata të bie aktgjykim pa shqyrtim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë, me dispozitën e nenit 399 është parë mundësia e nxjerrjes së aktgjykimit pa shqyrtim por për refuzimin e kërkesëpadiës.

Gjykata do të vlerësojë se kërkesëpadia është e pathemeltë në qoftë se ajo qartazi është në kundërshtim me faktet të cilat paditësi i ka theksuar në padi, në qoftë se faktet të cilat i ka prezantuar janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar paditësi për vërtetimin e fakteve, apo nëse kërkesëpadia është në kundërshtim me faktet e ditura botërisht.

Kërkesëpadia do të jetë në kundërshtim me faktet në qoftë se sipas të drejtës materiale nga faktet e treguara nuk del themelësia e kërkesëpadiës, faktet do të jenë në kundërshtim me provat në qoftë se me provat e propozuara do të vërtetohen fakte tjera nga ato të prezantuara nga paditësi e gjithashtu në qoftë se faktet e prezantuara nga paditësi do të jenë në kundërshtim me faktet e ditura botërisht e të cilat nuk ka nevojë të provohen.

6. Aktgjykimi plotësues

Nëse gjykata me vendim meritior nuk ka vendosur për ndonjë kërkesë të palës, atëherë ajo mund të kërkojë që gjykata të vendos lidhur me këtë kërkesë.

LPK sa i përket kërkesës nuk bën dallim në mes të kërkesave kryesore dhe atyre aksesore. Me dispozitën e nenit 162.1 të LPK-së, është përcaktuar se: *“Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen në aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t’i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij”*. Po që se pala nuk paraqet propozimin brenda afatit do të konsiderohet se është tërhequr padia në pjesën që nuk është përfshirë në aktgjykimin e dhënë. Propozimi i vonuar për plotësimin e aktgjykimit hidhet poshtë nga ana e gjykatës ndërsa propozimi i pathemeltë refuzohet nga gjykata pa u caktuar seanca gjyqësore.

Nga të cekurat rrjedh se gjykata do ta plotësojë aktgjykimin nëse plotësohen disa kushte në mënyrë kumulative:

- Nëse nuk është vendosur për të gjitha kërkesat apo për një pjesë të kërkesës,
- nëse paraqitet propozimi për plotësim nga pala dhe
- nëse propozimi për plotësim të aktgjykimit është i afatshëm.

Vlerësojmë se gjykata nuk mundet ex officio të bëjë plotësimin e aktgjykimit pa pasur propozim nga pala.

Konsiderohet se është kërkesë për plotësim edhe ankesa e cila mbështetet vetëm në shkakun se gjykata nuk ka vendosur për tërë kërkesëpadinë, pra në këtë rast gjykata ankesën duhet ta trajtoj si kërkesë për plotësimin e aktgjykimit.

Paditësi i cili nuk e ka parashtruar kërkesën për plotësimin e aktgjykimit nuk e humb të drejtën që për pjesën e pavendosur të paraqesë padi të re.

Në qoftë së propozimi për plotësimin e aktgjykimit i referohet vetëm kërkesës për shpenzime atëherë gjykata nuk vendos me aktgjykim por me aktvendim.

Kundër aktgjykimit plotësues lejohet ankesë e veçantë.

7. Dhënia, hartimi me shkrim dhe dërgimi i aktgjykimit

Parimisht, aktgjykimi duhet dhënë menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit kryesor. Gjithashtu, menjëherë pas dhënies aktgjykimi duhet shpallur në seancë.

Sipas dispozitës së nenit 153.1 të LPK-së, gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Koha në të cilën jepet aktgjykimi quhet dita në të cilën ai hartohet me shkrim.

Në qoftë se gjyqtari e kalon afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për dhënien e aktgjykimit ai ka për detyrë ta njoftojë kryetarin e gjykatës për shkaqet e tejkalimit të tij.

Mos përmbajtja ndaj afatit për dhënien e aktgjykimit nuk ka kurrfarë pasojash procedurale-juridike për palët, ndërsa për gjyqtarin mos përmbajtja e afatit mund të ketë pasoja administrative të natyrës disiplinore.

Shpallja e aktgjykimit- pas përfundimit të shqyrtimit kryesor gjykata i njofton palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit, e në qoftë se ndonjëra nga palët nuk merrë pjesë në seancë atëherë gjykata duhet që ta njoftojë me shkrim.

Duhet theksuar se në praktikën gjyqësore në vendin tonë nuk respektohet detyrimi i shpalljes së aktgjykimit përveç në një numër të vogël kontestesh, pasi që në praktikën gjyqësore respektohet detyrimi i gjykatës që palës t'i dërgojë aktgjykimin me shkrim siç parasheh dispozita e nenit 155.2 e LPK-së.

Mos shpallja e aktgjykimit nga gjykatat tona është edhe pasoja e procedurës shumë formale që parasheh dispozitat e nenit 154 paragrafi 1 e LPK-së, me të cilën përcaktohet detyrimi i gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit kryesor t'i njoftojë palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit (mendohet për shpalljen e aktgjykimit), e rrjedhimisht në qoftë se ndonjëra nga palët nuk ka marrë pjesë në seancën për shqyrtim kryesor, gjykata më shkrim ta njoftojë të njëjtën për ditën e dhënies së aktgjykimit. Vlerësojmë së kjo është një procedurë shumë formale që është në kundërshtim me parimin e ekonomizimit të procedurës, prandaj ne insistojmë që të respektohet afati për hartimin me shkrim brenda 15 ditësh, ndërsa për detyrimin e shpalljes së aktgjykimit gjithsesi mendojmë së është një detyrim ligjor që duhet respektuar, por rrethanat praktike sigurisht që do të ndikojnë që ky detyrim që mos jetë i zbatuar. Në këtë aspekt paraqitet edhe një problematikë që lidhet më afatin e ankimit pasi që sipas dispozitës së nenit 154.2 të LPK-së, parashihet së në qoftë se palët janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit, afati për ankim kundër aktgjykimit fillon të ecë ditën e nesërme pas dorëzimit të aktgjykimit. Në këtë kontekst shtrohet pyetja çka nëse palët nuk janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit sidomos kur njëra palë nuk ka marrë pjesë në seancën, çka ndodh me afatin nëse njëra palë ka qenë e njoftuar rregullisht dhe nuk ka marrë pjesë.

Mendojmë se dispozitat ligjore janë të paqarta, e për rrjedhojë ka ndikuar edhe në krijimin e praktikës që palëve t’ju dërgohet aktgjykimi me shkrim pa e shpallur paraprakisht gjykata të njëjtin.

Aktgjykimi burimor - aktgjykimin burimor e nënshkruan gjyqtari. Nga kjo rrjedhë se gjyqtari e nënshkruan vetëm një dokument origjinal (aktgjykimin burimor). Sipas kuptimit të dispozitës së nenit 159 rrjedhë se palëve të kontestit duhet tu dërgohet kopja e legalizuar e aktgjykimit, ndërsa aktgjykimi burimor duhet të ruhet së bashku me shkresat e lëndës në gjykatë. Praktika gjyqësore është e ndryshme pasi që gjykatat tona palëve u dërgojnë nga një kopje të aktgjykimit të cilat janë të nënshkruara nga gjyqtari, ndërsa praktika tregon se në gjykatën e shkallës së dytë dhe të tretë respektohet kuptimi i kësaj dispozite.

Momenti i komunikimit të aktgjykimit në aspektin procedural është i rëndësishëm sepse nga ky moment fillon të ecë afati partitiv (afati i përmbushjes vullnetare të detyrimit) e gjithashtu fillon të ecë edhe afati për të drejtën e ankesës. Këtu bëhet fjalë për dorëzimin e aktgjykimit palëve e jo shpalljen e tij.

8. Korrigjimi i aktgjykimit

Korrigjimi i aktgjykimit i referohet vetëm mungesave që kanë të bëjnë me gabimet e bëra në shkrim ose llogari, si dhe pasaktësitë e dukshme të vendimit. Të kësaj natyre janë edhe gabimet në lidhje me formën e aktgjykimit si dhe mospajtimi midis kopjes dhe origjinalit të aktgjykimit. LPK-ja me dispozitën e nenit 165 i referohet korrigjimit të aktgjykimit.

Sipas dispozitës së nenit 165.1 përcaktohet se: *“gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi midis kopjes me origjinalin e aktgjykimit, e korrigjon gjykata në çdo kohë”*.

Gjykata për korrigjimin e gabimeve nxjerrë aktvendim të posaçëm dhe një kopje e këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

Në qoftë se midis origjinalit dhe kopjes së aktgjykimit ka mospajtime atëherë palëve u dërgohet nga një kopje e korrigjuar e aktgjykimit, duke u treguar se më këtë kopje të aktgjykimit zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në këtë rast afati për ankim kundër pjesës së korrigjuar fillon të ecë nga dita e pranimit të kopjes së korrigjuar nga palët.

Për korrigjimin e aktgjykimit gjykata vendos pa dëgjimin e palëve. Kundër aktvendimit me të cilin bëhet korrigjimi i aktgjykimit lejohet ankesë e veçantë.

Gabimet përkatësisht mungesat në aktgjykim të cilat janë bazë e korrigjimit të aktgjykimit nuk guxojnë të jenë rezultat i formulimit të gabuar të vullnetit të gjykatës në kohën e dhënies së vendimit, sepse me anë të korrigjimit nuk mund të ndryshohet vullneti i gjykatës i formuar me rastin e dhënies së vendimit, pasi që gjykata është e lidhur me të nga momenti i shpalljes së aktgjykimit.

9. Forma e prerë e aktgjykimit

Marrëdhëniet e ndryshme juridike të palëve në kontest caktohen në mënyrë përfundimtare, atëherë kur vendimi i gjykatës merr formën e prerë.

Pas marrjes së formës së prerë, vendimi fiton fuqinë e *“gjësë së gjykuar”* që do të thotë se pala që ka fituar gjyqin mund të vërë vendimin në përmbarim të detyrueshëm në qoftë se ai nuk ekzekutohet vullnetarisht nga subjekti që ka humbur gjykimin (debitori).

Sipas dispozitës së nenit 166.1 të LPK-së, parashihet se *“aktgjykimi i cili nuk mund të goditet me anë të ankesës bëhet i formës së prerë për aq sa është vendosur me të mbi kërkesëpadinë apo të kundërpadisë”*.

Është detyrë e gjykatës që ex-officio gjatë tërë procedurës të kujdeset nëse çështja objekt i shqyrtimit është gjë e gjykuar. Nëse konstatohet se kemi të bëjmë me çështje të gjykuar padia hedhet poshtë si e palejueshme.

Aktgjykimi mund të bëhet i formës së prerë:

- nëse palët kanë hequr dorë nga e drejta për të parashtruar ankesë,
- nëse palët i kanë tërhequr ankesat e paraqitura,
- nëse ka kaluar afati për paraqitjen e ankesës dhe
- nëse ka vendosur gjykata e shkallës së dytë duke e refuzuar ankesën dhe duke e vërtetuar vendimin e shkallës së parë.

Sipas LPK-së, kundër të gjitha aktgjykimeve lejohet e drejta e ankesës, prandaj në asnjë rast aktgjykimi nuk mund të bëhet i formës së prerë në mënyra tjera përveç mënyrave të cekura.

Aktgjykimi i formës së prerë prodhon efekt juridik vetëm ndërmjet palëve ndërgjyqëse, përveç kur nga shkaku i natyrës së raportit kontestues apo, sipas urdhrorit të ligjit, prodhon efekt kundër personave të tretë.

10. Udhëzime për përmbajtjen e të dhënave në vendimet gjyqësore për shkak të anonimizimit dhe publikimit

Sistemi gjyqësor i Kosovës është duke vepruar në drejtim të realizimit të objektivave për transparencën e për punë gjyqësorit dhe një nder komponentët kryesor në këtë drejtim është publikimi i vendimeve gjyqësore.

Lidhur me publikimin e vendimeve gjyqësore Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve të Plotfuqishme.

Me këtë Udhëzim Administrativ është përcaktuara mënyra e anonimizimit dhe publikimit të aktgjykimeve të plotfuqishme në ueb-faqen zyrtare, në interes të qasjes publike në aktgjykimet e gjykatave për promovimin e transparencës gjyqësore.

Sipas Udhëzimit është përcaktuar se aktgjykimet duhet të publikohen në formë të plotë duke i anonimizuar disa të dhëna.

Me dispozita e nenit 3 të Udhëzimit Administrativ janë përcaktuara të dhënat që duhet të anonimizohen, më përmbajtje si në vijim:

“3.2. Te dhënat personale në aktgjykimet e plotfuqishme penale, civile, administrative dhe ekonomike që anonimizohen janë:

3.2.1 Emri, mbiemri, adresa, data dhe vendi i lindjes, numri i letërnjoftimit apo pasaportës, patente-shoferi apo tabelat e regjistrimit të automjetit, apo numri i ndonjë dokumenti tjetër personal i palës.

3.2.2 Te autorizuarit e palës, siç; janë përfaqësuesit ligjore të palës, avokatet apo praktikuesit ligjore, noterët, duke përjashtuar avokatin shtetëror.

3.2.3 Administruesit falimentues dhe debitorët.

3.2.4 Kreditorët ekzekutues dhe debitorët.

3.2.5 Numri personal apo numri fiskal.

3.2.6 Adresa e email-it apo ueb-faqja apo adresa/faqet tjera në rrjetet sociale.

3.2.7 Personi i vdekur, testament lënësi dhe trashëgimtarët e tij/saj, dëshmitarët, të afërmit dhe të tjerët që kanë ndonjë lidhje me personin e vdekur.

3.2.8 Ekspertet e gjykatës dhe përkthyesit, dhe dëshmitarët e gjykatës, përfshirë por jo vetëm dikush që ka lidhje me palën (familja, miku, etj.) punëtorët sociale, psikologët, arsimtarët, doktorët, etj.

3.2.9 Komuna (përveç; nëse qyteti apo komuna është pale në rast).

3.2.10 Viktima, i dënuari, dëshmitari, dhe personat e tjerë të akuzuar por të liruar ose kundër të cilëve është refuzuar aktakuza.

3.2.11 Ekspertet mjeko-ligjore dhe ekspertet hetues”.

Në disa raste ndodh që vendimet gjyqësore përmbajnë shumë të dhëna të cilat në fazën e publikimit të vendimeve gjyqësore duhet të anonimizohen. Në rastet kur aktgjykimet përmbajnë

shumë të dhëna që duhet të anonimizohen atëherë paraqitën vështirësi për Zyrën e Publikimit të Vendimeve sepse procesi merr shumë kohë.

Në çështje civile Ligji për Procedurën Kontestimore i ka përcaktuar të dhënat që duhet ti përmbaj aktgjykimi në pjesën hyrëse, në dispozitiv dhe në arsyetim, prandaj është e këshillueshme që secili gjyqtar ti përmbahet me korrektësi dispozitave ligjore për përmbajtjen e aktgjykimit dhe të mos e ngarkoj aktgjykimin më të dhëna të cilat duhet të anonimizohen kur ato nuk janë të nevojshme.

Parimisht hyrja e aktgjykimit është pjesa formale a e aktgjykimit e cila përmban të dhënat kryesore për palët ndërgjyqësore ndërsa në pjesët tjera të aktgjykimit gjyqtarët duhet të rezervohen nga përshkrimi i panevojshëm i të dhënave të palëve dhe subjekteve tjera të procedurës sidomos kur ato të dhëna janë paraqitur në hyrje të aktgjykimi. Krejt kjo më qëllimin e vetëm që të lehtësohet procesi i anonimizimit të të dhënave për publikimin e e vendimeve gjyqësore.

Për shembull:

-Kur të dhënat për palët ndërgjyqësore janë shënuar në hyrje të aktgjykimit nuk është e nevojshme përsëritja e tyre edhe në pjesë e arsyetimit, por përdoren nocionet që ligji u njeh palëve si “paditësi” dhe “ i padituri”.

- Kur ekzistojnë ma shumë subjekt si paditës, gjykata në arsyetim nëse është e nevojshëm të specifikohet njëri nga “ta” nuk e shënon ermin dhe mbiemrin e “tij” por shënon, për shembull “paditësi i parë”, “paditësi i dytë”, “i padituri i parë”, “i padituri i dytë” etj.
- Në qoftë së është dëgjuar një dëshmitar , gjykata në pjesën e përshkrimit të provave të administruara i shënohen të dhënat e dëshmitarit, por nuk përsërit më emrin e tij, sepse përdoret emërtimi “dëshmitari”, etj.
- Në qoftë se është nxjerr një ekspertizë nga eksperti përkatës, në pjesë e përshkrimit të provave të administruara shënohen të dhënat për ekspertin por pastaj përdoret emetimi “ekspertiza” apo “eksperti”.

Në këtë mënyrë ne mund të rezervohemi nga përshkrimi i të dhënave të përsëritura dhe të panevojshëm në vendime gjyqësore.

Është në interesin e drejtësisë por edhe të secili gjyqtar që të publikohen vendimet e gjykatave sepse publikimi do të shërbej për ngritjen e nivelit të besueshmërisë në gjykata dhe rrjedhimisht do të ndikoj në ndërtimin imazhit të secilit gjyqtar, prandaj këshillohet që gjatë hartimit të vendimeve gjyqësore të jemi të kujdesshëm dhe të mos i ngarkojmë vendimet me të dhëna të panevojshme duke ndikuar kështu që të publikohen sa ma shumë vendime që është e mundur.

PJESA E PESTË

PRAKTIKA GJYQËSORE PËR SHKRIMIN DHE ARSYETIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

I. NGA PRAKTIKA E GJYKATËS KUSHTETUESE PËR ARSYETIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

Rasti I.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës
Rastin nr. KI72/12, Prishtinë, më 07. Dhjetor 2012.

”Përfundimisht, neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut përcakton: Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Prandaj, parashtruesit e kërkesës kanë të drejtë të marrin një vendim gjykate në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), kur "kontestet lindin nga një akt i Republikës së Kosovës, ose nga autoriteti publik i Republikës së Kosovës". Kjo e drejtë përfshinë obligimin e gjykatave që të ofrojnë arsye për vendimet e tyre, me bazë të arsyeshme, në nivelin procedural dhe material. E drejta për të pasur arsye për vendime të gjykatës kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe ligjërish të ndërtuara mirë për vendimin e marrë në çdo rast individual.

*Kështu, e drejta për një gjykim të drejtë përfshinë të drejtën për një aktgjykim të arsyetuar. GJEDNJ-ja konsideron se, derisa autoritetet gëzojnë liri të konsiderueshme në zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme për të siguruar se sistemet e tyre gjyqësore janë në përputhje me kërkesat e nenit 6(1) të Konventës, gjykatat e tyre duhet "t'i tregojnë me qartësi të mjaftueshme bazat mbi të cilat e kishin bazuar vendimin e tyre". (Shih, *Hadjianastassiou vs. Greqise*, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 33).*

*Në një aktgjykim të kohës së fundit, GJEDNJ përsëriti se "aktgjykimet e gjykatave dhe të tribunaleve duhet t'i theksojnë në mënyrë adekuate arsyet në të cilat ata bazohen". (Shih, *Tatishvili vs. Rusise*, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).*

*Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës i obligojnë gjykatat të japin arsye për aktgjykimet e tyre. Sidoqoftë, kjo nuk nënkupton të kërkuarit e përgjigjes së detajuar nuk do argument apo pyetje (Shih, *Van de Hurk vs. Holandes*, 19 prill 1994, paragrafi 61). Masa deri në të cilën aplikohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit. Megjithatë, nëse parashtrësa është me rëndësi thelbësore për rezultatin e rastit, pasi që është*

pronë në një rast te rrënimit, atëherë gjykata duhet te merret ne mënyrë te veçante me te ne aktgjykimin e saj.

Një funksion tjetër i vendimit te arsyetuar është t'u tregoje palëve se ato janë dëgjuar. Për me tepër, një vendim i arsyetuar i ofron mundësinë palës për t'u ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e rishikimit te vendimit nga një organ ankimor. Vetëm duke lëshuar vendim te arsyetuar, mund te ketë shqyrtim publik te administrimit te drejtësisë. (Shih, Tatishvili vs. Rusise, Aktgjykimi i GJEDNJ-se i 22 shkurtit 2007, paragrafi 58).

Veç kësaj, e drejta e marrjes së vendimit gjyqësor në harmoni me ligj, përfshin obligimin e gjykatave të ofrojnë arsye për aktvendimet e tyre me baza të arsyeshme në nivel procedural dhe material. Sigurimi i arsyeve kërkon shpjegime me arsye bindëse dhe të ndërtuara mirë për vendimin e marrë në çdo rast individual, i cili duhet të përfshijë që të dyja: kriteret ligjore dhe elementet faktike në mbështetje të vendimit.

Në rastin Hiro Balani vs. Spanjes, parashtruesi kishte paraqitur parashtrësë në gjykatë, me të cilën kërkonte përgjigje të veçantë dhe të qartë. Gjykata dështoi ta japë atë përgjigje, duke e bërë të pamundur konstatimin se nëse ajo thjeshtë e kishte lënë pas dore të merret me çështjen ose e kishte ndërmend ta refuzojë dhe nëse është ashtu, cilat ishin arsyet për refuzimin e saj. Nga GJEDNJ-ja u gjet se kjo ishte shkelja e nenit 6 (1) të Konventës.

Rrjedhimisht, deklarata e arsyeve duhet t'i mundësojë personit, të cilit i drejtohet vendimi dhe opinionit në përgjithësi, për ta ndjekur arsyetimin, i cili e çoi gjykatën të marrë vendimin konkret.

Prandaj, arsyetimi i vendimit duhet ta theksojë raportin ndërmjet gjetjeve të meritave dhe reflektimit, kur t'i shqyrtoje provat e propozuara nga një anë dhe konkluzionet ligjore nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do ta shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, nëse arsyetimi i dhënë dështon të përmbaje fakte të vërtetuara dhe dispozita ligjore si dhe marrëdhënien logjike ndërmjet tyre.

Gjykata vëren se, në rastin në fjalë, arsyetimi i Gjykatës Supreme nuk është mjaftueshëm i shprehur dhe i përpunuar, pasi që raporti ndërmjet provave përkatëse, vlerësimit relevant të dispozitave të aplikueshme ligjore dhe gjetjeve të meritave nuk është konstatuar në mënyrë të qartë dhe të plotë.

Në këtë mënyrë, gjykata konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme të sigurojë përgjigje të qarta dhe të plota vis-a-vis kërkesave pronësore kritike i shkelë të drejtat e parashtruesit që të dëgjohet, si dhe të drejtën për një vendim të arsyetuar, si një element i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Prandaj, Gjykata konkludon se ka shkelje të nenit 31 [E drejta për një Gjykim të drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës”.

Detyrimi për arsyetimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile përveç se ekziston si detyrim që rrjedh nga Konventa Evropiane, përcaktohet specifikisht edhe me dispozitat e LPK-së.

Rasti II.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës Rastin nr. KI18/16, më datë 15 korrik 2016.

Neni 6 [E drejta për një proces të rregullt], paragrafi 1 i KEDNJ-së, parasheh: "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me Zigj".

Për më tepër, Gjykata rithekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës: "Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut".

Gjykata rikujton se ankesa kryesore e parashtruesit të kërkesës bazohet në faktin se Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm aktgjykimin e saj, respektivisht nuk ka arsyetuar se për cilat arsye u ndryshuan vendimet e gjykatave më të ulëta, që kishin të bënin me lartësinë e caktuar të kompensimit monetar për dëmin jo material të shkaktuar, ndërsa në anën tjetër, Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit i arsyetuan aktgjykimet e tyre bazuar në gjetjet nga ekspertiza dhe super-ekspertiza, duke analizuar me kujdes secilin raport veç e veç.

Gjykata konstaton se Gjykata Themelore në Prishtinë e përcaktoi shumen e kompensimit për dëmin jo material që do t'i paguhej parashtruesit të kërkesës, duke i pranuar në tërësi ekspertizën mjekësore dhe super-ekspertizën të kryer nga disa ekspertë mjekësorë. Gjykata Themelore në përcaktimin e shumës së kompensimit, gjithashtu, u thirr në praktiken e vendosur gjyqësore në raste të ngjashme.

Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit në tërësi e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komonale në pjesën lidhur me caktimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar jo material, ndërsa në pjesën lidhur me caktimin e kompensimit të dëmit të shkaktuar material e prishi aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ktheu në Gjykatën Themelore për rigjykim.

Gjykata e Apelit e ka arsyetuar Aktgjykimin e saj në pjesën lidhur me konfirmimin e kompensimit të caktuar për dëmin jo material si më poshtë:

"Vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket kompensimit për dhimbje fizike, frikës, shëmtimit, dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si dhe kompensimit të dëmit material në emër të veturës së dëmtuar në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë për arsye se dispozitivi i aktgjykimin të atakuar në këto pjesë është

i qartë i kuptueshëm dhe si i tillë i përshtatshëm përmbartim. Dispozitivi në këtë pjesë nuk është në kundërtë me vetveten dhe me arsyetimin dhe se përmban arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare në këtë çështje juridike. Kështu aktgjykimi i atakuar në këtë pjesë nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 të LPK, të cilat i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK. Për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës të shkallës së parë sa i përket këtyre formave të dëmit. Gjykata e Apelit vlerëson se shumica e gjykuar në emër të dëmit jo material është satisfaksion për paditësin {parashtruesin e kërkesës} lidhur me vendosjen e ekuilibrit të dhimbjeve shpirtërore me dëm jo material të pësuar dhe në këtë pjesë pretendimet ankimore paraqiten si të pabazuara".

Në anën tjetër, Gjykata rikujton se Gjykata Supreme, përderisa e ka zvogëluar dukshëm shumën e kompensimit për dëmin jo material, që është arsyetuar dhe aprovuar nga gjykatat e instancës më të ulët, ajo vetëm e ka arsyetuar aktgjykimin e saj, duke theksuar që "duke konsideruar që shumata e kompensimit nuk janë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material". Gjykata Supreme gjithashtu mori parasysh "moshën e paditësit (... natyrën e lëndimeve si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jo material". Gjykata Supreme konsideroi se "shumat e gjykuara (... janë reale dhe paraqesin satisfaksion të plotë për paditësin".

Megjithatë, me vendimin e Gjykatës Supreme, nuk është sqaruar asnjë nga faktet që i ka shqyrtuar as ndonjë prej arsyeve të veçanta që ajo mund të ketë marrë parasysh, kur në mënyrë të konsiderueshme i ka ndryshuar dhe zvogëluar shumata e miratuara më parë nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

Në këtë drejtim, Gjykata sqaron se nuk e ka për detyrë të shqyrtojë nëse Gjykata Supreme e ka interpretuar saktë ligjin e aplikueshëm (ligjshmëria), por nëse Gjykata Supreme me aktgjykimin e saj të lartpërmendur i ka shkelur të drejtat dhe liritë individuale të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria) (shih, për shembull, Rasti nr. KI72/14, parashtruesja e kërkesës: Besa Qirezi, Aktgjykimi i 4 shkurtit 2015, paragrafi 65).

Përveç kësaj, si rregull i përgjithshëm, vërtetimi i fakteve të rastit dhe interpretimi i ligjit janë ekskluzivisht çështje për gjykatat e rregullta, të gjeturat dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë detyruese për gjykatën.

Megjithatë, kur vendimi i gjykatës së rregullt është arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta shqyrtojë (Shih, Sisojeva dhe të tjerë kundër Letonisë [DHM], kërkesa nr. 60654/00, Aktgjykimi i 15 janarit 2007, paragrafi 89).

Në të vërtetë, Gjykata rithekson se aktgjykimi i kontestuar nuk i referohet ndonjë arsyeje faktike dhe ligjore në lidhje me atë se si dhe pse ai dallonte në mënyrë të konsiderueshme nga vendimi i gjykatave të shkallës më të ulët sa i përket shumës së kompensimit për dëmin jo material.

Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se mbi çfarë baze i ndryshoi vendimet e gjykatave më të ulëta përkitazi me caktimin e lartësisë së kompensimit për dëmin e shkaktuar jo material, si dhe përse Gjykata Supreme konsideroi se vendimet fillestare nuk ishin adekuate dhe nuk ishin në përputhje me natyrën e kompensimit për dëmin jo material.

Gjykata vëren se vlerësimet e dhëna në Aktgjykimin e kontestuar, dhe të cilat e arsyetojnë vendimin, bazohen në formulimin "nuk janë adekuate dhe në përputhje", "moshën e paditësit (...J natyrën e lëndimeve si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jo material" dhe "shumat e gjykuara (...J janë reale dhe paraqesin satisfaksion të plotë për paditësin".

Megjithatë, gjykata vlerëson se pa arsye faktike dhe ligjore, këto vlerësime janë të natyrës bindëse dhe nuk mund të plotësojnë standardet e kërkuara për një vendim të arsyetuar dhe të respektojnë të drejtën e parashtruesit për një vendim të arsyetuar, të garantuar me Kushtetutë dhe me KEDNJ.

Gjykata konsideron se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme nuk arsyetohet veçanërisht se përse shuma e ndryshuar e kompensimit monetar për dëmin jo material që i është shkaktuar parashtruesit ishte ndryshuar dhe zvogëluar në raport me qëndrimin e gjykatave të shkallës më të ulët për çështje të njëjtë.

Gjykata rithekson se e drejta për të marrë një vendim gjyqësor në pajtim me ligjin përfshin detyrimin e gjykatave të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre, si në nivelin procedural ashtu dhe në nivelin substancial.

Konkluzioni i lartpërmendur vërtetohet nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, e cila përcakton se dhënia e arsyeve kërkon arsyetime bindëse dhe të ndërtuara mirë ligjërisht për vendimin e marrë në çdo rast individual i cili duhet të përfshijë edhe kriteret ligjore edhe elementet faktike në mbështetje të vendimit (Shih Gjykata Kushtetuese, rastet KI72/12, parashtrues të kërkesës: Veton Berisha dhe Ilfete Haziri, Aktgjykimi i 7 dhjetorit 2012. dhe KI135/14

Parashtrues IKK Classic Aktgjykim i 8 shkurtit 2016).

Ngjashëm me këtë, GJEDNJ konstatoi shkelle të nenit 6 (1) (Shih Hiro Balani kundër Spanjës, Nr. 46/1993/441/520 Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 9 dhjetorit 1994), të Konventës (në rastin kur kishte konkluduar se gjykatat në procedurën e rregullt nuk i kishin arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme vendimet e veta e as nuk kishin dhënë përgjigje në çështjet thelbësore të parashtruesit, që e kishte bërë të pamundur përcaktimin nëse gjykatat e rregullta thjeshtë e kishin neglizhuar këtë çështje, ose nëse kishin pasur qëllimin ta hidhnin poshtë kërkesën (në atë rast, mutatis mutandis, ta ndryshojnë) dhe, nëse po, cilat ishin arsyet për hedhjen poshtë (në atë rast, mutatis mutandis, për ndryshimin).

Rrjedhimisht, arsyetimi duhet t'ia mundësojë personit të cilit i drejtohet vendimi dhe opinionit në përgjithësi, që ta kuptojë arsyetimin që qoi Gjykatën në nxjerrjen e atij vendimi.

Për këtë arsyeje, Gjykata konsideron se dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje të qarta dhe të plota në lidhje me pyetjen se pse e ka konsideruar të nevojshëm ndryshimin e shumës së kompensimit monetar për dëmin jo material që do t'i paguhej parashtruesit të kërkesës nga SIGMA, siç ishte vendosur nga gjykatat më të ulëta, paraqet shkelle të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për një vendim të arsyetuar, si pjesë përbërëse e së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Prandaj, Gjykata konkludon se ka shkelle të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

Përveç kësaj, gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës. Në këtë drejtim, gjykata konsideron se nuk është e nevojshme që të merret më tej me pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 21 të Kushtetutës, jo vetëm sepse parashtruesi i kërkesës ka mbështetur pretendimin, por edhe sepse është konstatuar shkelje e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

II. NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ARSYETIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

Rasti I.

Gjykata Supreme e Kosovës, në vendimin e saj Rev. Nr.15/2015, të datës 11.05.2015, thekson së:

“Gjykata Supreme e Kosovës tani për tani nuk mund ta pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, si të drejtë dhe të ligjshëm ngase sipas vlerësimit të saj aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara nga neni 182.2 pika n) të LPK-së, dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk është vërtetuar gjendja faktike, ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara me nenin 182.1, lidhur me nenin 194 të LPK-së, për të cilin shkak të dy aktgjykimet e përmendura u dashtë të prishen.

Shkelje thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore qëndron në faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit ka paraqitur kronologjinë e provave të administruara dhe faktet me të cilat i ka vërtetuar ato, por nuk ka dhënë vlerësimin se cilat fakte vendimtare janë vërtetuar dhe në çka e bazon vlerësimin e saj, kur lidhur me faktet vendimtare ka kundërthënë mes asaj që thuhet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së provës me shikim, në të cilën mbështetet aktgjykimi si dhe mes provave të administruara.....”.

Rasti II.

Gjykata Supreme e Kosovës, me Rev.nr.182/2016, dt.04.10.2016.

“aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i gjykatës së shkallës së dytë, është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika (n) të LPK-së, sepse në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënë midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit, ngase, në arsyetimin e aktgjykimit të cekur është konstatuar se paditësi nga data 03.09.2010 është sistemuar te e paditura në vendin e punës Zyrtar i shitjes

për biznes-vala dhe në këtë pozitë është paguar me gradën 5, mirëpo, në shkresat e lëndës mungon aktvendimi nr.01-5341/11, datë 29.11.2011, (me të cilin vendim gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin e saj), nuk mund të vërtetohet se paditësit cila gradë e të ardhurave personale i është caktuar. Sipas kontratës së punës nr.01-2880-2024/2011, datë 20.10.2011, paditësi i është caktuar grada 5”.

III. NGA PRAKTIKA E GJYKATËS SË APELIT PËR ARSYETIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE

Rasti I.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me vendimin Ac.nr.1761/13, dt. 10.03.2017

“Gjykata e Apelit nuk mund të pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së, vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe aplikim i gabuar i të drejtës materiale nga neni 184 të LPK-së, andaj është dashur që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, nuk ka dhënë arsye lidhur me atë mënyrë të vendosjes, nuk arsye se në bazë të cilave prova ka vendosur në pjesën aprovuese dhe në pjesën refuzuese, kjo është në kundërshtim me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, pasi është detyrë e gjykatës që në arsyetim të jep arsye lidhur me kërkesat e palëve, me faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato, që nuk janë arsyetuar në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, të cilin e bën kontradiktor me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit, për arsye se nuk janë arsyetuar faktet vendimtare. Po ashtu nga dispozitivi nuk mund të konkludojm se cila pjesë e kërkesëpadisë së paditëses është refuzuar, andaj aktgjykimi është prishur në tërësi, formulimi “refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbi pjesën e gjykuar siç është e përshkruar në paragrafin një të këtij dispozitivi të aktgjykimit” që është në kundërshtim me nenin 160 par.3, të LPK-së, që paraqet shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika n) të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të arsyeve të dhëna në aktgjykimin e atakuar, si dhe pretendimeve të paraqitura nga palët, veçanërisht ajo e paditur, të cilat nuk janë marrë parasysh nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk janë vlerësuar, andaj konsiderojmë se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë. Nga arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e atakuar, nuk mund të konkludojm sa është vlera e shtëpisë, në mënyrë që të ketë

një gjendje të qartë sa është investuar në këtë shtëpi e cila është objekt i kërkesëpadisë, prej secilës nga palët. Nga ekspertiza financiare e ekspertit Ukë Sadiku, të dt.03.01.2013, nuk është vërtetuar se sa është kontributi i secilës nga palët, në bazë të kësaj ekspertize nuk mund të arrihet në përfundim sa ka qenë kontributi i secilës nga palët, pasi palët kanë dështuar të ofrojnë prova të mjaftueshme për të vërtetuar kontributin e tyre, nga afarizmi i tyre rrjedh se të dy palët kanë afruar me humbje, ndërsa paratë nga kreditë edhe nën supozimin se janë investuar në shtëpinë e ndërtuar, të njëjtat kredi është dashur të kthehen. Pala paditëse në deklarinimin e saj ka pasur një deklarinim kontradiktor deklaroi se “kam punuar tërë kohën dhe kam palue pare” ndërsa në pyetjen sa ka qenë fitimi mujor, e njëjta ka deklaruar “fitimi ka qenë 200 deri 250 euro dita” ndërsa në pyetjen tjetër se sa para i ka dhënë të paditurit për ndërtimin e shtëpisë është deklaruar “se ekziston pasqyra e bankës sa kam kursye si dhe kreditin që kam marrë” andaj në bazë të kësaj nuk kemi pasqyrë të qartë të gjendjes faktike, sa është pretendimi i shprehur në para se paditësja ka investuar dhe kontribuar në ndërtimin e shtëpisë, sipas padisë që e bënë që gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë, e që paraqet arsye të mjaftuar që aktgjykimi atakuar të priset konform nenit 183 të LPK-së.

Gjykata po ashtu ka bërë aplikim të gabuar të dispozitës së nenit 54 të Ligjit mbi Familjen i Kosovës, pasi këtë dispozitë e ka aplikuar pa e vërtetuar në tërësi gjendjen faktike dhe kontributi i paditëses dhe i të paditurit në ndërtimin e shtëpisë, sipas padisë për të cilën kërkohet vërtetimi i kontributit të paditëses”.

Rasti II.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me vendimin Ac.nr.3390/14, dt. 13.03.2017

“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK-së.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së sepse dispozitivi i aktgjykimit nuk është në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin e aktgjykimit, respektivisht në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë dhënë arsyeje për mënyrën se si gjykata i ka kualifikuar faktet vendimtare në raport me normat materialo-juridike.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur kërkesave të LPK-së nga neni 160 paragrafi 4 dhe 5, të cilat specifikisht i referohen detyrimit që gjykata përveç tjerave në arsyetimin e aktgjykimit të jep shpjegime se si i ka vërtetuar faktet, nëse i ka vërtetuar me prova, cilat prova i ka shfrytëzuar, si i ka vlerësuar ato dhe si i ka kualifikuar faktet, gjegjësisht cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Sa i përket dispozitave materialo-juridike arsyetimi i aktgjykimit është i mangët ngase gjykata e

shkallës së parë specifikisht nuk i është referuar as një norme respektivisht dispozite mbi bazën e së cilës do ta arsyetonte qëndrimin dhe përfundimin e saj.

Në mungesë të dispozitave të referuar material-juridike Gjykata e Apelit nuk ka mundur ta pranoj si të rregullt përfundimin e gjykatës së shkallës së parë mbi themelësinë kërkesëpadisë sepse për të vlerësuar zbatimin e të drejtës materiale është e domosdoshëm që aktgjykimi i atakuar të përmbajë arsyetim se si gjykata e shkallës së parë e ka zbatuar të drejtën materiale. Në këtë pjesë janë pranuar pretendimet ankimore”.

Rasti III.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me vendimin Ac.nr.3732/13, dt. 16.12.2016

“Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelle të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe 182 paragrafi 1 e lidhur me nenin 2 të LPK-së.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit e po ashtu arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare të çështjes janë të mangëta dhe të paqarta.

Dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit e rrjedhimisht për faktet vendimtare nuk janë paraqitur arsyeje ose arsyet e paraqitura janë të paqarta. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë përkitazi me arsyetimin e aktgjykimit është dashur ti përmbahet dispozitave të nenit 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së, të cilat përcaktojnë se arsyetimi i aktgjykimit përmban kërkesat e palëve, faktet e parashtruara dhe provat e propozuara, cilat fakte janë vërtetuar, pse dhe si janë vërtetuar e në qoftë se janë vërtetuar me prova, cilat prova i ka shfrytëzuar gjykata dhe si i ka vlerësuar ato.

Nga arsyet e aktgjykimit nuk mund të kuptohet se mbi bazën e të cilave prova dhe cilave fakte gjykata ka arritur në përfundimin se paditësi është ngarkuar me borxh sipas faturave pa harxhuar energji elektrike. Gjykata e shkallës së parë është mjaftuar me një përshkrim përmbledhës duke specifikuar se cilat prova ka administruar por pa dhënë arsyeje se cilat fakte i ka provuar me provat e tilla dhe si pastaj gjendjen faktike të konstatuar e ka kualifikuar në raport me të drejtën materiale. Referencën në dispozitën e nenit 378 të LMD-së, në kontekstin e rrethanave të konstatuara nga gjykata e shkallës së parë nuk rezulton se është dispozita materiale e cila do të mund të aplikohet në këtë çështje kontestuese nga arsyeja se baza juridike e kërkesëpadisë është në këtë rast sipas paditësit pasurim i pabazë, ndërsa parashkrimi është

prapësim i natyrës materiale që do të kishte kuptim si institut në qoftë se do të zbatohet në kërkesat e kreditorit për detyrimet aktive të debitorit.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipërcituara, të cilat në riprocedurë duhet të eliminohen nga gjykata e shkallës së parë, në atë mënyrë që gjykata fillimisht duhet të bëjë shqyrtimin paraprak të padisë, të konstatojë nëse plotësohen kushtet për lejueshmërinë e procesit gjyqësor, duke pasur në konsideratë prapësimet e të paditurës për kompetencën e gjykatës dhe pas shqyrtimit paraprak të padisë nëse konstaton se plotësohen kushtet (sidomos kushti i kompetencës lëndore) nga të cilat varet lejueshmëria e procesit gjyqësor atëherë të caktojë shqyrtimin gjyqësor”.

IV. NGA PRAKTIKA GJYQËSORE PËR SHKRIMIN DHE ARSYETIMIN E VENDIMEVE MERITORE

Rasti I

Kompensim i dëmit

Përshkrimi i rastit: *Çështja është paraqitur në gjykatë e shkallë së parë sipas padisë për kompensim të dëmit, të shkaktuar në aksident komunikacioni.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryeso ka administruar provat dhe ka vendosur që pjesërisht ta aprovoi kërkesëpadinë.*

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nga këto arsye.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadisë meqë i autorizuari i palës së paditur asnjëherë nuk e ka kontestuar, madje palës paditëse i ka ofruar ofertë për arritjen e marrëveshjes.

Kontestuese ishte lartësia e kërkesëpadisë të precizuar me parashtresën e datës _____.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata sipas propozimit të autorizuarit të paditëses, në cilësinë e provës materiale, ka nxjerr ekspertizën mjekësore të punuar nga Dr. _____ ekspert i ortopedisë dhe _____ eksperte e psikiatrisë, të cilët në bazë të dokumentacionit mjekësor dhe pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditëses, kanë dhënë mendimin profesional, përmes ekspertizës se punuar me shkrim dt. _____, ku sipas tyre paditësja ka pësuar

lëndime si djegie të gradës I dhe II të parakrahut të majtë (i cilësuar si lëndim i rëndë), ndrydhje e kokës, ndrydhje e hundës, distorzion të qafës, ndrydhje të regjionit lumbal, ndrydhje të kafazit të kraharorit dhe pelvikut (të cilësuar si lëndime të lehta trupore).

Me këto prova të administruara gjykata në emër të dhimbjeve fizike aprovoi kërkesën në shumën prej 2.500€, dhe e vlerësoi si një shpërblim të drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit, sepse paditësja sipas mendimit të ekspertit mjekësor ortoped – traumatolog, si pasojë e lëndimeve të marra, ka pësuar dhembje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë që kanë zgjatur 30 minuta, deri në dhënien e ndihmës së parë, dhembje fizike të intensitetit të rëndë 2 ditë, dhembje fizike të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 21 ditë, për çka e dëshmon terapia e ordinuar, dhembje fizike të intensitetit më të ulët ka edhe sot e kësaj dite me ndryshimin e kushteve klimatike sipas.

Ne emër të frikës së pësuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 2.000€, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se sipas mendimit të ekspertes mjekësore të psikiatrisë, paditësja ka pësuar frikë primare të manifestuar në formë të frikës nga vdekja që ka zgjatur disa sekonda. Frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 3 ditë që është shoqëruar me gjendje ankthi, dhe shqetësime gjatë natës e kryesisht gjendje të reagimit ndaj stresit. Kjo pastaj ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit më të ulët e cila sot e asaj dite është prezentë e shoqëruar fillimisht me brengë nga pasojat e aksidentit përfshirë edhe gjendjen e djegjes dhe pasojat në dorën e majtë shoqëruar me stigmë, shqetësimeve gjatë gjumit me zgjime të shpeshta, rënie të disponimit dhe të qajtura të herë pas hershme me reagime emocionale, si dhe pasiguri të theksuar sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion. Paditësja është trajtuar edhe te psikiatri me terapi qetësuese kundër stresit të përjetuar.

Ne emër të shëmtimit të pësuar gjykata ka caktuar shpërblimin në shumë prej 2.000€, dhe e ka vlerësuar si shpërblim të drejtë, duke u nisur nga fakti se nga ekspertiza të paditësja është prezent shëmtimi trupor në shkallën e mesme për shkak të defektit-cikatriksit të mbetur pas djegies në regjionin e parakrahut të majtë me diametër rreth 10 cm me 5 cm, që paraqet pjesë të ekspozuar në disa periudha kohore gjatë viti e duke e marrë parasysh moshën e re të paditëses.

Ekspertizën e lartpërmendura gjykata e mori në tërësi të bazuara dhe ia dha besimin e plotë, këtë nga se ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se e paditura mbanë përgjegjësi në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditëses me rastin e lëndimit gjatë aksidentit të trafikut, për çka e paditura është e obliguar që paditëses t'ia kompensoi dëmin me që shkaktuesi i dëmit ka lidhur kontratë me të paditurën KS “_____”, dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bën e paditura mbi bazën e sigurimit të autopërgjegjësive TPL (Sigurimit të detyrueshëm për Palët e Treta) konform nenit 178 al.1 dhe 154 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Me dispozitën e nenit 202 al.1 e LMD-se janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jo material dhe atë për dhimbjet e pasura fizike, për frikën e pësuar etj.

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë si dhe duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jo material, e posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditëses, moshën e saj, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të përshkruar si më lartë, gjykata miratoj kërkesëpadinë e paditëses e në vlerat e shpërblimit të dëmit si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke vlerësuar si shpërblim real, objektive dhe me bindje se ky shpërblim është në pajtueshmëri me natyrën dhe pasojat e lëndimit.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet më dëmin jo material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që vlerësoi se kompensim përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Gjykata vendosi që ti refuzoj kërkesat e paditëses në emër të dëmit materi për ndihmën dhe kujdesin e huaj, në shumën prej 100 € dhe për ushqim të përforcuar, në shumën prej 80€, pasi që vlerësoi se nga ana e palës paditëse gjykatës nuk i është ofruar asnjë provë me të cilën kishte me u vërtetuar lartësia e kërkesave të pretenduar. Andaj në mungesë të dëshmimeve për dëmin material gjykata vendosi si në diapozitiv të aktgjykimit për pjesën e refuzuar.

Gjykata konsideron se shumata e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfakcion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuarat të paditëses në aksidentin e komunikacionit, lëndimit dhe pasojave duke marrë parasysh edhe kriteret e parapara me dispozitën e nenit 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, standardin jetësor të qytetareve të Kosovës dhe praktiken e deritanishme të Gjykatave të Kosovës.

Gjykata lidhur me kërkesën për kamatën ka vendosur në mbështetje të nenit 277 të LMD-së⁵⁹.

Rasti II

Kompensim i dëmit

Përshkrimi i rastit: Çështja është paraqitur në gjykatë e shkallë së parë sipas padisë për kompensim të dëmit të shkaktuar gjatë trazirave. E paditur ka qenë Qeveria e Kosovës. **Mënyra e vendosjes:** Gjykata në shqyrtimin kryeso ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë.

⁵⁹ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, C.nr.3135/12, dt.05.02.2014

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Është fakt notor se më 17 e 18 mars 2004, në Kosovë kanë ndodhur protesta dhe trazira të cilat në disa raste dhe vende të caktuara kanë rezultuar me dhunë dhe me dëme materiale qoftë në objekte kulturore, prona publike por edhe ato private.

Në këtë çështje kontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ka qenë kontestuese fakti se paditësi ka pësuar dëm, si pasojë e trazirave të datës 17 dhe 18.03.2004 dhe vlera e dëmit kap shumën prej 297.000 Euro.

Gjithashtu nuk ka qenë kontestuese as fakti se paditësi rastin dhe pasoja e dëmeve, që i ka pësuar si pasojë e trazirave të datës 17 dhe 18.03.2004, i ka paraqitur në Shërbimin Policor të asaj kohe, stacioni policor në Graqanicë.

Me rastin e paraqitjes së rastit në stacionin policor në Graqanicë, është përpiluar raporti inicial nr. 04928, dt. 19.03.2004. Paditësi rastin e ka prezantuar në cilësinë e subjektit NT. “Drini Commerce” si pronarë i lokalit afarist-depo e cila gjendet në fshatin LL. Sellë në rrugën magjistrale Prishtinë-Shkup, e që i referohet dëmit material për shkak të asgjësimit dhe vjedhjes së mallit i cili është gjendur në depon e paditësit.

Gjatë administrimit të provave të këtij rasti, gjykata gjeti se lidhur me depon e shkatërruar, mallin e asgjësuar dhe të vjedhur, paditësi ka parashtruar kërkesë Komisionit Ndërmnistror, përkatës për sanimin e dëmeve të 17 e 18 marsit 2008, me datë 31.03.2004. Komisioni përkatës pas vlerësimit të gjendjes, pjesërisht ka bërë kompensimin e dëmit ndaj paditësit dhe atë në kontekst të riparimit të objektit-fasadë dhe vendosjes së xhamave të kalitur, në shumën prej 23,151.50 Euro, si dhe ka bërë pranimin e TVSH-së në shumën prej 44,555.00€, të paguar në kufi me rastin e importimit të mallit.

Ndërsa vlera e dëmit në lartësi prej 297 000 Euro, nga ana e të paditurës nuk i është kompensuar paditësit. Pavarësisht se në mes të palëve ndërgjyqësore nuk ka qenë kontestuese lartësi e dëmit gjykata përmes ekspertizës financiare të datës 26.05.2008, ka gjetur se vlera e mallit në depon e paditëses sipas regjistrimit të datës 01.01.2004 ishte 405,953.96 Euro, kurse me blerjet që ka bërë paditësi prej dt. 01.01 deri më 17.03.2004, në depon e tij kishte mall me vlerë prej 536,214.96 Euro. Paditësi, prej dt. 01.01.2004 deri më 17.03.2004 kishte bërë shitje neto në vlerë prej 96,375.37 Euro, çka rezulton se vlera e mallit në depon e paditësit më 17.03.2004 para trazirave ishte në vlerën prej 439,839.59 Euro, kurse në regjistrimin e datës 24.03.2004 për pas trazirave, në depo e paditësit kishte mbetur mall në vlerë prej 142,839.59 Euro, që rezulton se malli në lartësi prej 297 000 Euro, ishte vjedhur ose shkatërruar.

Pavarësisht rrethanave jokontestuese në mes të palëve ndërgjyqësore, për dëmin dhe lartësinë e dëmit që ka pësuar paditësi si pasojë e trazirave të datës 17 dhe 18.03.2004, e paditura në këtë çështje kontestuese, e ka kundërshtuar cilësinë e palës së paditur me arsyetim se i mungon

legjitimiteti pasiv pasi që për sigurinë e vendit në kohën e trazirave nuk ka qenë përgjegjëse e paditura.

Për të vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, gjegjësit për të vendosur se a ka e paditura legjitimitet pasiv në këtë çështje kontestuese, gjykata ka gjetur se e paditura Qeveria e Kosovës, me vendimin e kryeministrit të asaj kohe z.Bajram Rexhepi, vendimi nr. 20-1/04 i datës 22.03.2004, është formuar Fondi Emergjent për Riparimin e objekteve fetare, kulturore, shkollore, shëndetësore dhe private të dëmtuara gjatë trazirave të fundit në Kosovë.

Në nenin 2 të këtij vendimi obligohen të gjitha ministrinë kompetente dhe drejtorinë komunale kompetente që të përpilojnë raporte me shkrim lidhur me vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në objekte shkollore, kulturore, fetare, shtëpi të shëndetit dhe shtëpi –objekte private.

Gjykata gjeti gjithashtu se e paditura një pjesë të dëmit që i referohet objektit të dëmtuar, ia ka kompensuar paditësit e gjithashtu e pjesën e TVSH, të paguar për mallin që ishte në depo para trazirave ja ka kompensuar.

Sipas vlerësimit të gjykatës fakti se e paditura ka krijuar një Fond Emergjent, për riparimin e dëmeve të shkaktuara në objekte qoftë kulturore, fetare, publike dhe private, e po ashtu edhe fakti se e paditura i ka kompensuar paditësit një pjesë të dëmit të shkaktuar e rrjedhimisht i ka zbritur (i ka kthyer) edhe pjesën e TVSH, për mallin e dëmtuar, nënkupton se e paditura pavarësisht që mund të mos ketë qenë përgjegjëse për kompensimin e këtyre dëmeve, ajo me veprimet e saj e ka fituar cilësinë e palës përgjegjëse e rrjedhimisht edhe cilësinë e legjitimitetit pasiv si palë.

Ky përfundim i gjykatës del edhe nga fakti se nëse e paditura nuk ka qenë përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara për shkak të trazirave, me qenë se nuk ka pasur përgjegjësinë për sigurinë në atë kohe, atëherë pse e paditura paska pasur përgjegjësi për ti kompensuar dëmet e shkaktuar në objekte kulturore, fetare, publike dhe private e jo edhe dëmet tjera. Pranimi i përgjegjësisë nga ana e të paditurës për kompensimin e dëmeve, sipas vlerësimit të gjykatës nuk mund të kuptohet si përgjegjësi e pjesëshme, pasi që e paditura me paditësin është futur në marrëdhënie juridike, në rastin konkret atë të kompensimit të dëmit, duke i pranuar kështu paditësit kompensimin për një pjesë. Gjykata ka gjetur se kompensimi i dëmit për pjesën që është kompensuar paditësi nuk mund të kuptohet si ndihmë nga e paditura, pasi që e paditura i ka kompensuar paditësit saktësisht vlerën reale të objektit të dëmtuar, pra e paditura në rastin konkret ka pranuar cilësinë e palës përgjegjëse duke bërë kështu kompensimin sipas vlerësimit reale për një pjesë të dëmit në rastin konkret atë të objektit të dëmtuar”⁶⁰.

⁶⁰ Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.421/2007, dt.11.02.2011

Rasti III

Kompensim i dëmit

Përshkrimi i rastit: Çështja është paraqitur në gjykatë e shkallë për kompensim të shpenzimeve të mjekimit të mbuluara me polisë vullnetare të sigurimit.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurë Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike- civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga provat e administruara gjykata konstaton se paditësit dhe e paditura KS Sigal me seli në Prishtinë, me dt. 23.02.2012, kanë lidhur kontratë për sigurimin shëndetësor, në bazë të pилcës me nr. 5045, e cila kontratë – policë e sigurimit përfshin e mbulimin e shpenzimeve mjekësore.

Nga provat e administruara e veçanërisht nga dokumentacioni mjekësore gjykata ka konstatuar se paditësi Jon Tigani ju është nënshtruar intervenimit kirurgjik me dt. 26.08.2013 në klinikën Acibadem-Cristina në Shkup, të Republikës së Maqedonisë, dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit ka paguar shumën në lartësi prej 1 250 euro, ndërsa me dt. 05.03.2013 ka kryer terapinë të ftiziatrit dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit ka paguar shumën në lartësi prej 250 euro.

Nga provat e administruara e veçanërisht nga dokumentacioni mjekësore gjykata ka konstatuar se paditësi Nezafete Tigani me dt. 05.03.2014 është vizituar nga ortopedi dhe ka kryer terapinë të ftiziatrit dhe në emër të shpenzimeve të mjekimit ka paguar shumën në lartësi prej 260 euro.

Pasi që gjykata shqyrtoi të gjitha provat prezent në lëndë e duke u mbështetur në dispozitat të nenit 897, 901, 902, 908, 917, 918, 919 e lidhur me nenin 142 dhe 148 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve vendosi si në dispozitiv, të këtij aktgjykimit, duke e aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditësve si të bazuar për arsye së në bazë të dispozitave të cekura me lartë kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese, dhe ky përcaktim është i natyrshëm dhe i pranueshëm në rastin konkret, për arsye së është rregull i përgjithshëm dhe parim i së drejtës sepse në fushën e marrëdhënieve të detyrimeve palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijojnë raporte juridike gjegjësisht marrëdhënie juridike.

Në rastin konkret palët me vullnetin e tyre kanë përcaktuar kushtet e kontratës duke përfshirë edhe shpenzimet e mjekimit, me të dhënat e përshkruar si ma lartë prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i pranuar në tërësi kushtet e kontratës për sigurimin shëndetësor.

Sa i përket lartësisë së kërkesë padisë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke marrë për bazë faturat e shpenzimeve të mjekimit të cekura me lartë e të cilat janë prezentë në shkresat e lëndës, në bazë të cilave gjykata konstaton se paditësi Jon Tigani në emër të shpenzimeve të mjekimit ka paguash shumën në lartësi prej 1 500 euro, ndërsa paditësja Nezafete Tigani në emër të shpenzimeve të mjekimit ka paguar shumën në lartësi prej 260 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e palës së paditur sidomos kundërshtimin për rrethanën se kërkesa e paditësit duhet të refuzohet pasi që kemi të bëjmë me sëmundje para ekzistuese, një kundërshtim të tillë gjykata nuk e aprovoj për arsye së eksperti mjekësor nga lamia e ORL-së, në seancën e shqyrtimit kryesor në mendimin e tij profesional ka deklaruar së duke u bazuar në raportin mjekësor të dt. 25.07.2012, në rastin konkret nuk kemi të bëj me sëmundje para ekzistuese sepse në bazë të këtij raporti me rastin e kontrollit nga mjeku specialist tek pacienti këtu paditësi Jon Tigani, ka pasur pezmatim të fytit – bajameve dhe rritje të bajames së tretë dhe në bazë të kësaj diagnozë fillestare asnjë pacienti nuk i rekomandohet e as nuk i lejohet një intervenim kirurgjik-gjegjësisht operimi i bajameve, sepse si në rastet të tilla kjo diagnozë është e momentit – gjendje e përkohshëm në atë moment, që ka mundur ti kalohet me terapinë e përshkruar në ketë raport, eksperti ka sqaruar së me kalimin e kohës gjendja e bajameve ka mundur të përqeshohet çka ka ndodhur në rastin konkret ku shihet së i njëjti është operuar në Shkup, gjegjësisht me dt. 04.09.2013, gjerë me datë 06.09.2013, dhe nëse marrim për bazë kontrollin e parë mjekësorë të dt. 25.07.2012, dhe datën e polices së sigurimit të dt. 01.03.2012, do të thotë së nga data kuar është bërë nënshkrimi i polices së sigurimit është lidhur 4 muaj e 27 ditë, para kontrollit të parë mjekësorë.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe pretendimet e palës së paditur sidomos kundërshtimin për rrethanën se kërkesa e paditësve duhet të refuzohet pasi që paditësit nuk i kanë bashkangjitur kuponët fiskal, një kundërshtim të tillë gjykata nuk e aprovoj për arsye së në bazë të faktuarve prezent në shkresat të lëndës shihet çartë që pala paditëse ka bërë pagesat në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe së e paditura me as një provë nuk e ka argumentuar të kundërtën e asaj që është pasqyruar në faturat e cekura me lartë dhe se çështja së pala paditëse gjykatës nuk ja ka bashkangjitur kuponët fiskal nuk është me ndikim për një vendim ndryshe për arsye së pala paditëse ka bërë pagesat në emër të shpenzimeve të mjekimit dhe e paditura nuk e ka bërë rimbursimin e këtyre shpenzimeve të mjekimit e që ka pasur për detyrim në bazë të policës shëndetësore me nr. 5045 e dt. 23.02.2013, e cila ka hyr në fuqi për palët me dt. 01.03.2012.

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoj edhe pretendimet – kundërshtimet e tjera të palës së paditur të gjitha këto në kuptim të përgjegjës në padi mirëpo të njëjtat nuk ishin më ndikim për një vendim ndryshe për arsye se me provat e administruara është vërtetuar e kundërta për çka gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, për arsye së kontrata për sigurimin shëndetësor, është kontratë që bën pjesë në grupin e kontratave aleatore dhe nuk vlen parimi i barazisë së prestimeve dhe rrethana e paraqitjes së rastit të siguruar është rrethanë e ardhshme dhe e pa sigurtë, nga paraqitja e saj dhe në bazë të kësaj lind detyrimi i sigurvearit që për rastin e siguruar ta paguaj shumën e caktuar apo të ndërmerr një veprim apo një bërje dhe askush, as një palë nuk mund ti ik detyrimit, që ka në bazë të këtyre kontratave duke u thirrur në dy kuptueshmërinë e ndonjë dispozite të këtyre kontratave që lënë mundësin e interpretimit dhe dëmtimit të njëjës pale, sepse dispozitat ligjore në fuqi ja japin të drejtën gjykatës që të kontratat formulare duhet të interpretohen në favor të palës me të dobët, kur vinë në shprehje situatat dhe palës me të fortë ja japin mundësin e keqpërdorimit të të drejtave të palës me të dobët, për arsye së kontrata e sigurimit është kontratë formularë ku sigurvearit i diktojnë kushtet e lidhjes së kontratës ndërsa për palën e siguruar mbetet vetëm mundësia e refuzimit apo pranimit të kushteve të kësaj kontrate. Gjykata nuk aprovoj kundërshtimet e palës së paditur me rastin e vendosjes për arsye së e paditura sikur ta kishte argumentuar së i siguruari ka bërë me dashje lajmërimin e pa saktë ose me dashje e ka lënë në heshtje ndonjë rrethanë të një karakteri të atillë sa që sigurveari nuk do ta lidhet kontratën po të kishte ditur për gjendjen e vërtetë dhe në këto rrethana e paditura në rastin konkret ka mundur ta kërkoj anulimin e polices për sigurimin shëndetësor, gjë të cilën në rastin konkret nuk e ka bërë e që ka mundur ta bëjë në bazë të nenit 908 të LMD-së, madje e njëjta e ka heshtur këtë të drejtë dhe ka vazhduar ta pranojë preminë e sigurimit nga të siguruarit, e në anën tjetër ka refuzuar rimbursimin e shpenzimeve mjekësore dhe kundërshtimet e të paditurës gjykata i vlerësoj si kundërshtime të paditurës sa për ti ikur detyrimit në bazë të kësaj police.

Gjykata vendosi për kamatën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u mbështetur në dispozitat të nenit 277, lidhur me nenin 186 të LMD-së, pasi që e paditura ka ra në vonës për rimbursimin e shpenzimeve ditën kur paditësit kanë ushtruar padi pranë gjykatës.

Vendimin që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësve në këtë procedurë⁶¹.

⁶¹Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1236/13, . 29.10.2014

Rasti IV

Kompensim i dëmit (rast me vdekje nga aksidenti)

Përshkrimi i rastit: Çështja është paraqitur në gjykatë e shkallë për kompensim të dëmit material (përfshirë mbajtjen/rentën) dhe jo material.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjyimit

“Nuk është kontestuese baza e kërkesë padisë sa i përketë shkaktarit të aksidentit, nuk është kontestuese se aksidenti ka ndodhur me dt. 03.11.2013, nuk është kontestuese se tani i ndjeri _____ --, ka vdekur në këtë aksident, nuk është kontestuese se paditësit janë bashkëshortja, nëna, vëllezërit, motra dhe fëmijët e tani të ndjerit _____ ---, nuk është kontestuese se deri te aksidenti ka ardhur me fajin e të siguruarit të të paditurës KS-SIGMA, mirëpo kontestuese është vetëm lartësia e kërkesëpadisë.

Në bazë të provave të administruara e posaçërisht nga raporti i aksidentit DR-3009-0021-13, i dt. 02.11.2013, skica e vendit të ngjarjes, fotografit e vendit të ngjarjes, ekspertiza e komunikacionit rrugor e dt. 11.12.2013, si dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve gjykata erdhi në përfundim se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me dt. 02.11.2013, dhe si pasojë e këtij aksidenti ka vdekur tani i ndjeri _____, paditësit janë bashkëshortja, nëna, vëllezërit, motra dhe fëmijët e tani të ndjerit _____ dhe se mbështetur në prova të administruara gjykata ka konstatuar se kemi të bëjmë me përgjegjësi ekskluzive të të siguruarit të e paditura KS “SIGMA”.

Përgjegjësia e të siguruarit të të paditurës konsiston në faktin se _____ --, në cilësinë e ngasësit të veturës e tipit VË Golf 2, me targa 04-298-BF, deri sa ishte duke qarkulluar në rrugën Magjistrale Prishtinë – Pejë, me të arritur në fshatin Gllaviqic, duke mos ju përshtatur kushteve të rrugës dhe kushteve klimatike, hynë në tejkallim dhe me pjesën e parë ballore të anës së majtë të automjetit të cekur me lartë e godet në pjesën e parë ballore të anës së djathtë të automjetit e tipit Mercedes 410 D, me targa 03-890-CC, drejtuesi i automjetit i cili ka qenë i siguruar pranë të paditurës, ka përgjegjësinë-ekskluzive të vetme për shkaktimin e këtij aksidenti dhe tani i ndjeri Ilir Morina në cilës të pasagjerit, më asnjë veprim të tij, nuk ka kontribuar në shkaktimin e këtij aksidenti.

Duke u nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, gjykata ka konstatuar përgjegjësinë e vetme dhe ekskluzive të drejtuesit të veturës, që ka qenë i siguruar pranë të paditurës, dhe duke marrë për bazë faktin se nga e paditura e ka pranuar baza juridike të kërkesë padisë, gjykata konstaton se

kërkesëpadia, sa i përket bazës juridike gjënë mbështetje në dispozitat e nenit 136, 137, 140 dhe 159 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve me nr. 04/L-007 (në tekstin e mëtejme LMD-së).

Nga certifikatat e lindjes për paditësit, gjykata ka vërtetuar se paditësja _____ është nëna, paditësja _____ është ish bashkëshortja, paditësit _____, _____ dhe _____ janë fëmijët, paditësit _____, _____ dhe _____ janë vëllezërit, paditësja _____ - është motra, e tani të ndjerit _____, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 184.1 dhe 2, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, u ka pranuar kompensimin e dëmit jo material për dhimbjet e përjetuara shpirtërore si në pikën I., të dispozitivit të këtij aktgjykimi, dhe për aprovimin e pjesshëm të kërkesë padisë, për këtë kategori të dëmit, gjykata ka marr parasysh rrethanat që kanë mundur dhe që kanë ndikuar në intensitetin dhe kohë zgjatjen e dhimbjeve shpirtërore që kanë përjetuar paditësit për shkak të humbjes së bashkëshortit, djalit, vëllait dhe babait.

Me këtë rast gjykata ka pasur parasysh raportin e bashkëshortes dhe fëmijëve, me tani të ndjerin, raportin e nënës me tani të ndjerin, raportin e vëllezërve dhe motrës me tani të ndjerit, duke marr për bazë rrethanën se raportet në mes të prindërve dhe fëmijëve, raportet në mes të bashkëshorteve, vëllezërve dhe motrave janë shumë emocionale, të ndjeshme dhe shpirtërore, dhe në këtë vështrim gjykata vlerëson se dhimbjet shpirtërore të paditësve për shkak të vdekjes së bashkëshortit, djalit, babit dhe vëllait të tyre, në aksident kanë qenë të larta, prandaj aprovimi i pjesshëm i kërkesë padisë për këtë aspekt të dëmit, nga ana e gjykatës është konsideruar se është në pajtim me të mirën e të shkelur dhe me qëllimin e të cilit i shërben kompensimi dhe se shumat e aprovuara për paditësit paraqesin një satisfaksion për ta.

Gjykata e refuzoi kërkesëpadinë e paditësve si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që vlerësoi që kompensimi përtej të shumës së gjykuar si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sa i përket dëmit jo material, për dhimbjet e përjetuara shpirtërore, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllim që kompensimi të ishte i drejt dhe në harmoni me praktikën e mira të gjykatave.

Për dëmin e gjykuar material si në pikën III dhe VII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, që i referohen shpenzimeve të varrimit gjykata e ka aprovuar në tërësi si të bazuar sa i përket shpenzimeve të varrimit, ndërsa e refuzoi në tërësi sa i përket rregullimit të varrezës dhe ngritjen e përmendores, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 177.1 të LMD-së, me këtë rast, duke u mbështetur mbi përgjegjësin e të paditurës dhe duke pasur parasysh shpenzimet e varrimit dhe ceremonive të nevojshme fetare sipas adeteve të vendit nga vjen familja e tani të ndjerit, tani paditësve dhe duke e shtuar faktin se gjykatës për këto shpenzime, pala paditëse i ka prezantuar provat, të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit kryesor dhe që argumentojnë shpenzimet e bëra, sa i përket shpenzimeve të varrimit, e jo për shpenzimet e ngritjes së përmendores si në pikën VII, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për çka gjykata refuzoi kërkesën

në tërësi për atë kategori të dëmit sepse pala paditëse nuk ka argumentuar me prova e që ka pasur për obligim për një gjë të tillë në kuptim të nenit 7.1, 319.1 dhe 321 të LPK-së.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë si në pikën IV., në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata sipas propozimit të palëve në cilësi të provës materiale ka nxjerr ekspertizën e punuar nga Aziz Berisha ekspert i aktuaristikës. Sipas kësaj ekspertize lartësia e kompensimit për paditësit për periudhën kohore nga dt. 02.11.2013 e deri me datë 30.11.2014, është në shumën e tërësishme prej 3 444 euro, ndërsa për periudhën kohore duke filluar nga dt. 01.12.2014, e tutje e deri sa për këtë ekzistojnë kushtet ligjore renta e paditësve duhet të jetë 266.30 euro për çdo muaj në të ardhmen, për katër anëtarët e ngushtë të familjes, bashkëshortes _____ - dhe tre fëmijët e saj nga 66.57 euro për secilin veç e veç, e kjo shumë në formë të kapitalizuar arrin vlerën prej 45 803.50 euro, të cilës ekspertizë gjykata ja fali në tërësi besimin për arsye se e njëjta është në harmoni të plotë me prova prezent në lëndë e bazuar në përgatitjen shkollore të paditësit.

Gjykata për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjegjësisht për të aprovuar kompensimin në formë të rentës së arritur nga data e aksidentit e deri me datë 30.11.2014, dhe në forme të rentës mujore për periudhën pas datës 01.12.2014, e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e nenit 178.1 dhe 2 të LMD-së, e cila parasheh se të lezionimi trupor ose të dëmtimi i shëndetit kompensimi caktohet si rregullt në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar dhe gjykata duke ju referuar kërkesës së paditësve e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 188.2 të LPK-së, ka lejuar që më anë të ekspertizës financiar – të aktuaristikës të bëhet llogaritja e rentës së arritur për pagesë dhe llogaritjes së rentës mujore për periudhën e ardhshme. Me rastin e vendosjes gjykata morri për bazë edhe praktikën gjyqësore për rastet të tilla.

Për kamatën gjykata ka vendosur si në pikën V., në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të LMD-së, duke filluar nga dt. 27.06.2016, kur gjykata ka vendosur me aktgjykim, sepse nga kjo datë e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit, ndërsa pala paditëse ka ra në njohuri për format dhe lartësinë e dëmit.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur si në pikën VI, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore pasi që i autorizuari i palës paditëse, gjykatës ja ka dorëzuar listën e shpenzimeve që kërkohet sipas dispozitës së nenit 463 të LPK-së, dhe atë për përpilimin e padisë 624 euro, për përpilimin e parashtrësë për precizimin e padisë 624 euro për 5 seanca të mbajtura nga 810 euro për secilin veç e veç, për dy seancë të shtyrë nga 405 euro, për shpërblimit e ekspertit të aktuaristikës 150 euro, për taks gjyqësore për aktgjykim 429 euro, e në shumën e tërësishme prej 687 euro, e duke u mbështetur dhe në Tarifën e Odës së Avokatëve të Republikës së Kosovës”⁶².

⁶² Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1304/13, dt.11.07.16

Rasti V

Kompensim i shpenzimeve të shërimit jashtë shtetit

Përshkrimi i rastit: Çështja është paraqitur në gjykatë e shkallë për kompensim të shpenzimeve të shërimit jashtë shtetit. E paditur ka qenë Qeveria e Kosovës-Ministria e Shëndetësisë.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjyimit

“Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e raportit specialistik datës 24.05.2007 të lëshuar nga klinika Euromed dhe referenca 3139 datës 19.09.2007, të lëshuar nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës, paditësi kishte aplikuar të e paditura për shfrytëzimin e mjeteve financiar nga buxheti me qëllim të trajtimit mjekësorë jashtë vendit.

Në kuadër të të paditurës është themeluar Komisioni për Vlerësim Mjekësor, i cili komision ka vlerësuar kërkesën e paditësit dhe sipas vlerësimit të bërë me shkresën nr.protokolit 481, numri i dosjes 07-364/25.09.2007, rezulton se kërkesa e paditësit për shërim jashtë vendi është aprovuar.

Bordi Ekzekutiv si organ kompetent për të marr vendim përfundimtar për mënyrën e shfrytëzimit të buxhetit për këtë qëllim, të rasti i paditësit, sipas vlerësimit të bordit me numër 481, numri i dosjes 07-364 i datës 28.09.2007, është aprovuar kërkesa dhe paditësit i është ndarë shuma prej 3,658€, që janë vlerësuar si mjete adekuate për trajtim mjekësor jashtë vendit.

Paditësi e ka kuptuar se është aprovuar kërkesa e tij për shërim jashtë vendi dhe për shkak të gjendjes së tij shëndetësore është dashur që menjëherë të udhëtoj jashtë vendi dhe nuk ka mundur që të pres pagesën të cilën është dashur ta bëjë Ministria e Shëndetësisë. Paditësi ka shkuar në Gjermani për ta kryer trajtimin mjekësor të sugjeruar nga mjekët specialist dhe terapia është kryer në Klinikën Universitare Saarlandit, ku paditësi prej datës 10.12.2007 e deri me datën 28.01.2008 ishte në trajtimin terapeutik rrezatues.

Nga fatura nr.24424 datës 16.10.2007, lëshuar nga Klinikën Universitare Saarlandit Gjermani, vërtetohet se paditësit trajtimi mjekësor në këtë klinik i ka kushtuar në shumën prej 3.658,35€.

Paditësi e ka paguar këtë shumë të kërkuar nga klinika e lartshënuar Gjermane, ndërsa e paditura nuk e ka kryer obligimin e vet edhe pse ka aprovuar kërkesën e paditësit për shërim jashtë vendit në shumën prej 3.658,35€.

Sipas Ligjit për Shëndetësi numër 2004/4, përkatësisht me nenin 31.3 është parapa që: “Shfrytëzimi i shërbimeve të kujdesit tretësor shëndetësor të cilat nuk mund të sigurohen brenda sistemit të shëndetësisë së Kosovës sigurohen dhe rregullohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë”. Ndërsa me Udhëzimin Administrativ (Shëndetësi) 7/2003, përkatësisht nenin 4 është parapa Komisioni për Vlerësim Mjekësor si organ kompetent për vlerësimin e kërkesave për trajtim jashtë vendit, kurse me nenin 5 të këtij udhëzimi është parapa Bordi Ekzekutiv si organ kompetent për të marrë vendimin lidhur me shpenzimit të buxhetit të ndara për programin e trajtimit mjekësor jashtë vendit.

Mbi këtë bazë gjykata vlerëson se e paditura është e obliguar që paditësit, në emër të shpenzimeve të shërimit në botën e jashtme, t’ia paguaj shumën prej 3.685,35€ ngase nuk është mundur që të sigurohet shfrytëzimi i shërbimeve mjekësore brenda sistemit shëndetësor të vendit tonë duke e marrë parasysh natyrën e sëmundjes dhe për kundër faktit që paditësi ka aplikuar të e paditura për shërim jashtë vendit, është aprovuar kërkesa nga komisioni mjekësor dhe Bordi Ekzekutiv ka vendosur që shuma për shërim jashtë vendi të jetë 3.685,35€, mirëpo përkundër kësaj kjo shumë ende nuk i është paguar paditësit.

Kundërshtimin e përfaqësues së të paditurës se vendi për trajtim mjekësor jashtë vendit që kushton më shumë se 3.000€ do të duhej që të nënshkruhet nga Ministri i Shëndetësisë gjykata e vlerësoj si të pa bazuar, ngase paditësi pasi që është informuar nga e paditura se i është aprovuar kërkesa e tij për shërim jashtë vendit është dashur që për shkak të gjendjes së tij shëndetësore të udhëtoj për shërim jashtë vendi dhe nuk ka mundur që të pres deri sa këto mjete të deponohen nga e paditura. Vendimi ka qenë aprovues për paditësin nga Bordi Ekzekutiv dhe çështja se si e paditura ka aplikuar dispozitat e Udhëzimit Administrativ 7/2003 është çështje e organeve të saj mbi bazën e së cilës kërkuesi i shërbimeve mjekësore të cilat nuk i sigurohen në sistemin tonë shëndetësorë nuk mund të dëmtohet. Një arsye e tillë është e papranueshme që të mos i paguhet paditësit shuma e cekur në dispozitiv të aktgjykimit e cila është pranuar nga e paditura për shërim jashtë vendit.

Në kundërshtimet e saj e autorizuar e të paditurës thirret në nenin 5 pika 2 të Udhëzimit Administrativ 03/2010, mirëpo gjykata vlerëson se ky udhëzim administrativ të rasti i paditësit nuk mund të zbatohet ngase paditësi ka aplikuar të e paditura për shërim jashtë vendit me datën 21.09.2007 ndërsa kërkesa i është pranuar 28.09.2007 ndërsa sipas nenit 10 të këtij udhëzimi është parapa që: “Për aplikacionet që kanë filluar të procedohen para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, do të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ 7/2003”. Lidhur me kamatën gjykata ka vendosur në mbështetje të dispozitës së nenit 277 par 1 i LMD”⁶³.

⁶³ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Ppërgjithshëm, C.nr.1345/2011, dt.11.06.2014

Rasti VI

Pasurim pabazë

Përshkrimi i rastit: Çështja është paraqitur në gjykatë e shkallë për shkak të pasurimit pabazë.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku, e në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko- civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas shqyrtimit të gjitha provave prezentë në shkresat e lëndës e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 210, 211, 212, dhe 213 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve gjykata erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Deri të kjo gjendje faktike, gjykata ka ardhur duke u mbështetur në provat e administruara si më lartë, të cilat i ka pranuar si të besueshme për faktin se:

Nga shkresat e lëndës C. nr. 730/11, gjykata konstaton se paditësi _____ nga fshati _____ Komuna e Pejës është bashkëpronar më 1/2 pjesë ideale të paluajtëshmërisë e cila evidentohet si ngastër kadastrale më nr. 3360, 3361/1, 3362/1 dhe 3362/2, në sipërfaqe të tërësishme prej 0.16, 55 ha, të regjistruara në fletën poseduese me nr. 1551, zona kadastrale Pejë, dhe bashkëpronarë me 1/2 pjesë ideale të objektit banesorë të ndërtuar në këtë paluajtëshmëri.

Nga dokumenti në dorëshkrim i dt. 07.09.2010, gjykata konstaton se të paditurit më parë dhe në vazhdimësi kanë shitur 11 banesa të cilat, gjenden në objektin banesorë të ndërtuar në paluajtëshmërinë e cekur më lartë të përshkruar si në referatin e padisë, ku sipërfaqja e tërësishme e këtyre 11 banesave është 872, 62 metra katrorë e cila sipërfaqe është llogaritur në vlerë monetare sipas palëve nga 580 euro, për një metër katrorë çka do të thotë se shuma e tërësishme e shndërruar në euro, për metër katrorë e banesave të shitura është 506 120 euro, nga kjo shumë është zbritur shuma 2 490 dhe është shtuar shuma paprapak në lartësi prej 39 170 euro, çka do të thotë se shuma totale sipërfaqes së banesave të shitura nga ana e të paditurve e shndërruar në euro, arrin shumë në lartësi prej 542 770 euro, dhe nga kjo shumë 1/2 pjesë ideale, në rastin konkret i takon paditësit çka do të thotë se shuma e papaguar paditësit nga ana e të paditurve është 271 385 euro.

Nga dëgjimi në cilësi të palës paditëse _____ dhe dëgjimit e të paditurve _____, _____ dhe _____ gjykata ka konstatuar se të paditurit kanë shitur banesat e ndërtuara në objektin banesorë në paluajtëshmërinë e përshkruar si në referatin e padisë dhe se nga shitja e këtyre banesave të paditurit paditësit nuk ja kanë dhënë pjesën e parave e as të mjeteve të tjera që i kanë marrë si kompensim për çmimin e kontaktuar sipas shitjes se banesave të cekura më lartë e që kanë pasur për detyrim në rastin konkret sepse paditësi është bashkëpronar i 1/2 pjesë ideale të asaj paluajtëshmërie dhe objektit banesorë në atë paluajtëshmëri.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditësit për faktin së për të ekzistuar pasurimi i pa bazë duhen të plotësohen katër kushte: a) që të ekzistoj pasurimi i cili mund të shprehet në rritjet të aktivitetit dhe zvogëlim të pasivitetit, b) që pasurimi të jetë shkaktuar në kurriz – dëm të personit tjetër që mund të jetë i shprehur me kalimin e një pjese të pasurisë nga një person në personin tjetër, më pagesën e shumës e të hollave, në dorëzimin e ndonjë sendi apo më kryerjen e ndonjë veprimi c) që të ekzistoi lidhja shkakore në mes të pasurimit dhe varfërimit dhe d) pasurimi duhet të jetë bërë pa bazë juridike apo në fillim gjegjësisht në krijimin e raportit të detyrimeve baza juridike ka ekzistuar mirëpo me kalimin e kohës ajo bazë ka dështuar. Duke marr për bazë këto rrethana – këto kushte të domosdoshme që të ekzistoj pasurimi pa bazë, rrjedh së elementet të cilat karakterizojnë pasurimin pa bazë janë: zmadhimi apo rritja e pasurisë në njërën anë, zvogëlimi i pasurisë në anën tjetër, lidhja shkakore në mes të zmadhimit dhe zvogëlimit të pasurisë dhe mos ekzistimi i bazës juridike.

Në rastin konkret janë plotësuar të gjitha këto kushte, për arsye se paditësi është bashkëpronar me 1/2 pjesë ideale të paluajtëshmërisë të përshkruar si më lartë dhe objektit banesorë të ndërtuar në atë paluajtëshmëri dhe për faktin se të paditurit kanë shitur banesat e ndërtuara në atë objekt dhe të paditurit nga shitja e atyre banesave nuk ja kanë dhënë pjesën e çmimit që i ka takuar sipas pjesës ideale të tij, të paditurit në rastin konkret janë pasuruar pa bazë juridike në shumën 271 385 euro në dëm të paditësit.

Sipas dispozitës së nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK-ës, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Megenëse pala e paditur me asnjë provë nuk arriti të argumentoi të kundërtën e pasurimin pa bazë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe të gjitha kundërshtimet e palës se paditur në kuptim të kundërshtimeve nga përgjigja në padi dhe kundërshtimeve gjatë shqyrtimit kryesor mirëpo të njëjtat nuk ishin më ndikim për një vendim ndryshe sepse më provat e administruara

është vërtetuar se të paditurit në rastin konkret janë pasuruar pa bazë juridike për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka refuzuar propozimin për dëgjimin e dëshmitareve _____, _____ dhe _____, sepse të njëjtit kanë qenë ta pa nevojshëm të dëgjohen në cilësi të dëshmitareve për rrethanat të cilat i kanë propozuar palët dhe për faktin se më provat e administruara e veçanërisht më dëgjimin e të paditurve në cilësi të palës janë vërtetuar faktet vendimtare për të vendosur për këtë çështje kontestimore e duke u mbështetur në dispozitat e nenin 321 e lidhur me nenin 387 të LPK-së.

Vendimi për kamatën gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 277 të LMD-së, për faktin se paditësi ka kërkuar përmbushjen e detyrimit me dt. 20.06.2012, ditë kjo kur i njëjti ka ushtruar padi pranë gjykatës, për çka të paditurit kanë ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit nga kjo datë dhe për faktin se në dokumentin e dt. 07.09.2010 nga palët nuk është caktuar data e përmbushjes së detyrimit, andaj duke u bazuar në rregullat e detyrimeve vlen parimi se për të gjitha rastet kur nuk është caktuar afati i përmbushje, debitori bie në vonës kur kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit”⁶⁴.

Rasti VII

E drejta në trashëgimi në rendin e dytë të trashëgimisë

Përshkrimi i rastit: Çështja është paraqitur në gjykatë e shkallë së parë sipas padisë së vëllezërve të trashëgimlënësit, kundër bashkëshortes së trashëgimlënësit si e paditur.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Gjykata vlerësoi së kërkesëpadia e paditësve është e bazuar pasi që sipas dispozitave nga neni 14.1 të Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës parashihet se “ pasurinë e trashëgimlënësit që nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti i tij”, ndërsa me dispozitën e nenit 14.2, përcaktohet se “ prindërit trashëgojnë gjysmën e pasurisë në pjesë të barabarta ndërsa gjysmën tjetër e trashëgon bashkëshorti i trashëgimlënësit” kurse me dispozitën e nenit 15.3 parashihet së “ në qoftë së të dy prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit, pjesën e pasurisë trashëgimore që do ti takonte secilit prej tyre sikur të kishte jetuar pas trashëgimlënësit e trashëgojnë pasardhësit përkatës”.

⁶⁴ Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.503/12 , dt. 02.12.2014

Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore gjykata vlerësojë dhe vendosi që kërkesëpadia është e bazuar pasi që trashëgimlënësi ka vdekur pa lënë pasardhëse dhe në rastin konkret të paditurës i takon gjysma e pasurisë sipas trashëgimisë në rendin e dytë ligjore, ndërsa prindërve të trashëgimlënësit do tu takonte gjysma në pjesë të barabarta, mirëpo meqenëse prindërit e trashëgimlënësit kanë vdekur para trashëgimlënësit atëherë pjesa që do tu takonte atyre u kalon vëllezërve dhe motrave të trashëgimlënësit e në rastin konkret paditësve”⁶⁵.

Rasti VIII

E drejta e pronësisë sipas tapisë (paraardhësi i paditësve ishte shpërngul nga vendi)

Përshkrimi i rastit: *Kontesti është zhvilluar në mes të pasardhësve të ish pronarit dhe Komunës së Prishtinës si pronare aktuale.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.*

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Ne mes të palëve nuk ishte kontestuese se paraardhësit juridik të paditësve kanë pasur tapinë për patundshmërinë kontestuese të lëshuar nga autoritetet e perandorisë Osmane të asaj periudhe, po ashtu nuk ishte kontestuese se paraardhësi juridik i paditësve është shpërngulur nga Kosova për në Turqi duke e lënë pronën e tij, për shkak të regjimit të atëhershëm serb. Nga ana e të paditurës nuk është kundërshtuar as legjitimiteti aktiv i paditësve që në rastin konkret shtrohej përmes dokumenteve të noterizuara nga autoritetet Turke.

Në mesin e çështjeve kontestuese në mes të palëve paraqitet ligjshmëria e kalimit të pronës në emrin e të paditurës dhe shfrytëzimi i pronës nga ana e të paditurës, në këtë kuptim edhe kërkohet vërtetimi i pronësisë nga ana e paditësve.

Gjykata sipas propozimit të palëve në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë ekspertizën e gjeodezisë, përmes së cilës ka gjetur se patundshmëria kontestuese evidentohet si ngastër kadastrale numër 5626, e shtrirë në anën e majtë të rrugës “ Ramiz Sadiku ” tani bulevardi “Nëna Terezë”, sipas fletës poseduese 4137, zona kadastrale nr.71914059 Prishtinë, me sipërfaqe prej 00.03,24 ha dhe oborr me sipërfaqe prej 00.01,94 ha, në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.05,18, e evidentuar si pronë shoqërore me shfrytëzues Komuna e Prishtinës.

Sipas ekspertizës në mungesë të historiatit kadastral (pasi elaborati kadastral gjendet ne Krushevc të Serbisë), nuk dihet se kur prona ka kaluar në emrin e të paditurës.

⁶⁵ Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.61/09, dt.02.10.2012.

Përmes plotësimit të ekspertizës, eksperti duke ju referuar një raport të lëshuar nga Republika e Serbisë - Krushevc, me datë 28.02.2008, të regjistruar me numër 952-3/2008-1999, i nënshkruar nga Sreten Sharanoviqi, ish drejtor i Drejtorisë Gjeodete të Prishtinës, deri në vitin 1999, jep edhe këtë plotësim se ngastra kadastrale 5626, është evidentuar si rezultat i matjeve detale të cilat kanë hyrë në fuqi në vitin 1967, me ç'rast për patundshmërinë kontestuese është regjistruar si shfrytëzues Komuna e Prishtinës, (Kuvendi Komunal Prishtinë).

Sipas raportit në fjalë eksperti shton se me matjet e vitit 1947 dhe atë sipas skicës detale nr.61/27, ngastra kontestuese 5626, me parë është regjistruar rivelemi si ngastër nr.2150, në vendin e quajtur "Armata e Kuqe nr.9" dhe në atë kohë është evidentuar në fletën poseduese 1332 si pronë e Këshillit Popullor të Prishtinës.

Gjykata gjatë vlerësimit të provave pjesën e ekspertizës gjegjësisht plotësimin e ekspertizës, që i referohet raportit të cituar më lart, nuk e vlerësoj në cilësinë e provës pasi që bëhet fjalë për një dokument të lëshuar nga strukturat paralele. Mirëpo si rrethanë me rëndësi gjykata e mori deklarinimin e paditëseve se paraardhësi i tyre juridik është shpërngul nga Kosova për në Turqi, e po ashtu deklarinimin e paditëseve, sipas parashtresës së datës 06.06.2006, ku thuhet përveç të tjerave se pas vdekjes së Shefki Senturkut, me 14.02.1907, në rrethana të pa kjarë e paditura Komuna e Prishtinës, e ka marrë këtë pronë, me arsyetim se kinse trashëgimlënësi nuk ka pasur trashëgimtare ligjor. Gjykata në rrethanën e lënjës-(braktisjes) së pronës nga paraardhësi i paditëseve dhe në rrethanën se prona shumë vite ma herët ka kaluar në emrin e të paditurës e pranoi si të besueshëm deklarinimin e paditëseve.

Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëseve është e pabazuar pasi që sipas dispozitës së nenit 44 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (LMTHJP) "E drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësinë shoqërore".

Sipas dispozitës së nenit 45 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore "E drejta e pronësisë që e ka personi i caktuar mbi një send pushon, kur personi tjetër fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send".

Ndërsa me dispozitën nga neni 46 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore "e drejta e pronësisë pushon me braktisjen e sendit" ndërsa "Sendi konsiderohet i braktisur kur pronari i tij në mënyrë të padyshimtë shpreh vullnetin se nuk dëshiron më ta mbajë" po ashtu "Sendi i paluajtshëm i braktisur kalon në pronësinë shoqërore në momentin e braktisjes së tij".

Gjykata vlerëson se paraardhësi juridik i paditëseve e ka humbur të drejtën e pronësisë në momentin kur prona e tij ka kaluar në pronësi shoqërore, në pajtim me dispozitën e nenit 44 të LMTHJP. Në vlerësimin e gjykatës marrë për bazë rrethanat e rastit duke përfshirë edhe ato jo kontestuese në rastin konkret bëhet fjalë për braktisje të sendit, siç parashihet me dispozitën e nenit 46 të LMTHJP, ndërsa në mungesë të historiatit të pronës si bazë të pranueshme të kalimit të pronës nga paraardhësit juridikë të paditëseve në emrin e të paditurës, gjykata e pranoi

rrethanën se sendi i braktisur kalon në pronësinë shoqërore në momentin e braktisjes së tij, neni 46 i LMTHJP.

Gjykata i është referuar këtyre dispozitave sepse në kohën kur është ushtruar padia LMTHJP ka qenë në fuqi, e gjithashtu marrë për bazë edhe faktin se patundshmëria tani figuron si pronësi shoqërore LMTHJP e ka rregulluar këtë kategori të pronës.

Sipas Ligjit në fuqi, për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, dispozita nga neni 40, përcaktohet se “personi i cili me mirëbesim e ka 20 (njëzet) vjet në posedim të pandërprerë një patundshmëri apo një pjesë të saj e fiton pronësinë në të” në rastin konkret e paditura përveç që e ka në posedim patundshmërinë e ka edhe të regjistruar. Gjykata në këtë rast e ka vlerësuar vetëm kërkesën e paditëseve pa u lëshuar në të drejtën e të paditurës mbi sendin – pronën kontestuese.

Sipas Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, dispozitat nga neni 42.2 përcaktohet se “Në qoftë se hiqet dorë nga pronësia në një palujtshmeri, atëherë pronësinë në atë palujtshmeri e fiton subjekti publik kompetent në territorin e të cilit ndodhet palujtshmeria. Autoriteti publik kompetent e fiton të drejtën e pronësisë në këtë send me regjistrimin e të drejtës së pronësisë në regjistrin e të drejtave në palujtshmeri”. Dispozitat nga ky nen janë ekuivalente me ato nga neni 45 dhe 46 i LMTHJP, përveç se tani çështja nuk shtrohet për pronë shoqërore.

Përveç të cekurave nga dispozitat materialo juridike si rrethanë me rendësi për ta refuzuar kërkesëpadinë, gjykata e mori edhe faktin se patundshmëria kontestuese, nga momenti i lënies së saj asnjëherë nuk u kthye në posedim të paditëseve, gjegjësisht paditëset asnjëherë nuk ishin në posedim të kësaj patundshmërie, kjo rrethanë është konfirmuar nga vetë paditëset.

Duhet theksuar se gjykata në tërësi pranon konceptin se prona duhet të mbrohet sipas protokollit I (një) të Konventës Evropiane, me që mbrojta e pronës sipas kësaj konvente për gjykatën është detyrim kushtetues, mirëpo në rastin konkret vlerësimi i gjykatës është se kërkesëpadia është e pabazuar, pasi që gjykata në asnjë rast nuk mund të thirret në mbrojtje të pronës për një subjekt duke mohuar të drejtën e ligjshme të subjektit tjetër”⁶⁶.

Rasti IX

Vërtetimi i pronësisë në pronë shoqërore/publike të shpronësuar

Përshkrimi i rastit: Kontesti është zhvilluar në mes të pasardhësit të ish-pronarit dhe Komunës së Prishtinës si pronare aktuale.

⁶⁶ Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.2101/05, 10.02.2011.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Gjykata gjeti se e paditura gjegjësisht Sekretariati për Financa i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, me aktvendimin e datës 17.05.1978, numër 07.nr.465-23/77-III, për nevoja të “Auto Motos” ka shpronësuar dhe ka bartë në emrin e Komunës Prishtinës, ngastrat kadastrale numër 7584/2, në sipërfaqe prej 0.67.44 ha dhe ngastrën 7585/2, në sipërfaqe prej 0.45.73 ha.

Sipas vendimit për ngastrën numër 7584/2 në sipërfaqe prej 0.67.44 ha është shpronësuar _____, ndërsa për ngastrën 7585/2 në sipërfaqe prej 0.45.73 ha është shpronësuar pronari faktik, në rastin konkret si pronar faktik evidentohej _____ me 2/3 e ngastrës kadastrale 7585/2 në sipërfaqe prej 0.45.73 ha.

Kësaj gjendje faktike i korrespondon edhe vendimi i organit të shpronësimit i datës 13.05.1966, ku shihet se në listën e ngastrave kadastrale të shpronësuara bëjnë pjesë edhe ngastrat kontestuese 7584/2 dhe 7585/2.

Në rrethanën e bartjes së pronësisë dhe evidentimit aktual këtë gjendje e konfirmon edhe ekspertiza e gjeodezisë e punuar nga ing. Sharr Pllana. Gjykata këtë gjendje e pranon si të saktë dhe për vërtetimin e saj i pranojë si të besueshme vendimet e cituara më lartë dhe ekspertizën në rrethanën e cituar.

Ndërsa në rrethanën se ish-pronari ishte i informuar për procedurën e shpronësimit, gjykata gjeti se ish pronari juridik për ngastrën kadastrale numër 7584/2 në sipërfaqe prej 0.67.44 ha i dhe ish pronari faktik për 2/3 e ngastrës kadastrale 7585/2 në sipërfaqe prej 0.45.73 ha. _____ ishte ftuar dhe ishte informuar për procedurën e shpronësimit sipas procesverbalit të datës 13.12.1977. Në këtë rrethanë gjykata e pranoi si të besueshëm procesverbalin në fjalë.

Në kuptim të cekurave gjykata vlerësoi se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar pasi që sipas dispozitave nga neni 21 i Ligjit për Eksproprijimin përveç tjerave parashihet se “ vendimi në formë të prerë mbi eksproprijimin do të anulohet dhe në bazë të kërkesës së pronarit të përparshëm, të pasurisë së patundshme të eksproprijuar, nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit në afat prej 3 vitesh ç’prej se vendimi ka marrë formë të prerë, nuk ka kryer, sipas natyrës së objektit punimet e nevojshme në atë objekt.

Pasi të kalojnë dhjetë vjet nga dita kur vendimi ka marrë formën e prerë mbi eksproprijimin nuk mund të paraqitet kërkesë për anulimin e vendimit”.

Përveç dispozitave të cituara nga Ligji për Eksproprijimin, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar pasi që sipas dispozitës së nenit 44 të Ligjit mbi Marrëdhëniet

Themelore Juridike Pronësore (LMTHJP) “E drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësinë shoqërore”.

Sipas dispozitës së nenit 45 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore “E drejta e pronësisë që e ka personi i caktuar mbi një send pushon, kur personi tjetër fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send”.

Gjykata vendimin e mbështeti edhe në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, pasi që nga ana e paditësit kërkesëpadia në pikëpamje formale nuk ishte e orientuar në anulimin e vendimit mbi eksproprijimin, por si bazë përdorte vërtetimin e pronësisë sipas trashëgimisë. Në këtë kuptim gjykata nuk është shpallur inkompetente lëndore sipas pretendimeve të t’paditurës në mbeshteje të nenit 18 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, pasi që për padinë dhe kërkesën e saj në formën e preshtuar gjykata ishte kompetente.

Sipas bazës së trashëgimisë paditësi po ashtu nuk arriti ta argumentojë kërkesën e tij, pasi që të gjeturat faktike nga ana e gjykatës në këtë çështje kontestuese tregojnë së patundshmëria kontestuese nuk përbënte masë trashëgimore të paraardhësit juridik të paditësit, meqenëse se e njëjta ishte pronë e subjektit tjetër.

Gjykata në arsyetimin e refuzimit të kërkesës iu referua dispozitave materialo-juridike të ligjeve të ndryshme, pasi që sipas dispozitës së nenit 253.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata nuk është e lidhur për bazën juridike, prandaj gjykata duke i marrë për bazë rrethanat e rastit pavarësisht bazës së treguar në padi vendosi ta refuzoj kërkesëpadinë sipas cilito do bazë që i korespondon gjendja faktike e treguar në padi apo e vërtetuar nga ana e gjykatës.

Meqenëse gjykata vendosi ta refuzoj kërkesëpadinë në kuptim të dispozitave të cituara, sipas të gjeturave faktike të përshkruara më lartë, pretendimet e paditësit se posedon faktikisht pronën kontestuese dhe se e njëjta nuk është kompensuar nga e paditura gjykata nuk i mori si rrethana me rëndësi pasi që kërkesë e padisë nuk ishte kompensimi i pronës së shpronësuar, e rrjedhimisht kërkesë e padisë nuk ishte ofrimi i mbrojtjes juridike për posedimin apo sipas posedimit. Në këtë kuptim edhe të gjeturat e ekspertizës për posedimin nuk ishin me rëndësi për aprovimin e kërkesëpadisë”⁶⁷.

⁶⁷ Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.2661/05, 20.06.2011

Rasti X

Vërtetimi i pronësisë me mbajtje (sipas padisë) dhe dorëzim i pronës (sipas kundërpadiës)

Përshkrimi i rastit: Me padie është kërkuar e drejta e pronësisë me mbajtje, ndërsa pala e paditur me kundërpadi ka kërkuar dozimin e pronës.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoi në tërësi kërkesëpadinë dhe ta refuzoj në tërësi kërkesën nga kundërpadia.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Gjykata sipas propozimit për përsëritjen e procedurës e paraqitur nga e paditura - kundër paditësja me vendimin e datës 19.11.2012 ka lejuar përsëritjen e procedurës në këtë çështje juridike - kontestimore dhe e ka prish aktgjykimin C.nr. 1499/05 i dt.27.12.2005.

Pasi që është lejuar përsëritja e procedurës dhe më që në ndër kohë është vërtetuar fakti se palët e kontestit _____, dhe _____, kishin vdekur dhe atë _____, me dt.01.09.2009 ndërsa _____, me dt.01.07.1986, gjykata ka lejuar rregullimin dhe ndryshimin e padisë sipas subjekteve të tanishëm të kontestit pasi që si trashëgimtarët ligjor të ndjerit _____, me vendimin e trashëgimisë T.nr.61/2012 dt.29.09.2012 i lëshuar nga gjykata komunale në Deqan ishin shpallur tani paditësit, ndërsa për të paditurën _____, trashëgimtar ligjor me vendimin T.nr.569/2009 dt.02.11.2009 lëshuar nga Gjykata Komunale Prishtinë dega Graqanicë trashëgimtar është shpallur tani e paditura – kundër paditësja.

Gjykata gjatë këqyrjes në vende dhe me ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë ka gjetur se paditësit kanë në shfrytëzim numër 1009-0, në sipërfaqe prej 705 m², e cila shtrihet prej pikës 10-1, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 29.50 m, prej pikës 11-12, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 17.55 m, prej pikës 12-13, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.93, prej pikës 13-14, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 3.77 m, prej pikës 14-15, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 5.12m, prej pikës 15-16, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 19.94 m, prej pikës 16-17, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 7.93 m dhe prej pikës 17-10, kufiri është i drejtë dhe gjatësia e frontit është 21.45m. Në këtë pjesë të ngastrës kontestuese të cilën paditësit-kundër të paditurit e kanë në shfrytëzim kanë të ndërtuar edhe objekte të banimit P+0, P+1 dhe P+1+Nk, gabaraiti i të cilave është P=0,

pjesë e garazhës jugperëndimore $3.77 m = +3.05m \times 10.83m = 3.41m \times 10.83m = 36.93m^2$. Objekti $P+I+Nk$ $9.79m \times 9.37m + 2.35m \times 9.79m + 4.04m \times 0.80m = 117.97m^2$. Objekti $B=P=NK$ $15.00m \times 5.45m + 1.82m \times 5.94m + (3.15m \times 1.18m)/2 = 94.58m^2$ dhe objekti $P+0$ $7.79m \times 5.83m = 45.42m^2$.

Me ekspertizë është vërtetuar së paraardhësi i paditësve _____, pjesën e ngastrës kontestuese të cilën e kanë tani paditësit në shfrytëzim e ka pasur të regjistruar në emrin e tij edhe në bazë të matjeve aerofotogrametike të viti 1983. Matjet e viti 1983 nuk janë bërë të plotfuqishme por shërbejnë si dëshmi se pala paditës e ka pasur në posedim këtë patundshmëri edhe gjatë periudhës kur janë realizuar matjet.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës dhe këqyrjes së drejtpërdrejtë në vendshikim.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarëve ka dëgjuar _____, _____ dhe _____, të cilët kanë deklaruar së paraardhësi i paditësve –kundër të paditurve në pronën kontestuese është vendosur në vitin 1977 dhe që nga ajo kohë e shfrytëzon në mënyrë të papenguar nga askush.

Dëshmitarët kanë theksuar së nuk kanë qenë prezent gjatë marrëveshjes së shitblerjes por e dinë së babai i paditësve e ka blerë pronë kontestuese dhe pas blerjes ka ndërtuar edhe shtëpinë e cila edhe sot shfrytëzohet nga paditësit.

Pronë kontestuese babai i paditësve e kishte blerë si pllac e pas blerjes ka ndërtua shtëpinë. Asnjëherë nga askush nuk është penguar familja e paditësve në shfrytëzimin e pronës kontestuese kanë theksuar dëshmitarët.

Dëshmi e dëshmitarëve gjykata i ka pranuar në tërësi të besueshme pasi që kanë qenë konkrete, të përputhshme dhe me provat tjera dhe bindëse.

Sipas kësaj gjendje të vërtetuar gjykata vlerëson se paditësi-paraardhësi i paditësve në shfrytëzim të pronës kontestuese është vendosur me mirëbesim pasi që i ka parapri marrëveshja e cila nuk është formalizuar me legalizimin dhe regjistrimin e kontratës, rrethanë kjo e konfirmuar nga dëshmitarët

Sa i përket kontinuitetit të shfrytëzimit të pandërprerë të pronës kontestuese nga paditësit dhe paraardhësi i tyre gjykata i ka marrë në vlerësim vendimin e Drejtorisë Republikane të të hyrave publike njësia rajonale Prishtine dt.08.07.1982, lajmërimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës - sekretariati për Urbanizëm dt.04.05.1992, kontratën e lidhur ne mes të Kooperativës banesore Prishtinë dhe _____, dt.05.07.1990, aktvendimin e komitetit krahinor të urbanizmit, veprimtarive komunale dhe banesore dt.07.09.1983, lajmërimin e sekretariatit për urbanizëm, pune komunale dhe banesore dt.19.07.1992 dhe dëftesën e dt.30.12.1992, të cilat i

ka pranuar si të besueshme me që janë dokumente të lëshuara nga organet publike për detyrimet e ndryshme të paraardhësit të paditësve e që ndërlidhen drejtpërdrejtë me pronën kontestuese.

Gjykata e ka marrë në vlerësim edhe skicën e matjeve të vitit 1983 e cila e konfirmon posedimin e pronës nga paditësit.

Pasi që gjykata vërtetoi këtë gjendje fakti gjeti së kërkesëpadia e paditësve është e bazuar në kuptim të dispozitës së nenit 28 al 4 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (LMTHJP).

LMTHJP me dispozitën e nenit 28 al 4 parasheh se :”mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshtëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh”.

Në rastin konkret është vërtetuar së paditësit e mbajnë me mirëbesim patundshmërinë objekt kontesti për më shumë se njëzet vite, në mënyrë të papenguar nga askush.

Gjykata ka vendosur ta refuzoj kundërpadinë e të paditurës-kundër paditëses sepse sipas vlerësimit të gjykatës së drejta e pronësisë paraqet autorizim për pronarin që të mbajë, ta përdorë - shfrytëzoj dhe të disponoj lirisht me pronësinë e tij.

Në rastin konkret e drejta e pronësisë sipas këtij vendimi i takon paditësve dhe në këtë kuptim gjykata ka refuzuar kundërpadinë sepse autorizimi i posedimit rrjedhe nga pronësia gjë që i mungon të paditurës-kundër paditëses.

Gjykata e ka vlerësuar edhe dëshminë e të paditurës dëgjuar në cilësinë e palës por të njëjtën nuk e ka pranuar si të besueshme pasi që nuk ka qen bindëse dhe ka hasë në kundërshtim me faktet e çështjes të provuara me provat tjera.

Në këtë kuptim e nga të cekurat gjykata nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës-kundër paditëses.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave nga neni 450 dhe 463. Në rastin konkret kërkesa e palës paditëse është refuzuar në kuptim të dispozitës së nenit 463.1 ku përcaktohet së “për pagimin e shpenzimeve procedurale, gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim vërbalisht lidhur me kërkesën”. Ndërsa neni 463.2 përcakton se ”pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar, t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që

se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës, ndërsa për t'paditurën e ka refuzuar kërkesën për shkak së e njëjta e ka humbur kontestin”⁶⁸.

Rasti XI

Lirimi i pronës

Përshkrimi i rastit: Me padi është kërkuar lirimi i pronës me pretendimin se paditësi është pronar i pronës kontestuese dhe sipas autorizimit që ka pronari mbi pronën

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjyqimit

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjykata ka administruar këto prova: kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmerisë me leg.nr. _____, të datës _____; certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL- _____, të datës _____; kontratën e pa vërtetuar mbi shitblerjen e paluajtshmerisë të datës _____, e nënshkruar ndërmjet _____ dhe _____; raportin e ekspertit të gjeodezisë _____ të datës data _____; raportin e plotësuar të ekspertit të gjeodezisë _____, të datës _____; si dhe është bërë dëgjimi i _____ në cilësi të palës ndërgjyqëse.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të lartë cekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Në bazë të kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmerisë leg.nr. _____, të datës _____, gjykata ka konstatuar faktin se këtu paditësi _____, me ish shitësin _____, kanë lidhur kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmerisë-shtëpisë në Prizren rr. “_____” nr. _____, respektivisht ngastrës kadastrale nr. _____, sipas listës poseduese (të vjetër) _____ ZK _____, në sipërfaqe prej _____ m².

Në bazë të certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr. UL- _____, të datës _____, gjykata ka konstatuar faktin se ngastra kadastrale nr. _____, ZK _____, në sipërfaqe prej _____

⁶⁸ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1499/05, dt.07.10.2013

_____ m2, evidentohet në emër të këtu paditësit _____ dhe atë në _____ të saj.

Në bazë të kontratës së pa vërtetuar mbi shitblerjen e paluajtshmerisë, të datës _____, e nënshkruar ndërmjet _____ (nuk figuron nënshkrimi i tij por vetëm shenja e gishtit) si shitës dhe _____, si blerës, gjykata ka konstatuar se objekt i kësaj kontrate është “shitblerja” e paluajtshmerisë në rr. “_____” nr. _____ dhe atë oborr në sipërfaqe prej _____ m2, të ngastrës kat. Nr _____, nga fleta poseduese nr. _____ ZK, Prizren.

Nga raporti i ekspertit të gjeodezisë _____, të datës _____, respektivisht raporti plotësues i datës _____, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi është pronar i ngastrës _____ ZK Prizren, e cila ngastër regjistrohet në listën poseduese nr. _____ dhe atë në sipërfaqe prej _____ m2. Pos gjendjes faktike të parcelës në fjalë, eksperti gjithashtu ka konstatuar se i padituri _____, i cili është pronar i ngastrës kadastrale fqinje nr. _____, ZK Prizren, momentalisht është duke shfrytëzuar një pjesë të ngastrës së lartëcekur të paditësit nr. _____ ZK Prizren dhe atë në një sipërfaqe prej _____ m2. Në skicën përcjellëse të këtij raporti me ngjyrë të kuqe është shënuar pjesan kontestuese e ngastrës kadastrale nr.4325, të cilën është duke e shfrytëzuar i padituri si oborr, në dimensionet nga lindja _____ m, në perëndim _____ m, nga jugu _____ m, dhe nga veriu _____ m.

Gjykata ka bërë edhe dëgjimin e paditësit Hibe Shopa në cilësi të palës ndërgjyqëse, i cili para gjykatës ka deklaruar se ai para 30 viteve e kishte blerë shtëpinë së bashku me truallin nga daja i tij _____, për të cilin fakt kishin lidhur kontratë, të cilën edhe e kanë vërtetuar në gjykatën Komunale në _____ (leg.nr. _____, të datës _____). Atij i është kujtuar se në një bisedë me axhën _____ (të atin e të paditurit), ishte njoftuar se edhe ky i fundit e kishte blerë prej shitësit të njëjtë, një pjesë të kopshtit dhe atë afër truallit të cilin ai e kishte blerë, gjë të cilën atij i'a kishte vërtetuar edhe shitësi _____ (i cili është daja i paditësit). Më tutje ka deklaruar se gjendja faktike në këtë ngastër kadastrale nuk ndryshon dhe se është e njëjtë si në kohën kur ai e ka blerë para shumë viteve, duke shkjaruar se ai ka hyrë në pjesën kontestuese të ngastrës kadastrale nr. _____ ZK _____ dhe atë përmes dritares së shtëpisë, të cilën hyrje e kishte shfrytëzuar deri në momentin e blerjes së shtëpisë e cila kufizohet me këtë ngastër, ku më pastaj e kishte rrënuar një pjesë të murrin të shtëpisë e cila kufizohet me këtë pjesë të ngastrës kat. _____ ZK _____. Për fund ka deklaruar se në shtëpinë e cila gjendet në ngastrën kat. _____ ZK _____, ka jetuar vetëm i padituri.

Baza ligjore

Sipas nenit 20 të të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, është e paraparë se “e drejta e pronësisë mund të fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”. Me nenin 37 të po këtij ligji është paraparë se “pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon, e ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotrimin faktik të të paditurit. E drejta e paraqitjes së kësaj padie nuk parashkruhet”. Me nenin 10 të Ligjit për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme është paraprë se “kontrata për transferimin e të drejtave të pronës së paluajtshme duhet të bëhet me shkrim dhe se nënshkrimet e palëve kontraktuese duhet të vërtetohen nga gjykata”, ndërsa neni 33 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, parasheh kërkesa shtesë për vlefshmërinë e kontratës së transakcionit - respektivisht parasheh se e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik.

Vlerësimi përfundimtarë i gjykatës

Nga të gjitha faktet e administruara, pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe bazës ligjore të cekur më lartë, gjykata ka ardhë në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet si e bazuar. Kjo për faktin se më kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmerisë leg.nr. _____, të datës _____, të lidhur midis këtu paditësit dhe pronarit të më hershëm të saj _____, paditësi e kishte blerë ngastrën kadastrale nr. _____ ZK _____ dhe atë në sipërfaqe prej _____ m². Kësaj prove gjykata i'a fali besimin e plotë. Po ashtu, bazuar në certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.UL- _____, të datës _____, vërtetohet se pjesa kontestuese e kësaj paluajtshmerie, evidentohet në emër të këtu paditësit _____ dhe atë si pronar i vetëm i saj. Kësaj prove gjykata po ashtu i'a fali besimin e plotë. Siq u cek edhe më lartë, me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë gjendjes faktike, gjykata në këtë çështje ka angazhuar edhe ekspertin përkatës të gjeodezisë, i cili në raportin e tij me shkrim gjithashtu ka konstatuar se ngastra kadastrale nr. _____ ZK _____, e cila është e regjistruar në listën poseduese nr. _____, në sipërfaqe prej _____ m², në të cilën është e përfshirë edhe pjesa kontestuese, evidentohet në emër të këtu paditësit me dimensione dhe shtrirje sikurse në ekspertizën e këtij eksperti. Edhe kësaj ekspertize gjykata i'a fali besimin e plotë. Në anën tjetër gjykata nuk i'a fali besimin “kontratës” së pavërtetuar mbi shitblerjen e paluajtshmerisë, të lidhur në mes të shitësit _____ dhe të atit të të paditurit _____ (me emër të njëjtë sikurse vetë i padituri) të datës _____, ngase kjo kontratë në mënyrën se si është lidhur, nuk paraqet justus titulus të rregullt për bartjen e të drejtës së pronësisë. Mes tjerash, përmes kësaj kontrate shihet se i ati i të paditurit e kishte “blerë” një sipërfaqe të oborrit prej _____ m², ndërsa nga ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë shihet se ai është duke shfrytëzuar një sipërfaqe prej _____ m², gjë që nuk është në përputhje as më vetë “kontratën” e tij të pavërtetuar.

Duke qenë se në bazë të së drejtës pozitive, paditësi _____ është pronar i ngastrës kadastrale nr. _____, ZK _____ dhe se i padituri është duke e mbajtur në zotrimin faktik këtë ngastër, gjykata vlerëson se në këtë rast, ai si pronar ka të drejtën që të kërkoj kërkoj nga mbajtësi, në këtë rast këtu i padituri, kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale, e që në këtë rast është ngastra kadastrale nr. _____ ZK _____, respektivisht pjesa e saj me dimensione dhe shtrirje sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Andaj gjykata ka ardhë në përfundim se padia e paditësit duhet të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat dhe theksimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së⁶⁹.

Rasti XII

Lirimi i pronës

Përshkrimi i rastit: Me padi është kërkuar lirimi i pronës me pretendimin se paditësi është bartës i së drejtës se posedimit në pronën kontestuese dhe sipas autorizimit që ka pronari mbi pronën.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkespadia e paditëses ËSHTË E BAZUAR.

Me leximin e kontratës për ndërrimin e paluajtshmërisë Leg.nr.3121/96, të datës 16.09.1996, gjykata ka vërtetuar faktin e ndërrimit të paluajtshmërisë dhe atë në mes të Qendrës për Punë Sociale në Prizren dhe _____ nga Prizreni, me objekt të kontratës - këtu banesën kontestuese, më gjerësisht sikurse në këtë kontratë.

Me leximin e kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë Leg.nr.3045/96, të datës 09.09.1996, gjykata ka vërtetuar faktin e shitblerjes së banesës në mes të _____, si

⁶⁹ Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.711/08 dt.22.05.2012

shitëse në një të anë dhe _____, si blerës në anën tjetër, me objekt të kontratës së shitblerjes - këtu banesën kontestuese, më gjerësisht sikurse në këtë kontratë.

Me leximin e kontratës mbi shitblerjen e banesës Leg.nr.428/93, të datës 16.03.1993, gjykata ka vërtetuar faktin e shitblerjes së banesës, të lidhur në mes të Komunës së Prizrenit, si shitëse në një të anë dhe të paditurës _____, si blerëse në anën tjetër, me objekt të kontratës - banesën e cila është objekti i këtij kontesti, më gjerësisht sikurse në këtë kontratë.

Me leximin e kërkesës e të paditurës _____ drejtuar Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë për dhënien e pajtimit në lidhje me vërtetimin e kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë, të datës 09.08.1996, gjykata ka vërtetuar faktin se këtu e paditura _____, asokohe i ishte drejtuar ministrisë së lartcekur për dhënien e pëlqimit për aprovimin e kontratës mbi shitblerjen e banesës e cila është objekti i këtij kontesti, të cilën banesë del se ajo i 'a kishte shitur _____, më gjerësisht sikurse në këtë kërkesë.

Me leximin e aktvendimit nr.4/2-5-413-6/96, të datës 24.09.1996, si dhe aktvendimit nr. 4/2-5-413-131/96, të datës 24.09.1996, gjykata ka konstatuar se asokohe Drejtoria Republikane e të Ardhurave Publike të Republikës së Serbisë, i 'a kishte caktuar këtu të paditurës shumë përkatëse të të hollave për pagesën e tatimit për shkak të shitblerjes së banesës e cila është objekti i këtij kontesti, më gjerësisht sikurse në këto aktvendime.

Me leximin e konkluzionit të Komunës së Prizrenit – Sekretariati për Urbanizëm, Punë Komonale dhe Banësore me nr.04/4-360-165/85, të datës 07.04.1988, si dhe procesverbalit me nr.04/4-360-165/85, të datës 28.03.1988, gjykata ka konstatuar se asokohe organi i lartcekur komunal, kishte marrë konkluzion përmes të cilit ishte lejuar ekzekutimi i vendimit të Sekretariatit për Urbanizëm, Punë Komonale dhe Banësore, përkatësisht largimi i këtu të paditurës _____, si dhe i të gjithë anëtarëve të saj nga banesa e cila është objekti i këtij kontesti, në të cilën kishin hyrë pa kurrfarë baze ligjore, më gjerësisht sikurse në këtë konkluzion dhe procesverbal.

Me leximin e protokollit mbi dorëzimin e çelësave të UNHPD-së, të datës 25.01.2006, gjykata ka konstatuar faktin se e paditura me datën 25.01.2006, i kishte marrë çelësat e banesës kontestuese pranë organit të lartcekur.

Me leximin e aktvendimit të Ministrisë së Financave të Republikës së Serbisë me nr.464-8-39232-96, të datës 19.08.1996, gjykata ka konstatuar faktin se përmes këtij aktvendimi ministria e lartcekur, asokohe i 'a kishte lejuar Qendrës për Punë Sociale në Prizren që të lidhë kontratën mbi ndërrimin e paluajtshmërisë me _____, për banesën e cila është objekti i këtij kontesti, më gjerësisht sikurse në këtë aktvendim.

Për vërtetimin sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka bërë edhe dëgjimin e dëshmitarit _____, nga Prizreni, përndryshe drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Prizren, i cili para gjykatës ka deklaruar se banesa e cila është objekt i këtij kontesti është pronë e Qendrës për Punë Sociale në Prizren dhe atë duke u bazuar në lutjen e këtij të paditurës _____, të datës 09.08.1996, e cila aso kohe përmes kësaj lutje, kishte kërkuar nga Ministria e Financave e Republikës së Serbisë që t'ia mundësoj shitjen e banesës së lartë përmendur, e cila shitje ishte realizuar përmes kontratës së shitblerjes e lidhur në Prizren Leg.nr.3045/96, të datës 09.09.1996, ndërmjet _____, si shitëse në njërën anë dhe blerësit _____, si blerës në anën tjetër. Më pas, përmes vendimit mbi shitblerjen e banesës me nr.4/2-5-413-131/96, të datës 24.09.1996, kishte pasuar kontrata mbi ndërrimin e pronës kontestuese në mes të Qendrës për Punë Sociale në Prizren dhe _____, e përmes të cilës kontratë palët ishin dakorduar që të bëhet ndërrimi i paluajtshmërive ashtu që Qendra për Punë Sociale në Prizren e kishte marrë nga _____, banesën e cila është objekt i këtij kontesti, ndërsa si kompensim, të njëjtit i'a kishte dhënë një pjesë të patundshmërisë së Qendrës për Punë Sociale në Prizren, e cila ka qenë afër me paluajtshmërinë e _____, përkatësisht sipërfaqen prej 23 m2, në ngastrën kadastrale nr.8674 ZK Prizren. Mbi bazën e të lartcekurave del se banesa kontestuese është pronë e Qendrës për Punë Sociale në Prizren sepse kjo e fundit, siç edhe u dëshmuar më lart, për të njëjtën banesë asokohe i'a kishte kompensuar _____, një pjesë të paluajtshmërisë së saj në sipërfaqe prej 23 m2 nën ngastrën kadastrale nr. 8674 ZK Prizren. Pas luftës kjo banesë ka qenë e uzurpuar nga një person fizik i quajtur _____, nga fshati Reti, Komuna e Prizrenit, ndaj të cilit Qendra për Punë Sociale në Prizren kishte iniciuar padi civile po pranë kësaj gjykate. Përndryshe ky person, përgjatë zhvillimit të procedurës kontestimore ndaj tij dhe ende pa përfunduar kjo procedurë, vullnetarisht ishte larguar nga banesa kontestuese. Pas kësaj Qendra për Punë Sociale në Prizren kishte kërkuar nga policia që këtë banesë ta monitoroj për disa ditë për shkak të mundësisë eventuale që personi i larguar nga aty përsëri të kthehej në të njëjtin banesë. Për këtë fakt edhe në shkresat e lëndës ekzistojnë provat materiale. Në ndërkohë e paditura _____, kishte shkuar në UN Habitat duke pretenduar se banesa në fjalë është e saj, ku mbi bazën e kërkesës së saj UN Habitatit, të njëjtës edhe i'a kishte dorëzuar çelësat e banesës, duke e vërë kështu në lajthim UN Habitatin, ngase kjo banesë tani më nuk ka qenë banesa e saj. Qendra për Punë Sociale në Prizren për shkak të uzurpimit të kësaj banese në mënyrë të pa drejtë nga këtu e paditura _____, me datën 28.08.2009 ndaj saj ka ngritur padi civile duke kërkuar nga e njëjta që këtë banesë ta liroj menjëherë dhe që të njëjtën t'ia dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të lirë Qendrës për Punë Sociale në Prizren. Përndryshe dëshmitari _____ ka deklaruar se të gjitha këto fakte i ka të njohura nga se siç edhe është cekur më lartë, i njëjti ushtron postin e drejtorit të Qendrës për Punë Sociale në Prizren dhe atë që nga viti 1999.

Gjykata po ashtu ka bërë edhe dëgjimin e të paditurës _____, në cilësi të palës ndërgjyqëse, e cila para gjykatës ka deklaruar se banesën kontestuese e ka fituar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit, sepse asokohe ajo ka qenë punëtore e N.SH. "Printeks" në

Prizren. Më tej ka shtuar se diku në vitin 1996, pasi që banesa kishte qenë me një hyrje por në të cilën kishin banuar tri familje, një pjesë të kësaj banese burri i saj i ndjerë i'a kishte shitur _____, me ç'rast ka ritheksuar se këtij të fundit i ishte shitur një pjesë e banesës e jo e tërë banesa nga se ajo në ndërkohë këtë banesë e kishte zgjeruar në rreth 67 m2. Më pastaj, në një pjesë të kësaj banese, përmes vendimit të Kuvendit Komunal ishte vendosur një familje e komunitetit rom, e cila familje pas rreth dy muajsh këtë pjesë i'a kishte shitur një familjes tjetër rome, të cilët edhe sot e kësaj dite jetojnë në këtë pjesë të banesës. Sipas të paditurës, momentalisht në atë banesë është duke jetuar vetëm ajo dhe askush tjetër. Për fund ka theksuar se banesa kontestuese është pronë e saj nga se siç edhe ka cekur më lartë të njëjtën ajo e kishte fituar nga Kuvendi Komunal i Prizrenit të asaj kohe.

Baza ligjore

Sipas nenit 18 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS) "Pronësia është e drejta e tërësishme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët ti përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti". Me nenin 93 të po këtij ligji është paraparë se "pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi."

Gjithashtu edhe me nenin 3 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (LMThJP), është e paraparë se "pronari ka të drejtë që sendin e vetë ta mbajë, shfrytëzoj dhe ta disponoj në kufijtë e caktuar me ligj", ndërsa me nenin 37 të po të njëjtit ligj ceket se "pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit. E drejta e paraqitjes së padisë nga par.1 i këtij neni, nuk parashkruhet".

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe se njëjta duhet të aprovohet në tërësi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në të vërtetë, bazuar në kontratën mbi shitblerjen e banesës Leg.nr.428/93, të datës 16.03.1993, është provuar se fillimisht këtë banesë e kishte blerë e paditura _____, nga Komuna e Prizrenit. Më pastaj është provuar se të njëjtën banesë, përmes kontratës mbi shitblerjen e patundshmërisë Leg.nr.3045/96, të datës 09.09.1996, e paditura _____, i'a kishte shitur personit të quajtur _____, nga Prizreni. Përfundimisht, në bazë të kontratës për ndërrimin e paluajtshmërisë Leg.nr.3121/96, të datës 16.09.1996, gjykata ka vërtetuar faktin e ndërrimit të paluajtshmërisë, përkatësisht banesës e cila është objekt i këtij kontesti dhe atë në mes të Qendrës për Punë Sociale në Prizren dhe _____, nga Prizreni, me ç'rast banesa kontestuese kishte kaluar në pronësi të Qendrës për Punë Sociale në Prizren. Duke u nisur nga

përkufizimi ligjor i të drejtës së pronësisë, del se pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdor, me atë të disponojë dhe të tjerët t'i përjashtoj nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti. Gjykata ka vlerësuar se në këtë rast, paditësja ka të drejtë të disponoj lirshëm me pronën e saj, ngase në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, nuk është vërtetuar se me disponimin e lirshëm të saj, ndër të tjera, ajo do të mund të binte në kundërshtim me ligjin, ose me të drejtat eventuale të dikujt tjetër, respektivisht në këtë drejtim, e paditura nuk i ka parashtruar asnjë provë gjykatës, përmes të cilës provë, gjykata eventualisht do të mund të vendoste ndryshe. Gjykata vlerëson se përderisa paditësja gëzon të drejtën e tërësishme ndaj banesës kontestuese, ndërsa që të njëjtën pa kurrfarë baze ligjore e mban në posedim dhe shfrytëzim këtu e paditura, është e drejtë e paditëses që me këtë pronë të disponoj sipas dëshirës dhe vullnetit të saj, që nënkupton se ajo ka jus utendi, jus fruendi dhe jus abutendi ndaj kësaj prone, gjithnjë duke u bazuar në nenin 18 të LPDTS-së, të sipërcituar tekstualisht. Nga kjo arsye, gjykata edhe e aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditëses duke e detyruar të paditurën që me të gjithë personat dhe gjesendet e saja, të shpërngulet nga banesa kontestuese dhe që të njëjtën t'ia dorëzoj në posedim dhe shfrytëzim të lire paditëses, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kontestimet e të paditures dhe të autorizuarit të saj, gjykata nuk i mori për bazë ngase të njëjtat bien ndesh me gjendjen faktike të vërtetuar përmes provave të administruara në këtë procedurë, të cilave gjykata i'a fali besimin e plotë.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 450 të LPK-së, e duke pasur parasysh faktin se asnjëra palë nuk i kishte kërkuar ato”⁷⁰.

Rasti XIII

Shuarje e servitutit

Përshkrimi i rastit: *Me padi është kërkuar shuarje e të drejtës së servitutit e kalimit nëpër shkallet e objektit me pretendimin së mund të shfrytëzohet hyrje tjetër dhe shkallë tjera për kalim.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.*

⁷⁰ Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.699/09, dt.11.12.2013

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve fakti se paditësja ka në pronësi një pjesë të katit përdhese të ndërtesës e cila gjendet në Rr.” Nëna Terezë” nr.31/1, ndërsa të paditurat kanë një pjesë të kësaj ndërtese në katin e parë.

Nuk ka qenë kontestuese gjithashtu fakti se të paditurat shfrytëzojnë hyrjen e ndërtesës e cila gjendet në hapësirën e objektit të paditëses e gjithashtu shfrytëzojnë edhe shkallët të cilat gjenden në hapësirën e brendshme të objektit të paditëses.

Gjykata ka gjetur se paditësja në procesin e privatizimit ka privatizuar dhe është bërë pronare e pronës ku gjendet hyrja kryesore dhe shkallët të cilat përdoren nga të paditurat.

Gjykata në cilësinë e provës materiale ka administruar ekspertizën e ndërtimitarisë, e cila ka konstatuar se për të ju shmangur përgjithmonë problemeve dhe mosmarrëveshjeve që mund të ndodhin në mes të palëve, me rastin e kalimit të përditshëm nga hyrja kryesore dhe në shkallët të cilat ndodhen në hollin e objektit të paditëses e të cilat shërbejnë për kalim nga të paditurat të cilat pronën e tyre e kanë në katin e parë në objektin ku paditësja është pronare e përdhese, si zgjidhje me të lehtë ka propozuar që të paditurat të hapin derën e vet zyrtare në anë e pasme të objektit respektivisht në hyrjen e banorëve, pikërisht në vendin ku ka qenë dikur hyrja.

Pasi që gjykata konstatoi këtë gjendje faktike vendosi që kërkesëpadia e paditëses është e pabazë.

Sipas dispozitës së nenit 58 al 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, (LMTHPJ), parashihet se: “servituti real pushon në qoftë se pronari i pronës shërbyese e kundërshton ushtrimin e tij, kurse pronari i pronës sunduese tre vjet rresht nuk e ka ushtruar të drejtën e vet”.

Sipas dispozitës së nenit 58 al 2 të LMTHPJ-ës, parashihet se: “ pronari i pronës shërbyese mund të kërkojë që të pushojë e drejta e servitutit real kur ai bëhet i panevojshëm për shfrytëzimin e pronës sunduese ose kur nuk ekziston me arsye për të cilën ai është vendosur”.

Sipas dispozitës së nenit 58 al 3 të LMTHPJ-ës, parashihet se: “ servituti real pushon po që se nuk ushtrohet gjatë kohës së nevojshme për fitimin e tij me anë të parashkrimit fitues, kur i njëjti person bëhet pronar i pronës shërbyese ose i pronës sunduese ose me shkatërrimin e pronës sunduese, respektivisht të pronës shërbyese”.

Sipas gjendjes faktike të vërtetuar e me referencë në të drejtën materiale sipas dispozitave të cituara më lartë gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar sepse në rastin

konkret nuk është plotësuar asnjëri nga kushtet ligjore për shuarjen e të drejtës së servitutit për të paditurat.

Nga administrimi i provave gjykata ka gjetur dhe ka vlerësuar se në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet ligjore për shuarjen e të drejtës së servitutit për të paditurat sepse hyrja dhe përdorimi i shkallëve kontestuese është kalim i domosdoshëm për të paditurit. Kalimi i të paditurve nga hyrja kontestuese dhe përdorimi i shkallëve kontestuese nga të paditurat në vlerësimin e gjykatës është kalim dhe përdorimi i domosdoshëm. Hyrja dhe përdorimi i shkallëve kontestuese janë shfrytëzuar nga të paditurit në kontinuitet edhe para se paditësja të fitojë të drejtën e pronësisë në përdhësen e objektit ku është e vendosur hyrja kontestuese dhe shkallët kontestuese, rrethanë kjo e cila nuk është kontestuar.

Është i njohur parimi në drejtësi se mund të bartën të drejtat nga një subjekt në tjetrin por mund të bartën vetëm ato të drejta të cilat i ka subjekti që bartë të drejtën e pronësisë. Në rastin konkret paditësja ka prezantuar provat me të cilat i ka argumentuar gjykatës të drejtën e pronësisë në përdhësen e objektit ku janë të vendosura hyra dhe shkallët të cilat i përdorin të paditurit, por kjo e drejtë e paditëses nuk e mohon të drejtën e të paditurve për kalim sepse të paditurit këtë të drejtë e kanë pasur edhe ndaj pronarit të mëparshëm nga i cili paditësja ka fituar të drejtën e pronësisë.

Gjykata nuk e ka pranuar vlerësimin e ekspertit të ndërtimtarisë për hyrjen dhe shkallët alternative, sepse të paditurit e kanë të drejtën nga hyrja dhe shkallët kontestuese dhe gjithashtu hyrja e propozuar nga eksperti nuk është pranuar nga të paditurat sepse humbet vlera e pronës së tyre. Ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë do të pranohej vetëm me marrëveshjen e palëve.

Gjykata nuk u lëshuar fare në vlerësimet e pretendimeve të paditurve sa i përket bashkëpronësisë në hyrjen dhe shkallët kontestuese, sepse në rastin konkret gjykata ka vendosur vetëm për kërkesën e paditëses e cila është refuzuar pavarësisht nga mos vlerësimi i pretendimeve të t'paditurve për bashkëpronësinë.

Gjykata e ka pranuar si të vlefshme vetëm punën juridike të transferit të pronës nga Agjencia Kosovare Mirëbesimit tek paditësja, ndërsa komunikimet e palëve ndërgjyqësore me zyrtarët e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit përkatësisht të Privatizimit mbi të drejtën e kalimit apo mos kalimit nga të paditurat në hyrjen dhe shkallët kontestuese, gjykata nuk i konsiderojë të rëndësishme për të vendosur ndryshe. Këtë komunikim të palëve ndërgjyqësore nuk mund të ndryshojnë përmbajtjen e punës juridike të lidhur në mes të paditëses dhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, e rrjedhimisht puna juridike e lidhur në mes tyre nuk mund të ndryshoj përmbajtjen e të drejtës së të paditurave për të kaluar nga hyrja dhe shkallët kontestuese”⁷¹.

⁷¹ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2955/12, dt.18.12.2012

Rasti XIV

Anulim i kontratës

Përshkrimi i rastit: *Kontesti është zhvilluar në mes të ish pronarëve të pronës së bartur sipas kontratës dhe kooperativës bujqësore si pronare aktuale e pronës, me pretendimin së kontrata e shitblerjes është lidhur pa vullnetin e shitësve/paraardhësve të paditësve.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit.*

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: ekspertizën e gjeodezisë të datës 17.01.2006, të punuar nga _____, skicën e matjeve në teren, fletët poseduese numër 1161, 222 dhe 213, aktvendimin e datë 30.06.2009, T.nr.211/2009, aktvendimin e datës 29.04.2010, ka dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve _____, _____ dhe _____

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestimore duhet vendosur si në diapozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Në mes të palëve nuk ishte kontestues fakti se paraardhësi juridik i paditësve dhe e paditura me datë 01.08.1964, kishin lidhur kontratën e shitblerjes Vr.Nr. _____, me të cilën paraardhësi juridik i paditësve i kishte shitur të paditurës patundshmërinë kontestuese.

Në këtë çështje ishte kontestuese vlefshmëria e kontratës, meqë paditësit pretendojnë se e njëjta është nule për arsyet e paraqitura nga ta në këtë çështje kontestuese.

Gjykata përmes ekspertizës së gjeodezisë të punuar nga Ing. _____, gjeti se në vitin 1964, ngastrat kontestuese 596, 597, 598 dhe 652, kanë qenë pronë e patundshme e Ramë Sopit, paraardhësit të paditësve.

Mirëpo sipas kontratës mbi shitblerjen nr. _____, e datës 01.08.1964, _____, ish nga fshati Mramor, ja shet blerësit KBI ” Kosova Eksport” nga

Fushë Kosova dhe atë ngastrat 596, 597, 598 dhe 652, te cilat ngastra tani kanë sipërfaqet si në vijim: ngastra 596, me kulturë arë, e klasit të tretë, në vendin e quajtur “ Utrina”, në sipërfaqe prej 2.49.20 ha, ngastra 597, me kulturë arë, e klasit të pestë, në vendin e quajtur “ Utrina Potok”, në sipërfaqe prej 2.23.35 ha, ngastra 598, me kulturë arë, e klasit të pestë, në sipërfaqe prej 0.09.31 ha dhe ngastra 652, me kulturë arë, e klasit të katërt, në vendin e quajtur “ Llojze”, në sipërfaqe prej 1.03.83 ha, sipërfaqja totale e këtyre ngastrave ishte 5.85.69 ha.

Ngastrat kadastrale 596, 597 dhe 598 kanë qenë në të njëjtin kompleks, ndërsa ngastra 652 nuk ka qenë në të njëjtin kompleks, në ngastrat kontestuese nuk ka të ndërtuara objekte dhe nuk ka të mbjellura pemë.

Pas lidhjes së kontratës në vitin 1964, ngastrat kadastrale të theksuara më lartë kanë kaluar në fletën poseduese numër 226, të blerësit KBI “Kosova Eksport” nga Fushë Kosova, sipas regjistrimit të ndërrimeve sipas numrit rendor 67/1964.

Gjykata gjeti po ashtu se sipas kontratës numër 1913/69 e datës 02.09.1969, e lidhur në mes të KBI “Kosova Eksport” nga Fushë Kosova, është bërë ndarja e patundshmërisë dhe është bërë ndërrimi në elaboratin kadastrale, në vijën e mexhes, në sipërfaqen e ngastrave dhe në shfrytëzimin e ngastrave.

Ndryshime kanë ndodhur edhe më vonë dhe gjendja aktuale sipas regjistrimit kadastral, sa i përket të regjistruarve si pronar është si në vijim: si pronar i ngastrës kadastrale 596, fleta poseduese 222, Zona kadastrale Çagllavicë, në sipërfaqe prej 2.49.20 ha është KBI “Kosova Eksport” nga Fushë Kosova, si pronar i ngastrës 597 dhe 598, fleta poseduese 213, Zona kadastrale Çagllavicë, në sipërfaqe prej 2.32.66 ha janë me nga ½ _____ dhe _____, ndërsa si pronar i ngastrës 652, fleta poseduese 1161, Zona kadastrale Çagllavicë, në sipërfaqe prej 1.03.83 ha, është _____. Për këtë gjendje faktike gjykata e pranoi në tërësi si të besueshme ekspertizën e ekspertit _____.

Pretendimet e palës paditëse për të vërtetuar se kontrata mbi shitblerjen Vr.Nr. _____, datë 01.08.1964, është nule, për gjykatën janë të pabazuara, pa mbështetje ligjore, prandaj rrjedhimisht edhe është refuzuar kërkesëpadia pasi që sipas dispozitës nga neni 7 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa me dispozitën e nenit 319.1 të LPK-ës parashihet se secila palë ndërgjyqëse ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Në rastin konkret pala paditëse me asnjë provë nuk ka arritur të ja bëjë të besueshme gjykatës pretendimet e tyre për nulitetin e kontratës mbi shitblerjen të lidhur në mes të paraardhësit juridik të paditësve dhe të paditurës.

Me rastin e vendosjes gjykata në tërësi pranon konceptin se prona duhet të mbrohet sipas protokollit I (një) të Konventës Evropiane, me që mbrojtja e pronës sipas kësaj konvente për gjykatën është detyrim kushtetues, mirëpo në rastin konkret vlerësimi i gjykatës është se

kërkesëpadia është e pabazuar, pasi që gjykata në asnjë rast nuk mund të thirret në mbrojtje të pronës për një subjekt duke mohuar të drejtën e ligjshme të subjektit tjetër.

Gjithashtu gjykata pranon kërkesat e ligjit se një marrëdhënie kontraktuese për të qenë e vlefshme duhet të përmbajë në radhë të parë kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës dhe atë: aftësia punuese e palëve kontraktues, (aftësia e veprimit gjegjësisht mosha madhore), vullneti i palëve, lënda e kontratës dhe baza e kontratës. Po ashtu në rastin konkret është respektuar si kërkesë e ligjit edhe kushti i veçantë e që bëhet fjalë për formën e kontratës.

Gjykata pranon autorizimet ligjore nga neni 109 i LMD-ës, se gjykata kujdeset kryesisht për nulitetin e kontratës, mirëpo gjykata do të veprojë sipas këtij autorizimi kur gjen se kontrata është lidhë në kundërshtim me dispozitën e nenit 103 të LMD-ës, respektivisht kur kontrata është në kundërshtim me kushtetutën, rregullin shoqëror, dispozitat e detyrueshme apo moralin shoqëror. Në rastin konkret gjykata nuk gjeti se kontrata është në kundërshtim me dispozitën e nenit 103 të LMD-ës.

Pretendimet e palës paditëse se të metat e vullnetit për lidhjen e kontratës nga paraardhësi juridik i paditësve, kanë bazë në dispozitën e nenit 60 të LMD-ës, ngase kontrata sipas paditësve është lidhur nën kërcenim gjegjësisht kanosje, për gjykatën këto pretendime janë të paargumentuara nga ana e palës paditëse. Gjykata nuk vendos duke u mbështetur në supozime, por në fakte të provuara.

Si përfundim gjykata nuk ka gjetur asnjë element për ta shpallur kontratën lëndore absolutisht nule, ndërsa nëse i referohet kërkesës së padisë vetëm në të meta e vullnetit të kontratës atëherë çështja do të duhej të trajtohej në kuadër të dispozitave ligjore për kontratat e rrëzueshme e që në këtë rast sipas dispozitës së nenit 117 al 1 dhe 2 të LMD-ës, kjo e drejtë ka pushuar me kalimin e afati prej 1 respektivisht 3 vitesh, nga data e lidhjes së kontratës. Në fakt e paditura edhe i është referuar kundërshtimit sipas kësaj dispozite, duke theksuar së këtë rast ka parashkrim..

Për kërkesën tjetër të paditësve që i referohet vërtetimit të pronësisë, meqenëse gjykata nuk gjeti elemente për ta shpallur nule kontratën, rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësve është refuzuar edhe për kërkesën e pronësisë.

Përveç të cekurave më lartë sa i përket kërkesës për vërtetim pronësie kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar pasi që sipas dispozitës së nenit 44 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (LMTHJP) “E drejta e pronësisë pushon me kalimin e sendit në pronësinë shoqërore”.

Sipas dispozitës së nenit 45 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore “E drejta e pronësisë që e ka personi i caktuar mbi një send pushon, kur personi tjetër fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send”.

Meqenëse gjykata vendosi ta refuzoj kërkesëpadinë në kuptim të dispozitave të cituara, sipas të gjeturave faktike të përshkuara më lartë, pretendimet e paditësve që posedojnë faktikisht pronën

kontestuese në kontinuitet për më shumë se 30 vite, nuk ishin me relevancë për të vendosur ndryshe. Rrethanën e posedimit e kanë pohuar edhe dëshmitarët _____, _____, dhe _____, këto dëshmi të dëshmitarëve nuk ishin me rëndësi sepse në rastin konkret nuk shtrohet çështja e vërtetimit të së drejtës së pronësisë sipas parashkrimit me mbajje, por e drejta e pronësisë duke u shpallur fillimisht nule kontrata pastaj secila palë ti kthejë palës tjetër atë që i ka marrë.

Meqenëse se gjykata gjeti se kërkesëpadia është e pabazuar rrjedhimisht edhe kërkesa për masë të përkohshme (tani masë sigurie) ishte e pabazuar.

Gjykata vendosi ta refuzoj edhe kërkesën për masë të përkohshme, si pjesë të dispozitivit të këtij vendimi, meqenëse për kërkesën për masë nuk ishte vendosur paraprakisht. Arsyeimi i refuzimit të kërkesës për masë të përkohshme i referohet refuzimit të kërkesëpadisë, në këtë rast paditësi nuk ka arritur ta bëjë të besueshme kërkesëpadinë e rrjedhimisht as kërkesën që me anë të masës të sigurohet realizimi i kërkesës së tij.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 450 të LPK-ës, pasi që nga asnjëra palë nuk kishte kërkesë për shpenzime⁷².

Rasti XV

Anulim i kontratës mbi shitblerjen

Përshkrimi i rastit: *Kontesti është zhvilluar në mes të paditësve si shitës të pronës dhe të paditurit të parë blerës. Paditësit kanë kërkuar anulimin e kontratës.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovojnë tërësi kërkesëpadinë e paditësit.*

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: kontrata mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Leg.nr.3192/2009, e datës 27.05.2009; çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.UL-71813023-00884, e datës 21.07.2009, e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Prizren; autorizimi nr.165/09, i datës 22.04.2009, i “vërtetuar” pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj - dega në Shtërpce; çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.UL-71813023-00884, e datës 11.06.2009, e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale në Prizren; njoftimi (përgjigja) e Gjykatës Komunale në Ferizaj - dega në Shtërpce

⁷² Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr. C.nr. 1257/10, dt.06.10.2011.

Agj.nr.9/09, të datës 21.07.2009, aktakuza e Prokurorisë Komonale në Prizren me nr.PP.nr.2393/09, e datës 01.04.2011; fletëpagesa për shitblerjen e paluajtshmërisë e lëshuar nga "Raiffaisen Bankë Kosovë", e datës 18.05.2009; si dhe ekspertiza me shkrim e ekspertit të gjeodezisë të angazhuar në këtë çështje kontestimore, _____, e datës 04.03.2013, bashkë me skicën përcjellëse.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Nga leximi i kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë Leg.nr.3192/09, të datës 27.05.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se kjo kontratë është "lidhur" midis këtu paditësve të cilët "me autorizim", i ka përfaqësuar këtu e paditura e parë _____, si shitës në njërën anë dhe i padituri i dytë _____, si blerës në anën tjetër. Si objekt i kësaj kontrate paraqitet të jetë paluajtshmëria e evidentuar si ngastra P-71813023-00032/0, në vendin e quajtur "Barutni magacin", me kulturë arë e klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 80,45 ari dhe kullosë e klasit të 2-të, në sipërfaqe prej 2.80 ari, e evidentuar sipas fletë posedimit UL-71813023-000884, ZK Arbanë. Çmimi i shitblerës së kësaj paluajtshmërie figuron të jetë 22.000,00 euro.

Nga leximi i certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.UL-71813023-00884, të datës 21.07.2009, e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komonale në Prizren, gjykata e ka vërtetuar faktin se në momentin e lëshimit të kësaj certifikate, paluajtshmëria kontestuese P-71813023-00032/0, në vendin e quajtur "Barutni magacin", me kulturë arë e klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 80,45 ari dhe kullosë e klasit të 2-të, në sipërfaqe prej 2.80 ari, e evidentuar sipas fletë posedimit UL-71813023-000884, ZK Arbanë, është evidentuar në emër të të paditurit të parë Besir (Qerim) Bytyqi.

Nga leximi i autorizimit nr.165/09, të datës 22.04.2009, të përpiluar pranë Gjykatës Komonale në Ferizaj - dega në Shtërpce, gjykata ka konstatuar se me këtë autorizim, e paditura e dytë _____, kinse është "autorizuar" nga këtu paditësit, për shitjen e ngastrës e cila është objekt i këtij kontesti.

Nga leximi i certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me nr.UL-71813023-00884, të datës 11.06.2009, e lëshuar nga Zyra Kadastrale Komonale në Prizren, gjykata e ka vërtetuar faktin se në momentin e lëshimit të kësaj certifikate, paluajtshmëria kontestuese P-71813023-00032/0, në vendin e quajtur "Barutni magacin", me kulturë arë e klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 80,45 ari dhe kullosë e klasit të 2-të, në sipërfaqe prej 2.80 ari, e evidentuar sipas fletë posedimit UL-71813023-000884, ZK Arbanë, është evidentuar në emër të këtu paditësve.

Nga leximi i njoftimit (përgjigjes) së Gjykatës Komonale në Ferizaj - dega në Shtërpcë Agj.nr.0/09, të datës 21.07.2009, të nënshkruar nga administratori i kësaj gjykate _____, si përgjigje ndaj kërkesës së paditësit _____, të datës 21.07.2009, gjykata ka vërtetuar faktin se autorizimi nr.165/09, të datës 22.04.2009, nuk figuron në regjistrat e kësaj gjykate dhe se për të njëjtin ekziston dyshimi se është i falsifikuar. Këtij njoftimi gjykata ia fali besimin e plotë.

Nga leximi i aktakuzës së Prokurorisë Komonale në Prizren me nr.PP.nr.2393/09, të datës 01.04.2011, gjykata ka vërtetuar faktin se, mes të tjerëve, edhe kundër këtu të paditurës së dytë _____, nga ana e organit të lartcekur është ngritur aktakuza për veprën penale të falsifikimit të dokumentit si dhe veprën penale të mashtrimit.

Në bazë të fletëpagesës për shitblerjen e paluajtshmërisë, të lëshuar nga “Raiffaisen Bank Kosovë”, të datës 18.05.2009, gjykata ka konstatuar me datën e lartcekur, në xhirollogarinë e të paditurës së dytë _____, është deponuar shuma prej 22.000,00 euro, nga këtu i padituri i dytë _____, për shkak të shitblerjes së paluajtshmërisë e cila është objekt i kontratës së kontestuar.

Në bazë të ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë të angazhuar në këtë çështje kontestimore _____, të datës 04.03.2013, bashkë me skicën përcjellëse, gjykata ka konstatuar faktin se pasi që është bërë identifikimi i ngastrës në teren, është konstatuar se e njëjta është e papunuar dhe e pa shfrytëzuar, se në të nuk ka objekte të ndërtuara, respektivisht se kjo ngastër është e lirë. Sipas ekspertizës, në bazë të shënimeve me të cilat disponon aktualisht Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Prizrenit, ngastra e cila është objekt i këtij kontesti, është e regjistruar në emër të _____, regjistrimi i së cilës është bërë në bazë të kontratës së shitblerjes Leg.3192/2009, të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Prizren me datën 27.05.2009. ndërsa që më parë kjo ngastër ka qenë e regjistruar në emër të këtu paditësve gjegjësisht _____, _____, _____, _____, _____ dhe _____, që të gjithë nga fshati Gornje Sellë, Komuna e Prizrenit.

Baza Ligjore

Bazuar në nenin 12 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), “në themelimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në realizimin e të drejtave dhe të detyrimeve nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit kanë për detyrë t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe të ndershmërisë”. Sipas nenit 28 të LMD-së, është e paraparë se “vullneti për të lidhur kontratën mund të deklarohet me fjalë, me shenjat e zakonshme ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij”. Në nenin 51 të po këtij ligji thuhet se “secili detyrim kontraktues duhet ta ketë bazën e lejueshme”, ndërsa me nenin 52 të tij në mënyrë decisive ceket se “në qoftëse baza nuk ekziston, ose është e palejueshme, kontrata është nule”.

Po ashtu me nenin 103 të LMD-së, është e paraparë se “kontrata e cila është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë, me dispozitat e detyrueshme apo me moralin e shoqërisë, është kontratë nule”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Ne rastin konkret gjykata e ka vërtetuar nulitetin e kontratës së shitblerjes për paluajtshmërinë kontestuese, ngase për lidhjen e të njëjtës nuk janë plotësuar kushtet e përgjithshme, respektivisht nuk janë plotësuar elementet qenësore të kontratës së shitblerjes, të parapara me dispozitat ligjore të lartë cituara të LMD-së. Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, është vërtetuar se këtu paditësit asnjëherë nuk e kanë autorizuar të paditurën e dytë _____, për shitjen e ngastrës kadastrale e cila është objekt i kontratës së kontestuar. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar në bazë të provave të administruara në këtë procedure, e sidomos përmes njoftimit (përgjigjes) së Gjykatës Komunale në Ferizaj - dega në Shtërpcë Agj.nr.0/09, të datës 21.07.2009, të nënshkruar nga administratori i kësaj gjykate _____, nga i cili njoftim vërtetohet fakti se autorizimi nr.165/09, i datës 22.04.2009, përmes të cilit kine këtu paditësit e kishin “autorizuar” të paditurën e dytë _____ që, mes tjerash, ta shesë paluajtshmërinë e tyre, nuk figuron në regjistrat e kësaj gjykate dhe se për të njëjtin ekziston dyshimi se është i falsifikuar. Siq edhe u cek më lartë, këtij njoftimi gjykata ia fali besimin e plotë. Kjo do të thotë se kontrata Leg.nr.3192/2009, e datës 27.05.2009, nuk ekziston – konsiderohet se nuk është lidhur asnjëherë në mes të paditësve dhe të paditurit të parë _____, për shkak se ata as që e kanë nënshkruar atë, e krejt kjo ngase të njëjtit asnjëherë nuk e kanë autorizuar askënd që në emër të tyre të lidhë kontratën mbi shitblerjen paluajtshmërisë së tyre. Gjykata vlerëson se në rastin në fjalë, nuk ka ekzistuar njëra palë kontraktuese, gjegjësisht nuk ka ekzistuar vullneti i njëjës palë, për ç’arsye edhe kjo kontratë nuk ekziston. Si rezultat i të lartcekurave del se në këtë rast, ndër të tjera, ka munguar edhe baza (e lejueshme) e kontratës, ngase në mungesë të palës kontraktuese konsiderohet se ka munguar edhe qëllimi juridik që e ka shtyrë subjektin përkatës (në këtë rast paditësit), që të krijoj të drejta dhe të marrë detyrime, elemente këto të cilat i japin karakterin juridik punës së caktuar juridike. Në mungesë të bazës së kontratës, e cila mes tjerash duhet të jetë edhe e lejueshme, kontrata konsiderohet të jetë nule. Prandaj, sipas vlerësimit përfundimtarë të kësaj gjykate, kontrata e shitblerjes e cila është objekti i këtij kontesti, nuk mund të ekzistojë, e njëjta konsiderohet të jetë nule, ngase nuk i përmban elementet esenciale të lartpërmendura të cilat duhet t’i përmbaj secila kontratë, nga ku edhe del përfundimi se quad nullum est, nullum producitur effectum.

Vlen të theksohet se edhe e paditura e dytë _____, nuk e ka kundërshtuar vërtetimin e nulitetit të kësaj kontrate, ngase sipas vetë deklarimit të saj, ajo as që e ka ditur se çka ishte duke nënshkruar, me ç’rast shprehimisht ka shtuar se ajo nuk ka qenë e autorizuar nga paditësit për shitjen e paluajtshmërisë së tyre.

Kontestimet e të autorizuarit të të paditurit të parë av. _____, nga Prizreni në lidhje me paafatshmërinë e padisë së paditësve, gjykata nuk i mori për bazë, ngase me shiqim në shkresat e lëndës shihet qartë se kontrata kontestuese Leg.nr.3192/2009, është vërtetuar pranë Gjykatës Komonale me datën 27.05.2009, ndërsa që padia e paditësve për vërtetimin e nulitetit të saj është bërë pranë kësaj gjykate me datën 21.07.2009, që i bie dikund pas më pak se 2 muajve. Pavarësisht këtij fakti, gjykata vlerëson se bazuar në dispozitat ligjore të LMD-së, kontrata Leg.nr.3192/2009, e datës 27.05.2009, nuk është kontratë e rrëzueshme, për të cilën ekzistojnë afatet prekluzive brenda të cilave afate mund të kërkohet anulimi i saj, por në rastin në fjalë kemi të bëjmë me kontratë absolutisht nule, për shkak se kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me dispozitat ligjore (të detyrueshme), të cilat parashohin se kontrata duhet të lidhet në pajtim me vullnetin e dy palëve, andaj e drejta e theksimit të nulitetit të kësaj kontrate nuk parashkruhet.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Sa i përket masës së përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.244/11, të datës 13.09.2011, gjykata vendosi që të njëjtën ta le në fuqi deri në përfundimin të plotfuqishëm të këtij kontesti, në mënyrë që palëve ndërgjyqëse të mos u shkaktohet ndonjë dëm i pariparueshëm”⁷³.

Rasti XVI

Zgjidhje e martesës, besimi i fëmijës dhe mbajtjes

Përshkrimi i rastit: *Kontesti është zhvilluar në mes të bashkëshortëve për zgjidhje e martesës, besimin e fëmijëve, kontaktin dhe alimentacionin.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoj kërkesëpadinë për zgjidhjen e martesës, fëmijën e mitur ja ka besuar të paditurës/nënës, paditësit ja ka caktuar kontaktin dhe e ka detyruar që paguaj alimentacion për çdo muaj.*

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Pas vlerësimit të provave të administruara e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

⁷³ Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.244/11, dt.24.04.2013

Në mesë palëve ndërgjyqësore nuk është kontestuese se marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar deri në atë shkallë saqë jeta e tyre e përbashkët është bërë e padurueshme dhe si rezultat i kësaj bashkësi martesore edhe faktikisht është shkëputur nga data 28.08.2012.

Duke u nisur nga fakti se e paditura nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit për zgjidhjen e martesë me shkurorëzim, kjo gjykatë, në kuptim të nenit 68 par.4 të Ligjit për Familjen i Kosovës, padinë e paditësit e konsideron si propozim i përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje dhe nuk i heton faktet sa i përket shkaqeve të zgjidhjes së martesës në kuptim të nenit 69 dhe martesën e zgjidh në bazë të nenit 68 par 2 të Ligjit në fjalë.

Në bazë të certifikatës së martesës shihet se bashkëshortët kanë lidh martesë me dt. 09.12.2009 pranë zyrës së ofiqarisë në Prishtinë. Nga certifikatat e lindjes vërtetohet se nga kjo bashkësi martesore kanë lindur të miturën _____, e lindur me 10.01.2010 e lindur në Prishtinë, nga i ati ____ dhe e ëma _____.

Paditësi me padi ka kërkuar që ati ti besohet vajza në ruajtje kujdes dhe edukim përkatsisht nënës së tij, ndërsa e paditura këtë e ka kundërshtuar.

Nuk ishte kontestuese që vajza e mitur pas ndarjes së prindërve që nga data 28.08.2012 jeton me nënën e saj. Për të vendosur lidhur me çështjen se cilit nga prindërit t'i besohet fëmija në përkujdesje dhe edukim gjykata ka marr raportet e dy qendrave për punë sociale, asaj në Prishtinë dhe Lipjan. Qendra për punë sociale në Prishtinë në raportin e saj, lidhur me këtë çështje, ka dhënë mendim dhe propozim që duke i marrë parasysh kushtet e paditësit për rritjen e vajzës pse mos t'i besohet edhe atij dhe se për këtë i mbetet gjykatës që të vendos për rastin. Qendra për punë sociale në Lipjan në raportin e saj ka dhënë mendimin përfundimtar me një konstatim që shikuar nga ana psiko-fizike nëna i plotëson të gjitha kushtet që të përkujdeset për fëmijën e saj.

Sa i përket besimit të fëmijës së mitur _____ gjykata vlerësoi raportet e të dy Qendrave për Punë Sociale në Prishtinë dhe Lipjan dhe pasi i mori për bazë edhe rrethanat e tjera vendosi që vajzat e mitura t'i besohet në ruajtje mbajtje dhe edukim të paditurës gjegjësisht nënës, për arsye se vajza e mitur më tepër është e lidhur emocionalisht me nënën, sepse që nga momenti i ndarjes jeton së bashku me nënën si dhe për shkak të moshës së re të saj i nevojitet kujdesi i vazhdueshëm i nënës. Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjyqimit dhe duke ju referuar neneve 140 dhe 144 të Ligjit mbi Familjen ka shqyrtuar të gjitha rrethanat e rëndësishme objektive dhe ato subjektive të cilat janë më rëndësi për zhvillimin e drejtë psikik e fizik dhe për edukimin e fëmijës, e në radhë të parë është nisur nga interesi më i mirë i fëmijës.

Në kuptim të nenit 290 par. 1 të Ligjit për Familjen i Kosovës, prindërit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje financiare për fëmijët e tyre të mitur. Shuma e detyrimit ushqimor caktohet në përpjesëtim me mundësitë e detyruesit për ushqimi dhe brenda

kufijve të nevojave të kërkesit të ushqimit, duke pasur parasysh moshën dhe nevojat e fëmijëve si dhe mundësitë e personit që ka për detyrë të japë ushqimin, gjykata do t'i marrë parasysh të gjitha të ardhurat e tij dhe mundësitë reale që të realizojë fitimin si dhe nevojat e tij vetanake dhe detyrimin ligjor të ushqimit. Rrethanat në bazë të të cilave caktohet ushqimi vlerësohen në kohën e vendosjes lidhur me ushqimin.

Mbi këtë bazë gjykata vlerësoi kërkesën e të paditurës për caktimin e pagesës për ushqimi për të miturën dhe vendosi që paditësi – babai i të miturës të kontribuoj në edukimin dhe kujdesin për të miturën ashtu që i njëjti proporcionalisht me mundësitë e tij materiale do të paguaj për çdo muaj nga 70 €, sepse sipas pohimit të tij dhe kontratës së punës rezulton që paditësi është në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në “N.H.T SIRUS-B” dhe merr pagë mujore në shumën prej 300€, ndërsa e paditura është e pa punë dhe nuk realizon të ardhura personale.

Sa i përket lartësisë së ushqimit, kjo Gjykatë konsideron se shuma e caktuar është në përpjesëtim me mundësitë e paditësit dhe se u përgjigjet nevojave dhe kërkesave të vajzës se mitur, duke pasur parasysh edhe kontributin e të paditurës dhe mundësitë e saj për ushqimi. Në këtë rast kemi të bëjmë me zbatimin e vlerësimit të lirë nga neni 323 të LPK, sipas të cilit kur gjykata vërteton se palës i takon e drejta që t'i shpërblehet dëmi me të holla, por pamundësitë që të caktohet shuma e të hollave, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë.

Vendimin për rregullimin e kontakteve personale të fëmijëve me prindërin, që nuk e ushtron të drejtën prindërore, gjykata e merr në radhë të parë duke e marrë për bazë interesin e fëmijës që të sigurohet mbajtja e lidhjes ndërmjet fëmijës dhe prindit, me qëllim të kultivimit të ndjenjave dhe raporteve të ndërsjella të tyre. Nisur nga kjo e duke e marrë për bazë edhe faktin që e paditura nuk e ka kundërshtuar çështjen e kontaktit të vajzës me paditësin, gjykata vlerëson se kontakti personal i paditësit me fëmiun e mitur të caktohet si në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit, nga këto arsye: U vendos që në gjashtëmujorin e parë vajza të kontakton me të atin në orar më të shkurtuar, ashtu që gradualisht të njifet me të atin, të rikrijoj kontaktin e humbur, të rifitoj sigurinë dhe besimin për të qenë në prani të tij. Besohet që një periudhë gjashtëmujore është e mjaftueshme që i ati dhe vajza të krijojnë një lidhje të shëndoshë prind – fëmijë për të krijuar bazën për kontakt më të gjatë dhe atë duke i dhënë përparësi interesit të fëmijës për zhvillimin e drejtë psikik, fizik dhe për edukimin e saj”⁷⁴.

Rasti XVII

Alimentacion/mbajtje

⁷⁴ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.545/12-Pr.1, dt.21.11.2013

Përshkrimi i rastit: Kontesti është zhvilluar në mes të ish bashkëshortëve me kërkesë nga ish bashkëshortja që të detyrohet ish bashkëshorti që të paguaj alimentacion për fëmijën e mitur dhe mbajtje për ish bashkëshorten.

Mënyra e vendosjes: Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë alimentacion dhe mbajtje, ndërsa pjesën tjetër e ka refuzuar si ët pabazuar.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Pas çmuarjes me ndërgjegje dhe të kujdesshme të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, në pajtim me nenin 8 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv që kërkesëpadinë e paditëseve pjesërisht ta aprovoi si të bazuar.

Nga Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, C. nr. 434/2007, i formës së prerë më dt. 10.08.2007, vërtetohet që i padituri të kishte jetuar në bashkësi martesore me bashkëshorten _____, deri me datën 10.08.2007 kur është zgjidh kurora, ndërsa fëmijët e përbashkët _____, e lindur më 29.04.1996 dhe _____, e lindur më 08.03.1994, i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës _____, të cilat edhe tani jetojnë me të. Me këtë aktgjykim i padituri nuk është obliguar në pagimin e alimentacioit.

Për të vlerësuar mundësit e të paditurit për të dhënë mbajtje financiare gjykata i është referuar kontratës së punës nr. 1/421 dt. 18. 05. 2012, nga e cila vërtetohet se i padituri është në marrëdhënie pune në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, në pozitën profesor i asocuar, ku realizon të ardhura mujore në shumën prej 1062.67€ në muaj. Ndërsa nga provat e siguruar nga gjykata rezulton se i padituri ka të hapura gjirrollogari vetëm në bankat NLB Prishtina dhe Raiffeisen Bank. Nga këto gjirrollogari rezulton që i padituri ka mjete vetëm në Raiffeisen Bank dhe atë lartësia e mjeteve deri me datën 03.10.2013 ka qenë në shumën prej 29.907.96€

Nga vendimi numër 538 datë 31.05.2013, lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, vërtetohet se me datën 20.05.2013 të paditurit i është ndërpre marrëdhënia e punës në këtë institucion dhe atë për pozitën udhëheqës i qendrës për inovacione dhe transfer të teknologjisë (QITT). Ndërsa nga akti i emërimit sipas të cilit i padituri në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është emëruar drejtor i departamentit të arsimit të lartë, rezulton se të paditurit me datën 31.08.2013 i ka përfunduar marrëdhënia e punës në këtë institucion.

Edhe pse paditësja _____, tani ka mbushur moshën madhore, ngase nga certifikata e lindjes nr. 25/302 dt. 07. 03. 2012 vërtetohet se ka lindur 08.03.1994, gjykata ka caktuar mbajtjen financiare në shumën prej 150€ në muaj e për faktin se ajo është në vazhdim të shkollimit dhe atë tani si studente e rregullt në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë, që vërtetohet nga ID e bashkangjitur në parashtresën për dorëzimin e provave datë 11.09.2013. Ky obligim i mbajtjes financiare të fëmijës madhor për shkak të shkollimit rrjedh nga marrëdhëniet prindërore. Një detyrim i tillë rrjedh nga neni 280 pika 2 i LF, sipas të cilit

prindërit janë të detyruar të sigurojnë mbajtje financiare në mënyrë të arsyeshme për fëmijët në moshën në mes 18 dhe 26 vjeç përderisa ata jetojnë në shtëpinë e prindërve të tyre apo njërit prind dhe janë ende në shkollim të përgjithshëm. Një nga detyrat prindrore në kuadër të kujdesit prindëror është edhe arsimimi i fëmijëve dhe sipas nenit 290.2 të LF, është parapa detyrimin e prindërve për mbajtje financiare për fëmijët që kanë mbushur moshën madhore e të cilët janë duke u shkolluar dhe nuk kanë mbushur moshën 26 vjeçare.

Edhe në raport me paditësen të miturën _____, gjykata në emër të mbajtjes financiare ka caktuar shumën prej 150€ në muaj duke vlerësuar se ushqimi i fëmijës është detyrim i natyrës pasurore i cili ka të bëjë me sigurimin e kushteve të nevojshme për ngritjen dhe edukimin e saj. Sipas dispozitës së nenit 290 të Ligjit mbi Familjen të Kosovës, përcaktohet detyrimi e prindërit për mbajtje financiare të fëmijëve të tyre të mitur, që ka të bëjë me sigurimin e mbajtjes dhe kujdesit të nevojshëm për mirëqenien e tij, e që nënkupton edukimin, shkollimin dhe përgatitjen e tij për t'u aftësuar në jetë dhe në komunitetin ku jeton e edhe me gjerë. Mirëpo ushqimi caktohet sipas nevojave të fëmijëve e me mundësit e çdo njërit prind. Mbajtja financiare e fëmijut të tyre të mitur është obligimi ligjor i të dy prindërve pavarësisht a jetojnë bashkë apo jo. Në këtë kontekst, prindërit nuk mund të heqin dorë nga mbajtja financiare e fëmijëve të tyre të mitur e as të lirohen nga ky detyrim. Fëmijët e mitur gëzojnë të drejtën e mbajtjes financiare përderisa ata janë të mitur, pa marrë parasysh a janë në shkollim të mëtutjeshëm apo nuk kanë zhvilluar shkollimin e tyre, pra fëmija i mitur deri në moshën 18 vjeçare është detyrim i prindërit për mbajtje financiare respektivisht prindi nuk lirohet nga mbajtja financiare deri në moshën 18 vjeçare. Është parapa si rregull e përgjithshme se prindërit kanë detyrim të kontribuojnë në mbajtjen financiare e fëmijëve të mitur edhe në rast së rrezikojnë mjetet e tyre financiare, përkatësisht në dëm të vetin

Lartësinë e vlerës së mbajtjes financiare në shumë nga 150€ për secilën nga paditëset gjykata e caktoi duke marrë parasysh nevojën e tyre, moshën, nevojat e tjera për edukim, arsimim, përkujdesje mjekësore (neni 330 i LF) dhe mundësitë e ushqimdhënësit, duke u bazuar në lartësinë e të ardhurave mujore që realizon dhe të shumave të deponuara në gjirollogari të tij si dhe duke u nisur nga fakti jokontestues se tani i padituri është martuar dhe ka krijuar familje të re. Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara janë në proporcion me nevojat e paditëseve edhe nga fakti se ato jetojnë me nënën e cila është në marrëdhënie pune dhe realizon të ardhura mujore prej 750€.

Nga këto arsye gjykata e refuzoj pjesën e kërkesëpadisë së paditëseve në shumat më të larta të kërkuar prej 150€ në muaj nga ato të aprovuar prej 150€, duke filluar nga parashtrimi i padisë dt.20.03.2012 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për këtë pagesë, duke konsideruar se shumat prej 150€ janë në përputhje me nevojat reale të paditëseve dhe se me këtë lartësi arrihet qëllimi i mbajtjes financiare.

Në kuadër të kujdesit prindërorë që përfshihet edhe arsimimi i fëmijëve, gjykata vlerëson se shumat e caktuara për paditëset janë reale duke marrë për bazë koston e shkollimit në Kosovë në shkollat publike. Sa i përket provave të prezantuara nga paditëset e që kanë të bëjnë me pagesat për shkollim në Kolegje private, gjykata vlerëson se është e drejtë e tyre që sipas mundësive financiare të zgjedhin edhe institucionin se ku do të shkollohen.

Gjykata aprovoj kërkesën për pagim të mbajtjes financiare nga data 20.03.2012 kur është ushtruar padia, ngase qëllimi i kontributit për ushqim është plotësimi i nevojave të kërkuarit të ushqimit nga momenti i paraqitjes së kërkesës e në të ardhmen.

Lidhur me kamatën gjykata vendosi që ajo të jetë 3% dhe atë sipas neneve 186 dhe 277 të LMD-së dhe jo 8% siç është kërkuar nga paditëset ngase në kohën kurë është paraqit padija nuk ka qenë në fuqi Ligji i ri i Marrëdhënieve të Detyrimeve (Ligji nr.04/I-077), ngase i njëjti ka hyr në fuqi me 20 dhjetor 2012”⁷⁵.

Rasti XVIII

Anulim i njoftimi, kthim në punë dhe pagesë e pagave

Përshkrimi i rastit: *Me padi është kërkuar anulimi i njoftimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kthimi në punë dhe pagesa e pagave.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë.*

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e provave nga shqyrtimi i mbajtur në këtë gjykatë me 22.10.2013, bëri administrimin e provave me leximin e Kontratave të punës versioni në anglisht dhe shqip dt.19.09.2005, Vendimi i të paditurës dt. 19.11.2009, Shkresa e dt. 18.03.2011 e të paditurës drejtuar paditëses me reference permbyllja e kontratës së punës, pergjegja e të paditurës e dt. 21.05.2010, Politika e personelit me numer REF.HRS –Bl. 09 /955, manuali i procedurave të personelit, Konfirmimi me numër të referencës 12/294 dt. 22.3.2012, ekstrakti i librit të pranimit dorezuar nga e paditura mbi dergesat postare, kërkesa për kthim në vendin e punës dt.17.05.2010 dhe lista e punëtorëve të degës së Vushtrrisë datë 21.10.2013.

Gjykata fillimisht ka vendosur lidhur me afatshmërin e padisë.

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi dhe seancat paraprake është thirr në afatshmërinë e padisë së paditëses e me arsyetim se paditësja aktin e refuzimit e ka pranuar me

⁷⁵ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, c.nr.1033/13, dt.05.11.2013

24.05.2010 ndërsa padinë në Gjykatën Komunale në Vushtrri e ka dorëzuar me 29.06.2010. Për ta vërtetuar këtë fakt i autorizuari i të paditurës ka marrë për obligim që ta siguroj këtë provë dhe për këtë ka dorëzuar librin e pranimit në të cilën figuron emri i paditëses dhe data 24.05.2010 kurë është dorëzuar shkresa në postë.

Gjykata kryesisht, sipas kundërshtimit të paditurës dhe mbi bazën e provave të administruara e vlerësoj se padia e paditëses është e afatshme për faktin se i autorizuari i të paditurës nuk ka arritur të provoj faktin se kurë paditësja personalisht e ka marrë një shkresë të tillë nga e paditura e që në këtë rast një gjë e tillë është e domosdoshme. Prova të cilës i referohet e paditura (libri i pranimit) dëshmon se shkresa që i referohet paditëses është dorëzuar në post me dt.24.05.2010 dhe mbi bazën e kësaj prove nuk mund të vlerësohet se paditësja shkresën e ka marrë në dorëzim atë ditë.

Pas analizimit të provave secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe bindjes së lirë, konform nenit 8 te LPK-se, gjykata lidhur me këtë çështje civilo- juridike, vërtetoi këtë gjendje faktike.

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune të e paditura në pozitën e pastrueses. Sipas kontratës së punës të datës 19.09.2005 përkatësisht nenit 2 pika a) vërtetohet se paditësja të e paditura ka marrë detyrat e punës me datën 22 gusht 2005 për periudhë të pacaktuar.

E paditura me shkresën e datës 18 mars 2010, për përmbyllje të kontratës së punës, paditëses ja ka ndërpre kontratën e punës bazuar në paragrafin 5.9.1 të Politikës së Personelit, seksionit (c) e për shkak të ndryshimeve organizative të e paditura. Në paragrafin e dytë të shkresës e paditura ka konstatuar se pas analizës së brendshme të bërë nga departamenti i burimeve njerëzore, kemi ardhë në përfundim se shërbimet tuja nuk janë më të nevojshme. Si rezultat i kësaj, në pajtueshmëri me paragrafin 7 c), ne kemi vendosur të ndërprejm kontratën e sipërpërmendur nga data 18 mars 2010.

Lidhur me ligjshmërin e ndërprerjes së marrëdhënies se punës – kontratës se punës.

Gjykata shkresën e të paditurës për përmbyllje të kontratës së punës dt. 18 mars 2010 e konsideron si jo të ligjshëm, nga këto arsye:

E paditura në përgjigje në padi dhe seanca gjyqësore është thirr në atë se e ka paralajmëruar paditësen se marrëdhënia e punës do t'i ndërprehet përfundimisht me datën 18 mars 2010, mirëpo nuk ka ofruar prova për ta dëshmuar që paditësja paraprakisht të jetë njoftuar në ndonjë mënyrë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Pala e paditur pretendon se paditësja paraprakisht është njoftuar për shuarjen e vendit të saj të punës, mirëpo për këtë nuk ka siguruar prova dhe sipas nenit 7.1 të LPK-së barra kryesore për paraqitjen e fakteve dhe provave në një proces gjyqësor ju takon palëve. Mbi këtë bazë gjykata vlerëson se e paditura paditëses ja ka

shkëputur kontratën e punës në kundërshtim me nenin 7 pika c) e kontratës së punës, me të cilin nënë palët kontraktuese kanë parapa se kontrata mund të ndërpritet nga të dy palët me paralajmërim para një muaj.

E paditura thirret në atë se paditëses ja ka ndërpre marrëdhënien e punës duke u thirrur në paragrafin 5.9.1 të Politikës së Personelit, seksionit (c) e për shkak të ndryshimeve organizative, ndërsa në përgjigje në padi thirret në dispozitën e nenit 11.7 të Ligjit Themelor të Punës në Kosovë që parasheh se kontrata e punës mund të shkëputet nga punëdhënësi për shkak të ndryshimeve ekonomike, teknologjike ose strukturale të ndërmarrjes.

Gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës për përmbyllje të kontratës së punës është në kundërshtim edhe me dispozitat e nenit 11.7, përkatësisht nenit 12 të të Rregullores së UNMIK-ut për Ligjin Themelor të Punës, ngase në raste të tilla kur punëdhënësi ka për qëllim që ta shkëpus kontratën e punës ndaj punonjësit, për shkak që janë prapa në nenin 12.1, ai duhet ta njoftoj me shkrim punonjësin para se t'i zbatoj ndryshimet e tilla. Në pikën b) të këtij neni është parapa se punëdhënësi e njofton punonjësin e tij me shkrim lidhur me shkëputjen e kontratës së punës së paku 3 muaj para datës së shkëputjes. Veprime të tilla nuk janë ndërmarr nga e paditura dhe mbi këtë bazë rezulton kundërligjshmëria e vendimit të paditurës.

Pretendimin e të autorizuarës së të paditurës se vendi i punës së paditëses nuk ekziston dhe organizimin e tanishëm sipas listës së prezantuar për punëtorët që janë tani duke punuar të e paditura gjykata i vlerëson si irelevante ngase paditëses i është shkëputur kontrata e punës në mars të vitit 2010 dhe atë për shkak të ndryshimeve strukturore organizative mirëpo ka dështuar të dëshmoj se në atë kohë ka ndodhur një ndryshim i tillë dhe që ta ketë njoftuar me shkrim paditësen për ndryshimet e pretenduara sipas dispozitave ligjore të cekura më lartë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar si më lart, gjykata vërtetoi se njoftimi i të paditurës për shkëputjen e kontratës së punës i datës 18 mars 2010 është i kundërligjshëm, duke e detyruar të paditurën që ta kthej në vendin e mëparshëm të punës me të drejtat dhe obligimet sipas kontratës së punës të datës 19.09.2005

Lidhur me kërkesën për pagimin e pagës mujore.

Gjykata vlerëson se e paditura në mënyrë të kundërligjshme paditëses ja ka ndërpre marrëdhënien e punës dhe në këtë mënyrë ia ka pamundësuar që të punoj dhe të realizoj të ardhurat nga marrëdhënia e punës.

Me dispozitën e nenit 164 të Ligjit mbi punën e bashkuar, si ligj i zbatueshëm në Kosovë, është paraparë së, nëse punëtori pëson dëme në punë ose lidhur me punën, ka të drejtë nga organizata të kërkoj kompensimin e dëmit në bazë të parimit të përgjithshëm për përgjegjësinë e dëmit.

Si rezultat, Gjykata vlerëson se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar dhe si të tillë aprovon në tërësi në mbështetje të dispozitës së nenit 164 al. 1 të LPB lidhur me nenin 154 të LMD-së, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'ia paguaj pagën mujore sipas kontratës së punës dt.19.09.2005, dhe atë nga data 01.04.2010 e tutje deri në kthimin në vendin e punës, me kamat vonesë prej 3.5% nga data e marrjes së aktgjykimit 22.10.2013 e deri në pagesën definitive

Ndërkaq lartësinë e kamatës e ka caktuar duke e marrë për bazë lartësinë që e paguajnë bankat që operojnë në Kosovë, për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar mbi një vit, në kuptim të dispozitës së nenit 277 par 1 i LMD.

Gjykata gjatë vendosjes i vlerësoj edhe të dhënat e parashtruara nga i autorizuari i të paditurës por të njëjtat nuk ishin bindëse që të vendoset ndryshe, meqenëse me asnjë provë nuk ka argumentuar që paditësja paraprakisht dhe atë në aftin e paraparë në kontratë të jetë informuar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe nuk është provuar që të e paditura të ketë pasur ndryshime organizative, ekonomike dhe strukturale gjatë vitit 2010 kur paditëses i është ndërpre kontrata e punës”⁷⁶.

Rasti XIX

Anulimi i vendimit, kthimi në punë dhe pagesë e pagave

Përshkrimi i rastit: *Me padi është kërkuar anulimi i vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kthimi në punë dhe pagesa e pagave.*

Mënyra e vendosjes: *Gjykata në shqyrtimin kryesor ka administruar provat dhe ka vendosur që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadijën.*

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Nga shkresat e lëndës gjykata konstaton me sa vijon: se paditësi, me këtu të paditurën ka lidhur marrëdhënie juridike të punës - Zyrtar Policor-për kohë të pacaktuar në vendin e punës, krimteknik, më të drejta dhe detyra si në kontratë.

E paditura me vendimin e saj, 739/KBD/14 të dt. 18.09.2014 ka nxjerr vendim që paditësi të largohet nga puna me arsyetim si në atë vendim.

E paditura me vendimit me nr. 254-KA-D/2014 dt. 23.10.2014, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e këtu paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e komisionit të brendshëm disiplinor me nr. 739/KBD/2014 të dt. 18.09.2014 më arsyetim si në aktvendim.

⁷⁶ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2103/13, dt.22.10.2013

Në shkresat e lëndës, gjykata ka konstatuar se: shkelja disiplinore e pretenduar e konstatuar në vendimin e kontestuar ka ndodhur më dt. 30.10.2008. Më dt. 28.05.2010 është bërë njoftimi për formularin e paraqitjes së disiplinës së brendshme. Drejtoria e Standardeve Profesionale rastin – lëndën e ka pranuar më dt. 24.10.2011. Fillimi i hetimeve disiplinore është bërë më dt. 09.06.2010. Pezullimi i hetimeve është bërë më dt. 15.07.2010 ndërsa përfundimi i hetimeve është bërë më dt. 04.08.2014 ndërsa vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë më dt. 18.09.2014.

Paditësi duke vepruar sipas këshillës juridike, të dhënë në aktvendimin me nr. 254-KA-D/2014 të dt. 23.10.2014, ka ushtruar padi, në Gjykatën Themelore në Pejë, të cilën padi e ka ndryshuar me parashtrësën e dt. 22.04.2016.

Gjykata duke vendosur lidhur me lirshmërinë e vendimit më të cilat vendim, paditësi është përjashtuar nga puna, pas administrimit të të gjitha provave prezent në lëndë, e duke u mbështetur ne dispozitat të nenit 5, 7, 10 12.1, pika 1.2) dhe 1.3), 55, 70, 71, 72, 74, 78, 79 dhe 80, 82, 85 dhe të Ligjit të Punës me nr. 03/L-212, e lidhur me nenin 17 të Udhëzimit Administrativ më nr. 15/2008-MPB, nenin 79 dhe 86 të Udhëzimit Administrativ më nr. 07/2002 Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës dhe lidhur më nenin 4, 5, 6, 9 dhe 45 të Udhëzimit Administrativ më nr. 06/2012, për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës erdhi ne përfundim së kërkesë padia e paditësit është në tërësi e bazuar dhe se vendimet e kontestuara, janë të pa drejta dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë.

Gjykata pas administrimit të provave prezent në lëndë, erdhi ne përfundim se vendimi i të paditurës me të cilat paditësi i është shqiptuar masa disiplinore, largim nga puna, është marrë në mënyrë të kundërligjshme, është i pa drejta dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura me lartë, për arsye se masat disiplinore e pushimit të marrëdhënies së punës mund ti shqiptohet të punësuarit sipas procedurës në mënyrën dhe rrethanat e parashikuara me ligj, akte normative dhe kontratën kolektive, të cilat janë të aplikueshme në Kosovë, të cilat parashikojnë se procedura disiplinore, e zhvillon komisioni disiplinor sipas kërkesës së organit kompetent, për shkak të shkeljeve të detyrave të punës, për të cilat shkelje shqiptohet masa e ndërprerjes së marrëdhënies e punës, sipas procedurës se përcaktuar me ligj. Ne rastin konkret, vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës është marrë me shkeljen e procedurës se paraparë me dispozitat të cekura më lartë, për arsye së paditësi i ka realizuar të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënies e punës, të e paditura dhe me asnjë prove të vetme nuk janë argumentuar shkaqet e ndërprerjes së marrëdhënies se punës, për të cilat pretendon e paditura, për arsye se procedura për konstatimin e përgjegjësisë se punëtorit për shkeljen e detyrave të punës, duhet të inicohet dhe përfundoj procedura disiplinore në afatet e parapara ligjore dhe duke respektuar të gjitha të drejtat e punëtorit. Në këtë rast e paditura, nuk e ka respektuar afatin kohor për fillimin dhe përfundimin e hetimeve, në këtë rast pas pezullimit, për fillimin dhe përfundimin e procedurës disiplinore, nuk e ka njoftuar me kohë për shkeljen e dyshuar dhe nuk ju ka dhënë

mundësia e deklaramit me shkrim për shkeljen e dyshuar dhe nuk ju ka dhënë mundësia për tu këshilluar me këshilltarin juridik sipas zgjedhjes së tij.

Gjykata vendosi si në pikën I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke i anuluar vendimin e kontestuar dhe duke e detyruar të paditurën, që paditësi ta kthejë në marrëdhënien e punës, në vendin e punës dhe detyrat punuese si Zyrtar Policorë, pranë të paditurës në Pejë, për arsye se ndërprerja e marrëdhënies së punës në bazë të vendimeve të kontestuara, ndaj paditësit nga ana e të paditurës, është bërë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës dhe dispozitat e Udhëzimeve Administrative të cekura me lartë.

Gjykata vendosi si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit, në emër të kompensimit të dëmit për shkak të pamundësisë të realizimit të ardhurave personale, duke filluar nga dt. 01.12.2014, e deri me dt. 29.02.2016, ti paguaj për pagat bazë-neto, të pa paguara, në shumën prej 7 498 euro dhe pagat e papaguara neto për çdo muaj, shumën në lartësi prej 499, 87 euro, duke filluar nga dt. 01.03.2016 e deri sa paditësi të kthehet në punë, me kamat ligjore 8%, duke filluar nga dt. 04.05.2016, e deri në pagesën definitive, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 5, 55 dhe 80, të ligjit të Punës, e duke marrë për bazë ekspertizën financiare të dt. 07. 03. 2016, të punuar nga eksperti financiar Ukë Sadiku, të cilës gjykata ja fali besimin në tërësi për arsye se eksperti financiar ka bërë llogaritjen e pagave të pa paguara paditësit, në mënyrë të saktë për periudhën kohore sipas kërkesës së paditësit, të ndryshuar si në parashtrësën e dt. 22.04.2016, për periudhën kohore nga dt. 01.12.2014, e deri me dt. 29.02.2016, eksperti në mendimin e tij profesional në formë të shkruar dhe tabelore, ka sqaruar periudhën kohore për pagat e pa paguara, pagën bruto, kontributin pensional, tatimin në burim, pagën neto, e të gjitha këto për secilin muaj veç e veç dhe shumën e tërësishme, duke marrë për bazë të gjitha provat në shkresat e lëndës.

Gjykata vendosi si në pikën I dhe II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë për bazë faktin se paditësit nuk i ka përfunduar marrëdhënien e punës sipas fuqisë ligjore me skadimin e kohëzgjatjes së saj, por paditësit i është ndërprerë marrëdhënien e punës me veprime të kundërligjshme nga e paditura, në bazë të vendimeve të kontestuara, të cilat vendime janë në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës dhe në kundërshtim me dispozitat e Udhëzimeve Administrative të cekura me lart, për çka paditësin e kanë vendosur në pozitë të pa favorshme dhe diskriminuese, duke e larguar nga puna pa bazë ligjore, dhe duke ja pamundësuar realizimin e të ardhurave personale.

Gjykata vendosi si në pikën III, të diapozitivit të këtij aktgjykimi duke e detyruar të paditurën që paditësit në emër të kamatës ligjore 8%, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382, të Ligjit për Marrëdhënien të Detyrimeve me nr. 04/L-077, për arsye se e paditura ka ra në vonës për pagat e pa paguara me dt. 04.05.2016, kur gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë edhe kundërshtimet e tjera të palës së paditur mirëpo nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për arsye se me asnjë provë të veprime nuk kanë arritur ta argumentojnë të kundërtën e pretendimeve nga padia e të cilën gjë, ka qenë e detyruar ta argumentojnë e paditura në kuptim të dispozitës së nenit 7.1, 319.1 dhe 322, të LPK - së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në piken IV, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, duke marrë për bazë suksesin e palës paditëse në këtë procedurë⁷⁷.

Rasti XX

Aktgjykim për shkak të mosbindjes

Përshkrimi i rastit: Me padi është kërkuar përmbushja e kontratës

Mënyra e vendosjes: Gjykata i ka dërguar të paditurit padinë për përgjigje dhe pas kalimit të afati për përgjigje në padi, pasi ka konstatuar se plotësohen edhe kushte tjera ka vendosur që të nxjerr aktgjykim për shkak të mosbindjes.

Pjesë nga arsyetimi i aktgjykimit

“Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi, me datë 01.04.2011, të cilin i padituri e ka pranuar me datë 14.04.2011. Me aktvendimin për përgjigje në padi gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat e ligjore që do të ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësin që gjykata të nxjerr aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë.

I padituri pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, në këtë çështje juridike kontestuese nuk ka jep përgjigje në padi.

Gjykata në kuadër të autorizimeve ligjore në kuptim të dispozitave nga neni 150 i Ligjit për procedurën Kontestimore pasi vlerësoi kushte ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të pa dëgjueshmërisë, gjeti së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushte ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë.

Gjykata i vlerësoi të gjitha kushte për nxjerrjen e aktgjykimit siç parashohin dispozitat nga neni 150.1 nën (a), (b) dhe (c), dhe atë së të paditurit i është dorëzuar padi dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi, në rastin konkret nga provat e dorëzuar me padi vërtetohet fakti së paditësi dhe i padituri kanë lidhë kontratën për re

⁷⁷ Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.151/14, dt. 16.05.2016

programimin e borxhit përkatësisht pagesën e borxhit me këste për shfrytëzimin e shërbimeve të telefonisë fikse, pastaj nga paditësi është prezantuar historia e llogarisë mbi shumën e shpenzimeve për shërbimet e ofruara dhe se faktet e treguara nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht. Në rastin konkret raporti për historinë e llogarisë është identik me lartësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata në kuptim të dispozitave të cituara nga neni 150 i LPK e në lidhje me dispozita nga neni 262 par.1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve, ku përcaktohet se “ kreditori në marrëdhënien detyrimit është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit kurse debitori është detyruar që ta përmbushë detyrimin me ndërgjegje dhe në tërësi siç kanë paraparë me parë”, gjeti se kërkesëpadia e paditësi është e bazuar dhe vendosi si në dispozita të këtij aktgjykimi.

Për kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 186 dhe 277 të LMD-së, dhe si datë të fillimit të rrjedhjes së kamatës ka pranuar datën e ushtrimit të padisë në gjykatë.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara, i referohen taksës për padi në shumë prej 15 Euro dhe taksës për aktgjykim në shumë prej 15 Euro”⁷⁸.

⁷⁸ Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.411/09, dt.22.07.2014

PRAKTIKA PENALE

1. Vendimet Gjyqësore

Në procedurën penale ekzistojnë tri lloje të vendimeve gjyqësore , që dallohen për nga organet që i marrin vendimet e tilla struktura, fuqia vendosësh dhe mundësia e atakimit me mjete juridike. Ekzistojnë vendime gjyqësore të cilat i merr vetëm gjykata (aktgjykimet), ndërsa aktvendimin dhe urdhëresën mund ta marrin edhe organet tjera që marrin pjesë në procedurë penale. Ekziston urdhëresa gjyqësore , ndaj të cilës nuk është e lejuar ankesa, aktvendimet gjyqësore ndaj të cilave parimisht është e lejuar ankesa , vetëm nëse me ligj nuk është përjashtuar një mundësi e tillë.

Aktvendimet gjyqësore me të cilat vendoset meritorisht një çështje penalo juridike aktvendimet gjyqësore me të cilat nuk vendoset meritorisht një çështje penalo juridike por me to vetëm udhëhiqet procedura penale aktgjykimet gjyqësore të cilat janë aktgjykimi lirues , refuzues dhe aktgjykimi gjykues.

2. Urdhëresat gjyqësore

Urdhëresat në esencë janë vendime të tilla në procedurën penale, me të cilat nuk vendoset as për çështjet procedurale e as për çështjet materialo juridike e as për ato faktike , por vetëm përgatitet përkatësisht sigurohet zbatimi i ndonjë veprimi procedural apo marrja e ndonjë prove. Duke u bazuar në karakterin e urdhëresës, ky lloj vendimi bihet praktikisht , në numrin më të vogël të rasteve, andaj edhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK) ka paraparë vetëm urdhëresat më të domosdoshme.

Duke pasur parasysh karakterin e urdhëresës, ajo është menjëherë e ekzekutueshme, pasi që ndaj urdhëresës nuk mund të ushtrohet asnjë mjet juridik , vetëm me ndonjë përjashtim p.sh neni 173 par.3 të KPPK. Përjashtimi i të drejtës në ankesë ndaj urdhëresës padyshim është e arsyeshme, ngase në shumicën e rasteve qëllimi i urdhëresës do të dështonte dhe me këtë edhe do t'i shkactohej dëm interesave të procedurës , nëse do të lejohej ankesa. P.sh. do të ishte iluzore nxjerrja e urdhëresës për masat e vëzhgimit të fshehtë , kur ndaj kësaj urdhërese do të lejohej ankesa, apo nxjerrja e urdhëresës për sjelljen e personit i cili refuzon të paraqitet në ftesën e rregullt etj.

Urdhëresë mund të nxjerrë gjykata dhe Prokurori Publik.

Urdhëresat e Gjykatës janë:

Urdhëresa për ruajtjen e fshehtësisë, për sjelljen e të pandehurit, për kontrollin e apo personave, për marrjen e përkohshme të sendeve, për sjelljen me dhunë e dëshmitarit dhe ekspertit, për caktimin e ekspertit, për caktim masave të vëzhgimit të fshehtë, urdhrin për anonimitet, urdhrin për caktimin e shqyrtimit gjyqësor, për sigurimin e provave të reja për shqyrtimin gjyqësor, për shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor, për largimin e personave të cilët pengojnë punën gjatë zbatimit të ndonjë veprimi hetimor apo në shqyrtimin gjyqësor, për vendosjen e të miturit entin pranues, edukuese apo të ngjashme, për dhënien e fletë arrestit, për dhënien e shpalljes, për tërheqjen e fletë arrestit, shpalljes.

Prokurori Publik mund të nxjerrë:

Urdhëresën për sjellje me dhunë e të pandehurit, dëshmitarit, këqyrjen ose rekonstrukcionin e vendit të ngjarjes, fotografimi ose vëzhgimi me video në vendet publike, monitorimi i fshehtë të bisedave në vendet publike; Hetime të fshehta; regjistrimi i bisedave telefonike.

Organet policore mund të nxjerrin këto urdhëresa:

Për kontrollimin e banesës apo personit, për marrjen e përkohshme të sendeve dhe përjashtimisht edhe urdhëresën ekspertizë (neni 201,204 të KPPPK).

Ligji shprehimisht nuk parasheh formën obligative të urdhëresës, por vetëm parasheh përmbajtjen e domosdoshme e disa urdhëresave. Urdhëresa duhet të përmbajë titullin e organit që e nxjerrë urdhëresën e tillë, baza ligjore për nxjerrjen e urdhëresës dhe pjesën dispozitive që paraqet përmbajtjen e urdhëresës. Urdhëresa parimisht nuk duhet të ketë arsyetim, ngase nga vet pjesa dispozitive rezultojnë edhe shkaqet për të cilat urdhëresa është nxjerrë.

3. Aktvendimet gjyqësore

Aktvendimi, si formë e vendimit në procedurën penale, është lloj i tillë i vendimeve me të cilat, sipas natyrës së çështjes dhe stadiumit të procedurës penale, mund të vendoset për çështjet faktike, çështjet proceduralo juridike dhe çështjet materiale juridike të cilat mund të kenë reperkusione në rrjedhën dhe përfundimin e procedurës konkrete penale.

Me aktvendim si vendim gjyqësor, vetëm përjashtimisht vendoset dhe përfundon çështja penale, p.sh Aktvendimi me të cilin shqiptimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik (neni 76 të KPPK), si dhe shqiptimi i masave edukuese ndaj kryesve të mitur të veprave penale sipas LPMK.

Me aktvendim në disa raste pushohet procedura penale, mirëpo me aktvendime kryesisht vendosën çështje të ndryshme procesuale lidhur me rrjedhën dhe drejtimin e procedurës, pastaj vendosjen për zbatimin e provave etj.

Për dallim nga aktgjykimi aktvendimi nuk merret në emër të popullit , që shpie në përfundim se ligji i jep autoritet më të madh aktgjykimit.

Me Kodin e Procedurës Penale shprehimisht është përcaktuar se kur dhe cili organ mundet dhe duhet të merë aktvendim në situatën e caktuar procedurale.

Gjatë procedurës penale, varësisht nga stadet e procedurës penale, mund të merren aktvendime të ndryshme, ashtu që disa aktvendime mund të merren në të gjitha stadiumet e procedurës, ndërsa disa vetëm në disa faza të procedurës.

Kush është i autorizuar t'i merr aktvendimet :

Aktvendimet mund t'i marrin organet policore, prokurori publik, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari për konfirmimin e aktakuzës, kryetari i trupit gjykues, trupi gjykues, gjyqtari i vetëm, kolegji jashtë shqyrtimor, kolegji gjyqësor.

LLOJET E AKTVENDIMEVE

- Aktvendimi për caktimin e kompetencës vendore,
- Aktvendimi për bashkimin e procedurave,
- Aktvendimi për ndarjen e procedurës, mund të merret deri në përfundim të procedurës,
- Aktvendimi për delegimin e kompetencës për shkak të pengesave juridike dhe objektive, mund të merret në çdo stadium të procedurës,
- Aktvendimi për delegimin e kompetencës për shkak të arsyeshmërisë, ky aktvendim merret deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,
- Aktvendimi për shpalljen inkompetente,
- Aktvendimi për konflikt kompetence,
- Aktvendimi për përjashtimin e gjyqtarit,
- Aktvendimi për përjashtimin e procesmbajtësit,
- Aktvendimi për përjashtimin e ekspertit,
- Aktvendimi për kthimin në gjendje të mëparshme,
- Aktvendimi për kufizimin e të drejtës për shqyrtimin e shkresave,
- Aktvendimi për vendosjen e përfaqësuesit të dëmtuarit si paditës,
- Aktvendimi për caktimin dhe shkarkimin e mbrojtësit sipas detyrës zyrtare,
- Aktvendimi për hedhjen e parashtrësës së parregullt,
- Aktvendimi për ndëshkim për shkak të fyerjes,
- Aktvendimi për veçimin e procesverbalit nga shkresat,
- Aktvendimi për leximin e procesverbalit të veçuar,
- Aktvendimi për shpenzimet e procedurës penale,
- Aktvendimi për masat e përkohshme të sigurisë,
- Aktvendimi për caktimin e mbrojtësit të akuzuarit sipas detyrës zyrtare, të dënuar me burg efektiv, ndërsa nuk mundet t'i dorëzohet aktgjykimi,
- Aktvendimi për ndëshkim për shkak të zvarritjes së procedurës,
- Aktvendimi për marrjen apo kthimin e patentë shoferit,
- Aktvendimi për pushimin e procedurës penale,
- Aktvendimi për zbatimin e hetimeve,
- Aktvendimi për zgjerimin e hetimeve,

- Aktvendimi për kufizimin e të drejtës të pandehurit dhe mbrojtësit të tij që të prezantojnë në veprimet e caktuar hetimore,
 - Aktvendimi për ndërprerjen e hetimeve,
 - Aktvendimi për pushimin e hetimeve,
 - Aktvendimi për zgjerimin e afatit për ngritjen e aktakuzës,
 - Aktvendimi për marrjen e dokumentit të udhëtimit,
 - Aktvendimi për dorëzani,
 - Aktvendimi për caktimin, vazhdimin apo heqjen e paraburgimit,
 - Aktvendimi për burgim për mos dhënien e sendeve,
 - Aktvendimi për burgim për shkak të mos tregimit apo dhënies të shkresave apo dokumenteve tjera,
 - Aktvendimi për dënimin e dëshmitarit për mungesë apo largim,
 - Aktvendimi për dënimin e dëshmitarit i cili pa arsye refuzon të dëshmoj,
 - Aktvendimi për burgosjen e dëshmitarit i cili edhe pas dënimit pa arsye refuzon të dëshmoj,
 - Aktvendimi për ndëshkimin e ekspertit,
- Aktvendimi për dërgimin e të pandehurit në observim,
- Aktvendimi për pushimin e procedurës penale,
 - Aktvendimi për konfirmimin e aktakuzës,
 - Aktvendimi për hedhjen e aktakuzës,
 - Aktvendimi për pranimin e akt dorëheqjes dhe anulimi i seancës për konfirmimin e aktakuzës,
 - Aktvendimi për refuzimin e akt dorëheqjes së të pandehurit,
 - Aktvendimi për pranimin e fajësisë,
 - Aktvendimi për papranueshmërinë e ndonjë prove.

Aktvendimet të cilat merren në shqyrtimin gjyqësor

Kodi i procedurës penale ka paraparë marrjen e një mori aktvendimesh në shqyrtimin gjyqësor, me të cilat sigurohet dhe përgatitet marrja e aktgjykimit të drejt dhe të ligjshëm. Karakteristikë e këtyre shumë aktvendimeve është se me to nuk vendoset për çështjet që janë objekt akuze, por me këto aktvendime rregullohen çështjet procedurale, disiplinore ose rregullatore, të cilat sigurojnë zhvillim të papenguar të shqyrtimit gjyqësor, si stadium themelor i një procedure penale, pas të cilit mund të merret aktgjykimi.

Karakteristikë tjetër e këtyre aktvendimeve është fakti se ndaj tyre është përjashtuar e drejta në ankesë- ankesa është e lejuar vetëm përjashtimisht ku shprehimisht një mundësi të tillë e ka paraparë ligji, por edhe në situata të këtilla vetëm me ankesë kundër aktgjykimit (e jo ankesë të veçantë), karakteristikë tjetër e aktvendimeve të këtilla është se nuk shkruhen aktvendimet dhe nuk u dërgohen palëve vetëm me ndonjë përjashtim, por vetëm konstatohen në procesverbal për shqyrtimin gjyqësor me arsyetim të shkurtër dhe u kumtohet palëve.

Në shqyrtimin gjyqësor merren këto aktvendime:

- Aktvendimi për përjashtimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor,
- Aktvendimi për lejimin e personave të caktuar që të prezantojnë në shqyrtim gjyqësor kur është përjashtuar publiku,
- Aktvendimi për dënimin e dëshmitarit, ekspertit, mbrojtësit interpretim dhe personave të tjerë të cilët edhe pas vërejtjes pengojnë shqyrtimin gjyqësor,
- Aktvendimi për largimin e të akuzuarit nga shqyrtimi gjyqësor, nëse edhe pas vërejtjes pengon punën në shqyrtimin gjyqësor,
- Aktvendimi për kompensimin e shpenzimeve për shqyrtimin e shtyrë gjyqësor për shkak të mosardhjes së mbrojtësit edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt,
- Aktvendimi për betimin e dëshmitarit- ekspertit,
- Aktvendimi për ndalimin e parashtrimit të pyetjeve të caktuar përkatësisht përgjigjes në pyetjet e parashtruara,
- Aktvendimi për shqyerjen e shpalljes së aktgjykimit,
- Aktvendimi për caktimin e paraburgimit pas shqiptimit të aktgjykimit,
- Aktvendimi për vazhdimin apo heqjen e paraburgimit pas shqiptimit të aktgjykimit,
- Aktvendimi për përmirësimin e aktgjykimit,
- Aktvendimi për hedhjen e ankesës si të paafatshme,
- Aktvendimi për mbajtjen e shqyrtimit para gjykatës së shkallës së dytë,
- Aktvendimi për anulimin e aktgjykimit,
- Aktvendimi për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor i ndërpreme për shkak të pengesave procedurale,
- Aktvendimi përkitazi me kërkesën për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktgjykim të plotfuqishëm,
- Aktvendimi për shtyrjen përkatësisht ndërprerjen e ekzekutimit të dënimit,
- Aktvendimi për hedhjen e kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit,
- Aktvendimin për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit,
- Aktvendimi për caktimin e mbrojtësit të miturit,
- Aktvendimi për bashkimin e procedurës ndaj të miturit,
- Aktvendimi për veçimin e procedurës ndaj të miturit,
- Aktvendimi për fillimin e procedurës ndaj të miturit,
- Aktvendimi për caktimin, vazhdimin dhe heqjen e paraburgimit ndaj të miturit,
- Aktvendimi për vendosjen e përkohshme të miturit në strehimore ose në institucion edukativ apo të ngjashëm,
- Aktvendimi për pushimin e procedurës penale ndaj të miturit,
- Aktvendimi për shqiptimin e masave edukuese ndaj të miturve,
- Aktvendimi për ndryshimin e masës së mbi këqyrjes së shtuar apo masës institucionale me ndonjë masë tjetër,
- Aktvendimi për dërgimin e të pandehurit në entin për sëmundje shpirtërore,
- Aktvendimi për lëshimin nga institucioni,
- Aktvendimi për lirim me kusht
- Aktvendimi për shqiptimin e masave të detyrueshme,
- Aktvendimi për marrjen e sendeve,
- Aktvendimi për revokimin e lirit me kusht,
- Aktvendimi për pushimin e procedurës për revokimin e dënimit me kusht,
- Aktvendimi për shlyerjen e dënimit,

- Aktvendimi për ndërprerjen e masës së detyrueshme,
- Aktvendimi për dorëzimin e shkresave shtetit të huaj,
- Aktvendimi për paraburgosen e të huajit,
- Aktvendimi për refuzimin e dorëzimit e të huajit shtetit të huaj,
- Aktvendimi për plotësimin e supozimeve për dorëzimin e të huajit shtetit të huaj,
- Aktvendimi për lejimin e dorëzimit të huajit shtetit të huaj,
- Aktvendimi për rehabilitim për shkak të dënimit të paarsyeshëm, apo privimit të paarsyeshëm nga liria.

4. Aktgjykimet

Padyshim akti më i rëndësishëm procedural i cili mund të merret në procedurën penale është aktgjykimi, me të cilin parimisht vendoset objekti i akuzës, me përjashtim të aktgjykimit refuzues(aktgjykimi formal) me të cilin aktgjykim çështja nuk vendoset meritorisht.

Aktgjykimin mund ta merr vetëm gjykata edhe atë sipas rregullit pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas mjetit juridik- ankesës kur mban shqyrtim apo kur vendos në seancën e kolegjit.

Aktgjykimi mund të merret edhe pa shqyrtim në këto situata : Në procedurën për dhënien e urdhrin ndëshkimit, në shqyrtimin e parë fillestarë të aktakuzës kur i akuzuari e pranon fajësinë, dhe me rastin rishikimit jo të drejt të procedurës penale (*ndryshimi i aktgjykimit të formës së prerë pa e përsëritu procedurën*) , mirëpo ky përjashtim është i karakterit specifik, parashihet për raste të posaçme dhe ka të bëjë vetëm me vendimin për dënimin.

Kodi i Procedurës Penale , shprehimisht ka paraparë se në procedurën penale mund të merren tri lloje të aktgjykimeve edhe atë: *aktgjykimi me të cilin akuza refuzohet, aktgjykimi me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza dhe aktgjykimi me të cilin i akuzuari shpallet fajtor*, këto lloje aktgjykimesh janë të përgjithshme edhe për procedurat para gjykatave të shkallës së dytë dhe të tretë, ngase edhe këto nuk mund të marrin ndonjë lloj tjetër të aktgjykimit.

Baza e aktgjykimit

Aktgjykimi duhet të mbështetet në fakte dhe prova të cilat janë proceduar në shqyrtimin gjyqësor. Andaj, parimi i drejt për drejtshmërisë dhe kontradiktori tetit duhej me konsekuencë respektuar, (përjashtimisht disa prova mund të procedohen në mënyrë të tërthortë). Është detyrë e gjykatës që me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë veç e veç dhe në lidhshmëri me provat tjera dhe në bazë të një vlerësimi të tillë të konkludoj se është apo nuk është vërtetuar ndonjë fakt. Nëse gjykata vlerëson vetëm ndonjë provë apo fakt, kjo nuk mund të jetë bazë për marrjen e aktgjykimit të drejt dhe të ligjshëm

Për të përmbushur funksionin që e ka një aktgjykim, gjykata gjatë marrjes së tij duhet të ketë parasysh që aktgjykimi i tillë nuk është rezultat i aplikimit mekanik dhe të verbët të ligjit, e as rezultat i ndjenjave emocionale të gjykatës, siç me keqardhje shpesh ngjanë në praktikën tonë

gjqësore, por duhet të jetë rezultat i vërtetimit të vërtetës për ekzistimin e veprës penale që është objekt i procedurës penale dhe personi që është akuzuar se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Në këtë gjykatën e obligon parimi themelor i procedurës penale parimi i të vërtetës, që drejt dhe plotësisht të vërtetohen faktet që janë me relevancë për marrjen e vendim të ligjshëm.

Aktgjykimet në procedurën e shkallës së parë

Shqyrtimi kryesor i procedurës penale përfshinë: fazën e përgatitjes të shqyrtimit gjyqësor, Fazën e shqyrtimit gjyqësor, dhe Fazën e marrjes së aktgjykimimit. Në fazën e fundit të procedurës penale gjykata ka për detyrë: shqiptimin e aktgjykimimit, komunikimin e aktgjykimimit, përpilimi me shkrim i aktgjykimimit, dorëzimin e aktgjykimimit dhe përmirësimi eventual i aktgjykimimit.

Llojet e aktgjykimimeve

Me aktgjykim aktakuza refuzohet, ose i akuzuari lirohet nga akuza, apo shpallet fajtor, andaj aktgjykimet në praktikë titullohen: “ Aktgjykimi refuzues, lirues dhe aktgjykimi gjykues”.

Aktgjykimi refuzues

Karakteristikë e këtij aktgjykimi qëndron në faktin se gjykata nuk vendosë për çështjen kryesore që është objekt akuze, d.m.th. nuk lëshohet në vendosjen meritore, por aktakuza refuzohet për arsye se ekzistojnë pengesa juridiko- procedurale për ndjekje penale. Me këtë aktgjykim vendosen vetëm çështjet procedurale juridike, për këtë arsye edhe quhen aktgjykimime formale.

Nëse këto të meta hetohen para caktimit të shqyrtimit gjyqësor , apo në to tregohet, atëherë gjykata merr aktvendim për pushimin e procedurës, përkatësisht hedhjen e aktakuzës.(neni 384 i KPPK).

Gjykata merr aktgjykim refuzues kur:

-paditësi është tërhequr nga akuza, nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor,

-i dëmtuari tërhiqet nga propozimi,

-i akuzuari për të njëjtën veprë penale është gjykuar me vendimin e formës së prerë, është liruar nga akuza ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendimin e formës së prerë ose,

-ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti ose falje, ose kur ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale.

Aktgjykimi lirues

Aktgjykimi lirues (liberator) është formë e vendimit të cilën gjykata e merr pas vendosjes meritorë për çështjen penale dhe kryesin dhe përfundimit se aktakuza është e pabazuar. Për dallim nga aktgjykimi refuzues në të cilin vendosen vetëm çështjet penale procedurale, këtu lëshohet në vendosjen e çështjeve si ato procedurale ashtu edhe në ato juridiko penale.

Në situata të caktuar varësisht nga qëndrimi i prokurorit publik varet se gjykata do të merr aktgjykim refuzues apo lirues, për arsye se disa shkaqe janë identike, andaj nëse në praninë e shkaqeve ligjore prokurori publik në shqyrtim heq dorë nga akuza gjykata merr aktgjykim refuzues, por nëse nuk heq dorë nga akuza gjykata për shkaqe identike merr aktgjykim lirues.

Gjykata merr aktgjykim lirues nëse :

- vepra me të cilin i akuzuari akuzohet nuk është vepër penale ;
- nëse ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale ose
- nuk është provuar se ia akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën akuzohet.

Aktgjykimi gjykues

Aktgjykimi gjykues (Kondemitor) është formë e aktgjykimit meritor me të cilën gjykata vërteton që i akuzuari është fajtorë për veprën e cila i vihet në barrë, d.m.th se akuza është e bazuar dhe i shqipton sanksionin penal apo e liron nga dënimi.

Gjykata në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpallë fajtor shënon:

- për të cilën vepër penale shpallet fajtor,
- emërtimi ligjor i veprës penale dhe cilat dispozita ligjore janë aplikuar;
- dënimin e shqiptuar të akuzuarit duke e përfshirë edhe dënimin alternativ,
- urdhri për shqiptimin e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim e kryerësve të varur nga droga dhe alkooli ose për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale,
- vendimi për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm të vuajtur në lartësinë e dënimit dhe
- vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore- juridike si dhe përcaktimi se a duhet të shpallet aktgjykimin e formës së prerë në shtyp, në radio dhe në televizion.

Formulari 1

AKTVENDIM PËR BASHKIMIN E PROCEDURËS (neni 35 KPPK-s)

KP.nr. _____

Gjykata Themelore _____ në përbërje prej _____ si kryetar kolegji dhe-si anëtar kolegji _____ me procesmbajtësen-në çështjen penale ndaj të akuzuarit _____ për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor , të parashikuar nga neni 189.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës , duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ PP.nr _____ datë _____, që të zbatohet procedurë e përbashkët, në seancën e mbajtur me, mori këtë:

A K T V E N D I M

Sipas lëndës penale të akuzuarit B.H.nga _____ për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor , të parashikuar nga neni 189.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës, dhe sipas lëndës penale të të akuzuarit N.K.nga _____ për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje , të parashikuar nga neni 190.par.1 të KPK-ës, do të zbatohet një procedurë dhe do të merret një vendim pranë Gjykatën Themelore në _____

A r s y e t i m i

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore _____ i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzë KP.nr. _____ datë _____ kundër të akuzuarit B.H. nga _____ për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor , të parashikuar nga neni 189.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës, ndërsa Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____ aktakuzë kundër të pandehurit N.K. nga _____, për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje , të parashikuar nga neni 190.par.1 të KPK-ës .

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____, ka paraqitur propozim që në çështjet e theksuara penale të zbatohet një procedurë dhe të merret një vendim, pasi që bëhet fjalë për një ngjarje të njëjtë.

Gjykata Themelore ka shqyrtuar çështjen e të akuzuarit B.H dhe të akuzuarit N.K. si dhe propozimin e Prokurorit Shtetëror dhe ka gjetur:

Propozimi është i bazuar.

Sipas nenit 35.të KPPK-ës, gjykata mund në propozim të Prokurorit Shtetëror të vendos që të udhëhiqet procedurë e njëjtë dhe të merret një vendim, nëse në mes të veprave penale të kryera ekziston lidhshmëri dhe ekzistojnë prova të njëjta.

Në rastin konkret ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri B.H. i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore tani të dëmtuarit K.L. ndërsa i akuzuari N.K ka marrë pjesë në rrahje, që shpije në përfundim se këto vepra penale janë të ndërlydhura, dhe se aktakuza është bazuar në prova të njëjta.

Meqenëse propozimi për bashkimin e procedurave është i bazuar, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në bazë të nenit-të KPPK-ës.

GJYKATA THEMELORE-

KP.nr. dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetar i kolegjit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Formulari 2

AKTVENDIM PËR VEÇIMIN E PROCEDURËS

(neni 36 KPPK-s)

P.NR.nr. _____

Gjykata Themelore në _____ në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët N.N. si kryetar kolegji, dhe gjyqtarëve S.V. dhe Z.M. si anëtarë kolegji, me procesmbajtësen D.M., në lëndën penale të të pandehurit B.P., etj, për shkak të shumë veprave penale vjedhje të rëndë, të parashikuar nga neni 328.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë së Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.____ datë____, në shqyrtimin gjyqësor të datës _____ ka marrë:

A K T V E N D I M

Në çështjen penale kundër të akuzuarit B.P. dhe etj, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 328.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës, procedura kundër të akuzuarit P.M nga _____ datë _____ do të veçohet dhe do të përfundohet veçmas në këtë gjykatë.

A r s y e t i m

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzë kundër B.P. etj , për shkak të disa veprave penale vjedhje të rëndë, të parashikuar nga neni328.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës.

Në shqyrtimin gjyqësor të caktuar për datë _____ ishin të pranishëm të gjithë personat e ftuar përpos i akuzuari P.M. i cili nëpërmjet mbrojtësit të tij ka informuar gjykatën se gjendet në spital në shërim , dhe për shërimin e plotë është e nevojshme përafërsisht 1 (një) vit.

Prokurori Shtetëror i cili ka përfaqësuar aktakuzën, ka propozuar që procedura kundër P.M. të ndahet dhe veçmas të procedohet pranë kësaj gjykate, kur gjendja shëndetësore e të akuzuarit lejon një gjë të tillë.

Propozimin e Prokurorit Shtetëror nuk e kanë kundërshtuar të akuzuarit që ishin të pranishëm dhe mbrojtësit e tyre.

Gjykata ka gjetur se propozimi është i bazuar.

Nga raporti i QKUK-së, nr. ____ datë ____, vërtetohet se i akuzuari P.M. gjendet i shtrirë në këtë qendër nga data-për shkak të sëmundjes së rëndë të veshkave dhe në shërim intensiv duhet të kalojë së paku një vit.

Duke pasur parasysh faktet që u përshkruan më lartë, si dhe rrethanën se procedura ndaj i akuzuari të dhënë mund të ndahet pa dëm për të akuzuarit tjerë , gjykata ka gjetur se janë përmbushur *kushtet* ligjore nga neni 36 .të KPPK-ës, për veçimin e procedurës, andaj ka vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE-

p.NR.nr. ____ datë ____.

Procesmbajtësi,

Kryetar i kolegjit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Formulari 3

RAPORTI DHE PROPOZIMI GJYKATËS PËR DELEGIMIN E KOMPENTENCËS TERRITORIALE

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Agj.nr.120/2014

Më.dt.

P r i s h t i n ë

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

-Kryetarit-

Pranë kësaj gjykate është rrjedh procedura penale kundër të akuzuarit P.M.nga _____, për shkak të veprës penale kundër sigurisë së trafikut publik nga neni 328 par 9.lidhur me par.1.të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorit Shtetëror të Prokurosisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.85/2014 të datës _____.

Në Gjykatën Themelore Prishtinë-Dega në _____ funksionin e gjyqtarit e ushtrojnë mbikëqyrësi i degës R.S.dhe gjyqtari A.A.

Mbikëqyrës i degës në procedurën e njëjtë ka ushtruar rolin e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nuk mund të ushtrojë funksionin e gjyqtarit. Gjyqtari AA. gjendet në raporte farefisnore me të dëmtuarin.

Duke ju informuar Juve se dega e Gjykatës Themelore në Podujevë për arsye juridike është e penguar që të veprojë në lëndën penale kundër të pandehurit NN. luteni që ju të caktoni një gjykatë tjetër në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë e cila do veprojë sipas kësaj çështje penale në kuptim të nenit 37 të KPPK-ës.

Mbikëqyri i degës R.S.

Formulari 4

AKTVENDIM PËR DELEGIMIN E KOMPENTENCËS TERRITORIALE (neni37. KPPK-s)

Pn..nr.100/2013

Kryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë _____, me procesmbajtësen K.K, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.B. nga _____ për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik , të parashikuar nga neni 378.par.9 lidhur me par.1.të KPK-ës, pas dëgjimit të Prokurorit Shtetëror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë M.M. në seancën e kolegjit të mbajtur më dt. _____ mori këtë:

AKTVENDIM

Për udhëheqjen e procedurës në çështjen penale e të akuzuarit B.B. nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.9. lidhur par.1.të KPK-s, caktohet Gjykata Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m i

Mbikëqyrësi i Degës së Gjykatës Themelore në Podujevë, ka propozuar që për udhëheqjen e procedurës në çështjen penale e të akuzuarit B.B. nga _____ për shkak të veprës penale rreziku i trafiku publik, të parashikuar nga neni 378.par.9. lidhur par.1.të KPK-s, sipas kërkesës së Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë KP.nr.144/2013 datë 10.02.2013, të caktohet një gjykatë tjetër me kompetencë lëndore nga territori i kësaj Gjykate, për arsye se dega e Gjykatës Themelore për shkak të pengesave juridike nuk mund të veprojë sipas kësaj çështje. Në degën e kësaj Gjykate ekzistojnë vetëm dy gjyqtarë edhe atë: mbikëqyri i degës dhe një gjyqtar, vendet tjera nuk janë plotësuar. Mbikëqyrësi i degës përjashtohet nga kjo çështje për faktin se ka ushtruar funksionin e Gjyqtarit të procedurës paraprake, ndërsa Gjyqtari A.A. është në raporte farefisnore me të dëmtuarin.

Prokurori Shtetëror ka propozuar që kërkesa për delegimin e kompetencës të aprovohet.

Duke vendosur lidhur me propozimin e degës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, për delegimi e kompetencës territoriale, kryetari i gjykatës gjjen se:

Propozimi është i bazuar

Nga propozimi me shkrim i cili është i dëshmuar me të dhënat e nevojshme, rezulton se dega e Gjykatës Themelore në Podujevë nuk është në mundësi që të veprojë në çështjen penale të akuzuarit B.B, për arsye se dega nuk ka gjyqtar të mjaftueshëm, ndërsa mbikëqyri i degës dhe gjyqtari A.A. sipas ligjit janë të përjashtuar në ushtrimi i funksionimit gjyqësor në këtë çështje penale.

Meqë dega e Gjykatës Themelore në Podujevë për arsye juridike është e penguar që të veprojë në çështjen e theksuar penale, në bazë të nenit 37.par.2 të KPPK-s, u vendos që kompetenca territoriale të delegohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, si gjykatë me kompetencë lëndore pranë së cilës do zbatohet procedura penale.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Pn..nr.100/2013 dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetar i Gjykatës,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Formulari 5

AKTVENDIM PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS TERRITORIALE

(Neni 37. KPPK-ës)

Kp.nr. _____

Gjykata e Apelit në Prishtinë në kolegjin e përbërë prej: M.M. kryetar kolegji S.S. dhe V.V. anëtarë kolegji, me bashkëpunëtorin profesional H.H. si procesmbajtës, në çështjen penale e të akuzuarit F.H. nga _____ për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik të parashikuar nga neni 378.par.9. lidhur par.1.të KPK-s, duke vendosur sipas propozimit të Gjykatës Themelore në _____, për delegimin e kompetencës territoriale, pas dëgjimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prizren, në seancën e kolegjit të mbajtur më dt. _____ mori këtë:

A K T V E N D I M

Për zbatimin e procedurës në lëndën penale të akuzuarit F.H. nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.9. lidhur par.1.të KPK-ës, caktohet Gjykata Themelore në Gjilan.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren ka propozuar që udhëheqjen e procedurës në lëndën penale ndaj të akuzuarit F.H. nga _____ për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.9. lidhur par.1.të KPK-s, sipas aktakuzës së Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren KP.nr.140/2013 datë _____, të caktohet Gjykata Themelore

në Gjilan. Vepra penale është kryer në territorin e Gjykatës Themelore të Prizrenit, mirëpo i akuzuari të dëmtuarit dhe tre dëshmitar të cilët do të duhej dëgjuar , e kanë vendbanimin në Gjilan, që jep të kuptosh se procedura penale më lehtë më shpejtë dhe më efektivisht, do zhvillohej në Gjykatën Themelore në Gjilan.

Gjykata e Apelit ka shqyrtuar shkresat e lëndës e të akuzuarit F.H. dhe propozimin e Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prizren , dhe ka gjetur:

Propozimi është i bazuar.

Meqenëse i akuzuari, i dëmtuari dhe dëshmitarët kanë vendbanimin në territorin e Gjykatës Themelore në Gjilan, e ardhja e tyre në Prizren do shkaktonte humbje kohe pa nevojshme, shpenzime më të mëdha materiale, e bënë të justifikueshëm propozimin se procedura në mënyrë më efikase , më të shpejtë dhe më të lehtë do zbatohet në Gjykatën Themelore në Gjilan , se sa në Gjykatën Themelore në Prizren (*si vend i kryerjes së veprës penale*), për këtë arsye është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA E APELIT NË PRISHTINË

Kp.nr. _____ datë _____.

Procesmbajtësi,

H.H.

Kryetar i kolegjit,

S.S

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Formulari 6

AKTVENDIM ME TË CILËN GJYKATA SHPALLET JO KOMPETENTE TERRITORIALE (Neni 37. KPPK-ës)

Kp.nr.70/2013

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: M.J. si kryetar kolegji M.S dhe B.B, si anëtar kolegji, me bashkëpunëtorin profesional V.V. si procesmbajtës, në lëndë penale ndaj të akuzuarit S.S. për shkak të veprës të përvetësimit në detyrë, të parashikuar nga neni 425. par.1. të KPK-s, në seancën e kolegjit të mbajtur më _____ ka marrë:

A K T V E N D I M

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, shpallet *jo kompetente territoriale*, për zbatimin e procedurës në lëndën penale e të akuzuarit S.S., nga _____, për shkak të veprës penale të përvetësimit në detyrë, të parashikuar nga neni 425. par.1. të KPK-s.

Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit lënda t'i dorëzohet Degës së Gjykatës Themelore në Gjakovë me kompetencë lëndore dhe territoriale.

A r s y e t i m i

Prokurori Shtetëror në Pejë i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzë kundër të akuzuarit S.S., nga _____ për shkak të veprës penale të përvetësimit në detyrë të parashikuar nga neni 425. par.1. të KPK-s.

Duke shqyrtuar kompetencën e vet Dega e Gjykatës Themelore në Istog ka gjetur se nuk ka kompetencë territoriale për vendosjen e kësaj çështje penale. Sipas nenit 10 .par.1. të KPK-ës, vepra penale është kryer si në vendin ku kryerësi ka vepruar ose ka qenë i detyruar të veprojë, po ashtu edhe vendi ku është shkaktuar pasoja.

Nga të dhënat e aktakuzës qartë rezulton se i pandehuri si depoist i Ndërmarrjes Ndërtimore _____, me seli në Gjakovë, në mënyrë të kundërligjshme ka përvetësuar të holla dhe mall në shumë prej ____ €, që nënkupton se edhe veprimi edhe pasoja janë shkaktuar në territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës, përkundër faktit se i akuzuari ka vendbanimin në Istog.

Meqë për udhëheqjen e procedurës kompetente është Gjykata Themelore në Gjakovë në territorin e të cilës është ndërmarrë veprimi dhe është shkaktuar pasoja , është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 37.par.1 KPPK-s.

GJYKATA THEMELORE-DEGA NË ISTOG

KP.nr.70/2013 datë _____

Procesmbajtësi,

V.V.

Kryetar i kolegjit,

M.J.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa Gjykatës së Apelit në

Prishtinë në afat prej 3 ditësh, nga data e marrjes së

aktvendimit.

Formulari 7

AKTVENDIM ME TË CILIN GJYKATA SHPALLET JO KOMPETNENTE LËNDORE

(Neni 37. KPPK-ës)

KP.nr.37/2013

Gjykata Themelore në Prishtinë, kolegji shqyrtimor i përbërë nga gjyqtarët ; P.P.kryetar kolegji , S.A.dhe T.R. anëtar kolegji , me procesmbajtësin S.S. , në lëndën penale e të pandehurit S.S. për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 189.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Kp.nr.15/2013 , në seancën e kolegjit të mbajtur më _____, ka marrë këtë:

A K T V E N D I M

Departamenti i përgjithshëm i Gjykatës Themelore në Prishtinë, shpallet jo kompetent në aspektin lëndor, për zbatimin e procedurës në çështjen penale të akuzuarit S.S. nga _____, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 189.par.2.nënp.2.2.të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m i

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka paraqitur pranë kësaj Gjykate aktakuzë PP.nr.____ndaj të pandehurit S.S., nga _____, për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 189.par.2.nënp.2.2 të KPPK-ës.

Gjatë përgatitjes së shqyrtimit fillestar të aktakuzës, duke vlerësuar kompetencën e gjykatës, gjyqtari i vetëm ka konstatuar se nga përshkrimi faktik i kryerjes së veprës penale dhe provave në të cilat aktakuza është bazuar, rezulton se aktakuza përmban elemente të veprës penale lëndim i rëndë trupor të parashikuar nga neni 189.par.4 lidhur me par.1. të KPPK-s, për të cilin është kompetent Departamenti për Krime të Rënda dhe ka propozuar që kolegji shqyrtues, të marr aktvendim me të cilin ky departament shpallet jo kompetent në aspektin lëndor.

Duke vendosur lidhur me propozimin e gjyqtarit të çështjes, gjykata ka gjetur:

Propozimi është i bazuar.

Sipas dispozitivit të aktakuzës rezulton se i akuzuari të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të rënda trupore të cilat kanë shkaktuar vdekjen e tani të ndjerit NN. Përshkrimi i tillë i veprimeve të kryerjes së veprës penale përputhet edhe me raportin me shkrim të reparit të Kirurgjisë QKUK-së, në Prishtinë nr.170/2013 datë 01.01.2013, në të cilin mes të tjerave theksohet, se i ndjeri ka vdekur si rezultat i lëndimeve të rënda trupore që kishte marr në rrahje me të akuzuarin.

Duke pasur parasysh përshkrimin e veprës penale që është dhënë në aktakuzë, dhe provave në të cilat aktakuza është mbështetur, rezulton se veprimi i të akuzuarve qëndrojnë në gjitha elementet esenciale të veprës penale lëndim i rëndë trupor me pasoja vdekje, të parashikuara nga neni 189.par.4 lidhur me par.1 të KPPK-s. për të cilët kompetent është Departamenti për Krime të Rënda.

Meqenëse gjykata nuk është e lidhur me cilësimin juridik të veprës penale, të cilën prokurori e ka theksuar në aktakuzë, u vendos si në dispozitiv, në bazë të nenit 36 par.1 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE-Departamenti i përgjithshëm Prishtinë

K.nr.37/2013 datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetar i kolegjit,

P.P.

S.S.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 ditësh, nga data e marrjes së aktvendimit.

Formulari 8

AKTVENDIM PËR KONFLIKT KOMPETENCE

(neni 37.par.5. KPPK)

Pn.nr.107/2013

Gjykata e Apelit në Prishtinë në kolegjin e përbërë prej D.D. kryetar kolegji, R.R. dhe S.J., anëtarë kolegji, me bashkëpunëtorin profesional V.A., si procesmbajtës, në çështjen penale e të akuzuarit D.D., nga _____, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit, të parashikuar nga neni 398.par.1, të KPK-s, duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës, në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën Themelore në Ferizaj, në seancën e kolegjit të mbajtur më _____, mori këtë:

AKTVENDIM

Për udhëheqjen e procedurës në lëndën penale e të akuzuarit D.D., nga _____, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit të parashikuar nga neni 398.par.1, të KPK-s, sipas aktakuzës së Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, kompetencë territoriale ka Gjykata Themelore në Ferizaj.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj me aktvendimin e vet KP.nr.37/2013 datë _____, është shpallur territorialit inkompetente që të veprojë në çështjen penale të të akuzuarit D.D., nga _____, për shkak të veprës penale të falsifikimit të dokumentit parashikuar nga neni 398.par.1, të KPK-s,, sipas aktakuzës së Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Ferizaj. Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit lënda i është dorëzuar Gjykatës Themelore në Prishtinë në procedurë të mëtejshme. Gjykata Themelore në Prishtinë, me parashtrësën P.nr.41/2013 datë _____, ka iniciuar procedurën për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës.

Gjykata e Apelit ka shqyrtuar shkresat e çështjes e të akuzuarit D.D., dhe ka gjetur se për udhëheqjen e procedurës në marrjen e vendimit në çështjen e theksuar penale kompetencë territoriale ka Gjykata Themelore në Ferizaj.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari dokumentin e ka falsifikuar në Prishtinë, mirëpo me këtë dokument ka themeluar marrëdhënie pune në Ferizaj, si shofer i Ndërmarrjes transportuese “Përparimi”. Meqenëse si vend i kryerjes së veprës penale konsiderohet si vend ku është ndërmarrë veprimi po ashtu edhe ku është shkaktuar pasoja, në rastin konkret veprimi është ndërmarrë në Prishtinë , mirëpo pasoja është shkaktuar në Ferizaj, dhe kësaj Gjykate, Prokurori për herë të parë ia ka adresuar çështjen, për këtë arsye kjo Gjykatë ka kompetencë territoriale që vendos për këtë çështje penale.

Meqenëse për udhëheqjen e procedurës dhe marrjen e vendimit teritorrialisht kompetente është Gjykata Themelore në Ferizaj, u vendos sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi, në bazë të nenit .37 par.5 .të KPPK-ës.

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Pn.nr.107/2013 datë _____

Procesmbajtës,

V.A.

Kryetari i kolegjit,

D.D.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Sqarim: 1. Në nenin 37.par.6 të KPPK-s, thuhet se ndaj aktvendimit nga **ky nen nuk lejohet ankesa?** (*përdoret shprehja në njëjës, edhe pse nga ky nen mund të merren disa aktvendime*).Me siguri është menduar ndaj aktvendimit kur lidhur me konfliktin e kompetencës vendosë Gjykata e Apelit(*par.4 dhe 5*), për ndryshe do ishte e palogjikshme që ndaj aktvendimit me të cilin një gjykatë është shpallë inkompetent të privohen palët nga e drejta në ankesë, ngase do ishte e mundur që gjykatat të shpallën inkompetente në aspektin lëndor dhe territorial pa asnjë arsye ose për arsye imagjinatave. Konsideroj se bëhet fjalë për një lëshim teknik të ligjdhënësit, ngase edhe në paragrafin 1.të këtij neni thuhet se :”pasi aktvendimi të marr formën e prerë rasti i dorëzohet gjykatës kompetente”, që do të thotë se ndaj këtij aktvendimi është e lejuar ankesa për ndryshe është e palogjikshme të përjashtohet ankesa .

2. Aktvendimi për shpalljen in kompetente e merr kolegji shqyrtues i Gjykatës, e jo gjyqtari i vetëm e as kryetari i trupit gjykues, ngase çdo herë kurë ligjdhënësi ka përdorë shprehjen “gjykata” nënkupton kolegji shqyrtimor .

3. Komptenca territoriale mund të kontestohet deri në marrjen e formës së prerë të aktakuzës, konsideroj se aktakuza merr formën e prerë kur në shqyrtimin e dytë të aktakuzës është caktuar shqyrtimi gjyqësor, ngase deri në këtë fazë aktakuza mund të hedhet .

4. Diskutabile rezulton situata kur kemi të bëjmë me ikompetencën lëndore e cila është vërejtur pasi që ka filluar shqyrtimi gjyqësor. Në rastin e tillë konsideroj se gjykata duhet të marr aktgjykim refuzuese, edhe pse fatkeqësisht në nenin **363** të KPPK-s nuk është theksuar kjo bazë, si arsye për aktgjykim refuzues. Mendoj se është bërë një gabim me rastin e përpilimit të ligjit, ngase shqyrtimi gjyqësor përfundon vetëm me aktgjykim, përjashtimisht kur kemi të bëjmë me vdekjen e të pandehurit, atëherë shqyrtim përfundon me aktvendim. Këtë e bazoj në faktin se ish LPP-e që aplikohej në Kosovë deri vitin 2004, në nenin 349.pika 1. parashihte refuzimin e akuzës në mungesë të kompetencës lëndore, pastaj KPPK-s i vitit **2004** edhe pse në nenin **389**.nuk e parashihte mungesën e kompetencës lëndore si bazë për aktgjykim refuzues, në nenin **403.par.par.1.pika 6**.parashihte si pazë ankimore “ Nëse gjykata gabimisht ka refuzuar akuzën për mungesë të kompetencës lëndore, nga kjo qartë rezulton se në situata të tilla duhet marr aktgjykim refuzues(*duke iu referuar vetëm nenit*) zgjidhe tjetër nuk është e mundur .

Formulari 9

KËRKESË PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARËVE (neni 39.KPPK-ës)

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

-Kryetarit-

Pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë zhvillohet procedurë kundër I.I. për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë parashikuar nga neni 327.par.1.nënp 1.1 KPK-s, të kryer në dëm të PTK-së, sipas aktakuzës së Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, KP.nr.15/2013 datë _____.

Sipas orarit të punës çështja i është ndarë në punë gjyqtarit M.M., i cili në cilësinë e kryetarit ka treguar shqyrtim gjyqësor për datën _____.

Arsye për përjashtim obligativ sipas ligjit nuk ekzistojnë , por ekzistojnë rrethana të cilat e vejnë në dyshime paanshmërinë e gjyqtarit të cilit lënda i është ndarë në punë. Gjyqtari M.M., ka djaln e tij i cili punon Drejtor komercial në PTK. Përpos kësaj Gjyqtari shpeshherë është parë në ndeja me djaln e tij dhe Drejtorin Gjeneral të PTK-së, gjithashtu Drejtori Gjeneral dhe djali i tij shpeshherë janë parë në zyrën e gjyqtarit i cili është ngarkuar në çështje.

Meqenëse rrethanat e theksuara më lartë e vejnë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit , lusim Kryetarit e Gjykatës që ta aprovojë kërkesën dhe Gjyqtarin M.M., ta përjashtojë nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në lëndën penale të akuzuarit I.I., në bazë të nenit 39.par.3 të KPPK-ës.

Datë. _____

Mbrojtësi i të akuzuarit

B.B.

Formulari 10

AKTVENDIM ME TË CILIN APROVOHET KËKRESA PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT (neni 39.par.3 të KPPK-s)

Agj.nr.17/2013

Gjykata themelore në Prizren sipas Kryetarit të Gjykatës I.J., në lëndën penale e të akuzuarit V.V., nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 327.par.1.nënp 1.1 KPK-s , duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit avokatit B.B., për përjashtimin e gjyqtarit M.M., në bazë të nenit 39.par.3 të KPPK-s, me datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Përjashtohet nga ushtrimi i detyrës së gjyqtarit, Gjyqtari i kësaj Gjykate I.H., në çështjen penale P.nr.30/2013 e të akuzuarit V.V., nga _____.

Çështja penale P.nr.37/2013 e të akuzuarit V.V., t'i dorëzohet në punë Gjyqtarit të kësaj Gjykate N.N., i cili do veprojë si kryetar i trupit gjykues.

A r s y e t i m i

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati B.B., ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit të kësaj Gjykate I.H., i cili në cilësinë e Kryetarit të trupit gjykues ka caktuar shqyrtim gjyqësor në çështjen penale P.nr.37/2013 për datë _____.

Në kërkesë ka theksuar se gjyqtari I.H., është në relacionin farefisnor me Drejtorinë komercial të të dëmtuarës PTK-së, gjithashtu ka edhe relacione të ngushta shoqërore me Drejtorin e përgjithshëm të PTK-së dhe shpeshherë këta janë parë në zyrën e tij edhe pas ngritjes së aktakuzës.

Gjyqtari I.H., në deklaratën e dhënë në kuptim të nenit 39.par.3. të KPK, nuk ka kontestuar rrethanat se është në relacione farefisnore babë e djalë me Drejtorin komercial të

PTK-së, dhe në relacionin shoqëror me Drejtorin e përgjithshëm të PTK-së, ka propozuar që për të evituar çdo dilemë lidhur me paanësinë të përjashtohet nga vendosja e kësaj çështje.

Kryetari i Gjykatës shqyrtoi kërkesën për përjashtim shkresat e çështjes penale e të akuzuarit V.V., dhe deklaratën e gjyqtarit I.H., dhe pas vlerësimit të gjendjes së drejtpërdrejtë faktike ka gjetur:

Kërkesa është e bazuar.

Edhe pse në rastin konkret nuk ekziston asnjë arsye ligjore për përjashtim të detyrueshëm të Gjyqtarit nga çështja, vetëm fakti se Gjyqtari e ka djalën e punësuar në ndërmarrjen e dëmtuar në cilësinë e Drejtorit komercial do e vinte në dilemë paanësinë e tij. Për këtë arsye janë përmbushur kushtet nga neni 39.par.3 të KPPK-s, që kërkesa për përjashtim të aprovohet dhe gjyqtari I.H. të përjashtohet nga ushtrimi i mëtejshëm i funksionit të Gjyqtarit në të njëjtën çështje.

Meqë kërkesa për përjashtim është aprovuar, çështja i është ndarë në punë Gjyqtarit tjetër si kryetar i trupit, sipas dispozitave aktuale për ndarjen e punëve në Gjykatë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Agj.nr.17/2013 datë _____

Kryetari i Gjykatës,

I.J

Formulari 11

AKTVENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESES PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT (neni .42.par.3.KPPK-ës)

Agj.nr.12/2013

Kryetari i Gjykatës Themelore në _____ Z.Z., në çështjen penale e të akuzuarit P.P., nga _____, për shkak të veprës penale vrasje nga pakujdesia, të parashikuara nga neni 181 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës së mbrojtësit të akuzuarit avokatit M.M., për përjashtimin e Gjyqtarit D.D., në bazë të nenit _____ par. ____ të KPK, me datë, _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të akuzuarit avokatit M.M., që nga gjykimi në çështjen penale e të akuzuarit P.P., për shkak të veprës penale vrasje nga pakujdesia, të parashikuar nga neni 181. të KPK-s, të përjashtohet Gjyqtari D.D.

A r s y e t i m i

Kundër të akuzuarit P.P., nga _____, është ngritur aktakuzë pranë kësaj Gjykate, për shkak të veprës penale vrasje nga pakujdesia, të parashikuar nga neni 181. të KPK-s.

Mbrojtësi i të akuzuarit para caktimit të shqyrtimit të aktakuzës ka paraqitur kërkesë për përjashtimin e Gjyqtarit D.D., në bazë të nenit 39.par.3 të KPPK-s, . Në kërkesë ka theksuar se i ndjeri J.J, ka qenë punëtor i Gjykatës Themelore në _____, dhe për shkak të kësaj rrethane mbrojtja dyshon në paanshmërinë e Gjyqtarit D.D.

Me deklarimin e vet të dhënë në kuptim të nenit 42.par.2. të KPPK-s, gjyqtari D.D., ka theksuar se rrethanat që i ndjeri ka qenë punëtor i Gjykatën Themelore në _____ nuk mund të ndikojë në objektivitetin e tij si Gjyqtarë.

Kryetari i Gjykatës ka shqyrtuar kërkesën për përjashtim , shkresat e çështjes penale deklarimin e Gjyqtarit D.D., dhe ka gjetur:

Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk është e bazuar.

Fakti se i ndjeri J.J., ka qenë punëtor i Gjykatës Themelore në Gjilan vetvetiu nuk do të thotë se gjyqtari D.D., do jetë i njëanshëm në udhëheqjen e procedurës dhe vendosjen. Duke pasur parasysh cilësinë e gjyqtarit D.D., si dhe rrethanat se ai nuk ka ekzistuar në raporte të afërta miqësore me tani të ndjerin J.J., kryetari i Gjykatës gjen se kërkesa për përjashtim është e pabazuar.

Pasi që nuk janë përmbushur kushtet nga neni 39.par.3.të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Agj.nr.12/2013 datë _____

Kryetar i Gjykatës,

Z.Z.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e posaçme.

Sqarim: Aktvendimi me të cilin kërkesa për përjashtim refuzohet mund të kundërshtohet me ankesë të posaçme, e kur një aktvendim i tillë është marrë pas ngritjes së aktakuzës, atëherë mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit(neni 42.par.3 të KPPK-ës).

Kur kemi të bëjmë me rrethana që absolutisht e bëjnë të padenjë gjyqtarin për ta trajtuar një çështje(neni 39.par.1 dhe 2) nuk ka nevojë të merret fare aktvendim, gjyqtari menjëherë ndërrohet me gjyqtar tjetër .

Formulari 12

AKTVENDIM PËR CAKTIMIN E MBROJTËSIT SIPAS DETRËS ZYRTARE (neni 57.par.1.pika 1.3. KPPK-ës)

Gjykata Themelore _____

Agj.14/2013

Më. _____

P r i s h t i n ë

Gjykata Themelore në Prishtinë, Kryetar i trupit gjykues N.N, në çështjen penale P.nr.61/2013 ndaj të akuzuarit B.B., nga _____, për shkak të veprës penale të vrasjes , të parashikuar nga neni 178. të KPK-s, me datë _____, merr

A K T V E N D I M

Në çështjen penale të akuzuarit B.B., për mbrojtës caktohet R.F., avokat nga _____.

Në bazë të nenit 178. të KPK-ës, mbrojtësi udhëzohet që me kohë t'i shqyrtoj shkresat e çështjes dhe të shikoj lëndën që është objekt shqyrtimi.

Për këtë të informohet mbrojtësi i caktuar.

A r s y e t i m i

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____, ka ushtruar aktakuzë kundër të akuzuarit, për shkak të veprës penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 178. të KPK-s. Për këtë veprë penale me ligj është parashikuar së paku pesë(5) vjet burgim, meqenëse i pandehuri nuk ka caktuar mbrojtës, ndërsa bëhet fjalë për mbrojtjen e detyrueshme nga momenti i ngritjes së aktakuzës, i është caktuar mbrojtësi sipas detyrës zyrtare, bazuar në nenin 57.par.1.nënp. 1.3. të KPPK-ës

Kryetar i trupit gjykues

N.I.

Formulari 13

AKTVENDIM PËR SHKARKIMIN E MBROJTËSIT PËR SHKAK TË USHTRIMIT JO TË RREGULLT TË DETYRËS SË MBROJTËSIT

(Neni 59. KPPK-ës)

Agj.nr.178/2013

Kryetari i Gjykatës Themelore në _____, D.D., në lëndën penale ndaj të akuzuarit V.V., nga _____, për shkak të veprës penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329.par 1.të KPK-ës, duke vendosur lidhur me kërkesën e të akuzuarit për shkarkimin nga funksioni i mbrojtësit i avokatit J.K., nga _____ me datë _____, muar këtë:

A K T V E N D I M

- I. Mbrojtësi i caktuar i të akuzuarit J.K, nga _____, shkarkohet nga detyra e mbrojtësit për shkak të kryerjes jo të rregullt të detyrimeve mbrojtëse.
- II. Për mbrojtës e të akuzuarit V.V., caktohet avokati K.K. nga _____.

III. Për shkarkimin e mbrojtësit , avokatit J.K. të njoftohet Oda e Avokatëve të Kosovës.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Kryetarit të trupit gjykues të kësaj Gjykate Agj.nr.15/2013 nga data _____, për mbrojtës e të akuzuarit V.V., nga _____, për shkak të veprës penale të grabitjes , të parashikuar nga neni 329.par 1.të KPK-ës, ka qenë caktuar avokati J.K, nga _____.

Me parashtrësën prej datës _____, i akuzuari ka kërkuar që avokati J.K. të shkarkohet nga funksioni i mbrojtësit , për arsye se dy herë radhazi nuk ka ardhur në shqyrtim gjyqësor duke arsyetuar me angazhime në çështje tjera penale. Përpos kësaj mbrojtësi nuk tregon kurrfarë interesimi për mbrojtjen në këtë çështje, ndërsa vetëm një herë e ka vizituar të akuzuarin në paraburgim.

Duke vendosur lidhur me propozimin e të akuzuarit, Kryetari i gjykatës ka shqyrtuar shkresat e çështjes ka siguruar dhe të dhëna tjera të nevojshme, dhe ka gjetur se kërkesa *e të akuzuarit është e bazuar.*

Nga shkresat e çështjes rezulton se Kryetari i trupit gjykues me datë _____ dhe me datë _____, ka treguar shqyrtim gjyqësor mirëpo që në dy rastet mbrojtësi i të akuzuarit ka munguar, ndërsa me parashtrësë me shkrim ka njoftuar kinse po të njëjtën ditë është i zënë me gjykime tjera dhe për këtë arsye nuk mund t'i përgjigjet ftesës së gjykatës.

Sipas të dhënave që janë marrë nga administrata e Gjykatës del se mbrojtësi është fare i pa interesuar në këtë çështje penale, nga se asnjëherë nuk ka kërkuar që t'i shikoj shkresat, ndërsa vetëm një herë ka kërkuar që të takohet me të akuzuarin.

Në faktet e vërtetuara del se mbrojtësi i caktuar i të akuzuarit V.V., avokati J.K., në mënyrë jo të rregullt ka ushtruar funksioni e mbrojtësit, andaj në bazë të nenit 59.par.4 KPPK-s, është vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, është caktuar mbrojtësi tjetër në kuptim të nenit 59.par.4 KPPK-s.

Për shkarkimin e mbrojtësit konform nenit 59.par.4 KPPK-s, do të informohet Oda e Avokatëve të Kosovës.

Procesmbajtësi,

Kryetari i gjykatës

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e

Apelit në afat prej 3 ditësh nga marrja e aktvendimit.

Sqarim: Pavarësisht se në paragrafin 3.të KPPK-ës, (*fjalë e fundit pas fjalës Gjykata Supreme*)thuhet se ndaj këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa, mendoj se është menduar vetëm ndaj aktvendimit të kryetarit të Gjykatës Supreme, por jo edhe ndaj aktvendimeve që marrin gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm, trupi gjykues, kryetari i Gjykatës Themelore , kryetari i Gjykatës së Apelit , pastaj pavarësisht se paragrafi 3. i nenit të cituar thotë se para shqyrtimit gjyqësor aktvendimin e merr gjyqtari i procedurës paraprake, do duhej të ishte para ngritjes së aktakuzës, ngase nga momenti i ngritjes së aktakuzës përfundon puna e gjyqtarit të procedurës paraprake në çështjet e njëjtë penale.

Formulari 14

AKTVENDIM ME TË CILIN MBROJTËSIT PËRKOHËSISHT I MOHOHET E DREJTA E SHIKIMIT TË SHKRESAVE TË CAKTUARA DHE PREZENCA NË MARRJEN E VEPRIMEVE TË CAKTUARA HETIMORE

(neni 213. KPP)

Hp.nr.25/2013

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në _____, J.B. me procesmbajtësen L.L, në lëndën penale e të pandehurit Z.B. nga _____, për shkak të veprës penale rekrutimi për terrorizmit , të parashikuar nga neni 139.të KPP-ës, me datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Mbrojtësit e të pandehurit Z.B., nga _____, av. S.S., përkohësisht i ndalohet:_____.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e plotfuqishëm të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____, Departamenti për Krime të Rënda , Hp.nr.25/2013 datë _____, është vendosur që

të zhvillohen hetimet kundër të pandehurit Z.B., nga _____, për shkak të veprës penale rekrutimi për terrorizmit parashikuar nga neni 139.të KPK-ës.

Prokurori Shtetëror çmon se në rrethana të caktuara duke pas parasysh shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore që paraqesin vepra të tilla penale si dhe procesi shumë i ndërlikuar hetimor ka ardhur në përfundim se mbrojtësi nuk do duhet të jetë i pranishëm me rastin e marrjes së dëshmisë së dëshmitarit N, nga se konsideron se me këtë mund të cënohet rëndë procedura e hetuesisë por edhe eventualisht mund të ndikojë që veprimet terroriste që kanë ngel në tentativë të përfundojnë.

Meqenëse janë arritur të gjitha arsyet ligjore nga neni 213 .par. 6.të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

PROKURORIA THEMELORE-DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDËA

Hp.nr.15/2-13 datë _____

Procesmbajtës,

L.L.

Prokurori Shtetëror

J.B.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjyqtarit të

procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në _____, në
afat prej 3 ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit.

Sqarim: Paragrafi **6 i nenit 213.** të KPPK-s, shprehet:” se prokurori mund të refuzoj shikimi in , fotografimin ose kopjimin e shkresave”. Në rast të tillë, mbrojtja mund të kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues që të lejojë shikimin, kopjimin ose fotokopjimin. Vendimi i gjyqtarit është përfundimtar. *Informacionet mund të redaktohet* ose të shënjohe nga prokurori i shtetit me vijë të trashë të zezë për të fshehur të dhëna të caktuara në kopjet e shkresave të cilat përmbajnë të dhëna të ndjeshme. I pandehuri mund të kundërshtojë redaktimin te gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues brenda tre (3) ditëve nga pranimi i kopjes së redaktuar. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të shpjegojë bazën ligjore të redaktimit pa zbuluar informacionin e ndjeshëm. Edhe pse norma nuk e ka qartësuar, se si i kufizohet një e drejtë, mendojë se kufizim mund të bëhet vetëm me aktvendim , ndaj të cilit është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh , në këtë rast

gjqytari i procedurës paraprake me aktvendim mund ta anuloj aktvendimin e prokurorit dhe mbrojtësit t'i lejohet shikimin, fotografimin ose kopjimin e shkresave” ,përkatësish anulimin e redaktimit .

Formulari 15

AKTVENDIM MBI VEÇIMIN E PROCESVERBALIT NGA SHKRESA (neni 249 KPPK)

P.nr.40/2013

Gjqytari i Gjykatës Themelore në _____, F.F. me procesmbajtësen M.M., në çështjen penale e të akuzuarit D.D., për shkak të veprës penale të vjedhjes parashikuar nga neni _____ par. _____ pika _____ të KPK, në shqyrtimin e parë fillestarë , duke vendosur sipas propozimit të mbrojtësit së të akuzuarit për veçimin e procesverbalit mbi marrjen në pyetje dëshmitarit H.H. me datë _____ mori këtë:

A K T V E N D I M

Procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarit H.H., i përpiluar para Prokurorit të Shtetit i Prokurorisë Themelore në _____ me datë _____, në çështjen penale HP.nr.200/2013 ka për të veçuar të mbyllet në mbështjellës të posaçëm dhe të ruhet ndaras nga shkresat tjera të lëndës.

A r s y e t i m i

Kundër të akuzuarit D.D., nga _____, është ngritur aktakuzë për shkak të veprës penale të vjedhjes , të parashikuar nga neni 325.par.1 . të KPPK-s, P.nr.40/2013.

Mbrojtësi i të akuzuarit në shqyrtimin e parë fillestarë më datë _____, ka paraqitur kundërshtim për pranueshmërinë e provave dhe ka propozuar që procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit H.H., prej datës _____, e cila është thënë te Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____, të veçohet në shkresat e lëndës, nga se bëhet fjalë për të personin i cili në çështjen e njëjtë është i bashkakuzuar me të akuzuarin N. Personi i tillë sipas

nenit 126.pika 1.3 .të KPPK-s, nuk mund të thirret për dëshmitar, dhe për këtë arsye në këtë dëshmi nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor.

Propozimi i mbrojtësit është i bazuar.

Sipas nenit 126.nënp. 1.3 .të KPPK-s, si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje i bashkëpandehuri deri sa zbatohet procedurë e përbashkët.

Meqenëse janë përmbushur kushtet nga neni 249.par.3. KPPK-s, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDËA

P.nr.40/2013 datë _____

Procesmbajtësi,

Gjyqtari,

F.F.

M.M.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesë në Gjykatës e Apelit në

Prishtinë, në afat prej pesë **(5)ditësh** nga dita e marrjes së

Aktvendimit, nëpërmjet Gjykatës Themelore

Formulari 16

PROCESVERBAL MBI KËSHILLIMIN DHE VOTIMIN

(neni 320 KPPK-ës)

P.nr.80/2013

I përpiluar më _____, pranë Gjykatës Themelore në _____, në çështjen penale kundër të akuzuarit T.T. nga _____, për shkak të veprës penale vrasjes nga neni 178.të KPK-ës.

Kryetari i trupit

B.B

Procesmbajtësi

J.H.

Anëtarët e trupit,

N.B

J.K.

Këshillimi ka filluar në ora _____,

Pasi që trupi njëzëri konstatoi se Gjykata ka kompetencë lëndore , se nuk ka rrethana që e përjashtojnë ndjekjen penale dhe nuk ka nevojë për plotësimin e procedurës e as për sqarimin e çështjeve të caktuara u vendos që të vendoset çështja kryesore.

RRJEDHJA E VOTIMIT

1.Për fajësinë.

Anëtarët e trupit gjykues dhe Kryetari i trupit gjykues njëzëri kanë votuar se i akuzuari ka kryer veprën penale.

Përkitazi me kualifikimin juridik të veprës penale anëtari i trupit gjykues N.B., voton se i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes të parashikuar nga neni 178. të KPK-s, ndërsa Kryetari i trupit gjykues dhe anëtari tjetër i trupit gjykues se i akuzuari ka kryer veprën penale vrasje në gjendje të afektit mendor të parashikuar nga neni 180 . i KPK-s.

Me shumicë votash merret vendimi se i akuzuari ka kryer vepër penale vrasje në gjendje të afektit mendor parashikuar nga neni 180.të KPK-s.

2.Për dënimin.

Anëtari i parë i trupit gjykues N.B., voton që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me 8 vjet burgim, ndërsa Kryetari i trupit gjykues dhe anëtari tjetër i trupit gjykues votojnë që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim në kohëzgjatje prej 5 viteve.

Me shumicë votash është vendosur që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim burgimi prej 5 vjetësh.

3.Për shpenzimet e procedurës penale.

Një zëri është vendosur që i akuzuari të paguajë në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës 500 €, dhe në emër të paushallit gjyqësor 100 €.

4. Për kërkesën pasurore-juridike.

Njëzëri është vendosur që i akuzuari t'i paguajë të dëmtuarës S.S., bashkëshortja e të ndjerit në emër të shpenzimeve të varrimit 1.500 €, ndërsa për pjesën tjetër të kërkuar të kërkesës pasurore juridike e njëjta është udhëzuar në kontest civil.

5. Për sendet.

Njëzëri u vendos që ndaj të akuzuarit të merret pushka e gjuetisë me nr. ___model___ dhe e njëjta të asgjësohet.

Ka përfunduar në ora. _____

Procesmbajtësi,

J.H.

Anëtarë të kolegjit,

N.B

Kryetari i trupit gjykues.

B.B.

Formulari 17

PROCESVERBAL MBI KËSHILLIMIN DHE VOTIMIN NË SHKALLË TË DYTË

AP.nr.50/2013

I përpiluar pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë në seancën e mbajtur më _____.

Të pranishëm.

Anëtarët e kolegjit,

K.K.

L.L.

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari

H.H.

I akuzuari.

J.L.

Procesmbajtësi,

I.K.

Prokurori Shtetëror

F.O.

Pas referatit të gjyqtarit raportues K.K., të paraqitur sipas ankesës së të pandehurit S.S. e paraqitur ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në _____, K.nr.10/2013, prej datë _____, pas marrjes së propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____, KP.nr.22/2013 prej datës _____, sqarime plotësuese të mbrojtësit të akuzuarit , në seancën e kolegjit të mbajtur më _____, Gjykata e Apelit në emër të popullit mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit S.S. nga _____, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në _____ K.nr.20/2013, nga data _____, vërtetohet.

Vendimi është marrë njëzëri.

Anëtarët e kolegjit,

K.K.

L.L.

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari

H.H.

Procesmbajtësi,

I.K.

I akuzuari.

J.L.

Prokurori Shtetëror

F.O.

Formulari 18

AKTVENDIM ME TË CILIN TË PANDEHURIT NUK I LEJOHET KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME (neni 447. KPPK-ës)

P.nr.30/2013

Gjyqtari i vetëm i Gjykatës Themelore në _____ B.B., në çështjen penale e të pandehurit H.H., për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185.par.1.të KPK-ës, duke vendosur sipas lutjes së të pandehurit për kthim në gjendje të mëparshme, më _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Nuk lejohet kthimi në gjendje të mëparshme të pandehurit H.H.

Ankesa e paraqitur kundër aktgjykimit të kësaj Gjykate P.nr.50/2013 datë _____ pas plotësimeve të kushteve ligjore i dërgohet Gjykatës së Apelit për vendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.50/2013 datë _____, i pandehuri H.H, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të kanosjes, të parashikuar nga neni 185.par.1.të KPK-s, dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 500 €.

Vendimi i theksuar i Gjykatës të pandehurit i është dorëzuar me datën _____, e që ai ka vërtetuar me nënshkrimin e tij në flet kthesë.

I pandehuri nuk ka ushtruar ankesë në afat prej 15 ditësh nga data e marrjes së aktgjykimit por atë e ka bërë më datë _____, me ç'rast njëkohësisht ka paraqitur edhe lutjen për kthim në gjendje të mëparshme. Në lutje ka theksuar se menjëherë pas marrjes së aktgjykimit ka udhëtuar në një udhëtim zyrtar në Shqipëri ku ka qëndruar deri më _____, për ç'arsye ka qenë e pamundur që me kohë të paraqes ankesë.

Arsyet që i ka theksuar i pandehuri në lutjen , sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk paraqesin arsye në kuptim të nenit 447 par 1.të KPPK-s, dhe nuk janë përmbushur kushtet ligjore për kthim në gjendje të mëparshme.

GJYKATA THEMELORE NË _____

P.nr.50/2013 datë _____

GJYQTARI,

B.B.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së
aktvendimit.

Sqarim: Edhe pse neni **448 par.3. i KPPK-s**, shprehet:” Kur i pandehuri paraqet ankesë kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kthimi në gjendje të mëparshme, gjykata detyrohet që këtë ankesë ose ankesën kundër aktgjykimit apo aktvendimit për konfiskimin e dobisë pasurore, përgjigjen në ankesë dhe të gjitha procesverbalet t’ia dërgojë gjykatës më të lartë për marrjen e vendimit”, ankesa me të gjitha shkresat e çështjes duhet t’i dorëzohet Gjykatës së Apelit , edhe kurë i pandehuri nuk ka paraqitur ankesë ndaj aktvendimit për refuzimin e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, ngase KPPK-s, nuk e ka autorizuar gjykatën e shkallës së parë që ta hedh ankesën si ta palejuar(*sic e parashihte kodi i mëhershëm*) dhe për ankesën e paraqitur së bashku me kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme duhet të vendosë Gjykata e Apelit.

Formulari 19

P.nr. ____/2013

VENDIM I POSAÇËM PËR SHPENZIMET E PROCEDURËS

(neni 450.KPPK-s)

Gjyqtari i vetëm Gjykatës Themelore _____ në _____ me procesmbajtëse S.S., në çështjen penale e të pandehurit H.H. për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor i parashikuar nga neni 189.par.2.nënp. 2.1 të KPK-s, duke vendosur për shpenzimet e procedurës penale me datë _____ mur këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri H.H. nga ____ i cili me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate P.nr. ____ datë ____ është shpallur fajtor për veprë penale lëndim i rëndë trupor, të parashikuar nga neni 189.par.2.nënp. 2.1 të KPK-s , dhe është gjykuar me dënim me burgim prej 2 (dy) vjetësh, obligohet që t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 1.200 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate P.nr. ____ datë ____, me të cilën i pandehuri H.H., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor , të parashikuar nga neni. 189.par.2.nënp. 2.1 të KPK-ës, dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh, është theksuar obligimi i të pandehurit që t'i kompensojë shpenzimet e procedurës, por nuk është caktuar lartësia e shpenzimeve për shkak të nuk ekzistojnë të dhënat të sakta përkitazi me këto shpenzime.

Nga regjistri i shpenzimeve rezulton se është paguar për dëshmitarët _____€, për ekspertë _____ e që gjithsejtë bëjnë _____.

Meqë në bazë të dhënave që posedon kjo gjykatë është vërtetuar saktë sasia e shpenzimeve të procedurës penale , është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit _____ të KPPK-s.

GJYKATA THEMELORE NË _____

P.nr. ____/2013 datë _____

Kryetari i trupit,

Procesmbajtësi,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa , kolegjit shqyrtues të kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Sqarim: Aktvendimin për shpenzimet e procedurës mund ta merr edhe procesmbajtësi, ngase sipas nenit 451.par.2 të KPPK-s, kur mungojnë të dhënat për shumën e shpenzimeve, procesmbajtësi merr aktvendim të posaçëm për shumën e shpenzimeve, i cili aprovohet nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kur sigurohen të dhënat.

Kur për shpenzimet e procedurës penale është vendosur me aktvendim të posaçëm, për ankesë kundër atij aktvendimi vendos kolegji (par.3).

Formulari 20

AKTVENDIM PËR SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE TË SHKAKTUARA ME FAJIN E PERSONAVE TË CAKTUAR (neni 452. KPPK-s)

P.nr. ____/

Gjykata Themelore në _____, nga gjyqtari i vetëm B.B., me procesmbajtësin H.J., në çështjen penale e të akuzuarit I.I., për shkak të veprës penale të mashtrimit , të parashikuar nga neni 335.par.1.të KPK -ës, me datë _____mori,

A K T V E N D I M

Mbrojtësi i të akuzuarit I.I., avokati B.B., nga _____, është i detyruar që t'i paguajë në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumën prej 100 €(*pagesa e mëditjeve për dëshmitarë*) , ndërsa në emër të paushallit gjyqësor 10€ , të shkaktuara me fajin e tij, pavarësisht se si përfundon procedura penale,

A r s y e t i m i

Në çështjen penale ndaj të akuzuarit I.I., nga _____, për shkak të veprës penale mashtrimit nga neni 335.par.1.të KPK, është treguar shqyrtim gjyqësor me datën _____, në ora _____, në të cilin janë thirr të gjithë personat të propozuar nga aktakuza.

Në kohën e caktuar në shqyrtimin gjyqësor kanë ardhur të gjithë personat e ftuar përpos mbrojtësit avokatit B.B. nga _____, i cili ftesën me rregull e ka pranuar, mirëpo nuk e ka arsyetuar mungesën.

Për shkak të mungesës së mbrojtësit me propozim që akuzuarit shqyrtimi gjyqësor është shtyrë. Dëshmitarëve H.I. , K.M. dhe N.N. nga _____, u është paguar në emër të shpenzimeve të udhëtimit të ushqimit dhe mëditjeve të humbura 100 €.

Sipas nenit 452.par.1 të KPPK-s, mbrojtësi i të akuzuarit , pavarësisht se si përfundon procedura penale i bartë shpenzimet e shqyrtimit gjyqësor të shtyrë dhe shpenzimet tjera të shkaktuara me fajin e tij si dhe pjesë të shumës paushalle. Meqenëse mbrojtësi i të akuzuarit B.B, i cili ftesën e ka marrë me rregull nuk ka ardhur në shqyrtimin gjyqësor, dhe as që e ka arsyetuar mungesën, me fajin e tij ka shkaktuar shpenzime për shkak të mos mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, andaj është i detyruar që t'i kompensojë ato pavarësisht nga përfundimi i procedurës penale.

Lartësinë e pjesës së paushallit gjykata e ka caktuar duke pas parasysh ndërlíkueshmërinë e procedurës dhe gjendjen pasurore të personit i cili është detyruar që këtë shumë ta paguajë.

GJYKATA THEMELORE NË _____

P.nr. _____ / datë _____

Procesmbajtësi,

GJYQTARI,

B.B.]

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa , kolegjit shqyrtues

të kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

SQARIM: I pandehuri, i dëmtuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi dhe specialisti, pavarësisht nga rezultati i procedurës penale, paguajnë shpenzimet e shoqërimit të tyre forcërisht, të shtyrjes së një veprimi hetimor, shpenzimet tjera të procedurës të shkaktuara me fajin e tyre, si dhe pjesën përkatëse të shumës paushallë (**452.par.1**).

Për shpenzimet nga neni 452.par.2. i këtij neni merret aktvendim i posaçëm, përveç kur për shpenzimet që i paguan i pandehuri vendoset me vendim për çështjen kryesore(*me aktgjykim*)).

Formulari 21

PROPOZIMI I TË DËMTUARIT PËR REALIZIMIN E KËRKESËS PASURORO JURIDIKE

(*neni 458 KPPK*)

GJYKATËS THEMELORE NË _____

I dëmtuari _____

I pandehuri _____

P R O P O Z I M

Për realizimin e kërkesës pasurore- juridike

Pranë Gjykatës Themelore në _____, kundër të pandehurit _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë lidhur me nenin 327.par.1.nënp.1.1.të KPK-ës, është duke u zhvilluar procedurë penale P.nr. _____ datë _____.

Ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale në dëm të dëmtuarit.

I pandehuri me datë _____, ka thyer punëtorin e të dëmtuarit _____, nga e cila ka marrë një sasi dhe ari dhe bizhuteri në vlerë prej 3.000 €.

Provë: Procesverbali mi shikimin e vendit të ngjarjes dhe raporti i ekspertit.

Propozoj që në kuptim të nenit _____ të KPPK, gjykata të akuzuarin _____ ta detyrojë që në emër të kërkesës pasurore- juridike të dëmtuarit _____ t'i paguajë 3.000 €, në emër të dëmit që i ka shkaktuar, në afat prej 15 ditësh me kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Më. _____

I dëmtuari,

Formulari 22

PROPOZIM PËR DHËNIEN E MASËS SË PËRKOHSHME TË SIGURISË SË KËRKESËS PASURORO JURIDIKE

(neni 467. KPPK)

GJYKATËS THEMELORE NË _____

I dëmtuari _____

I pandehuri _____

P R O P O Z I M

Për dhënie e masës së përkohshme të sigurisë e kërkesës pasurore -juridike

Ndaj të pandehurit _____nga_____, pranë kësaj gjykate është duke u zhvilluar procedurë penale për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë parashikuar nga neni 327.par.1.nënp 1.1.të KPK-s, në dëm të të dëmtuarit.

Me parashitjen e datës_____, kemi paraqitur kërkesë pasurore- juridike në shumë prej 3.000 €, dhe kemi propozuar që kjo të vendoset në procedurë penale.

Më vonë kemi mësuar se te i pandehuri janë gjetur sendet me vlerë dhe atë:

1.automjeti i markës “Opel Kadet”

2.një kultivator

3.një motor, dhe

4.një fotoaparati profesional i markës “Soni” i prodhuar në vitin 2012.

Gjithashtu kemi mësuar se vëllai i të akuzuarit I.K. posedon autorizim gjeneral që i ka dhënë i akuzuari , në bazë të cilit ka autorizim që këto sende t'i tjetërsoj.

Propozoj gjykatës që në kuptim të nenit 467.par.2. të KPPK-ës, të merr aktvendim me të cilin do të caktojë masën e përkohshme sigurimi i kërkesës pasurore - juridike e të dëmtuarit me ndalimin e tjetërsimit ose ngarkesës së sendeve të cilat janë gjetur te i pandehuri, nga se në të kundërtën i pandehuri nëpërmjet të vëllait të tij mund të pengojë përmbushjen e kërkesës pasurore- juridike.

Më. _____

I dëmtuari,

Formulari 23

VENDIM MBI ZËVENËDSIMIN E DËNIMIT ME GJOBË ME DËNIM ME BURGIM (Neni 46. KPK-s)

KP.nr. ____/ ____

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin e përbërjes prej, M.M., kryetar kolegji, K.P. dhe N.H. si anëtarë kolegji, me bashkëpunëtorin profesional I.S. , procesmbajtës, në çështjen penale e të dënuarit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 186.par. 1.nënp.1.1.të KPK-s, me datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Dënimi me gjobë në shumë prej 600 €, i shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate P.nr. ____/ ____ datë _____ të gjykuarit N.N., nga _____, i zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditësh, të cilin ka për ta mbajtur pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate P.nr. ____ / ____ datë ____ i dënuari N.N, nga _____, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 186.par. 1.nënp.1.1.të KPK-ës, dhe është gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 600 €, të cilin ka qenë i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në afatin e lënë i dënuari N.N., dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e ka paguar, andaj kësaj gjykate i është paraqitur propozim që dënimi me gjobë t'i zëvendësohet me dënim me burg.

I pandehuri nuk e ka paguar dënimi me gjobë në afatin e lënë , ndërsa në deklaratën e dhënë pranë kësaj Gjykate ai qartë është deklaruar se dënimin me gjobë nuk dëshiron ta paguaj.

Sipas nenit 46.par. 3.të KPK-ës, nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, një ditë burgim llogaritet me njëzet (20) Euro gjobë. Dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre (3) vjet.

Nga të shtruarat më sipër , e në kuptim të nenit 46. par.3 të KPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____

P.nr. ____ / datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa , kolegjit shqyrtues të

kësaj Gjykate, në afat prej **3** ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

SQARIM: Çështjet që krijojnë dilema tek zëvendësimi i dënimit me gjobë me dënim me burgim janë: 1.)A lejohet e drejta në ankesë nda aktvendimit për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim dhe, 2.A duhet që së pari të tentohet ekzekutimi i dhunshëm e pas pamundësisë që dënimi me gjobë të ekzekutohet në mënyrë të dhunshme, i njëjti t'i zëvendësohet me dënim me burgim?.

1.Konsideroj se ndaj këtij aktvendimi duhet lejuar ankesa , ngase sipas nenit **408 par.1** të KPPK-s, kundër aktvendimeve të gjyqtarit të procedurës paraprake dhe kundër aktvendimeve tjera të gjykatës themelore, palët dhe personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, në pajtim me nenin 411 të këtij Kodi mund të paraqesin ankesë, me përjashtim kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë (*ligji nuk ka përjashtuar të drejtën e ankesës kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me burgim*).

2.Gjithashtu konsideroj se dënimi me gjobë nuk mund të zëvendësohet me dënim me burgim, para se të tentohet ekzekutimi i dhunshëm, këtë e mbështesë në dispozitat e nenit **486 të KPPK-s, e cila shprehet:** “*Kur gjoba e shqiptuar me këtë Kod nuk mund të arkëtohet as detyrimisht, gjykata e ekzekuton duke zbatuar nenin 46 të Kodit Penal*”.

Pastaj sipas nenit 138 .pika 1. të Ligjit Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale thuhet: “*Personi i dënuar, i paguan shpenzimet e ekzekutimit të dhunshëm të dënimit me gjobë*”

Formulari 24

AKTVENDIM PËR MARRJEN E PATENT SHOFERIT (*neni 112 KPPK-s*)

HP.nr. ___ / ___

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë, H.H., me procesmbajtësen N.N., në çështjen penale e të pandehurit I.K., nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.4 lidhur me par.1.të KPK-ës, duke vendosur lidhur me propozimin e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, që të pandehurit përkohësisht t’i merret patentë shoferi, me datë _____mori:

A K T V E N D I M

Të pandehurit N.N., nga _____, ndaj të cilit janë duke u zhvilluar hetimet për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik , të parashikuar nga neni 378.par.4 lidhur me par.1.të KPK-ës, përkohësisht i merret patentë shoferi për kohën sa zgjatë procedura penale.

A r s y e t i m i

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë me parashtrësën KP.nr.____/____ datë____, ka paraqitur propozim që ndaj të pandehurit N.N., nga____, ndaj të cilit zhvillohet procedurë hetimore për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.4 lidhur me par.1.të KPK-ës , përkohësisht të merret patentë shoferi për kohën sa zgjatë procedura penale.

Duke vlerësuar propozimin e Prokurorit Shtetëror gjykata ka gjetur se kërkesa është e bazuar. Nga të dhënat të grumbulluara në procedurën e hetuesisë vërtetohet se i pandehuri edhe më herët dy herë ka qenë i dënuar për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik. Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore propozimit i ka bashkangjitur edhe aktvendimin e ish Gjykatës për Kundërvajtje në _____, në të cilën vërtetohet se të pandehurit i është shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 200 €, për shkak të kundërvajtjes në komunikacion të kryer në gjendje të alkoolizuar.

Kundër të pandehurit zbatohet procedurë hetimore për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprë penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.4 lidhur me par.1.të KPK-s. Më parë ka qenë dy herë i dënuar për të njëjtat vepra penale, gjatë procesit të hetuesisë prapë e ka ngarë makinën në gjendje të dehur dhe me këtë gjendje ka shkaktuar kundërvajtje në komunikacion.

Për arsyet e përshkruara më lartë rezulton se janë përmbushur të gjitha kushtet nga neni 112.par.1. të KPPK-ës, që ndaj të pandehurit t'i merret patentë shoferi deri në përfundim të procedurës dhe se propozimi i Prokurorit Shtetëror është i bazuar.

GJYKATA THEMELORE NË _____

HP.nr.____/ datë _____

Procesmbajtësi,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit

në afat prej tri (3) ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 25

AKTVENDIM MBI KTHYERJEN E PATENTË SHOFERIT (neni 116.par.1.KPPK-s)

KP.nr. ___/___

Kryetari i trupit gjykues NN. I Gjykatës Themelore në Prishtinë, me procesmbajtësen N.N., në çështjen penale e të akuzuarit I.K., nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik , të parashikuar nga neni 378.par.4 lidhur me par.1.të KPK-ës, duke vendosur lidhur me propozimin e mbrojtësit të akuzuarit që atij t'i kthehet patentë shoferi i marrë përkohësisht, në shqyrtimin gjyqësor datë _____ mori këtë :

A K T V E N D I M

Patentë shoferi i marrë përkohësisht nga i akuzuari I.K., nga _____, me aktvendimin e Gjyqarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate PP.nr. ___/___ datë _____, duhet t'i kthehet të akuzuarit pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjyqarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate PP.nr. ___/___ datë _____, përkohësisht është marrë patentë shoferi nga i akuzuari I.K, nga _____, në bazë të nenit **112.par.1. të KPPK-ës** .

Në shqyrtimin gjyqësor datë _____, mbrojtësi i të akuzuarit ka paraqitur propozim që atij t'i kthehet patentë shoferi nga se kanë pushuar shkaqet për të cilat i është marrë.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore _____, ka kundërshtuar propozimin e mbrojtjes dhe ka shpreh mendimin se nuk janë përmbushur kushtet që të akuzuarit t'i kthehet patentë shoferi.

Duke vendosur sipas propozimit të mbrojtësit , gjykata ka gjetur se kanë pushuar *shkaqet për të cilat i është marrë patentë shoferi*.

Ngjarjen për të cilën të akuzuarit i është marrë patentë shoferi dhe është zhvilluar një procedurë penale ka ndodh më _____. Aktvendimi për marrjen e përkohshme të patentë shoferit është marrë më _____. Nga raporti i NTP, "Tregtia" nga Prishtina, vërtetohet se i akuzuari pas marrjes së patentë shoferit është pranuar në punë në këtë Ndërmarrje për mirëmbajtjen e makinave në këto punë ka treguar rezultate të kënaqshme. Në shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari është vozitës profesional, është i martuar se ka tre fëmijë të mitur dhe se bashkëshortja është e papunë.

Duke pas parasysh faktet e paraqitura më lart veçmas nga koha e marrjes së patentë shoferit kanë kaluar më shumë se **dy(2)** vite dhe se sjellja e të akuzuarit në këtë periudhë ka qenë e kënaqshme, se është shofer profesional, gjykata ka gjetur se kanë pushuar arsyet për të cilat i është marrë përkohësisht patentë shoferi, nga se nga sjella e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale mund me bazë të konkludohet se ai me kujdes të shtruar do të marrë pjesë në trafik për të mos kryer vepra të reja penale.

GJYKATA THEMELORE NË _____

HP.nr. ____ / datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i trupit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën
e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 26

AKTVENDIM PËR DËNIMIN E MBROJTËSIT PËR SHKAK TË ZVARRITJES SË
RPROCEDURËS PENALE
(neni 64.KPPK-s)

P.nr. ____ / ____

Gjykata Themelore në Prishtinë, në trupin gjykues në përbërje H.H., si kryetar, anëtarë H.H. dhe F.I., me procesmbajtësen N.N., në çështjen penale e të akuzuarit I.K., nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik , të parashikuar nga neni 378.par.4 lidhur me par.1.të KPK-ës , duke vendosur në kuptim të nenit 64. të KPPK-ës, në shqyrtimin gjyqësor, datë _____ mori këtë :

A K T V E N D I M

Mbrojtësi i të akuzuarit I.K., nga _____, avokat N.N., nga _____, dënohet me dënim me gjobë në shumë prej 250 €, për shkak të zvarritjes së procedurës penale, të cilin është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

A r s y e t i m i

Pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj të akuzuarit I.K., nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik , të parashikuar nga neni 378.par.4 lidhur me par.1.të KPK-ës.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës _____, nuk ishte i pranishëm mbrojtësi i të akuzuarit i cili është thirrur në mënyrë të rregullt por me telefon e ka njoftuar gjykatën se ndodhet në pushim mjekësor. Pas shtyrjes së shqyrtimit gjyqësor nuk i ka ofruar gjykatës asnjë provë se vërtetë ka qenë në pushim mjekësor.

Në shqyrtimin gjyqësor kanë pretenduar të gjithë personat e ftuar përpos dëshmitarit H.K., i cili nuk ka qenë i ftuar me rregull. Pas zbatimit të provave të propozuara sipas aktakuzës së Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore përfaqësuesi i akuzës ka propozuar që dëshmia e dëshmitarit H.K, i cili është dëgjuar në procedurën e hetuesisë ndërsa dëshmia e tij nuk i përket fakteve vendimtare të lexohet. Mbrojtësi i të akuzuarit këtij propozimi i ka kundërshtuar dhe ka kërkuar që ky dëshmitar të dëgjohet drejtpërdrejtë. Për këtë arsye shqyrtimi gjyqësor është shtyrë për _____, ndërsa palëve data e mbajtjes së shqyrtimit të ri u është komunikuar gojarisht.

Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më _____, kanë prezantuar të gjithë personat e ftuar përpos mbrojtësit së të akuzuarit avokatit N.N, i cili me parashtresën i është dorëzuar një ditë para mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor ka njoftuar gjykatën se është i penguar të prezantojë në shqyrtim gjyqësor për arsye se të njëjtën ditë ka një shqyrtim gjyqësor në Gjykatën Themelore në _____, në çështjen penale ndaj të akuzuarit I.L, nga _____ i cili akuzohet për vepër penale të

vrasjes nga neni 146 të KPK-ës, në të cilën ai është mbrojtës dhe duhet pa tjetër të prezantojë në shqyrtim.

Nëpërmes telefonit është verifikuar se mbrojtësi-avokati N.N, nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin gjyqësor as në këtë gjykatë, por vetëm me telegram ka njoftuar gjykatën se nuk mund të merë pjesë në shqyrtim për shkak të tollovisë në komunikacion. Me informatat e siguruara nga dispeçeri i rrugëve regjionale Pejë-Prishtinë, është vërtetuar se në këtë relacion komunikacioni është zhvilluar pa asnjë tollovi, këto informacioni janë shënuar në procesverbal dhe seanca është shtyrë për datën_____.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës_____, kanë marrë pjesë gjithë personat e ftuar , mirëpo shqyrtimi gjyqësor në kuptim të nenit_____, është dashtë të fillojë rishtas për shkak se kishin kaluar më tepër se 3 muaj. Pas fillimit të procedimit të provave përfaqësuesi i akuzës ka propozuar që dëshmitarët dhe ekspertit të mos dëgjohej po të lexohen dëshmitë e tyre në kuptim të nenit _____ të KPPK-ës, mbrojtësi edhe këtë propozim e ka kundërshtuar dhe ka kërkuar që në kuptim të nenit _____ të KPPK-ës, provat përsëri të procedohen.

Gjykata të gjitha veprimet e mbrojtësit: mungesën nga shqyrtimi gjyqësor i datës_____, pa afruar dëshmi se ka qenë në pushim mjekësor, kundërshtimet në shqyrtimin gjyqësor të datës_____, që për leximin e dëshmisë së dëshmitarëve dëshmitë të cilëve nuk ishin me rëndësi kruciale për gjykimin, mungesa nga shqyrtimi gjyqësor i datës_____, pa ofruar prova të sigurta për pengesat dhe kërkesat që në shqyrtimin gjyqësor të datës_____, që të gjitha provat përsëri të procedohen edhe pse ishin proceduar para trupit të pandryshuar gjykues, i ka vlerësuar si veprime apriori të planifikuara me qëllim të prolongimit të procedurës penale, andaj në kuptim të nenit 64.par.1. të KPPK-s, i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË _____ P.nr. ____/
datë_____

Procesmbajtësi,

Kryetari i trupit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së
aktvendimit.

Formulari 27

KALLXIMI PENAL I POLICISË PROKURORIT SHTETËROR (neni 81.KPPK)

Prokurorisë Themelore në _____

Në bazë të nenit 81 par.1. të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës , paraqesë,

KALLËZIM PENAL

Ndaj _____, i lindur më _____, në _____, jeton në _____ nr., nga i ati _____ dhe nga e ëma _____, e vajzërisë _____, i punësuar në _____, realizon të ardhura në shumë prej _____, i martuar , baba i tre fëmijëve të mitur;

Për shkak të dyshimit të bazuar se:

Më _____, në rrugën regjionale, Gjilan –Kamenicë, në fshatin _____, duke mos ia përshtatur shpejtësinë e ngasjes, kushteve në rrugë , duke e ngarë mjetin e tij automobilistik me targa e regj _____ i markës “Mercedes” ngjyrë të zeze . në kundërshtim me nenin 53. të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor , pasi që rruga ishte pjesërisht e mbuluar me akull , nga pakujdesia duke menduar se deri te pasoja e ndaluar nuk do të vij , apo se të njëjtën, nëse paraqitet do ta evitoj, bazuar në përvojën e tij të gjatë si shofer, me të arritur përball shkollës _____, duke tentuar ta shmangë goditjen e një lope e cila po e truponte rrugën , rrëshqet dhe devijon nga rruga kalon ne trotuar , ku i godet disa fëmijë që po lëvizni atypari, me ç’rast , S.K nga goditjet fatale që i kishte marr vdes në vendin e aksidentit, ndërsa .S.Y.P.K dhe V.V, u shkakton lëndime të rënda trupore, ku qëndrojnë disa dit në kurim në Qendrën spitalore në _____.

Me këtë, do të kryente veprën penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 328, par.9.lidhur me parë 8 dhe 1.të KPK-ës.

SHTOJCË :Fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, procesverbali për këqyrjen e vendit të ngjarjes, emrat e dëshmitarëve okular të ngjarjes dhe provat materiale, nga vendi i ngjarjes- pjesë të shkëputura nga mjeti, sende personale e të ndjerit-të dëmtuarve , si çanta, çizme kapela etj.

Gjilan, më _____

Kallëzimin e parashtrori,

NN, komandant i njësitit të trafikut rrugor

Formulari 28

**KALLXIMI PENAL I TË DËMTUARIT PARAQITUR ORGANEVE POLICORE
KUNDËR KRYERËSIT TË PANJOHUR PËR SHKAK TË VEPRËS PENALE E CILA
NDIQET SIPAS DETYRËS ZYRTARE**

(Neni 79.KPPK)

SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS-NJËSITIT PËR KRIME TË RËNDA

Me datë _____, pa ftesë është paraqitur N.N., punëtor nga Peja, Rr. _____nr. _____, i lindur më _____, dhe ka deklaruar se dëshiron të paraqes

KALLXIM PENAL

Kundër dy kryerësve të panjohur të veprës penale të grabitjes nga neni 329.par. 3.lidhur me par.1.të KPK.

Me datë _____, derisa kthehesha nga Lagja e “Dragodanit” për në banesën time dhe kur kam arritur afër Qendrës së Studentëve mu kanë afruar tre persona dhe me përdorimin e thikave më kanë kontrolluar dhe nxjerr portofolin në të cilin kisha 2.000 €, si dhe më kanë marrë një zinxhir dore të arrit , në vlerë prej 300 €, dhe pasi më kanë rrahur më kanë lënë dhe kanë ikur në drejtim të panjohur.

Meqenëse ishte natë dëshmitarë nuk kishte unë nuk kam arritur t'i njoh këta persona mirëpo mund të them se të gjithë kanë qenë në mes moshës 21-25, njëri që më mbante për krah kishte mjekër të rregulluar dhe gjatësi sa e imja 1,75 , personi i dytë i cili më kontrollonte në gjepa ishte në afërsi prej 1,80 thatanikë dhe me flokë të gjata, ndërsa i treti i cili ka përdorë dhunë ndaj meje ishte me gjatësi përfarësisht sa e imja 1,75 kishte një bluzë të zezë me shkronja “Nwujork” dhe kishte një nishan në faqen e djathtë.

Denoncuesi ka theksuar se është në gjendje t'i identifikojë të tre këta keqbërës, sikurse të ballafaqohem me ta., pasi që ishin të pamaskuar dhe fizionominë e tyre e ka mbajtur në mend dhe e ka fiksuar .

Kallëzimin e kam lexuar dhe në tërësi e pranoj për timen.

Kallëzimin e ka pranuar,

Kallëzimin e ka paraqitur i dëmtuari,

N.N.

Formulari 29

AKTVENDIM PËR HEDHJEN E KALLËZIMIT PENAL (Neni 82.KPPK)

PROKURORIA E SHETITIT E PROKURORISË THEMELORE

PP.nr. ___/___

Më _____

P r i s h t i n ë

Prokuroria e Shtetit e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, në bazë të nenit 82 të KPPK-ës, me datë _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet kallëzimi penal , i S.S., student nga _____, i paraqitur kundër P.P.shofer nga _____, për shkak të veprës penale mos ofrimi i ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi

trafiku, të parashikuar nga neni 382.par.3 KPK-ës, nga se nuk janë përmbushur elementet esenciale të kësaj vepre penale.

A r s y e t i m

S.S., student nga _____, me datë _____, ka paraqitur kallëzim penal kundër të pandehurit P.P., shofer nga _____, i punësuar në _____, kundër të cilit udhëhiqet procedurë penale për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik i parashikuar nga neni 378 par. 9 lidhur me par.1.të KPK-ës, për shkak të mos dhënies të ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi trafiku , të parashikuar nga neni 382.par. 3.të KPK-ës, për shkak se me datë _____, në rastin e aksidentit të komunikacionit që ka ngjarë në rrugën regjionale _____ në hyrje të fshatit _____, të cilin e ka shkaktar me fajin e vet e ka lënë pa ndihmë M.S., bashkëshorte e paraqitësit të kallëzimit, e cila me këtë rast ka qenë lënduar rëndë dhe për shkak të mos ofrimit me kohë të ndihmës ka vdekur.

Duke i verifikuar të dhënat e paraqitur në kallëzim, është siguruar mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore dr.N.N., nga Qendra Spitalore në Prishtinë, nga e cila rezulton se S.S., me rastin e aksidentit të komunikacionit që e ka shkaktuar i pandehuri P.P. ka pësuar lëndime vdekjeprurëse nga të cilat ka vdekur në vendin e ngjarjes.

Sipas ligjit nëse personi i lënduar me automjet ose mjet tjetër transportues humb jetën menjëherë pas aksidentit të komunikacionit , atëherë nuk mund të ekzistojë vepra penale mos ofrimi i ndihmës personit të lënduar në aksident komunikacioni , e cila është parashikuar me nenin 382.par. 3.të KPK-ës, ngase objekt i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm personi i gjallë të cilit është i mundur ofrimi i ndihmës. Ikja nga vendi i ngjarjes në rastin konkret që është vërtetuar pa dyshim i pandehuri P.P., nuk ka mund që të konsumojë veprën e theksuar më parë, nga se S.S. ka mbetur i vdekur menjëherë në vendin e aksidentit.

Nga të theksuarat më lart, në mbështetje të nenit 82.par.1.nënp.1.1.të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv.

Prokuroria e Shtetit e Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Formulari 30

KËRKESË PËR MBLEDHJEN E INFORMATAVE TË NEVOJSHME

(neni 83. KPPK)

PROKURORIA E SHTETIT E PROKURORISË THEMELORE

PP.nr. ___/___

Më _____

P r i s h t i n ë

SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS-NJËSITIT PËR KRIME TË RËNDA

Ua dorëzojmë kallëzimin penal të H.H., mësuese nga _____, kundër B.B., inxhinier ndërtimi nga _____, për shkak të veprës penale vrasje , parashikuar nga neni 178 lidhur të KPK-s.

Nga kallëzimi penal rezulton se i pandehuri B.B., me datë _____, rreth orës _____, me rastin e konfliktit rreth një ndërtimi të një shtëpie, e ka shtyrë shkallëve të cilat ishin akoma të papërfunduara , nga rënia ka pësuar lëndime të rënda të kafkës , menjëherë është dërguar si rast urgjent në Qendrën Emergjente në Prishtinë , por përkundër përpjekjeve të mjekëve për t’ia shpëtuar jetën ka vdekur .

Në bazë të nenit 83.paragrafi 1 të KPPK-ës, paraqesë

Kërkesë për mbledhjen e informacioneve të nevojshme

Meqenëse të dhënat nga kallëzimi nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për të filluar hetimet e as bazë për marrjen e ndonjë vendimi tjetër sipas kallëzimit , është e nevojshme që të mblidhen informacione shtesë, me të cilat do të verifikoheshin të dhënat e paraqitura në kallëzim përkatësisht do të ndriçoheshin *rrethanat si më poshtë:*

Nëse i dyshuari është i kapshëm për organet, të merret deklarata në drejtim të sqarimit se mes tij dhe tani të dëmtuarit a kishte konflikt ditën kritike, a ka pas konflikte mes tij dhe të ndjerit në të kaluarën, të dëgjohen personat e theksuar në kallëzim D.D. M.S, dhe K.L, të gjithë punëtor të Ndërmarrjes Ndërtimore “Project” të cilët kinse kanë qenë dëshmitarë të ngjarjes, në drejtim sa a kishte konflikt në mes të dëmtuarit dhe të akuzuarit, a kanë ata njohuri për raportet eventuale në mes të dëmtuarit dhe të paraqiturit, se a mund të vërtetojnë se i dyshuari e ka shtyrë shkallëve tani të ndjerin , a e kanë parë rënien e tani të ndjerit nga shkallët , si është dukur rënia e tillë nga shkallët, të verifikohet sa është lartësia e shkallëve deri te vendi i rënies së të dëmtuarit, të vërtetohet nëpërmjet të Klinikës Kirurgjike në Prishtinë , kur i dëmtuari është sjell

në klinikë dhe në çfarë gjendje , a ishte në gjendje të alkoolizuar dhe në çfarë shkalle, kur ka vdekur dhe çka ishte shkak i vdekjes.

Pas veprimit sipas kësaj kërkesë të gjitha informatat e grumbulluara i dorëzoni kësaj Prokurorie.

Prokurori,

Formulari 31

AKTVENDIM I PROKURORIT TË SHITETIT PËR ZBATIMIN E HETIMEVE (neni 104.KPPK-s)

PROKURORIA SHITETËRORE E PROKURORISË THEMELORE NË _____

PPKR.nr. _____

Datë _____

Prokuroria Themelore në _____, nëpërmjet prokurorit _____, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses NN., në procedurën hetimore kundër të pandehurit N, nga _____, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprë penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329 par. 3.lidhur me par.1 të KPK-së, më datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËR FILLIMIN E HETIMEVE

Kundër:

Të dyshuarit N, i biri i S. dhe nënës M – e gjinisë B, i lindur më _____ në _____, tani me banim në Rr. E _____, nr. 123, ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, me profesion ndërtimtar, i gjendjes së mesme ekonomike, s shqiptuar, shtetas i Republikës së Kosovës, i njohur edhe më parë si kryerës i veprave penale të grabitjeve dhe vjedhjeve të rënda, në ndalim policor gjendet nga data . _____, në ora 20.

-meqë ekziston dyshimi i bazuar se:

Më datë _____ rreth orës 23 në Rr. _____ në _____, me qëllim që vetit t'i sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm dhe duke përdorur bris kun, ka kryer vepër penale të grabitjes në dëm të të dëmtuarit F. nga _____, i cili gjersa po lëviztë rrugës _____ përball dyqanit “Produkti” dhe po fliste me dikë në telefon, ai i është afruar nga prapa dhe e ka goditur në fytyrë atë, duke e rrëzuar për tokë, e pastaj nga xhepi e ka nxjerrë një bris k dhe i ka afruar te fyti dhe nën kërcënimin e bris kut nga i dëmtuari ka marrë një telefon celular të markës “Samsung-G-800”, në vlerë prej 500 €. e pastaj ka ikur nga vendi i ngjarjes,

-me çka kishte për të kryer vepër penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329 par. 3.lidhur me par.1 të KPK-së.

Hetimet kundër të pandehurit N, sipas këtij aktvendimi fillojnë nga data _____ në ora 12,00.

A r s y e t i m

Stacioni Policor- Njësi i hetimeve në _____ nën nr. _____ të datës _____ pranë kësaj prokurorie ka ushtruar kallëzim penal kundër të pandehurit _____, nga _____, me dyshim të bazuar se i njëjti kishte për të kryer vepër penale të grabitjes nga neni 329 par. 3.lidhur me par.1 të KPK-së.

Pas shqyrtimit dhe të dhënave nga kallëzimi penal, dhe provave të bashkangjitura kallëzimit penal, konsideroj se ndaj të pandehurit _____ duhet zbatuar hetimet, pasi që nga provat e parashtruara, rrjedhë dyshimi i arsyeshëm se i njëjti ka kryer vepër penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329 par. 3.lidhur me par.1 të KPK-së, me qëllim që në procedurën hetimore të mblidhen prova, në bazë të të cilave do të vendoset se a do të ngritët aktakuza apo hetimet do të pushojnë.

Gjatë procedurës hetimore është e nevojshme që të dëgjohet i pandehuri N nga _____, nga të gjitha rrethanat nga kallëzimi penal, ndërsa në cilësi të dëmtuarit F, nga _____, Rr. _____, nr. _____.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 104 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

PROKURORI _____

Formulari 32

AKTVENDIM I PROKURORIT PUBLIK PËR AUTORIZIMIN E ZBATIMIT TË HETIMEVE TË CAKTUARA (neni104/4 KPPK)

Hp.nr. ___/___

Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në _____, me procesmbajtësin _____, në lëndën penale e të pandehurit A.A., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1 të KPK-s, me datën _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

Autorizohet Shërbimi Policor i Kosovës, Njësi të Krime të Rënda në Prishtinë, që të kryejë këto veprime hetimore:

1. të marrë në pyetje të pandehurin A.A.

2. t'i dëgjojë dëshmitarët P.A., K.K., H. J. në rrethanat se si janë marrë sendet nga shtëpitë e tyre vlera e sendeve të marra dhe si është depërtuar në shtëpitë e tyre.

A r s y e t i m

Në bazë të aktvendimit të kësaj prokurorie janë duke u zhvilluar hetimet penale ndaj të pandehurit A.A., për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1 të KPK-s, Duke pas parasysh provat dhe të dhënat e mbledhura deri më tani, prokurori gjen se veprimet e mësipërme hetimore duhet besuar organeve policore me qëllim të përfundimit me sukses të procedurës së hetuesisë.

Meqenëse janë përmbush të gjitha kushtet që të autorizohet policia për zbatimin e veprimeve hetimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 104.par.4. të KPPK-ës.

Prokuroria e Shtetit e Prokurorisë Themelore në Prishtinë

HPKR.nr. ___/___ datë _____

Procesmbajtësi,

Prokurori i Shtetit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa

Formulari 33

AKTVENDIM PËR PEZULLIMIN E HETIMEVE

(Neni 157.KPPK-s)

Prokurori Publik i Prokurorisë Themelore _____ me procesmbajtësin, në lëndën penale e të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1.të KPK-s,, me datën _____, mur këtë;

A K T V E N D I M

Pezullohen hetimet , në çështjen penale të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1.të KPK-s.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e plotfuqishëm të kësaj prokurorie HP.nr. ____/____, nga data _____, është vendosur që të zbatohen hetimet kundër të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1.të KPK-ës.

Gjatë hetimeve i pandehuri ka lëshuar vendbanimin dhe ka shkuar në drejtim të panjohur(*prokurorinë nuk e ka njoftuar për ndërrimin e vendbanimit*), e kjo shihet nga raporti i Stacionit të Policisë nr.1 në Prishtinë nr.____prej datës_____.

Meqenëse i pandehuri ka lëshuar vendbanimin e tij dhe ka shkuar në drejtim të panjohur , me kërkesën e prokurorisë, gjyqtari i procedurës paraprake ka dhënë urdhër për lëshuarjen e letër rreshtimi.

Meqenëse i pandehuri është i paarritshëm për organet shtetërore, në kuptim të nenit 157.par.1, të KPPK-s, u vendos që hetimet të pezullohen, derisa i pandehuri të gjendet dhe të sillet në prokurori .

PROKURORIA SHTETIT E PROKURORISË THEMELORE _____

HP.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,

Prokurori,

SQARIM: Ligji nuk e parasheh të drejtën në ankesë por as nuk e përjashton atë, megjithatë konsideroj se meqë prokurori si palë në procedurë dhe si organ i ndjekjes i ka pezulluar apo i ka pushu hetimet, nuk ka kush të paraqes ankesë, ngase i dëmtuari ka të drejtë ankese vetëm për vendimin për dënimin , edhe atë për disa vepra penale.

Formulari 34

AKTVENDIM PËR PUSHIMIN E HETIMEVE

(Neni 158.KPPK-ës)

Prokurori Publik i Prokurorisë Themelore _____ me procesmbajtësin, në lëndën penale e të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1të KPK-s,, me datën _____, mur këtë;

A K T V E N D I M

Pushohen hetimet në çështjen penale të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë , të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1.të KPK-ës.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e plotfuqishëm të kësaj prokurorie HP.nr. ____/____, nga data _____, është vendosur që të zbatohen hetimet kundër të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp. 1.1.të KPK-ës. Pas përfundimit të hetimeve, Prokurori shtetëror erdhi në përfundim se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë, andaj në kuptim të nenit 158 nënp. 1.1 . të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv.

PROKURORIA THEMELORE _____

HP.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,

Prokurori,

SQARIM: Ligji nuk e parashih të drejtën në ankesë por as nuk e përjashton atë, megjithatë konsideroj se meqë prokurori si palë në procedurë dhe si organ i ndjekjes i ka pezulluar apo i ka pushu hetimet, nuk ka kush të paraqes ankesë, ngase i dëmtuari ka të drejtë ankese vetëm për vendimin për dënimin , edhe atë për disa vepra penale.

Formulari 35

OFRIMI I DORZANISË

(Neni 179.KPK)

GJYKATËS THEMELORE NË _____

Me aktvendimin e plotfuqishëm të kësaj prokurorie HP.nr. ____/____, nga data _____, është vendosur që të zbatohen hetimet kundër të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje , të parashikuar nga neni 325.par.1. të KPK-ës.

Ndaj të pandehurit Gjyqtari i procedurës paraprake sipas propozimit të Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore _____, me aktvendimin PP.nr. ___/___ datë _____, ka caktuar paraburgimin në bazë të nenit 187.par. 1.nënp.1.1 dhe nënp.1.2.1 të KPPK-ës, për shkak të rrezikut të ikjes.

Babai i të pandehurit i propozon gjykatës që të pandehurin ta lirojë që të mbrohet në liri me dorëzani se i njëjti deri në përfundim të procedurës penale nuk do të ikë dhe me premtimin e të pandehurit se deri në fund të procedurës penale nuk do të fshehët dhe as që do e lëshojë vendbanimin pa lejen e gjykatës.

Në emër të dorëzani së babai i të pandehurit N.N. ofron 10.000 €, të cilën e ka deponuar në depozitin e gjykatës.

I pandehuri është i martuar jeton me bashkëshorten e cila është e papunësuar dhe 3 fëmijë të mitur, që tregon se dorëzania i ofruar është garancion i mjaftueshëm se i pandehuri deri në përfundimin e procedurës nuk do të ikë.

Për këtë arsye propozoi që Gjyqtari i procedurës paraprake që pas dëgjimit të Prokurorit të Shtetit, në bazë të nenit _____ të KPPK-ës, të pranojë dorëzani në e ofruar dhe të pandehurin ta lirojë menjëherë që të mbrohet në liri.

Më. _____

Babai i të pandehuri,

S.S.

Formulari 36

AKTVENDIM PËR PRANIMIN E DORZANISË

(Neni 180 .KPPK-ës)

PPH.nr. ___/___

Gjyqtari i procedurës paraprake nga Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në _____, N.N. me bashkëpunëtorin profesional, N.N. si procesmbajtës, në çështjen penale e të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 KPPK-ës, duke vendosur sipas propozimit të prindit të të pandehurit për caktimin e dorëzani së, më datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet dorëzania e ofruar, ashtu që i pandehuri N.N. nga _____, i cili ndodhet në paraburgim prej _____, ka për tu lëshuar në liri, pasi që babai i tij N.N. të paguajë në depozitën e kësaj gjykate shumën prej 10.000 €, si garancë se i pandehuri deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor nuk do të ikë.

A r s y e t i m i

Pranë Prokurorisë Themelore Departamenti për Krime të Rënda në _____, janë duke u zbatuar hetimet kundër të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 KPK-ës, sipas aktvendimit HP.nr. ___/___ datë _____.

I pandehuri gjendet në paraburgim nga _____, sipas aktvendimit të Gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate PP.nr. ___/___ datë _____. Paraburgimi është caktuar në bazë të nenit 187.par.1. nënp. 1.2.1.të KPPK-ës, për shkak të rrethanave që tregojnë rrezikun e ikjes.

Me parashtesën nga data _____, prindi-babai ka propozuar që i pandehuri të lëshohet në liri me dorëzani dhe ka ofruar që të paguajë në depozitën e kësaj gjykate 10,000 €, e cila do shërbej si garancë se i pandehuri deri në fund të shqyrtimit gjyqësor nuk do të ikë.

Gjykata konsideron se me ofrimin dhe deponimin i dorëzani prej 10.000 €, shmang dyshimin se i pandehuri deri në përfundimin e procedurës penale mund të ikë, duke pas parasysh peshën e veprës penale rrethanat e tij familjare dhe personale si dhe gjendjen ekonomike e babait të tij i cili ka ofruar dorëzani. I pandehuri dyshohet se në rastin e grabitjes në shtëpinë e të dëmtuarit ka vjedhur sende në vlerë prej 6.000 €. Ai është i martuar ka 2 fëmijë të mitur dhe ka premtuar se deri në fund të shqyrtimit gjyqësor nuk do të fshehët dhe as që do të braktisë vendqëndrimin pa lejen e gjykatës. Të gjitha këto rrethana përjashtojnë dyshimin se i pandehuri duke qëndruar në liri do ikë.

Meqenëse janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, të parashikuar nga neni 180.par.1. të KPPK-s, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE _____

PPH.nr. ___/___ datë ____

Procesmbajtëse,

Gjyqtari i procedurës paraprake.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën
e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 37

AKTVENDIM PËR HUMBJEN E DORZANISË DHE DERDHJA NË BUGJET (neni 182. KPPK-s)

PNr.nr. _____ / _____

Kryetari i trupit gjykues , i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në _____ N.S. me bashkëpunëtorin profesional, _____, si procesmbajtës, në çështjen penale e të akuzuarit _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 KPK-s, sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit të prokurorisë themelore, departamenti për krime të rënda në _____ PP.nr. _____ datë _____, më datë _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Dorëzani së prej 10.000 €, e deponuar në llogarinë e kësaj Gjykate, nga babai i të pandehurit N.N. si garancion se i pandehuri N.N. nga _____ nuk do të ikë deri te përfundimi i procedurës penale hiqet, ndërsa mjetet e deponuara derdhen në buxhetin e kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

Pranë kësaj gjykate është në procedim e sipër procedura penale ndaj të akuzuarit N.N, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 KPK-s.

Me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake PPH.nr. ____ / ____ datë _____, është pranuar dorëzania që ka ofruar babi të pandehurit në shumë prej 10.000 €, dhe i pandehuri është lëshuar në liri, me premtim se nuk do të fshehët deri në fund të procedurës, dhe pa leje të gjykatës nuk do e braktisë vendbanimin.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale me urdhër, ka caktuar shqyrtim gjyqësor për datën _____ në të cilin i ka ftuar palët dhe dëshmitarët. Ftesa të akuzuarit nuk ka mundur t'i dorëzohet, me konstatim se ai ka ndërruar vendbanimin dhe nuk është e ditur se ku tani ndodhet .

Sipas raportit të Stacionit Policor nr.1 në _____ nr. _____ datë _____, i pandehuri N.N. ka lëshuar vendbanimin e tij dhe ilegalisht ka udhëtuar në botën e jashtme.

Meqenëse i pandehuri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor ka ikur, gjykata në kuptim të nenit 182.par.1. të KPPK-s, ka vendos që dorëzania e ofruar të hiqet dhe derdhet në buxhetin e kësaj Gjykate.

GJYKATA THEMELORE _____

PPH.nr. ____ / ____ datë _____

Procesmbajtëse,

Gjyqtari i procedurës paraprake.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së
aktvendimit.

Formulari 38

AKTVENDIM PËR KTHYERJEN E DORËZANISË

(Neni 182.KPPK-ës)

KP.nr. ____ / ____

GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime të Rënda në _____ në kolegjin gjyqësor në përbërje prej N.N. kryetar, anëtarëve N.N. të trupit me bashkëpunëtorin profesional

N.N. si procesmbajtës, në çështjen penale e të pandehurit N.N për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 KPK-ës, duke vendosur sipas propozimit të babait të pandehurit për heqjen e dorëzanisë pas dëgjimit të Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në _____, në seancën e mbajtur më _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Hiqet dorëzania në çështjen penale të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 KPK-ës, ashtu që shuma prej 10.000 €, e paguar në depozitin e kësaj gjykate, si garancë se i pandehuri nuk do të ikë deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor ka për tu kthyer babait të tij N.N.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kësaj gjykate PPH.nr. ____/ __ datë _____, është pranuar dorëzania e babait të të pandehurit N.N. nga _____, në shumë prej 10.000 €, si garancë se i pandehuri deri në fund të shqyrtimit gjyqësor nuk do të ikë dhe i pandehuri menjëherë është liruar në liri.

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate P.nr. ____/ __ datë _____, i pandehuri N.N. është shpallur fajtor, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 KPK-s, dhe është dënuar me dënim burgu prej 2 (dy) vitesh.

Sipas raportit të Departamentit për ekzekutimin e sanksioneve penale ED.nr. ____/ __ datë _____, i dënuari ka filluar mbajtjen e dënimit më datë _____.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____, është pajtuar me propozimin që dorëzania të hiqet.

Meqenëse i dënuari ka filluar mbajtjen e dënimit me burgim janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për heqjen e dorëzanisë në kuptim të nenit 182.par.4 të KPPK-ës, andaj propozimi i babait të pandehurit është aprovuar dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime të Rënda

KP.nr. ____/ ____ datë _____

Procesmbajtës,

Kryetari i kolegjit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 39

AKTVENDIMI I GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT (Neni 188.KPPK-ës)

PPH.nr. ____ / ____

Gjyqtari i procedurës paraprake N.N: i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në _____, me procesmbajtësin N.N. në çështjen penale e të pandehurit nga _____, për shkak të veprës penale vjedhjes grabitqare, të parashikuar nga neni 328. par.1.të KPK-s, me datë _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit N.N. nga _____, kundër të cilit janë duke u zbatuar hetimet për shkak të veprës penale të vjedhjes grabitqare parashikuar nga neni 328. par.1.të KPK-s, sipas aktvendimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____, HP.nr. ____ / ____ datë _____, caktohet paraburgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, në bazë të nenit 187.par.1.nënparagrafi 1.1 dhe 1.2.1.të KPPK-s, i cili ka për tu llogaritur prej _____.

A r s y e t i m i

Kundër të pandehurit janë duke u zbatuar hetimet për shkak të veprës penale të vjedhjes grabitqare parashikuar nga neni 328. par.1.të KPK-s, sipas aktvendimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____, HP.nr. ____ / ____ datë _____.

Pas plotfuqishmërisë të aktvendimit për zbatimin e hetimeve i pandehuri ka lëshuar vendbanimin e tij dhe është larguar në drejtim të panjohur, ashtu që ftesa e gjykatës nuk ka qenë e mundur t'i dorëzohet.

Me kërkesë të gjykatës organet policore e kanë gjet të pandehurin në _____, dhe ia kanë sjellë gjykatës me datë _____.

I pandehuri pa shkaqe të pa arsyeshme ka lëshuar vendbanimin e tij, dhe për te nuk ka informuar gjykatën e as prokurorinë ku janë duke u zhvilluar hetimet, dhe është gjetur nga ana e organeve policore, rrethanë e cila tregon se ai fshihet, dhe janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që në kuptim të nenit 187.par.1.nënp.1.1. dhe 1.2 të KPPK-ës, që ndaj tij të caktohet paraburgimi.

GJYKATA THEMELORE _____

PPH.nr. ___ / ___ datë _____

Procesmbajtëse,

Gjyqtari i procedurës parap

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit, në afat prej 24 orësh nga dita e marrjes së

aktvendimit.

SQARIM :Për caktimin e paraburgimit, nuk mjafton parafrazimi i dispozitës ligjore (*ps*h *supozimi se i pandehuri do ikë nëse ndodhet në liri*) por duhet të vihen në pah fakte të pakontestueshme, që e bëjnë frikën e bazuar se nëse ai ndodhet në liri do ikë. Vetëm parafrazimi i dispozitës ligjore (*vetëm në bazën e supozimeve*) vendimin përpos që e bënë juridikisht të paqëndrueshëm atë e bënë edhe arbitrare.

Formulari 40

PROPOZIMI I PROKURORIT PËR VAZHDIMIN E PARABURGIMIT NDAJ TË
PANDEHURIT
(Neni 191. KPPK-ës)

HP.nr. ___ / _____

GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE DEPARTAMENTIT PËR KRIME TË RËNDA NË

Në bazë të nenit 191.par.1.të të KPPK-ës, paraqesim këtë:

P R O P O Z I M

Që ndaj të pandehurit të vazhdohet paraburgimi edhe për 1 (një) muaj ditë.

Ndaj të pandehurit N.N. janë duke u zbatuar hetimet për shkak të veprës penale vjedhje grabitqare të parashikuar nga neni 328. par.1.të KPK-ës .

Gjatë hetimeve i pandehuri ka ikur nga vendi p pasaportë dhe ka qëndruar në botën e jashtme deri në fund të vitit _____, kur nga ana e organeve kompetente të _____i është dorëzuar vendit tonë.

Me datë _____, i pandehuri i është dorëzuar gjyqtarit të procedurës paraprake dhe pas seancës dëgjimore ndaj tij është caktuar paraburgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj ditësh.

Në vazhdim të hetimeve janë paraqitur prova të reja të cilat tregojnë se ndaj këtij të pandehuri duhet zgjeruar hetimet edhe në disa vepra penale dhe për këtë arsye kjo kërkon kohë shtesë, në çështjen e njëjtë është e nevojshme që të dëgjohen edhe 5 dëshmitar 2 nga të cilët ndërkohë kanë ndërruar vendbanimin dhe nuk ka qenë e mundur që të dëgjohen me kohë.

Duke pas parasysh se i pandehuri ilegalisht ka shkuar në botën e jashtme dhe me kërkesën e vendit tonë nga organet e Shtetit-i është dorëzuar organeve të Shtetit tonë konsiderojmë se edhe më tej ekzistojnë arsyet për paraburgim nga neni _____par.____të KPK, pasi që ekziston frika se i pandehuri nëse gjendet në liri do të ikë.

Propozoj që në bazë të nenit 191.par.1.të KPPK-ës, ndaj të pandehurit të vazhdohet paraburgimi edhe për 1 (një) muaj ditë, aç sa është e nevojshme që të përfundohet hetimi.

Më _____

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____

Formulari 41

AKTVENDIM PËR VAZHDIMIN E PARABURGIMIT (Neni 191.KPPK-ës)

PPH.nr. ____ / ____

Gjykata Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në _____, gjyqtari i procedurës paraprake N.N. me procesmbajtësin N.N. në lëndën penale ndaj të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale vjedhjes grabitqare, të parashikuar nga neni 328. par.1.të KPK-ës, i cili ndodhet në paraburgim prej datës _____, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ që ndaj të pandehurit të vazhdohet paraburgimi edhe për 1 (një) muaj ditë, me datë _____, mur:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit N.N. nga _____, i cili ndodhet në paraburgim prej _____, sipas aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake PPH.nr.____/____ datë _____, *vazhdohet paraburgimi edhe për 1 (një) muaj*, dhe do të zgjasë deri më _____.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake PPH.nr.____/____ datë _____, është caktuar paraburgimi ndaj të pandehurit për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale vjedhje grabitqare, të parashikuar nga neni 328. par.1.të KPK-ës. Paraburgimi është caktuar në bazë të nenit 187.par.1.nënp.1.1. dhe 1.2.1të KPPK-ës.

Në propozimin me shkrim për vazhdimin e paraburgimit Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në _____, ka theksuar se në afat prej 1 muaji nuk ka mund t'i përfundojë hetimet, për faktin se ndërkohë hetimi është zgjeruar edhe në drejtim të veprave tjera penale ndaj të pandehurit, si dhe për faktin se dy nga dëshmitarët e propozuar kanë ndërruar vendbanimin dhe nuk e ka njoftuar gjykatën, kështu që ata nuk kanë mundur të dëgjoen me kohë, dhe këto veprime hetimore nuk mund përfundohen para një muai.

Gjyqtari ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe propozimin e prokurorit dhe ka gjetur se propozimi është i bazuar.

Arsyet nga neni 187.par.1 nënp.1.1. dhe 1.2.1 të KPPK-ës, për të cilat është caktuar paraburgimi ekzistojnë akoma. Nga se i pandehuri u tha më sipër ilegalisht kishte shkuar në botën e jashtme dhe është gjetur me letër shtim ndërkombëtar dhe nga shteti _____ i është dorëzuar organeve tona për të zbatuar procedurën penale ndaj tij. Prokurori me propozimin e tij ka dëshmuar se nevojitet kohë për t'i përfunduar të gjitha veprimet hetimore dhe vonesat e tilla nuk mund t'i atribuohen mos punës apo neglizhencës së Prokurorit Shtetëror, ndërsa ndodhja e të pandehurit në liri do jepet mundësia që ai prapë të arratiset, siç kishte vepruar më herët.

Vazhdimi i paraburgimit në afat prej 1 (një) muaj ditësh është i domosdoshëm, me qëllim që hetimi të përmbyllet, nga se nga shkresat rezulton se përpos që duhet ndërmarrë veprime të caktuara procedurale në drejtim të veprave tjera penale, duhet dëgjuar edhe 5 dëshmitarë dhe duhet të mblidhen prova tjera materiale.

Meqenëse janë përmbush kushtet për vazhdimin e paraburgimit, gjykata në bazë të nenit 191.par.1 të KPPK-s, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE-Departamenti për Krime të Rënda

PPH.nr. _____ / _____ datë _____

Procesmbajtës,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

N.N.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në Gjyka e Apelit në afat prej 24 orësh, nga dita e marrjes së aktvendimit

Formulari 42

PROPOZIM I MBROJTËSIT PËR NDËRPRERJEN E PARABURGIMIT TË PANDEHURIT (neni 192 KPPK)

GJYKATËS THEMELORE-DEPARTAMENTIT PËR KRIME TË RËNDA NË _____

Aktvendimi i Gjyqtarit të procedurës paraprake PPH.nr. ____ / ____ datë _____, është vendosur që ndaj N.N. nga _____, për shkak të veprës penale të grabitjes të parashikuar nga neni 329.par.1. të KPK-ës, të caktohet paraburgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj ditësh në bazë të nenit 187.par.1.nënp.1.2.2 të KPPK-ës, për shkak të rrethanave që tregojnë se nëse i pandehuri ndodhet në liri do pengojë hetimet duke ndikuar në dëshmitarë.

I pandehuri ndërkohë ka pranuar veprën penale dhe ka pranuar që menjëherë t'ia kompensojë dëmin të dëmtuarit përkatësisht të paguajë në emër të sendeve të vjedhura 1.000 €, dhe e ka bërë këtë meqë vërtetohet në bazë të vërtetimit të nënshkruar nga vet i dëmtuari.

Dëshmitarët të cilët i ka propozuar prokurori janë dëgjuar me datë _____.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar se ka kryer veprën penale, pastaj se dëshmitarët e propozuar nga prokurori janë dëgjuar si dhe faktin se babai i të pandehurit ka paguar në tërësi dëmin të dëmtuarit, kanë pushuar arsyet për të cilat është urdhëruar paraburgimi nga se më nuk ekzistojnë rrethanat që tregojnë se i pandehuri do pengojë hetimet duke ndikuar në dëshmitarë.

Propozoi gjyqtari i procedurës paraprake pranë Gjykatës Themelore në _____, që të merr aktvendim në të cilën do i ndërprerë paraburgimin të pandehurit N.N. në bazë të nenit 192.par.4.nënp.4.1.të KPPK-ës.

Më _____ në _____

Mbrojtësi i të pandehurit,

N.N.

Formulari 43

AKTVENDIMI I GJYQTARIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE PËR NDËRPREJEN E PARABURGIMIT (Neni 192. KPPK-ës)

PPH.nr. ____ / ____

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në _____, Departamenti për krime të rënda N.N, me procesmbajtësen N.N: , në lëndën penale ndaj të pandehurit N.N, nga _____, për shkak të veprës penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329.par.1.të KPK-ës,

duke vendosur sipas propozimit të mbrojtësit të pandehurit për heqjen e paraburgimit me datë _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Ndërprehet paraburgimi ndaj të pandehurit N.N. nga _____, i caktuar me aktvendimin e Gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore në _____-departamenti për krime të rënda PPH.nr. ____/____ datë _____, ashtu që i pandehuri ka për tu lëshuar në liri menjëherë.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjyqtarit të procedurës paraprake PPH.nr. ____/____ datë _____, është vendosur që kundër të pandehurit N.N. nga _____, të caktuar paraburgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj ditësh për shkak të veprës penale të grabitjes , të parashikuar nga neni 329.par.1.të KPK-ës, paraburgimi është caktuar për shkak të dyshimit se me ndodhjen në liri i pandehuri mund të pengojë zhvillimin e hetimeve(*në bazë të nenit 187 .par.1.nënp.1.1.dhe 1.2.2. të KPPK-ës*).

Në mbrojtjen e tij që i pandehuri e ka dhënë me datën _____, ka pranuar se ka kryer veprën penale, ai ka deklaruar se prindi i tij ka paguar dëmin që i pandehuri i ka shkaktuar të *dëmtuarit* dhe këtë e ka dëshmuar vërtetimin të nënshkruar nga ana e të *dëmtuarit*. Dëshmitarët e propozuar janë dëgjuar nga ana e Prokurorit Shtetëror nga data _____.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____-Departamenti i Krimeve të Rënda me parashtresën PP.nr. ____/____ datë _____, është pajtuar që ndaj të pandehurit të hiqet paraburgimi.

Meqenëse kanë pushuar arsyet për të cilat ka qenë i caktuar paraburgimi, ndërsa Prokurori Shtetëror është pajtuar që paraburgimi të hiqet , në bazë të nenit 192.par.4.nënp.4.1. të KPPK-ës, është vendos si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELROE NË _____DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PPH.nr. ____/____ datë _____

Gjyqtari i procedurës paraprake,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së
aktvendimit.

Formulari 44

AKTVENDIM I GJYQTARIT PËR HEQJEN E PARABURGIMIT (Neni 193.KPPK-ës)

PDP.nr. ____ / ____

Gjyqtari i vetëm Gjykatës Themelore në _____, N.N. me bashkëpunëtorin profesional N.N, si procesmbajtës, në çështjen penale të pandehurit N.N, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.9 lidhur me par.1. të KPK-s, duke vendosur në kuptim të nenit 193.par.2.të KPPK-ës, në seancën dëgjimore të mbajtur më _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Kundër të pandehurit N.N, i cili ndodhet në paraburgim me aktvendimin e Gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate PPH.nr. ____ / ____ datë _____, hiqet paraburgimi, ashtu që i pandehuri ka për tu lëshuar në liri menjëherë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Shtetërore e Prokurorisë Themelore në _____, i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzë PP.nr. ____ / ____ datë _____, kundër të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik të parashikuar nga neni 378.par.9.lidhur me paragrafin 1. të KPK-ës.

Meqenëse i pandehuri ndodhet në paraburgim me aktvendimin e Gjyqtarit të procedurës paraprake PPH.nr. ____ / ____ datë _____, ndërsa me aktakuzë nuk është propozuar që ai të lirohet në liri , në kuptim të nenit 193.par.1.të KPPK-ës, gjyqtari detyrimisht ka vlerësuar se a qëndrojnë akoma arsyet për të cilat ndaj të akuzuarit është caktuar paraburgimi.

Paraburgimi ndaj të pandehurit është caktuar në bazë të nenit 187.par.1.nënp.1.1. dhe 1.2.2. të KPPK-s, për shkak të frikës së bazuar se me ndodhjen e tij në liri mund të pengojë hetimet duke ndikuar në dëshmitarë.

Pas marrjes së mendimit të prokurorit të shtetit , mendimin e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij , gjykata ka vlerësuar se kanë pushuar arsyet për vazhdimin e paraburgimit, ngase janë dëgjuar të gjithë dëshmitarët për të cilat ka qenë i caktuar paraburgimi.

Gjykata njëkohësisht ka shqyrtuar se mos eventualisht ekzistojnë ndonjë nga rrethanat tjera për caktimin e paraburgimit parashikuar nga neni 187.të KPPK-ës, por ka gjetur se arsyet për paraburgim nuk ekzistojnë më. I pandehuri ka vendbanimin në _____, është i martuar, baba i 5 fëmijëve, gjer më tani ka qenë i pagjykuar, ashtu që asnjë rrethanë nuk tregon se ekziston ndonjë bazë për t'ia vazhduar paraburgimin.

Meqenëse kanë pushuar arsyet për të cilat paraburgimi ka qenë i caktuar ndaj të pandehurit nga ana e Gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate, ndërsa nuk ekziston asnjë arsye tjetër për caktimin e paraburgimit , u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 193.par.3.nënp.3.1. të KPPK-s.

GJYAKTA THEMELORE në _____-Departamenti për Krime të Rënda

KP.nr. _____ / _____ datë _____

Procesmbajtësi,

N.N.

Gjyqtari,

N.N.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së

aktvendimit.

Formulari 45

AKTVENDIM PËR REFUZIMIN E KËRKESËS PËR HEQJEN E PARABURGIMIT
(Neni 192.par.2. KPPK-ës)

PPH.nr. _____ / _____

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore N.N: me procesmbajtësin N.N., në lëndën penale ndaj të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor, të

parashikuar nga neni 187.par.2.nënparagrafi 2.2. të KPK-ës, duke vendosur sipas propozimit të mbrojtësit të pandehurit për heqjen e paraburgimit, në seancën dëgjimore të mbajtur më _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar propozimi i mbrojtësit të pandehurit që ndaj të pandehurit N.N, të hiqet paraburgimi i caktuar me aktvendimin PPH.nr. ____/____ datë _____.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjyqtarit të procedurës paraprake të kësaj gjykate PPH.nr. ____/____ datë _____, ndaj të pandehurit është caktuar paraburgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj ditësh, për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë truporë, të parashikuar nga neni nga neni 187.par.2.nënparagrafi 2.2. të KPK-ës. Paraburgimi është caktuar për shkak të dyshimit të bazuar se nëse i pandehuri ndodhet në liri do të ndikojë në dëshmitarë nga neni 187.par.1.nënp.1.1.dhe 1.2.2.të KPPK-ës.

Propozimi për heqjen e paraburgimit e ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, duke theksuar se i pandehuri është i martuar, ka 3 fëmijë të mitur, ka vendbanimin e caktuar, dhe se me përjashtim të dy(2) dëshmitarëve provat tjera janë zbatuar, ka propozuar që propozimi i tij të aprovohet dhe i pandehuri të lirohet në liri.

Gjykata ka shqyrtuar shkresat e çështjes propozimin e mbrojtësit dhe ka gjetur se propozimi është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se i pandehuri nëpërmjet vëllait të tij N.N, ka tentuar që të ndikojë në dëshmitarë, dhe meqenëse në këtë çështje penale akoma nuk janë dëgjuar të gjithë dëshmitarët, nuk është evituar rreziku se i pandehuri nuk do të pengojë procedurën hetimore duke ndikuar në dëshmitarë të pa proceduar (*pa dëgjuar*), për faktin si u tha më sipër ai kishte tentuar të ndikojë në dëshmitarë përmes vëllait të tij.

Meqenëse akoma ekzistojnë arsyet për të cilat është caktuar paraburgimi në bazë të nenit 192.par.2.të KPPK-s, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE në _____

PPH.nr. ____/____ datë _____

Procesmbajtësi,

gjyqtari i procedurës paraprake,

N.N:

N.N.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën

e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së

aktvendimit.

SAQRIM:Në raste të tilla vendimi merret pa mbajtur seancë dëgjimore(*kur është e dukshme se nuk kanë pushuar arsyet për paraburgim*) , ngase sipas nenit 192.par.3 të KPPK-s, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose kryetari i gjykatës themelore mund të zbatojë seancë dëgjimore në pajtim me neni 188, paragrafët 3., 4., 5. dhe 6. të këtij Kodi nëse është e dukshme se : arsyet për paraburgim nga neni 187 i këtij Kodi që nga vendimi i fundit gjyqësor për paraburgim pushojnë së ekzistuari për shkak të ndryshimit të rrethanave ose zbulimit të fakteve të reja; ose ndalimi për ndonjë arsye tjetër është i kundërligjshëm.

Formulari 46

AKTVENDIM PËR DËNIM DISIPLINOR TË PARABURGOSURIT

(Neni 201. KPPK-ës)

PPH.nr. _____ / _____

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në _____ Departamenti për Krime të Rënda N.N. me procesmbajtësin N.N, në çështjen penale të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë, të parashikuar nga neni 178. të KPK-s, më datë _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Të paraburgosurit N.N: nga _____, për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë , parashikuar nga neni 178.të KPK-ës, i ndalohen vizitat familjare dhe korrespondenca në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit.

A r s y e t i m i

Kundër të pandehurit me aktvendimin e Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____-Departamenti për Krime të Rënda janë duke u zbatuar hetimet për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë parashikuar nga neni 178.të KPK-ës, i pandehuri ndodhet në paraburgim.

Drejtori i Burgut në _____, me parashtrësën e vet me datë _____, ka njoftuar Gjyqtarin e procedurës paraprake se i paraburgosuri N.N. ka bërë delikt disiplinor, ashtu që me rastin e vizitës nga ana e motrës së tij N.N. me datë _____, ka tentuar që t'i dorëzojë pije alkoolike të kamofluar kinse një lloj lëngu shërues për lukth. Ky lloj alkooli është marrë me rastin e dorëzimit nga ana e personit zyrtar të Qendrës së paraburgimit dhe i është bashkangjitur propozimit që ndaj të pandehurit të merren masa disiplinore në kuptim të nenit 201.par.2.nënp.2.3.të KPPK-ës.

Pas shqyrtimit të propozimit të Drejtorit të Burgut , Gjyqtari i procedurës paraprake ka vlerësuar se për shkak të shkeljes disiplinore të të paraburgosurit N.N. duhet kufizuar vizitat në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj ditë dhe korospodencën në afat prej 30 ditësh , nga se për te janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore parashikuar nga neni 201.par.2.pika 2.3. _____të KPPK-ës,

Procesmbajtësi,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Kolegjit

shqyrtues të kësaj Gjykate në afat prej 24 orësh nga dita

e marrjes së aktvendimit.

SQARIM: Kohëzgjatja e këtyre masave disiplinore, caktohet sipas rregullores së Qendrës së Paraburgimit, mirëpo masa disiplinore nuk kanë efekte ndaj vizitave ose korrespondencave me mbrojtësin, mjekët, Ombudpersonin e Kosovës, përfaqësuesit e ambasadës, zyrës ndërlidhëse ose të misionit diplomatik të shtetit, shtetas i të cilit është i paraburgosuri, ose të përfaqësuesve të organizatës kompetente në rastin e refugjatit ose të personit i cili në ndonjë mënyrë tjetër është nën mbrojtjen e asaj organizate ndërkombëtare

Formulari 47

URDHËRESË PËR KONTROLLIN E BANESËS

(Neni 105. KPPK-ës)

GJYKATA THEMLORE NË _____ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

HP.nr. ____/____

Datë _____

U R D H Ë R E S Ë

Në bazë të nenit 105.par.3.të KPPK-s, Urdhërohet kontrollimi i banesës dhe lokaleve tjera në shtëpinë e të pandehurit N.N. nga _____, Rr. _____ nr. _____.

Kontrollimi i banesës u besohet Policisë së Kosovës përkatësisht Stacionit Policor nr.3 në _____, dhe ka për të kryer sipas dispozitave të nenit 106.të KPPK-s.

Ndaj të pandehurit janë duke u zhvilluar hetimet me aktvendimin e Prokurorit Shtetërorë të Prokurorisë Themelore në _____ HP.nr. ____/____ datë _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1. të KPPK-s. Ekziston mundësia që në shtëpinë e të pandehurit të gjenden sendet që kanë qenë objekt vjedhje.

Gjyqtari i procedurës paraprake,

N.N.

SQARIM: Kontrolli kryhet vetëm me urdhër të gjykatës, përjashtimisht kontrolli mund të kryhet e dhe pa urdhër nëse: personi përkatës me dije dhe me vullnet jep pëlqimin për kontroll; personi thërret për ndihmë; kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes; arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkojnë një veprim të tillë për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejt dhe serioz për njerëzit dhe pronën; personi kundër të cilit është lëshuar urdhër arrest nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera. Në rrethana të ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve, zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore nga gjyqtari kompetent, kontrolli mund të zbatohet pa praninë e dëshmitarëve nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Policia mund të zbatojë kontrollin e personit pa urdhër

ose pa praninë e dëshmitarëve kur ekzekuton aktvendimin për sjelljen forcërisht të personit ose kur bën arrestimin e tij, nëse ekziston dyshim i bazuar se personi mban armë apo ndonjë mjet për sulm ose kur mund të mënjanojë, fshehtë apo asgjësojë sendet të cilat nga ai duhet të merren si provë në procedurë penale. Kur policia ndërmerr kontroll pa urdhër të shkruar gjyqësor, brenda afatit prej dymbëdhjetë (12) orësh pas kontrollit i dërgon raport lidhur me këtë prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për këtë çështje është caktuar ndonjë gjyqtar në mënyrë që të merret aprovimi retroaktiv gjyqësor i kontrollit, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës (neni 110 i KPPK-ës).

Formulari 48

PROCESVERBAL PËR KONTROLLIMIN E BANESËS DHE PERSONAVE (Neni 108.KPPK-ës)

P R O C E S V E R B A L

Mbi kontrollimin e banesës, lokaleve tjera dhe kontrollin personal e të pandehurit N.N. murator nga _____, Rr. ____ nr. ____.

Procesverbali është përpiluar me datë _____, nga ana e personave të autorizuar të Stacionit Policor nr. ____ nga _____, në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale vjedhjes së rëndë parashikuar nga neni 327.par.1.të KPK-s.

Të pranishëm

Personi Zyrtar i Policisë

N.N.

Inspektori i Kriminalistikës

N.N.

Procesmbajtësi

N.N.

Të pandehurët:

1. N.N.

2. N.N.

Para fillimit të kontrollit të pandehurit N.N. i është dorëzuar urdhëresa e Gjyqtarit të procedurës paraprake PPH.nr. ____/____ datë ____, dhe është ftuar që të hap të gjitha vendet e mbyllura me qëllim që të njëjtët mos të dëmtohen.

Dëshmitarit i është tërhequr vërejtja që të kujdesen se si po kryhet kontrolli dhe se kanë të drejtë të paraqesin kundërshtim në përmbajtjen e procesverbalit.

Meqenëse i pandehuri N.N. ka refuzuar që vullnetarisht të dorëzoj sendet që janë objekt të veprës penale për të cilat është dhënë urdhri për bastisje është filluar me bastisjen.

Kontrrolli ka filluar në ora _____.

Së pari është filluar me kontrollin personat të pandehurit dhe me këtë rast në gjepat e brendshme të sakos janë gjetur 3 unaza 3 gramsh nga 20 karat, sendet tjera të dyshimta me rastin e kontrollit personat të pandehurit nuk janë gjetur.

Pastaj është filluar bastisja e banesës së të pandehurit e cila përbëhet prej 1 dhomë dite 2 dhoma gjumi 1 kuzhinë 1 depo të vogël dhe 1 ballkon. Me kontrollin detal të këtyre lokaleve si dhe sendet që gjenden në këto lokale nuk janë gjetur sendet për të cilat ka të bëjë urdhëresa.

Nga udhëheqësi i rendit shtëpiak të ndërtesës që gjendet në Rr. ____nr.____, kanë mësuar se i pandehuri shfrytëzon edhe 1 lokal në podrum është vendosur që të kontrollohet edhe ky lokal, lokali në podrum ishte i mbyllur për këtë arsye është ftuar i pandehuri që ta hap atë mirëpo ai ka refuzuar hapjen duke arsyetuar se nuk e din ku është çelësi, atëherë ky lokal është hapur me dhunë pas një kontrolli të gjatë dhe të detajuar në një vend të fshehur i cili gjendet në thellësi të murit në mes të dy shtyllave të betonit është gjetur një kuti hekuri me dimensione 15x15 cm, e cila me kujdes ka qenë e ruajtur në këtë kuti janë gjetur: 3 qafore, 3 hallka dore, 10 parë vathë dhe 2 pllaka ari.

Të gjitha sendet e theksuara si a to me të cilat ka të bëjë urdhëresa po ashtu ato të cilat nuk ka të bëjë urdhëresa po që tregojnë në veprën tjetër penale për të cilat ndiqet sipas detyrës zyrtare përkohësisht janë marrë.

Të pandehurit N.N. i është dhënë vërtetimi për sendet e mara.

Bastisja ka përfunduar në ora _____.

Meqenëse procesverbalit është lexuar në zë i pandehuri dhe dëshmitarët nuk kishin vërejtje në përmbajtjen e procesverbalit përkatësisht në veprimet e personave të autorizuar të cilët kanë kryer bastisjen dhe kanë nënshkruar procesverbalin pa vërejtje.

Personat e autorizuar zyrtar,

N.N.

I pandehuri,

N.N.

Dëshmitarët,

N.N.

Formulari 49

URDHËRESA PËR MARRJEN E PËRKOHSHME TË SENDEVE

(Neni 112.KPPK-ës)

PPH.nr. ____/____

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në ____-Departamenti për Krime të Rënda , N.N, me procesmbajtësin N.N, në lëndën penale të pandehurit N.N. nga ____ për shkak të veprës penale vrasjes në tentativë, të parashikuar nga neni 178 të KPK-ës, më datë____, jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

Nga i baba i të pandehurit N.N. nga _____, përkohësisht merret revolja e markës ____ kal. ____ dhe e njëjta dorëzohet në depoizitën e kësaj gjykate në ruajtje deri në përfundim të procedurës penale.

Këtë urdhëresë do ta zbatojë punëtorët e autorizuar të policisë së Kosovës , nga stacioni nr. _____, në _____ dhe për marrjen e sendit duhet që pronarit t'i lëshoj vërtetim.

Nëse N.N. e refuzon ta dorëzoj revolen do të dënohet me gjobë dhe në shumë prej _____,

A r s y e t i m

Pranë Prokurorisë Themelore në ____-Departamenti për Krime të Rënda janë duke udhëhequr hetimet kundër të pandehurit N.N, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë parashikuar nga neni 178. të KPK.

Në mbrojtjen e tij në procesverbal e datës _____, i pandehuri ka deklaruar se revolja me të cilën ka shtënë në të dëmtuarin N.N. është pronë e babit të tij dhe pas ngjarjes atë ia ka dorëzuar pronarit.

Sipas nenit 112.par.1.të KPPK-ës, sendet të cilat sipas Kodit Penal duhet merren ose të cilët mund të shërbejnë si prova në procedurë penale përkohësisht merren dhe i dorëzohen në ruajtje gjykatës. Në rastin konkret i pandehuri ka pranuar se revolja e markës _____ është pronë e babit të tij dhe me këtë revole ka shtënë në të dëmtuarin N.N. me qëllim që ta privojë nga jeta, andaj ky send mund të shërbej si provë në procedurën penale ,për këtë arsye sipas vlerësimit të kësaj gjykate ekziston baza ligjore për dhënien e urdhrit për marrjen e përkohshme të sendit.

Me nenin 112.par. 11.të KPPK-ës, është parashikuar se personat të cilët refuzojnë të dorëzojnë sendet mund të dënohen me dënim gjobë në shumë prej 50% të vlerës së sendit , andaj kjo mundësi i është vënë në dukje personit me këtë urdhëresë.

Procesmbajtësi,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

N.N:

N.N.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër kësaj urdhërese nuk lejohet ankesa.

Formulari 50

URDHËRESA E GJYQTARIT PROCEDURËS PARAPRAKE PËR MBAJTJEN E LETRËS, TELEGRAMIT DHE DËRGESAVE TJERA

(Neni 112. KPPK-ës)

PPH.nr. ____ / ____

Gjyqtari i procedurës paraprake N.N i Gjykatës Themelore në _____-Departamenti për Krime të Rënda, në lëndën penale ndaj të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale të krimit të organizuar të parashikuar nga neni 283.par.1.të KPK-s, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____-Departamenti për Krime të Rënda PP.nr. ____ / ____ datë _____, më datë _____, jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

Kompania PTK në _____, është e detyruar që pas marrjes së kësaj urdhërese e gjer në vendimin tjetër të gjykatës të mbajë dhe dorëzojë Gjyqtarit të procedurës paraprake letrat, telegramet dhe dërgesat tjera të cilat i adresohen N.N. tregtar nga _____, i cili përgjigjet për veprën penale të krimit të organizuar, të parashikuar nga neni 283.par.1.të KPK-s.

Urdhëresa jepet për arsye se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, në kuadër të një grupi të strukturuar i cili është i shtrirë në disa shtete, prandaj me bazë mund të pritet që dërgesat të cilat do të mbahen do të shërbejnë si provë në procedurë penale.

Gjyqtari i procedurës paraprake,

N.N.

Formulari 51

PROCESVERBAL MBI MARRJEN NË PYETJE TË PANDEHURIN (Neni 152. KPPK-ës)

HP.nr. ___/___

P R O C E S V E R B A L

Përpiluar më _____, pranë Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ - Departamenti për Krime të Rënda në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë parashikuar nga neni 327.par.1.nënp.1.1. të KPK-s.

Të pranishëm:

Procesmbajtësi,

I pandehuri,

N.N.

Mbrojtësi,

Ka filluar në ora _____

I pandehuri për vete jep këto të dhëna: N.N. i quajtur “Malok” nga babai N.N. nëna N.N. e lindur N. i lindur në _____ ku dhe jeton , i lindur më datë _____, Shqiptuar Shtetas i Kosovës, pa profesion i pamartuar ka të kryer shkollën fillore gjendje të varfër ekonomike i gjykuar edhe më herët për vepër penale të vjedhjes nuk zhvillohen hetimet për ndonjë vepër tjetër penale.

I pandehuri para Prokurorit Shtetëror ka ardhur së bashku me mbrojtësin e tij i cili ka dorëzuar autorizimin dhe prezanton në marrjen në pyetje të tij. Më pas të pandehurit i është bërë me dije se për çka dyshohet dhe dyshimi i bazuar se ekziston ndaj tij, dhe në kuptim të nenit 152.par.3.nënp.3.3. KPPK-ës, është njoftuar se nuk është i detyruar të paraqes mbrojtjen e tij e as të përgjigjet në pyetje që do t'i parashtrohen.

Pas njoftimeve të paraqitura më lart i pandehuri në mbrojtjen e tij deklaron: jam i njoftuar nga aktvendimi për zhvillimin e hetimeve se për çfarë pandehem dhe dyshimi i bazuar që ekziston ndaj meje, jam njoftuar se nuk kam obligim të paraqes mbrojtjen e as të përgjigjen në pyetjet e parashtruara gjithashtu jam i informuar se mund të kem mbrojtës i cili mund të prezantoj në marrjen time në pyetje.

Jam i lindur më _____, në _____, ku dhe jetoj. Prindërit e mi janë të papunësuar jetoj në _____ një banesë e cila përbëhet prej 3 dhomave prindërit e mi kanë 4 fëmijë dhe atë 3 vajza dhe 1 djalë. Unë jam fëmiju më i madh i familjes ndërsa fëmiju më i vogël është vëllai im N. i cili ka 5 vjet. Nuk kemi kurrfarë pasurie pos banesës ku jetoj, familja mbahet nga puna e kohëpaskohshme të cilën e bënë babai si punëtor fizik në ndërtimtari.

Unë kamë përfunduar shkollën fillore mirëpo shkollimin e mëtejshëm nuk kam vazhduar, nga se nuk kam poseduar mjete për të blerë libra, pas braktisjes së shkollës kohë pas kohe jam marrë me shitjen e hekurinave që i kam mbledh nëpër mbeturina.

Më herët sa kam qenë i mitur, ndaj meje është zhvilluar procedurë penale për shkak të veprës penale të vjedhjes, dhe më është shqiptuar masa edukuese e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e organit të kujdestarisë.

Me datë _____, isha me vëllain tim N. dhe shokët N.N. dhe N.N. meqenëse nuk kishim para për të shkuar në diskotekë u morëm vesh që të thyejmë me dhunë derën e marketit i cili ndodhet në _____ Rr. ____ ngase kemi menduar se atje mund të gjejmë para. Ia kemi arritur që me një shufër metalike të hapim derën dhe pas kontrollimit të sirtarëve në kasë kemi gjetur para të imta diku afër 100 €, e më pastaj nga marketi kemi marrë edhe disa pako cigare, çokollata, bonbone dhe kemi ikur nga lokali.

Unë jam përcaktuar për veprime të tilla kriminale i shtyrë nga gjendja e varfër ekonomike nga se prindërit e mi janë të gjendjes së varfër ekonomike dhe nuk kemi kurrfarë burime materiale për ekzistencë, lajmërohem rregullisht në Qendrën e Punësimit rajonale në _____ mirëpo nuk kam pasur mundësi që të punësohem.

Pranoj në tërësi kryerjen e veprës penale, jam penduar për këtë, por lus gjykatën që të ketë parasysh se veprën penale e kam kryer për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike.

Procesverbalin e nënshkruar pa vërejtje.

Ka përfunduar në ora _____

Procesmbajtësi,

Prokurori Shtetëror

N.N.

N.N.

I pandehuri N.N.

Formulari 52

PROCESVERBAL MBI DËGJIMIN E DËSHMITARIT

(Neni 132. KPPK-ës)

P R O C E S V E R B A L

Përpiluar më _____, pranë Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ - Departamenti për Krime të Rënda në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N. nga _____, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1. nënp. 1.1.të të KPK-s.

Të pranishëm:

Procesmbajtësi,

I pandehuri,

N.N.

Mbrojtësi,

N.N.

Dëshmitari,

N.N.

Ka filluar në ora _____

Dëshmitarit i është tërhequr vërejtja se është i detyruar të flasë të vërtetën dhe nuk guxon të heshtë asgjë, i është tërhequr vërejtja se dhënia e dëshmisë së rrejshme është vepër penale, si dhe nuk është i detyruar të përgjigjet në pyetjet me të cilat përgjigje veten ose anëtarët e familjes së tij i sjellë para turpit të madh, dëmit material ose ndjekjes penale. Pastaj nga dëshmitari janë marrë të dhënat personale:

N.N. nga babai N.N. me profesion taksist me vendbanim në _____Rr.____nr.____ i lindur më _____, nuk është në relacionin farefisnore me të pandehurin. Dëshmitarit i është tërhequr vërejtja se është i detyruar që për çdo ndërrim të adresës ta informojë gjykatën.

Më pas dëshmitari është thirr që të paraqes krejt atë që din për këtë çështje penale, pastaj ai deklaroi si më poshtë:

Unë jam taksist i punësuar në kompaninë “Roberti” në _____, më datë _____ isha duke u kthyer për në shtëpi në rrugën dytësore _____, por meqë pata një defekt të shkurtër në automobil isha skajuar skaj rrugës dhe po tentoja ta riparojë ora ka qenë _____, në një moment kam vërejtur se në marketin i cili gjendet afër janë fikur dritat e brendshme dhe kjo ma ka tërhequr vëmendjen për faktin se zakonisht në lokale të tilla dritat qëndrojnë të ndezura tërë natën dhe jam përqendruar në drejtim të këtij marketi aty kam vërejtur se kohë pas kohe është ndezur një qiri diku pas 10 minutave kam vërejtur ku nga ai lokal me disa sende në dorë kanë dal 3 persona që të tret kanë qenë të pamaskuar veçmas vëmendjen ma ka tërhequr njëri i cili ishte i gjatë dhe i dobët me shëndet kishte një mjekër karakteristike dhe sikur çalonte nga pak. Meqenëse si taksist posedoj numrat e telefonave kujdestar të policisë kam ftuar në kujdestarinë e policisë dhe ju kam treguar për rastin për një kohë shumë të shkurtër kanë ardhur organet policore më pas edhe Prokuroria dhe kanë bërë shikimin në vendin e ngjarjes unë ju kam përshkruar përafërsisht pamjen e personave që i kam vërejtur ditën kritike.

Pas disa ditësh unë jam ftuar në Stacionin Policor nr.____ dhe aty më janë paraqitur disa persona ku në mesin e tyre kam identifikuar njërin nga ata persona të cilin e kam përshkruar në organet policore tani të pandehurin N.N.

Kjo është deklarata ime nuk di se kush kanë qenë personat tjerë dhe nuk di se çfarë kanë marrë nga ai minimarket por e di se natën kritike në market ishin ndal dritat nga ai market kishin dalë 3 persona me disa sende në dorë e në mesin e tyre ishte tani këtu i pandehuri.

Mbrojtësi dhe i pandehuri nuk kanë pyetje.

Diktimi i procesverbalit është bërë me zë dhe në te janë shënuar të gjitha ato që dëshmitari i ka deklaruar andaj të njëjtin e nënshkruan pa vërejtje.

Ka përfunduar në ora _____

Dëshmitari N.N.

Procesmbajtësi,

N.N.

Prokurori Shtetëror,

N.N

Formulari 53

AKTVENDIM PËR DËNIMIN E DËSHMITARIT

(Neni 135 KPPK-ës)

PPH.nr. ____ / ____

Gjyqtari i procedurës paraprake N.N.i Gjykatës Themelore në _____-Departamenti për Krime të Rënda, me procesmbajtësin N.N. në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale të vjedhjes grabitqare parashikuar nga neni ____ të KPK-ës, me datë _____, mori :

A K T V E N D I M

Dëshmitari N.N. nga _____, dënohet me dënim me gjobë në shumë prej _____, të cilën është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

A r s y e t i m

Pranë Prokurorisë Themelore në _____ Departamenti për Krime të Rënda janë duke u zhvilluar hetimet ndaj të pandehurit N.N. për shkak të veprës penale vjedhje grabitqare parashikuar nga neni _____ të KPK-ës.

Për datën _____, është caktuar dëgjimi i dëshmitarëve, në mesin e të cilëve edhe dëshmitari N.N. i cili ftesën e ka marrë me rregull dhe me kohë, mirëpo nuk është paraqitur në gjykatë dhe nuk ka arsyetuar mungesën e tij. Prokurori Shtetëror i është drejtuar Gjyqtarit të procedurës paraprake që ndaj këtij dëshmitari të shqiptojë dënimin në kuptim të nenit 135 të KPPK-ës.

Gjyqtari i procedurës paraprake pas shqyrtimit të shkresave të çështjes ka gjetur se janë përmbushur kushtet për aplikimin e dispozitave të nenit 135. Par.1 të KPPK-ës, andaj dëshmitarin e ka gjykuar me dënim me gjobë si në dispozitiv.

Procesmbajtësi,

N.N.

Gjyqtari i procedurës paraprake,

N.N:

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 54

PROCESVERBAL PËR KËQYRJEN E VENDIT TË NGJARRJES

(Neni 150.KPPK-ës)

PN.nr. ____/ ____

Procesverbal për këqyrjen e vendit të ngjarjes.

I përpiluar nga ana e Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ - Departamenti për Krime të Rënda më datë _____, në rastin e aksidentit të trafikut publik i cili ka ngjarë në rrugën regjionale _____ në _____.

Të pranishëm.

Prokurori Shtetëror,

N.N.

Procesmbajtësi,

I pandehuri NN

Mbrojtësi,

Tekniku i Kriminalistikës,

N.N.

Ka filluar në ora ____.

Shërbimi kujdestar i Stacionit Policor në _____ Departamenti i trafikut ka informuar Prokurorin Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ Departamenti për Krime të Rënda se në fshatin _____ në rrugën regjionale _____, rreth orës _____, ka ngjarë një aksident trafiku ku disa persona kanë pësuar lëndime trupore dhe janë shkaktuar dëme të mëdha materiale.

Prokurori Shtetëror menjëherë ka dal në vendin e ngjarjes për të kryer këqyrjen.

Në vendin e ngjarjes janë gjetur punëtorët e stacionit policor në _____, të cilët kishin siguruar vendin e ngjarjes.

Në këtë aksident trafiku kanë marrë pjesë mjeti automobilistik i markës “Mercedes” me tabela të regjistrimit _____ të cilin e ka drejtuar shoferi N.N. i cili posedon patentë shoferin nr. _____ lëshuar nga MPB, në _____ me datë _____, me B kategorinë dhe mjeti automobilistik i markës “Passat” me tabela të regjistrimit _____ të cilin e ka drejtuar shoferi N.N. me patentë shofer nr. _____ lëshuar nga MPB në _____, me kategori A,B,C.

Përshkrimi i vendit të ngjarjes.

Aksident trafiku ka ngjarë në fshatin _____, në rrugën regjionale Prishtinë -Pejë, 200 m. nga kryqëzimi i rrugës N.N. Rruga është e gjerë 10 metra e mbuluar me asfalt të kualitetit të mirë i rrafshët e dukshme. Nëpërmes të rrugës ekziston vija e bardhë me ndërprerje. Dy anët e rrugës ekzistojnë bankina në gjatësi prej 50 centimetra. Në këtë pjesë të rrugës nuk ekzistojnë shenjat e kufizimit të shpejtësisë e as shenja tjera ndalimit kufizimit apo informimit.

Kushtet atmosferike në momentin e aksidentit

Koha është e vranët asfalti i lagët dhe pjesërisht i mbuluar me zhavorr i sjell nga lumi afër ku eksplatohen inertet.

Sipas deklarimit të punëtorëve policor N.N. , N.N, dhe N.N. si dhe të pranishmëve të tjerë në kohën e ndeshjes po binte një shi i imët.

Si dhe në çfarë pozicioni janë gjetur mjetet e përfshira në aksident

Në anën e djathtë të rrugës shikuar në drejtim të _____, është gjetur qerrja tërheqëse e ngarkuar me tërfojë e cila pjesërisht ka qenë e derdhur – shpërndarë nëpër pjesën e djathtë të rrugës në një gjatësi prej 20 metrash. Pozicioni i qerres ishte si vijon: pjesa e përparme 10 cm, nga vija e bardhë, ndërsa pjesa e pasme 40 cm, nga vija e bardhë. Nga cepi i djathtë i shiritit rrugor qerrja ishte larg nga pjesa e djathtë ballore prej 2.90 m, ndërsa në pjesën e përparme 2.44 m, nga pjesa e pasme e qerres janë të dukshme gjurmët e lëvizjes së qerres nëpër rrugën e lagësht dhe pjesërisht me zhavorr, dhe shkojnë në gjatësi prej 23,60 m.

Në gjysmën e anës së majtë të shiritit rrugor shikuar në drejtim të _____, 17,80 m, para qerres tërheqëse gjendet vetura e markës “Mercedes” dhe veturës “Passat”. Vetura e markës “Mercedes” është e kthyer në drejtim të _____, ashtu që pjesa e djathtë ballore në lartësinë e rrotave gjendet në distancë prej 1,25 m, nga vija e mesme ndërsa niveli i rrotave të pasme në distancë prej 0,70 m, nga vija e mesme. Gjurmët e frenimit të këtij mjeti fillojnë në anën e djathtë të rrugës , 6 m, pas qerres tërheqëse dhe lehtas kalojnë në shiritin e majtë dhe përfundojnë në distancës prej 17,80 m, përpara qerres tërheqëse. Në fillim frenimi ishte i intensitetit të mesëm në gjatësi prej 4,30 m, pastaj të intensitetit të fuqishëm me bartje në anën e majtë në gjatësi prej 20 m, në të cilin vend ka ardhur gjer te kontakti me automjetin “Passat” i cili ka lëvizur në drejtimin e kundërt.

Vetura “Passat” në pjesën e përparme është e drejtuar në drejtim të _____, dhe në pjesën e përparme ka kaluar nga shirit rrugor në bankinë, ndërsa pjesën e pasme në nivelin e rrotave të pasme është larg nga këndi i majtë i shiritit rrugor shikuar në drejtim të _____, për 0,50 cm. Gjurmët e frenimit të këtij mjeti fillojnë në distancë prej 70 m, para vendit në të cilin automjetet janë ndeshur, gjurmët janë të dukshme në fillim të intensiteti të dobët gjatësi prej 12 m, intensitetit të mesëm në gjatësi prej 20 m, dhe intensitetit të fuqishëm në gjatësi prej 35 m. Gjurmët shkojnë mesit të anës së majtë të shiritit rrugor me një kthim gradual në anën e djathtë të shiritit rrugor, në drejtim të lëvizjes së automjetit (për_____). Nga vendi i kontaktit të këtyre automjeteve për 10 m, në drejtim të _____, ekziston shenjat e bartjes së automjetit kah bankina e djathtë ku automjeti edhe është ndalur.

Gjurmët e konstatuara me rastin e këqyrjes

Në vendin ku është ardhur deri tek kontakti i këtyre automjeteve janë të dukshme gjurmët e gjakut si dhe në pjesën e përparme të automjetit “Mercedes” në një sipërfaqe prej 5 m2, gjenden pjesët e shkapërderdhura të xhamave të thyer mbrojtësi i përparmë korniza e dritave si dhe llajsnet anësore të automjetit “Passat”.

Dëmtimet e automjeteve.

Automjetet në masë të mjaftueshme janë të dëmtuar. Qerrja është dëmtuar në pjesën ballore të majtë mbrapa janë nxjerr dërrasat dhe pjesërisht janë dëmtuar. Në Dërrasat vërehen gjurmët e ngjyrës së automjetit “Mercedes”. Automjeti “Mercedes” është dëmtuar ju janë thyer dritat , mbrojtësi i djathtë i bartjes në pjesën e përparme automjeti plotësisht është deformuar, ftohësi është shtypur, motori është lëviz në pjesën e brendshme të mjetit, mbrojtësi i përparmë i erës (shofershajbnja) është thyer, dera e djathtë e deformuar. Automjeti “Passat” në pjesën e përparme është shtypur, drita e majtë e përparme është thyer, kapaku i motorit ka dalur nga foleja , xhami mbrojtës nga era i përparmë është thyer, mbrojtësi i majtë nga balta është dredhuar në drejtim të rrotës së përparme të majtë, ashtu që rrota nuk mund të lëviz.

Personat e lënduar.

Shoferët e dy automjeteve kanë pësuar lëndime të lehta trupore dhe nuk kanë kërkuar ndihmë mjekësore.

Udhëtari nga automjeti “Mercedes” N.N. e cila ka qenë në ulësen e përparme ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe urgjentë është përcjell në QKUK. Udhëtarët në automjetin “Passat” N.N. dhe N.N, kanë pësuar lëndime të lehta trupore dhe të njëjtit janë dërguar në Qendrën Klinike për Trajtim Mjekësor.

Vërejtjet dhe konstatimet tjera:

Vendi i ngjarjes është fotografuar është skicuar nga ana e Kriminalistikës së teknikës N.N. Fotodokumentacioni dhe skica në vend të ngjarjes përbëjnë pjesë përbërëse të këtij procesverbali.

Shoferët e mjeteve automobilistike nuk tregojnë shenja të përdorimit të alkoolit, ndërsa te drejtuesi i qerres tërheqëse N.N. shenjat të tij janë të dukshme. Është dhënë urdhër që nga shoferët të merret gjaku me qëllim të verifikimit se a thua te ndonjëri nga këta ekziston prezenca e alkoolit dhe në çfarë shkalle.

Mjetet automobilistike janë dërguar në Qendrën për kontroll teknik, me qëllim të vërtetimit të gjendjes teknike të tyre.

Në vendin e ngjarjes janë hasur edhe dëshmitarët N.N. N.N, dhe N.N. të cilët mund të kenë njohuri lidhur me te se si ka ardhur deri te aksidenti i komunikacionit.

Këqyrja ka përfunduar në ora _____

Procesmbajtësja, Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore,

Formulari 55

PROCESVERBAL PËR REKONSTRUIMIN E VENDIT TË NGJARJES
(Neni 150 KPPK)

P.nr.120/2013

PROCESVERBAL

PËR REKONSTRUIMIN E VENDIT TË NGJARJE

I përpiluar nga ana e gjyqtarit të vetëm të Gjykatës Themelore në _____ datë 15.7.2013, në çështjen penale e të akuzuarit S.S. për shkak të veprës penale kundër trafikut publik parashikuar nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 1 të KPK-së.

Të pranishëm janë

Gjyqtari

S/S/

Procesmbajtësi

H.K.

Prokurori Shtetëror

B.B.

I akuzuari

S.S.

Mbrojtësi

B.K.

Tekniku i kriminalistikës

A.A.

Ka filluar në ora 22:00

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.7.2013 gjykata ka vendosur që të bëjë rekonstruimin e vendit të ngjarjes. Rekonstruimi i vendit të ngjarjes është bërë me qëllim të verifikimit të mbrojtësit të akuzuarit, ngase ai në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ditën kritike udhëtonte nga _____ për në _____ diku rreth orës 22:00 të natës, me të ardhur në fshatin _____ përballë rrugës regjionale kalon edhe një rrugë fushore dhe në atë moment lëvizte një traktor në drejtim të tij me drita të ndezura dhe ai ka menduar se mjeti që po i vinte nga drejtimi i kundërt po lëvizte në shiritin e tij të rrugës dhe për këtë arsye ai me të shpejtë është kthyer në anën e tij të majtë, ka humbur kontrollin mbi makinën dhe e ka goditur një plep i cili ndodhet për skaj rrugës.

Rekonstrukcionit të ngjarjes prezantojnë të gjithë personat e ftuar.

Ngjarja ka ndodhur në rrugën regjionale _____ në fshatin _____, 20 metra larg nga shtylla elektrike nr. 36 e cila ndodhet për skaj rrugës shikuar në drejtim të lëvizjes së automjetit përkatësisht në drejtim të Gjilanit.

Vendi i ngjarjes sipas dukjes është identik me atë që është përshkruar në procesverbalin për këqyrjen të përpiluar nga ana e Prokurorit të shtetit më datë 15 qershor 2013. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk kontestojnë të dhënat nga procesverbali për këqyrjen e vendit të ngjarjes dhe pajtohen se të dhënat në të që kanë të bëjnë me vendin ku është zhvilluar ngjarja, koha, gjendjen në trafik-rrugë, gjurmët në rrugë dhe shenjat e trafikut janë me korrektësi të shkruar. Më pas ka filluar rekonstruimi i vendit të ngjarjes.

Është siguruar makina e markës “BMË 3” e cila ka marrë pjesë në këtë aksion të komunikacionit dhe traktori i markës “Ferguson” pronë e B.B. nga _____.

Teknikut të kriminalistikës i është urdhëruar që të përpilojë skicën e vendit të ngjarjes dhe të fotografijve sequenca të caktuara të rekonstruimit të vendit të ngjarjes të cilat i përcakton gjyqtari.

I pandehuri deklaron se kushtet kohore sa i përket dukshmërisë rrethanave atmosferike janë të ngjashme me ato që ekzistonin në kohën e aksidentit. Koha është e vërejtur ndërsa asfalti i terur. Në vendin ku është shkaktuar aksidenti ekziston një kthesë e butë ndërsa në dy anët e rrugës për skaj bankinave ekzistojnë drunjtë plepash, përballë rrugës së asfaltuar përkatësisht paralel me rrugën e asfaltuar ekziston edhe një rrugë e pa kategorizuar që lëvizin mjetet e ndryshme për të shkuar në fusha. Niveli i kësaj rrugës dytësore është përafërsisht i njëjtë me nivelin e rrugës së asfaltuar. Këto detaje janë të skicuara dhe të fotografuara (*fotografimi nr. 1*).

Të akuzuarit i është lënë në dispozicion mjeti automobilistik në të cilin përpos tij janë ulur gjyqtari, Prokurori Shtetëror dhe mbrojtësi i të akuzuarit. Pronarit të traktorit i është dhënë urdhër që në një distancë prej 120 metrash para vendit ku është shkaktuar aksidenti që në shenjë fishkëllimi ta vejë traktorin në lëvizje dhe t’i kyç dritat.

Teknikut të kriminalistikës i është urdhëruar që saktësisht në ora 22:00 e 15 minuta të jep shenjë për kalimin e traktorit dhe mjetit automobilistik.

Në sinjalin e dhënë janë vënë në lëvizje dy mjetet automobili “BMW X3”.dhe traktori.Distanca në mes të mjetit automobilistik dhe traktorit ka qenë 120 metra. Deri te anashkalimi mes mjetit automobilistik dhe traktorit ka ardhur në 10 metra distancë pas daljes nga trungut të plepit, i shënuar me nr. 3 (fotografia nr. 2).

Nga paraqitja e traktorit dhe deri te anashkalimi me mjetin automobilistik është vështirë që të vërehet dallimi mes nivelit të rrugës së asfaltuar dhe nivelin e rrugës të pa kategorizuar (rrugës fushore), ashtu që lehet përshtypja se edhe rruga fushore është pjesë e rrugës së asfaltuar.

I akuzuari deklaron se përsëritja e situatës përkatësisht momentit të ballafaqimit të mjetit automobilistik dhe traktorit, i përgjigjet kushteve në të cilat ka ndodhur ngjarja përkatësisht aksidenti.

Palët nuk kanë propozime tjera që të procedohet dhe sqarohet edhe ndonjë rrethanë nëpërmjet të rekonstruimit të ngjarjes.

Rekonstruimi i ngjarjes ka përfunduar në ora 22:50 minuta.

Procesmbajtësi,

H.K.

Gjyqtari

S.S.

Formulari 56

URDHËRESA PËR EKSPERTIM DHE ÇAKTIMI I EKSPERTIT
(Neni 136 i KPPK-s)

PP.nr. _____/2006

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore N.F. në çështjen penale e të pandehurit S.B. nga _____, për shkak të veprës penale të mashtrimit, të parashikuar nga neni 335. par. 2 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit publik të Prokurorisë Komunale në _____ më datë _____, mur këtë:

U R D H Ë R E S Ë S

I. Që të kryhet ekspertiza nga ana e ekspertit të ndërtimtarisë me qëllim të vërtetimit se në çfarë sasive dhe në çfarë standarde janë kryer punët në objektet si në vijim:

1.Objekti në Rr. “Tefik Çanga” nr. 15/3.

-a është ndërtuar pllaka e betonit (baza), sipas projektit;

-a janë ndërtuar sipas projekteve dhe standardeve shtyllat kryesore mbajtëse të katit përdhes;

2.Objekti në Rr. “Heronjtë e Kombit” nr. 10.

-në lokal a janë vendosur raftet dhe dimensionet e tyre a i përgjigjen parametrave nga kontrata lidhur më _____.

-a janë ndërtuar tavolina për mbajtjen e bukës me sirtarë dhe ndarës;

-a është vendosur korniza me 20 fole ndarëse për mbajtjen e mishit të thatë;

3.Objekti në Rr. “Hajdar Dushi” nr. 25/3.

-a është kryer nivelizimi i lokalit sipas projektit;

-a është ndërtuar dollapi për gardërobë.

4.Objekti në Rr. “Komuna e Parisit” nr. 13.

-a është ndërtuar instalimi elektrik për rrymë trefazore me standarde përkatëse.

-a është ndërtuar instalimi i ujit dhe kanalizimit sipas kontratës për ndërtim.

Për punët të cilat nuk janë kryer është e nevojshme të përcaktohet vlera para llogaritare.

II.Ekspertizën do ta kryejë eksperti H.H. nga _____, rr.

“_____”, nr. _____, i cili është i obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së urdhërësës, kësaj Gjykate t’i dorëzojë vendimin dhe konstatimin me shkrim.

III. Me rastin e ekspertimit i pandehuri duhet të jetë i pranishëm.

IV. Urdhëresa t’i dorëzohet ekspertit dhe palëve.

Gjyqtari i procedurës paraprake , N.F.

Formulari 57

URDHËRESA PËR EKSPERTIM ME RASTIN E AKSIDENTIT NË TRAFIK

PP.nr.78/

Prokurori i Prokurorisë Themelore në _____, A,K me sekretaren juridike F.S_____, në lëndën penale kundër të pandehurit M.B._____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.6 lidhur me par.1 të KPK-ës, në mbështetje të nenit 137 par. 1 të KPPK-ës, më dt. 10.12._____, lëshoi këtë;

URDHËRESË

Që të bëhet ekspertimi i komunikacionit (ekspertiza) nga eksperti i komunikacionit ing. I.B, mbi shkaqet e aksidentit të trafikut që ka ndodhur më dt. 16.04.2008, rreth orës 10,00, në _____ përballë pompës së derivateve “Ferizi Petroll, me ç’ rast nga pasojat e këtij aksidenti ka vdekur tani i ndjeri S.K. nga fsh. _____.

Me anë të ekspertizës të konstatohet ;

- me lëshimet e kujt ka ndodhur aksidenti me pasoja fatale,
- gjendjen e automjetit të udhëtarëve,
- gjendja në rrugë (*kushtet e rrugës*),
- kontributi i faktorit njeri dhe faktorit rrugë, në shkaktimin e aksidentit dhe,
- të gjitha faktet tjera (*rrethanat tjera*) që kanë kontribuar në shkaktimin e aksidentit.

Eksperti ka për obligim që lëndën e ekspertimit ta shqyrtoj me kujdes , të paraqesë me saktësi gjithçka që vëren dhe konstaton .Mendimin dhe konstatimin e tij ta parashtrojë objektivisht dhe në pajtim me rregullat e shkencës dhe të profesionalizmit .Eksperti është paralajmëruar se dhënia e deklaramit të rremë paraqet vepër penale .

Mendimin dhe konstatimin e tij lidhur me këtë çështje penale, eksperti duhet ta dorëzoj në prokurorisë në afat prej një (1) muaji nga dita e marrjes së urdhërësës.

SHTOJÇË : Procesverbali mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes, foto dokumentacioni , skicimi i vendit të ngjarjes i përpiluar nga tekniku i kriminalistikës , raporti për kontrollin teknik të automjetit , janë pjesë përbërëse e kësaj urdhërese.

Me këtë urdhëresë duhet të njoftohet eksperti dhe palët.

PROKURORI I PROKURORISË THEMELORE NË _____

Më dt. 10.12. _____.

Procesmbajtësja,
F. S.

Prokurori,
I. D.

Formulari 58

URDHËRESË PËR KONTROLLIMIN E BANESËS

(NENI 105. KPPK-ës)

Hpn.nr. ____/

Gjykata Themelore në _____, gjyqtari i procedurës paraprake S.S. duke vendosur sipas kërkesës së Prokurorit Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____, më datë _____, për kontrollin e shtëpisë , lokaleve dhe pronës së PP, nga _____, Komuna e _____, më _____, konform nenit 105.par.4.të KPPK-ës, jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

Urdhërohet kontrollimi i shtëpisë , objekteve ndihmëse dhe pronës së PP, nga _____, rruga _____nr. 42, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se i përmenduri merret me shitjen e mjeteve psikotropike, dhe kjo rrethanë është konfirmuar nga masat e fshehta të cilat kanë qenë të urdhëruar ndaj këtij personi. Arsye e këtij kontrollimi është që te personi i apostrofuar përkatësisht në shtëpinë e tij do të gjendet mjete psikotropike që do të shërbejnë si prova në procedurën e mëtejme penale .

Këtë urdhëresë do ta zbatojë policia gjyqësore në afat prej 48.orëve nga lëshimi i urdhrit.

Procesmbajtësja,

Gjyqtari i procedurës paraprake,

Formulari 59

RAPORTI I EKSPERTIT LIDHUR ME EKSPERTIZËN E KRYER

(Neni 138 i KPK-së)

Gjykatës Themelore – Departamentit për Krime të Rënda _____

Meqenëse janë paraqitur dyshime në llogaritshmërinë e të pandehurit, gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, me urdhëresën Ppr.nr. 50/2012 datë 10.7.2012, të pandehurin F.Z. punëtor nga fsh.M komuna M, i lindur më _____, nga i ati P, nëna N. e lindur H. E ka dërguar në observim psikiatrik, me qëllim të vlerësimit të përgjegjshmërisë (llogaritshmërisë) së tij, në kohën e kryerjes së veprës penale.

Me këtë rast në institucionin ndëshkues korrektues – në Spitalin Psikiatrik në Prishtinë, nga drejtoria e spitalit janë caktuar ekspertët përkatësisht mjekët ; Dr. N.N. , M.M. dhe F.F. me detyrë që bëjnë observimin, kontrollimin-ekzaminimin psikiatrik e të pandehurit dhe të japin mendimin dhe konstatimin e tyre përkitazi me gjendjen e tij shpirtërore në kohën e kryerjes së veprës penale.

Ekspertët kanë shqyrtuar shkresat gjyqësore – dosjet gjyqësore, kanë kryer kontrollin e nevojshëm psikiatrik ndaj të pandehurit F.Z. kanë siguruar, hulumtime plotësuese klinike, kanë bërë observimin e sjelljes së të pandehurit në rrethin spitalor dhe në bazë të gjitha këtyre :

KONSTATOJMË

I. Nga shkresat e çështjes gjyqësore shihet se ndaj të pandehurit F.Z. është ushtruar kërkesë për fillimin e hetimeve:

“Ngase ekziston dyshimi i bazuar se më datë _____ rreth orës 8:00 në fshatin _____, afër trafo stacionit të fshatit ka tentuar të privoi nga jeta L.L. dhe me atë me dashje ka vënë në rrezik edhe jetën e Z.K. dhe Sh.T. në atë mënyrë që pas konfliktit dhe rrahjes me të dëmtuarin L.L. ka shkuar në shtëpi ka marrë pushkën e gjuetisë dhe aty afër trafos elektrike ku dëmtuari qëndronin njëri pranë tjetrit ka nderur njëkohësisht dy fishekë nga pushka e gjuetisë me ç’rast i dëmtuari L.L. ka pësuar lëndime të rënda trupore në pjesën e djathtë të gjoksit ndërsa Z. K. Ka pësuar lëndimi e të rënda trupore në pjesën e majtë të krahorit dhe dorës së majtë.

Me çka kishte për të kryer veprën penale vrasje në tentativë, parashikuar nga nen 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së.

Nga procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurin rezulton se i pandehuri në mbrojtjen e tij deklaroi se nuk i kujtohet se ditën kritike i ka ndezur dy fishekë nga pushka e gjuetisë. Ai, gjithashtu thekson se nga pushka ka shtënë tre muaj ditë para ditës kritike dhe në pushkë ekzistojnë patrona të ndezura të pushkës qysh nga ajo kohë. Me rastin e deklarimit të tillë ai ka ngelë pranë thënieve duke ngul këmbë se nuk din se nga pushka e tij ka shtënë ditën kritike përkundër faktit se i është prezantuar deklarimi i dëshmitarit SH.L. Në procesverbalet për dëgjimin e dëshmitarëve nuk ekziston asnjë thënie i cili do të tregonte në çrregullime shpirtërore e të pandehurit F.Z. në kohën kritike.

Në shkresa ndodhet raporti për kontrollin e kryer ndaj të pandehurit në QKUK – Reparti i Neuropsikiatrisë nr. 100/2012 i cili është kryer më datë _____. Në këtë raport është dhënë ky mendim: “lëndimet të F.Z. të përshkruara nën pikën 2 të konstatimit në pjesën e kapakëve të syrit, maja e hundës dhe buzës së epërme janë njolla gjaku dhe shqyerje e lëkurës të shkaktuara përafërsisht 24 orë para kontrollimit me mjet të fortë mekanik të topitur. Secili veç e veç dhe të gjitha së bashku të vlerësuara paraqesin lëndim të lehtë trupor”.

II. Duke e përshkruar historinë e tij jetësore i pandehuri F.Z. thekson se është rritur në familje bujqish në të cilën ka mbretëruar raporte harmonike familjare. Motra më e madhe i ka vdekur kur ishte fëmijë, ka edhe një motër më të vogël e cila është e shëndosh në aspektin shëndetësor. Nëna u ka vdekur nga atakuar kardiak ndërsa babai nga një aksident trafiku që të dy të moshuar.

Sipas thënieve të prindërve i pandehuri ka ecur dhe folur me kohë. Në shkollë ka shkuar në vitin e shtatë dhe i ka përfunduar tetë vjet të shkollës fillore e më pas ka punuar në ekonominë e tyre familjare bujqësore.

Është martuar në vitin _____ dhe nga kjo martesë ka një djalë i cili gjithashtu është i martuar dhe i shëndoshë.

Vuan nga tensioni i lartë i gjakut a vitet e fundit edhe nga sëmundja e sheqerit. Sëmundje tjera nuk ka pas.

Nuk konsumon alkool dhe nuk pinë duhan.

Në bisedë me të përkitazi me veprën penale me të cilën i vihet në barrë, me rastin e hulumtimit psikiatrik ka ndërruar përshkrimin e tij të ngjarjes kritike. Me rastin e bisedës së parë në tërësi ka përsëritur thëniet e tij nga procesverbali për marrjen në pyetje të të pandehurit, për të deklaruar më vonë se iu ka rikujtuar se ditën kritike ka hy në shtëpi, ka marrë pushkën, ka dalë para shtëpisë dhe është nisur në drejtim të të dëmtuarit F.Z. me qëllim që ta dëmtojë atë. Nuk ka ditur se pushka është e mbushur ndërsa ka tërhequr shulën me qëllim që me zhurmën që do të shkaktonte manovrimi me pushkë ta frikësonte të dëmtuarin F.Z. Pushka është ndezur edhe pse ai nuk kishte qëllim që të shtënë nga ajo. Tani i vie shumë keq për atë se çka ka ndodhur, dhe po të dinte se pushka është e mbushur atë nuk do ta nxirrte fare jashtë. Pjesën tjetër të ngjarjes e përshkruan si në procesverbalin e theksuar më lartë. Me kontrollimin psikiatrik është konstatuar

se i pandehuri Z.K. duket i rregullt, i mbajtur mirë në raport me pyetësit i dëgjueshëm dhe korrekt. Me sukses bashkëpunon në kontrollim.

Urdhëresat gjatë kontrollit fizikal dhe neurologjik i kryen saktë dhe menjëherë.

Në pyetjet e parashtruara, jep përgjigje të sakta dhe të drejtpërdrejta, flet drejt në aspektin gramatikor .Deklarimet e t'ia i përcjell me një mimikë të përshtatshme me gjestikulacione dhe me fjalë.

Vëmendjen me lehtësi e orienton në temën e propozuar të bisedës dhe në masë të mjaftueshme atë e mban.

Saktë vlerëson qëllimin, kohën dhe vendin e kontrollit, din qëllimin e institucionit në të cilin kryhet kontrolli dhe rolin e ekzaminuesve. I din me përpikëri dhe në detaje i përshkruan të dhënat personale për veten e tij.

Mbamëndja e ngjarjeve të vjetra dhe të tanishme nga jeta e tij personale si dhe historia moderne në tërësi i është ruajtur.

I pandehuri disponon dijen i cilit i përgjigjet moshës së tij, shkallës së arsimimit dhe rrethit ku ai jeton.

Ai ka parashikim të qartë, të kuptueshëm situatën e përgjithshme shoqërore dhe për situatën aktuale para gjykatës. Në të gjitha situatat gjykon drejt.

Nuk tregon ide sumanute.

Nuk përjeton dëgjime mashtruese.

Reagimet e tij emocionuese gjatë observimit janë në përputhje me temat e bisedës dhe situatën e krijuar.

Gjendja neurologjike është në kufijtë e normales.

Me kontrollin fizik në rastin e pranimit, janë konstatuar njolla gjaku në pjesën e kapakëve të dy syve dhe në pjesën e rrënjës së hundës, ndërsa në buzën e epërme në gjysmën e djathtë ekziston një gërvishje e madhësisë së 1x10 cm dhe në të njëjtën pjesë në pjesën e brendshme dëmtim të mukozës me dhëmbë. Parametrat tjerë fizikale janë në kufij të normales.

III.Me ekzaminimin elektro encoefalografike parametrat e gjetura (vlerat) nuk kalojnë kufijtë e normales. Me fotografimin radiografik të kokës, nuk janë zbuluar ndryshime patologjike e as gjurmë të thyerjes së kockave.Rezultatet e analizës rutinore laboratorike të gjakut dhe urinës janë në kufijtë e normales.

IV. Për kohën e qëndrimit në spital i pandehuri ka respektuar rendin shtëpiak, nuk ka ardhur në konflikt me pyetësit tjerë dhe personelin, në tërësi është sjell si person psiqikisht i shëndoshë në rrethana të tilla.

Në bazë të konstatimeve të theksuara i japim këtë:

M E N D I M

1. I pandehuri F.Z. është person i shëndoshë psikik dhe nuk vuan nga asnjë sëmundje e përkohshme dhe e përhershme psikike- çrregullimit psikik, e as që ekzistojnë shenja të ngeçjes në zhvillimin psikik (*zhvillimi i metë psikik*).

2. Në mbrojtjen e tij i pandehuri thekson se në kohën kritike ka qenë në gjendje të dehur, e cila sipas sasisë së konsumuar të alkoolit dhe sipas përshkrimit të sjelljes së tij në kohën kritike i përgjigjet dehjes së një shkalle të lehtë.

3. Gjendja alkoolike e shkallës së lehtë, lëndimet të cilat i pandehuri F.Z. i ka përjetuar në kohën kritike, e gjithashtu edhe rrethanat në të cilat e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, nuk kanë zvogëluar aftësinë e tij, që të kuptojë rëndësinë e veprës së dhe t'i kontrolloj sjelljet e t'ia, ashtu që ai në atë kohë ka qenë *plotësisht i llogaritshëm- i përgjegjshëm*.

QKUK-Reperti i Neuropsikiatriisë

Prishtinë _____

Drejtori

B.B.

Formulari 60

(DEKLARATË PËR TË HYRË NË NEGOCIATA PËR PRANIMIN E FAJËSISË)

PROKURORIA THEMELORE NË _____

DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PP.I.nr. _____

Më datë: _____

Në bazë të nenit 233 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës Unë , I. D, jap këtë:

DEKLARATË

Jam, i lindur më _____, në _____, me banim në fsh. _____, K. _____, serb, shtetas i R. Kosovës, më parë nuk kam qenë i dënuar e as nën hetime.

Në pajtim të nenit 233 të KPPK-së, jam i gatshëm të pranojë veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe Kanosja nga neni 185 par. 4 të KPRK-së. di shkrim dhe këndim, kam të kryer shkollën e mesme.

Kur po jap këtë deklaram jam koshient dhe në gjendje të mirë shëndetësore, në aspektin fizik dhe psikik, nuk jam i sëmurë dhe nuk vuaj nga sëmundjet mendore,

Nuk jam përdorues i alkoolit e as substancave narkotike .

Në këtë marrëveshje po hyj në mënyrë vullnetare dhe vetëdije të plotë në pajtim të nenit 233 par. 18 nënparagrafi 18.1 të KPRK-së, dhe askush nuk më ka premtuar asgjë përveç premtimeve të parapara në këtë marrëveshje, askush nuk më ka kërcënuar mua apo ndonjë anëtarë të familjes sime për të më detyruar në këtë negociim marrëveshje.

Me avokatin tim E.H., e kemi diskutuar dhe shqyrtuar në mënyrë detale rastin tim dhe kam vendosë që të hyjë në negociimin e marrëveshjes me prokurorinë për pranimin e fajësisë. E kemi biseduar aktakuzën dhe akuzën e mundshme lidhur me veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe Kanosja nga neni 185 par. 4 të KPRK-së. Me avokatin tim në detaje i kem analizuar të gjitha dimensionet e rastit, cila do jetë pozita ime në rrethana të tilla nëse nuk e pranoj fajësinë dhe cilat janë favoret e mundshme që ligji më ofron nëse e pranoj fajësinë. Jam i kënaqur me përfaqësimin e avokatit tim dhe profesionalizmin e tij, ngase nga ai mora të gjitha këshillat profesionale përkitazi me këtë marrëveshje dhe mi sqaroi të gjitha refleksionet e marrëveshjes eventuale.

E kuptoj akuzën kundër meje

E kuptoj aktakuzën dhe akuzat e mundshme kundër meje, provat që i posedon prokurori për të mbështetur aktakuzën ose akuzat e mundshme, e kuptoj faktin se nëse nuk hyj në këtë marrëveshje për pranimin e fajësisë, procedura për këtë vepër penale fillon me ngritje të aktakuzës dhe zhvillim të procedurës gjyqësore të rregullt në gjykatë. E kuptoj mbrojtjen e që mund ta bëjë lidhur me aktakuzën apo provat e propozuara kundër meje.

Të drejtat nga të cilat heqë dorë me rastin e hyrjes në këtë negociim

Un jam i gatshëm që për hire të kësaj marrëveshje të heqë dorë:

-nga e drejta për shqyrtim gjyqësor duke përfshirë të drejtën e prokurorit që të provojë akuzat kundër meje

-të drejtën për të ftuar dëshmitarët e mi,

-të drejtën për t'i marrë në pyetje dëshmitarët e ftuar nga gjykata dhe prokurori,

-të drejtën për të kërkuar nga gjykata që t'i shpallë provat të papranueshme,

-të drejtën për të kërkuar nga gjykata që ta hedhë poshtë aktakuzën,

-të drejtën për të heshtur apo për të dëshmuar në dobi time,

-të drejtën për të sfiduar peshën e provave të pranuar në shqyrtim gjyqësor,

-të drejtën për të kërkuar dënim tjetër nga ai i pajtuar gjatë negociimit,

-të drejtën për urdhër tjetër të arkëtimit e obligimit të shmangur tatimor që është i ndryshëm nga ai i pajtuar gjatë negociimit.

-të drejtën për të kërkuar marrëveshje eventuale financiare që është e ndryshe nga ajo e pajtuar gjatë negociimit.

Pranimi i fajësisë

Deklaroj se e kam kryer veprën penale të përshkruar në këtë negociim dhe se do t'i prezantoj gjykatës faktet që dëshmojnë që unë e kam kryer veprën penale të përshkruar në këtë negociim. Po ashtu deklaroj se gjykata mund të marrë në konsideratë listën e mundshme të dokumenteve dhe provave për të përcaktuar fajësinë time për veprën penale të përshkruar në këtë negociim

Po që se gjykata nuk e pranon dhe nuk e merr për bazë këtë negociim, unë e refuzoj këtë negociim dhe kërkoj shqyrtim gjyqësor.

Po që se dështoj në përmbushjen e obligimeve të këtij negociimi, prokurori mund ta refuzojë negociimin dhe të kërkojë shqyrtim gjyqësor.

Po që se Gjykata dhe Prokuroria e marrin për bazë këtë negociim, e kuptoj se nuk mund ta refuzojë këtë negociim dhe do ta pranoj dënimin e pajtuar me këtë negociim.

Mund të ankohe kundër aktgjykimit vetëm poqë se gjykata më shqipton dënim jashtë marrëveshjes, në pajtim me nenin 233 paragrafi 13 i KPPK-s.

I pandehuri

Formulari 61

MARRVESHJE PËR PRANIMIN E FAJËSISË (Neni 223 i KPPK-s)

**PROKURORI I SHETIT I PROKURORIA THEMELORE NË _____
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**

PP.I.Nr. _____

Më datë _____

Në _____

Në bazë të nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPRK), Prokurori i Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në _____ dhe të pandehurit I. D, e R. F. nga fshati _____, Komuna e _____, kanë arrite këtë:

MARRËVESHJE PË PRANIM TË FAJËSISË

I pandehuri I. D. pajtohet që të pranojë fajësinë për veprat penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe Kanosja nga neni 185 par. 4 të KPRK-së si dhe i pandehuri R.F. pajtohet që të pranojë fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së.

Prokurori pajtohet që të mos akuzojë të pandehurit për veprat penale shtesë që lindin nga veprimet e tyre dhe të cilat përbëjnë bazë për veprën për të cilën të pandehurit e pranojnë fajësinë.

Të pandehurit pranojnë të ofrojnë marrëveshjen e mëposhtme:

Para zyrtarëve të zbatimit të ligjit të zbulojë plotësisht dhe sinqerisht të gjitha informatat që ndërlidhen me veprën penale me të cilën ngarkohet apo ndonjë vepër tjetër penale për të cilën i pandehuri ka njohuri dhe të dëshmojë nëse një gjë e tillë i kërkohet nga Prokurori.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, Prokurori pajtohet që t'i bëjë me dije Gjykatës për bashkëpunimin e plotë të pandehurve dhe të rekomandoj gjykatën t'i shqiptoj të pan dehurve sanksion penal.

Dënimi për të pandehurin I. D, është: dënim me gjobë në shumën prej 250 € për veprën penale nga neni 374 par. 1 të KPRK-së dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve; i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afatin brenda një viti nuk do të kryej vepër tjetër penale, kurse për të pandehurin R. F. dënimi për veprën penale nga neni 374 par. 1 është dënim me gjobë në shumën prej 150 €, e që marrëveshja për këto masa të dënimit është bërë me aplikimin e nenit 75 paragraf. 1 të KPP-së, me ç'rast është bërë zbutja e dënimit nën minimumin

ligjor meqë i janë marrë parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese për të pandehurin I. D. për veprën penale nga neni 185 par. 4 të KPRK-së, me ç'rast të njëjti sipas kësaj marrëveshje do t'i shqiptohet dënimi me kusht, fakti se të njëjtit kanë pranuar veprat penale në tërësi, janë penduar thellë, nuk kanë kryer më parë vepra penale dhe se janë njerëz familjar. Gjithashtu, me këtë marrëveshje nuk është trajtuar kërkesa dëmtonjëse meqë i dëmtuari D. T., në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori sa i përket kërkesës dëmtonjëse shprehimisht është deklaruar se nuk kërkon kompensim material nga i pandehuri I. D. ndërsa pohon që sa i përket ndjekjes penale, ia lë të vendosë organi kompetent përkatësisht Gjykata.

E drejta për të refuzuar negociimin

Të pandehurit dhe Prokurori janë të vetëdijshëm se nëse ndonjëra prej palëve dështon në kryerjen e obligimeve të marra sipas kërkesës së marrëveshjes, pala tjetër mund të refuzoj negociimin dhe çështja do të shkoj në shqyrtim gjyqësor sikur negociimi të mos kishte ekzistuar kurrë.

Të pandehurit dhe Prokurori i Shtetit janë të vetëdijshëm se asgjë e thënë gjatë procesit të negociimit nuk mund të përdoret si provë, nëse nuk pranohet marrëveshja nga ana e Gjykatës, por nëse prokurori vlerëson se i pandehuri gjatë dhënies së dëshmisë ofron informata të rreme jo kompetente apo të gabuara, kjo nënkupton shkelje të kësaj marrëveshje nga i pandehuri.

Heqja dorë e të pandehurit nga të drejtat

Të pandehurit dhe prokurori pajtohen që të pandehurit do të heqin dorë nga e drejta për shqyrtim gjyqësor si dhe nga të gjitha të drejtat në lidhje me shqyrtimin gjyqësor të përcaktuar me nenin 233 të KPPRK-së dhe të deklaroj pranimin e fajësisë për veprën penale të përshkruar në aktin akuzues.

Nuk ka marrëveshje tjetër

Të pandehurit dhe Prokurori i Shtetit pajtohen që ky dokument është e gjithë marrëveshja në mes palëve dhe se më vonë nuk mund t'i shtohen, t'i hiqen premtimet, kushtet ose terma të tjerë.

Të pandehurit pranojnë se në pranimin e fajësisë ka hyrë vullnetarisht, pa shtrëngim apo nën presion, i pandehuri më tej pranon se në tërësi i kupton të gjitha kushtet dhe pasojat e kësaj marrëveshje.

Më datë: _____

Në _____

NN.

NN

Kryeprokurori

Prokurori i shtetit

Avokatët-Mbrojtësit

M. A
Të pandehurit:

I. D. _____ R. F.

Formulari 62

DËRGIMI I MARRVESHJES PËR PRANIMIN E FAJËSISË GJYKATËS

PROKURORI I SHTETIT

PROKURORIA THEMELORE NË _____

DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PP.I.Nr. _____

MË DATË _____

NË _____

GJYKATËS THEMELORE

DEPARTAMENTIT PËR KRIME TË RËNDA _____

Në emër të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore-Departamentit për Krime të Rënda në _____, **informoj Gjykatën** se Prokurori i Shtetit dhe të pandehurit I. D. e R. nga fshati , _____, Komuna e _____, përmes avokatëve mbrojtës av. E. H. dhe av. M.A. kanë arritur një marrëveshje të pranimit të fajësisë, të cilën dëshirojmë ta marrë parasysht Gjykata.

Procesi i cili na solli deri tek kjo marrëveshje, kushtet e pranimit të fajësisë dhe dokumentacioni përkatës, bazohen në nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, nëse kjo e fundit pranohet nga kjo Gjykatë, i pandehuri I. D. ka pranuar fajësinë për veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe Kanosja nga neni 185 par. 4 të KPRK dhe i pandehuri R. F. pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe janë pajtuar për sanksionin penal, që del nga marrëveshja për pranimin e fajësisë.

Andaj, kërkojmë nga Gjykata të caktojë seancë sa më shpejtë që të jetë e mundur, në mënyrë që të merret parasysht marrëveshja për pranimin e fajësisë, në të cilën seancë do të jenë të pranishëm të gjitha palët. Prokurori i Shtetit dhe avokatët do të paraqesin marrëveshje dhe të pandehurit do të jenë të gatshëm për marrjen në pyetje nga ana e Gjykatës. Gjatë seancës do të prezantojmë marrëveshjen për pranimin e fajësisë, deklaratën e të pandehurve mbi pranimin e fajësisë dhe një kopje të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Palët e vlerësojnë dhe ju falënderojnë për marrjen në konsiderim të kësaj marrëveshje lidhur me çështjen sipërshënuar penale-juridike.

Prokurori i Shtetit

Formulari 63

AKTAKUZË KUNDËR NJË PERSONI PËR NJË VEPËR PENALE

PROKURORIA THEMELORE-DEPARATAMENTI I PËRGJITHSHËM

PP. Nr. (____)

Dt. _____

Prishtinë

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

-departamenti të përgjithshëm -

Në bazë të nenit 241. të Kodit të Procedurës Penale, paraqesë,

A K T A K U Z Ë

KUNDËR:

N.N. nga i ati N.N dhe e ëma N, me profesion tregtar, pronar i NTP"Vigani" me seli në _____ i lindur më _____ 1968 në Prishtinë , ku edhe jeton rruga _____, i martuar, baba i tre fëmijëve i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e lartë të biznesit , shtetas i Kosovës, më parë i pagjykuar,

S E P S E:

Sepse më me datat 23.02.2013, në pikën doganore në _____, me qëllim të shmangies nga pagesa e tarifave doganore , zyrtarëve doganorë me rastin e deklarimit të mallit të eksportuar “qumësht pluhur” u ka paraqitur dokumente të rrejshme lidhur me vlerën e mallit , ashtu që për dy ngarkesa me qumësht pluhur vlera reale e të cilave ishte 81.840,00 €, ka paraqitur rrejshëm vlerën prej 22.000,00, me që rast Doganën e Kosovës e ka dëmtuar për 12.568,00 €.

- me çka ka kryer veprën penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore , të parashikuar nga neni 318.par.1. të KPK-ës

PRANDAJ PROPOZOJ

Që pranë kësaj Gjykate të mbahet shqyrtim publik gjyqësor, në të cilin duhet të ftohen:

- 1.Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____;
- 2.I pandehuri N.N, në adresën _____
- 3.Përfaqësuesi i Doganave të Kosovës
- 4.Eksperti gjyqësor N.N. nga Prishtina dhe,
- 5.Dëshmitarët : N.N.dhe N.N. zyrtar doganor në pikën doganore _____

Që gjatë shqyrtimit gjyqësor të administrohen provat:

- procesverbali i përpiluar nga komisioni pran Doganave të Kosovës, nr.____ datë _____
- ekspertiza e ekspertit gjyqësor ,nr. _____,datë _____
- raporti nga Organet Doganore të Republikës së Serbisë, nr. ___ datë _____

Pas procedimit dhe vlerësimit të provave, i pandehuri të shpallën fajtorë dhe të gjykohen me dënime meritore konform ligjit.

A r s y e t i m i

Shërbimi doganor i Republikës së Kosovës, ndaj të pandehurit, N.N. ka paraqitur kallëzim penal për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale shmangie nga pagesa e

tarifave të detyrueshme doganore , të parashikuar nga neni 318.par.1. të KPK-s dhe në këtë drejtim janë zhvilluar hetimet , nga të cilat pa mëdyshje ka rezultuar se i pandehuri ka konsumuar këtë vepër penale.

Gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar në bazë dokumentacionit që është siguruar në rrugë diplomatike nga Republika e Serbisë, ekspertiza e kryer dhe në bazë të dëshmive të zyrtarëve doganor N.N.dhe N.N.

I pandehuri nuk e ka pranuar veprën penale, dhe në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ka qenë lajthim ngase ka menduar se vlerë e mallit është aq sa e ka paraqitur te organet doganore.

Zyrtari doganore ka deklaruar se më _____, në pikën doganore “Dheu i bardhë” në emër të kompanisë “ Ballkani” janë zhdoganuar dy ngarkesa me qumësht pluhur dhe zyrtarit N.N. i është paraqitur malli në vlerë prej 22.000,00€ në bazë të cilit ky zyrtar(shpediteri) ka përpiluar DUD(dokumentin unik doganor) dhe në këtë shumë janë llogaritur obligimet doganore , mirëpo ndërkohë në bazë të një memorandumit që ka ekzistuar me Republikën e Serbisë kanë siguruar dokumentacionin origjinal nga i cili doli se i pandehuri si shofer i kompanisë “Ballkan” ka bërë deklarinimin e rrejshëm të vlerës së mallit, nga se ka deklaruar mall në vlerë prej 22.000.00 €, ndërsa vlera reale e të cilit ka qenë 81.000,00 € .

Përfaqësuesi i Doganave të Kosovës ka deklaruar se deklarinimin e mallit e bëjnë shoferët dhe dokumentacionin që u prezantojnë në kufi e prezantojnë edhe te shpediteri dhe në terminal dhe DUD(dokumenti unik doganor) plotësohet në bazë të dokumenteve që shoferit i paraqesin shpediterit, ndërsa kontrollimin e mallit e bëjnë zyrtarët doganor .Në rastin konkret shoferi përkatësisht i pandehuri ka prezantuar dokumente të rrejshëm në kufi dhe në terminal, në bazë të cilit nga zyrtari i i agjencionit “Arsenal” është përpiluar DUD-r, rezulton se malli nuk është kontrolluar fare nga zyrtarët doganor. Mirëpo më vonë kur kanë siguruar dokumentacione nga Serbja ka dal se eksportuese ishte një kompani nga Beogradi, Importuese kompania nga Kosova “Ballkan” me shofer të pandehurin N.N., ndërsa porositës i mallit kompania”D....” me seli në P _____ dhe se vlera e mallit nuk ishte 22000,00 €, por 82.000,00€ .

Në bazë të ekspertizës financiare që është bërë nga eksperti përkatës, del se duke paraqitur në mënyrë të rrejshme vlerën e mallit (dy mauneve) i pandehuri ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës dhe shuma shmangies së përgjithshme të detyrimeve të taksave doganore dhe TVSH-së është 12.000,00 €.

Mbështetur në provat që janë të pranishme në fashikullin(shkresat) e çështjes , pa mëdyshje rezulton se në veprimet e të akuzuarit N.N. përmbahen të gjitha elementet qenësore të veprës penale - me çka ka kryer veprën penale shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore , të parashikuar nga neni 318.par.1. të KPK-s.

Prokurori shtetëror i prokurorisë themelore në _____

Formulari 64

AKTAKUZË PËR SHUMË PERSONA PËR NJË VEPËR PENALE
(*Neni 241*)

PROKURORIA THEMELORE-DEPARATAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PP. Nr. (____)

Dt. _____

PRISHTINË

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

-departamenti për krime të rënda -

Në bazë të nenit 241. të Kodit të Procedurës Penale paraqesë,

A K T A K U Z Ë

Kundër:

1. N.N, i lindur më _____ në fsh. _____ Komuna e _____, nga i ati N. dhe e ëma N, shtetas i Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, tani student i viti të tretë(3) , në kolegjin _____, me gjendje të varfër ekonomike, më parë i pagjykuar, në paraburgim që nga data _____

2. N.N. nga i ati N dhe e ëma N, i lindur më _____ .1983 në _____, i pa punë dhe pa kualifikim profesional, me vendbanim në _____, rr _____ nr. __, shqiptar, shtetas i Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i pamartuar, më parë i pagjykuar, në paraburgim që nga data _____

PËR ARSYE SE:

Me datën _____ 2013, rreth orës 23.00 në rrugën _____, duke përdorur forcën janë përpjekur ta detyrojnë të dëmtuarën N.N. farmacistë nga _____ (adresa _____) në kryerje të marrëdhënieve seksuale me dhunë , në atë mënyrë që kur e dëmtuara ishte duke ecur në këmbë për në shtëpi, të akuzuarit e ndalojnë atë dhe e rrokin për duarsh, duke e tërhequr në një shtëpi të braktisur dhe më pas i mbyllin gojën me qëllim që e dëmtuara të mos thërras në ndihmë, e godasin me duar në pjesë të ndryshme të trupit dhe i shkaktojnë lëndime të lehta

trupore, arrijnë ta shtrinë për toke, me dhunë tentojnë ta zhveshin dhe ja shqyejnë brekët, mirëpo aktin e dhunimit nuk e kanë kryer dhe kanë ikur nga vendi i ngjarjes, ngase e dëmtuara fuqishëm ju ka rezistuar, kurse dëshmitarët N.N. dhe N.N. që vinin nga ana e kundërt e rrugës, pasi kanë dëgjuar britmën e viktimës, kanë nxituar t'i jepnin ndihmë –

-me çka kanë kryer veprë penale të dhunimit në tentativë, të parashikuar nga neni 230.par.4.nënpargrafi 4.6 dhe 4.2 lidhur me nenin 28.të KPK-s.

ANDAJ PROPOZOJ

Që pranë kësaj gjykate të mbahet shqyrtim publik gjyqësor, në të cilin duhet të ftohen:

1. Prokurori i shtetit në _____,
2. Të pandehurit, N.N. nga _____ dhe N.N. nga _____,
3. E dëmtuara, N.N. Nga _____
4. Dëshmitarët : N.N. dhe N.N. nga _____

I. Gjatë seancës në të cilën do të lexohet dhe të merret si provë raporti mjekësor nr. _____ dt. _____ në emër të të dëmtuarës N.N.

II. *Pas procedimit dhe vlerësimit të provave*, të pandehurit të shpallën fajtorë dhe të gjykohen me dënime meritore konform ligjit.

A r s y e t i m i

Gjendja faktike e paraqitur në dispozitivin e aktakuzës është vërtetuar në bazë të thënieve të dëshmitarëve, të dëmtuarës dhe në bazë të raportit mjekësor.

Të pandehurit N.N. dhe N.N. në fillim kanë mohuar kryerjen e veprës penale me të cilën akuzohen, duke thënë se nuk kanë pas lidhje me njeri tjetrin, nuk kanë qenë në shoqëri dhe nuk e kanë parë as një herë më parë. Mirëpo, ballafaqimi i tyre me të dëmtuarën bëri që këta të pranojnë një gjë të tillë dhe t'i vërtetojnë të gjitha thëniet e dëmtuarës duke shprehë njëkohësisht keqardhjen për veprën e kryer.

E dëmtuara N.N., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar se i ka njohur të pandehurit, se i ka parë disa herë në shoqëri, por nuk ka pas asnjë kontakt me të pandehurit. Natën kritike, pasi ka mbyllur barnatoren ku punonte, kishte marrë edhe pazarin ditor të cilin e kishte mbështjellë dhe fshehur në jelek. Në fillim të sulmit ajo kishte menduar se të pandehurit donin t'ia rrëmbenin

paratë, mirëpo pasi e ka kuptuar që ata donin ta detyronin në marrëdhënie seksuale, i erdhi ‘një fuqi dhe rezistencë e jashtëzakonshme’ e cila e pengoi qëllimin e tyre. Të pandehurit, sikur të zëmëruar (dëshpëruar) filluan atë ta godasin dhe ti shkaktojnë dhembje, sidomos në pjesën e gjoksit.

Nga dëshmia e dëshmitarëve N.N. dhe N.N. janë vërtetuar plotësisht ishte thëniet e të dëmtuarës . Natën kritike, duke u kthyer nga kafeneja, në rrugën _____, kanë dëgjuar disa (klithma)psherëtimë që vinin nga drejtimi i një shtëpie të pabanuar, kur iu afruan ata vënë re një person-femër e cila ishte e shtrirë në tokë dhe dy të tjerë – meshkuj të cilët iknin në drejtim të parkut. E dëmtuara, duke qarë nga dhembjet e shkaktuara ju tha se çfarë i ka ndodhur. Ishte e rrahur dhe lëvizte me vështirësi të madhe. Bari ishte i shkelur dhe vunë në dukje brekë të shqyer.

Nga raporti i ekzaminimit fizik, të QKUK-s në _____, rezulton se e dëmtuara ka pësuar lëndime të lehta trupore. Janë vërejtur disa gërvishtje në kokë si dhe lëndime e mavijosje në pjesë tjera të trupit.

Bazuar në provat që ndodhen në shkresat e lëndës , rezulton se në veprimet e të akuzuarve N.N. dhe N. N. Arrihen të gjitha elementet e veprës penale të dhunimit në tentativë, të parashikuar nga neni 230.par.4.nënp. 4.6 dhe 4.2 lidhur me nenin 28.të KPK-s.

Duke i pas parasysh të gjitha këto, kjo aktakuzë është e ligjshme dhe e drejtë.

PROKURORI SHTETËROR I PROKURORISË THEMELORE NË _____

Formulari 65

AKTAKUZË PËR SHUMË PERSONA DHE DISA VEPRA PENALE

PROKURORIA THEMELORE-DEPARATAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PP. Nr. (____)

Dt. _____

Prishtinë

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

-departamenti për krime të rënda

Në bazë të nenit 241. të Kodit të Procedurës Penale, paraqesë

A K T A K U Z Ë

Kundër:

1.N.N. i lindur më _____,1981 në _____, nga i ati N. dhe e ëma N, shqiptar, shtetas i Kosovës, me profesion ekonomist, i martuar, baba i dy fëmije të mitur, ka të kryer shkollën e lartë komerciale në _____, i papunë, gjendje të varfër ekonomike, gjer më tani i pagjykuar , në paraburgim që nga data _____

2. N.N. i lindur më _____1983 në _____, ku edhe jeton , nga i ati N. dhe e ëma N. Shqiptar, shtetas i Kosovës, me profesion automekanik, i martuar pa fëmijë , ka të kryer shkollën fillore , i dënuar me par me aktgjykimin P.nr.123./2008 , datë _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 253.par.3.të KPK-s , me gjashtë muaj burgim , dënimin e ka mbajtur , nën paraburgim që nga data _____

3. N.N. i lindur më _____,1982 në _____, nga i ati N. dhe ëma N, shqiptar, shtetas i Kosovës, i pamartuar baba i një fëmiu , e ka të kryer shkollën fillore dhe dy vite të shkollës së mesme bujqësore , më parë i pagjykuar, në paraburgim prej _____.

PËR ARSYE SE:

- a) Me datën 12.4.2013, rreth orës 01.00 pas mesnate, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm të dobisë materiale me përdorimin e dhunës, që të tretë befaz nga prapa e sulmojnë të dëmtuarin N.N, pensionistit nga _____, duke e goditur në kokë e kanë rrëzuar në trotuar, ia nxjerrin nga xhepi portofolin , në të cilin kishte me 350,-euro, dhe një unazë gishti në vlerë prej 150 € duke, dhe ikin në drejtim të panjohur .

-me çka kanë kryer veprën penale grabitje nga neni 329.par.3.lidhur me paragrafin 1.të KPK-s.

- b) Me datën 20.10.2013, rreth orës 23 , me qëllim përfitimi të kundërligjshëm të dobisë materiale , e kanë përcjellë viktimën N.N. nga _____, i cili po kthehej nga puna në shtëpi , e kanë rrethuar që të tretë në një vend të errësuar dhe duke e kërcënuar me jetë, kanë kërkuar që t'i dorëzoj gjithë paratë dhe sendet tjera me vlerë, me që rast nga ai kanë marrë me dhunë 300,- euro, një orë dore të markës “rolexa’ me vlerë 500 €, dhe një telefon “ajfon. 5”, në vlerë prej 500 €.

- me çka kanë kryer veprën penale grabitje nga neni 329.par.3.lidhur me paragrafin 1.të KPK-s.

ANDAJ PROPOZOJ:

Që pranë kësaj Gjykate , të caktohet shqyrtim gjyqësor , në të cilin duhet thirrën :

1. Prokurori shtetërorë në Prishtinë;
2. Të pandehurit S.S dhe T.L (të sillen nga paraburgimi), kurse i pandehuri i tretë – në bazë të adresës së tij.
3. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të administrohen edhe këto prova :
 - raporti mjekësor për të dëmtuarin S.V. dhe
 - raporti nga evidenca e të dënuarve për të pandehurit ,
 - të procedohen edhe prova tjera eventuale.

Pas procedimit dhe vlerësimit të provave, të pandehurit të shpallën fajtorë dhe të gjykohen me dënime meritore konform ligjit.

Meqenëse akoma qëndrojnë arsyet për të cilat të pandehurve u është caktuar paraburgimi, propozoj që ndaj tyre tu vazhdohet paraburgimi.

Arsyetimi

Gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë vërtetohet pjesërisht me pranimin e fajësisë e të pandehurve, të thënieve e të dëmtuarve dhe ekspertizës mjekësore.

I pandehuri S.S. gjatë hetimit ka deklaruar dhe ka pranuar pjesëmarrjen e tij ku bashkë me dy të tjerë (të pandehurit T.L dhe V. V.) fizikisht kanë sulmuar të dëmtuarin S.V. ndërsa portofolin me 350,- euro sipas tij, ia kanë marrë të pandehurit T.L. dhe V.V. Po ashtu, i pandehuri S.S. ka pranuar se viktimë e sulmit ishte edhe një person tjetër, në afërsi të nënkalimit, ku me atë rast është grabitur një shumë parash dhe një orë dore.

Të gjitha këto veprime i pandehuri S.S pohon se i ka bërë në gjendje të dehur dhe se nuk ka ekzistuar marrëveshja midis tyre për ta kryer veprën në fjalë.

I pandehuri T.L. gjatë hetimeve para prokurori të shtetit ka pranuar se ditën kritike në vendin e cekur në aktakuzë, kanë sulmuar një person dhe e kanë rrahur me grushta , por ai nuk e di se kush ia ka marrë portofolin me të holla, vetëm e di se kur njëri nga të pandehurit hapi portofolin, e në te nuk kishte të holla dhe të njëjtën e hodhën në park. I pandehuri T.L. pretendon

se ai ishte i pranishëm kur u sulmua i dëmtuari R.M. dhe ka parë kur ata morën portofolin e tij, por në këtë ngjarje ai nuk ka marrë pjesë.

I pandehuri V.V. para prokurorit ka pranuar se ka marrë të holla dhe një orë dore, por nuk ka pranuar se ka rrahur të dëmtuarin S.V. dhe nuk e mohon praninë e tij në këtë ngjarje. Pohon se ndaj të dëmtuarit nuk ka përdorur ndonjë forcë, dhunë, pasi që ai vet dha një shumë prej 250,-euro.

Tre të pandehurit pohojnë se para kryerjes së veprave penale kanë vizituar disa kafene, kanë konsumuar shumë alkool dhe se ishin rëndë të alkoolizuar .

Mbrojtjes së të pandehurve T.L dhe V.V nuk mund t'i falet besimi, sepse dëshmia e të pandehurit S.S. padyshim vërteton që të dy të pandehurit e tjerë kanë rrahur me grushta të dëmtuarin, të cilit ia kishin marr portofolin me 250,- euro të holla, një orë dore, duke e kërcënuar edhe me vrasje.

Të dëmtuarit R.S. dhe R.M. i kanë njohur të pandehurit dhe i kanë identifikuar si autorë të veprave penale – të grabitjes. I dëmtuari R.S. konfirmoi se ai u sulmua dhe u rrah pa asnjë arsye dhe se njëri nga tre sulmues ia nxjerri nga xhepi portofolin me 350,- euro të holla. Si pasojë e goditjeve ndjen akoma dhimbje koke. I dëmtuari R.M. vërtetoi se është sulmuar nga të tre të pandehurit, se ishte kërcënuar me vdekje nëse nuk i dorëzon të gjitha paratë që i ka. Pra me dhunë ia rrëmbejnë orën e dorës dhe portofolin me para.

Sipas raportit mjekësor rezulton se të dëmtuarit janë vërtetuar disa lëndime të lehta trupore, sidomos tek R.S (në pjesën e djathtë të kokës).

Bazuar në arsyetimin e mësipërm, qartë rezulton se në këtë çështje penalo juridike, ekzistojnë prova të pakontestueshme , me të cilat vërtetohet se të pandehurit S.S, T.L dhe V.V. në bashkëkryerje kanë kryer dy vepra penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329.par.3.lidhur me par.1.KPK-s.

Nga të cekurat e më sipërme kjo aktakuzë është e ligjshme dhe e drejtë.

PROKURORI SHTETËROR I PROKURORISË THEMELORE NË _____

Formulari 66

AKTAKUZË KUNDËR TRE PERSONA DY VEPRA PENALE

REPUBLIKA E KOSOVËS

PROKURORIA THEMELORE NË _____

PP. _____

NË. _____

GJYKATËS THEMELORE DEPARTAMENTIT _____

Në bazë të nenit 304 par. L. i KPPK-së, paraqes:

A K T A K U Z Ë

Kundër:

1.N.M nga i ati N dhe e ëma N e vajzërisë N i lindur më _____ në fsh. _____ Komuna e _____ ku edhe tani jeton shqiptuar, shtetasi i Kosovës, i martuar baba i _____ fëmijëve ka të kryer shkollën e mesme i gjendjes së mesme ekonomike, gjendet në paraburgim nga data _____.

2.M.L nga i ati N.dhe e ëma N. e vajzërisë N, i lindur më N. në N. ku edhe jeton në rr. _____ nr. _____ shqiptar, ka të kryer shkollën fillore i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë në paraburgim nga dt. _____ deri më dt. _____.

3.F.A. nga i ati N. dhe e ëma N. e vajzërisë N. i lindur më N. në N. ku edhe jeton në rr. _____ nr. _____, shqiptar shtetas i Kosovës, beqar, ka të kryer shkollën fillore, me profesion automekanik, i gjendjes së mesme ekonomike, ka qenë në paraburgim nga dt. _____ deri më dt. _____.

S E P S E

I . Sepse i akuzuari N.M. me dt. _____ pas një marrëveshje paraprake përmes telefonit me personin e quajtur N.N vendos për të shkuar deri në fsh. _____ për të marr një kuti me municion, dhe pas kontaktit që ka pasur me të akuzuarin M.L. dhe F.A. të njëjtit vënë në dispozicion mjetin me të cilin është kryer vepra dhe nisen për në vendin e caktuar ku në fshat i pret personi i panjohur me ç’rast i akuzuari N.M pasi që del, merr një thes të cilën e fut brenda në automjet të markës “Wolsfagen Polo” me targa _____ të cilin e drejtonte i akuzuari N.N. dhe duke u kthyer për në _____ rreth orës 18,40 min. Në afërsi të fsh. _____ ndalen nga ana e patrullës së policisë dhe me kontrollim paraprak të kryer në automjet janë gjetur një qese me

1,220 (njëmijedyqindenjëzet) fishek të kalibrit 7.62 mm. Për të cilat është vërtetuar se i posedonin dhe bartnin pa leje valide.

- këso dore kanë kryer veprën penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, të parashikuar nga neni 372 par.2 lidhur me par.1. lidhur me nenin 31 të KPK-së.

II. I akuzuari N.M.

Sepse me datë, kohë dhe vendin e njëjtë sikurse në dispozitivin nën pikën I. të kësaj aktakuze, me rastin e kontrollimit në stacionin policor të fsh._____, në xhepin e djathtë të sakos së të dyshuarit N.M. janë gjetur katër qese të najlonit, me rreth 19 (nëntëmbëdhjetë) gram substancë bimore të gjelbërta, të cilat në bazë të analizave laboratorike të kryera nga hetuesit e sektorit qendror për hetimin e narkotikëve dhe njësisë së krim teknikës, kanë rezultuar të jenë substanca narkotike të llojit *mariuhanë*, të cilat më pas janë konfiskuar nga ana e policisë.

- këso dore ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273.par.1 i KPK-së.

Andaj

PROPOZOJ

Që pranë kësaj Gjykate të caktohet dhe mbahet seanca kryesore publike në të cilën duhet ftuar:

Prokurorin i Prokurorisë Themelore në _____

Të akuzuarit N.M, M.L,dhe F.A.

Të bëhet leximi në raportin e ekzaminimit kriminalistik të laboratorit të SHPK-së, mbi rezultatet e ekzaminimit të substancës narkotike nr.____ të datës _____,

- Leximi i mesazheve telefonike të të akuzuarit gjatë komunikimit me persona të tretë si dhe këqyrja në foto dokumentacionin e shkresave të lëndës,

Në bazë të neneve 115 KPPK-së , propozoj që municioni i konfiskuar, në një qese prej ____ fishek të kalibrit ____ mm , si dhe katër qeset e najlonit në peshë prej ____ gram marihuanë si objekt i kryerjes së veprave penale të konfiskohen.

Pas procedimit dhe vlerësimit të provave, të pandehurit të shpallën fajtorë dhe të gjykohen me dënime meritore konform ligjit.

Propozoj që ndaj të akuzuarit N.M të vazhdohet paraburgimi.

A r s y e t i m

Pas përfundimit të procedurës së hetimeve në këtë çështje penale dhe pas shqyrtimit të gjithanshëm të të gjitha provave të grumbulluara gjatë kësaj procedure është konstatuar gjendja faktike si vijon:

Sepse i akuzuari N.M me dt._____, pas një marrëveshje paraprake përmes telefonit me personin e quajtur N.N. vendos për të shkuar deri në fsh._____ për të marr një kuti me municion, dhe pas kontaktit që ka pas me të akuzuarin M.L.dhe F.A, të njëjtit vënë në dispozicion mjetin me të cilin është kryer vepra dhe nisen për në vendin e caktuar ku në fshat i pret personi i panjohur me ç’rast i akuzuari N.M. pasi që del, merr një thes të cilën e fut brenda në automjet të markës “Wolsfagen Pollo” me targa ____ të cilën e drejtonte i akuzuari M.L. dhe duke u kthyer për në _____ rreth orës _____ në afërsi të fsh._____ ndalen nga ana e patrullës së policisë dhe me kontrollim paraprak të kryer në automjeti janë gjetur një qese me ____ copë fishek të kalibrit.____.mm për të cilat është vërtetuar se i posedonin dhe bartnin pa leje valide të organit kompetent, i cili municion është konfiskuar nga ana e policisë.

II.Sepse i akuzuari N.M. me datë, kohë dhe vendin e njëjtë sikurse në dispozitivin në pikën I. të kësaj aktakuze me rastin e kontrollimit detal të dyshuarve të kryer në stacionin policor të fsh._____, në xhepin e djathtë të jakës së të dyshuarit _____ janë gjetur katër kese të najlonit me rreth _____ gram substancë bimore të gjelbërt të cilat në bazë të analizave laboratorike të kryera nga hetuesit e sektorit qendror për hetimin e narkotikëve dhe njësish të krim teknikës, kanë rezultuar të jenë substanca narkotike të llojit *mariuhanë*, të cilat më pas janë konfiskuar nga ana e policisë.

Gjendja e këtyre faktike është vërtetuar në bazë të deklaratës së të akuzuarit N.M i cili në hetuesi me rastin e marrjes në pyetje në prokurori ka vërtetuar se ka kontraktuar me personin e quajtur N.N nga i cili është urdhëruar përmes telefonit që të shkron deri në fshatin _____ ku do ta takon personin i cili do t’ia dorëzoj një qese me municion me ç’rast i njëjti ka kontaktuar më pas me të akuzuarin M.L. dhe F.A. dhe me automjetin e tyre të cilën e ka drejtuar i akuzuari M.L kanë shkuar deri në fshatin _____ ku ai ka kontaktuar me personin i cili ishte duke pritur dhe nga ai ka marrë një qese të cilën e ka futur në automjet dhe me rastin e kthimit për në _____ në fshatin _____ janë ndalur nga patrulla e policisë, të cilët me kontrollimin paraprak të automjetit kanë gjetur qesen me municion ndërsa me kontrollimin të cilën e kanë bërë në Stacionin policor të fshatit _____ është vërtetuar se tek i akuzuari _____ janë gjetur katër qese në peshë prej _____ gram mariuhanë në xhepin e djathtë të sakos së tij. Përafërsisht deklaratë identike kanë dhënë edhe të akuzuarit M.L. dhe F.A të cilët kanë pranuar faktin se janë takuar me të akuzuarin M.L. në parkun e qytetit dhe më pas me automjetin të cilën e ka drejtuar F.A kanë shkuar deri në

fshatin ____ ku i akuzuari ____ është takuar me një person i cili ia ka dhënë një qese të cilën i njëjti e ka futur në automjet dhe se me rastin e kthimit për në ____ në fshatin ____ janë ndalur nga patrulla e policisë dhe tek atëherë kanë kuptuar se i akuzuari N.M në qese kishte pasur municion.

Nga përmbajtja e mesazheve telefonike del se i akuzuari ka kontaktuar me personin i cili ka udhëzuar për veprimet të cilat ai duhet t'i ndërmarrë, e që vërteton përmes njoftimit të lëshuar nga Stacioni policor si dhe Raporti për numrin ____ e cila është numër me të cilën i akuzuari N.N. ka kontaktuar me të tjerët.

Nga raporti i ekzaminimit kriminalistik që është bërë nga laboratorit i SHPK-së Sektori i kimisë-drogave me nr. ____ të dt. ____ del se sasia e narkotikut që është gjetur te i akuzuari në peshë prej ____ gr. ka rezultuar si pozitiv e që është cilësuar si narkotik i llojit Marihuanë.

Po ashtu duhet të vihet në pah se i akuzuari N.M. edhe më herët është marr me këtë veprimtari, që do të thotë transporti i municionit si dhe shitja e substancave narkotike. Ndaj këtij të pandehur në muajin shkurt është paraqitur raporti i policisë pranë Prokurorisë të Prokurorisë Themelore në _____, për posedim të lëndës narkotike të llojit mariuhanë prej ____ kg. si dhe të municionit .

Pjesën e deklaratës së të akuzuarve M.L dhe F.A. të dhënë në prokurori se ata nuk dinin se po shkojnë në fshatin _____ për të marr municion , është e paramenduar me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale, ngase bazuar në rrjedhën e ngjarjes qartë rezulton se ata bashkëvepruan .

Në bazë të tërë kësaj që u shënuar më lartë, konstatoj se në veprimet e të akuzuarve N.M, M.L dhe F.A formohen të gjitha elementet e veprës penale Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse, të parashikuar nga neni 372 par.2 lidhur me par.1. lidhur me nenin 31 të KPK-ës, ndërsa i akuzuari N.M. edhe për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e pa autorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge, të parashikuar nga neni 273.par.1 i KPK-së, dhe se këto vepra i kanë kryer në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në aktakuzë dhe për këto janë përgjegjës.

Prandaj Gjykatës i propozoj që pas shqyrtimit të gjithanshëm të provave, të akuzuarit të i shpall fajtor për veprat penale që u vihen në barë dhe të i dënojë sipas ligjit, duke marr parasysh me këtë rast të gjitha rrethanat relevante me ndikim për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit dhe t'ua konfiskoj municionin dhe mjetet psikotropike .

Andaj konsideroj se aktakuza është e arsyetuar dhe në ligj e bazuar.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në _____

Formulari 67

FORMË E AKTAKUZËS E NGRITUR NGA PROKURORJA E TRIBUNALIT TË
HAGËS, NDAJ FUNKSIONARËVE CIVIL DHE USHTARAK TË SERBISË PËR
KRIMET E KRYERA NË KOSOVË

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË

Lënda Nr.IT-99-37-I

KUNDËR :	PROKURORJA	E	TRIBUNAL
S.M.			
M.M.			N.SH.
V.S.			D.O.

AKTAKUZË E NDRYSHUAR

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në përputhje me kompetencat e saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Statuti i Tribunalit”), akuzon :

1. S.M
2. M.M.
3. D.O
4. V.S

PËR KRIME KUNDËR NJERËZIMIT DHE SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË
LUFTËS SIÇ PARASHTROHET MË POSHTË:

TË AKUZUARIT

S.M u lind më 20 gusht 1941 në qytetin e P, në Republikën e sotme të Serbisë (më tej: Serbia). Në vitin 1964 u diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit dhe filloi karrierë si drejtor dhe bankier. **S.M** mbajti postin e zëvendësdrejtorit dhe pastaj të drejtorit të përgjithshëm në kompaninë e madhe të gazit *Tehnogas* deri në vitin 1978. Pastaj u bë president i bankës *Beogradska Banka (Beobanka)*, njëra prej bankave më të mëdha në ish-Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (më tej: RSFJ), dhe mbeti në këtë pozitë deri më 1983.

1.S. M filloi karrierën e tij politike në vitin 1983. U bë kryetar i Komitetit të Qytetit të Lidhjes së Komunistëve të Beogradit më 1984. Më 1986 u zgjodh kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe u rizgjodh më 1988. Më 16 korrik 1990, Lidhja e Komunistëve të Serbisë dhe Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Serbisë u bashkuan; partia e re u quajt Partia Socialiste e Serbisë (SPS); **S. M** u zgjodh kryetar i saj. Ai vazhdon të mbajë postin e kryetarit të SPS-së deri më datën e kësaj aktakuze.

2.S. M. U ZGJODH KRYETAR i Kryesisë së Serbisë më 8 muaj 1989 dhe u rizgjodh më 5 dhjetor po atë vit. Pas hyrjes në fuqi të kushtetutës së re të Serbisë më 28 shtator 1990, **S. M.** u zgjodh në postin e sapokrijuar të kryetarit të Serbisë në zgjedhje shume partiake mbajtur më 9 dhe 26 dhjetor 1990; ai u rizgjodh më 20 dhjetor 1992.

3.Pas sy mandateve si kryetar i Serbisë, **S. M.** u zgjodh kryetar i Republikës Federale të Jugosllavisë (më tej: RFJ) më 15 korrik 1997 dhe filloi nga detyrat zyrtare më 23 korrik 1997. Pas humbjes së tij në zgjedhjet presidenciale të shtatorit në vitin 2000, **S. M** dha dorëheqjen nga kjo pozitë më 6 tetot 2000. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **S. M** ka qenë në postin e kryetarit të RFJ-së.

4.M M. u lind më 19 dhjetor 1942 në Beograd, në Serbinë e sotme. **M.M** u diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit.

5.Gjatë tërë karrierës së tij politike, **M. M.** ka mbajtur shumë poste të larta qeveritare në Serbi dhe në RFJ. **M.M.** ishte deputet në Dhomën Shoqërore-Politike dhe anëtar i Komitetit të Politikës së Jashtme në Kuvendin Federal. Ai ka qenë sekretar për Arsim dhe Shkencë i Serbisë; anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Serbisë; dhe drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Serbisë. **M. M.** ka shërbyer gjithashtu si ambasador në Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme dhe si ambasador i RFJ-së, në Greqi. Ai u emërua ministër i Punëve të Jashtme të RFJ-së më 15 gusht 1995. **M. M.** është anëtar i SPS-së.

6.Më 21 dhjetor 1997, **M. M.** u zgjodh kryetar i Serbisë. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **M. M.** ishte në postin e kryetarit të Serbisë.

7.N. SH. u lind më 7 dhjetor 1948 në Bor, Serbi. Ai u diplomua në Universitetin e Lubjanës më 1977 dhe ka magjistruar në inxhinierinë kimike. Ai filloi karrierën e tij politike në komunën e Borit, ku m bajti postin e kryetarit të Kuvendit Komunale të Borit prej vitit 1978 deri më 1982.

8.Gjatë tërë karrierës së tij politike, N. SH. ka qenë anëtar aktiv i Lidhjes së Komunistëve dhe i partisë Socialiste (SPS). Ai ka mbajtur postin e kryetarit të Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve në Bor. Më 25 nëntor 1995, u zgjodh anëtar i Këshillit Drejtues të SPS-së dhe anëtar i Këshillit Ekzekutiv të saj. Gjithashtu ai u caktua kryetar i komitetit për përgatitjen e Kongresit të Tretë të Rregullt të SPS-së (mbajtur në Beograd më 2-3 mars 1996). Më 2 mars 1996 u zgjodh si njëri prej disa zëvendëskryetarëve të SPS-së. Mbeti në këtë post deri më 24 prill 1997.

9. N. SH.ka mbajtur disa poste në qeveritë e Serbisë dhe të RFJ-së. Më 1989 ai ishte anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Serbisë dhe sekretar për Industri, Energjetikë dhe Teknologji. U emërua ministër për Miniera dhe Energjetikë i Serbisë më 11 shkurt 1991 dhe përsëri më 23 dhjetor 1991. Më 23 dhjetor 1991 u emërua gjithashtu zëvendëskryeministër i Serbisë. u emërua ministër i Ekonomisë i RFJ-së më 14 korrik 1992 dhe përsëri më 11 shtator 1992. Ai dha dorëheqje prej këtij posti më 29 nëntor 1992. Më 10 shkurt 1993, u zgjodh kryeministër i Serbisë.

10. Më 22 shkurt 1993, u emërua zëvendëskryeministër i RFJ-së. Ai u riemërua në këtë post në tri qeveri me radhë: më 12 qershor 1996, më 20 mars 1997 dhe më 20 maj 1998. S.M. caktoi N. SH. si përfaqësues të tij për gjendjen në Kosovë. N. SH. kryesoi komisionin për bashkëpunim me Misionin Verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë dhe ishte anëtar zyrtar i delegacionit serb në bisedime për paqe në Rambuje në shkurt të vitit 1999. u tërhoq nga pozita e tij si zëvendëskryeministër i RFJ-së para datës ose më datën 4 shtator 2000, kur u formua qeveria e re federale. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, N. SH. ishte në postin e zëvendëskryeministrit të RFJ-së.

11. Gjeneralkoloneli D. O. u lind më 1 qershor 1941 në fshatin Ravni afër Uzhicës, në Serbinë e sotme. Më 1958 ai mbaroi Shkollën e Këmbësoresisë për Nënoficerë dhe më 1964 mbaroi Akademinë Ushtarake të Forcave Tokësore. Më 1985 Gjeneralkoloneli u diplomua në Akademinë e Shtabit të Komandës dhe në Fakultetin e Mbrojtjes Popullore me titullin e magjistrit të shkencave ushtarake. Në një kohë shërbeu si sekretar i Lidhjes së Komunistëve të Korpusit të 52-të të Armatës Popullore Jugosllave (APJ), paraardhëse i Korpusit të 52-të të Forcave të Armatosura të RFJ-së (më tej: UJ).

12.Më 1992, ishte zëvendëskomandant i Korpusit të 37-të të APJ-së, më vonë të UJ-së, me bazë në Uzhicë, Serbi. Ai mori gradën e gjeneralmajorit më 20 prill 1992 dhe u bë komandant i Korpusit të Zhicës. Nën komandën e tij, Korpusi i Uzhicës mori pjesë në veprime luftarake në Bosnjën lindore gjatë luftës në Republikën e Bosnjës e Hercegovinës (më tej: Bosnjë e Hercegovinë). Në vitet 1993-1994, shërbeu si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Parë të RFJ-së. Ai ishte komandant i Armatës së Parë në vitet 1994-1996. Më 1996 u bë zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së. Më 26 nëntor 1998 S.M. emëroi **Gjeneralkolonelin D. O.** shef

të Shtabit të përgjithshëm të UJ-së në vend të M. P.. **Gjeneralkoloneli D. O.** u emërua ministër federal i mbrojtjes më 15 shkurt 2000 dhe shërbeu në këtë post deri më 3 nëntor 2000. Ai u nxor në pension nga shërbimi ushtarak me dekret presidencial më 30 dhjetor 2000. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **D. O.** ishte në postin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.

13.V. S u lind në Malla Kërsna në Serbi. U diplomua në drejtësi në Universitetin e Beogradit dhe pastaj u punësua në gjykatën komunale Më vonë u bë drejtor i Sekretariatit Ndërkomunal të Punëve të Brendshme në Pozharevc. ka shërbyer si drejtor i kompanisë PIK në Pozharevc, zëvendëskryetar dhe kryetar i Këshillit Ekonomik të Jugosllavisë, si dhe kryetar i Këshillit Ekonomik të Serbisë.

14. Para prillit të vitit 1997, u bë zëvendëskryeministër i qeverisë së Serbisë dhe ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Më 24 mars 1998, Kuvendi i Serbisë zgjodhi një qeveri të re dhe **V. S.** u emërua ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Ai është gjithashtu anëtar i Këshillit Drejtues të SPS-së, dha dorëheqjen nga posti i tij si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë më 9 tetor 2000. Ai është deputet në Dhomën e Republikave të Kuvendit Federal. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, ka qenë në postin e ministrit të Punëve të Brendshme.

A K U Z A T

PIKAT 1-4 KRIMET KUNDËR NJERËZIMIT SHKELJET E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS

15.Duke filluar nga janari i vitit 1999 deri më 20 qershor 2000,**S.M.I; M. M., N. SH., D.r O.** dhe **V. S.** kanë planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer, apo ndihmuar në ndonjë mënyrë tjetër, një fushatë terrori dhe dhune kundër civilëve shqiptarë të Kosovës që jetojnë në Kosovë, në RFJ. Me përdorimin e fjalës “kryer” në këtë aktakuzë, Prokurorja nuk ka për qëllim të sugjerojë se ndonjëri prej të akuzuarve fizikisht dhe personalisht e ka bërë ndonjërin prej krimeve për të cilët akuzohen.

16.Fushata e terrorit dhe e dhunës e drejtuar kundër popullsisë shqiptare të Kosovës është kryer nga UJ-ja, forcat policore të RFJ-së, forcat policore të Serbisë dhe njësitë paramilitare (të gjitha tutje: forcat e RFJ-së dhe të Serbisë) duke vepruar nën drejtimin dhe me nxitjen, apo përkrahjen e **S. M. M. M. N SH.D. O.** dhe **V. S.** Veprimet kundër shqiptarëve të Kosovës janë ndërmarrë me qëllim që të largohet nga Kosova një pjesë e konsiderueshme e popullatës shqiptare të Kosovës në përpjekje për të siguruar kontroll të mëtejshëm serb mbi krahinën. Për të arritur këtë qëllim forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar në bashkëpunim , ndërmorën veprime të përgatitura dhe të bashkërenditura mirë, të përshkuara në paragrafët 18 deri 24 më poshtë.

17.Në mënyrë sistematike, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dëbuan me dhunë dhe zhvendosën brenda vendit qindra mijëra shqiptarë të Kosovës nga shtëpitë e tyre në mbarë Krahinën e Kosovës. Për të lehtësuar këto dëbime dhe zhvendosje, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëllimisht krijuan një atmosferë frike dhe shtypjeje me anë të forcës, me kërcënime për përdorimin e forcës dhe me akte dhune.

18.Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë plaçkitën pasurinë vetjake dhe komerciale të shqiptarëve të Kosovës dhe nxjerrë nga shtëpitë e tyre. Policët, ushtarët dhe oficerët ushtarakë përdorën bastisjet masive, kërcënimet me forcë, dhe aktet e dhunës për t'ua plaçkitur shqiptarëve të Kosovës të hollat , vodhën automjete personale dhe pasuri të tjera prej shqiptarëve të Kosovës të dëbuar nga Krahina.

19.Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërmorën një fushatë sistematike për të shkatërruar pasurinë e civilëve shqiptarë të Kosovës. Kjo fushatë u krye me anë të granatimit intensiv të qyteteve dhe të fshatrave; me djegie të shtëpive, të fermave dhe të objekteve ekonomike; si dhe me shkatërrim të pasurisë personale. Si pasojë e këtyre veprimeve të bashkërenditura, fshatra, qytete dhe rajone të tëra u bënë të pabanueshme për shqiptarë të Kosovës.

20.Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike ngacmuan, poshtërua dhe degraduan civilë shqiptarë të Kosovës me anë të keqtrajtimit fizike dhe fyerjeve verbale. Policët, ushtarët dhe oficerët ushtarakë në mënyrën e vazhdueshme bënë shqiptarët e Kosovës objekt fyerjesh, ofendimesh raciste, veprimesh poshtëruese, rrahjes dhe keqtrajtimesh të tjera fizike mbi bazë të përkatësisë së tyre kombëtare, fetare dhe politike.

21.Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike konfiskuan dhe shkatërruan dokumentet personale të identifikimit dhe targat e automjeteve të shqiptarëve të Kosovës. Derisa shqiptarët e Kosovës po dëboheshin nga shtëpitë dhe drejtoheshin drejt kufijve të Kosovës, ata u nënshtroheshin kërkesave që të dorëzonin letërnjoftimet në pika të veçanta gjatë rrugës për në kufi dhe në vendkalimet kufitare me Republikën e Shqipërisë dhe Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Këto veprime u bënë me qëllim për të fshirë çdo gjurmë të pranisë së shqiptarëve kosovarë në Kosovë dhe për t'ua mohuar të drejtën për t'u kthyer në shtëpitë e tyre.

22.Duke filluar më 1 janar 1999 apo rreth kësaj dite e deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo përkrahjen e **S. M., M.M. N. SH. D. O.** dhe **V. S.** kanë kryer veprimet e parashtuara në paragrafët 92 deri në 96, duke shkaktuar depërtimin e dhunshëm të rreth 740.000 shqiptarëve civilë të Kosovës. Këto veprime u

ndërmorën në të gjitha viset e Kosovës dhe këto mjete dhe metoda janë përdorur anembanë Krahinës, duke përfshirë këto komuna:

a).Gjakovë: Më 2 prill 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të detyronin banorët e Gjakovës të largoheshin nga qyteti. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shpërndaheshin nëpër qytet dhe shkonin shtëpi për shtëpi, duke urdhëruar shqiptarët e Kosovës të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Në disa raste, janë vrarë njerëz dhe shumica e njerëzve është kërcënuar me vdekje. Shumë shtëpi dhe dyqane që u takonin shqiptarëve të Kosovës, janë djegur, kurse ato që u takonin serbëve janë mbrojtur. Gjatë periudhës prej 2 deri më 4 prill 1999, mijëra shqiptarë të Kosovës, banorë të Gjakovës dhe të fshatrave përreth, iu bashkuan një kolone të gjatë njerëzish në këmbë apo me vetura, kamionë dhe traktorë, dhe shkuan në kufirin me Shqipërinë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i drejtuan të ikurit në rrugë të caktuara që më parë. Në postblloqe policore gjatë rrugës, letërnjoftimet dhe targat e makinave iu konfiskuan shumicës së shqiptarëve të Kosovës. Në disa raste, kamionët e Ushtrisë Jugosllave janë përdorur për të çuar njerëz deri në kufirin me Shqipërinë.

b.Gjilan: Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë hyrë në fshatin Përlepticë më 6 prill 1999 apo rreth kësaj date dhe u kanë dhënë urdhër banorëve që të largoheshin duke thënë se fshati do të minohej të nesërmen. Banorët u larguan dhe u përpoqën të hynin në një fshat tjetër, por i ktheu policia. Më 13 prill 1999, banorët e Përlepticës përsëri u lajmëruan se fshati duhej të zbrazej deri të nesërmen. Në mëngjesin e të nesërmes, banorët shqiptarë të Kosovës u larguan në një kolonë prej afro 500 mjetesh transporti dhe ia mësynë kufirit me Maqedoninë. Pak pas largimit të banorëve, shtëpive në Përlepticë iu vu zjarri. Shqiptarë të Kosovës në fshatra të tjera në komunën e Gjilanit gjithashtu u nxorën nga shtëpitë e tyre dhe u detyruan t'i bashkoheshin një kolonë tjetër deri në kufirin me Maqedoninë. Gjatë udhëtimit, disa meshkuj janë marrë nga kolona dhe janë vrarë buzë rrugës. Shqiptarëve të Kosovës iu morën letërnjoftimet kur arritën në kufi.

c.Mitrovicë: Në fund të marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të lëviznin sistematikisht nëpër qytetin e Mitrovicës. Ata hynin nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës dhe urdhëronin banorët që t'i lëshonin menjëherë shtëpitë dhe të shkonin në stacionin e autobusëve. Disa shtëpive u është vënë zjarri, kështu që banorët u detyruan të iknin në lagje të tjera të qytetit. Gjatë kësaj periudhe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vazhduan të dëbonin banorët shqiptarë kosovarë të qytetit. Në këtë kohë, objektet që ishin pronë e shqiptarëve të Kosovës u shkatërruan dhe shqiptarëve kosovarë u janë plaçkitur të holla, automjete dhe sende të tjera me vlerë. Metoda të ngjashme janë zbatuar në fshatrat e tjera të komunës së Mitrovicës: shqiptarët e Kosovës u nxorën nga shtëpitë dhe pastaj fshatrat e tyre u shkatërruan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Banorët shqiptarë kosovarë të kësaj komune u detyruan t'u bashkoheshin kolonave drejt kufirit me Shqipërinë. Gjatë rrugës për në kufi, ushtarë serbë, policë dhe oficerë ushtarakë ua plaçkitën artikujt me vlerë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet.

d.Rahovec: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Celinë me tanke dhe autobllinda. Pasi granatuan fshatin, trupat hyn në fshat dhe sistematikisht plaçkitën çdo artikull me vlerë nga shtëpitë. Shumica e fshatarëve shqiptarë të Kosovës kishin ikur në një pyll të afërt para ardhjes së ushtrisë dhe policisë. Më 28 mars, një numër policësh serbë detyruan mijëra njerëz që ishin strehuar në pyll të dilnin prej aty. Civilët u detyruan të marshonin deri në një fshat të afërt, ku u ndanë burrat nga gratë. Meshkujt u rrahën, u plaçkitën, dhe atyre iu morën të gjitha letërnjoftimet. Meshkujt pastaj u detyruan të shkonin në këmbë në Prizren dhe pastaj të shkonin në kufirin me Shqipërinë.

Më 25 mars 1999, një grup i madh shqiptarësh të Kosovës shkuan në një mal afër fshatit Nagafc, gjithashtu në komunën e Rahovecit, duke kërkuar siguri prej sulmeve mbi shatrat përreth. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i rrethuan dhe të nesërmen i urdhëruan të 8.000 njerëzit që kishin kërkuar strehim në mal të largoheshin. Shqiptarët e Kosovës u detyruan të shkonin në një shkollë aty afër dhe pastaj u shpërndanë me forcë nëpër fshatrat përreth. Pas tri apo katër ditësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hyn në fshatra, shkuan shtëpi për shtëpi dhe urdhëruan njerëzit të dilnin jashtë. Më në fund, këta njerëz u kthyen me forcë në shtëpi dhe u urdhëruan që të mos dilnin. Ata për të cilët nuk kishte vend nëpër shtëpi u detyruan që të rrinin në vetura dhe në traktorët që ishin parkuar aty afër. Më 2 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të granatonin fshatrat, duke vrarë një numër njerëzish që ishin duke fjetur nëpër traktorë dhe vetura. Ata që mbetën gjallë ia mësynë kufirit me Shqipërinë. Tek kalonin nëpër fshatra të tjera të shkatërruara të shqiptarëve të Kosovës, ushtarët serbë i ngacmonin. Kur arritën në kufi, fshatarëve iu morën të gjitha letërnjoftimet.

e.Pejë. Më 27 dhe 28 mars 1999, në qytetin e Pejës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi për shtëpi duke detyruar shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Disa shtëpive iu vu zjarri dhe disa njerëz u pushkatuan. Ushtarë dhe policë u vendosën në çdo rrugë, duke i drejtuar shqiptarët e Kosovës drejt qendrës së qytetit. Kur erdhën njerëzit në qendrën e qytetit, ata pa vetura apo mjete transporti u detyruan të hipnin nëpër autobusë apo kamionë dhe u çuan në qytetin e Prizrenit. Në hyrje të qytetit të Prizrenit, shqiptarët e Kosovës u detyruan të zbritnin prej autobusëve dhe të ecnin rreth 40 kilometra deri në kufirin me Shqipërinë, kur u urdhëruan t'u dorëzonin letërnjoftimet policëve serbë.

f.Prishtinë: Më 1 prill 1999 apo rreth kësaj date, policët serbë shkonin në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës në qytetin e Prishtinës dhe i detyronin banorët që të largoheshin brenda pak minutash. Gjatë këtyre debimeve me forcë, një numër njerëzish janë vrarë. Shumë prej të dëbuarve shkuan drejt në stacionin e trenave, derisa të tjerët kërkuan strehim në lagje të tjera në afërsi. Qindra shqiptarë etnikë, të cilëve policët serbë ua tregonin udhën në çdo udhëkryq, u mblodhën në stacionin e trenave dhe pastaj u futën në trena dhe në autobusë të stërmblushur pas një pritjeje të gjatë, gjatë së cilës nuk u është dhënë ujë apo ushqim. Ata në tren u çuan deri në Han të Elezit, fshat afër kufirit me Maqedoninë. Gjatë udhëtimit me tren, shumë njerëzve u janë marrë letërnjoftimet. Pasi zbritën nga treni, shqiptarëve të Kosovës policia serbe u tha të ecnin nëpër

binarë deri në Maqedoni, sepse toka përreth ishte e minuar. Ata që kërkonin të fshiheshin në Prishtinë u dëbuan në një mënyrë të ngjashme disa ditë më vonë.

Gjatë kësaj periudhe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynin në fshatrat e komunës së Prishtinës, ku ata rrahën dhe vranë shumë shqiptarë të Kosovës, duke ua plaçkitur të hollat dhe pasurinë dhe duke ua djegur shtëpitë. Shumë prej fshatarëve u çuan me kamion në Glllogoc të komunës së Lipjanit. Nga andej janë transportuar në han të Elezit me tren dhe kanë ecur deri në kufirin me Maqedoninë. Të tjerët, pasi arritën në qytetin e Ferizajt, morën urdhra nga policia serbe të hipnin në tren për në Han të Elezit, prej ku e kaluan në këmbë kufirin me Maqedoninë.

g.Prizren: Më 25 mars 1999, fshati Piranë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë me tanke dhe lloj-lloj automjetesh ushtarake. Fshati është granatuar dhe një numër banorësh janë vranë. Pastaj policët hyn në fshat dhe dogjën shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës. Pas sulmit, fshatarët e mbetur u larguan nga Pirana dhe shkuan në fshatrat përreth. Disa prej shqiptarëve të Kosovës, duke ikur në drejtim të Sërbicës, u vranë apo u plagosën nga snajperët. Forcat serbe pastaj filluan një ofensivë në rethinën e Sërbicës, duke granatuar fshatrat Reti i Ulët, Reti dhe Randobravë. Fshatarët shqiptarë të Kosovës u përzunë nga shtëpitë dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë. Prej 28 marsit 1999 në vetë qytetin e Prizrenit, policët serbë shkonin shtëpi për shtëpi, duke urdhëruar banorët shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Ata u detyruan t'u bashkoheshin kolonave të automjeteve dhe të njerëzve që udhëtonin në këmbë drejt kufirit shqiptar. Në kufi, policët serbë ua morën të gjitha dokumentet personale.

h. Skenderaj: Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, fshatrat Vojnik, Leçinë, Klladernicë, Turiçec, Brojë dhe Izbicë u shkatërruan nga granatimet dhe djegiet. Një grup prej afro 4.500 shqiptarët të Kosovës prej këtyre fshatrave u mblodh afër fshatit Izbicë, ku pjesëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë u kërkuan të holla dhe i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Një numër i madh i burrave pastaj u vra. Gratë dhe fëmijët që mbetën gjallë u çuan në grup në drejtim të Vojnikut dhe pastaj në kufirin me Shqipërinë.

i.Suharekë: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forca të RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan qytetin e Suharekës. Gjatë këtyre ditëve, policët shkonin shtëpi për shtëpi, duke kërcënuar banorët shqiptarë të Kosovës dhe duke nxjerrë shumë njerëz nga shtëpitë e tyre nën tytën e pushkës. Gratë, fëmijët dhe pleqtë u larguan nga policia dhe pastaj një numër burrash u vranë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Shqiptarët e Kosovës u detyruan të iknin me kamionë, traktorë dhe rimorkioi drejt kufirit me Shqipërinë. Duke kaluar kufirin, u janë marrë të gjitha dokumentet dhe të hollat.

Më 31 mars 1999, rreth 80.000 shqiptarë të Kosovës të zhvendosur nga fshatrat e komunës së Suharekës u mblodhën afër Bellanicës. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e granatuan Bellanicën, duke detyruar të zhvendosurit të iknin drejt kufirit shqiptar. Para se të kalonin kufirin, u janë marrë të gjitha letërnjoftimet.

j.Ferizaj: gjatë periudhës prej 4 deri 14 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i granatuan fshatrat Softaj, Rahovicë, Zllatar, Pojatishtë, Komogllavë dhe Sojevë, duke vrarë një numër banorësh. Pas granatimit, automjete policore dhe ushtarake hyn në fshatra dhe urdhëruan banorët të largoheshin. Pas fshatarët kishin dalë nga shtëpitë, ushtarët dhe policët i dogjën ato. Fshatarët e zhvendosur iu bashkuan një kolone për në kufirin me Maqedoninë. Në kufi u janë marrë të gjitha dokumentet.

Duke filluar nga 1 janari i vitit 1999 apo rreth kësaj date dhe duke vazhduar deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimi, me nxitjen apo me përkrahjen e **S. M, M. M , N. SH, D. O** dhe **V. S** kanë varë qindra civilë shqiptarë të Kosovës. Këto vrasje u bënë në mënyrë sistematike anembanë Krahinës së Kosovës dhe shkaktuan vdekjen e shumë burrave, grave dhe fëmijëve. Ndër incidentet e vrasjeve në masë janë përfshirë këto:

a.Më 15 janar 1999 apo rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, fshati Reçak në komunë e Shtimes u sulmuar nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Pas granatimit nga njësitë e UJ-së, policia serbe hyri në fshat më vonë në orët e paradites dhe filloi bastisjet shtëpi për shtëpi. Fshatarët të cilët kërkonin të iknin prej policisë serbe u vranë kudo në fshat. Një grup prej afro 25 meshkujve u përpoqën të fshiheshin në një ndërtesë, por u zbuluan nga policia serbe. Ata u rrahën dhe pastaj u çuan në një kodër të afërt, ku policët i pushkatuan. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë rreth 45 shqiptarë të Kosovës në Reçak dhe rreth tij. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën A, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë).

b.Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Bellacërkë në komunën e Rahovecit. Shumë banorë të Bellacërkës ikën te shtrati i një përroi jashtë fshatit dhe kërkuan strehim nën një urë hekurudhore. Derisa fshatarë të tjerë i afroreshin urës, një patrullë e policisë serbe hapi zjarr kundër tyre, duke vrarë 12 veta, 10 prej tyre gra dhe fëmijë. Policia pastaj urdhëroi fshatarët e tjerë të dilnin nga shtrati i përroit. Në këtë moment meshkujt u ndanë nga gratë dhe fëmijët e vegjël. Policia pastaj urdhëroi meshkujt të zhvisheshin dhe ua plaçkiti sistematikisht të gjitha sendet me vlerë. Grave dhe fëmijëve pastaj u dhanë urdhër për t'u larguar. Mjeku i fshatit u përpoq të fliste me komandantin e policisë, por ai u pushkatua, si edhe nipi i tij. Meshkujt e tjerë pastaj u urdhëruan të ktheheshin në shtratin e përroit. Pasi zbatuan urdhrin, policia hapi zjarr kundër këtyre meshkujve, duke vrarë rreth 65 shqiptarë të Kosovës. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën B, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë).

c.Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, fshatrat Krusha e Madhe dhe Krusha e Vogël në komunën e Rahovecit u sulmuan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Banorët e fshatrave u strehuan në një pyll afër Krushës së madhe, ku patën mundësi të shihnin policët që sistematikisht plaçkitën dhe pastaj dogjën shtëpitë e tyre. Më apo rreth 26 marsit, në orët e paradites, policia

serbe i gjeti fshatarët në pyll. Policia urdhëroi gratë dhe fëmijët të largoheshin dhe të shkonin në Shqipëri. Policët pastaj i kontrolluan burrat dhe djemtë dhe ua morën letërnjoftimet. Pastaj i detyruan të ecnin drejt një shtëpi të pabanuar midis malit dhe Krushës së Vogël. Kur burrat dhe djemtë ishin mbledhur brenda shtëpisë, policia serbe hapi zjarr mbi ta. Pas të shtënave që zgjatën disa minuta, policia hodhi sanë mbi burrat dhe djemtë dhe e ndezi për t'i djegur kufomat. Si pasojë të pushkatimeve dhe të zjarrit, rreth 105 burra dhe djem shqiptarë të Kosovës janë vrarë nga policia serbe. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën C, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

ç.Në mbrëmjen e 26 marsit të vitit 1999 apo rreth kësaj date, në qytetin e Gjakovë, serbë të armatosur erdhën në një shtëpi në Rrugën Ymer Grezda. Gratë dhe fëmijët brenda shtëpisë u ndanë nga burrat dhe u urdhëruan të ngjiteshin në katin e sipërm. Atëherë serbët e armatosur pushkatuan të gjashtë meshkujt shqiptarë të Kosovës që ishin në këtë shtëpi. (Emrat e të vrarëve janë radhitur në Shtesën D, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

d.Më 27 mars 1999 apo rreth kësaj date, në orët e mëngjesit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Padalishtë të komunës së Istogut. Tek hynin në fshat, forcat qëlluan mbi shtëpitë dhe mbi fshatarët që përpiqeshin të iknin. Tetë anëtarë të familjes së Bekë IMERAJ-t u dëbuan me forcë nga shtëpia dhe u vranë para shtëpisë së vet. Banorë të tjerë të Padalishtës janë vrarë në shtëpitë e tyre dhe në një shtrat përroi afër fshatit. Gjithsej, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë afro 20 shqiptarë të Kosovës nga Padalishta. (Të vrarët që dihen me emër janë radhitur në Shtesën E, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

dh.Më 27 mars 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Republikës së Serbisë sulmuan fshatin Izbicë në komunën e Skenderajt. Disa mijëra banorë të fshatit u strehuan në një lëndinë afër fshatit. Më apo rreth 28 marsit 1999, forca të RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatarët dhe rreth 28 marsit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatarët dhe iu afruan atyre, duke u kërkuar para. Pasi ushtarët dhe policët u vodhën sendet me vlerë, i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët e vegjël. Meshkujt pastaj u ndanë në dy grupe. Njëri grup u dërgua në një kodër të afërt kurse tjetri u dërgua në shtratin e një përroi. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj qëlluan mbi të dyja grupet dhe rreth 130 shqiptarë të Kosovës u vranë. (Të vrarët që dihen me emër janë radhitur në Shtesën F që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

e.G.Në orët e hershme të mëngjesit të datës 2 prill 1999 apo rreth kësaj date, policia serbe filloi një aksion kundër lagjes Qerimi të Gjakovës. Gjatë një periudhe prej disa orësh, policia serbe hyri me forcë në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës në lagjen Qerimi, duke vrarë banorët dhe duke u vënë zjarrin shtëpive. Në bodrumin e një shtëpie në Rrugën Millosh Gilliq, policia serbe pushkatoi rreth 20 njerëz dhe i vuri zjarrin shtëpisë. Si pasojë e pushkatimeve dhe të zjarreve të

ndezura nga policia serbe, 20 shqiptarë të Kosovës janë vrarë, duke përfshirë 19 gra dhe fëmijë. (Emrat e të vrarëve janë radhitur në Shtesën G, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

ë. Më 2 maj 1999 apo rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke ardhur nga pjesa veriore e komunës së Vushtrisë, sulmuan disa fshatra, duke përfshirë fshatrat Skronë, Boshlan, Gumnishtë, Pasojë, Millenicë, Kurillovë, Sllakoc dhe Ceceli. Fshatarët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë prej këtyre shtëpive u dogjën. Më vonë u radhitën me forcë në një kolonë prej rreth 30.000 deri në 40.000 njerëzve, të cilët niseshin në rrugën e grykës së Studimës, në drejtim të Vushtrisë. Gjatë këtyre veprimeve, forcat e RSFJ-së dhe të Serbisë ngacmuan, rrahën dhe vranë rreth 104 shqiptarë të Kosovës. (Të vrarët, emrat e cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën H, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

f. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999 ose rreth asaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sulm masiv kundër popullatës shqiptare kosovare të luginave të Carragojsit, Erenikut dhe Travës (komuna e Gjakovës) për të dëbuar popullatën prej kësaj treve. U dislokuan një numër i madh ushtarësh dhe policës dhe u ngritën disa postblloqe. Gjatë tërës ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkëngjiteshin kolonave të refugjatëve me traktorë, qerre me kuaj dhe makina. Në mejë, Korenicë dhe Mejë Orizë, një numër i madh dhe ende i pacaktuar meshkujsh civilë, shqiptarë të Kosovës, u ndanë nga turma e fshatarëve që o iknin dhe u rëmbyen. Shumë prej këtyre meshkujve u ekzekutuan pa procedurë dhe rreth 300 persona ende mungojnë. (Të vrarët emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën I, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

g. Më 22 maj 1999 ose rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, një roje burgu në uniformë në kompleksin e Burgut të Dubravës (komuna e Istogut) lajmëroi prej kullës së vrojtimit se të gjithë të burgosurit duhet të mblidhnin plaçkat e tyre personale dhe të radhiteshin në fushën e sportit në kompleksin e burgut për transferim në burgun e Nishit në Serbi. Brenda një kohe shumë të shkurtër, qindra të burgosur u mblodhën në fushën e sportit me plaçkat e tyre në çanta dhe u radhitën për të pritur transportin. Pa paralajmërim, rojat e uniformuara të burgut hapenë zjarr kundër të burgosurve prej kullës së vrojtimit, prej vrimave në murin rrethues dhe prej foleve të zjarrit jashtë murit. Shumë të burgosur u vranë menjëherë dhe të tjerë u plagosën.

Më 23 maj ose rreth kësaj date, në pasdite, rojat e burgut dhe policët special serbë hodhën granata dhe qëlluan në kanalet e shkarkimit, kanalet e ujërave të zeza, në godina dhe bodrume, duke vrarë dhe plagosur shumë të burgosur të tjerë të cilët kishin kërkuar strehim në këto vende pas ngjarjeve të ditës së mëparshme. Rreth 50 të burgosur gjithsej u vranë. (Shumë prej të burgosurve të vrarë mbeten të paidentifikuar. Mirëpo, emrat e personave të vrarë që dihen janë radhitur në Shtesën J, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

j.Më 26 mars 1999 ose rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e rrethuan afërsinë e oborrit të familjes BERISHA në Suharekë (komuna e Suharekës). U vunë në pozitë tanksat, të drejtuara kundër shtëpive. Policia urdhëroi banorët të dilnin nga shtëpitë. U ndanë meshkujt nga gratë dhe fëmijët dhe u vranë gjatë anëtarë të familjes. Forcat serbe dërguan anëtarët e tjerë në drejtim të një kafeneje. Këta anëtarë i kanë shtyrë në kafene, bashkë me tri grupe të familjes së gjerë të Berishëve. Pastaj pushkatarët serbë hynë në kafene dhe hapën zjarr kundër njerëzve aty brenda. U hodh edhe eksploziv në kafene. Së paku 35 civilë u vranë në këtë aksion dhe u plagosën rëndë edhe të tjerë. Kufomat e viktimave u tërhoqën zvarrë prej kafenesë dhe u vendosën në platformën e një kamioni, i cili pastaj u nis në drejtim të Prizrenit. Tre individë të plagosur, të cilët u hodhën në kamion bashkë me kufomat, kërcen prej kamionit gjatë rrugës për në Prizren. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën K, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

23.Gjatë periudhës prej marsit 1999 deri në maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë nisën një sërë ofensivash masive kundër disa fshatrave në komunën e Kaçanikut, të cilat shkaktuan vdekjen e më shumë se 100 civilëve. Më 24 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Kotlinë. Gjatë sulmit, shumica e shtëpive u dogjën dhe 17 persona u vranë. Disa prej këtyre viktimave u kapën në pyll, u ekzekutuan dhe pastaj u hodhën në puse. Pastaj janë hedhur eksplozivë në puse. Më 13 prill 1999 ose rreth asaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi që granatuan fshatin, trupat e këmbësorisë dhe policia hyn në fshat dhe plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, 13 civilë u vranë me armë zjarri. Më 21 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e rrethuan fshatin Stagovë. Popullata u përpoq të ikte në drejtim të maleve nga ana lindore e fshatit. Gjatë këtij aksioni, 13 persona u vranë. Pjesa më e madhe e fshatit u plaçkit dhe u dogj. Më 25 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e rrethuan fshatin Lisnajë. Derisa forcat hynin në fshat, iu dha urdhri popullatës që të mblidhej te shkolla dhe të largohej prej fshatit me traktorë. Pastaj meshkujt u ndanë nga gratë dhe fëmijët. Gjatë këtij aksioni u vranë katër meshkuj. Gjithashtu u vranë katër anëtarë të familjes Qorri, duke u orvatur për të ikur drejt pyllit. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Shtesën L, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

24.Duke filluar më 1 janar të vitit 1999 apo rreth kësaj dite dhe duke vazhduar deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo me përkrahjen e **S. M, M. M, N.SH, D. O.** dhe **V. S,** shfrytëzuan mjetet dhe metodat e përshkuara në paragrafët 18 deri në 24 për të kryer një fushatë përndjekjeje kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës për arsye politike, racore, ose fetare.

25.Me këto veprime **S. M, M. M, N. SH, D O** dhe **V. S** planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyrë të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e veprimeve me sa vijon:

PIKA 1
(Deportimi)

Pika 1. Deportimi, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të nenit Nenit 5 (d) të Statutit të Tribunalit.

PIKA 2
(Vrasje)

Pika 2: Vrasje, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (a) të Statutit të Tribunalit.

PIKA 3
(Vrasje)

Pika 3: Vrasje, një **SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONVE TË LUFTËS**, e ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit të Tribunalit dhe e njohur në Nenin 3 (1) (a) (vrasje) të Konventave të Gjenevës.

PIKA 4
(Përndjekje)

Pika 4: Përndjekjet për arsye politike, racore, ose fetare, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të nenit 5 (h) të Statutit të Tribunalit.

AUTORITETET E PRORE

26. S. M., u zgjodh kryetar i RFJ-së më 15 korrik 1997 dhe filloi detyrën më 23 korrik 1997. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë ai ka mbajtur postin e kryetarit të RFJ-së.

27. Si kryetar i RFJ-së **S.M** ishte edhe kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes të RFJ-së. Këshilli Suprem i Mbrojtjes përbëhej nga kryetari i RFJ-së dhe kryetarët e republikave anëtare, Serbisë dhe Malit të Zi. Këshilli Suprem i Mbrojtjes vendosi për Planin e Mbrojtjes Kombëtare dhe shpalli vendime lidhur me UJ-në. Si kryetar i RFJ-së, **S. M.** kishte kompetencë “për të urdhëruar zbatimin e Planit Kombëtar të Mbrojtjes” dhe komandoi UJ-në në luftë dhe në paqe në përputhje me vendimet e Këshillit Suprem të Mbrojtjes. **S. M.**, si komandat suprem i UJ-së, kreu këto detyra nëpërmjet “komandimeve, urdhrave dhe vendimeve”.

28. Sipas Ligjit mbi Mbrojtjen të RFJ-së, **S.M** si komandant suprem i UJ-së gjithashtu ushtroi autoritet komandues mbi njësitet policore republikane dhe federale, të cilat viheshin në vartësi të

UJ-së në gjendje lufte apo në gjendje të kanosjes së afërt të luftës. Deklarata e kanosjes së afërt të luftës u shpall më 23 mars 1999, ndërsa ajo e gjendjes së luftës më 24 mars 1999.

29. Përpos kompetencave të tij *de jure*, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **S.M** ushtroi kontroll të gjerë *de facto* mbi shumë institucione me rëndësi thelbësore për kryerjen e krimeve që përmenden në këtë aktakuzë, apo për përfshirjen në këto krime **S. M**, ushtroi kontroll të gjerë *de facto* mbi institucione federale që formalisht janë nën kompetencat e Kuvendit apo të Qeverisë së RFJ-së. **S. M** gjithashtu ushtroi kontroll *de facto* mbi funksione dhe institucione që formalisht janë nën kompetencat e Serbisë dhe të krahinave autonome, duke përfshirë policinë e Serbisë. **S.M** gjithashtu ushtroi kontroll *de facto* mbi shumë lëmenj të jetës dhe ekonomike të RFJ-së, veçanërisht mbi mjetet e informimit. Prej vitit 1986 deri në fillim të viteve 1990, **S. M** dalëngadalë mori nën kontroll *de facto* këto institucione federale, republikane dhe krahinore.

30. Kontrolli *de facto* i **S. M** mbi organet e Serbisë, të RSFJ-së dhe të RFJ-së dhe mbi organe të tjera shtetërore rrodhi pjesërisht nga udhëheqja prej tij e të dyja partive politike kryesore të cilat kanë qenë në pushtet në Serbi prej vitit 1986 deri në 2000 dhe në RFJ prej vitit 1992 deri në 2000. Prej vitit 1986 deri në 1990 ai ishte kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë, atëbotë partia në pushtet në Serbi. Në vitin 1990, ai u zgjodh Kryetar i Partisë Socialë të Serbisë (SPS), partia pasardhëse e Lidhjes së Komunistëve të Serbisë dhe të Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Serbisë. Gjatë periudhës së tij si kryetar i Serbisë, prej 1990 deri më 1997, dhe si kryetar i RFJ-së prej vitit 1997 deri në vitin 2000, **S. Mishte** edhe udhëheqës i SPS-së.

31. Duke filluar nga ajo më vonë se tetori i vitit 1988 dhe gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **S. M** ushtroi kontroll *de facto* mbi institucionet në pushtet dhe ato qeveritare të Serbisë, duke përfshirë policinë. Të paktën që nga tetori i vitit 1988, ai ushtroi kontroll *de facto* mbi të dy krahinat autonome të Serbisë – Kosovës dhe Vojvodinë – dhe mbi përfaqësimin e tyre në organet federale të RSFJ-së dhe RFJ-së. Të paktën që nga tetori i vitit 1988 deri në mesin e vitit 1998, **S. M** ka ushtruar gjithashtu kontroll *de facto* mbi institucionet në pushtet dhe ato qeveritare të Republikës së Malit të Zi (tutje: Mali i Zi), duke përfshirë përfaqësimin e Malit të Zi në të gjitha organet federale të RSFJ-së dhe të RFJ-së.

32. Prej vitit 1989 dhe gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **S.M** ishte bashkëbiseduesi kryesor i bashkësisë ndërkombëtare në negociata, takime dhe konferenca të rëndësishme ndërkombëtare. Me të u arritën marrëveshjet ndërkombëtare të cilat më vonë u zbatuan brenda Serbisë, RSFJ-së dhe gjetkë në territorin e ish-RSFJ-së. Ndër konferencat dhe negociatat ndërkombëtare në të cilat përfaqësues kryesor i RSFJ-së ishte **S. M** ishin: Konferenca e Hagës më 1991; negociatat e Parisit në mars 1993; Konferenca Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në janar 1993; negociatat për planin e paqes Vens-Ouen prej janarit deri në maj 1993; bisedimet për paqe në Gjenevë në verën e vitit 1993; mbledhja e Grupit të Kontaktit në qershor 1994; negociatat për një armë pushim në Bosnjë e Hercegovinë prej 9 deri më 14 shtator 1995;

negociatat për t'u dhënë fund bombardimeve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Bosnjë e Hercegovinë prej 14 deri më 20 shtator 1995; dhe negociatat për paqe në Dejton në nëntor të vitit 1995.

33. Si kryetar i RFJ-së, komandant suprem i UJ-së, kryetar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes dhe në bazë të autoritetit të tij *de facto*, **S. M** ishte përgjegjës për veprimet e vartësve të vet brenda UJ-së dhe cilësdo forcë policore, qoftë federale apo republikane, që kryen krimet e përfshira në këtë aktakuzë në Krahinën e Kosovës prej janarit të vitit 1999.

34. **M. M** u zgjodh kryetar i Serbisë më 21 dhjetor 1997 dhe vazhdon të jetë kryetar në datën e kësaj aktakuze. Si kryetar i Serbisë, **M. M**, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, ishte kryetar shteti. Ai përfaqëson Serbinë dhe udhëheq marrëdhëniet e Serbisë me shtete të huaja dhe organizata dhe organizata ndërkombëtare. Ai organizon përgatitjet për mbrojtjen e Serbisë.

35. Si kryetar i Serbisë, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **M. M** ishte anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes të RFJ-së dhe mori pjesë në vendime lidhur me përdorimin e UJ-së.

36. Si kryetar i Serbisë, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **M. M** ishte anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes të RFJ-së dhe mori pjesë në vendime lidhur me përdorimin e UJ-së.

37. Gjatë gjendjes së luftës së shpallur apo gjendjes së kanosjes së afërt të luftës, **M. M** si kryetar i Serbisë kishte mundësi të merrte masat që normalisht janë në kompetencat e Kuvendit, duke përfshirë miratimin e ligjeve; këto masa mund të përfshinin riorganizimin e qeverisë dhe të ministrive si edhe kufizimin e disa të drejtave dhe lirive.

38. Përpos kompetencave të tij *de jure*, gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **M. M** ushtroi ndikim apo kontroll të gjerë *de facto* mbi shumë institucione që për kryerjen e krimeve që paraqiten këtu, ishin esenciale, apo edhe të përfshira në to. **M. M** ushtroi ndikim apo kontroll *de facto* mbi funksione dhe institucione që teknikisht ishin nën kompetencat e qeverisë dhe Kuvendit të Serbisë dhe të krahinave autonome të saj, duke përfshirë policinë e Serbisë por pa u kufizuar vetëm me të.

39. Prej vitit 1995 dhe gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **M. M** ishte një nga bashkëbiseduesit kryesor të bashkësisë ndërkombëtare në negociata, takime dhe konferenca të rëndësishme ndërkombëtare. Ndër konferencat dhe negociatat ndërkombëtare në të cilat **M.M** ishte një përfaqësues parësor të RFJ-së janë: negociatat paraprake për një armëpushim në Bosnjë e Hercegovinë prej 15 deri më 21 gusht 1995; takimet e Gjenevës lidhur me armëpushimin e Bosnjës më 7 shtator 1995; negociatat e mëtejshme për një armëpushim në Bosnjë e Hercegovinë prej 9 deri më 14 shtator 1995; negociatat për t'u dhënë fund bombardimeve të NATO-së në Bosnjë e Hercegovinë prej 14 deri në 20 shtator 1995; dhe negociatat e paqes në Dejton në

nëntor 1995. **M. M** gjithashtu ka qenë i pranishëm në negociatat e Rambujesë në shkurt të vitit 1999.

40. Si kryetar i Serbisë dhe anëtar i Këshillit Suprem të Mbrojtjes dhe në bazë të autoritetit të tij *de facto*, **M. M** ishte përgjegjës për veprimet e të gjithë vartësve të tij brenda UJ-së dhe të të gjitha forcave policore që kanë kryer krimet e paraqitura në këtë aktakuzë që nga janari i vitit 1999 brenda krahinës së Kosovës.

41. **Gjeneralkoloneli D. O** u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së më 26 nëntor 1998. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, ai mbajti postin e Shefit të Përgjithshëm të UJ-së. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Gjeneralkoloneli **D. O** komandoi, urdhëroi, udhëzoi, rregulloi dhe për ndryshe drejtoi UJ-në, në bazë të akteve të lëshuara nga kryetari i RFJ-së dhe sipas nevojës për komandimin e UJ-së.

42. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli D. O** gjithashtu përcaktonte planin për rekrutimin dhe plotësimi e posteve të lira në UJ dhe shpërndarjen e rekrutëve brenda saj; lëshonte rregullore që kishin të bënin me stërvitjen e UJ-së; përcaktonte planin arsimor dhe përgatitjen e lartë të oficerëve ushtarakë profesionistë dhe rezervistë; dhe kryente detyra të tjera të caktuar me ligj.

43. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli D. O** – apo oficerë të tjerë të cilëve u ka dhënë autorizim – caktonte në detyrë oficerë, nënoficerë dhe ushtarë në detyrë. Ai gradonte nënoficerë, oficerë rezervistë dhe oficerë deri në rangun e kolonelit. **Gjeneralkoloneli D. O** gjithashtu emëronte kryetarë të gjyqeve, gjykatës, prokurorë dhe zëvendës dhe sekretarë të tyre, nëpër gjyqe disiplinore ushtarake.

44. **Gjeneralkoloneli D. O** kryente përgatitje për turrje në ushtri të qytetarëve dhe mobilizimin e UJ-së; ai bashkëpunonte me Ministrinë e Punëve të Brendshme të RFJ-së dhe të Serbisë dhe me Ministrinë e Mbrojtjes të RFJ-së, duke mobilizuar organet dhe njësitë e Ministrisë së Punëve të Brendshme; mbikëqyrte dhe propozonte masa për të korrigjuar probleme që haseshin gjatë këtij mobilizimi dhe informonte qeverinë e RFJ-së dhe Këshillin Suprem të Mbrojtjes rreth zbatimit të tij.

45. Si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, **Gjeneralkoloneli D. O** ishte përgjegjës për veprimet e vartësve të vet brenda UJ-së dhe për veprimet e çdo force policore federale apo republikane që ishin nën vartësinë e UJ-së dhe e cila kryen krime brenda Krahinës së Kosovës prej janarit të vitit 1999 deri në qershor të vitit 1999, duke i përfshirë që të dy këta muaj.

46. **V. S** u emërua ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë më 24 mars 1998. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **V. S** mbajti postin e ministrit të punëve të brendshme të Serbisë. Si

titullar i një ministrie të qeverisë serbe, **V. S** ishte përgjegjës për zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe të akteve të përgjithshme të nxjerra nga Kuvendi, qeveria, apo kryetari i Serbisë.

47. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **V. S** drejtonte punën e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe personelin e saj. Ai përcaktonte strukturën, mandatin dhe fushëveprimin e operacioneve të njësiteve të organizuara brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai kishte kompetenca të thirrte anëtarët e korpusit rezervist të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kryer detyrat në kohën e paqes dhe për të parandaluar veprime që kërcënonin sigurinë e Serbisë. Urdhrat të cilat ai dhe oficerët e lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme i dhanë personelit të Ministrisë së Brendshme ishin të detyrueshme, përveç në ato raste kur përbënin një veprim kriminal.

48. Si ministër i punëve të Brendshme të Serbisë, **V. S** kishte kompetencat për të rishikuar vendimet dhe veprimet e personelit të Ministrisë. Ai shqyrtonte ankesa kundër vendimeve të marra në instancën e parë nga shefi i një njësi të organizuar të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ai kishte gjithashtu kompetenca për të vendosur për ankesat e individëve që mbaheshin në arrest nga policia.

49. Më 8 prill 1999, kompetenca e **V. S** si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë u zgjeruan për të përfshirë transferimin e personelit të Ministrisë në detyra të ndryshme brenda Ministrisë për sa kohë që të jetë e nevojshme.

50. Si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë, **V. S** ishte përgjegjës për ruajtjen e ligjit dhe rendit në Serbi. Si ministër i Punëve të Brendshme, ai ishte përgjegjës për veprimet e vartësve të tij brenda forcave policore të Ministrisë së Brendshme të Serbisë që kryen krime në Krahinën e Kosovës prej fillimit të janarit të vitit 1999 deri në fund të qershorit 1999.

AKUZA TË PËRGJITHSHME

51. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë ka ekzistuar një gjendje e konfliktit të armatosur në Kosovës, RFJ.

52. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet që kualifikohen si krime kundër njerëzimit ishin pjesë të një sulmi të gjerë dhe sistematik kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës në RFJ.

53. Secili prej të akuzuarve është përgjegjës individualisht për krimet për të cilat është akuzuar në këtë aktakuzë, në bazë të Nenit 7 (1) të Statutit të Tribunalit. Përgjegjësia penale individuale përfshin kryerjen, planifikimin, nxitjen, urdhërimin apo ndihmesën në planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e çfarëdo krimi të përmendur në Nenet 2 deri në 5 të Statutit të Tribunalit.

54. Për aq sa kishte pushtet ose kontroll mbi UJ-në, mbi njësitet policore dhe njësite të tjera apo individë që ishin vënë në vartësinë e komandës së UJ-së në Kosovë, **S. M.**, si kryetar i RFJ-së, komandant suprem i UJ-së dhe kryetar i Këshillit Supreme të Mbrojtjes është gjithashtu, ose alternativisht, penalisht përgjegjës penal për veprimet e vartësve të tij, duke përfshirë anëtarët e UJ-së dhe personelin e lartpërmendur të Ministrive të Mbrojtjes të RFJ-së dhe të Serbisë, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

55. Për aq sa kishte autoritet ose kontroll mbi njësitet policore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të UJ-së, ose njësitet policore, njësite të tjera ose individë që ishin nën vartësinë e komandës së UJ-së në Kosovë, **M. M.**, si kryetar i Serbisë dhe anëtar i Këshillit Supreme të Mbrojtjes është gjithashtu, ose alternativisht, penalisht përgjegjës për veprat e vartësve të tij, duke përfshirë personelin e lartpërmendur të Ministrisë së Mbrojtjes të Serbisë, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

56. Për aq sa kishte autoritet ose kontroll mbi UJ-në, njësitë policore dhe njësi të tjera apo individë që ishin vënë në vartësinë e komandës së UJ-së në Kosovë, **Gjeneralkoloneli D. O.**, si shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së është gjithashtu, ose alternativisht, penalisht përgjegjës për veprat e vartësve të tij, duke përfshirë anëtarët e UJ-së dhe të punësuarit e lartpërmendur të Ministrive të Mbrojtjes së Serbisë dhe të RFJ-së, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

57. Për aq sa kishte autoritet ose kontroll mbi të punësuarit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke përfshirë çdo njësi tjetër policore të rregullt apo të mobilizuar, **V. S.**, si ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë është gjithashtu ose alternativisht penalisht përgjegjës për veprat e vartësve të tij, duke përfshirë të punësuarit e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, në bazë të Nenit 7 (3) të Statutit të Tribunalit.

58. Eprori është përgjegjës për veprat e vartës-it/ve të vet në qoftë se ka ditur apo ka pasur arsye të dinte se vartësi/-t ishte/ishin gati për të kryer veprime të tilla apo i kishte/kishin kryer dhe eprori nuk ka marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për të parandaluar veprime të tilla, apo për të ndëshkuar fajtorët për to.

FAKTE TË MËTEJSHME

59. Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë gjendet në pjesën jugore të Republikës së Serbisë, një republikë përbërëse e RFJ-së. Territori i tashëm i RFJ-së ishte pjesë e RSFJ-së. Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë kufizohet në veri dhe veriperëndim me Republikën e Malit të Zi, një republikë tjetër përbërëse e RFJ-së. Në jugperëndim, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë kufizohet me Republikën e Shqipërisë, kurse në jug me Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Kryeqyteti i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë është Prishtina.

60. Në vitin 1990, Republika Socialiste e Serbisë shpalli një Kushtetutë të re, me të cilën ndër të tjera, iu ndryshuan emrat republikës dhe krahinave autonome. Emri i Republikës Socialiste të Serbisë u ndryshua në Republika e Serbisë (të dyja tutje “Serbia”); emri i Krahinës Autonome Socialiste e Kosovës u ndryshua në Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë (të dyja më tej “Kosova”); dhe emri i Krahinës Socialiste Autonome të Vojvodinës u ndryshua në Krahina Autonome e Vojvodinës (më tej “Vojvodina”). Gjatë kësaj periudhe, Republika Socialiste e Malit të Zi ndryshoi emrin në Republikën e Malit të Zi.

61. Në vitin 1974, Kushtetuta e re e RSFJ-së parashihte decentralizimin e pushtetit qendror në të gjashtë republikat përbërëse të vendit. Brenda Serbisë, Kosova dhe Vojvodina fituan autonomi të gjerë, duke përfshirë kontrollin e sistemeve të tyre arsimore, të gjykatave dhe të policisë. Fituan gjithashtu kuvendet e tyre dhe përfaqësoheshin në Kuvendin, Gjykatën Kushtetuese dhe Kryesinë e RSFJ-së.

62. Në vitin 1981, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë me pjesëmarrje pothuajse të plotë, Kosova kishte përafërsisht 1.585.000 banorë, prej të cilëve 1.227.000 (77 për qind) ishin shqiptarë, ndërsa 210.000 (13 për qind) ishin serbë. Ka në dispozicion vetëm vlerësime për popullsinë Kosovës në vitin 1991, sepse shqiptarët e Kosovës bojkotuan regjistrimin e popullsisë të organizuar në atë vit. Sipas vlerësimeve të përgjithshme, gjatë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, Kosova kishte midis 1.800.000 e 2.100.000 banorë, prej të cilëve rreth 85-90 për qind ishin shqiptarë të Kosovës dhe 5-10 për qind ishin serbë.

63. Gjatë viteve 80, serbët shprehën shqetësime për diskriminimin e tyre nga qeveria krahinore e udhëhequr nga shqiptarët e Kosovës. Në të njëjtën kohë, shqiptarët e Kosovës shprehën shqetësime lidhur me zhvillimin e pakët ekonomik dhe kërkuan liberalizimin politik dhe statusin e republikës për Kosovën. Që nga viti 1981, shqiptarët e Kosovës organizuan demonstrata, që u shtypën nga Ushtria e RSFJ-së dhe forcat policore të Serbisë.

64. Në prill të vitit 1987, **S. M.**, i cili ishte zgjedhur kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë në vitin 1986, shkoi në Kosovë. Në takime me udhëheqës të serbëve vendës dhe në një fjalim të mbajtur para një turme serbësh, **S.M** përkrahu një program të nacionalizmit serb. Me këtë hap, ai braktisi politikën e partisë dhe të pushtetit e cila, prej themelimit të shtetit nga Josip Broz Tito pas Luftës së Dytë Botërore, kishte kufizuar shprehjen e nacionalizmit në RSFJ. Që atëherë, **S. M** shfrytëzoi baticën e nacionalizmit serb për të forcuar pushtetin qendror në RSFJ.

65. Në shtator të vitit 1987, **S. M** dhe përkrahës të tij morën nën kontroll Komitetin Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë. Në vitin 1988, **S. M** u rizgjodh kryetar i Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Serbisë. Nga kjo pozitë me ndikim, **S. M** pati mundësi që të zhvillonte më tej pushtetin e vet politik.

66. Prej korrikut të vitit 1988 deri në mars 1989 ndodhën në Vojvodinë dhe Mal të Zi një varg demonstratash dhe mitingjesh në përkrahje të politikës së **S. M** – të ashtuquajturit “revolucion antiburokratik”. Këto protesta çuan në përmbyjsjen e qeverisë përkatëse krahinore dhe republikane. Qeveritë pasardhëse e përkrahën **S. M** dhe i detyroheshin atij.

68. Në po këtë kohë, brenda Serbisë u shpeshuan thirrjet për ta vënë Kosovën nën një pushtet më të fortë serb, për ç’gjë u mbajtën shumë demonstrata. Më 17 nëntor 1988, personalitete të larta politike të shqiptarëve të Kosovës u larguan nga udhëheqja krahinore, ndërsa në vend të tyre u emëruan njerëz besnikë ndaj **S. M**. Në fillim të vitit 1989, Kuvendi i Serbisë propozoi ndryshime në Kushtetutën e Serbisë, të cilat do të zhvishnin Kosovën nga pjesa më e madhe e autonomisë, duke përfshirë kontrollin mbi policinë, politikën arsimore dhe ekonomike, zgjedhjen e gjuhës zyrtare dhe ë drejtën e vetos mbi ndryshime të mëtejshme në Kushtetutën e Serbisë. Shqiptarët e Kosovës bënë protesta masive kundër ndryshimeve të propozuara. Duke filluar nga shkurti i vitit 1989, një grevë e minatorëve shqiptarë të Kosovës tendosi gjendjen edhe më shumë.

69. Për shkak të trazirave politike, më 3 mars 1989 Kryesia e RSFJ-së deklaroi se gjendja në krahinë ishte keqësuar dhe përbënte një kërcënim ndaj kushtetutës, integritetit dhe sovranitetit të vendit. Qeveria pastaj imponoi “masa të posaçme”, të cilat i dhanë përgjegjësinë për sigurinë publike qeverisë federale, në vend të qeverisë së Serbisë.

70. Më 23 mars 1989, Kuvendi i Kosovës u mbledh në Prishtinë dhe me abstenimin e shumicës së delegatëve të shqiptarëve të Kosovës, votoi për pranimin e ndryshimeve të propozuara për Kushtetutën. Edhe pa shumicën e duhur të dy të tretave të votave në Kuvend, kryetari i Kuvendit shpalli miratimin e ndryshimeve. Më 28 mars 1989, Kuvendi i Serbisë votoi për të miratuar ndryshimet në Kushtetutë, duke hequr faktikisht autonominë e dhënë me Kushtetutën e vitit 1974.

71. Në kohën e këtyre ndryshimeve në Kosovë, **S. M** forcoi më tej pushtetin e vet politik kur u bë kryetar i Serbisë. **S. M** u zgjodh kryetar i Kryesisë së Serbisë më 8 maj 1989 dhe posti iu konfirmua formalisht më 6 dhjetor 1989.

72. Në fillim të vitit 1990, shqiptarët e Kosovës mbajtën demonstrata masive për të kërkuar heqjen e “masave të posaçme”. Në prill të vitit 1990, Kryesia e RSFJ-së i hoqi “masat e posaçme” dhe tërhoqi shumicën e forcave policore, ndërsa Serbia mori përsipër përgjegjësinë për detyra policore në Kosovë.

73. Në korrik të vitit 1990, Kuvendi i Serbisë miratoi vendimin për të pezulluar Kuvendin e Kosovës, pak kohë mbasi që 114 prej 123 delegatëve shqiptarë të Kosovës në këtë Kuvend miratuan një rezolutë jozyrtare me anë të së cilës Kosova u shpall njësi e barabartë dhe e pavarur brenda RSFJ-së. Në shtator të vitit 1990 shumë prej këtyre delegatëve shqiptarë të Kosovës

shpallën kushtetutën e “Republikës së Kosovës”. Një vit më vonë, në shtator të vitit 1991, shqiptarët e Kosovës mbajtën një referendum jozyrtar në të cilin shumica dërrmuese votuan për pavarësi. Më 24 maj 1992, shqiptarët e Kosovës mbajtën zgjedhje jozyrtare për kuvendin dhe kryetarin e “Republikës së Kosovës”.

74. Më 16 korrik 1990, Lidhja e Komunistëve të Serbisë dhe Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Serbisë u bashkuan për të formuar Partinë Socialiste të Serbisë (SPS). **S. M** u zgjodh kryetar i partisë. Si pasardhëse e Lidhjes së Komunistëve, SPS-ja u bë partie politike kryesore në Serbi; **S. M** si kryetar i SPS-së, pati mundësi për të ushtruar pushtet dhe ndikim të konsiderueshëm në shumë degë të qeverisë si dhe të sektorit privat. Edhe **M. M** dhe **N. SH** ishte anëtar Këshillit Drejtues dhe i Këshillit Ekzekutiv dhe nënkryetar i partisë. **M. M** fitoi zgjedhjet për postin e kryetarit të Serbisë si kandidat i SPS-ë më 1997.

75. Pas miratimit të Kushtetutës së re të Serbisë më 28 shtator 1990, **S. M** u zgjodh kryetar i Serbisë në zgjedhje shumëpartiake që u mbajtën më 9 dhe 26 dhjetor 1990. U rizgjodh më 20 dhjetor 1992. Në dhjetor të vitit 1991, **N. SH** u emërua zëvendëskryeministër i Serbisë.

76. Pas heqjes faktike të autonomisë së Kosovës më 1989, u thelluan ndasitë në gjendjen politike në Kosovë. Në fund të vitit 1990 dhe gjatë vitit 1991, mijëra shqiptarë të Kosovës – mjekë, arsimtarë, profesorë, punëtorë, policë dhe nëpunës – u përzhunë nga postet e tyre. Gjykatat vendore në Kosovë u hoqën dhe shumë gjykatës u larguan nga puna. U shtua dhuna policore kundër shqiptarëve të Kosovës.

77. Gjatë kësaj periudhe, udhëheqja jozyrtare e shqiptarëve të Kosovës ndiqte politikën e rezistencës qytetare paqësore dhe filloi të vendoste sistemin e institucioneve paralele dhe jozyrtare në sektorët e shëndetësisë dhe të arsimit.

78. Në fund të qershorit të vitit 1991 filloi shpërbërja e RSFJ-së në një sërë luftërash të njëpasnjëshme në Republikën e Sllovenisë (më tej “Sllovenia”), në Republikën e Kroacisë (më tej: Kroacia”), dhe në Republikën e Bosnjës e Hercegovinës. Më 25 qershor 1991 Sllovenia shpalli pavarësinë nga RSFJ-ja, gjë që çoi në shpërthimin e luftës. Një marrëveshje e paqes u arrit më 8 korrik 1001. Kroacia shpalli pavarësinë më 25 qershor 1991, gjë që çoi në luftime midis forcave ushtarake kroate, në një anë dhe Armatës Popullore të Jugosllavisë (APJ), njësive paramilitare dhe “Armatës së Republikës së Krajnës Serbe”, në anën tjetër.

79. Më 6 mars 1992 Bosnja e Hercegovina shpalli pavarësinë, gjë që çoi në një luftë të gjerë pas 6 prillit të vitit 1992. Më 27 prill 1992, RSFJ-ja u rikonstitua si RFJ. Atëherë APJ-ja u riformua si UJ-ja. Gjatë luftës në Bosnjë e Hercegovinë, APJ-ja dhe më vonë UJ-ja luftuan bashkë me “Ushtrinë e Republikës Serbe” kundër forcave ushtarake të qeverisë së Bosnjës e Hercegovinës dhe të “Këshillit Kroat të Mbrojtjes”. Luftimet aktive pushuan me nënshkrimin e marrëveshjes së Dejtonit në dhjetor të vitit 1995.

80. Edhe pse **S. M** ishte kryetar i Serbisë gjatë luftërave në Slloveni, Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, ai ishte politikani kryesor serb që ushtroi kontroll faktik mbi qeverinë federale si dhe atë republikane. Ai ishte gjithashtu njeriu me të cilin bashkësia ndërkombëtare bëri biseda për një sërë planesh të paqes dhe marrëveshjes lidhur me këto luftëra.

81. Midis viteve 1991 dhe 1997, si **M. M** ashtu edhe **N. SH** mbajtën disa poste të larta brenda qeverive federale dhe republikane dhe vazhduan të bashkëpunonin ngushtë me **S. M**. Gjatë kësaj periudhe, **M. M** punoi në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RFJ-së dhe për një kohë ishte ambasador në Greqi. Më 1995, ai u caktua ministër i Punëve të Jashtme të RFJ-së.. Mbeti në këtë post deri më 1997. **N. SH** ishte kryeministër i Serbisë më 1993 dhe zëvendëskryeministër i RFJ-së më 1994.

82. Në kohën e luftërave në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë, gjendja në Kosovë, ndonëse e tendosur, nuk shpërtheu në dhunën dhe luftimet intensive të sojit çfarë u panë në vende të tjera. Mirëpo, nga mesi i viteve 90, një pjesë e shqiptarëve të Kosovës organizoi një grup, të quajtur *Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)*. Ky grup u angazhua për një fushatë kryengritjeje të armatosur, duke bërë rezistencë me dhunë kundër autoriteteve serbe. Në mes të vitit 1996, forcat e UÇK-së filluan sulme drejtuar kryesisht kundër forcave policore të RFJ-së dhe të Serbisë. Pastaj, edhe gjatë tërë vitit 1997, forcat policore të RFJ-së dhe të Serbisë u përgjigjën me aksione të fuqishme kundër bazave dhe përkrahësve të mundshëm të UÇK-së në Kosovë.

83. Pas përfundimit të mandatit si kryetar i Serbisë, **S. M** u zgjodh kryetar i RFJ-së më 15 korrik 1997 dhe u inaugurua në këtë post më 23 korrik 1997. Pastaj u mbajtën zgjedhjet për postin e kryetarit të Serbisë. **M.M** mori pjesë në zgjedhje si kandidat i SPS-së dhe u zgjodh kryetar u riemërua zëvendëskryeministër i RFJ-së. Pjesërisht falë lidhjeve të tij të ngushta me **M.M**, **S. M** mund të ruante ndikimin e tij mbi qeverinë e Serbisë.

84. Nga fundi i shkurtit të vitit 1998, thellohej konflikti ndërmjet UÇK-së, në një anë, dhe forcave të RFJ-së dhe të Serbisë në anën tjetër. Një numër shqiptarësh të Kosovës dhe serbësh të Kosovës u vranë dhe u plagosën gjatë kësaj kohe. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i hynë një fushate të granatimit të qyteteve dhe fshatrave të banuara kryesisht nga shqiptarët e Kosovës, të shkatërrimeve të mëdha të pasurisë dhe të dëbimeve të popullsisë civile nga viset në të cilat vepronte UÇK-ja. Shumë banorë ikën nga ky territor për shkak të luftimeve apo shkatërrimeve, apo u detyruan të shpërnguleshin në vende të tjera brenda Kosovës. Sipas vlerësimeve të Kombeve të Bashkuara, deri në mesin e tetorit të vitit 1998, mbi 298.000 njerëz, apo afër 15 për qind të popullsisë, u zhvendosën brenda Kosovës ose u larguan nga krahina.

85. në përgjigje ndaj thellimit të konfliktit, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1160 në mars të vitit 1998, “duke dënuar përdorimin e forcës së tepruar nga forcat policore serbe kundër civilëve dhe demonstruesve paqësor në Kosovë”, dhe vendosi embargon e

armëve kundër RFJ-së. Gjashtë muaj më vonë, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1199 (1998), e cila theksonte se “keqësimi i gjendjes në Kosovë, Republika Federale të Jugosllavisë, kërcënon paqen dhe sigurinë në rajon”. Këshilli i Sigurimit kërkoi pushimin e luftimeve nga të gjitha palët dhe tërheqjen e “forcave që përdoren për shtypjen e civilëve”.

86. Në përpjekje për të ulur tensionet në Kosovë, përfaqësuesit e NATO-s dhe të OSBE-së mbajtën bisedime me **S. M** në tetor të vitit 1998. “Marrëveshja për Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë” u nënshkrua më 16 tetor 1998. Kjo marrëveshje dhe “marrëveshja Klark-Nauman”, e cila u nënshkrua nga **N. SH**, parashikoi tërheqjen e pjeshme të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë nga Kosova, kufizimin e futjes së forcave dhe të pajisjeve të tjera në krahinë, dhe vendosjen e verifikuesve të paarmatosur të OSBE-së.

87. Edhe pse dhjetëra verifikues të OSBE-së u vendosën anembanë Kosovës, luftimet vazhduan. Gjatë kësaj periudhe, verifikuesit ndërkombëtarë dhe organizatat për të drejtat e njeriut dokumentuan një sërë vrasjesh të shqiptarëve të Kosovës. Në një rast të tillë, më 15 janar 1999, 45 shqiptarë të paarmatosur të Kosovës u vranë në fshatin Reçak, në komunën e Shtimes.

88. Përsëri në përgjigje të konfliktit që po vazhdonte në Kosovë, u organizua një konferencë ndërkombëtare e paqes në Rambuje të Francës, e cila filloi më 7 shkurt 1999. **N. SH**, zëvendëskryeministër i RFJ-së, ishte anëtar i delegacionit serbë në bisedimet e paqes dhe **M. M**, kryetar i Serbisë, gjithashtu ishte i pranishëm gjatë negociatave. Shqiptarët e Kosovës u përfaqësuan nga UÇK-ja dhe një delegacion prej udhëheqësve politikë e qytetarë të shqiptarëve të Kosovës. Me gjithë negociatat intensive që zgjatën disa javë, bisedimet dështuan në mesin e marsit të vitit 1999.

89. Dhuna në Kosovë vazhdoi gjatë bisedimeve të paqes në Francë. Në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sërë ofensivash kundër dhjetë fshatrave dhe qyteteve të banuara kryesisht nga shqiptarë të Kosovës. Forcat ushtarake të RFJ-së përfshinin njësi të Armatë së Tretë konkretisht Korpusin e 52-të, të quajtur Korpusi i Prishtinës, me disa brigada dhe regjimente nën komandën e Korpusit të Prishtinës. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, me përgjegjësinë komanduese mbi Armatën e Tretë dhe rrjedhimisht mbi Korpusin e Prishtinës, ishte Gjeneralkoloneli D. O. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, Komandanti Suprem i UJ-së ishte **S. M**.

90. Forcat policore që merrnin pjesë në aksione në Kosovë ishin pjesëtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, bashkë me disa njësi nga Ministria e Punëve të Brendshme e RFJ-së. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, të gjitha forcat policore që ishin punësuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë apo që punonin nën autoritetin e saj ishin nën komandën e **V.S**, ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë. Sipas Ligjit për Mbrojtjen e RFJ-së, këto forca policore të angazhuara në aksione ushtarake gjatë gjendjes së luftës apo kanosjes së

afërt të luftës i nënshtroreshin komandës së UJ-së, komandantë të së cilës gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë ishin **Gjeneralkoloneli D. O** dhe **S. M.**

91. Para dhjetorit të vitit 1998, **S. M** caktoi **N. SH** si përfaqësues të tij për gjendjen në Kosovë. Një sërë diplomatësh dhe zyrtarësh të tjerë ndërkombëtar, të cilët kishin nevojë të bisedonin me një zyrtar qeveritar rreth ngjarjeve në Kosovë, ishin drejtuar te **N. SH**. Ai luajti një rol aktiv në negociatat që çuan në themelimin e misionit verifikues të OSBE-së për Kosovën dhe mori pjesë në shumë takime të tjera rreth krizës në Kosovë. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **N. SH** mori përsipër rolin e ndërlihdësit midis **S. M** dhe udhëheqësve të ndryshëm të shqiptarëve të Kosovës.

92. **N. SH** u ricaktua zëvendëskryeministër i RFJ-së më 20 maj 1998. Rrjedhimisht, ai ishte anëtar i qeverisë së RFJ-së e cila, ndër detyra dhe përgjegjësi të tjera, përcaktoi politikën e brendshme dhe të jashtme; zbatoi ligjin federal, drejtoi dhe bashkërenditi punën e ministrive federale, dhe organizoi përgatitje për mbrojtje.

93. Gjatë ofensivave të tyre, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vepruan bashkërisht, duke u angazhuar në një fushatë të planifikuar dhe të bashkërenditur mirë për të shkatërruar pasurinë e civilëve shqiptarë të Kosovës. U garantuan qytete dhe fshatra; u dogjën shtëpi, ekonomi bujqësore dhe objekte ekonomike; u shkatërrua pasuria personale. Si pasojë e këtyre aksioneve të planifikuara, qytete, fshatra dhe rajone të tëra u bënë të pabanueshme për shqiptarë të Kosovës. Përveç kësaj, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përndoqën, poshtëruan dhe degraduan shqiptarët e Kosovës përmes keqtrajtimit fizike dhe verbale. Shqiptarët e Kosovës gjithashtu u nënshtroan vazhdimisht sharjeve, fyerjeve, raciste, veprimeve poshtëruese mbi bazë të përkatësisë së tyre etnike dhe fetare; rrahjeve dhe formave të tjera të keqtrajtimit fizik.

94. Dëbimi i jashtëligjshëm dhe transferimi i dhunshëm i mijëra shqiptarëve të Kosovës nga shtëpitë e tyre në Kosovë janë bërë përmes përpjekjesh të planifikuara dhe të bashkërenditura mirë nga udhëheqësit e RFJ-së dhe të Serbisë dhe forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, që të gjithë duke vepruar bashkërisht. Aksione të ngjashme kanë ndodhur gjatë luftërave në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë në vitet 1991-1995. Gjatë këtyre luftërave, forcat ushtarake paraushtarake dhe policore serbe dëbuan me forcë dhe depërtuan popullatën jo serbe nga viset nën kontrollin serb në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë, duke përdorur të njëjtat metoda të veprimit si në Kosovë në vitin 1999: granatimet me armë të rënda; sulmet e armatosura mbi fshatra; vrasje masive; shkatërrimin e vendbanimeve jo serbe dhe të objekteve kulturore dhe fetare; dhe transferimin e dhunshëm dhe depërtimin e popullatave jo serbe.

06. Më 24 mars 1999, NATO-ja filloi sulmet ajrore kundër caqeve në RFJ. RFJ-ja shpalli dekrete për kanosjen e afërt të luftës më 23 mars 1999 dhe të gjendjes së luftës më 24 mars 1999. Pas fillimit të sulmeve ajrore, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan fushatën e tyre sistematike dhe dëbuan me dhunë qindra mijëra shqiptarë të Kosovës.

95. Përveç dëbimit me d hunë të shqiptarëve të Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë gjithashtu kanë marrë pjesë në një numër vrasjesh të shqiptarëve të Kosovës pas 24 marsit të vitit 1999. Vrasjet e tilla kanë ndodhur në shumë vende, duke përfshirë Bellacërkën, Krushën e Vogël, Krushën e Madhe, Gjakovën, Padalishtën, Izbicën, Vushtrrinë, Mejën, Burgun e Dubravës, Suharekën dhe Kaçanikun, dhe pa u kufizuar vetëm në këto vendbanime.

96. Përgatitja dhe kryerja e fushatës së ndërmarrë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë ishte planifikuar, nxitur, urdhëruar, zbatuar apo në ndonjë mënyrë tjetër ndihmuar nga **S. M** kryetar i RFJ-së; **M. M** kryetar i Serbisë, **N. SH**, zëvendëskryeministër i RFJ-së; Gjeneralkoloneli Dragolub OJDANIQI, shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së; dhe **V. S**, ministër i Punëve të Brendshme të Serbisë.

97. Deri më 20 maj 1999, më shumë se 740.000 shqiptarë të Kosovës, afër një e treta e popullsisë së Kosovës, u dëbuan nga Kosova. Mendohej se mijëra të tjerë ishin zhvendosur brenda vendit. Një numër i panjohur shqiptarësh të Kosovës u vranë në operacione të ndërmarra në forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.

98. Më 3 qershor 1999, RFJ-ja dhe Serbia pranoi një dokument parimor që synonte ta zgjidhte krizën në Kosovë, i cili u dorëzua përfaqësuesve të tyre nga përfaqësuesi i Bashkimit Evropian Martti Ahtisaari, dhe, përfaqësuesi i posaçëm i Federatës Ruse Viktor Çernomyrdin. Ky dokument, i cili parapriu Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244 (1999), parashikoi një zgjidhje politike të krizës së Kosovës, duke përfshirë ndërprerjen e menjëhershme të dhunës dhe tërheqjen e shpejtë të forcave ushtarake, policore dhe paraushtarake të RFJ-së dhe të Serbisë, bashkë me dërgimin e personelit civilë dhe personelit të sigurisë nën kujdesin e OKB-së.

99. më 9 qershor 1999, Marrëveshja Ushtarake Teknike u nënshkrua midis NATO-s, të përfaqësuar nga Gjeneral Sir Michael Jackson dhe përfaqësuesve të UJ-së dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kjo marrëveshje parashikoi tërheqjen e të gjitha forcave të FRJ-së dhe të Serbisë nga Kosova. Sipas dispozitave të Marrëveshjes Ushtarake Teknike, fushata e NATO-s e bombardimit kundër caqeve në RFJ do të ndërpritej pas tërheqjes së plotë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë. Më 20 qershor 1999, KFOR-i shpalli tërheqjen e plotë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë nga territori i Kosovës.

Karla Del Ponte (Carla Del Ponte) Prokurore _____

29 qershor 2011

Hagë, Holandë

Formulari 68

AKTVENDIM PËR KTHYERJEN E AKTAKUZËS PËR TA PLOTËSUAR

Gjykata Themelore në _____ me gjyqtarin H.K., me procesmbajtësin L.P, në çështjen penale të pandehurit M.H. nga _____ për shkak të veprës penale mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik parashikuar nga neni 381 par.5 lidhur me par.1 të KPK-ës, duke vendosur lidhur me kundërshtimin e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij ndaj aktakuzës së Prokurorit Shtetëror në _____ PP.nr. _____ datë _____, në seancën fillestare të mbajtur më _____, mori:

A K T V E N D I M

Aktakuza PP.nr. _____ datë _____, e Prokurorisë së Shtetit të Prokurorisë Themelore në _____, i kthehet në plotësim në afat prej 3 ditësh.

Nëse Prokurori nuk e plotëson aktakuzën në afatin e lënë e njëjta do të hedhet si e parregullt.

A r s y e t i m i

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____, pas zbatimit të hetimeve me aktakuzën PP.nr. _____ datë _____, ka akuzuar të pandehurin M.H. për shkak të veprës penale mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik parashikuar nga neni 381 par.1 i Kodit Penal të Kosovës.

Gjyqtari i çështjes duke vepruar sipas kësaj aktakuze ka caktuar shqyrtimin fillestar në të cilin ishin të pranishëm i pandehuri M.H., mbrojtësi i tij avokati B.B. nga _____, Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë F.T. Me këtë shqyrtim fillestar mbrojtësi paraqiti kundërshtimet e tij sa i përket ligjshmërisë së aktakuzës me pretendim se aktakuza është ngritur ndaj të pandehurit i cili në rastin konkret nuk ka cilësinë e personit përgjegjës, nga se ai ditën kritike ishte vetëm udhëheqës i ndërrimit ndërsa person përgjegjës i punishtes ku atë ditë kryeshin punët është Z.L., andaj ka propozuar që ndaj të pandehurit të hedhet aktakuza ose eventualisht të plotësohen hetimet.

Gjyqtari pas shqyrtimit të kundërshtimeve të mbrojtësit të pandehurit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur:

Nga provat e mbledhura gjatë hetimeve është vërtetuar se në rrugën regjionale Prishtinë-Pejë janë kryer punët në riparimin e kësaj rruge nga ana e ndërmarrjes për mirëmbajtjen e rrugëve “Graniti” me seli në _____. Ditën kritike në mesin e punimeve tjera është bërë një prerje e thellë e asfaltit në këtë pjesë të rrugës me ç’rast në rrethanat të tilla rruga ka qenë e pashfrytëzueshme, me të përfunduarit të orarit të punës mjetet që janë përdorur për punë janë mbledhur dhe në rrugë nuk është vënë asnjë paralajmërim ndriçues sikundër urdhërojnë dispozitat e ligjit për sigurinë në trafikun publik se në këtë pjesë rruga është e pakalueshme dhe duhet të shfrytëzohen rrugët dytësore, ashtu që tani i ndjeri B.H. duke u kthyer nga bota e jashtme dhe duke mos pasur fare njohuri se në atë pjesë rruga është e pakalueshme kur ka ardhur me makinën e tij në vendin kritik ka tentuar të frenojë por megjithatë në pjesën e përparme të makinës është fut në prerjen e asfaltit që ishte bërë nga punëtorët e kësaj kompanie dhe nga lëndimet që ka pësuar në këtë aksident pas 2 dite ka vdekur në QKUK.

Gjykata gjen se në procedurën e hetuesisë nuk janë ndriçuar në masë të duhur faktet vendimtare dhe atë: a është i pandehuri M.H. person përgjegjës lidhur me kryerjen e punëve në këtë rrugë, nga se sipas nenit 381 të KPK-ës, këtë vepër penale mund ta kryej vetëm personi përgjegjës.

Nga provat që janë bashkangjitur aktakuzës, për tani nuk mund të vërtetohet se i pandehuri kishte cilësinë e personit përgjegjës ditën kritike, kur me rastin e kryerjes së punimeve në rrugë ishte lëshuar vendosja e shenjave në të cilët i paralajmëronte pjesëmarrësit në trafik se në atë pjesë të rrugës për shkak të punimeve rruga është e pakalueshme. Kjo nuk rezulton as nga procesverbali mbi gjetjet e inspektorëve dhe as nga Bordi i kompanisë me çka me të drejtë i referohet kundërshtimi i mbrojtjes.

Për të mund të vlerësuar ligjshmërinë e aktakuzës e Prokurorit të Shtetit PP.nr.____datë____, është e nevojshme të plotësohen hetimet në drejtim të sigurimit të provave me qëllim të sqarimit të fakteve relevante se i pandehuri a kishte cilësi të personit përgjegjës ditën kritike me rastin e kryerjes së punëve në pjesë të rrugës ku u shkaktua aksidenti përkatësisht çfarë ka qenë roli i tij ditën kritike me rastin e kryerjes së punëve në rrugë.

Prokurori i Shtetit është paralajmëruar se nëse nuk vepron në kundërshtim me këtë vërejtje gjykata do e hedhë aktakuzën.

Nga të ushtruarat më lart u vendos si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 442 par.3 të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Pn.nr. ____ datë ____

Procesmbajtësi,

L.P.

Gjyqtari,

H.K.

Formulari 69

PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT FILLESTAR-KUR TË AKUZUARIT NUK KANË PRANUAR FAJËSINË

(Neni 245)

PKR.nr. _____

PROCESVERBALI I SHQYRTIMIT FILLESTAR TË AKTAKUZËS

I përpiluar më dt. _____ në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në _____, në çështjen penale të pandehurve 1. _____ 2. _____ 3. _____, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par 1 lidhur me neni 31 të KPRK, të pandehurit 1. _____ 2. _____ 3. _____ 4. _____ dhe 5. _____, për shkak të veprës penale ndotja e degradimi ose shkatërrimi i mjedisit, ty; paparashikuar nga neni 347 par 1 lidhur me neni 31 të KPRK.

Prezantojnë:

Kryetari i trupit gjykues,

Prokurori i shtetit

Të pandehurit

- 1.
- 2.
- 3.

4.

5.

Mbrojtësi

Sekretare juridike,

1.

2.

3.

4.

5.

Filloi në ora 13:20 minuta

Shqyrtimi fillestar është publik

Kryetari i trupit gjykues konstaton se në shqyrtimin e sotëm fillestar prezentojnë prokurori _____ i _____ shtetit _____, të pandehurit 1. _____ 2. _____ 3. _____ 4. _____ dhe 5. _____, mbrojtësit e të pandehurve si dhe praktikantët e zyrës së avokatëve.

Kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e këtij shqyrtimi fillestar.

Kryetari i trupit gjykues e fton të pandehurin dhe nga i njëjti merr shënimet personale.

I pandehuri 1. _____ me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës pa ndryshime,

I pandehuri 2. _____ me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës pa ndryshime,

I pandehuri 3. _____ me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës pa ndryshime,

I pandehuri 4. _____ me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës pa ndryshime,

I pandehuri 5. _____ me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës pa ndryshime,

Meqenëse se i pandehuri par. _____ dhe i pandehuri 4. _____ nuk ka mbrojtës me autorizim, si dhe duke e pas parasysh kërkesën e tyre dhe peshën e veprave penale për të cilat akuzohen, atëherë kryetari i trupit gjykues mori këtë ,

A K T V E N D I M

Të pandehurin 1. _____ t'i caktohet sipas detyrës zyrtare avokat _____, ndërsa të pandehurit 4. _____ avokat _____, .

Pa vërejtje .

Kryetari i trupit gjykues konstaton se e drejta në mbrojtës e të pandehurit është respektuar dhe se prokurori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i KPP.

Nga shkresat e lëndës shihet se nga një kopje e aktakuzës i është dorëzuar të pandehurve edhe atë:

Të pandehurit 1. _____ dhe mbrojtësit të tij më datën 24.03.2016, të pandehurit 4. _____ dhe mbrojtësit të tij më dt. 24.03.2016, , të pandehurit 5. _____ dhe mbrojtësit të tij më datën 29.03.2016 .Të pandehurve 2 dhe 3. Dhe avokatëve të tyre më dt. 14.04.2016,

Kryetari i trupit gjykues i udhëzon të pandehurit për të drejtën e tyre për të mos u deklaruar për çështjen e tyre ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen e tyre nuk e ka për detyrë ta inkriminojë vetveten ose të afërmit e tyre të mbrohet vet ose përmes mbrojtësit dhe ta kundërshtojë aktakuzën ose pa panshmërinë e provave në aktakuzë.

Të pandehurit udhëzohen se pranimi i fajësisë konsiderohet rrethanë mbi bazën e së cilës gjykata mund ta zbusë dënimin.

Ftohet prokurori _____, që ta lexojë aktakuzën PP.I.nr. _____.

Pas leximit të aktakuzës të gjithë të pandehurit deklaruan se kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohen, dhe se nuk e pranojnë fajësinë.

Në këtë fazë të procedurës avokati NN. mbrojtës i të akuzuarit të parë deklaroi: meqenëse pas ngritjes së aktakuzës në kuptim të dispozitës së nenit 244 të KPK nuk janë zbardhur provat të cilat i mbështet kjo aktakuzë, në bazë të para 3 të kësaj dispozite ligjore kërkoj nga gjykata që në afatin ligjor prokurori i shtetit apo edhe gjykata të na ofroj të gjitha provat në të cilat mbështet aktakuza. Përndryshe me rastin e deponimit të autorizimit në prokurori e në kuptim të dispozitës së nenit 132 paragrafi 6 , mbrojta ka kërkuar që të njoftohet në afatin ligjor përkitazi me marrjen e provave gjatë fazës së hetimeve, mirëpo jo që nuk jemi njoftuar por prokurori nuk na ka lejuar që të prezantojmë gjatë nxjerrjes së këtyre provave duke përfshirë edhe marrjen në pyetje edhe gjatë marrjes në pyetje të pandehurve tjerë.

Prokurori _____ lidhur me këtë deklaroi: për sa i përket pajisjes mbrojtësve me shkresa të lëndës zotohemi se në afat sa më të shkurtër do ti pajisim me shkresa të lëndës të gjithë mbrojtës në këtë çështje penalo-juridike ndërsa sa i përket konstatimit të mbrojtësit të të akuzuarit _____, se kinse prokurori i ka ndalu që të marrin pjesë në seanca me rastin e dëgjimit të dëshmitarëve përkatësisht sigurimit të provave ky konstatim konsideroj se është i paqëndrueshëm , se ky fakt fare nuk ekziston por varet nga interesimi i mbrojtjes se sa është në gjendje me i përcjell seancat me rastin e intervistimit të dëshmitarëve të çështjes penale. Është çështja e avokatëve se sa janë të zënë me shërbime të tjera por nuk është obligim i prokurorit që në çdo fazë t'i ftoj mbrojtësit , që kjo e drejtë në asnjë mënyrë nuk iu është kufizuar atyre.

Duke u bazuar në nenin 244 të KPP-e dhe 245 paragrafi 5 fjalia e dytë e KPP-e, pas dëgjimit të avokatit dhe prokurorit si dhe duke u bazuar në faktin se të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë merr këtë

A k t v e n d i m

- I. Kërkohej nga prokurori i shtetit që më së voni deri më 6 maj 2016 t'i furnizoj me materialet nga shkresat e lëndës mbrojtjen .
- II. Kërkohej nga të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre që deri më datën 23 maj 2016 të paraqesin kundërshtimet ndaj ligjshmërisë së aktakuzës apo pranueshmërisë së provave.

Propozime tjera nuk ka.

Përfundoi në ora 13:41 minuta

Të pandehurit

Prokurori i shtetit,

Mbrojtësi i të akuzuarit

Vërtetojnë:

Sekretarja juridike,

Kryetari i trupit gjykues,

Formulari 70

**PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT TË DYTË FILLESTAR-KUR TË AKUZUARIT
NUK KANË PRANUAR FAJËSINË**

(Neni 254)

PKR.nr. _____

PROCESVERBALI I SHQYRTIMIT TË DYTË

I përpiluar më datën 01.09.2014, në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në _____, në çështjen penale të pandehurve 1. _____, 2. _____ dhe 3. _____, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë, nga neni 179 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, i pandehuri 1 _____, edhe për shkak të

veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPK-ës.

Prezantojnë:

Kryetari i trupit gjykues,

Prokurori i shtetit

Të pandehurit

Mbrojtësit

Sekretarja juridike

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar,

Filloi në ora _____

Shqyrtimi i dytë është publik.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se në shqyrtimin e sotëm të dytë prezanton prokurori _____, të pandehurit mbrojtësit e tyre, përfaqësuesi i palës së dëmtuarve avokati _____, praktikantët e kësaj Gjykate.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e këtij shqyrtimi publik.

Nga shkresat e lëndës shihet se mbrojtësi i të pandehurit av. _____ me datën 12.08.2014 ka paraqitur një parashtrësë në të cilën ka kërkuar që të hedhet aktakuza. Gjithashtu i njëjti në këtë parashtrësë ka propozuar që si dëshmitar të dëgjohet dëshmitari me emrin N.N. dhe personi i quajtur N.N. që të dy taksist nga f. _____.

Nga shkresat e lëndës shihet se edhe mbrojtësi i të pandehurit _____ me datën 5.08.2014 ka paraqitur një kundërshtim për pranimin e provave me të cilin i ka propozuar kryetarit të trupit që disa nga provat të cekura në këtë kundërshtim të shpallën n si të papranueshme.

Nga shkresat e lëndës shihet se prokurori i shtetit _____ me dt.21.08.2014 ka paraqitur një përgjigje në lidhje me parashtrirat e mbrojtësve dhe ka propozuar që të njëjtat të refuzohen dhe të vazhdohet me shqyrtimin e rregullt gjyqësor.

Prokurori i shtetit përveç asaj çka ka shënuar në këtë parashtrirë nuk ka çka të shtoj tjetër.

Mbrojtësit e të pandehurit 1. _____ i propozon Kryetari i trupit gjykues, që të bëhet një ekzaminim i gjakut i cili është gjetur në rrobat e të ndjerit N.N.

Të pandehurit, mbrojtësit e të pandehurve, përfaqësuesi i palës së dëmtuar dhe prokurori i shtetit nuk kanë propozime tjera.

Meqenëse nuk ka propozime tjera kryetari i trupit gjykues brenda afatit ligjor do të vendos për kundërshtimet e paraqitura nga mbrojtësit e të akuzuarve .

Meqë nuk ka propozime tjera kryetari i trupit gjykues e shpall të përfunduar shqyrtimin e dytë.

Përfundoi në ora 14:50 minuta

Të pandehurit;

Prokurori i shtetit

1. _____

2. _____

3. _____

Mbrojtësit

1. _____

2. _____

3. _____

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar

Vërtetojnë:

Sekretarja juridike

Kryetari i trupit gjykues

Formulari 71

**PROCESVERBAL I SHQYRTIMIT TË PARË FILLESTAR, KUR I AKUZUARI
E KA PRANUAR FAJËSINË
(Neni 246 KPPK-ës)**

PKR.nr. _____

PROCESVERBALI I SHQYRTIMIT FILLESTAR

I përpiluar më datën 3 tetor 2016, në Departamentin e Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në _____, në çështjen penale kundër të pandehurit _____ nga fshati _____, Komuna e _____, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Prezantojnë:

Kryetari i trupit gjykues,

Prokurori i Shtetit

I pandehuri

Mbrojtësi,

Sekretare juridike,

Filloi në ora _____

Shqyrtimi fillestar është publik.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se në shqyrtimin e sotëm fillestar prezentojnë prokurori i shtetit _____, i pandehuri _____ dhe mbrojtësin ie tij av. _____.

Kryetari i trupit gjykues vlerëson se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e këtij shqyrtimi fillestar.

Duke vepruar sipas kërkesës së të pandehurit dhe duke u bazuar në nenin 58 par 2 nënpar 1 të Kodit të Procedurës Penale, kryetari i trupit gjykues merr këtë

A K T V E N D I M

Av. _____, nga _____ sipas detyrës zyrtare caktohet si mbrojtës i të pandehurit _____.

Pa vërejtje në vendimin e marrur.

Kryetari i trupit gjykues e fton të pandehurin dhe nga i njëjti merr shënimet personale.

I pandehuri _____, me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës, pa ndryshime dhe plotësime.

Kryetari i trupit gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar për çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen e tij nuk e ka për detyrë ta inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij, as ta pranojë fajësinë, të mbrohet vet ose përmes mbrojtësit dhe ta kundërshtojë aktakuzën ose pranueshmerinë e provave.

Kryetari i trupit gjykues i udhëzon të pandehurin se pranimi i fajësisë konsiderohet rrethanë mbi bazën e së cilës gjykata mund ta zbus dënimin.

Kryetari i trupit gjykues, konstaton të pandehurit dhe mbrojtësit të tyre iu është dorëzuar një kopje e aktakuzës para fillimit të këtij shqyrtimi fillestar.

Kryetari i trupit gjykues konstaton se e drejta në mbrojtës e të pandehurit është respektuar dhe se prokurori i ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij që kanë të bëjnë me zbulimin e provave nga neni 244 i KPP-ës.

Ftohet prokurori _____, që ta lexojë aktakuzën PP.I.nr. _____ dt. _____.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri _____ deklaroi :

E kam kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohem duke shtuar se e pranojnë fajësinë për këtë veprë penale për të cilat akuzohem. Më parë nuk kam qenë i dënuar , jam penduar thellë për këtë veprë penale dhe në të ardhmen nuk do të kryej tjetër veprë penale.

Prokurori _____ konsideroj e janë plotësuar kushtet ligjore për praninë e fajësisë.

Avokati _____ konsideroj që janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë

Kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve mori këtë

A k t v e n d i m

Pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit _____ , për kryerjen e veprës penale e cila me aktakuzë i vihet në ngarkesë, ngase rezulton se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore .

Kryetari i trupit gjykues konstaton se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre av. _____ dhe pranimi i fajësisë mbështetet në fakte e çështjes që përmban aktakuza .Aktakuza nuk përmban shkelje ligjore ose defekte në fushën e fakteve.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pandehuri edhe në procedurën e hetuesisë e ka pranuar fajësinë .

Propozime të tjera nuk ka.

Meqenëse nuk ka propozime të tjera kryetari i trupit gjykues e shpall të përfunduar shqyrtimin fillestar dhe tërhiqet për ta marr aktgjykimin.

Shpallja e aktgjykimit do të bëhet menjëherë.

Përfundoi në ora _____

Prokurori i shtetit,

1 .I pandehuri. _____

2. Mbrojtësit . _____

Vërtetojnë:

Sekretarja juridike,

Kryetari i trupit gjykues,

Formulari 72

NJË FORMË E AKTVENDIMIT ME TË CILIN REFUZOHET KUNDËRSHTIMI I PALËVE PËR PAPRANUESHMËRINË E PROVAVE
(Neni 249 KPPK-ës)

Gjykata Themelore _____ me gjyqtarin N.N..kryetar i trupit _____ me procesmbajtësen N.N. në çështjen penale ndaj të akuzuarit _____ për shkak të veprës penale, lëndimi i rëndë trupor nga neni 189.par.5.lidhur me paragrafin 1 të KPK-ës, duke vendosur sipas kërkesës të mbrojtësit të akuzuarit N.N. për shpalljen si provë të papranueshme të dëshmisë së dëshmitarit N.N, më _____ 2015. mori;

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtësit të akuzuarit N.N, avokat N.N, për shpalljen provë të papranueshme, të dëshmisë së dëshmitarit N.N. dhënë te prokurori i shtetit më datë _____ 2015.

A r s y e t i m i

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore-i ka paraqitur kësaj gjykate aktakuzë PP.nr. _____ datë _____ kundër _____ të akuzuarit _____ nga _____ për shkak të veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 189.par.5.lidhur me paragrafin 1 të KPK-ës.

Kryetari i trupit gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestarë sipas kësaj aktakuze më datë _____ 2015, në të cilën ishin të pranishëm i akuzuari N.N, mbrojtësi i tij avokat .Në shqyrtimin fillestar, mbrojtësi i të pandehurit kishte paraqitur që të shpallet provë e papranueshme dëshmia e dëshmitarit N.N , dhënë polici, me arsyetim se me rastin e dhënie së dëshmisë së tij , nuk ishin të pranishëm ai dhe mbrojtësi i tij për të kundërshtuar deklaratimet e tilla.

Ndaj këtij kundërshtimi prokurori i shtetit i prokurorisë themelore në _____, me parashtrësën PP.nr. _____/2015, ka paraqitur përgjigje me shkrim dhe ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata shqyrtoi pretendimet e mbrojtësit si dhe përgjigjen e dhënë nga ana e përfaqësuesit të akuzës, dhe konkludoi, se kërkesa është e pabazuar për arsyet si në vijim:

Prokurori i shtetit i prokurorisë themelore të _____, në procedurën e hetuesisë ndaj të pandehurit N.N, në mesin e veprimeve tjera procedurale , kishte dëgjuar edhe dëshmitarin N.N, me datën _____ 2015.Për datën e dëgjimit të dëshmitarit ishin njoftuar mbrojtësi dhe i pandehuri N.N. 15 ditë para seancës, dhe në njoftimin me shkrim, ishin paralajmëruar, se nëse nuk marrin pjesë në seancën e dëgjimit të dëshmitarit konform nenit 132.par.7.të KPPK ndërsa mos ardhjen nuk e arsyetojnë e humbin të drejtën për ta kundërshtuar vlefshmërinë e kësaj prove.

Meqenëse i pandehurit dhe mbrojtësi i tij N.N, konform nenit 132.par.6.të KPPK-s, ishin njoftuar me kohë për datën e marrjes në pyetje të dëshmitarit N.N, dhe ishin paralajmëruar për pasojat e mos ardhje në seance , ndërsa nuk kishin prezantuar me rastin e marrjes në pyetje dhe mungesën nuk e kishin arsyetuar , nuk k në të drejtë që të kundërshtojnë pranushmërinë e kësaj prove, konform nenit 132.par.6.të KPPK-ës

Nga të shtruarat më lart, konform nenit 249.par.3.të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA _____

PKR.nr. dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetar i trupit-gjyqtari,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit, në afat prej pesë (5) ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.

Formulari 73

AKTVENDIM PËR HEDHJEN E AKTAKUZËS

(Neni 253.të KPPK-s)

Gjyqtari i vetëm N.N , i gjykatës Themelore në _____, me bashkëpunëtoren profesionale M. M, procesmbajtëse, në çështjen penale e të akuzuarit N.S, nga _____, për shkak të veprës penale, lëndimi i lehtë trupor, i parashikuar nga neni 188.par.1.nënp.1.1.të KPPK-s, sipas aktakuzës së Prokurorit shtetërorë të Prokurorisë Themelore në _____PP.nr.____datë _____, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin fillestar të aktakuzës , më _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit N.S, nga _____, konform nenit 253.par.1.nënp.1.4.të KPPK **hedhet aktakuza dhe pushohet procedura penale**, për shkak të veprës penale, lëndimi i lehtë trupor i parashikuar nga neni 188.par.1.nënaragrafi 1.1. të KPPK-s.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokurori shtetërorë i Prokurorisë Themelore në _____, departamenti i përgjithshëm, kësaj Gjykate i ka paraqitur aktakuzë PP.nr.123/2015, datë 12.9.2015, me të cilën ka akuzuar të pandehurin N.S. se ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor, i parashikuar nga neni 188.par.1 nënparagrafi 1.1. të KPK-s.

Nga shkresat e lëndës rezulton se vepra penale është kryer më 01.01.2013, kallëzimi penal është adresuar në Prokurorinë Themelore në _____ më 25.01.2013. Prokuroria Themelore deri më 12.09.2015, kur ka dorëzuar aktakuzën në Gjykatë, nuk ka ndërmarr as një veprim procedural, nga kjo rezulton se vepra penale është përfshirë me parashkrim relativ akoma pa arritur në gjykatë, për faktin se për veprën penale lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 188.par.1.nënp.1.1. mund të shqiptohet dënim me burgim deri në një (vit), ndërsa sipas nenit 106.paaagrafi.1.nënp.1.5.të KPK-s, për veprat penale për të cilat mund të shqiptohet deri një(1) vit burgim, afati relativ i parashkrimit është 2.vjet. Në rastin konkret nga momenti i kryerjes së veprës penale nuk është ndërmarr asnjë veprim që do e ndërpriste ecjen e afatit relativ të parashkrimit, derë kur është dorëzuar aktakuza në gjykatë më 12.09.2015. dmth kanë kaluar më tepër se dy(2) vite).

Nga arsyet e paraqitura më sipër, në kuptim të nenit 253.par.1.nënp.1.3. të KPPK-s, gjykata e hodhi aktakuzën dhe e pushoi çështjen penale ndaj të pandehurit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuara në nenin 454.paragrafi 1.i KPPK-s.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil, është i mbështetur në nenin 463.par.3.të KPPK-s.

GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM _____

PDP.nr. dt. _____

Procesmbajtësi,

Gjyqtari, _____

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit, në afat prej pesë (5) ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.

Formulari 74

URDHËRESË PËR SJELLJE ME DHUNË E TË PANDEHURIT

(Neni 307 KPPK-ës)

P.nr. _____

Gjykata Themelore në _____ – Departamenti për Krime të Rënda në trupin gjykues në përbërje prej K.K. kryetar, M.L. dhe H.H. anëtarë, të trupit me procesmbajtësen L.S., në çështjen penale e të akuzuarit G.M. nga _____, për shkak të veprës penale të grabitjes, të parashikuar me nenin 329 par. 1 të KPK-së, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 10.11.2013, jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë

I akuzuari G.M. nga _____ ka për t'u sjellë me dhunë në Gjykatën Themelore në _____ – Departamenti për Krime të Rënda më datë 25.11.2013, në ora 10 në gjykatoren nr. 15. Këtë urdhëresë kanë për ta zbatuar Stacioni Policor nr. 1 në Prishtinë.

A r s y e t i m

Pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda udhëhiqet procedurë penale kundër të akuzuarit G.M. nga _____ për shkak të veprës penale grabitje të parashikuar me nenin 329 par. 1 të KPK-së.

Me urdhëresën e kryetarit të trupit gjykues është treguar shqyrtim gjyqësor më datë 10.11.2013 në të cilën i akuzuari është ftuar në mënyrë të rregullt, e që vërtetohet në bazë të fletë kthesës e cila ndodhet në shkresat e çështjes.

Gjykata vlerëson se i përmbush të gjitha kushtet ligjore nga neni 307 par. 1 të KPPK-së, që të urdhërohet sjellja me dhunë e të akuzuarit ngase është ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa nuk ka prezantuar në shqyrtimin gjyqësor dhe as që mungesën e tij e ka arsyetuar.

Procesmbajtësja,

L.S.

Kryetari i trupit,

K.K.

Formulari 75

AKTVENDIM PËR CAKTIMIN E PARABURGIMIT ME QËLLIM TË SIGURIMIT TË PREZENCËS SË TË AKUZUARIT NË SHQYRTIMIN GJYQËSOR

(307. të KPPK-s)

P.nr. _____

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm nëpërmjet të gjyqtarit të vetëm H.B. dhe procesmbajtëses S.A., në çështjen penale të të akuzuarit D.B. nga _____, komuna e _____, për shkak të veprës penale të mashtrimit, të parashikuar nga neni 335 par. 1 të KPK-së, në shqyrtimin gjyqësor të datës 1.7.2013 mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të akuzuarit D.B. nga _____, komuna e _____, për shkak të veprës penale mashtrimi parashikuar nga neni 335 par. 1 të KPK-së, në bazë të nenit 307.par.2 të KPPK-së, caktohet paraburgimi në kohëzgjatje prej një (1)muaji , i cili do t'i llogaritet nga dita e privimit nga liria.

A r s y e t i m

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur kësaj Gjykate aktakuzë PP.nr. _____ datë _____, ndaj të akuzuarit D.B. për shkak të veprës penale mashtrimi i parashikuar nga neni 335 par. 1 të KPK-së. Sipas kësaj aktakuzë është treguar disa herë shqyrtimi gjyqësor mirëpo procedura nuk ka mundur të përfundoj për arsye se i akuzuari D.B. haptas e shmang ardhjen në shqyrtim gjyqësor. Me urdhëresë të gjyqtarit të vetëm shqyrtimi gjyqësor është treguar për datën 15.6.2013. I akuzuari në mënyrë të rregullt ka pranuar ftesën mirëpo ka munguar nga shqyrtimi gjyqësor ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata ka marrë vendim që shqyrtimi tjetër gjyqësor të caktohet për datën 25.6.2013 ndërsa i pandehuri të sillet me dhunë. Urdhëresa e gjykatës është zbatuar dhe në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari është sjellë forcërisht. Meqë janë përmbushur kushtet ligjore që shqyrtimi gjyqësor të mbahet gjykata ka marrë në pyetje të pandehurin dhe ka dëgjuar dëshmitarët e propozuar në aktakuzë. Me qëllim të verifikimit të mbrojtjes të akuzuarit shqyrtimi gjyqësor është shtyrë për datën 10.7.2013 e që kjo datë palëve iu është komunikuar gojarisht, ndërsa të akuzuarit posaçërisht i është tërhequr vërejtja se në rast të mungesës do të sillet me dhunë ose ndaj tij do të caktohet paraburgimi.

Në shqyrtimin gjyqësor të caktuar për datën 10.7.2013 kanë ardhur të gjithë personat e ftuar me përjashtim të të akuzuarit. Dëshmitarët M.N. B.J dhe H.P. kanë deklaruar se po atë mëngjes para ardhjes në gjykatë e kishin vërejtur të akuzuarin në oborrin e tij dhe e kanë ftuar që të shkojë me ata, po ai ia ka kthye me këto fjalë “kam punë më të rëndësishme se sa të shkoj në gjykatë”.

Nga sjellja e tërësishme e të akuzuarit, gjykata ka ardhur në përfundim se ai haptas i shmanget ardhjes në shqyrtim gjyqësor, andaj me aplikimin e nenit 307. Par 2. të KPPK-së, ka vendosur që ndaj tij të caktojë paraburgimin.

Procesmbajtësja,

Kryetari i trupit,

H.B.

S.A.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është liruar ankesa Gjykatës së Apelit në

Prishtinë në afat prej 24 orësh nga momenti i marrjes së aktvendimit.

Sqarim : Kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ekzistojnë shkaqe për paraburgimin e tij nga neni 187 i këtij Kodi, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të caktojë paraburgim për sigurimin e pranisë së të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, i cili paraburgim zgjat derisa të shpallet aktgjykimi, por jo më shumë se një (1) muaj (neni 307 par.2.KPPK-s).

Formulari 76

AKTVENDIM PËR DËNIMIN E DËSHMITARIT PËR SHKAK TË MUNGESËS GJATË SHQYRTIMIT GJYQËSOR

(Neni 135.të KPPK-së)

P.nr.._____

Gjykata Themelore në _____, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Z.P. me procesmbajtësen F.K., në çështjen penale të akuzuarit M. Ç. nga _____ për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325 par. 1 të KPK-së, në shqyrtimin gjyqësor të datës 20.5.2013 mori këtë:

AKTVENDIM

Dëshmitari B.H. nga _____ dënohet me dënim me gjobë në shumë prej 250 €, të cilën është i detyruar të paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktvendimit.

A r s y e t i m

Në shqyrtimin gjyqësor i caktuar për datën 20.5.2013 dëshmitari nuk ka ardhur në shqyrtim gjyqësor dhe nuk e ka arsyetuar mungesën edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

Meqenëse janë përmbushur kushtet ligjore që ndaj dëshmitarit të shqiptohet dënim me gjobë, në kuptim të nenit 135.par.1. të KPPK-së, u vendos si në dispozitivit të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË _____ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSËM

P.nr. _____, më _____

Procesmbajtësja,

Kryetari i trupit,

F.K.

Z.P.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa Kolegjit shqyrtues të

kësaj Gjykate , në afat prej 3 ditësh nga momenti i marrjes së
aktvendimit.

Sqarim: . Kur dëshmitari ose eksperti i thirrur me rregull nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor pa arsye, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues mund të urdhërojë sjelljen e tij të menjëhershme me forcë(**neni 309 par.1.**), mund ta dënoj me gjobë(**neni 135.par.1.**), por mund edhe ta detyroj t'i kompensoj shpenzimet gjyqësore që janë shkaktuar për shkak të mos ardhjes së tij në shqyrtim gjyqësor(**neni 452.par.1.të KPPK-s**).

Formulari 77

PROCESVERBALI MBI SHQYRTIMIN GJYQËSOR

(Neni 315 KPPK-së)

I mbajtur me _____ para Gjykatës Themelore në _____, sipas aktakuzës së Prokurorit shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____, PP. _____ datë _____ kundër të akuzuarit M.S. lidhur me veprën penale vrasje nga pakujdesia, të parashikuar nga neni 181.të KPK-s.

Të pranishëm :

Gjyqtari i vetëm, S.D.

Prokurori Shtetërorë, B.N.

Mbrojtësi, P.ZH.

Procesmbajtësi, J.Q.

I dëmtuari, M.K.

Kryetari i trupit gjykues, në ora 08,00 e hapë shqyrtimin, publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në shqyrtimin kryesor janë të pranishëm të dy palët, pos dëshmitares J.R. e cila me kohë ka marrë ftesën.

Pasi janë plotësuar kushtet për mbajtjen e shqyrtimit kryesor, Gjykata merr këtë:

AKTVENDIM

Që shqyrtimi i sotëm kryesor të mbahet. Shqyrtimi është publik.

Gjyqtari e hapë shqyrtimin gjyqësor dhe merr shënime:

I akuzuari M.S. i biri i R. dhe i S, mbiemri i vajzërisë i nënës _____, i lindur me _____ në _____, shtetas i Kosovës, bujk, i martuar, baba i dy fëmijëve, të kryera katër klasë të shkollës fillore, me të ardhura mesatare, i padënuar më parë, gjendet në paraburgim prej datës _____

I akuzuari është njoftuar për të drejtat dhe obligimet, nga neni 323. të KPPK-së ____

Kryetari i kolegjit udhëzon dëshmitarët që të ulen në vendin e paraparë deri në thirrjen e tyre.

I akuzuari udhëzohet që me vëmendje të përcjell shqyrtimin gjyqësor , për të drejta e tij për tu parashtruar pyetje dëshmitarëve , pastaj për të kërkuar sqarime rreth deklarimeve të tyre etj.

Prokurori ka lexuar aktakuzën.

I akuzuari deklaron se e ka kuptuar aktakuzën .

I akuzuari është deklaruar i pafajshëm

FJALA HYRËSE

Palët në procedurën , në fjalën e tyre hyrëse ju referuan rrjedhës së gjertanishme të kësaj çështje penale, përfaqësuesi i akuzës se tezat nga akuza janë mbështetura me prova të pakontestueshme, ndërsa mbrojtësi dhe i pandehuri se ngjarja ishte aksident i shkaktuar nga dëshmitari por jo nga i akuzuari.

PROCEDURA PROVUESE:

Dëshmitari – i dëmtuari M.K. i biri i V. dhe i nënes K., bujk nga _____ moshës 54 vjeç, që nuk ka lidhje familjare me të pandehurin dhe të dëmtuarin, paraprakisht i paralajmëruar që duhet thënë të vërtetën, që nuk guxon asgjë të fshehtë , i është tërhequr vërejtja se dhënia e deklaratave të rrejshme paraqet vepër penale dhe se nuk është i detyruar të përgjigjet në pyetjet e parapara në nenin 125 par.1.të KPPK-s, deklaroi:

Unë nuk e kam të njohur se si është zhvilluar ngjarja pasi që nuk isha prezent. Vajza ime, tani e ndjera (R) shkoi në dasmë me të ëmën, pasdite. Muzika e cila dëgjohej edhe në shtëpinë tonë zgjati deri vonë në mbrëmje. Kur po bëhesha gati të shkoj në gjumë dëgjoja të shtëna njëra pas tjetrës dhe një tjetër (*të fundit*) pas pak. Atëherë dëgjoja një vajtim me ç’ rast kuptova se ndodhi një e keqe. Vesha pallton dhe u nisa drejt shtëpisë së S. Me tu afruar e njoha zërin e gruas sime dhe vrapova të pyes se çfarë ka ndodhur. Në oborrin e shtëpisë disa më treguan se vajza ime ishte dërguar në spital pasi që ishte e plagosur, e qëlluar me një plumb pa dashje. Menjëherë shkova në _____ dhe në spital më treguan që bija ime kishte vdekur gjatë operacionit.

Asgjë tjetër s kam për të deklaruar. Nuk jam i interesuar të parashtoj kërkesë për kompensim dëmi.

Dëshmitari T.G., i biri i Ç dhe i nënës M, bujk nga _____, i moshës 51 vjeç, që nuk ka lidhje familjare me të pandehurin dhe të dëmtuarin, paraprakisht i paralajmëruar që duhet thënë të vërtetën..... deklaroi:

‘ Në fillim të majit të këtij viti miku im S.F. e martoi të birin me ç rast isha i ftuar në gazmendin familjar. Erdha rreth orës 13,00 në kohën kur pritej kthimi i dasmorëve (krushqve). Kam ndenjur në tavolinat e vendosura në kopsht së bashku me të akuzuarin dhe dëshmitarë M.M, R.P dhe J.J. Kemi pirë raki dhe kemi biseduar. Gazmendi filloi me të ardhur të krushqve. I akuzuari filloi të shti në ajër. Gjatë tërë kohës kam ndenjur pranë të akuzuarit kur ka shti me armë. Pas pak ishte dëgjuar edhe një e shtënë kur kam dëgjuar një britmë. Plumbi ka qëlluar vajzën e cila ishte në valle.

Gjatë gjuajtjes me armë unë kam qëndruar larg të akuzuarit, gati një metër, në mënyrë që t’i shpëtoj goditjeve të gëzhojave të plumbave. Nuk është e vërtetë që unë e kam goditur të akuzuarin në dorë në të cilën e ka mbajtur revolen për cilin shkak thotë se ka shkrepur revolja.

S’ kam asgjë tjetër për të deklaruar.

I akuzuari kundërshton dëshminë e dëshmitarit

Dëshmitari R.P., i biri i D dhe i nënës N, bujk nga _____, i moshës 24 vjeç, që nuk ka lidhje familjare me të pandehurin dhe të dëmtuarin, paraprakisht i paralajmëruar që duhet thënë të vërtetën..... deklaroi:

Kur u martua shoku im V. Unë isha prezent në gazmendin familjar. Së bashku me dasmorët të tjerë kam shkuar në fshatin fqinjë për të marr nusen dhe pastaj në _____ ku është kryer kurorëzimi. Rreth orës 22,00 isha duke vallëzuar pranë tani të ndjerës R. Pas disa të shtënave dëgjova britmën e shoqes sime e cila u rrëzua. Fillova ta mbajë dhe pashë që gjaku po i rridhte me ç’ rast një miku im V.S., thirri ‘ E sillni në veturën time!’ Shumë shpejt e futem në veturë. Pranë saj ishte ulur shoqja e saj dhe u nisem në drejtim të _____.

S kam asgjë tjetër për të deklaruar.

Palët nuk kanë vërejtje.

Dëshmitari M.M. i biri i V _____

Kur ndodhi ngjarja isha i ulur pranë dëshmitarit T.G. E pashë kur i akuzuari nxori revolen dhe shtiu në ajër. Duke e lëshuar revolen e kam dëgjuar edhe një të shtënë dhe pastaj vëreja që muzika u ndalë dhe u bë një rrëmujë në valle. Nxitova dhe pashë se R. po bartej drejt veturës ‘Mercedes’

Meqenëse isha duke e shikuar të akuzuarin deklaroj që dëshmitari T.G. nuk ia ka prekur dorën të akuzuarit, përndryshe do ta kisha vërejtur.

S kam asgjë tjetër për të deklaruar.

Në pyetjen e mbrojtësit se a ka vërejtur ndonjë lëvizje të dorës kur i akuzuari ka shkrepur plumbin e fundit dëshmitari e pohoi këtë, por theksoi se lëvizja e dorës është bërë për shkak të shkrepjes së plumbit.

Pas përfundimit të dëgjimit të dëshmitarëve , prokurori deklaroi se heqë dorë nga propozimi për të dëgjuar edhe dëshmitaren J.R. sepse konsideron se janë shqyrtuar prova në mënyrë të mjaftueshme dhe se deklarata e saj në rrethana të tilla tregohet e panevojshme.

Pas kësaj gjykata merr këtë:

AKTVENDIM

(Leximi i shkresave)

- Lexohet raporti i ekspertit V.P. i datës _____,
- procesverbali nga vendi i ngjarjes i datës _____,
- procesverbali i obduksionit të kufomës së ndjerës R. i datës _____,

Palët nuk kanë vërejtje,

Mbrojtja e të pandehurit

Versioni i tij rreth ngjarjes

Në mbrojtjen e tij i akuzuari deklaroi : Me datën _____ në shtëpinë e komshiut tim S.F. u organizua një aheng me rastin e martesës së djalit të madh V.S. Unë shkova në shtëpinë e S. herët në mëngjes në mënyrë që t iu ndihmojë rreth përgatitjeve të ahengut familjar dhe të të presë dasmorët. Me të arritur, mua dhe dasmorët tjerë të cilët bëheshin gati të shkonin të merrnin nusen, na shërbyen me një gotë raki. Me sa mbaj mend, kam pirë tri gota raki dhe pasi dasmorët shkuan në fshatin fqinj ta marrin nusen, i ndihmova komshiut të vendosin tavolinat në oborr përpara shtëpisë. Ato u rregulluan nga ora 14,00 dhe pas kësaj S. më tha të argëtohem me mysafirë të tjerë pasi që kishte të tjerë familjarë që mund të ndihmonin. Kështu që unë shkova në shtëpi, veshja rroba solemne dhe e dërgova dhuratën për të sapomartuarit dhe u ktheva në shtëpinë e S. Me vete mora revolen e markës ‘Bereta’ të kalibrit 7,65 për të cilën kam leje të rregullt, për më se 10 vite. Revolen e mora pasi që të ne është zakon që dasma bëhet edhe më

madhështore kur shtihet me armë zjarri, gjë që njësoj kam vepruar edhe më herët dhe çdo herë kam pasur kujdes në përdorimin e saj pasi që edhe kam goxha përvojë me to. Kam kryer shërbimin ushtarak ku kam qenë 'mitralozgji'. Me vite të tëra merrem me gjah për çfarë posedoj edhe lejen. Siç e theksova më lartë me vite të tëra posedoj edhe revolen. Me sa më kujtohet kam pirë 5 gota raki së bashku me komshitë dhe shokët T.G, M.M, R.P dhe J.J. në kohën kur isha duke pritur që të ktheheshin dasmorët.

Pas përfundimit të kurorëzimit të çiftit në _____, dasmorët u kthyen në shtëpi rreth orës 17,00. U krijua një festë e vërtetë, ku dy vetë luanin me harmonikë, ndërsa dasmorët argëtoheshin. Me rastin e hyrjes së nuses në oborrin e shtëpisë, kam shkrepe të tetë plumbat dhe kam ndërruar karikatorin e revoles, pastaj revolen e kam futur në xhepin e jashtëm të palltos.

Festa ka vazhduar deri në mbrëmje dhe unë kam kënduar, kam pirë dhe jam argëtuar me shokët e mi.

Rreth orës 22,00 në oborr është hedhur vallja. Unë isha i dehur dhe tejet në qejf. Fillova të shti në ajër. Pas disa të shtënave, duke lëshuar revolen që ta bllokoj, miku im T.G. i ulur pranë meje më goditi në dorë dhe me që e kisha ende gishtin në këmbëz revoljës shtiu (krisi) në mënyrë të pakontrolluar dhe unë dëgjova një britmë. Nga shqetësimi nuk di se çfarë ka ndodhur më tutje. Dikush thirri : ' Njerëz ndihmoni, R. po vdes !!!'

Bashkëshortja ime më dërgoi në shtëpi dhe më tregoi që plumbi e ka goditur të bijën e mikut të tyre (R.) e cila ishte duke vallëzuar dhe se ishte dërguar me veturë në spital.

Të nesërmen në mëngjes u informova se R. ka vdekur gjatë operacionit me ç'rast jam privuar nga liria.

Ndihem fajtor për veprën penale e cila më ngarkohet, por theksoj që në kryerjen e veprës penale ndihmova edhe dëshmitari T.G. i cili padashur më goditi në dorë, gjë që qoi deri të e shtëna e pakontrolluar e armës. Më vie keq për veprën penale dhe e kam edhe më të rëndë pasi që ka pësuar e bija e mikut tim të mirë.

Nuk kam asgjë më shumë për të shtuar dhe lus gjyqin që të më dënojë sa më lehtë'.

Në pyetjen e Prokurorit Publik, se pse në deklaratën e tij të parë nuk përmendi se dëshmitari T.G. e ka goditur në dorë, i akuzuari u përgjigj se ky fakt i shpëtoi pa e thënë për shkak se ishte shumë i shqetësuar.

Në pyetjen e mbrojtësit të tij i akuzuari përgjigjet se kur nuk ka ra ndesh me ligjin, që madje në gjyq s' ka qenë as si dëshmitar, se ka raporte të mira fqinjësore me të gjithë komshinjtë e tij.

Pas kësaj gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

Të bëhej ballafaqimi në mes të akuzuarit dhe të dëshmitarit T.G., se a është goditur i akuzuari në dorë për cilin shkak edhe ka shkrepur revolja. Ballafaqimi është bërë. I akuzuari dhe dëshmitari qëndrojnë pranë deklaratave të tyre.

Palët ranë dakord që të lexohet raporti i ekspertit i datës _____.

Meqë nuk ka prova tjera, as propozime për plotësimin e tyre, gjykata konstaton se procedura e provave mori fund.

FJALA PËRFUNDIMTARE E PALËVE

Prokurori shtetërorë B.N. në fjalën e tij përfundimtare deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës. Me prezantimin e provave, me pranimin e pjesërishëm të fajit nga ana e të akuzuarit, deklaratave të dëshmitarëve, me ekspertizën e bërë, është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale, andaj i ka propozuar gjykatës që ta shpall fajtorë për veprën penale vrasje nga pakujdesia .

I dëmtuari M.K., në fjalën e tij përfundimtare propozon se i akuzuari duhet shpallet fajtor për shkak të veprës penale dhe të dënohet sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit P.ZH. në fjalën e tij përfundimtare thekson se:

I akuzuari ka pranuar kryerjen e veprës penale dhe ka shprehur pendim të thellë për kryerjen e saj. Ka pësuar vajza e mikut të tij më të ngushtë dhe këtë ngjarje e ka përjetuar mjaft rëndë. Është i gatshëm të ofroj ndihmën e nevojshme (materiale) për të zbutur sadopak dhembjen.

Konsideroi se këtu ka elemente të veprës penale vrasje nga pakujdesia në kuptim të nenit 181 të KPK-s, mirëpo lus gjykatën që me rastin e vendosjes të merr në konsideratë sjelljen (e mirë) e të akuzuarit, pjesëmarrjen e tij në UÇK, pranimin e fajit dhe shprehjen e pendimit dhe se në kryerjen e veprës penale ka kontribuar edhe dëshmitari T.G. i cili pa dashur e goditi në dorë gjë që çoi deri te e shtëna e pakontrolluar. Këto rrethana vërtetojnë se me dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit.

I akuzuari, në fjalën e tij përfundimtare deklaron se tërësisht përkrahë fjalët e mbrojtësit, madje e pranoi fajësinë e vet dhe kërkoi nga gjykata që të marr një dënim më të butë.

Gjykata konstaton se seanca përfundoj në ora 12,30.

Pas këshillimit dhe votimit , gjykata në emër të popullit merr, ndërsa kryetari i trupit gjykues në praninë e palëve publikisht shpallë këtë ;

AKTGJYKIM

I akuzuari S.M, me të dhënat tjera si në shkresat e lëndës ,

ËSHTE FAJTOR

Se më datën _____, rreth orës 22,00, në oborrin e S.F. në fshatin _____ gjatë një ahengu familjar me rastin e martesës së djalit S (V) nga pakujdesia në përdorimin e revoles të tipit ‘Bereta’ të kalibrin 7,65 mm. ka privuar nga jeta të ndjerën R.K. nga _____. Pas disa të shtënave duke lëshuar revolen shtiu edhe një herë dhe plumbi goditi të ndjerën R. në gjoks duke kaluar nga kraharori dhe duke e prekur edhe zemrën, duke shkaktuar gjakderdhje të madhe ku pas intervenimit kirurgjikal viktimja vdiq një orë më pas.

Kësodore ka kryer veprën penale të vrasjes nga pakujdesia, të parashikuar nga neni 181, lidhur me nenin 23 të të KPK-s .

Andaj Gjykata të akuzuarin , në kuptim të nenit 365 të KPPK-s ,

E GJYKON

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetësh , në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës _____ deri më datën _____.

Të akuzuari i merret revolva e tipit ‘Bereta’ 7,65 mm, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 200 €. si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 600€.

Procesmbajtësi (J.C.)

Gjyqtari _____

Formulari 78

AKTGJYKIM ME TË CILËN AKUZA REFUZOHET (Neni 363. të KPPK-së)

PDP..nr. _____

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore-Departamenti i Përgjithshëm _____, me gjyqtarin e vetëm S. M., me bashkëpunëtoren profesionale M. M, procesmbajtëse, në çështjen penale e të akuzuarit N.S, nga _____, për shkak të veprës penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, të parashikuar nga neni 331 të KPK-s, sipas aktakuzës së Prokurorit shtetërorë të Prokurorisë Themelore në _____ PP.nr.145/ 2013 datë 12.03.2013 , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik gojor, më 12.10.2013 , në prezencën e Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ S.P. të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. S.T ka marr dhe të njëjtën dit ka shpallur këtë;

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit N.S, nga i ati T. Dhe e ëma B. E lindur SH, i lindur më 12.09.1970 në _____ku edhe tani jeton rruga” sheshi i dëshmorëve” nr.123/b, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën e mesme ekonomike, i papunë, i martuar baba i 4.(katër) fëmijëve, gjer më tani i pagjykuar, mbrohet nga liria,

Në bazë të nenit. 363.pika.1.1.të KPPK-s,

REFUZOHET AKUZA

Se me datë _____, gjatë natës, me një çelës të përshtatur e ka marrë një veturë të tipit “pasat” me targa regjistrimi KS, pronë e të dëmtuarit V.K nga _____, duke e përdorur dhe duke e lënë në një vend tjetër ku më vonë është gjetur, për shkak të heqjes dorë të prokurorit publik nga akuzat, në shqyrtimin gjyqësor.

-me çka kishte për të kryer veprën penale marrja në posedim e pasurisë së luajtshme, të parashikuar nga neni 331 .par.1.të KPK-s,

I dëmtuari V.K. për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokurori shtetërorë i Prokurorisë Themelore në _____, departamenti i përgjithshëm, kësaj Gjykate i ka paraqitur aktakuzë PP.nr.123/2013, datë 20.9.2013, me të cilën ka akuzuar të pandehurin N.S. se ka kryer veprën penale marrja e pasurisë së luajtshme, të parashikuar nga neni 331 të KPK-s, nga e cila është tërhequr në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më _____ 2013.

Meqenëse prokurori shtetëror ka hequr dorë nga aktakuza, në shqyrtimin gjyqësor, gjykata konform nenit 363.par.1.nënp. 1.1.të KPPK, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në përputhje me nenin 454.par.1.të KPPK, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale në shumë prej _____ të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është i mbështetur në nenin 463.par.3. të KPPK-s.

GJYKATA THEMELORE -DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM _____

P.nr. _____, datë _____

Procesmbajtësja,

Gj y q t a r i,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat

prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit – Gjykatës së Apelit, e në

përmjet kësaj gjykate.

Sqarim: 1. Edhe pse neni 363 të KPPK-s, nuk parasheh si bazë ligjore për aktgjykimin refuzues, mungesën e kompetencës lëndore tërheqjen e të dëmtuarit nga ndjekja penale, leja e organit public kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen; ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen, në situata të tilla, procedura duhet të përfundoj me aktgjykim

refuzues. Ngase shqyrtimi i filluar gjyqësor përfundon patjetër me aktgjykim(përfashtimisht përfundon me aktvendim , kur i akuzuari vdesë gjatë rrjedhës së procedurës).

2. Edhe pse sipas nenit 358 të KPPK-ës para shqyrtimit gjyqësor trupi gjykues apo gjyqtari i vetëm , me aktvendim e hudh aktakuzën kur: *procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të shtetit; ka munguar propozimi i kërkuar i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen; ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.Aktakuza me aktvendim do duhej të hudhet edhe për të gjitha rastet e parashikuara nga neni 363.par.1.nënp.1.1,1.2. dhe 1.3.të KPPK-ës, nëse këto rrethana janë paraqitur para shqyrtimit gjyqësor, ngase nuk mund të shkosh në shqyrtim gjyqësor nëse parashkrimi ka arritur para shqyrtimit gjyqësor, nuk mund të shkosh në shqyrtimin gjyqësor nëse vepra penale është përfshirë me amnisti apo falje para shqyrtimit gjyqësor.*

Formulari 79

AKTGJYKIM ME TË CILIN I AKUZUARI LIROHET NGA AKUZA (Neni 363. të KPPK-së)

PDP.nr _____ / _____

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA Themelore në _____,Departamenti i Përgjithshëm , me gjyqtarin e vetëm N.N, me bashkëpunëtoren profesionale N.N procesmbajtëse, në çështjen penale e të akuzuarit N.S, nga _____, për shkak të veprës penale, rrezikimi i sigurisë së trafikut publik, të parashikuar nga neni 328.par.9 lidhur me par.2.të KPK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ PP.nr.____/ ____ datë _____ , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik gojor, më _____ , në prezencën e prokurorit _____ S.P. të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.S.T, të dëmtuarit N.N. , ka marr dhe të njëjtën dit ka shpallur këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.S, nga i ati T. dhe e ëma B. E lindur SH, i lindur më 12.09.1950 në _____ ku edhe tani jeton rruga” sheshi i dëshmorëve” nr.123/b, shqiptar, shtetas i

_____ me profesion shofer –makinist i trenave, ka kryer shkollën e mesme të makinerisë i punësuar në hekurudhën e Kosovës, sektori i transportit të udhëtarëve, në F. Kosovë, i martuar baba i 4.(katër) fëmijëve, gjer më tani i pagjykuar, mbrohet nga liria,

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1.nënp.1.3. të KPPK-ës;

LIROHET NGA AKUZA

Sepse më _____ në Pejë, derisa po e drejtonte trenin në relacion Fushë Kosovë – Pejë , duke mos e përshtatur shpejtësinë e ngasjes kushteve në trafikun hekurudhor(në vende të banuara), me të arritur në fshatin -_____, në vendin e dedikuar për kalim këmbësorësh, deri sa i tani i ndjeri NN. po e kalonte rrugën e ka goditur atë, dhe e nga goditja e furishme e ka hedhur 10 m larg , duke i shkaktuar lëndime të shumta trupore e që kanë shkaktuar vdekjen e menjëhershme të të ndjerit .

Me çka kishte për të kryer veprën penale rrezikimi i sigurisë së trafikut publik , të parashikuar nga neni 328.par.9 lidhur me par.2.të KPK-ës

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në _____, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr._____datë_____ ndaj të pandehurit N.S, _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i sigurisë së trafikut publik , të parashikuar nga neni 328.par.9 lidhur me par.2.të KPK, pranë të cilës ka ngelur edhe në shqyrtimin gjyqësor prokurori N.N.

Gjykata ka proceduar provat e propozuara , ka dëgjuar dëshmitarët NN.NN.N.N,ka zbatuar ekspertizën nëpërmjet ing. të diplomuar të komunikacionit .N.N, ka shikuar procesverbalin nga vendi i ngjarjes me fotodokumentacionin , procesverbalin mbi oduksionin e kufomës N.N. , dhe procesverbalin për rekonstruimin e vendit të ngjarjes. Pas vlerësimit të materialit të theksuar provues , gjykata ka gjetur se nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në ngarkesë.

Me provat e proceduara pa mëdyshje është vërtetuar se goditja e këmbësorit nuk ka ndodhur ne vendin e dedikuar për këmbësor por 10 metra larg vendit të dedikuar për këmbësor

.Dëshmitarët e dëgjuar N.N. dhe N.N.në mënyrë identike kanë dëshmuar se deri te rrezimi i këmbësorit ka ardhur në 10 m. largësi nga vendi i dedikuar për këmbësor dhe drejtpërsëdrejti pas daljes së kamionit transportues .Me këto prova është vërtetuar mbrojtja e të akuzuarit se këmbësori nuk e kishte kaluar, por befasisht paraqitur në rrugë pas kamionit transportues i cili po i truponte rrugën tramvajit .

Dëshmitarët nuk janë farefis dhe nuk janë të interesuar andaj nuk ka asnjë arsye që mos tu besohet dëshmime të tyre .Duke pas parasysh mbrojtjen e të akuzuarit dhe dëshmitë e dëshmitarëve , gjykata nuk ka mundur të pranojë dëshminë e dëshmitarit N.N. i cili kishte deklaruar se këmbësori ishte goditur në vendin e dedikuar për kalimin e këmbësorëve .Ky dëshmitarë ngjarjen e ka parë nga një distancë prej 30 metrash siç deklarohet ai vet, andaj ka mundur gabimisht ta perceptoj se në cilin vend këmbësori ka dal në rrugë. Përveç kësaj dëshmia e këtij dëshmitari është edhe në kundërshtim me konstatimin e theksuar në procesverbal se çanta e të ndjerit është gjetur 10 metra larg zebres për këmbësor. Për këtë arsye gjykata nuk i besoi këtij dëshmitari i cili ka ngelur i vetmuar dhe në kundërshtim me provat tjera të proceduara.

Gjykata ka pranuar mbrojtjen e të akuzuarit se këmbësori ishte paraqitur befasisht në rrugë drejtpërsëdrejti pas karakerisës së kamionit transportues në momentin kur i ishte nxënë pamja dhe kur më nuk ishte në gjendje ta ndal tramvajin .Mbrojtja e tij gjen mbështetje në dëshmitë e dëshmitarëve N.n. dhe N.N., ndërsa nuk ka prova të tjera të cilat do e vënin në dilemë mbrojtjen e tillë .

Sipas mendimit dhe konstatimit të ekspertit ing.i dipl. N.N , shpejtësia e lëvizjes së tramvajit ishte 28 km. në orë dhe nëse pranohet mbrojtja e të akuzuarit se këmbësori kishte dal në rrugë 5.m. para tramvajit , shoferi nuk do mund ta ndalte tramvajin në atë distancë ngase rruga ndalëse e tramvajit me shpejtësinë 28 km. në orë është 13.5 m.

Mendimin dhe konstatimin e ekspertit gjykata e ka pranuar në tërësi ngase ishte i logjikshëm dhe në masë të mjaftueshme i arsyetuar.

Duke pas parasysh se në vendkalimin për këmbësor nuk kanë kaluar këmbësorët , shpejtësia prej 28 km.në orë , sipas vlerësimit të gjykatës , nuk ishte e papërshtatshme në situatën konkrete në trafik , siç ajo i vihet në barrë me aktakuzën e prokurorit publik .

Këmbësori N.N. pa vëmendje dhe befasisht ka tentuar që ta trupoj rrugën jashtë vendit të dedikuar për këmbësor edhe atë në momentin kur pamjen e kishte absolutisht të zënë me karaserin e mjetit transportues i cili lëvizte nëpër atë rrugë, i pandehuri këtë pengesë të papritur nuk ka mundur ta parashohë dhe as që ka mundur si shofer të ndërmarrë diçka për ta evituar kontaktin me këmbësorin.

Meqenëse nuk është vërtetuar se deri te rrezikimi i trafikut publik dhe shkaktimin e pasojës së dëmshme ka ardhë me fajin e të akuzuarit , gjykata e ka liruar të akuzuarin nga akuzat , në bazë të nenit 364.par.1.nënpagrafi 3. të KPP-ës.

Në bazë të nenit 454 par.1. të KPPK-ës, është vendosur që shpenzimet e procedurës të bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimi për ta udhëzuar ë dëmtuarën për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është bazuar në nenin 463.par.2. të KPPK-ës.

GJYKATA E QARKUT NË _____,

Më _____, PDP.nr. _____ / _____

Procesmbajtësi

Gjyqtari;

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit – Gjykatës së Apelit , e në përmjet kësaj gjykate.

Formulari 80

AKTGJYKIMI ME TË CILIN SHQIPTOHET DËNIMI ME KUSHT(NENI 51 I KPK-s), NË SHQYRTIMIN E PARË FILLESTAR, KUR I AKUZUARI KA PRANUAR FAJËSINË

(Neni 248.par.4 KPPK-s)

PKR.nr. ____ / ____

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në _____, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit N.N., me sekretaren juridike N.N. në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N, nga fshati _____, Komuna e _____, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, të cilin sipas autorizimit e mbron avokati .N.N, nga _____, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në _____, Departamenti i Përgjithshëm, PP.I.nr. _____, të datës _____, të cilën e

përfaqësonte prokurori N.N., pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën _____, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa, më datën _____, e përpilojë me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.N, nga babai N dhe e nëna N, e lindur N, i lindur më 15 nëntor _____, në fshatin _____, Komuna e _____, ku edhe jeton, me numër personal _____, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i dy fëmijëve, pensionist, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë vepër tjetër penale,

ËSHTË FAJTOR

Sepse në kohë të pavërtetuar më parë, në shtëpinë e tij, në fshatin____, Komuna e____, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit, edhe atë një revole të kalibrit 6.35 mm, me ngjyrë të bardhë, prodhim “C Zastava” dhe një karikator të të njëjtës revole, e cila armë më datën _____, i është vjedhur prej shtëpisë së tij nga ana e të pandehurve _____, e më pas më datën _____, arma e lartcekur sekuestrohet nga ana e oficerëve të Policisë së Kosovës,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, gjyqtari i vetëm , në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 62, 69, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe neneve 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit N.N, i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) viti, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Konfiskohet arma e zjarrit, edhe atë një revole të kalibrit 6.35 mm, me ngjyrë të bardhë, prodhim “C Zastava”

Detyrohet i pandehuri N.N, që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (Njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m i

Rrjedha e procedurës

Prokuroria Themelore në _____, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurve N.N, nga fshati____, Komuna e _____, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës _____, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri N.N. ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin N.N. se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri N.N, me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Tiparet qenësore (figura) e veprës penale

Në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, duke u bazuar në nenet 17 dhe 23 të Ligjit për armët, është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent.

Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjyqtari ka vendosur që të pandehurin N.N.t'a shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit (Individualizimi i dënimit)

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në veçanti, me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht është marrë për bazë përveç rrethanave të shënuara më poshtë, edhe fakti se prokurori i shtetit gjatë seancës për vërtetimin e fakteve relevante lidhur me dënimin, ka propozuar që duke e marrë për bazë gjendjen e rëndë shëndetësore të pandehurit, atëherë, ndaj tij të shqiptohet ndonjë dënim alternativ. Përveç kësaj, si rrethana lehtësuese për të pandehurin, kryetari i trupit gjykues e ka marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit; moshën e tij të shtyrë; gjendjen e tij të rëndë shëndetësore; se bëhet fjalë për vetëm një armë zjarri; se sipas deklaratës së të pandehurit, të cilës kryetari i trupit gjykues ja fali besimin, i njëjti është pensionist; se është përnduar për kryerjen e kësaj vepre penale; se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, kryetari i trupit gjykues, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të pandehurin.

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me kusht ndaj të pandehurit N.N, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Dënimi plotësues

Përveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62, 69 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK, ndaj të pandehurit N.N., shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja-konfiskimi revoles, të kalibrit 6.35 mm, me ngjyrë të bardhë, prodhim “C Zastava”.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (Njëzetepesë

Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Departamenti i Përgjithshëm Më _____

Sekretarja juridike,

Gjyqtari,

N.N

N.N

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.

Sqarim : 1.Së bashku me dënimin me kusht të pandehurit mund t'i caktohen tri lloj detyrimesh: Detyrimet e përgjithshme (*afati i sprovimit*), detyrimet e posaçme(*psh.kompensimi i dëmit të dëmtuarit*) dhe detyrimet që dalin nga disa vepra penale (*psh.neni 252.par.4.të KPK-s*), dhe për mos përbushje të secilës nga këto detyrime , mund të jetë arsye për revokimin e dënimit me kusht.

2.Pavarësisht se me nenin 22.par.1.pika 1.75 të. KPPK-ës, vepra penale nga neni 174 i është lënë në kompetencë Departamentit për Krime të Rënda , kjo vepër penale bie në kompetencë të Departamentit të Përgjithshëm, ngase Ligji Për Gjykatat në nenin 15. këtë vepër penale nuk e ka lënë në kompetencë të Departamentit për Krime të Rënda. Ligji Për Gjykatat përcakton se për cilat vepra penale gjykojnë Departamenti i përgjithshëm dhe për cilat Departamenti për Krime të Rënda e jo KPPK-s.

Formulari 81

NJË FORMË E AKTGJYKIMIT KUR I PANDEHURI LIROHET NGA DËNIMI (Neni 77.i KPK-s)GJATË SHQYRTIMIT TË PARË FILLESTAR ,KUR I PANDEHURI KA PRANUAR FAJËSINË
(Neni 248.par.4 të KPPK-s)

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në _____, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit N.N., me sekretaren juridike .N, në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N, nga fshati____, Komuna e _____, për shkak të veprës penale vrasje nga pakujdesia, nga neni 181 lidhur me nenin 23 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës , dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, të cilin e mbrojnë avokati N.N, nga ____, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në____, Departamenti i Përgjithshëm, PP.I.nr.____ e datës____, të cilën e përfaqëson prokurori N.N, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën _____, mori dhe publikisht shpalli, kurse më datën _____, e përpilojë me shkrim këtë :

AKTGJYKIM

I pandehurin.N, nga babai N dhe nëna .N, e lindur N.i, i lindur më _____, në____, tani me vendbanim në fshatin____, Komuna e____, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, i pamartuar, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë tjetër penale,

ËSHTE FAJTOR

I.

Sepse më datën _____, rreth orës 12:50 minuta, në fshatin____, Komuna e____, në shtëpinë e tij në dhomën e ndejës, i pandehuri nga pakujdesia me vetëdije e ka kryer vrasjen nga pakujdesia në atë mënyrë që : derisa i pandehuri ishte në dhomë të ndejës me dy motrat e tij N.dhe të ndjerën. N., si dhe gruaja e vëllait N., tani e ndjera N.merr pushkën e gjuetisë e cila ishte në dhomën e tjetër e kalibrit 12 mm, “Armsan”, pronë e babait të saj , hynë në dhomën ditore të ndejës duke manovruar me armë, në atë mënyrë që duke e parë këtë gjendje i pandehuri ngritët në këmbë me qëllim që t’ia marr pushkën, ku nga pakujdesia me vetëdije se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo ai do të mund të parandalojë shkaktimin e saj, ashtu që arrin t’ia marr pushkën dhe gjatë tërheqjes dy hapa mbrapa nga pakujdesia për shkak të llojit të pushkës gjysmë automatike, shkrep aksidentalisht në drejtim të saj, duke e goditur një herë në pjesën e epërme të kokës për shkak të sferave të cilat kanë përmbajtur

municionin, e njëjta nuk mund t'i mbijetojë plagëve të marra dhe për këtë konfirmon edhe raporti mjekësor mbi vdekjen e të ndjerës,

- me këtë ka kryer veprën penale vrasje nga pakujdesia, nga neni 181 lidhur me nenin 23 paragrafi 2 të KPRK.

II.

Sepse më datën _____, i pandehuri në shtëpinë e tij në fshatin____, Komuna e____, pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë edhe atë një pushkë gjuetie e kalibrit 12 mm “Armsan”, me numër serik APK- PQV 12A36283, pronë e babait të tij N.pushkë zyrtare edhe pse i njëjti e ka ditur se mbajtja e armës është në kundërshtim me ligjin ka posedua të njëjtën, në atë mënyrë që e njëjta armë sekuestrohet nga ana e pjesëtarëve policor,

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll ose në posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitave së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 46, 62, 69, 73, 74, 78 dhe 83 të KPRK, si dhe neneve 248 dhe 365 të Kodit të Procedurës Penale, i pandehurin.N., për shkak të veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi :

LIROHET NGA DËNIMI

Ngase pasoja e veprës penale të vrasjes nga pakujdesia, nga neni 181 lidhur me nenin 23 paragrafi 2 të KPRK, nga dispozitivi I i këtij aktgjykimi, e ka goditur aq rëndë të pandehurin, sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Ndërsa, për shkak të veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, të pandehurit L.Z. i shqiptohet

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurit N.N, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguajë në afat prej 1 (një) muaj, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguajë dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e

dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë, dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Krahas dënimit kryesor, ndaj të pandehurit shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja - konfiskimi i armës, përkatësisht pushkës së gjuetisë, e kalibrit 12 mm, “Armsan”, me numër serik APK-PVQ 12A36283.

Në dënimin e shqiptuar me gjobë, të pandehurit, i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datën 03 nëntor 2015 e deri më datën 11 nëntor 2015, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Arsyetime

Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në_____, Departamenti i Krimeve të Rënda, më_____, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit N.N., nga fshati_____, Komuna e_____, për shkak të veprave penale vrasje nga pakujdesia, nga neni 181 lidhur me nenin 23 paragrafi 2 të KPRK dhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK.

Pas pranimit të aktakuzës, kryetari i trupit gjykues e ka caktuar shqyrtimin fillestar për datën_____, ku është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të aktakuzës, i pandehuri N.N.ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohet duke shtuar se e pranojë fajësinë për kryerjen e këtyre veprave penale.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe mbrojtësit të pandehurit, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin N.N.; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

- se i pandehuri N., nga pakujdesia e ka kryer veprën penale vrasje nga pakujdesia, nga neni 181 lidhur me nenin 23 paragrafi 2 të KPRK dhe me dashje e ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtat është penalisht përgjegjës.

Elementet e veprave penale

Në nenin 181 të KPRK, është parashikuar se veprën penale të vrasjes nga pakujdesia e kryen “Kushdo që e privon nga jeta personin tjetër nga pakujdesia”. Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në privimin nga jeta të personit tjetër (ana objektive veprës penale) dhe ky privim nga jeta i personit tjetër duhet të bëhet nga pakujdesia (ana subjektive e veprës penale). Për këtë veprë penale është parashikuar dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet. Sipas nenit 23 të KPRK, mund të jetë me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Sipas kësaj dispozite ligjore, “personi vepron me pakujdesi të vetëdijshme kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj”. Kurse, “personi vepron me pakujdesi të pavetëdijshme kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi”.

Kurse, në nenin 374 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se formën themelore të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, e kryen “kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë deri në 7.500 € (shtatë mijë e pesëqind Euro) ose me burgim deri në 5 (pesë) vjet”. Ndërsa, duke u bazuar në nenin 17 deri 31 të Ligjit për armët, për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, kryetari i trupit gjykues, e ka shpallur fajtor të pandehurin N.N., për shkak të veprave penale vrasje nga pakujdesia, nga neni 181 lidhur me nenin 23 paragrafi 2 të KPRK dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e këtyre veprave penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjyqtari ka vendosur që të pandehurin N.N., t’u shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së lartcekur

Vendimi për lirimin nga dënimit

Në nenin 78 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPRK, është parashikuar se “Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryer nga pakujdesia nëse pasojat e asaj vepre penale e godasin kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij”. Pra, për t’u liruar nga dënimi i pandehuri sipas kësaj dispozite ligjore duhet që të plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte :

1. Që vepra penale të jetë kryer nga pakujdesia dhe
2. Pasojat e veprës penale ta godasin aq rëndë të pandehurin, sa që dënimi të jetë i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Gjyqtari i çështjes, pas shkimit me kujdes të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, prindit të të ndjerës, z. N.N., mbrojtësit të viktimave, N.N., të pandehurit N.N.dhe mbrojtësit të tij, avokatit N.N., gjatë seancës për vërtetimin e fakteve relevante, ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, i pandehuri N.N., duhet të lirohet nga dënimi sa i përket veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, ngase, janë plotësuar kushte ligjore që parashihen në dispozitën e lartcekur ligjore. Në njëërën anë, vepra penale nga dispozitivi I i këtij aktgjykimi është kryer nga pakujdesia, ndërsa, në anën tjetër, pasojat e kësaj vepre penale e kanë goditur aq rëndë të pandehurin N.N sa që dënimi do të ishte i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij. Kjo për faktin se i pandehuri N.N , ditën kritike, nga pakujdesia e ka privuar motrën e tij, të ndjerën N.N. Nga shkresat e lëndës, shihet se i pandehuri N.N., e kishte dashur shumë motrën e tij, të ndjerën N.N.; ishte përkujdesur shumë për të, etj. ku edhe ditën kritike, pasi që kishte ardhur e ndjera në shtëpinë e të pandehurit, i pandehuri N.N.e kishte bërë një torte për ta ngrënë me familje. Andaj, kryetari i trupi gjykues ka ardhur në përfundim, se duke u bazuar në të gjitha këto rrethana, do të ishte i panevojshëm dënimi për realizimin e qëllimit të tij, sa i përket veprës penale sipas dispozitivit I të këtij aktgjykimi, ngase, vetë privimi nga jeta i motrës së tij, është një pasojë që e ka goditur tejet rëndë të pandehurin.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Duke u bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit për shkak të kryerjes së veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, gjyqtar i ka marrë për bazë disa rrethana që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, ka marrë për bazë sjelljet e mira të pandehurit gjatë shqyrtimit fillestar; pranimin e fajësisë; se i njëjti është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale; se ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale; moshën e tij të re, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale. Gjithashtu, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë, është marrë për bazë edhe gjendjen pasurore të pandehurit dhe të ardhurat e tij, ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të pandehurin

Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me gjobë ndaj të pandehurit, për shkak të veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë,

është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Gjykata duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje t'a paguaj atë, atëherë dënimin me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimin me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Dënimi plotësues

Përveç dënimit kryesor, duke u bazuar në nenet 62, 69 dhe 374 paragrafi 3 të KPRK, ndaj të pandehurit, shqiptohet edhe dënimi plotësues marrja – konfiskimi i armës, përkatësisht pushkës së gjuetisë, e kalibrit 12 mm, “Armsan”, me numër serik APK-PVQ 12A36283.

Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar me gjobë

Në dënimin e shqiptuar me gjobë, të pandehurit, i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datën 03 nëntor 2015 e deri më datën 11 nëntor 2015, ashtu që 1 (një) ditë e qëndrimit në paraburgim do të barazohet me 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në _____ Departamenti i Përgjithshëm

PDP.nr, _____ Më _____ ,

Procesmbajtësja,

Gjyqtari,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Formulari 82

AKTGJYKIM ME TË CILIN I PANDEHURI SHPALLET FAJTOR (Neni 365 të KPPK-së)

PKR.nr. _____/

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore _____ Departamenti për krime të rënda, në trupin gjykues i përbërë nga gjyqtarët _____, kryetar _____, dhe _____ anëtar, _____, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit _____ nga _____, për veprën penale vrasje nga neni 178 të KPK-ës, sipas aktakuzës paraqitur nga ana e prokurorit të prokurorisë themelore në _____ nr. _____ dt. _____, në seancën kryesore të mbajtur më _____, në prezencën e zëvendës prokurorit publik P.P. dhe mbrojtësit të të akuzuarit _____, avokat nga _____, mori dhe po këtë ditë shpalli këtë;

A K T G J Y K I M

I akuzuari _____ nga _____, i biri i _____ dhe _____ mbiemri i vajzërisë së nënës _____ i lindur më _____, shtetas i Kosovës, i martuar, din shkrim lexim, shkollën e mesme të kryer, baba i një fëmije, me të ardhura mujore prej _____, i pa dënuar më parë, gjendet në paraburgim prej datës _____

ËSHTË FAJTOR

Se me datën _____, rreth orës ____, në _____, para zyrës nr.____ të ndërtesës së _____, e ka vrarë bashkëshorten e tij _____, duke e qëlluar katër herë me thikë, me teh të gjatë 12 cm, duke i shkaktuar plagë në pjesën e djathtë të qafës dhe të gjoksit, duke i shkaktuar lëndime serioze në arterien e qafës dhe të pjesës mushkërore dhe dy therje pas qafës ku viktimja vdiq si rezultat i gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme të shkaktuara nga të prerat që pësuan organet jetike.

- me këtë ka kryer veprën penale të vrasjes , të parashikua nga neni 178. të KPK-ës, prandaj gjykata në bazë të nenit 361, 365 të KPPK-ës , dhe neni 178 të KPK-ës të akuzuarin,

E G J Y K O N

Me 12 vjet burgim , duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej _____

I akuzuari është i obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj _____, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumë prej _____ .

A r s y e t i m i

Prokurori Publik i Qarkut në _____ me aktakuzën e vet Kp.nr.____ datë _____, ka akuzuar M.U nga _____ për shkak të veprës penale të vrasjes , të parashikuar nga neni 178.të KPK-ës.Pran kësaj aktakuze ka ngelur prokurorit shtetëror i prokurorisë themelore _____ R.R. me propozim që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të gjykohet me dënim meritor konform ligjit.

Versioni i ngjarjes sipas të akuzuarit

I akuzuari _____ e ka pranuar se ka privuar nga jeta bashkëshorten e tij, të ndjerën _____, në mënyrën siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Pranimi i veprës është vërtetuar edhe në bazë të procesverbalit të këqyrjes së vendit të ngjarjes datës _____, raportit të autopsisë , foto-dokumentacionit teknik, raportit të njësitit të forenzikës të PK-s, dhe pjesërisht nga dëshmitë e dëshmitarëve M.M.,R.J.,Lj.I.,R.B., dhe M.B.

I akuzuari, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk e kishte planifikuar paraprakisht vrasjen , por bashkëshorten e kishte goditur me thikë, kur ajo definitivisht ka refuzuar të kthehet dhe të jetojë përsëri me të, duke i thënë: “Nuk më interesoni, as ti, as djali”. Në vazhdim, në mbrojtjen e tij ai është shprehur se me të ndjerën D. është martuar në vitin _____ pas një njohje të shkurtër, se në fillim të jetës bashkëshortore kanë pasë harmoni, por më vonë raportet mes tyre kanë filluar të çrregullohen për arsye se D. ishte nën ndikimin e motrës së saj LJ. për të cilën konsideron se është fajtores kryesore për çrregullimin e raporteve bashkëshortore , mirëpo nuk ka mundur konkretisht të theksojë në çka konsiston ndikimi e dëshmitares LJ në motrën e saj tani të ndjerën D. I akuzuari ka pranuar se të ndjerën, gjatë grindjeve, ndonjëherë e kishte goditur me shuplakë fytyrës dhe se ajo, për herë të parë e ka braktisur atë dhe bashkësinë martesore në vitin _____ por me iniciativën dhe insistimin e tij ka ardhur deri te pajtimi në mes tyre. Përsëri, vie gjer ke konflikti gjatë vitit _____, për shkak se paska theksuar se motra e saj LJ. Është e padëshirueshme për të . Pesëmbëdhjetë ditë pas këtij konflikti tani e ndjera D. sërish kishte braktisur bashkësinë martesore dhe ishte kthyer në shtëpinë e saj (shtëpinë e babait) dhe definitivisht ka refuzuar që të kthehet për të vazhduar jetën e përbashkët dhe njëkohësisht ka ushtruar padi për divorc. Ka refuzuar që të vizitojë edhe djalin i cili gjendej tek prindërit e tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit, nuk e ka e mohuar faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes mirëpo ai mendon se në rrethana të tilla arrihen elementet e veprës penale të vrasjes e kryer në gjendje të tronditjes së fortë psikike, të parashikuar nga neni 181.KPK-ës por jo edhe asaj për të cilën akuzohet. Mbrojtja konsideron se D. Rëndë e ka ofenduar të akuzuarin me vet faktin që ka braktisur bashkësinë martesore dhe ka refuzuar t’i normalizojë raportet dhe të pajtohet me të akuzuarin, kështu që gjatë bisedës në ndërtesën e Agjencionit për sigurime _____, ajo e ka sjellë në gjendjet të tronditjes së fortë psikike duke i thënë se nuk ka më interesim, as për të, as për feminë.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Gjykata pranoi pohimin e të akuzuarit se me datën _____ brenda objektit, në korridor të ndërtesës së entit sigurues , pas bisedës së shkurtër me bashkëshorten e vet D. nga xhepi i majtë i palltos, ka nxjerrë thikën dhe me të njëjtin ka privuar nga jeta tani të ndjerën D. duke i shkaktuar asaj shumë goditje në pjesën e qafës.

Pranimi i vrasjes nga ana e të akuzuarit është vërtetuar si me provave materiale e po ashtu edhe me dëshmitë e dëshmitarëve R.M. dhe M.M. të cilët një pjesë të ngjarjes e kanë parë me sy. Këto provat në mes vete përputhen , ashtu që kjo pjesë e mbrojtjes e të akuzuarit është në harmoni me provat tjera dhe nuk ka asnjë kundërthënie.

Mirëpo , mbrojtjen e të akuzuarit , sa i përket rrethanave që kanë sjellë deri te kryerja e veprës penale , gjykata nuk ka mundur ta pranojë , pasi që mbrojtja në këtë pjesë është në kundërshtim me provat tjera të proceduara në shqyrtim kryesor.

Meqenëse i akuzuari pranoi se ka privuar nga jeta të ndjerën D. Gjykata, veçmas vlerësoi relacionin psikik me veprën e kryer dhe erdhi në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale të vrasjes me dashje direkte . Deri te një konkludim i tillë gjykata e ka ardhë në bazë të shumë provave të proceduara në shqyrtimin kryesor . Nuk kontestohet se i akuzuari me thikë, me teh të gjatë 12 cm, ka goditur të ndjerën 4 herë në pjesën e qafës. Katër goditje të fuqishme në pjesën vitale vërtetojnë këmbëngulësinë e të akuzuarit që të privoj nga jeta bashkëshorten e vet, tani të ndjerën D. Më tutje, i akuzuari pranoi se thikën e ka blerë gjatë kohës kur është braktisur nga bashkëshortja dhe se ditën kritike e ka mbajtur pa këllëf, në xhep edhe pse posedonte këllëfin .Nga kjo gjykata konkludon se i akuzuari ka ardhur në ndërtesën e ndërmartjes “D.....” paraprakisht i vendosur që ta privojë nga jeta bashkëshorten e vet, në rast se ajo refuzon t’i kthehet.

Gjykata nuk mund të pranoj pretendimin e mbrojtësit, se ai ka blerë thikën për tu mbrojtur nga sulmi eventual i axhës të së ndjerës, ngase ai nuk jeton në P...., por jeton në K.....dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar se ai e ka kërcënuar apo rrezikuar të akuzuarin.

Provat

Nga dëshmia e dëshmitarit M.M. është vërtetuar se i akuzuari pasi që ka kryer veprën është shprehur me fjalë “ Nuk kam mundur të qëndroj më, atë që kam menduar e kam bërë ”. Në të vërtetë , dëshmitari tjetër R.M. nuk ka dëshmuar se këto fjalë i kishte thënë i akuzuari , mirëpo duke pasur parasysh shqetësimin i cili është normale në situatat e tilla , gjykata gjen se dëshmitari edhe ka mundur të mos i dëgjoj këto fjalë, për këto arsye i besoj dëshmisë së dëshmitarit M.M.

Edhe prova të tjera shpjen në përfundim të sigurt se i akuzuari ka kryer veprën penale me dashje direkte. I akuzuari disa herë kishte kërcënuar bashkëshorten e vet se do ta vriste, për këtë arsye ajo çdoherë ndihej e rrezikuar.

Në kallëzimin penal të datës _____ i cili i ishte adresuar Prokurorisë publike komunale në _____ D. Thekson se i akuzuari e kishte rrahur dhe i kishte shkaktuar lëndime të rënda trupore, madje e kishte sulmuar edhe me thikë dhe mezi kishte shpëtuar pa e goditur duke rezistuar. Në Kallëzimin e dytë penal i datës _____ e ndjera kishte shënuar se i akuzuari seriozisht e ka kërcënuar me këto fjalë : “ Tani, mu në mes të rrugës, do të masakroj” më pas kishte theksuar edhe këtë ; se i akuzuari , disa herë e kishte shqetësuar në vend të punës, duke kërcënuar për jetën. Nga raporti policor i datës _____ del se pas këtij denoncimi është zhvilluar biseda me të akuzuarin nga e cila punëtorët e autorizuar R. dhe S. kanë konstatuar : “Ekziston frika e arsyeshme se kërcënimet e tilla mund të realizohen”.

Dëshmitari S.B, baba i të ndjerës D. ka dëshmuar se i akuzuari e kishte kërcënuar D dhe LJ., për çka ishte i detyruar t’i shoqëronte ato për t’i mbrojtur pas mbarimit të orarit të punës. Dëshmitari tjetër,M.B. axha i të ndjerës dëshmoi për kërcënimet që po i bënte i akuzuari tani të ndjerës dhe ajo ndihej e frikësuar veçmas natën. Në një rast në praninë e tij i kishte thënë “Çfarë

gjyqi, unë do të gjykoj” (unë do të vendosi për fatin tënd,). Dëshmitarja L.J. motra e të ndjerë dëshmoi se motra i kishte thënë për maltretime që ajo po i përjeton, për kërcënime, për sjelljet e vrazhda, për sulme me thikë, duke kërkuar që babai dhe xhaxhai atë ta mbrojnë . Për sjelljet e njëjta e të akuzuarit ndaj të ndjerës kanë dëshmuar edhe dëshmitarët R.j., dhe R.B.

Gjykata i vlerësoi deklaratat e dëshmitarëve bindëse dhe reale, përkundër asaj se dëshmitarët S.B., Lj.B dhe M.B janë në lidhje të ngushtë familjare me D.B të ndjerë, ngase këto dëshmi vërtetohen edhe nga provat me shkrim – kallëzimet që e ndjera i kishte adresuar në Prokurorinë Komunale në _____

Provat materiale

Sipas mendimit të ekspertit mjekësor , të cilin gjykata në tërësi e ka pranuar i akuzuari shpirtërisht është person i shëndosh . Në kohën kur është kryer vepra penale i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm për sjelljet e veta dhe ka mundur t’i kontrolloj sjelljet e veta .Veprën penale sipas vlerësimit të gjykatës e ka kryer me dashje direkte, që rezultojnë nga provat e theksuara më lart. Në rrethana të këtilla arrihen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale të vrasjes të parashikuar nga neni 178.të KPK-ës.

M o t i v i

Edhe pse i akuzuari këtë drejtpërdrejt nuk e pranon , gjykata e vlerësoi se motiv i vrasjes ishte xhelozia . I akuzuari i ka pranuar dhe vërtetuar grindjet e shpeshta, rrahjet, që kanë ndodhur në mes tyre, por nuk ishte në gjendje të jap ndonjë arsye që do justifikonin sjelljen e tillë .Lidhur me këtë, dëshmitarja L.J. ka dhënë dëshminë bindëse, se motra e saj ka pas probleme, pasi që i akuzuari është tip xheloz (fanatik) dhe si i tillë e maltretonte. Ajo tregoi se si e ndjera i kishte treguar se i akuzuari i kishte ndaluar përdorimin e shminkës. Një rast tjetër, gjatë pritjes në semafor, i kishte thënë “ Pse ti, e shikon shoferin”? Edhe dëshmitari M.B ka kuptuar se i akuzuari është gjelozë dhe në një rast kur e ndjera atij i kishte thënë se ajo do ndahej nga ai edhe nëse djali mbetet tek ai , i është përgjigjur asaj “ Do të jesh vet dhe e lirë?”.Të gjitha këto prova vërtetojnë se vrasja është motivuar në gjelozinë e pabazuar të të akuzuarit.

Pretendimet për vrasje në çast –ligji

Objekt vlerësimi i gjykatës ka qenë edhe teza e mbrojtjes se në veprimet e të akuzuarit arrihen elementet e veprës penale vrasje në gjendje të tronditjes psikike (çast) , të parashikuar nga neni 180.të LPK-s . Kjo tezë nuk ka mundur të pranohet ngase nuk gjen mbështetje në provat e proceduara në shqyrtimin kryesor .Për ekzistimin e veprës penale nga neni 180. të KPK-ës, është e nevojshme që i akuzuari të silltet në gjendje të tronditjes së fortë psikike pa fajin e tij me sulmin apo fyerjen që atij i bëjnë vrari .Me provat e proceduara nuk është vërtetuar ekzistimin i asnjërit nga elementet ligjore të vrasjes së privilegjuar . As sulmi e as fyerje nga ana e të ndjerës D.nuk ka ekzistuar .Të gjithë dëshmitarët e dëgjuar që e njohën të ndjerën D. Dëshmuar se ajo ishte punëtore e shkëlqyer dhe shembull prej bashkëshorteje.Këtë nuk e ka kontestuar as i akuzuari .Nga shkresat e lëndës qartë rezultojnë se shkëputja e bashkësisë martesore kishte

ndodhur ekskluzivisht për fajin e të akuzuarit , i cili bashkëshorten e tij pa asnjë arsye e ka rrahur dhe maltretuar . Braktisja e jetës martesore nga ana e D, tani të ndjerës, refuzimi i kthimit të saj tek i akuzuari si dhe fjalët e saj “nuk më interesoni, as ti, as djali” nuk mund të konsiderohen si fyerje e rëndë, sipas nenit 180.të KPK-s.

Nuk mund të flitet as për gjendjen e tronditjes së fortë psikike , parashikuar nga neni 180 të KPK-s, ngase nga raporti i ekspertit mjeko-ligjor del se i akuzuari në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i shqetësuar, por ka mund t’i kontrolloj emocionet e veta.

Vendimit për dënimin

Me rastin e matjes së dënimit gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale juridike sipas nenit 73 KPPK-s. Po ashtu i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese , se i akuzuari është i moshës së re, se ka pranuar kryerjen e veprës penale, se ka një fëmijë të mitur (nën 2 vjeç), se gjer në këtë moment nuk ka ardh në konflikt me ligjin . Është vlerësuar edhe fakti se i akuzuari nuk ka shprehur pendim të thellë për kryerjen e veprës penale si dhe tendencën që fajin për ngjarjen t’ia hedh tani të ndjerës pa asnjë bazë.

Gjykata vlerëson se me dënimin e shqiptuar, me burgimi në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vjetësh , do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41. të L

KPP-ës, në të gjitha segmentet e tij .

Shpenzimet e procedurës

Meqenëse gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin , e ka obliguar që konform nenit 453 të KPPK-ës, t’i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej _____ edhe atë për pagesën e mëditjeve dëshmtarëve në shumë prej _____, për ekspertizën profesionale në shumë prej _____, ngase sipas gjendjes ekonomike të tij ai ka mundësi që t’i paguaj shpenzimet gjyqësore .

Gjykata të akuzuarin në emër të paushallit gjyqësor e ka obliguar që të paguaj shumë prej _____ , meqë rast kishte parasysh ndërlikueshmërinë dhe kohëzgjatjen e çështjes dhe gjendjen ekonomike të akuzuarit konform nenit 450.par.3. të KPPK-ës.

Llogaritja e paraburgimit në dënimin e shqiptuar.

Meqë i akuzuari ndodhet në paraburgim , gjykata, në bazë të nenit 83,par 1.të KPP-ës, ka vendosur që koha e kaluar në paraburgim t’i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Për kërkesën pasurore-juridike

E dëmtuara nuk parashtrroi kërkesë pasurore - juridike , andaj për këtë kërkesë gjykata nuk ka vendosur.

GJYKATA THEMELORE NË _____ DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA

PKR.nr. _____, datë _____

Procesmbajtësi ,

Kryetari i trupit ,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit ,Gjykatës së Apelit e në përmjet kësaj gjykate.

Formulari 83

PËR NJË PERSON – PËR DISA VEPRA PENALE(VETËM DISPOZITIVI)

AKTGJYKIM

I akuzuari M.G. i biri i _____ dhe _____ mbiemri i vajzërisë së nënës _____ i lindur më _____ shtetas i Kosovës, i pamartuar, din shkrim lexim, ka të kryer dy klasë të shkollës së mesme, i dënuar për shkak se ka kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 253.par.1.pika1.të KPK, me burgim në kohëzgjatje prej 11 muaj të cilin e ka mbajtur, gjendet në paraburgim prej datës _____

ËSHTË FAJTOR

Se me datë _____, gjatë natës, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, me anë të një shufre hekuri ka thyer drynin e derës së hyrjes së dyqanit nr.2, pronë e ndërmarrjes “Graniti” i cili gjendet në _____, ku ka marrë gjëra të ndryshme: 4 goma për automobil r.18, në vlerë prej 400 euro, 3.kg. cigare të llojit “laki strike” në vlerë prej _____ euro.

Se me datë _____, gjatë natës, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, ka thyer dritaren e vjedhur me thyerje të një dyqani _____ i cili gjendet në _____ pronë e N.H., ku ka marrë një magnetofon “Philips”, në vlerë prej 100.€, tre tel. “ajfon 4 “ në vlerë prej 900€, televizor multifunksional , në vlerë prej 800 €.

Se me datë _____, gjatë natës, me një çelës të përshtatur e ka marrë një veturë të tipit “pasat” me targa regjistrimi KS, pronë e të dëmtuarit V.K nga _____, duke e përdorur dhe duke e lënë në një vend tjetër ku më vonë është gjetur,

- me çka ka kryer dy vepra penale të vjedhjes së rëndë, nga neni 327.par 1.nënp.1.1, dhe një vepër penale të marrja e pasurisë së luajtshme, të parashikuar veturës nga neni 331.par.1. të KPK-ës, andaj gjykata konform nenit 80. par. Lidhur me par.2.nënp. 2.2.të KPK-ës, i përcakton :

- për veprën penale të përshkruar nën pikën 1, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj;

- për veprën penale të përshkruar nën pikën 2, dënimin me burg në kohëzgjatje prej një viti;

- për veprën penale të përshkruar nën pikën 3, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 7(shtatë) muajsh dhe e ,

GJYKON

Me dënim të unik në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 3 (tre) muaj burgim ,në të cilin do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej _____ deri _____.

I akuzuari obligohet që ndërmarrjes “Graniti “ t'i paguajë në emër të dëmit shumën prej 600 €, në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit N.H.në emër të dëmit për sendet e vjedhura t'i paguaj 1800€ në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

I dëmtuari V.K, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike , udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari në bazë të nenit 453.par.4.të KPPK-s lirohet nga detyrimi i pagesës së shpenzimeve procedurale .

Formulari 84

PËR DISA PERSONA, PËR DISA VEPRA PENALE (VETËM DISPOZITIVI)

AKTGJYKIM

1.I akuzuari F.M. i biri i ____ dhe ____mbiemri i vajzërisë së nënës ____, i lindur me ____ në ____ku edhe ka vendbanim të përhershëm, punëtor, ka të kryer shkollën fillore , i pa martuar, shtetas i Kosovës, i dënuar më parë me burgim në kohëzgjatje prej 3 muaj, për vepër penale të vjedhjes nga neni 325 par.1.nënp.1.1.të KPK-ës, në paraburgim është nga data ____;

2.I akuzuari P.SH. i biri i ____ dhe ____mbiemri i vajzërisë së nënës____, i lindur me ____ në ____ku edhe ka vendbanim të përhershëm, shtetas i Kosovës, bojagji, i martuar, baba i tre fëmijë të mitur, ka të kryer shkollën fillore, i padënuar më parë;

3.I akuzuari F.S. i biri i ____ dhe ____mbiemri i vajzërisë së nënës____, i lindur me ____ në ____me vendbanim të përhershëm, shtetas i Kosovës, pa profesion, i papunë, i martuar, baba i dy fëmijëve, në gjendje të vështirë ekonomike, i padënuar më parë.

JANË FAJTORË

Për shkak se:

I.Të akuzuarit F.M, P.SH. dhe F.S:

1.Me datë____ në ____ F.M. e then xhamin e dyerve të marketit“Ndriçimi” pronë e H.P. në rrugën ____nr____ , dy të akuzuarit tjerë P.SH dhe F.S bënin roje, ku pastaj të gjithë së bashku hyjnë brenda dhe marrin: para të gatshme në vlerë prej 1.240,-euro, gjera të ndryshme ushqimore në vlerë prej 3000 €

2.Se me datë të panjohur, kah mesi i muajit shkurt të vitit ____, kanë thyer dyqanin e NTP”Profiti” pronar i së cilës është P.E. i cili gjendet në ____ në atë mënyrë që derisa i akuzuari i parë F.M.me kaçavidë e thente xhamin e derës së hyrjes, dy të tjerë kujdeseshin për

siguri e pastaj të gjithë së bashku kanë hyrë brenda dhe kanë vjedhur: 6 transistorë “Sony” në vlerë prej 300€, një gramafon në vlerë prej 150€ dhe para të gatshme në shumë prej 350 €.

- me çka kanë kryer dy vepra penale të vjedhjes së rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp.1.1 të KPK-ës.

II.Të akuzuarit F.M dhe F.S.me datë _____ në _____, kanë marrë në mënyrë të kundërligjshme veturën e tipit _____ me targa regjistrimi _____ pronë e të dëmtuarit B.R i cili gjendej në parkingun e ndërtesës në lagjen _____ nr, _____, me qëllim të shfrytëzimit për vozitje ku së bashku me persona tjerë të mitur Z.P dhe V.R për të cilët zhvillohet procedurë e ndarë, kanë hapur veturën me një çelës të përshtatur e pastaj me lidhje të shkurtër, përmes kablllove elektrike e vejnë në lëvizje dhe bëjnë gjiro nëpër qytet, deri në momentin kur me veturë qëllojnë në një shtyllë e madje e lënë mjetin aty dhe arratisën,

- me çka kanë kryer veprë penale plaçkitja e mjeteve motorike, të parashikuar nga neni 346.par.1. të KPK-s .

III. I akuzuari F.M

Me datë _____ kah ora _____ në _____, në byqe _____ në rrugën _____, me sjellje të dhunshme ka prishur rendin dhe qetësinë publike duke u ofruar te tavolina ku ishin të ulur dy gra, V.R dhe B.D i ka fyer dhe ka tentuar të ulet vetë në tavolinën e tyre, mirëpo nuk iu është lejuar një gjë e tillë dhe në ato momente i akuzuari V.R e shtynë dhe e rrëzon në dysheme duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, në formë të shtypjes së kofshës së djathtë, ndërsa B.D ia hedh pijen në fytyrë duke tentuar edhe këtë fizikisht të sulmojë, por është penguar nga ana e kamarierit – dëshmitarit D.V,

- me çka ka kryer veprë penale lëndim i lehtë trupor , të parashikuar nga neni 188.par.1.nënp. 1.1.të KPK-s, andaj gjykata konform nenit 80.par.2.nënp. 2..2 të KPK-s, i përcakton:

- të akuzuarit F.M për veprën penale të përshkruar nën pikën I/1, dënimin me burg në kohëzgjatje prej një vit e gjashtë muaj, nën pikën I/2, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 10 muaj, nën pikën II, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një muaji dhe nën pikën III, dënimin me burg në kohëzgjatje dy muaj ;

- të akuzuarit P.SH. për veprën penale të përshkruar nën pikën I/1, i përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej një viti dhe për veprën penale nën pikën I/2, dënimin me burg në kohëzgjatje prej gjashtë muaj;

- të akuzuarit F.S, për veprën penale: I/1-dënimin me burgim në kohëzgjatje prej një viti , për veprën penale nën pikën I/2-dënimin me burgim në kohëzgjatje gjashtë muaj dhe nën II, dënim me burg në kohëzgjatje prej një muaji dhe i ,

GJYKON

Të akuzuarin F.M. me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej dy vitesh (2) e tre(3)muaj. Në dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej ____;

Të akuzuarin P.SH. me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej një viti (1) e tre(3) muaj dhe ,

Të akuzuarin F.S. me dënim unik burgimi kohëzgjatje prej një(1) viti e pesë(5) muaj .

Të akuzuarit detyrohen që në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, solidarisht t'i paguajnë shpenzimet e procedurës në shumë prej 500 €, që në afatin e njëjtë të paguajnë në emër të paushallit gjyqësor: i akuzuari F.M.200 €, i akuzuari P.SH.100 €, ndërsa i akuzuari F.S.150 €.

Të akuzuarit detyrohen që në afat prej 2 muajsh, pasi që aktgjykimi të marr formën e prerë solidarisht të dëmtuari H.P.pronar i marketit “Ndriqimi” në emër të dëmit të shkaktuar t'i paguajnë 4240 €, ndërsa të dëmtuarit P.E 800 €

Të dëmtuarit B.R dhe V.R. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Formulari 85

ME LLOJET E NDRYSHME TË VENDIMEVE (VETËM DISPOZITIVI)

AKTGJYKIM

I akuzuari G.B. i biri i _____ dhe _____, mbiemri i vajzërisë së nënës _____, i lindur me _____, me vendbanim në _____ rr. _____ nr. _____, shtetas i Kosovës, bojaxhi, i martuar, pa fëmijë, të kryer katër(4) klasë të shkollës fillore, ka gjendje të varfër ekonomike, i dënuar më parë për veprën penale të grabitjes , nga neni _____KPK-ës, me burg në kohëzgjatje prej tri (3) vjetësh,

I.

ËSHTEË FAJTOR

1.Se me datë _____, rreth orës 10, në tregun e gjelbër në _____, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, të dëmtuarit M.M nga _____ deri

sa ai po provonte gjalpin nga një shitës , ia fut dorën në gjep ia tërheqë portofolin, por intervenojnë qytetarët dhe tregtarët dhe ia marrin atë dhe ia kthejnë të dëmtuarit.

- me çka ka kryer veprë penale të vjedhjes në tentativë , të parashikuar nga neni 325 par.1.lidhur me nenin 28. të.KPK-ës;

2.Se me datë _____, rreth orës 024, në kafenenë “Gjajtari” në _____, prone e të dëmtuarit G.P, me sjellje arrogante dhe të dhunshme ka prish rendin dhe qetësinë publike, duke thyer inventar dhe dritaret e kafenesë vlere e të cilave kap shumën prej 500 €, ka fyer dhe sharë klientë që ishin në kafene, deri se kanë arritur organet e rendit dhe e kanë arrestuar .

- me çka ka kryer veprë penale **asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë** , të parashikuar nga neni 333.par.1.të KPK-ës.

Gjykata në bazë të nenit 76, 80.par.1. dhe par.2.nënp.2.2.të KPK-s dhe nenit 365 të KPPK-ës

I PËRCAKTON

- për veprë penale nga neni 325.par.1. tetë(8)muaj burgim , për veprë penale nga neni 330.par.1.dy(2) muaj burgim , dhe në bazë të nenit 80.par.1.par.2.nënp.2.2.

E GJYKON

Me dënim të unik burgimi në kohëzgjatje prej një viti e nëntë(9)muaj.

I akuzuari detyrohet që t’i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 100 € dhe në emër të paushallit gjyqësorë 20 €, në afat prej 15.ditësh pasi aktgjykimi të marr formën e prerë.

I akuzuari detyrohet që të dëmtuarit G.P.në emër të dëmit t’i paguaj 500 €, në afat prej dy (2) muajsh, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë.

II

Në bazë të nenit. 364.par.1.nënp.1.3.të KPPK-ës,

LIROHET NGA AKUZA

Se me datë _____ në Pishinën “Delfini” , ne xhveshtore e pishinës, me qëllim të përftimit të dobisë pasurore të kundërligjshme nga çanta e të dëmtuarit Q.S. ka marr një telefon “nokia” dhe portofolin me 200 € .

- me çka kishte për të kryer veprë penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325 par.1.KPK-ës,

III

Në bazë të nenit 363 .par 1.nënp.1. 1. të KPPK-s

REFUZOHET AKUZA

Se me datë _____ në _____, ka blerë nga e G.K. nga _____ një palë vathë , dy hallka dore në vlerë prej 300 € , dy varëse ari , në cvlerë prej 400 € dhe një orë dore meshkujsh , të markës “kontinental” të pruaruar me arë në vlerë prej 1500 € edhe pse ka ditur që G.P. sendet e përshkruara më lart i ka të vjedhura,

- me çka kishte për të kryer veprë penale **blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale**, të parashikuara nga neni 345.par.1.të KPK-ës.

-për shkak se **Prokurori është** tërhequr nga aktakuza

Formulari 86

AKTVENDIM PËR PËRMIRËSIMIN E AKTGJYKIMIT

(Neni 371. të KPPK-ës)

PDP.nr. 20/2013

Gjyqtari i vetëm i Gjykatës Themelore në _____ H.L., me procesmbajtësen B.H., në çështjen penale të pandehurit S.B. nga Peja, për shkak të veprës penale të vjedhjes të parashikuar nga neni 325 par. 1 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës së të pandehurit që të bëhet përmirësimi i aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në _____ Departamenti i Përgjithshëm P.nr. 20/2013 nga data _____ më datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Përmirësohet aktgjykimi jo i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore në _____, PDP.nr. 20/2013 datë _____, ashtu që në dispozitivin e aktgjykimit duhet të ekzistojë emri i të pandehurit “Sabit” në vend të emrit të gabuar “Sahit”.

Përmirësimi duhet të shënohet në burimin e aktgjykimit.

A r s y e t i m

I pandehuri me parashtrësën e datës 20.3.2013, ka paraqitur kërkesë që të bëhet përmirësimi i aktgjykimit i cili akoma nuk e ka formën e prerë i Gjykatës Themelore në _____ Departamenti i Përgjithshëm, PDP.nr. 20/2013 datë _____, ashtu që në dispozitiv në vend të emrit “Sabit” duhet shkruar emrin “Sahit”.

Kërkesa e të pandehurit është e bazuar.

Me shikimin në shkresat e lëndës është konstatuar se për shkak të gabimit me rastin e të shkruarit ka ardhur deri te shënimi i emrit gabim, si në burim ashtu edhe në përshkrimin e aktgjykimit, që do të thotë se ekzistojnë mos përputhje i burimit të aktgjykimit me aktgjykimin e shpallur.

Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për gabim të qartë në të shënuar të emrit, kërkesa e të pandehurit është e bazuar, andaj është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 371. par.1 të KPPK-ës.

GJYKATA THEMELORE _____ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr. 20/2013, më datë 25.3.2013

Procesmbajtësja,

B.H.

Gjyqtar ,

H.L.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditësh nga momenti i marrjes së aktvendimit.

Sqarim : Kur gjykata me aktvendim e përmirëson aktgjykimin e përpiluar me shkrim ngase ka dallime (shpërputhje) nga origjinali për çështje substanciale (psh.në origjinal ekziston dënimi plotësues por jo edhe në aktgjykimin e përpiluar me shkrim), Në rastin e tillë, palët kanë të drejtë ankese kundër aktgjykimit në afatin i cili fillon të rrjedhë nga momenti i marrjes së aktvendimit për përmirësimin e aktgjykimit(neni 371.par.2.) .

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e posaçme

Formulari 87

ANKESA E TË AKUZUARIT KUNDËR AKTGJYKIMTI TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË
PARË PËR TË GJITHA BAZAT LIGJORE
(Neni 380 të KPK-së)

P.nr____/2015

GJYKATSËS THEMELORE PRISHTINË

Për

GJYKATËN E APELIT PRISHTINË

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr.____2015 datë_____, me të cilën i pandehuri M.M. nga_____, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPK-së, dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjetësh, në bazë të nenit 380 të KPPK, paraqes

A N K E S Ë

I.Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara nga neni 384.par.2. nënp 2.1 të KPPK-së,

II.Konstatimi të gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, nga neni 386. të KPPK-ës,

III.Shkeljes së ligjit penal dhe

IV.Për shkak të vendimit për dënimin.

A r s y e t i m

I. Shqyrtimi i parë gjyqësor në këtë çështje penalo-juridike është mbajtur më 15 shkurt 2015. Meqenëse gjykata ka pranuar propozimin e mbrojtjes që me qëllim të plotësimit të procedurës provuese të dëgjohet si dëshmitar S.S., shqyrtimi gjyqësor është shty për 10 qershor 2015.

Meqenëse në mes të shqyrtimit të parë dhe shqyrtimit të dytë ka kaluar më tepër se 3 (tre) muaj, gjykata ka qenë e detyruar në bazë të nenit 311 paragrafi 3 të KPPK-së, që shqyrtimit t'ia nisë nga fillimi.

Mirëpo, meqenëse gjykata nuk ka vepruar në përputhje me dispozitën e cituar ligjore, por ka vazhduar me shqyrtimin duke mos i ri proceduar provat që më herët janë shqyrtuar, me këtë veprim ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2 nënp. 2.1 të KPPK-së.

II. Në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar gjykata thekson se i akuzuari M.M., nuk e ka përshtat shpejtësinë e mjetit, kushteve në rrugë, ngase rruga ishte e dëmtuar dhe e rrëshqitshme, andaj ka qenë i detyruar që me rastin e anashkalimit të qerres tërheqëse të B.J., të ndërmerr frenimin e shpejtë për ç'arsye ka ardhur deri te devijimi i mjetit në trotuar dhe goditja e këmbësorit L.B., nga pasojat e lëndimeve ka vdekur në vend. Mirëpo, në arsyetimin e aktgjykimit ka theksuar se bazuar në faktin se në rrugë nuk kanë ngelur gjurmët e frenimit ekspertit nuk ka mundur që saktë të deklarohet për shpejtësinë me të cilën ka lëvizur kamioneta në momentin e aksidentit.

Sipas kësaj me provat e proceduara nuk është vërtetuar një nga rrethanat themelore të kësaj ngjarje shpejtësia me të cilën në momentin kritik ka lëvizur i akuzuari me mjetin e tij. Nëse shpejtësia e lëvizjes nuk ka qenë e madhe siç mbrohet i akuzuari, atëherë ai nuk ishte i detyruar për frenim të vullshëm dhe të shpejtë, dhe kjo nuk ka qenë shkak i aksidentit, por realisht aksidenti ka ngjarë për shkak të lëvizjes jo të rregullt të qerres tërheqëse e cila po lëvizte mesit të rrugës.

Në mendimet dhe konstatimin e tij eksperti i komunikacionit Ing. i dipl. V.K., nuk ka përjashtuar mundësinë se deri te devijimet e kamionetës majtas-djathtas në rrugë ka ardhur për shkak të prezencës një shtrese të vajit që ishte në asfalt, të cilën i pandehuri sigurisht nuk ka mund me kohë ta vërej dhe për këtë i akuzuari ka mund ta humb kontrollin mbi mjetin dhe pikërisht në pjesën mjaft kritike të rrugës: në një pjerrtësi mjaft të theksuar.

Bazuar në atë se gjykata nuk vërtetoi një nga rrethanat themelore – shpejtësinë e lëvizjes së të akuzuarit në momentin e aksidentit, pastaj fare nuk ka vlerësuar në tërësi mendimin dhe konstatimin e ekspertit dhe nuk ka vlerësuar dëshminë e drejtuesit të qerres tërheqëse të dytë, e cila po lëvizte menjëherë pas qerres tërheqëse B.B., dëshmitarin R.K., i cili ka vërtetuar se B.B.,

me qerren e tij tërheqëse ka lëvizur mesit të rrugës e me këtë gjendja faktike del të jetë gabimisht e vërtetuar dhe jo e plotë.

III.I akuzuari në rastin konkret nuk ka bërë asgjë që do të ishte në kundërshtim me rregullat e trafikut e që do të përbënte ngjarje jo të rregullt dhe të kundërligjshme. Ai ka vozitur krejt normalisht gjer sa nuk ka arritur në pjesën e rrugës e shtresuar me vaj të hedhur nga mjetet e tonazhit të rëndë e që nuk ka mund të dijë dhe as të supozoj gjer sa nga ana e kundërt nuk ka ardhur qerrja tërheqëse e cila në mënyrë të parregullt po lëvizjes mesit të rrugës.

Përpos kësaj në shkresat përkatësisht materialin e provuar nuk ka absolutisht asnjë propozim për konstatimin e gjykatës se i pandehuri ka ngarë mjetin me shpejtësi të madhe – dmth. me shpejtësi të papërshtatshme, kushteve të rrugës dhe për këtë ka qenë i detyruar që pa prituri të frenojë, e që në rrugën e rrëshqitshme ka sjellë deri te devijimet-shëtitjet e mjetit djathtas-majtas, kalimin në trotuar dhe vdekjen e këmbësorit të pafajshëm.

Sipas kësaj rrëshqitja e mjetit të akuzuarit ka pasuar për shkak të prezencës së një pjese shtresore të vajit në pjesën e asfaltit e që i akuzuari nuk ka mundur ta vërejë dhe tek ai nuk ka qenë e pranishme dija lidhur me atë se ka ndërmarrë veprimin e cila në vete do të përmbajë një nga elementet themelore të veprës në fjalë. Për këtë arsye nuk ka përfundim të gjykatës se shkallës së parë se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për mundësinë e shkaktimit të rrezikut për jetën e njerëzve por se lehtë ka menduar se deri te pasoja nuk do të vijë përkatësisht se atë mund ta evitojë.

Përkundrazi ai është sjellë drejt dhe në pajtueshmëri me dispozitat që rregullojnë trafikun rrugor, ku pas paraqitjes së mjetit tërheqës ka ndërmarrë veprimin e frenimit të lehtë dhe të kujdesshëm, e cila në situatën e dhënë ka qenë e domosdoshme, por nuk ka mund të supozoj ekzistencën e vajit rrëshqitës në pjesën e asfaltit ku është ndodhur ajo.

Për këtë arsye gjykata e shkallës së parë ka cenuar ligjin kur ka konstatuar se veprimet e të akuzuarit ekzistojnë element të veprës penale nga neni 378 paragrafi 9 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPK-së.

IV.Nga shkaqet e përshkruara më parë çart rezulton se nuk ka pasur bazë për shpallen e të akuzuarit M.M., fajtor për veprën penale nga aktakuza përkatësisht për çfarëdo vepre tjetër penale, dhe në mbështetje të kësaj as bazë për shqiptimin e çfarëdo dënimi ndaj tij.

Mirëpo, nëse vendimi i gjykatës së shkallës së parë për fajësinë e të pandehurit merret si i drejtë dhe i bazuar prapë se prapë dënimin të cilin gjykata i ka shqiptuar është absolutisht i padrejtë, ngase i pandehuri në tërë këtë ngjarje më së pakti ka kontribuar në shkaktimin e pasojës së rëndë, edhe në situatën kur veprën dhe pasojën do të mund t'ia ngarkojmë pakujdesisë së tij.

Nuk është kontestuese se deri te pasoja kanë sjellë faktor tjerë përkatësisht se deri te pasojat ka ardhur për shkak të veprimit të personave tjerë pjesëmarrës në trafik edhe atë shumë ma shumë se vetë i akuzuari. E kjo para se gjithash ka të bëjë me faktin se asfalti ishte shtresuar

me një pjesë të vajit që e kishte bërë atë pjesë të rrugës të rrëshqitshme, deri te cila kishte ardhur për shkak të pakujdesisë së punëtorit në auto servisin e afërm, pastaj lëvizjen e parregullt të qerres tërheqëse e cila nuk iu ka përmbajtur rregullave për të lëvizur në anën e djathtë të rrugës së tyre, përkundrazi më tepër ka lëvizur mesit të rrugës, dhe nuk ka reaguar drejt me rastin e kalimit të kamionetës të cilën e ka drejtuar i akuzuari.

Duke vërejtur lëvizjen e parregullt të qerreve tërheqëse i akuzuari me kohë ka filluar që të ul shpejtësinë e lëvizjes së mjetit të tij, me qëllim të shmangies së ndeshjes, mirëpo në atë moment ai ka has në pjesën e asfaltit të mbuluar me shtresë vaj dhe të rrëshqitshme, që nuk ka mund të pres dhe as të e vërej , për shkak të errësirës kur ai befas devijon, humb kontrollin me mjet dhe fatkeqësisht kalon në trotuar dhe i shkakton vdekjen këmbësorit.

Kontributi i të akuzuarit në shkaktimin e pasojës së rëndë është deri në atë masë i papërfillshëm sa që ky rast mund të trajtohet si formë më e lehtë e pakujdesisë(*pakujdesi pa vetëdije*). Për këtë arsye dënimi i shqiptuar në asnjë aspekt nuk i përgjigjet shkallës së përgjegjshmërisë dhe rrezikshmërisë së veprës të kryerësit, nëse merret se ai është fajtor i aksidentit.

Bazuar në të kaluarën e tij, rezulton se ai kishte jetë të rregull dhe kurrë nuk kishte ardh në konflikt me ligjin, andaj duke marrë për bazë personalitetin tij, është më se e qarë se qëllimi i dënimit do të mund të arrihej edhe nëse i shqiptohet dënim me kusht.

Sipas vlerësimit tonë të gjitha rrethanat nga të cilat varet vendimi për dënimin në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet për zbutje të dënimit nga neni 75 të KPK-së, përkatësisht kushtet për shqyrtimin me kusht nga neni 51 të KPK-së. Për këtë arsye

P r o p o z o j

Që Gjykata e Apelit për arsye të parashtruara më lartë dhe në bazë të nenit 398 para. 1 nënp. 4 të KPPK-së, ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza, ose ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarit t'i shqiptoj dënim me kusht, ose në mbështetje të nënparagrafit 3. të nenit të cituar , të njëjtin ta anulojë dhe çështjen ta kthejë gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prishtinë, _____

Mbrojtësi ,

S.S. avokat nga Prishtina

Sqarim: Me rastin e ankesës, nuk është e mjaftueshme që ankuesi t'i parafranoj shkeljet ligjore (sa për ta përmbushur anën formale), por për secilin pretendim duhet të jap arsye të qarta dhe logjike, në të kundërtën nëse vetëm parafrazon dispozitën ligjore, ndërsa në arsyetim flet krejt diçka tjetër, konsiderohet se ankuesi nuk ka dhënë arsye për pretendimet e t'ia dhe në rrethana të tilla gjykata lirisht mund ta shqyrton ankesën vetëm për shkelje procedurale dhe ato ligjore, për të cilat mban llogari sipas detyrës zyrtare. (psh nëse në ankesë thuhet se gjykata ka bërë tejkalim objektiv të akuzës, duhet të jap arsye se ku qëndron ai tejkalim, ose nëse pretendon se në aktgjykim ka kundërthënë në mes dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit, duhet të japë arsye të qarta ku qëndrojnë ato kundërthënie etj.)

P.nr. ____2015

Formulari 88

PËRGJIGJA NË ANKESËN KUNDËR AKTGJYKIMT

(Neni 388. të KPPK-së)

GJYKATËS THEMELORE PRISHTINË

Për

GJYKATËN E APELIT PRISHTINË

Në çështjen penale P.nr. _____ 2015, në bazë të nenit 388 paragrafi 2 të KPPK-së, paraqes:

PËRGJEGJE NË ANKESË

E Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore Prishtinë të paraqitur kundër Gjykatës Themelore Prishtinë, P.nr. _____ datë _____ 2015.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë P.nr. _____ datë _____ 2015, për shkak të veprës penale të mashtrimit nga neni 335 paragrafi 1 të KPPK-së, të pandehurit i është shqiptuar dënimi me kusht, ashtu që iu ka caktuar dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (NJË)

VITI, e ekzekutimi i të cilit nuk do të bëhet nëse i akuzuari prej 1 (një) viti nuk do të kryen veprën tjetër penale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka paraqitur Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore Prishtinë, PP.nr. _____/2015 datë _____ 2015 dhe atë për dy baza ligjore: për shkak të shkeljes së ligjit penal me pretendim se në veprimet e të akuzuarit arrihen të gjitha elementet e veprës penale nga neni 335 paragrafi 2 të KPPK-së dhe për shkak të vendimit për dënimin me arsyetim se nuk ka pasur bazë që ndaj të akuzuarit të shqiptohet dënim me kusht, me propozim që Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar në raport me cilësimin juridik ashtu që të akuzuarin ta shpall fajtor për veprën penale nga paragrafi 2 dhe në raport me dënimin ashtu që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim me burgim, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e veçmas lartësinë e dëmit që i akuzuari u ka shkaktuar të dëmtuarve.

Ankesa e Prokurorit Shtetëror e Prokurorisë Themelore Prishtinë nuk është e bazuar. Është e vërtetë se i mbrojturi im e ka vu në lajthim të dëmtuarin M.S., dhe i ka marrë 2.000 € me qëllim që t'i rregulloj një vizë pune në Austri por këtë nuk ka mundur ta bëjë ngase edhe atë e kanë mashtruar personat tjerë të cilët të mbrojturit tim i kanë premtuar se kanë mundësi që ligjërisht personave të caktuar t'u siguroj punë me zonën shengen. Është e vërtetë se i mbrojturi im është marrë vesh me të dëmtuarin që me rastin e sigurimit të vizës dhe punës në Austri t'i paguajë edhe 5.000 €, mirëpo deri te kjo nuk ka ardhur për shkak se i akuzuari nuk ka mundur të sigurojë vizë pune, kështu që krejt dëmi që i është shkaktuar të dëmtuarit ka qenë 5.000 € të cilat edhe tani i janë kthyer të dëmtuarit, andaj konsideroj se janë të pabazuara pretendimet nga Prokurori se cilësimi juridik ka qenë i ngarkuar në favor të të pandehurit, ngase nuk është përmbushur asnjë element që ka të bëjë me lartësinë e dëmit të shkaktuar për ta cilësuar veprën penale nga neni 335 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës.

Me rastin e marrjes së vendimit për dënimin gjykata e shkallës së parë ka marrë parasysh shumë rrethana lehtësuese se në vendin e punës ku akuzuari punon është i sjellshëm dhe me përpikëri i kryen të gjitha obligimet në punë, se është baba i tre fëmijëve të mitur, se gjer më tani ka qenë i pa dënuar, se dëmin ia ka kompensuar menjëherë të dëmtuarit, se ka shprehur keqardhje për këtë që i ka ndodhur, se këtë më tepër e ka bërë nga naiviteti se sa që ka pasur qëllim për ta mashtruar të dëmtuarin ngase i njëjti ka ra pre i mashtruesve të tjerë.

Nga kjo gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur veprimet e të akuzuarit i ka cilësuar sipas nënti 335 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës dhe në plotni me ligjin dhe rrethanat lehtësuese dhe të pranishme në anën e të akuzuarit i ka shqiptuar dënim me kusht dhe plotësisht besoj se edhe vetëm një kërcënim për dënimin duke pasur parasysh të kaluarën e të akuzuarit do të ndikojë pozitivisht te ai që të mos përsëris veprime të tilla të paligjshme e për këto arsye Gjykatës së Apelit i

P r o p o z o j

Që për arsyet e përshkuara më lartë ankesën ta refuzoj si të pabazuar ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të vërtetoj.

Prishtinë _____

Mbrojtësi i të akuzuarit,

D.A. avokat nga Prishtina

Formulari 89

AKTVENDIM PËR HEDHJEN E ANKESËS SI TË PASAFATSHME

(Neni 399 të KPPK-së)

P.nr. nr. _____

Gjykata e Apelit në Prishtinë, në kolegjin në përbërje prej gjyqtarëve NN, NN dhe NN, me procesmbajtësen B.H., në çështjen penale të pandehurit S.B. nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes të parashikuar nga neni 325 par. 1 të KPK-së, duke vendosur për afatshmërinë e ankesës të pandehurit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në _____ Departamenti i Përgjithshëm P.nr. _____ nga data _____, më datë _____, murr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET si e pas afatshme, ankesa e të pandehurit N.N, nga _____ të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në _____, Departamenti i Përgjithshëm P.nr. _____ nga data _____,

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____ P.nr. _____ datë _____ i akuzuari _____, nga _____ është shpallur fajtor për shkak të veprave penale të vjedhjes të parashikuar nga neni 325 par. 1 të KPK-së dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3.muajve, ekzekutimi i të cilit konform nenit 51 të KPK-ës është shtyrë në afat prej një viti, me kusht që i akuzuari të mos kryej vepra tjetër penale .

Të pandehurit aktgjykimi personalisht i është dorëzuar më 12.03.2015, ky fakt dëshmohet nga fletë kthesa e nënshkruar nga vet i akuzuar.

Me të 01.04.2015, i akuzuari me letër rekomande ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit e cila i ka arrite gjykatës më 03.04.2015.

Afati për paraqitje të ankesës , konform nenit 380 të KPPK-ës , është 15.ditë.

Meqenëse ankesa kundër aktgjykimit është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor, gjykata ka vendosur si në dispozitiv , në mbështetje të nenit 399 të KPPK-ës sejtë vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

AP.DP.nr. /2015, më datë _____

Procesmbajtësja,

Kryetari i Kolegjit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi , mund të ushtrohet ankesë Gjykatës

Supreme të Kosovës, në afat prej tri(3) ditësh, nga dita e marrjes së

aktvendimit , nëpërmjet kësaj Gjykate.

Sqarim: 1.Edhe pse në neni 398 të KPPK-ës, shprehimisht nuk thuhet se kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit me të cilën ankesës e palëve është hedhur si e pas afatshme ose e palejuar mund të ushtrohet ankesë, kjo e drejtë nuk mund tu mohohet palëve (*me ligjin që ishte në aplikim deri në vitin 2013 ankesën mund ta hidhte si të palejuar dhe të pasa afatshme gjykata e shkallës së parë*)aq më parë kur në nenin 411.par.pika e 5 dhe 6.të KPPK-ës, theksohet se mund të paraqitet ankesë kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit e cila gjykatë, këtë ankesë ia dërgon Gjykatës Supreme .

2. Ankesa mund të hudhet si e pas afatshme (neni 399 i KPPK-ës) apo si pa lejueshme (neni 400 të KPPK-ës).

3. Forma e aktvendimit për hedhjen e ankesës të palejueshme, është e njëjtë me aktvendimin për hudhjen e ankesës si të pas afatshme, por duhet theksuar shkaqet konkrete për shkak të cilave ankesa konsiderohet e palejueshme, duke u thirrur në dispozitat përkatëse të KPPK-ës.

Formulari 90

AKTGJYKIMI ME TË CILIN ANKESA REFUZOHET SI E PABAZUAR

(Neni 420. të ish. KPPK-ës)

Ap.nr. ____/

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: NN., kryetar, NN, NN.dhe NN. anëtarë, procesmbajtëse N.N. në lëndën penale të të akuzuarve : NN, nga _____, komuna e _____, për veprën penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje, të parashikuar nga neni 147.par.1. nënp.9. lidhur me nenin 23 .të KPK-ës; N.N edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuar nga neni 328.par.2, lidhur me ankesën e Prokurorit _____, ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, avokatit N.N. nga _____, ankesat e të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, avokatëve : NN. Dhe N.N. nga _____ paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së _____, P.nr.693/ datë _____, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 410 të KPPK, më _____ mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara, ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut në _____, ankesa e përfaqësuesit të palës së dëmtuar , dhe ankesat e të akuzuarve :N.N. dhe N.N. dhe të mbrojtësve të tyre, kurse aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut _____, P.nr.693/2006 datë 20.5.2008, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e Qarkut Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.693/datë _____ i ka shpallur fajtorë të akuzuarit _____ dhe _____ për veprën penale të vrasjes së rëndë në bashkëkryerje, të parashikuar nga neni 147.par.1. nënp.9 lidhur me nenin 23 .të KPK, kurse të akuzuarin N.N. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo në shfrytëzim të paautorizuar të armëve, të parashikuar nga neni 328.par.2 të KPK. Gjykata të akuzuarit N.N. për veprën penale të vrasjes i ka caktuar dënimin me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim; për veprën penale të armëmbajtjes pa leje i ka caktuar dënimin me 1 (një) vit burgim dhe pastaj i ka gjykuar: të akuzuarin N.N. me dënim unik burgu prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjetësh, në të cilin i është përfshirë edhe koha e kaluar në paraburgim prej 01.5.2006 e tutje, kurse të akuzuarin N.N. me 10 (dhjetë) vjet burgim, në të cilin i është përfshirë edhe koha e kaluar në paraburgim prej 1. 5.2006 e tutje. Ndaj të akuzuarit NN.është shqiptuar edhe dënimet plotësuese – marrja e pushkës automatike si mjet i kryerjes së veprës penale. Të akuzuarit janë obliguar që në mënyrë solidare t'i paguajnë shpenzimet e procedurës aq sa do të jenë ato sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor, secili nga 200 €.

E dëmtuara N.N është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesa kanë paraqitur:

- Prokurori Publik i Qarkut në _____, vetëm për shkak të vendimit për dënimin , me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'u shqiptohen dënime më të ashpra;

-përfaqësuesi i palës së dëmtuar, vetëm për shkak të vendimit për dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarve t'u shqiptohen dënime më të ashpra;

- të akuzuarit N.N dheN.N, pa i përcaktuar bazat ankimore dhe pa ndonjë propozim;

- mbrojtësi i të akuzuarit N.N., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPK-ës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin, duke propozuar që Gjykata Supreme aktgjykimin e goditur ta anulojë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose ta ndryshojë atë dhe të akuzuarin ta lirojë nga akuza dhe

- mbrojtësit e të akuzuarit N.N, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit për dënimin; duke propozuar që Gjykata Supreme aktgjykimin e goditur ta

anulojë dhe lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rigjykim ose ta ndryshojë atë dhe këtë të akuzuar ta lirojë nga akuza.

Në ankesë mbrojtësit kanë kërkuar që, në kuptim të nenit 410 të KPPK-ës, ata dhe të akuzuarit të njoftohen për seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë dhe të akuzuarve t'u mundësohet pjesëmarrja në seancë.

Gjykata Supreme mbajti seancën e kolegjit në kuptim të nenit 410 të KPPK, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori Publik i Kosovës, N.N, i cili propozoi që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut dhe ajo e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të aprovohen, ndërsa ato të mbrojtësve dhe të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara. Të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, pas sqarimit të disa thënieve të ankesave, në tërësi qëndruan në propozimet e tyre të cilat i tumirën edhe të akuzuarit.

Prokurori Publik i Kosovës edhe me shkrim – me parashtrësën PPA.nr.488/2008 datë 10.12.2008 – ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut dhe ajo e përfaqësuesit të palës së dëmtuar të aprovohen ndërsa ato të mbrojtësve të akuzuarve të refuzohen si të pabazuara.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, studimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 415 të KPPK, vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjeve ndaj ankesave, Gjykata Supreme konstatoi:

Ankesat janë të pabazuara :

Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe as shkelje të ligjit penal, të cilat Gjykata Supreme, si gjykatë e shkallës së dytë, i vëren detyrimisht (neni 415 të KPPK-ës).

Mbrojtësit e të akuzuarve, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, theksojnë se dispozitivi i aktgjykimit është konfuz dhe i pakuptueshëm, ngase deri sa në dispozitiv thuhet se të akuzuarit janë shtyrë nga motive të dobëta, nuk është përmendur së paku një motiv i tillë; në dispozitiv nuk thuhet fare se pësoi apo jo lëndime trupore i akuzuari N., ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit thuhet se edhe N. u qëllua nga tani i ndjeri N.; pastaj, sipas ankesës, edhe arsyet e dhëna janë të paqarta, mbasi në një pjesë thuhet se i ndjeri u paska shkaktuar të ndjerit N.dhe të akuzuarve lëndime trupore, derisa vetë ishte i pa lënduar. Të gjitha këto mbrojtësit i konsiderojnë shkelje esenciale absolute të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara nga neni 403.par.1.pika 12 të KPPK-ës, për të cilat shkelje aktgjykimi domosdoshmërisht duhet anuluar. Veç kësaj, pretendohet se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë edhe me shkelje të dispozitave të nenit 191.par.1.nënp.1.të KPPK-ës, pasi që në dispozitiv nuk janë theksuar të gjitha elementet që duhet t'i përmbajë dispozitivi për një vepër të tillë.

Përkundër këtyre pretendimeve ankimore, aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye për faktet vendimtare, nga të cilat qartë konkludohet se si të akuzuarit kryen veprën penale të vrasjes, cilat veprime i ndërmorën ata për kryerjen e veprës së njëjtë. Gjithashtu nga provat e proceduara shihet se me cilat prova dëshmohen fakte të caktuara që kanë të bëjnë me kryerjen e veprës penale dhe se si gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar provat e proceduara.

Në arsyetimin e aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështjeje juridiko-penale. Po ashtu, janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, të cilat, si të drejta dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim me dispozitën e nenit 387 par.2 të KPPK-ës, kurse me provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 396.par.7. të KPPK-ës, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose si të paprovuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore; pra, ajo ka bërë analizën e të gjitha provave të proceduara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe lidhur me to ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat, si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Qasja ndaj fakteve vendimtare ka qenë e drejtë dhe e ligjshme; asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje ose i pavërtetuar. Faktet vendimtare jo vetëm që janë vërtetuar drejt, por ato edhe janë arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë. Pastaj nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk ka theksuar së paku një motiv të dobët, ngase ai konstatim ekziston, (për shkak të konflikt rreth një prone), dhe këtë motiv e ka arsyetuar shumë qartë në arsyetimin e aktgjykimit, domethënë motivi i dobët i këtij konflikt me pasoja tragjike është transparent dhe i padiskutueshëm.

Qëndron pretendimi i ankesës se në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar nuk është theksuar se i akuzuari N. ka pësuar lëndime trupore, mirëpo kjo është arsyetuar në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, kështu që ky “ lëshim” nuk e bën aspak të paqartë dispozitivin, ngaqë fakti se ky i akuzuar kishte pësuar lëndime trupore nga tani i ndjeri N. është sqaruar dhe arsyetuar qartë në aktgjykimin e ankimuar dhe përkitazi me këtë rrethana nuk ka ngelur asnjë mëdyshje dhe as që është vënë në dyshim nga askush.

Edhe pretendimet ankimore për ekzistimin e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara nga neni 403.par.2.pika 1 të KPPK-ës , ngase është shkelur dispozita e nenit 391.par.1.pika 1. të KPPK-ës, janë të pabazuara, sepse aktgjykimi i ankimuar i përmban të gjitha elementet e parashikuara nga ky nen, ndërsa ankesa, përpos që ka parafrazuar në mënyrë stereotipe par.1.nënp.1. të nenit 191.të KPPK-ës, nuk ka dhënë as një arsye se cilat elemente nuk po i përmbaka aktgjykimi .

Pretendimet ankimore përkitazi me gjendjen faktike

Për sa i takon bazës ankimore vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, mbrojtësit e të akuzuarve në ankesat e tyre, në esencë, kontestojnë mënyrën se si janë vlerësuar

provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga ana e gjykatës së shkallës së parë si dhe konkludimet që i ka nxjerrë ajo në bazë të provave që i kishte proceduar. Pretendohet se provat janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe sipërfaqësisht, pa ndonjë analizë kritike dhe kjo, sipas tyre, ka bërë që edhe konkludimet të jenë të gabuara.

Mbrojtësit e të akuzuarve në ankesat e tyre, (të cilat janë tërësisht identike), pretendojnë se ngjarja nuk ishte zhvilluar ashtu siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë, por kishte një rrjedhë krejtësisht tjetër; shtrojnë shumë dilema dhe çështje hipotetike dhe konkludojnë se nuk ishin të akuzuarit ata që ia kishin bllokuar rrugën – i kishin zënë pritën – tani të ndjerit N., por, përkundrazi, i ndjeri N. me persona tjerë ua kishin zënë pritën të akuzuarve. Përfundimet e këtilla ata i mbështesin në faktin se kombi i të ndjerit N. ishte i parkuar skaj rrugës dhe se aty kishte hapësirë të mjaftueshme për të kaluar edhe automjete të tjera. Ata në ankesat e tyre pyesin se nëse ngjarja është zhvilluar ashtu siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë, përse atëherë kombi i të ndjerit nuk ishte në rrugë, por ishte skajuar anës rrugës.

Përveç kësaj, ata pretendojnë se bazuar në numrin e plagëve që i kanë marrë i ndjeri N. të akuzuarit N. dhe N. del se të akuzuarve plagët ua ka shkaktuar dikush tjetër nga prapa, duke aluduar te N, i cili kishte qenë akuzuar njëherë me akuzën e prokurorit publik ngase, sipas ankesës, absolutisht ka qenë e pamundur që i ndjeri N. vetë t'ua shkaktojë plagët të ndjerit N dhe të akuzuarve. Gjithnjë sipas ankesës, eksperti i balistikës ka deklaruar se të akuzuarit i kanë marr lëndimet trupore diku në një distancë prej 50 m dhe kjo rrethanë, sipas tyre, tregon se në anën e të ndjerit ishin të involvuar edhe persona tjerë.

Ankesat pretendojnë se eksperti ka përjashtuar mundësinë që të akuzuarit, pas pësimit të plagëve, të kenë mundur t'i shkaktojnë lëndime të ndjerit N, sepse ata tashmë ishin të alivanosur dhe të pavetëdijshëm.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, edhe pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë për arsytet që vijojnë:

Në këtë ngjarje tragjike nuk është kontestuese se më 1.5.2006, rreth orës 17,00, në fsh. _____, komuna e _____, është shkaktuar një përleshje fizike mes vëllezërve N, N dhe N.G. në njërin anë, dhe N.G.J. në anën tjetër, dhe se në këtë përleshje kanë ngelur të vdekur N.G. dhe B. G, ndërsa lëndime trupore kanë pësuar S. dhe Sh. G. Kontestuese janë faktet se a ishin tani i ndjeri B. dhe të akuzuarit ata që ia kishin zënë pritën tani të ndjerit Z. a ishte i ndjeri Z. personi që kishte privuar nga jeta të ndjerin B. dhe u kishte shkaktuar lëndime trupore të akuzuarve për t'u privuari më pas nga jeta nga i akuzuari S. siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë, apo ishte i ndjeri Z. që me persona tjerë ua kishin zënë pritën të akuzuarve, nëse të akuzuarit ishin plagosur nga persona të tjerë që ishin të involvuar në këtë ngjarje dhe nëse i akuzuari S. nuk e ka privuar nga jeta të ndjerin Z., sikundër edhe i akuzuari Sh. nuk i ka shkaktuar kurrfarë lëndimesh trupore tani të ndjerit Z, siç pretendojnë të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre në ankesa.

Përfundimet e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me rrethanat që kontestohen me ankesë janë të drejta dhe të mbështetura në prova të pakontestueshme. Në këtë çështje penale juridike provat, si ato formale, ashtu edhe ato materiale, me përjashtim të deklarimeve të akuzuarve, në të gjitha aspektet ishin të harmonishme, koherente dhe në tërësi plotësonin njëra-tjetrën, andaj mënyra e kryerjes së veprës penale, pastaj bashkëkryerja dhe motivet janë aq të qarta sa nuk lënë asnjë dyshim edhe për këtë Gjykatë.

Në këtë çështje penale juridike faktet relevante dhe kryesore se të akuzuarit ishin ata që i kishin zënë pritën të ndjerit Z., se tani i ndjeri Z ishte vetëm, se ai u sulmua nga vëllazërit G, se ata kishin motiv për ta sulmuar, se ai para se fatalist të goditej me breshëri automatiku nga akuzuari S, kishte pësuar lëndime tjera trupore me thikë dhe me mjet të topitur dhe se atë e privoi nga jeta i akuzuari S. janë vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar dhe lidhur me këto rrethana përfundimet e gjykatës së shkallës së parë janë të drejta, duke mos ngelur asgjë në mëdyshje dhe e pafaktuar.

Nga derivojnë përfundimet e tilla të gjykatës së shkallës së parë?

Së pari, përfundimi se të akuzuarit dhe tani i ndjeri B. ia kishin bllokuar rrugën të ndjerit Z. rezultojnë nga pozita e gjetur e kombit pas ngjarjes tragjike, pastaj nga dëshmia e dëshmitarëve E. Gj.i cili kishte arritur i pari në vendin e ngjarjes dhe dëshmitë e S. dhe I.Gj. të cilët kanë deklaruar se edhe kombi i të ndjerit Z. edhe vetura e të akuzuarve ishin të ndalur në të njëjtin drejtim – në drejtim të urës; vetura e markës golf ishte para kombit, me pjesën e parë në urë e me pjesën e pasme në rrugë dhe ishte e ndalur asisoj që nuk ka lejuar mundësinë e kalimit të kombit pa u ndalur. Së dyti, fakti se i ndjeri Z, ishte vetëm mbështetur në atë se asnjëri nga të akuzuarit nuk përmendën asnjë person tjetër që ta kishin parë atë ditë në vendin e ngjarjes, përpos deklaratave të të akuzuarve se i ndjeri Z. i kishte sulmuar me persona të tjerë të panjohur. Së treti, se i ndjeri Z para se të vritej ishte sulmuar nga të akuzuarit tregon ekspertiza mjekoligjore, e cila prezencën e barotit në duart e të ndjerit B. dhe të akuzuarit Sh. e shpjegon me faktin se kur i ndjeri Z. shtiu me armë në ta ishte shumë afër tyre ,në largësi prej 10-15 cm. Së katërti, motiv për t'i zënë pritën dhe për ta sulmuar kishin të akuzuarit, ngase i ndjeri Z. e kishte blerë një arë nga një serb, të cilën arbitrarisht pretendonin ta mbanin të akuzuarit, se për shkak të kësaj shitblerjeje, tani i ndjeri Z. dhe djali i tij kishin rënë në konflikt me të ndjerin B, dhe e kishin rrahur atë dhe për këtë rrahje nuk ishin pajtuar fare; se të akuzuarit pak para ngjarjes tragjike e paskan vërejtur të ndjerin Z. duke i hequr hunjtë, përkatësisht rrethojën e arës kontestuese që i kishin vendosur të akuzuarit dhe e kishte rrethuar me hunj dhe tel të tij dhe se kishte bërë xhiro në atë arë dhe po i binte burisë, gjë që të akuzuarit e kishin konsideruar provokim (këtë rrethanë e ka pohuar vetë i akuzuari S.). Së pesti, se i akuzuari kishte pësuar disa lëndime me thikë dhe me mjet të topitur vërtetohet nga ekspertiza mjekoligjore. Përpos lëndimeve me armë automatike, të cilat të ndjerit Z. ia ka shkaktuar i akuzuari S. gjë që nuk është kontestuese, nga ana tjetër nuk mund të dihet se cili nga të akuzuarit apo i ndjeri B. i kanë shkaktuar lëndimet e tjera, d.m.th. këto veprime në rrethana të këtylla nuk mund të personalizohen, edhe pse gjykata e shkallës së parë ka theksuar se me thikë e ka sulmuar i

akuzuari Sh, ndërsa me një mjet të topitur i ndjeri B. Këto rrethana nuk janë vërtetuar me prova të sigurta dhe as që ka mundësi të vërtetohen në rrethanat në të cilat është zhvilluar ngjarja. Sido që të jetë, nuk ka asnjë mëdyshje se i ndjeri ato lëndime i pësoi nga sulmuesit, (tani i ndjeri B dhe të akuzuarit), dashja e përbashkët e të cilëve ishte që ta privojnë nga jeta atë dhe është fare irelevante se cili nga ata e theri me thikë dhe cili nga ata e goditi me mjet të topitur.

Së gjashti, se i ndjeri Z. vdiq për pasojë të lëndimeve të shumta të marra nga pushka automatike vërtetohet nga ekspertiza mjekoligjore, sipas së cilës ai vdiq si pasojë e këtyre lëndimeve dhe pas këtyre goditjeve ai nuk ka mundur të veprojë më tej, (as të sulmojë e as të mbrohej).

Së shtati, se lëndimet vdekjeprurëse me automatik të ndjerit Z, ia shkaktoi i akuzuari S vërtetohet nga eksperti mjekoligjor, i cili ka konstatuar se i ndjeri B dhe i akuzuari Sh, pas lëndimeve me armë që morën nga i ndjeri Z, nuk kanë mundur as të sulmojnë më tej e as të mbrohen (d.m.th. ai përjashtoi mundësinë që këta ta kenë goditur me armë të ndjerit Z), ndërsa nga dëshmia e dëshmitarëve i vetmi që ishte me vetdije pas kësaj ngjarje ishte i akuzuari S, i cili nuk mund të ngrihej në këmbë, por zvarritej, që nuk lë asnjë dilemë se ai ekzekutoi të ndjerin Z.

Po t'i referohemi mbrojtjes së të akuzuarve, del se ata u sulmuan nga i ndjeri Z dhe persona të tjerë. Mirëpo, kjo mbrojtje e tyre imponon pashmangshëm pyetjen: kur ata ishin në armiqësi me të ndjerin, përse atëherë u ndalën për të biseduar me personin me të cilin ishin në konflikt dhe nëse ata po shkonin për të blerë “pleh artificial”, përse u armatosën deri në dhëmbë – me pushkë automatike, me thikë dhe me mjet të topitur? Të gjitha këto pyetje kanë vetëm një përgjigje, të cilën e ka dhënë drejt gjykata e shkallës së parë duke përfunduar se të akuzuarit dhe i ndjeri B. ia zunë priturën të ndjerit Z. dhe e sulmuan atë dhe ky sulm pati pasojë tragjike edhe për njërin, edhe për palën tjetër.

Mbrojtja e tyre se ata ranë në priturë të të ndjerit, është skajshmërisht e paqëndrueshme dhe jokohërente me provat e proceduara në këtë çështje penale-juridike, ngase ata vetë kishin deklaruar se pak para ngjarjes tragjike e kishin parë nga shtëpia e tyre të ndjerin në arën që ata pretendonin se u takonte atyre, i cili “po i binte burisë e kështu kishte vepruar edhe kur kishte kaluar para shtëpisë së tyre” dhe veprimet e tij i konsideronin provokim ndaj tyre. Nga kjo del qartë se këtu çdo gjë ishte e planifikuar nga të akuzuarit dhe i ndjeri B. dhe këtu nuk kishte asgjë të rastësishme, prandaj edhe përfundoi ashtu si përfundoi.

Prandaj, duke i pasur parasysh rrethanat e sipërpërmendura si dhe rrethanat dhe arsyet e cekura në aktgjykimin e goditur, rezultojnë të pabazuara pretendimet ankimore dhe, në anën tjetër, rezultojnë të drejta dhe të ligjshme përfundimet e gjykatës së shkallës së parë se të akuzuarit kryen veprën penale për të cilën janë shpallur fajtorë, sepse është vërtetuar drejt, në mënyrë të plotë dhe të padyshimtë se të akuzuarit i kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese, ndërsa në ankesa nuk vihen në dukje prova dhe fakte të tilla që kanë qenë objekt shqyrtimi në procedurën e shkallës së parë dhe të cilat do të mund t'i vinin në dyshim faktet e vërtetuara, ato vetëm paraqesin vlerësimet e tyre për faktet dhe rrethanat e njëjta, të cilat gjykata e shkallës së parë i kishte parasysh dhe të cilat, sipas gjetjes së Gjykatës Supreme, i kishte vlerësuar drejt.

Përkitazi me aplikimin e ligjit penal nga gjykata e shkallës së parë

Meqenëse aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penal, kurse gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar drejt dhe plotësisht ashtu siç e ka aplikuar drejt edhe ligjin penal, pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve për shkelje të ligjit penal janë të paqëndrueshme.

Bazuar në shkaqet që prodhuan këtë konflikt me pasoja tragjike, pa asnjë mëdyshje mund të konkludohet se të akuzuarit, të nxitur nga motive të dobëta, kanë privuar nga jeta të ndjerin Z. Gj. Ata pretendonin se ara që e kishte blerë i ndjeri nga një serb ishte e tyre, pasi që atë tokë e paskan shfrytëzuar me qira një kohë të gjatë. Kështu, të mllefosur se i ndjeri, përpos që e kishte blerë arën të cilën ata konsideronin se nuk ka guxuar ta blejë, ua kishte rrahur edhe vëllain e tyre, tani të ndjerin B, u armatosën dhe i dolën në pritë atij për t'u sqaruar me të. Veprimet e tilla nuk mund t'i emërosh ndryshe përpos si motive të dobëta, sepse ato përveçse janë në kundërshtim me moralin, janë në kundërshtim edhe me normat shoqërore, ngaqë nëse të akuzuarit e kanë pretenduar atë tokë, ata kanë mundur t'i kërkojnë të drejta e tyre në rrugë ligjore – gjyqësore e jo ta marrin drejtësinë në duart e veta, prandaj veprimet e tilla janë gjithësi antishoqërore.

Pretendimet ankimore përkitazi me dënimet

Gjykata vlerësoi ankesat e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë, ankesën e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, ankesat e të akuzuarve dhe ato të mbrojtësve të tyre përkitazi me vendimin për dënimin dhe konstatoi se ankesat janë të pabazuara edhe në këtë drejtim.

Prokurori Publik i Qarkut Prishtinë dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar pretendojnë se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejt rrethanat rënduese ndaj të akuzuarve, veçanërisht sjelljet e tyre pas kryerjes së veprës penale. Sipas ankesës, i akuzuari S. gjatë gjithë procedurës ka pasur sjellje arrogante, ndërsa me rastin e shpalljes së aktgjykimit të akuzuarit kanë filluar ta fyejnë kryetarin e trupit gjykues dhe me patericën ku mbahej e ka goditur në gisht përfaqësuesin e palës së dëmtuar, pastaj i akuzuari Sh. ka tentuar ta goditë me grusht përfaqësuesin e palës së dëmtuar, duke mos shprehur për asnjë çast kurrfarë konsiderate për të dëmtuarin dhe familjen e tij.

Mbrojtësit e të akuzuarve nuk i kanë arsyetuar pretendimet e tyre përkitazi me bazën ankimore - vendimi për dënimin.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit të akuzuarit S. G. ia mori për bazë faktin se është njeri familjar – baba i katër fëmijëve, se ka një gjendje të varfër ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese ia mori për bazë faktin se edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër penale kundër jetës dhe trupit, ndërsa ndaj të akuzuarit Sh. G si rrethanë lehtësuese ia mori për bazë faktin se është i martuar dhe baba i 6 (gjashtë) fëmijëve dhe mbajtës i familjes, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Nga faktet e shtruara më lart rezulton se dënimet, të cilat i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë ndaj të akuzuarve, paraqiten të domosdoshme dhe janë në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, si ekzekutorë, dhe se këto dënime duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme (speciale), forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe janë në pajtim me kërkesat për siguri personale të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i parashikuar me dispozitat e nenit 34 të KPK-ës.

Për këtë arsye ankesa e prokurorit publik dhe ajo e përfaqësuesit të palës së dëmtuar që të akuzuarve t'u shqiptohen dënime më të ashpra si dhe ankesa e mbrojtësve të akuzuarve për shqiptimin e dënimeve më të buta u refuzuan si të pabazuara. Sjelljet e të akuzuarve pas kryerjes së veprës penale, veçmas sjelljet e tyre ndaj kryetarit të trupit gjykues dhe palëve të tjera vërtet ishin të pashembullta dhe të paskrupullta dhe gjithsesi janë rrethana rënduese, mirëpo bazuar në pasojat që kishin rezultuar nga vepra penale e tyre, (u ishte vrarë një vëlla ndërsa vetë kishin pësuar lëndime të rënda trupore), gjykata nuk e gjeti oportune që atyre t'u shqiptojë dënim më të ashpër sesa që u ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, mirëpo sjellja e tyre shumë e vrazhdë, gjithashtu nuk lë hapësirë për ndonjë ulje të dënimit, siç kanë pretenduar mbrojtësit e tyre, aq më parë kur të akuzuarit të dytë i është shqiptuar vetëm minimumi i mundshëm i dënimit të paraparë për veprën penale të kryer.

Nga sa u parashtrua dhe në bazë të nenit 423 të KPPK, u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Ap.nr.488/08 datë 20.5.2009

Procesmbajtëse,

Kryetar i kolegjit

Anëtarët e kolegjit:

Formulari 91

AKTVENDIM ME TË CILIN AKTGJYKIMI I SHKALLËS SË PARË ANULOHET

(Neni 420 të ish të KPPK-së)

Ap.nr.197/2011

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegj i përbërë nga gjyqtarët: N.N. N.N,NN, N.N dhe N.N, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale N.N, në çështjen penale të akuzuarit

F.H, nga fshati _____, komuna e _____, për shkak të veprës penale nga vrasje e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 pika 4 lidhur me nenin 20 të KPK-ës, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 5 lidhur me par. 1 të KPK-ës, dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK-ës, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në _____ dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në _____ P.nr.195/2010 datë 15.2.2011, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPK-ës, më datë 14 mars 2012, mori këtë;

A K T V E N D I M

Me rastin e ankesave të Prokurorit Publik të Qarkut në _____ dhe mbrojtësit të të akuzuarit e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në _____ P.nr.195/2010 datë 15.2.2011, anulohet dhe çështja i kthehet gjykatës së njëjtë në rigjykim.

Ankesat e Prokurorit Publik të Qarkut në _____ dhe mbrojtësit të akuzuarit tani për tani janë jolëndore.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në _____ P.nr.195/2010 datë 15.2.2011, i akuzuari F. H. është shpallur fajtor për shkak të veprave penale vrasje në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 5 lidhur me par. 1 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK, dhe është gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 7.9.2010 deri më datë 4.2.2011, duke i përcaktuar më parë dënimet për secilën veprë veç e veç dhe atë për veprën e parë penale, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj për veprën e dytë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe për veprën e tretë penale dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj. I akuzuari është obliguar që të

paguajë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 50 €, dhe shpenzimet e procedurës penale në lartësi prej 150 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm. Njëkohësisht i është shqiptuar masa e sigurisë konfiskim i revoles së markës “Zastava” me nr.ET-910935 të kal.6.35 mm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë paraqitur:

-Prokurori Publik i Qarkut në _____, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

-mbrojtësi i të akuzuarit F. H., avokati R. A, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Gjykata Supreme konform nenit 410 të KPPK-ës, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën prezantoi avokati N. Sh., sipas autorizimit bartës, i cili në tërësi mbeti pranë pretendimeve të paraqitura në ankesë si dhe i akuzuari F.H, i cili në tërësi e përkrahu ankesën dhe pretendimet e bëra në te.

Prokurori i Shtetit edhe pse i njoftuar me rregull nuk ishte prezent, por me parashtrësën me shkrim PPA.nr.197/2011 datë 3.5.2011, ka propozuar që ankesa e Prokurorit Publik të Qarkut të aprovohet si e bazuar, ndërsa ajo e mbrojtësit të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pretendimet ankimore, konstatoi se me rastin e ankesave të Prokurorit Publik të Qarkut dhe mbrojtësit të të akuzuarit është i domosdoshëm anulimi i aktgjykimit sipas detyrës zyrtare e për këto arsye.

Aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara nga neni 403 par. 1 nën par. 12 të KPPK, për të cilat shkelje kjo Gjykatë konform nenit 415 të KPPK-ës kujdeset detyrimisht.

Fillimisht duhet theksuar se i akuzuari me aktakuzën e Prokurorit Publik të Qarkut në _____ është akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 pika 4 lidhur me nenin 20 të KPK, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 5 lidhur me par. 1 të KPK dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 1 të KPK, dhe nga ana e gjykatës së shkallës së parë është bërë ricilësimi juridik i kualifikimit të veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 nënp. 4 lidhur me nenin 20 të KPK dhe i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK, veprës penale të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm dhe veprës penale të vringëllimit me armë (neni 328 par.1.të KPK).

Dispozitivi i aktgjykimit është absolutisht i paqartë për këto arsye:

Në rastin konkret ka ekzistuar vetëm një ngjarje unike ; tentativa e të akuzuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarin E. B. , ka shtënë në drejtim të tij e ka huqur cakun dhe ka goditur B.M. (iberatio ictus) , nuk kanë ekzistuar dy ngjarje. Prokurori publik ka ndërtuar një dispozitiv kaotik të aktakuzës dhe fatkeqësisht këtë aktakuzë e ka konfirmuar gjyqtari për konfirmim. Në dispozitivin në 1.të aktgjykimit të ankmuar ekziston përshkrimi faktik i veprës penale të vrasjes në tentativë ndaj të dëmtuarit E. B. i cili përshkrim nuk përmban asnjë element të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 .par.1.pika 4 të KPK, edhe pse vepra penale nga ana e prokurorit publik është cilësuar sipas këtij paragrafi !!! (*përshkrimi faktik është kompatibil me vrasjen nga neni 146 dhe vepra penale nuk mund të cilësohet sipas nenit 147 nëse në përshkrimin faktik të veprës penale nuk ekziston asnjë elemente që veprën e bënë të cilësuar.*).Në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit ekziston përshkrimi tjetër i një ngjarje thujse të shkëputur nga kjo e para , ku përshkruhet se si i akuzuari në përpjekje për ta privuar nga jeta E. B. ka plagosur B. M. dhe me këtë paska shkaktuar rrezik të përgjithshëm nga nen 291 par.5. lidhur me par. 1.të KPK, !!, në dispozitivin nën pikën tre të aktgjykimit përshkruhet vringëllimi dmth. një veprim vihet në tri norma të ndryshme juridike; vringëllimi (328 par.1.) ; vrasja me rrezikim të personave tjerë (neni 147.par.1.nënp. 4) dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm (neni 297.par.5 lidhur me par.1.) .Kur veprimi i të akuzuarit është ndërmarrë me qëllim të privimit nga jeta të personit të caktuar , mirëpo ai nuk e ka realizuar pasojën që e ka dëshiruar , por një pasoj tjetër me shkaktimin e të cilës është pajtuar edhe pse nuk ka qenë synimi i kryerësit shkaktimi i kësaj pasoja (dashja eventuale) , nuk mund të bëhet fjalë për bashkim veprash penale të vrasjes dhe shkakimit të rrezikut të përgjithshëm , në situatën e tillë ose bëhet fjalë për vrasje duke vënë

në rrezik jetën e të tjerëve , vrasje me ndonjë rrethanë tjetër cilësuese apo për vrasje të rëndomtë e assesi për shkaktim të rrezikut të përgjithshëm , së dyti nëse me armë është realizuar pasoja konkrete siç ka ngjarë në rastin konkret, çështja ka kaluar nga fusha e vringëllimit , nuk kemi më vringëllim por armëmbajtje pa leje nëse arma është mbajtur pa autorizim dhe veprën penale konkrete që është konsumuar me veprën penale (në rastin konkret vrasje në tentativë) për vringëllim mund të bëhet fjalë vetëm po qese është përdor apo është vringëlluar arma me qëllim frikësimi , kërcënimi (përdor; shtënë në ajër për ta frikësuar të dëmtuarin , ka vringëlluar : duke e nxjerr armën, ia tregon , e zbulon armën për t'ia vënë në pah të dëmtuarit se është i armatosur).Në rastin konkret nuk ka shtënë për ta frikësuar por për ta realizuar pasojën konkretet për ta privuar të dëmtuarin nga jeta dhe në rrethana të tilla nuk bëhet fjalë: as për përdorim të armës në mënyrë frikësuese e as për vringëllim siç gabimisht e ka cilësuar prokurori publik dhe këtë cilësim e ka aprovuar edhe gjykata e shkallës së parë por për veprën penale konkrete të cilën e ka konsumuar kryerësi me përdorimin e armës, pastaj në përshkrimin faktik të veprës penale që ka të bëjë me veprën penale të vringëllimit me armë nuk është theksuar asnjë element i kësaj vepre penale .

Për shkak të lëshimeve të tilla u desh që aktgjykimi të anulohet detyrimisht e meqenëse aktgjykimi i ankimuar u anulua sipas detyrë zyrtare, ankesat e Prokurorit Publik të Qarkut dhe të mbrojtësit të akuzuarit, tani për tani janë jolëndore.

Po ashtu, duhet të theksohet se Kodi Penal i Kosovës nuk parasheh shqiptimin e “masave të sigurisë” të cilat janë shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por parasheh dënime plotësuese, andaj gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh edhe këtë gjatë marrjes së vendimit.

Në rishqyrtim gjykata e shkallës së parë edhe njëherë duhet t'i vlerësoj të gjitha provat e propozuara dhe eventuale, të vlerësoj drejt ngjarjen që është objekt akuze me të gjitha dimensionet e saja, për të nxjerrë konkludime të drejta se në rrethana të tilla; janë konsumuar elementet e veprave penale për të cilat pretendon akuza, apo ndonjë vepër tjetër penale (bazuar edhe në vërejtjet që janë dhënë më lart), e pastaj të marr një vendim të drejt dhe të ligjshëm .

Nga të gjitha këto që u tha më lart e konform dispozitës së nenit 424 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 15 mars 2012, Ap.nr.197/2011

Procesmbajtësja,

Anëtarët e kolegjit:

Kryetarja e kolegjit,

Formulari 92

AKTGJYKIMI I SHKALLËS SË PARË NDRYSHOHET

(Neni 420 të ish KPPK-së)

Ap.nr.503/2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët:N.N., kryetare, NN.NN,NN dhe NN.anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale N.N., procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit XX. Nga _____, për shkak të veprës penale vrasje e rëndë nga neni 147 par.1 pika 4 lidhur me nenin 8 par.4 të KPK, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në _____ P.nr.____ datë _____, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, me datë 27.06.2012, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesshëm të ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në _____ P.nr.17/2011 datë 26.07.2011, vetëm sa i përket cilësimit juridik ashtu që Gjykata Supreme gjen se në veprimet e të akuzuarit arrihen të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes të parashikuar nga neni 146 lidhur me nenin 8.par.4.të KPK.

A r s y e t i m i

Gjykata e Qarkut në _____ me aktgjykimin P.nr._____/2011 datë _____ e ka shpallur fajtor të akuzuarin NN. për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 par.1 nënp. 4 lidhur me nenin 8 par.4 të KPK për të cilën ia ka vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve dhe konform dispozitës së nenit 71 të KPK, e ka gjykuar me dënim unik burgu në kohëzgjatje prej 3 (tre) viteve e 4 (katër) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 10.03.2009 gjer më 26.07.2011. I akuzuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguajë shumën prej 832,86 €, dhe në emër të paushallit gjyqësor 300 €, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues marrja e armës të tipit “Bereta” kal.7.65 mm, me nr.serik.902962 dhe 1 fishek, të njëjtit kalibër. Palët e dëmtuara janë udhëzuar në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pronësore juridike.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit, N.N., avokati N.N. për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza.

Gjykata Supreme e Kosovës për seancën e kolegjit konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, njoftoi Prokurorin e Shtetit të Kosovës të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij.

Në seancë mori pjesë i akuzuari N.N, i cili ngeli pranë pretendimeve ankimore në ankesën e mbrojtësit të tij.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën PPA.nr.503/2011 datë 24.01.2012, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 415 të KPPK, dhe pasi që i vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesë aktgjykimin nuk e ankimon për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë, Gjykata Supreme të njëjtin sipas detyrës zyrtare shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 415 të KPPK, dhe konstatoi se i njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin me e kushtëzuar anulimin e tij.

Pretendimet e mbrojtësit

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit N.N., avokati N.N, e ndërlidhë bazën ankimore të shkeljes së ligjit penal dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Pretendohet se nëse i akuzuari ka vepruar në tejkallim të mbrojtjes së nevojshme konform dispozitës së nenit 8 par.4 të KPK, atëherë nuk është e mundur që veprimet e tij të cilësohen si vepër penale e kualifikuar nga neni 147 pika 4 të KPK, sipas tij vepra penale nuk mund të konsiderohet edhe privilegjuese edhe e kualifikuar me rrethana rënduese dhe këto rrethana sipas ankesë përjashtojnë njëra tjetrën. Sipas mbrojtësit jeta e të dëmtuarit Shërbim nuk është vënë në rrezik pasi që të shtënë e para kanë mbaruar në trupin e tani të ndjerit N.N, dy të tjera në tokë dhe një në bagazhin e veturës. Si protagonist i sulmit N.N. përjashtohet si i dëmtuar. Mbi këtë bazë edhe propozon që i akuzuari të lirohet nga akuza pasi që ka vepruar në mbrojtje të nevojshme. Sipas mbrojtësit të akuzuarit pretendohet se pasi që i akuzuari N.N. ka vepruar në mbrojtje të nevojshme nën kërcënimin e armës të tani të ndjerit N.N. dhe përpjekjes të Shërbim Berishës që ta kthejë në funksion armën e tij. Në një situatë të këtillë veprimet e të akuzuarit nuk mund të trajtohen ndryshe përpos si veprime në mbrojtje të nevojshme.

Përgjigja e gjykatës në pretendimet e ngritura me ankesë

Gjykata Supreme konsideron se ankesa e mbrojtësit është e bazuar vetëm sa i përket pretendimeve se vepra penale nuk mund të cilësohet sipas pikës 4.të nenit 147-rrezikimi i një apo më shumë personave për këto arsye :

Në rrethanat siç është përshkruar gjendja faktike në dispozitivin e aktgjykimit, të cilin e ka riformuluar (ndryshuar) prokurori publik në rigjykim, (prokurori publik në rigjykim, në bazë të provave të njëjta, të cilat i kishte në disponim si me rastin e ngritjes së aktakuzës por edhe me rastin e shqyrtimit të parë, kur kishte ngelur në tërësi pran aktakuzës edhe sa i përket përshkrimit faktik edhe cilësimit juridik të veprës penale, ka riformuluar përshkrimin faktik të veprës penale dhe ka ricilësuar sipas nenit 8.par.4.të KPK), veprimet e të akuzuarit nuk mund të cilësohen si rrezikim i personave të tjerë, jo për shkak të mungesës së rrezikut konkret apo distancës kohore siç pretendon mbrojtësi, ngase të gjitha këto predispozitat kanë ekzistuar, pastaj jo për shkak të rrethanave se një vepër penale nuk mund të jetë edhe privilegjuese edhe rënduese, pasi që vepra penale mund të kryhet edhe në rrethana të tejkalimit të mbrojtjes së nevojshme por edhe duke i rrezikuar të tjerët, ngase është e mundur që kryerësi duke e sprapsur sulmin e atëçastshëm dhe të kundërligjshëm i tejkalon limitet ligjore të mbrojtjes së nevojshme, por njëkohësisht shkakton rrezik konkret për jetën e të tjerëve, por për faktin se nëse edhe N.N. ka qenë i përfshirë në këtë konflikt me pasoja tragjike e rezultojnë se aktor kryesor i kësaj ngjarje ishte pikërisht ky i dëmtuar dhe nëse i akuzuari ka shtënë në drejtim të tij (dmth objekt sulmi nga i akuzuari ishte pikërisht ky i dëmtuar, kështu konstaton prokurori në dispozitivin e aktakuzës por edhe kështu rezultojnë nga zhvillimi i ngjarjes), atëherë nuk bëhet fjalë për rrezikim të personave të tjerë, por për vrasje në tentativë, mirëpo tani ky defekt nuk mund të evitohet. Do mund veprimet e të akuzuarit të vlerësohen si rrezikim i personave të tjerë nëse i dëmtuari N.N. s'ka qenë objekt sulmi, s'ka qenë i involvuar në konflikt, por ka rastisur afër vendit të ngjarjes apo në vendin e ngjarjes dhe ka ekzistuar rreziku konkret që jeta e tij të rrezikohet, mirëpo në rastin konkret ai ishte cak i sulmit nga i akuzuari, për këto arsye kjo Gjykatë duke e miratuar pjesërisht ankesën e mbrojtësit e ricilësoi veprën penale si në dispozitiv të aktgjykimit.

Pretendimet mbrojtësit se në dëm të akuzuari është aplikuar gabimisht ligji ngase veprimet e tij nuk duhet cilësuar si tejkalim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme por si mbrojtje të nevojshme janë të pabazuara, ngase nga rrjedha e ngjarjes dhe nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike, në këtë segment jo që nuk është shkelur ligji në dëm të të akuzuarit, përkundrazi ligji është shkelur në favor të tij, ngase nga rrjedha e ngjarjes rezultojnë se ngjarja nuk është zhvilluar në asnjë segment në rrethana të mbrojtjes së nevojshme e as të tejkalimit të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, mirëpo përfaqësuesi i akuzës kështu i ka "ricilësuar" veprimet

e të akuzuarit” si tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme” dhe gjykata ka qenë në pamundësi të veproj ndryshe .

Vendimi për dënimin

Mbrojtësi në ankesë aktgjykimin e ankimuar e godet edhe për shkak të vendimit mbi dënimin por në arsyetim të ankesës fare nuk bënë fjalë për këtë bazë ankimore e këtë nuk e ka propozuar as në propozimin e tij ku vetëm thuhet se i akuzuari ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, andaj edhe propozon që i njëjti të lirohet nga akuza.

Gjykata e shkallës së parë të akuzuarit N.N.si rrethana lehtësuese ia mori për bazë gjendjen ekonomike dhe familjare , moshën se më parë nuk ka qenë i gjykuar, sjelljen korrekte në gjykatë dhe situata në të cilën është gjetur, ndërsa si rrethanë rënduese se i akuzuari ka shtënë shumë herë duke rrezikuar edhe jetën e personave të tjerë.

Në situatën e dhënë (bazuar në ricilësimin e veprës penale nga prokurori publik) rezulton se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme, forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për siguri personale të individëve dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimin të parashikuar me dispozitën e nenit 34 të KPK, për këtë arsye kjo Gjykatë refuzoi ankesën edhe në këtë pjesë edhe pse veprën penale e ricilësoi në një vepër penale më të lehtë (nga neni 147 në neni 146) ngase pasojat që kanë rezultuar nga vepra penale, këtë dënim e tregojnë të domosdoshëm për arritjen e qëllimit të shqiptimit të sanksioneve penale në të gjitha segmentet e tij.

Nga çka u tha më lart e konform nenit 426 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ap.nr. _____/2011 datë _____

Procesmbajtëse,

Kryetare e kolegjit,

Anëtarët e kolegjit ;

Sqarim: Në formularin 87 dhe 89(*vendimet gjyqësore*) janë aplikuar dispozitat e ish KPK-ës dhe KPPK-ës(2004), kishite edhe strukturë tjetër gjyqësore dhe prokuroriale, nga kjo e viti 21013 e tutje.

Formulari 93

ANKESA KUNDËR AKTGJYKIMIT TË SHKALLËS SË DYTË

(*Neni 407 të ish KPPK-së*)

P.nr. _____ / _____

GJYKATËS THEMELORE _____

Për

GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit APKR.nr. _____ / _____ datë _____, në bazë të nenit _____ të KPPK-së, paraqes:

A N K E S Ë

_____ për shkak të vendimit për dënimin.

A r s y e t i m

Gjykata e Apelit në Prishtinë me aktgjykimin APRP.nr. _____ / _____ datë _____, ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore _____, PKR.nr. _____ / _____ datë _____, vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që të akuzuarit N.N. për shkak të veprës penale të vrasjes nga neni 179 par.1.nënp. 1.1 të KPK-së, i ka shqiptuar dënim me burg të përjetshëm. Konsideroj se nuk ka pasur vend për shqiptimin e dënimit me burg të përjetshëm, ngase në anën e të akuzuarit kanë ekzistuar rrethana lehtësuese që kanë justifikuar shqiptimin e një dënimi kohor, ashtu siç ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë.

Gjithashtu konsideroj se në rrethana të tilla, përkundër faktit se në rastin konkret një person është privuar nga jeta dhe tre të tjerë kanë pësuar lëndime trupore, dy të natyrës së lehtë dhe një i natyrës së rëndë, bazuar në rrethanat se si është zhvilluar ngjarja, veçmas faktin se konfliktin e kanë provokuar të dëmtuarit si dhe tani i ndjeri e bën të justifikueshëm dëmin me burgim që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë. I akuzuari në rastin konkret vepron me inercion dhe shpejtësi nga frika se do e sulmojnë nga i ndjeri dhe tani i dëmtuari, pa pasur mundësi që të kalkulojë pasojat eventuale të cilat edhe rezultuan nga ky veprim i pamenduar i të akuzuarit. I akuzuari gjatë gjithë jetës së tij kurrë nuk ka ra konflikt me ligjin, njihet si njeri i sjellshëm dhe human në rrethin ku jetonte, ndërsa kjo nuk mund të thuhet për të ndjerin dhe për të dëmtuarin, ngase në atë regjion këta persona njiheshin për shkaktim të shpeshta të konflikteve me fqinjët dhe me rrethin ku ata jetonin, pastaj se po të njëjtit disa herë ishin të skeduar penalisht te organet e ndjekjes për shukka të konflikteve rrahjeve me fqinjë , pa si që ata nuk hezitonin ta përdornin forcën , ndaj çdokujt që guxonte atyre tu kundërvihej.

Bazuar në të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe drejt i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, e veçmas faktin se i akuzuari është baba i pesë fëmijëve, se ka përgatitje superiore, pastaj se në jetën e tij të gjertanishme nuk ka ardhur asnjëherë në konflikt me ligjin, se në rastin konkret po edhe më herët konflikti ishte provokuar nga i ndjeri dhe të dëmtuarit , e arsyetojnë plotësisht si të drejtë dhe legjitim dënimin me burgim prej 20 vitesh që i ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë të akuzuarit. Gjykata e shkallës së dytë vetëm ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe dënimin kohor e ka shëndrruar në dënim permanent-burgim të përjetshëm edhe pse nuk ka konstatuar asnjë rrethanë tjetër nga ajo që e ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, që do e bënte të arsyeshëm dënimin me burgim të përjetshëm, në rrethana të tilla pa gjetur asnjë rrethanë tjetër rënduese në anën e të akuzuarit, dënimin me burgim të përjetshëm e bënë jo legjitim dhe arbitrar.

Për këtë arsye

P r o p o z o j

Që Gjykata Supreme si gjykatë e shkallës së tretë për arsye të mësipërme ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit APKR.nr_____ datë_____ dhe të vërtetoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilin të akuzuarit iu kishte shqiptuar dënim me burgim prej 20 vitesh.

Prishtinë, datë_____

Mbrojtësi i të pandehurit,

Avokat N.N.

Formulari 94

VENDIM I GJYKATËS SUPREME, LIDHUR ME ANKESËN KUNDËR AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË DYTË

Api.nr.5/2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – Kolegji i veçantë i përbërë nga Kryetari i Gjykatës-Kolegjit, N, N,N,N, dhe N , anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale N. procesmbajtëse, në çështjen penale të të akuzuarit N., për veprën penale vrasje e rëndë të parashikuar nga neni 147 par. 1 nënparagrafi 3 dhe 7 të KPK, lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, avokatit N., nga Prishtina, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr._____/2009 datë _____, në seancën e Kolegjit të veçantë të mbajtur konform dispozitave të nenit 410 të KPPK-ës, më datën 23.09.2011, mori këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit N.N., kurse aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr._____/2009 datë _____ dhe ai i Gjykatës së Qarkut në _____, P.nr._____/2008 datë _____, vërtetohen.

A r s y e t i m i

Rrjedha e procesit

Gjykata e Qarkut në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.174/2008 datë 30.6.2008, të akuzuarin N.N., nga fshati _____, komuna e _____, e ka shpallur fajtor për veprën penale vrasje e rëndë të parashikuar nga neni 147 par. 1 nënparagrafi 1.3 dhe 1.7 të KPK-ës dhe për këtë i ka caktuar dënimin me burgim afatgjatë prej 36 (tridhjetegjashtë) vitesh, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej 18.4.2008 e tutje. E ka obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe shpenzimet paushall në lartësi prej 200 €.

Ndaj të akuzuarit ka shqiptuar dënimin plotësues marrjen e pushkës së gjuetisë me dy tyta të markës “ÇIPSAN CSP-555” modeli TS – 870 TM të kal.12 bore, me nr.serik 154081 dhe dy complete municioni e 48 copë fishekë të pushkës së gjuetisë.

Të akuzuarin, po ashtu, e ka obliguar që palës së dëmtuar, familjes së të ndjerit X.X., t’ia kompensojë dëmin material në shumën prej 18.720 €, kurse për pjesën tjetër të kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Vendimi i Gjykatës Supreme lidhur me ankesën

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Ap.nr._____/2009 datë _____, e vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut _____, Pnr.174/2008, datë 30.06.2009.

Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme

Kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme në afatin ligjor ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit av. N.N., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, vendimit mbi kërkesën pasurore-juridike, vendimit mbi marrjen e sendit dhe vendimit mbi dënimin, me propozimin që Kolegji i veçantë i Gjykatës Supreme të Kosovës ta aprovojë ankesën, ta anulojë aktgjykimin e saj. Ap.nr.429/2009 datë 9.3.2011, kurse çështjen t’ia kthejë Gjykatës Supreme të Kosovës Prishtinë, respektivisht Gjykatës së Qarkut _____, për rigjykim dhe rivendosje.

Vendimi i Kolegjit të Veçantë të Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e mbajti seancën e Kolegjit të Veçantë konform dispozitës së nenit 410 të KPPK, në të cilën morën pjesë Prokurorja e Shtetit, N.N. i akuzuari N.N., dhe mbrojtësi i të akuzuarit, av. N.N. i cili, pasi sqaroi disa nga pretendimet, qëndroi në propozimin që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet për rigjykim dhe rivendosje.

Prokurorja e Shtetit, N.N, qëndroi në propozimin me shkrim PPAI.nr.5/2011 datë 6.9.2011, me propozimin që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit N.N. të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjetjet e Kolegjit të Veçantë

Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme i shqyrtoi shkresat e e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar konform dispozitës së nenit 415 të KPPK dhe, pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në ankesë, gjeti se ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e ngritura nga mbrojtja për shkeljet esenciale të

dispozitive të procedurës penale

Në ankesën e ushtruar nga mbrojtësi pretendohet se aktgjykimet e ankimuara janë të përfshira nga shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parashikuara nga neni 403 par. 1 nënparagraf 8 dhe 12 të KPPK. Kështu, mbrojtja konsideron se aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut _____ janë të bazuara në prova të papranueshme, sepse i akuzuari deklaratën e datës 20.4.2008 para policisë së e ka dhënë pa prezencën e mbrojtësit të tij dhe kjo vetëm përmendet në pjesën hyrëse të aktgjykimet. por askund nuk është nënshkruar. Po ashtu, konsideron se i akuzuari në polici fare nuk është njoftuar për të drejtat e parashikuara nga neni 231 i KPPK.

Në ankesën e mbrojtësit, po ashtu, pretendohet se dispozitivi i aktgjykimet është i pakuptueshëm, kundërtshënës me brendinë e tij dhe me arsyet e aktgjykimet, se nuk përmban arsyetim lidhur me faktet vendimtare ose arsyet janë të paqarta e kundërtshënëse mes asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimet lidhur me përmbajtjen e shkresave – procesverbaleve për deklaratimet e dhëna në procedurë dhe vetë këtyre shkresave – procesverbaleve, sepse nga dispozitivi i aktgjykimet nuk mund të kuptohet nëse i akuzuari e vuri në lajthim – e mashtroi të akuzuarin, duke keqpërdorur besimin e tij, duke ftuar atë me telefon celular kinse për të ngrënë mëngjes apo këto ishin veprime kriminale që do të pasonin, domethënë, sipas aktgjykimet të ankimuar, vënia në lajthim e të dëmtuarit u bë me qëllim të marrjes së parave.

Përgjigjet e gjykatës Supreme lidhur me këto pretendime

Para se gjykata t'i paraqesë përgjigjet e saja lidhur me pretendimet e ankesës do jap këto sqarime :

Mbrojtësi me ankesën e tij e atakon vetëm vendimin e Gjykatës Supreme, ndërsa me vendimin e Gjykatës Supreme është konfirmuar vendimi i shkallës së parë, nuk është mbajtur shqyrtim nuk janë proceduar prova .

Së dytë, kjo ankesë është identike me ankesën të cilën mbrojtësi e kishte ushtruar edhe ndaj aktgjykimet të shkallës së parë, (kopje e tërësishme e saj), për të cilat pretendime kishte marr përgjigje nga gjykata e shkallës së dytë.

Megjithatë edhe pse me ankesë atakohet vetëm aktgjykimi i shkallës së dytë të Gjykatës Supreme , Kolegji i kësaj Gjykate, për të mos i dëmtuar interesat e të akuzuarit, për lëshimet e avokatit (ai fare nuk e ka ankimuar aktgjykimin e shkallës së parë) e vlerësoi ankesën sikur kjo të ishte paraqitur edhe ndaj aktgjykimet të shkallës së parë.

Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme gjen se pretendimet për ekzistim e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë për këto arsye:

Në ankesën e tij mbrojtësi pretendon se aktgjykimi është i bazuar mbi një provë të papranueshme – mbrojtjen e të akuzuarit të cilën ai e kishte dhënë në polici. Pretendimet e këtilla janë të pabazuara, meqë nga shkresat e lëndës rezulton se i akuzuari, para fillimit të intervistës në Stacionin policor të _____ më datën 20.4.2008, është njoftuar për të gjitha të drejtat e tij të parashikuara nga neni 231 të KPPK-ës, dhe me at rast ishte i pranishëm edhe mbrojtësi i tij, N.N, nga _____. Edhe pse procesverbali mbi marrjen në pyetje të të pandehurit nuk është nënshkruar nga avokati, faktin se ai kishte qenë i pranishëm me at rast e ka dëshmuar vetë i akuzuari, i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se gjatë marrjes në pyetje në polici ishte i pranishëm edhe mbrojtësi i tij prandaj, në rrethana të këtilla, deklarim i të pandehurit dhënë në polici rezulton të jetë bërë në përputhje me ligjin dhe se nuk ka ekzistuar asnjë pengesë ligjore që kjo deklaratë të merret parasysh me rastin e vendosjes lidhur me këtë çështje penalo juridike.

Dispozitivët e aktgjyqimeve të ankimura janë të qarta, konkrete dhe nuk përbëjnë kundërthënie qoftë me vetveten, qoftë me arsyetimin e tyre. Në arsyetimin e aktgjykimit të shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike, të cilat i aprovon edhe ky Kolegj, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsyes merren si të provuara ose si të paprovuara. Duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitës së nenit 396 par. 7 të KPPK-ës, gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara e të analizuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, lidhur me të cilat ka nxjerrë përfundimet e veta, që, si të drejta, objektive dhe të ligjshme, i ka konfirmuar edhe kolegji i kësaj Gjykate, por i aprovon edhe Kolegji i Veçantë i kësaj Gjykate, edhe pse lidhur me këtë bazë ankimore mbrojtësi i të akuzuarit ka parafrazuar dispozitën ligjore, pa dhënë arsye se ku qëndrojnë këto shkelje.

Në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë janë përshkruar elementet cilësuese që kanë të bëjnë me dinakërinë dhe vrasjen për motive përfitimi të dobisë pasurore, ndërsa në arsyetim është arsyetuar qartë vënia nën këtë normë juridike e veprimeve të të akuzuarit dhe në këtë drejtim nuk ka asnjë paqartësi .

Pretendimet ankimore përkitazi me gjendjen faktike

Lidhur me bazën ankimore – vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit pretendon se nuk është bërë në mënyrë të drejtë vlerësimi i provave të administruara ose ato janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme nga ana e gjykatës së shkallës së parë, të cilin vlerësim e aprovoi edhe gjykata e shkallës së dytë, prandaj edhe konkludimet e nxjerra janë të gabuara, pra, në esencë, mbrojtësi konteston mënyrën e vlerësimit të provave të administruara. Gjithashtu ankesa pretendon se gjendja faktike ka ngelur e mangët për faktin se një mori faktesh vendimtare nuk janë vërtetuar.

Mbrojtësi më tej me ankesë e konteston gjendjen e vërtetuar faktike për shkak se: gjykata e shkallës së parë nuk ka urdhëruar ekzaminimin neuropsikiatrik të të akuzuarit lidhur me përgjegjshmërinë e tij, se nuk e ka urdhëruar ekspertin e botanikës për ekzaminimin e barit të

gjetur në bagazhin e N.N , se nuk ka urdhëruar ekspertizën balistike për të vërtetuar nëse i ndjeri ishte vrarë me pushkën që e posedonte i akuzuari, se gjykata e shkallë së parë nuk i dërgoi për ekspertizë edhe rrobat e të ndjerit, për të vërtetuar nëse në to ka ose jo gjurmë të gishtërinjve të të akuzuarit, ndërsa gjykata e shkallës së dytë ka shkelur “të drejtën në mbrojtje “ të të akuzuarit me faktin e vërtetimit të aktgjykimit të shkallës së dytë; se në shtëpinë e të akuzuarit nuk janë gjetur fare gjurmë të gjakut e gjurmë të tilla nuk janë gjetur as në vendin ku ishte varrosur viktimja, se nuk është bërë ekspertiza për t’u parë nëse ai ishte vrarë ose jo me pushkën e të akuzuarit, ngase, gjithnjë sipas ankesës, meqë i ndjeri kishte dhënë para me fajde, shumë të tjerë kishin motiv për ta vrarë atë, por një motiv të tillë nuk e kishte i akuzuari. Në vazhdim, ankuesi komenton ekspertizën e ekspertit mjekoligjor dhe konkludon se nga ekspertiza mjekoligjore rezultoi se i ndjeri nuk ishte vrarë aty ku ishte gjetur, por diku tjetër dhe ishte sjellë në shtëpinë e të akuzuarit, ku ai ishte detyruar nga NN.personi ta varrose atë. Pastaj, në ankesën e tij mbrojtësi parashtron pyetjen se si është e mundur që, në këto kohë moderne, në të cilat ekzistojnë mjete të avancuara për zbulimin e kryerësve dhe gjurmëve të veprave penale, nuk është urdhëruar asnjë ekspertizë, por është mjaftuar me një këqyrje nga subjektet e ndryshme në procedurë; ndërkaq, kundërshton edhe vendimin e prokurorit publik për tërheqjen nga akuza në raport me N.N, duke konstatuar se “Gjykata Supreme fare nuk e analizon tërheqjen e kundërligjshme të prokurorit nga ndjekja penale!!!; krejt këtë - sipas ankesës – edhe gjykata e shkallës së parë, edhe Gjykata Supreme, por edhe Prokuroria e Qarkut e bëjnë “për të mos u zbuluar e vërteta !”.

Përgjigjet e Kolegjit të Veçantë të Gjykatës Supreme lidhur me

pretendimet e mbrojtjes për të metat në gjendjen e fakteve

Pretendimet e mësipërme të mbrojtësit jo vetë që nuk janë të bazuara, por, për më tepër, ato përbëjnë fyerje për segmentet e caktuara të drejtësisë, (**kur pretendohet se “gjykatat dhe prokuroria po marrin vendime të kundërligjshme ndaj të akuzuarit për ta fshehë të vërtetën** , duke përfshirë këtu edhe Gjykatën Supreme!...), ndërsa ato nuk kanë të bëjnë fare me profesionalizmin, për arsytet që do të pasojnë.

Përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, të cilat i ka konfirmuar edhe gjykata e shkallë së dytë, janë të drejta dhe të mbështetura në prova të sigurta, ngase në këtë çështje penalo-juridike si provat materiale, ashtu edhe ato formale janë harmonike, koherente dhe plotësojnë njëra-tjetrën, ashtu që nuk ka ngelur në mëdyshje asnjë fakt që ka të bëjë me autorin e këtij krimi makabër, duke përfshirë këtu edhe mënyrën dhe motivin e kryerjes së krimit.

Devijimet e të akuzuarit në shpjegimin e ngjarjes në procedurat e mëtejme gjyqësor nga ai që kishte dhënë në polici janë qartazi të orientuara drejt ikjes nga përgjegjësia penale. Arsyet e mëposhtme në këtë drejtim rrëzojnë në tërësi mbrojtjen e tij si imagjinare dhe në kundërtënie absolute me provat e tjera, ndërsa pretendimet ankimore i bëjnë plotësisht të pabazuara.

Si është e mundur që i ndjeri të jetë vrarë diku tjetër dhe që kufoma të jetë sjellë nga N.N, e mbështjellë në batanije dhe të jetë varrosur ashtu e mbështjellë, (siç do të shpjegojë i akuzuari në shqyrtim gjyqësor dhe siç po pretendon ankesa), dhe i akuzuari t'i dijë të gjitha detajet e vrasjes: ku është goditur, me sa predha është goditur, llojin e pushkës etj. Pastaj, si është e mundur që deklarata e tij e bërë në polici të përputhet plotësisht me dëshminë e dëshmitarit N.N., i cili ka deklaruar se i ndjeri kishte kërkuar prej tij t'i siguronte për 30000 franga zvicerane valutë në euro dhe se ato po ia kërkonte i akuzuari, pra si është e mundur kjo përputhje deklaratash, nëse ngjarja nuk do të kishte rrjedhë ashtu siç ka gjetur gjykata e shkallës së parë dhe siç e ka përshkruar vet i akuzuari në deklaratën e tij dhënë në polici?. Nëse i ndjeri qenka vrarë nga N.N diku tjetër, siç po pretendon ankesa, si mundi atëherë i ndjeri t'i shkruaj sms N.N. me këtë përmbajtje: “Jam duke shkuar te N.N. për t'i marrë parat e ndoshta vonohem”?

Nga ekspertiza e autopsisë është vërtetuar se i ndjeri është goditur në shpinë me një predhë të pushkës së gjuetisë, kurse i akuzuari ka pohuar dhe precizuar se, derisa i ndjeri ishte duke shkuar kah lumi, kishte shtënë në të me pushkë gjuetie me predhën e parë, pra kur i ndjeri nuk kishte shkak dhe arsye të dyshonte se mund t'i ndodhte diçka nga i akuzuari, gjë që vërteton faktin se vrasja është kryer në mënyrë dinake, pra atëherë kur i ndjeri nuk e priste fare një veprim të tillë.

Nga fotodokumentacioni që ka të bëjë me dy pakot e municionit të konfiskuara në shtëpinë e te akuzuarit shihet se në njërin prej tyre mungojnë 2 fishekë, ndërsa nga autopsia vërtetohet se i ndjeri është goditur me dy predha të pushkës së gjuetisë dhe se gëzhojat e gjetura në gropën ku është gjetur edhe i ndjeri, sipas ekspertizës balistike, janë të të njëjtit kalibër,(12 bore), që ka edhe pushka e gjuetisë, e cila është konfiskuar në shtëpinë e te akuzuarit.

Janë fare irelevante gjithashtu edhe rrethanat nëse i ndjeri ishte vrarë 5, 10 apo 15 m larg bregut të lumit “Morava” dhe, po ashtu, pa asnjë relevancë është fakti nëse i akuzuari kishte mbajtur pushkën brenda apo jashtë, fakte këto që ankesa i quan “vendimtare”, duke qenë se asnjë detaj i ngjarjes, duke përfshirë këtu edhe motivet e kryerjes së krimit, nuk ka ngelur dubioz.

Gjykata e shkallës së parë, e ndodhur para këtyre fakteve të pakontestueshme, nuk ka pasur nevojë të ndërmarrë asnjë veprim tjetër të pretenduar nga ankesa, ngase çdo detaj ka qenë i qartë dhe pikërisht si është sjellë i ndjeri nga ___në _____ me mashtrim, si është vrarë nga i akuzuari, si është varrosur dhe për çfarë qëllimi është vrarë. Në praninë e këtyre provave të pakontestueshme, të thuash në ankesë se i ndjeri është vrarë nga N.N, diku tjetër dhe është sjellë në shtëpinë e të akuzuarit për t'u varrosur, është më së paku profesionale dhe askush që posedon njohuri sado modeste profesionale në drejtësi, nuk do të ngrinte çështje të këtilla absurde. Si është e mundur dikush të vrasë dikë në _____, (edhe N.N. edhe i ndjeri ishin nga _____), apo diku tjetër në një pyll dhe ta sjellë për ta varrosur në _____ dhe pikërisht në shtëpinë e të

akuzuarit; këtë s' do ta bënte as një i çmendur e lërë më personi për të cilin pretendon ankesa, prandaj çdo koment tjetër, në këto rrethana, është i panevojshëm .

I akuzuari, në prezencën e mbrojtësit, e ka përshkruar në detaje krimin në polici; është vërtetuar se i ndjeri, nëpërmjet sms, kishte komunikuar se po shkonte në shtëpinë e të akuzuarit në _____ për të marrë paratë e këmbjeryera, se është gjetur i varrosur në oborrin e shtëpisë së tij dhe pikërisht në vendin të cilin e kishte përshkruar vetë i akuzuari. Në praninë e kaq shumë fakteve të pakontestueshme, çfarë rëndësie paska ekspertiza mjekoligjore e pushkës ose e gëzhojave të gjetura në vendin e krimit, ekspertiza e makinës së N.N, ekspertiza e rrobave të të ndjerit, ekspertiza e barit, ekspertiza e vendit të krimit, të cilin e kishte ndryshuar i akuzuari pas kryerjes së vrasjes, (duke thirrur shokë për ta lëvruar). Nga kjo edhe rezultojnë qartë se i ndjeri nuk ishte vrarë aty ku është varrosur, por në oborrin e tij, siç e përshkruan i akuzuari); nuk është kontestues se i ndjeri ishte vrarë me pushkën me kalibër 12.bar., ashtu siç kishte pranuar vetë i akuzuari dhe se në njërin nga dy pakot e municionit që ishin gjetur në shtëpinë e të akuzuarit, mungonin dy fishekë të të njëjtit kalibër. Procedimi i këtyre “provave” të pretenduara, në rrethanat e përshkruara më lart, është fare i parëndësishëm dhe pa mundësi ndikimi në gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Gjykata ka për detyrim që të urdhërojë ekzaminimin psikiatrik të të akuzuarit kur lindin mëdyshje lidhur me përgjegjshmërinë e tij, kurse në rastin konkret asnjë sjellje e të akuzuarit, në asnjë fazë të procedurës, nuk kishte shkaktuar mëdyshje në bindjen e trupit gjykues përkitazi me përgjegjshmërinë e tij. Gjykata nuk urdhëron ekspertiza të panevojshme për tekat e palëve që tentojnë haptazi të fitojnë kohë dhe të shtyjnë procesin.

Gjithashtu, në praninë e rrethanave në të cilat është zhvilluar ngjarja dhe të fakteve që s'mund të kontestohen në asnjë variant, janë fare pa ndikim faktet të cilat ankesa i pretendon si “vendimtare”, domethënë nëse kishte apo nuk kishte i ndjeri marrëdhënie fajdeje me klientë të ndryshëm, të cilët, sipas ankesës, paskan pasur motiv për ta vrarë atë, ngase do ishte prodhim fantastik e mendjes së njeriut ajo se klientët e ndryshëm, që kishin marrë para nga i ndjeri, për të mos kthyer detyrimet, do e vrisnin atë e do ta sillnin të vrarë në oborrin e të akuzuarit për ta varrosur. Një gjë të tillë ata nuk do ta bënin edhe sikur të kishin bashkëpunuar me të akuzuarin në vrasje, ngase ky nuk është i vetëm në familje dhe, veç kësaj, kemi të bëjmë me një fshat tepër të dendur, në mes të të cilit ndodhet shtëpia e të akuzuarit ! Mbrojtja e të akuzuarit e dhënë në polici në praninë e mbrojtësit, (ai këtë rrethanë e pohon vet në shqyrtim gjyqësor, edhe pse, vërtetë, mbrojtësi nuk kishte vënë nënshkrimin e vet në procesverbal, në hyrje të të cilit, megjithatë, konstatohet se marrja në pyetje bëhet në prezencën e avokatit), dallon nga mbrojtja që e ka dhënë më vonë – në shqyrtimin gjyqësor, duke pretenduar se kinse te ndjerin e kishte sjellë të vrarë në shtëpinë e tij N.N.dhe e paska detyruar ta varrosë në pronën e tij .

Gjykata e shkallës së dytë nuk ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, siç pretendon mbrojtësi në ankesën e tij, ngase ajo nuk ka mbajtur shqyrtim e as që ka proceduar prova, por vetëm ka konfirmuar një gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Në rrethanat kur gjykata e shkallës së dytë vetëm ka refuzuar ankesën e parashtruar dhe ka vërtetuar

aktgjykimin e shkallës së parë, është absurde që dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë të quhet i paqartë, siç e konsideron atë ankesa! Gjithashtu, me aktgjykimin refuzues vendoset vetëm për çështjet procedurale, por jo edhe për ato faktike. Prokurori publik ka në dispozicion aktakuzën dhe është çështje e tij se çfarë do bëjë me të. Meqenëse në rastin konkret prokurori erdhi në përfundimin se nuk është provuar pjesëmarrja e N.N. në çfarëdo forme në këtë krim, u tërhoq nga ndjekja penale e tij dhe gjykata, në situata të tilla, ligjërisht nuk ka mandat të vlerësojë dhe të japë sqarime se ishte apo nuk ishte e ligjshme tërheqja e prokurorit nga ndjekja penale, siç pretendon mbrojtësi në “ankesë”, domethënë nëse ishte apo nuk ishte edhe dikush tjetër i përfshirë në këtë krim.

Prandaj, duke i pasur parasysh rrethanat e sipërpërmendura si dhe rrethanat dhe arsyet e cekura në aktgjykimin e goditur, rezultojnë të pabazuara pretendimet ankimore dhe, në anën tjetër, rezultojnë të drejta dhe të ligjshme përfundimet e gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë, sepse është vërtetuar drejt, në mënyrë të plotë dhe të padyshimtë se i akuzuari i ka ndërmarrë veprimet inkriminuese.

Pretendimet ankimore përkitazi me aplikimin e ligjit

Në ankesën e tij mbrojtësi pretendon se i akuzuari eventualisht mund të përgjigjej për veprën penale dhënia e ndihmës kryerësit pas kryerjes së veprës penale të parashikuar nga neni 305 të KPK dhe “moslajmërimi i veprave penale dhe kryerësit të saj nga neni 304 të KPK.”

Përgjigja e Kolegjit të Veçantë lidhur me këto pretendime

Meqenëse është vërtetuar me pa mëdyshje se autor i kësaj vrasjeje është i akuzuari, nga kjo rezulton se edhe ligji penal është aplikuar drejt, ngase me prova të pakontestueshme janë dëshmuar edhe motivi i kryerjes, edhe mënyra e kryerjes së veprës penale, (kryerja me dinakëri). Pastaj, nuk është e mundur që kryerësi të shpallet fajtor edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 304, edhe për veprën penale të parashikuar nga neni 305 të KPK, siç pretendon mbrojtësi në ankesë, madje edhe sikur të ishte vërtetuar një gjendje tjetër faktike (ajo që pretendon mbrojtësi), ngase nuk është e mundur bashkimi mes këtyre veprave penale; i akuzuari nuk është i detyruar ta paraqesë vetveten si kryerës të veprës penale, nëse ai në ndonjë mënyrë ka bashkëpunuar në krim, sepse ai në këtë mënyrë do ta denonconte vetveten.

Pretendimet ankimore përkitazi me vendimin për dënimin

Pretendimet se dënimi i shqiptuar është tejet i ashpër dhe nuk është në përputhje me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit i arsyeton me faktin se në anën e të akuzuarit janë vlerësuar si rënduese edhe rrethanat që paraqesin element esencial të veprës penale, ndërsa rrethanave lehtësuese nuk u është dhënë rëndësi e duhur, edhe pse formalisht ato janë vlerësuar si të tilla.

Duke i pasur parasysh rrethanat e vërtetuara me të cilat është udhëhequr gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit për veprën e kryer e të cilave u referohet në arsyetimin e aktgjykimit dhe duke i vlerësuar ato në raport me pretendimet

ankimore, kjo Gjykatë i gjen të pabazuara pretendimet se dënimi është tejte i ashpër, përkundër faktit se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit ia mori gabimisht si rrethana rënduese mënyrën e kryerjes (dinakërinë) dhe motivet e kryerjes së veprës penale (motivin e përfitimit material), të cilat rrethana i ka cilësuar si të tilla ligji dhe nuk mund të merren dy herë rënduese për të akuzuarin.

Me individualizimin e dënimit nëpërmjet të procesit të matjes së dënimit, pesha e veprës penale relativizohet dhe në këtë rast duhet pasur parasysh që dënimi, sipas masës, duhet të plotësojë qëllimin e dënimit, i cili, sipas orientimeve ligjore, duhet të shprehë një balans të drejtë mes kërkesave që të akuzuarit t'i mundësohet risocializimi nëpërmjet edukimit (parandalimi individual) dhe kërkesës së publikut që ai dënim, me peshën e tij, të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, (parandalimi i përgjithshëm).

Në situatën konkrete, të gjitha postulatet e përmendura ligjore me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit janë përmbushur, pra dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ai do të jetë në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme (speciale), forcimit të moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtim me kërkesat për siguri personale dhe të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i parashikuar me dispozitat e nenit 34 të KPPK, në segmentet e parandalimit të përgjithshëm dhe atij individual.

Prandaj, edhe me evitimin e rrethanave rënduese, që njëkohësisht paraqesin element cilësues i veprës penale dhe në praninë edhe të rrethanave lehtësuese, të cilat konform nenit 64 të KPK i ka marr në konsiderim gjykata e shkallës së parë, nuk do të mund të justifikohet shqiptimi i ndonjë dënimi më të butë se ai që ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, kur merren parasysh rrethanat e tjetra të pranishme që i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë me rastin e peshimit të dënimit, të cilat, si të drejta dhe të ligjshme, i pranon edhe Kolegji i kësaj Gjykate.

Pretendimet ankimore lidhur me kërkesën pasurore-juridike dhe marrjen e sendit

pushkës së gjuetisë

Meqenëse ankesa, siç u parashtua më sipër, e konteston gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, ka kërkuar që të hiqet detyrimi i të akuzuarit për kompensimin e kërkesës pasurore-juridike dhe kthimin e pushkës së gjuetisë.

Edhe në këtë drejtim ankesa është e pabazuar, ngase, në praninë e fakteve të pakontestueshme që u arsyetuan më sipër, del se i akuzuari me pushkën e gjuetisë e ka privuar nga jeta të ndjerin dhe nga ai ka marrë sasinë e përmendur të parave, të cilat edhe kishin qenë motiv për vrasjen e tij, rezulton se aktgjykimi edhe në këtë pjesë është i ligjshëm dhe i bazuar në prova të pakontestueshme, ndërsa ankesa është e pabazuar.

Nga sa u tha më lart e në bazë të nenit 423 të KPPK, u vendos si në dispozitivi të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 23.09._____, Api.nr.5/_____

Procesmbajtësja,

Kryetari i Gjykatës-kolegjit ,

Anëtarët e kolegjit,

RISHIKIMI I PROCEDURËS

Formulari 95

NJË FORMË E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN NDRYSHOHEN AKTGJYKIMET E PLOTFUQISHME PA RISHIKIMIN E PROCEDURËS

(*Rishikimi jo i drejtë i procedurës penale neni 420 të KPPK-s.*)

Kp.nr.____/_____

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata _____, në kolegjin shqyrtues në përbërje prej: S.M. kryetari i kolegjit, N.N. dhe M.L. anëtar të kolegjit, me procesmbajtësen C.T. në lëndën penale ndaj të gjykuarit S.S nga _____ për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë, të parashikuar nga neni 327.par.1 të dhe veprës penale të vjedhjes , të parashikuar nga neni 325.par.1. të KPK-ës, duke vendosur sipas kërkesës së të gjykuarit për shqiptimin e dënimit unik, pas marrjes së mendimit të Prokurorit _____ në _____ PP.____/____, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.10._____ mori këtë,

A K T G j Y K I M

Ndryshohen përkitazi me vendimin për dënimin, aktgjykimi i Gjykatës themelore në _____ PDP..nr.256/____ nga _____ me të cilin i gjykuari S.S.është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë , të parashikuar nga neni 327.par.1.nënp.1.1.të KPPK-ës, dhe është gjykuar me katër(4) vite burgim dhe aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____ P.nr.300/____ datë _____, me të cilën i gjykuari S.S.është shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhje , të parashikuar nga neni 325.par.1. të KPK-ës, dhe është gjykuar me 2 (dy) vjet burgim, ashtu që Gjykata Themelore në _____, duke i marrë dënimet e shqiptuara më parë si të vërtetuara , me aplikimin e nenit 81 të KPK –ës, dhe nenit 420.par.1.nënp.1.1.të KPPK -ës, e

G J Y K O N

Me pesë(5) vjet burgim, në të cilën i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej _____ e deri më _____.

A r s y e t i m i

Sqarim :

Marrja e aktgjykimit të ri është kompetencë e gjykatës themelore që ka gjykuar çështjen ku është shqiptuar lloji më i rëndë i dënimit. Kur janë shqiptuar dënime të llojit të njëjtë, aktgjykimi i ri merret nga gjykata e cila ka shqiptuar dënim më të rëndë, ndërsa kur dënimet janë të njëjta, aktgjykimi merret nga gjykata e cila e fundit ka shqiptuar dënimin.

Formulari 96

KËRKESA PËR RISHIKIMIN E PROCEDURËS

(Neni 423 të KPPK-ës)

A. Në favor të pandehurit.

Gjykatës Themelore në _____

Në bazë të nenit **423.par.1.nëparagrafi 1.3.të KPPK-ës**, paraqesë,

KËRKESË PËR RISHIKIMIN E PROCEDURËS PENALE

N.N.nga _____, me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore _____ nr. _____, është gjykuar për shkak të veprës penale të pranimi të mallrave të vjedhura nga neni 345. paragrafi 1.të KPK-ës, me dënim burgu në kohëzgjatje burgu prej 1 (një) viti.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, AP.nr. _____ datë _____, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore _____, P.nr. _____ datë _____, në raport me të mbrojturin tim N.N., i cili është gjykuar për shkak të veprës penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, të parashikuara nga neni 345. paragrafi 1. të KPK-ës, ndërsa është anuluar në raport me të akuzuarin F.L., i cili akuzohet për veprën penale të vjedhjes së rëndë , të parashikuar nga neni 327 paragrafi 2.nëparagrafi 2.1 të KPK-së.

I pandehuri N.N. është gjykuar për pranimin e sendeve të vjedhura për të cilën ai e ka ditur se janë të siguruar me vepër penale.

Në ri procedurë në relacion me të akuzuarin F.L. është vërtetuar gjendje tjetër faktike, përkatësisht është vërtetuar që vlera e sendeve të cilat ai i ka siguruar me vepër penale, a të cilat i pandehuri N.N. i ka pranuar nuk kapin vlerën prej **5000 euro**, siç është vërtetuar kjo me aktgjykimin e Gjykatës Themelore P.nr. _____ datë _____, **por shumën prej 2500 euro, domethënë për gjysmë më pak.**

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore, P.nr. _____ datë _____, e cila është bërë e plotfuqishme, ngase ndaj saj nuk është ushtruar ankesë në raport me të akuzuarin N.N. është provë e re e cila është e përshtatshme që në procedurën e përsëritur të rezultojë me aktgjykim sipas ligjit më të butë, ngase vlera e sendeve të përfituara me veprën penale, përkatësisht vlera e sendeve të cilat i pandehuri i ka pranuar duke e ditur se janë të përfituara me vepër penale, ndikon në kualifikimin e veprës dhe në vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe kryerësit, ndërsa gjykata themelore në _____, si gjykatë e shkallës së parë, përkatësisht Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, kur kanë vendosur për veprën dhe

dënimin e të pandehurit N.N. kanë konsideruar të faktuar se vlera e sendeve të tilla ka qenë shumë më e lartë se sa vlera reale që tani pa mëdyshje është vërtetuar, për këto arsye.

P r o p o z o j

Që Gjykata Themelore në _____, për arsye të përshkruara më sipër pas zbatimit të veprimeve procedurale në bazë të nenit **423. Paragrafi 1.nënp.1.3 të KPPK-ës**, të lejojë rishikimin e procedurë në dobi të pandehurit N.N. i përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj Gjykate P.nr. _____ datë _____.

Në _____

Mbrojtësi i të pandehurit,

M.M.

Formulari 96

B. Në dëm të pandehurit.

GJYKATËS THEMELORE NË _____

Në bazë të *nenit 423 paragrafi 2.të KPPK-ës*, paraqes,

KËRKESË PËR RISHIKIMIN E PROCEDURËS PENALE

N.N.nga _____, me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore _____ nr. _____, është gjykuar për shkak të veprës penale të pranimin të mallrave të vjedhura nga neni 345. paragrafi 1.të KPK-s, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

A r s y e t i m i

L.K. me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Departamentin i Përgjithshëm, PDP.nr. _____ datë _____, në bazë të nenit 364.par.1.nënp.1.3, të

KPPK-së, është liruar nga akuza për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 327 paragrafi 2.nënparagrafi 2.1 . të KPK-së.

Në këtë çështje penale përpos të të dëmtuarit i cili nuk e kishte identifikuar në momentin e vjedhjes të pandehurin është dëgjuar edhe dëshmitari B.S. i cili në momentin kritik kishte ndodhur afër vendit të ngjarjes dhe e kishte njohur të pandehurin. Mirëpo, i njëjti në procedurën e hetuesisë si dhe në shqyrtimin gjyqësor kishte ndërruar dëshminë e tij se i pandehuri L.K. nuk ishte personi që natën kritike e kreu vjedhjen por e kishte ngatërruar me një person tjetër të cilin nuk mund ta identifikojnë.

*Meqenëse ishte përfolur nga anëtarët e familjes së dëshmitarit se ky nuk kishte alternativë tjetër, ose të ndërrojë dëshminë ose të rrezikohet nga i pandehuri, ndaj të pandehurit kishte filluar procedurë për kërcënim ndaj dëshmitari dhe pas zbatimit të provave gjykata me aktgjykimin e plotfuqishëm P.nr. _____ datë _____, kishte shpallur fajtor **të pandehurin L.K. dhe e kishte gjykuar me 1 (një) vit burg**, për veprën penale për kërcënimin e dëshmitarit. Ky aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit, por edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.*

Bazuar se i pandehuri ka detyruar dëshmitarin B.S. që ta mohojë faktin se vjedhjen e kishte kryer ai rezulton se janë përmbushur kushtet për rishikimin e procedurës, andaj

P r o p o z o j

Që Gjykata Themelore në _____, për arsyet e përshkruara më sipër pas zbatimit të veprimeve procedurale, në bazë të nenit paragrafi **423.par.2. të KPPK-ës**, lejoj rishikimin e procedurës e cila ka përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore _____, Pdp.nr. _____, datë _____.

Në Prishtinë

Prokurori Shtetëror,

T.S.

Formulari 97

NJË FORMË E AKTVENDIMIT ME TË CILIN KËRKESA PËR RISHIKIMIN E PROCEDURËS HEDHET

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin e përbërë prej _____ kryetari i kolegjit , M.M.dhe P.K anëtarë të kolegjit _____, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit _____, në lëndën penale të pandehurit S.P. nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.8.lidhur me par.1 të KPK-ës, duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit e të pandehurit për rishikimin e procedurës , në seancën e kolegjit të mbajtur më _____ mur këtë;

A K T V E N D I M

HEDHET kërkesa e mbrojtësit të të pandehurit , për rishikimin procedurës, e përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës _____ në _____PDP.nr.____,datë _____

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës _____ në _____ P.nr. ____ dt. ____ M.B nga _____ është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378.par.8.lidhur me par.1 të KPK-ës, dhe është dënuar me dënim burgimi, **në kohëzgjatje prej një viti.**

Kërkesë për rishikim të procedurës penale ka parashtruar i dënuari i cili pretendon se e dëmtuara S.M. gjatë aksidentit nuk ka përjetuar lëndime të rënda trupore që është konfirmuar me aktgjykimin e kësaj gjykate, por ka përjetuar lëndime të lehta trupore. Këtë dyshim i dënuari e ka verifikuar në spitalin e përgjithshëm në _____ dhe ka konstatuar se e dëmtuara nuk është lajmëruar fare në këtë spital, që do të thotë nuk ka qenë e evidentuar si paciente në këtë spital. Për këtë arsye, mendimi dhe konstatimi i ekspertit në të cilën është i bazuar aktgjykimi i plotfuqishëm , nuk i përgjigjet gjendjes reale faktike , që paraqet arsye ligjore për rishikimin e procedurës.

Gjykata shqyrtoi çështjen penale së bashku me kërkesën për rishikimin e procedurës penale , dhe gjeti se kërkesa është e pabazuar .

Nga referati i kërkesës rezulton se mbrojtësi i të pandehurit kërkon rishikimin e procedurës në bazë të nenit 423 par.1.nënp.1.1 të KPPK-ës, nga se aktgjykimi është i bazuar në dokumentin e rrejshëm dhe dëshminë e rrejshme të ekspertit.

Sipas nenit 423,par.1.nënp.1.1.të KPPK-ës , rishikimi i procedurës penale është i mundur nëse vërtetohet se aktgjykimi është bazuar në deklaratat e rreme të dëshmitarëve, ekspertit apo interpretit. Rrethana se aktgjykimi është i bazuar në dëshminë e rrejshme të dëshmitarit, ekspertit apo intepretit, bëhet nëpërmjet të aktgjykimit të plotfuqishëm me të cilën këta persona janë deklaruar fajtorë për vepra penale deklarimi i rrejshëm .Përrjashtimisht vërtetimi i këtyre fakteve mund të dëshmohet edhe me prova tjera , nëse këta persona kanë vdekur apo ekzistojnë rrethana tjera që e përjashtojnë ndjekjen penale.

Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova të parapara me ligj se aktgjykimi i formës së prerë është i bazuar në dokumentin e rrejshëm dhe dëshminë e rrejshme të ekspertit , ndërsa provat në të cilat është e bazuar kërkesa nuk janë bazë e mjaftueshme për të lejuar rishikimin e procedurës penale konform nenit 426, par.1.të KPPK-ës , andaj në bazë të nenit 426.par.1.nënp.1.4.të KPPK-ës, është vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore _____

PDP.nr._____,datë _____

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së

Apelit në Prishtinë, brenda afatit 3 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit.

Formulari 98

AKTVENDIMI ME TË CILIN REFUZOHET PROPOZIMI PËR PËRSËRITJEN E PROCEDURËS

(neni 427 . të KPPK-ës)

KP.nr._____/____

Gjykata Themelore _____, në kolegjin e përbërë prej _____ kryetari i kolegjit , M.M.dhe P.K anëtarë të kolegjit _____, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit _____, në lëndën

penale të pandehurit S.P. nga _____, për shkak të veprës penale përvetësimi në detyrë , i parashikuar nga neni 425.par.2.KPK-ës, duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit e të pandehurit për rishikimin e procedurës penale , në seancën e kolegjit të mbajtur më _____ mur këtë;

A K T V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar propozimi për rishikimin e procedurës penale për të pandehurin _____ nga _____ i cili ka përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut në _____ P.nr. ____ dt. _____

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Qarkut _____ P.nr. ____ dt. ____ është shpallur fajtor V.V nga fshati ____ për shkak të veprës penale të shpërdorimit nga neni ____ të KPK dhe është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 2 (dy)vite.

Mbrojtësi i të dënuarit ka parashtruar kërkesën për rishikimin e procedurës penale me të cilën pretendon se aktgjykimi është marrë në bazë të raportit jo plotësisht të saktë të ekspertit financiar , ngase ekspertit nuk i është prezantuar dokumentacion i kompletuar.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në _____ me shkresë të paraqitur PP____, ka deklaruar se provat në të cilat bazohet kërkesa nuk janë të reja dhe se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për rishikimin e procedurës, andaj ka propozuar refuzimin e saj.

Eksperti V.K. në dëshminë e tij të datës _____ ka deklaruar se me rastin e ekspertimit kishte parasysh fletëpranimet nr. _____ dhe nr. _____ por ato nuk kanë mund të pranohen si shkarkim i të gjykuarit , ngas shitorja gabimisht ishte e shkarkuar , realisht me këtë fletëpranimë do duhej të shkarkohej shitorja nr. _____ e organizatës së njëjtë e që këto ishin objekt shqyrtimi dhe vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë .

Meqenëse provat e paraqitura në kërkesë për rishikimin e procedurës nuk janë të reja , u vendos si në dispozitiv , konform nenit 427.par.1. të KPPK-ës.

Gjykata Themelore _____

P.nr. _____, datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatës së Apelit,
brenda 3 ditësh nga dita e marrjes këtij aktvendimi

Formulari 99

AKTVENDIMI ME TË CILIN LEJOHET PËRSËRITJA E PROCEDURËS PENALE (neni 427 të KPPK-ës)

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin e përbërë prej _____ kryetari i kolegjit ,
M.M.dhe P.K anëtarë të kolegjit _____, me pjesëmarrjen e procesmbajtësit _____, në lëndën
penale të pandehurit D.G. nga _____, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e
sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale fshehjes , të parashikuar nga neni 345.par.3 . të
KPK-ës, duke vendosur lidhur me kërkesën e mbrojtësit e të pandehurit, për rishikimin e
procedurës penale , në seancën e kolegjit të mbajtur më _____mori këtë;

A K T V E N D I M

Lejohet rishikimi (përsëritja) i procedurës penale në dobi të pandehurit D.G.
përfunduar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në
_____PDP.nr.____dt.____ dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në
_____Ap.nr._____ dhe për këtë çështje penale caktohet shqyrtimi i ri
gjyqësor.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____ PDP.nr. ___dt. ___ i pandehuri D.G. është shpallur fajtor dhe është dënuar me pesë (5) vjet burgim, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë , të parashikuar nga neni 327.par.2.nënëp.2.1. të.KPK-ës , ndërsa i pandehuri D.D për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale fshehjes , të parashikuar nga neni 345.par.3 . të KPK-ës, dhe është dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy(2) vitesh.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit APDP.nr. ___dt. ___ është vërtetuar aktgjykimi në raport me të pandehurit D.D. ndërsa është anuluar përkritazi me të pandehurin D.G.

Në rigjykim i pandehuri D.G. me aktgjykimin PDP.nr. ___dt. ___ është shpallë fajtor për vepër penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 të KPK-ës dhe është gjykuar me dy (2) vite burgim, vendimin është bërë i plotfuqishëm, pasi palët nuk kanë ushtruar ankesë.

Mbrojtësi i të pandehurit D.D, avokati _____ nga _____ ka parashtruar kërkesë për rishikim të procedurës penale të përfunduar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Apdp. _____, datë _____ duke pretenduar se në rigjykimi ndaj të pandehurit D.G. është vërtetuar gjendje tjetër faktike, përkritazi me vlerën e sendeve që i akuzuari e ka përvetësuar me veprën penale të vjedhjes e të cilën i pandehuri D.D. një pjesë e ka fsheh një pjesë e ka shpërndarë nuk kap shumën prej 10.000 €, siç është vërtetuar me aktgjykimin e kësaj gjykate PDP.nr. _____ datë _____ por vlera prej 3000 €, siç është vërtetuar tani me aktgjykimin e ri po të njëjtës j gjykatë PDP.nr. _____ datë _____ që do të thotë 7000 € më pak. Meqenëse bëhet fjalë për rrethanë të re për të cilën nuk ka ditur as Gjykata Themelore e as Gjykata e Apelit kur kanë vendosur përkritazi me veprën dhe dënimin e të pandehurit D.D. kjo rrethanë sipas mendimit të mbrojtësit është e bazuar dhe mbështetë kërkesën për rishikimin e procedurës.

Pas shqyrtimit të shkresave të çështjes penale kërkesës së mbrojtësit të pandehurit D.D. dhe mendimit të Prokurorit të _____ në _____ PP.nr. _____ datë _____ kolegji ka gjetur:

Kërkesa e mbrojtësit për rishikimin e procedurës është e bazuar.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore PDP.nr. _____ datë ___ i pandehuri D.G.ka qenë shpall fajtor për veprën penale të vjedhjes së rëndë të parashikuar nga neni 327.par.2.nënëp.2.1. të.KPK-ës, dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje pesë(5) vitesh. Vlera e përcaktuar e sendeve të përfituara me këtë vepër penale sipas këtij aktgjykimi është 10.000 €. Me të njëjtin aktgjykim i pandehuri D.D. është shpallur fajtor për vepër penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale fshehjes , të parashikuar nga neni 345.par.3 . të KPK-ës, dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej dy (2) vitesh, nga se një pjesë të sendeve të vjedhura nga i pandehuri D.G. të përfituara me vepër penale të plaçkitjes e ka fsheh dhe një pjesë e ka shpërndarë.

Meqenëse aktgjykimi i mësipërm është anuluar në raport me të pandehurin D.G., ashtu që ai me aktgjykimin e ri të kësaj gjykate rishitas është shpallur fajtor por për vepër penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325.par.1 të KPK-ës dhe është gjykuar me dy (2) vite burgim, nga se është vërtetuar se vlera e sendeve të cilat ky i pandehur i ka përfituar me vepër penale kap shumën prej 3000€, që domethënë 7000€, më pak se sa që ishte vërtetuar me aktgjykimin e mëparshëm.

Duke pas parasysh se i pandehuri D.D. është shpallur fajtor për vepër penale të blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale fshehjes , të parashikuar nga neni 345.par.3 . të KPK-ës, të cilat i pandehuri D.G. i ka përfituar me vepër penale , si dhe fakti se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore _____ PDP.nr. ____ është vërtetuar se vlera e këtyre sendeve për afërsisht 7000€, më pak se sa që ishte vërtetuar me aktgjykimin e mëhershëm PDP.nr.____ , ndërsa duke pas parasysh se vepra penale e nga neni 345 është e natyrës aksesore, çka nënkupton se i pandehuri D.D. nuk ka mund të fsheh sende të cilat i pandehuri D.G. nuk i ka përfituar me vepër penale , nga këto arsye kolegji i kësaj gjykate gjen se vërtetimi i një vlere më të ulët të sendeve të përfituar me vepër penale, paraqet rrethanë të re ,për të cilën Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk kanë mund ta kenë parasysh, me rastin e vendosjes për veprën dhe dënimin e të pandehurit D.D.

Nga arsyet e parashtruara, qartë rezulton se janë paraqitur prova të reja , të cilat së bashku me provat tjera konform nenit 423.par.1.nënp.1.3.të KPPK-ës, mund të sjellin deri te aplikimi i ligjit më të butë për të pandehurin, se ai që ishte aplikuar me aktgjykimin e plotfuqishëm .

Nga të shtuarit më lart në bazë të nenit 427.par.1.të KPPK-ës.u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore _____

PDP..nr. _____,datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit,

në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit.

Sqarim :

1.Kur gjykata nuk e hudh kërkesën(neni 426.par.1), kopja e kërkesës i dërgohet prokurorit të shtetit ose palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që brenda tetë (8) ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi gjykata të merr përgjigje në kërkesë ose kur kalon afati për paraqitjen e përgjigjes, kryetari i kolegjit shqyrtues urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje, pas ndërmarrjes së veprimeve procedurale për verifikimin e pretendimeve nga kërkesa , kolegji mund ta refuzoj apo aprovoj kërkesën

2.Me rastin e vendosjes së kërkesës për rishikim, në kolegji nuk merr pjesë gjyqtari i cili ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit në procedurën e mëparshme.

Formulari 100

DISPOZITIVET E NDRYSHME TË AKTGJYKIMIT NË PROCEDURËN E RISHIKIMIT TË DREJTË

(Përsëritur neni 428 par.3.të KPPK-ës)

I.

A K TGJYKIM

(dispozitivi)

I akuzuari NN.nga babi N. Dhe e ëma S, e lindur Q, i lindur më _____ në _____, ku edhe tani jeton ,shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i pesë fëmijve, me profesion shofer në ndërmartjen transportuese “Përparimi “ me seli në _____,gjer më tani i pagjykuar,

Në bazë të nenit 364 par.1.nënp.1.3 të KPPK-ës;

LIROHET NGA AKUZA

Se më 13.7.2013, rreth orë 18,00, duke lëvizur në drejtim të rrugës regjionale _____, ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Mbi Sigurinë e Trafikun Rrugorë , ashtu që duke mos e përshtatur shpejtësinë e mjetit kushteve në rrugë , me të arritur në fshatin _____ , në

momentin kur nga drejtim i kundërt, vinte në ballafaqim traktori i markës “Rakovica” i paregjistruar, të cilin e ngiste S.T. nga pjesa e pasme e rimorkios me biçikletë del tani i ndjeri N.B. me qëllim që të kaloj në arën e tij që ishte përball rrugës së asfaltuar, I akuzuari përkundër frenimit të vrullshëm nuk ka arritur që të shmang kontaktin me çiklistin e ka goditur atë dhe e ka hedhur 15 m larg vend goditjes, me ç’rast i dëmtuari është dërguar si rast urgjent në qendrën spitalore në Vrajë ku po atë ditë ka ndërruar jetë

Me çka kishte për të kryer vepër penale rrezikimi i sigurisë së trafikut publik , të parashikuar nga neni 328.par.9 lidhur me par.1.të KPK-ës

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Aktgjykimi i gjykatës _____, PDP.nr. _____ datë _____, me të cilën i akuzuari është shpall fajtorë , për veprën penale rrezikimi i trafikut publik , të parashikuar nga neni 378.par.9. lidhur me par.1. të KPK-ës, **lehet jashtë fuqisë.**

II.

A K T G J Y K I M

I akuzuari NN.nga babi N. Dhe e ëma M, e lindur F, i lindur më _____ në _____, ku edhe tani jeton ,shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar baba i dy fëmijve, me profesion kontabilist, i papunë ,gjer më tani i pagjykuar;

ËSHTË FAJTOR

Sepse gjatë vitit _____, duke u prezantua rrejshëm si person komptent dhe kyç në fushën e punësimit në Kompaninë “Mebatex” i ka vënë në lajthim të dëmturit N.N. nga _____, NN.nga _____ , N.N.nga _____ N.N.nga _____ dhe NN.nga _____ duke ju premtuar punë në botën e jashtme në këtë kompani, dhe pas nga secili nga këta ka marrë nga 500€ është zhdukur pa gjurmë ,ndërkohë me letërshtim ndërkombëtar është arrestuar në Itali dhe i është dorëzura organeve të ndjekjes të RK-ës.

Me çka ka kryer vepër penale të mashtrimit nga neni 335.par.1 të KPK, andaj gjykata për këtë vepër penale e ,

G J Y K O N

Me dy(2) vjet burgim, në të cilën do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej _____ deri më _____ dhe koha e kaluar në mbajtje të dënimit prej _____ deri _____

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në _____ PDP.nr.____ datë_____ me të cilën i akuzuari është shpallë fajtor për veprë penale nga neni 335.par.2 lidhur me par.1.të KPK-ës, pjesërisht lehet jashtë fuqisë, në pjesën që ka të bëjë me veprën penale të mashtrimit nga neni 335.par.2 . të KPK-s, ku i akuzuari është shpallë fajtorë se të dëmtarëve u ka shkaktuar dëm në vlerë prej 12000 €

III.

Gjykata Themelore në _____,Departamenti i Përgjithshëm , me gjyqtarin e vetëm N.N, me bashkëpunëtoren profesionale N.N procesmbajtëse, në çështjen penale e të akuzuarit N.S, nga _____, për shkak të veprës penale, rrezikimi i sigurisë së trafikut publik, të parashikuar nga neni 328.par.9 lidhur me par.1.të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ PP.nr.____/ ____datë _____ , pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik gojor, më _____ , në prezencën e prokurorit _____ N.. të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.N, të dëmtuarit N. , ka marr dhe të njëjtën dit ka shpallur këtë,

A K T G J Y K I M

Lehet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Themelore në _____ PDP.nr.____/____datë_____ me të cilën i pandehuri NN.nga _____, me aktgjykimin e plotfuqishëm është gjykuar me dy (2) vjet burgim , për shkak të veprës penale të rrezikimi i sigurisë së trafikut publik, të parashikuar nga neni 328.par.9 lidhur me par.1.të KPK.

Sqarim :

Me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata anulon aktgjykimin e mëparshëm apo vetëm një pjesë të tij, ose e lë në fuqi aktgjykimin e mëparshëm. Në dënim të shqiptuar me aktgjykim të ri, gjykata i llogarit të akuzuarit dënimin e mbajtur, e kur lejohet rishikimi vetëm për ndonjë vepër për të cilën i akuzuari ka qenë i dënuar ose i liruar, gjykata shqipton dënim të ri unik sipas dispozitave të Kodit Penal.

Nëse në aktgjykimin e ri nuk vendoset për aktgjykimin e mëhershëm , atëherë faktikisht në fuqi mbesin dy aktgjykime.

Formulari 101

KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT

(Neni 429.të KPPK-s)

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

PËR

GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

P R I S H T I N Ë

Bazuar në dispozitat e nenit 429.të KPPK-ës, parashtroj këtë:

KËRKESË PËR ZBUTJEN E JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____ PDP.nr.3/_____ të dt. _____ është shpallur fajtor NN.nga fsh. _____ komuna e _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i sigurisë së trafikut publik, të parashikuar nga neni 328.par.9 lidhur me par.1.të KPK, dhe për këtë vepër iu është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një /1/ viti, në të cilin ka për të iu llogarit edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt. _____ deri më _____.

Me rastin e shqiptimit të dënimit të këtillë, gjykata e lartë theksuar i ka marrë në konsideratë rrethanat lehtësuese të cilat i shkojnë në favor të dënuarit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës të shkallës të parë, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë mbrojtësi i të pandehurit NN.

Gjykata e Apelit, me aktgjykimin e vetë APDP.nr. ____/____ të dt. ____, e ka refuzuar ankesën e mbrojtësit, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar.

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit janë parritur rrethana të reja të cilat nuk kanë ekzistuar kur të pandehurit i është shqiptuar dënimi, dhe po ekzistonin do kushtëzonin një dënim më të butë për të pandehurin .

Rrethana e tilla janë si në vijim:

Gjendja shëndetësore e të pandehurit NN. me kalimin e kohës vazhdimisht po keqësohet. Një gjendje të këtillë po i kontribuojnë dy faktorë. Pas aksidentit të komunikacionit ku humbi jetën tragjikisht e ndjera NN, nërsa lëndime trupore psoi z. NN, i pandehuri vazhdimisht ndien një tronditje të thellë shpirtërore e përcjellë me pagjumësi, kok dhembje e humbje e vullnetit për jetë. Ketë gjendje ia ka rënduar edhe marrja e plagëve me armë të zjarrtë vajza e mitur NN. deri sa ishte në lokalet e shkollës pranë qendrës shkollore – Gjumnazi “ _____”, në _____.

Provë: *Fletë lëshimi nga Spitali Rajonal _____*

Vajza e mitur tani bashkëjeton me stresin. Babai – i dënuari NN. vazhdimisht nga venbanimi NN. e dërgon në shkollë dhe e merr nga shkolla , sepse nuk ka kush tjetër. Këte NN. e bën që domosdo vajza e tij të përfundoj në shkollim, e mos të mbetet si ai punëtorë krahu.

Po ashtu vlen të theksohet se i dënuari NN. jeton në bashkësi familjare me babain dhe nënën të moshuar, bashkëshorten dhe katër (4) fëmij të mitur, të cilët janë në shkollim e sipër. I dënuari NN. është ai i cili me punën e vetë e bën sigurimin e ekzistencës materiale të familjes së vetë dhe e mundëson shkollimin e fëmijëve të vetë.

Provë: *Raporti për gjendjen shëndetësore për të dënuarin, Certifikata e bashkësisë familjare,*

Vërtetimet se fëmijët e të dënuarit janë në shkollim të rregullt.

Nisur nga gjendja e përshkruar si më lartë e të pandehurit, konsideroj se vuajtja e dënimit me burg sigurisht se do të prodhonte efekte negative në aspektin e gjendjes së tij shëndetësore, por para se gjithash në shkollimin e rregullt të fëmijve të tij.

Nga të theksuarat më lartë;

P R O P O Z O J

Që gjykata Supreme e Kosovës, konform dispozitave të nenit 429 të KPPK-ës, lidhur me nenin 75 dhe 76 të KPK-s , ta NDRYSHOJ aktgjykimin e theksuar më lartë përkitazi me dënimin, dhe të pandehurit t'i shqiptoj një dënim me të butë , ngase bazuar ne personalitetin e tij edhe me një dënim më të butë , do të arrihet qëllimi i dënimit në aspektin e prevencionit individual.

Mbrojtësi i të dënuarit:

Formulari 102

AKTVENDIM ME TË CILIN APROVOHET KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT

(Neni 431 par.6 të KPPK-së)

Pzd.nr.164/2016

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: NN., kryetare e kolegjit, NN. dhe NN. anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale NN, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarve NN. për shkak të veprës penale rrezikimi i sigurisë në punë nga neni 186 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 2 të KPK-ës, dhe NN. për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm , nga neni 291 par. 6 lidhur me par. 4 e 1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit NN.av.NN. nga _____, për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore _____, PKR.nr.179/2013 datë 22.05.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.12.2016, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pranohet kërkesa e mbrojtësit të të dënuarit NN. për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, ndryshohet aktgjykimin e formës së prerë i Gjykatës Themelore _____, PKR.nr.179/2013 datë 22.05.2014, vetëm përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, i cili i është shqiptuar për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par. 6 lidhur me par. 4 e par. 1 të KPK, i zbutet në mënyrë të jashtëzakonshme në dënim me 1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim.

Në pjesën tjetër aktgjykimin e formës së prerë i Gjykatës Themelore _____, PKR.nr.179/2013 datë 22.05.2014, ngelë i paprekur.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore _____, Pkr.nr.179/2013 datë 22.05.2014, i akuzuari NN. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikim i sigurisë në punë nga

neni 186 par. 5 lidhur me par. 3 dhe 2 të KPK-ës, dhe për këtë veprë është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse i akuzuari NN., për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 291 par. 6 lidhur me par. 4 e 1 të KPK-ës, është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve. Janë detyruar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë secili veç e veç shumën prej nga 200 €. Pala e dëmtuar NN., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.496/2014 datë 19.12.2014, e ka refuzuar ankesën e Prokurorit të Shtetit ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesë për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit NN. Av.NN. nga _____, duke propozuar që kërkesa të aprovohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 431 par.1 të KPPK, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pasi që vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe propozimet e Prokurorisë Themelore në _____, RLN.nr.39/2016 të datës 28.10.2016, e cila ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar, propozimin e Gjykatës Themelore në _____, PK.nr.177/2016 të datës 31.10.2016, e cila ka propozua që kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit të aprovohet si e bazuar dhe të Prokurorisë së Shtetit me numër KZJD.nr.165/16 të datës 08.11.2016, e cila ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar, gjeti se:

-kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit është e bazuar.

Gjykata Supreme, me rastin e vendosjes përkritazi me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, vlerëson nëse rrethanat e reja që theksohen në kërkesë do të çonin qartazi në caktimin e një dënimi më të butë, sikur të kishin ekzistuar dhe sikur të ishin vlerësuar me rastin e shqiptimit të dënimit në procedurën e rregullt, gjithnjë duke pas parasysh veprën e kryer penale. Me fjalë tjera, kjo Gjykatë pas paraqitjes së këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik, sipas dispozitës 429 të KPPK-së, vlerëson nëse vendimi për dënimin është i drejtë, duke pas parasysh rrethanat e reja të paraqitura në kërkesë.

Në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit theksohen rrethana të reja, të cilat nuk kanë qenë të njohura për gjykatën, të cilat rrethana janë keqësimi i gjendjes shëndetësore, problemet me sy dhe veshë, të cilat tregojnë se sistemin e të dëgjuarit e ka 100% të dëmtuar, se i dënuari kishte pësuar aksident të komunikacionit, me simptome të dëmtimit të boshtit kurrizor, hospitalizomi i të dënuarit në QKUK Prishtinë, në Spitalin e Kardiologjisë, hospitalizomi në Spitalin e Përgjithshëm të qytetit të Mitrovicës, hospitalizomi i të dënuarit në Spitalin e Burgut të Dubravës, hospitalizimi në QKUK Prishtinë Spitali i Kardiologjisë. Nga dokumentacioni mjekësor shihet se gjatë mjekimit kardiologjik janë konstatuar edhe sëmundje tjera të cilat edhe më tepër e vështirësojnë gjendjen shëndetësore të të dënuarit, si problemet me tretjen, me traktin e zorrëve, konstatimi i funksionimit të ultë-dobësimi të zemrës, kapaciteti i punës së cilës ka rënë në vetëm 25%. Për këtë shkak (funksionimit të dobët të zemrës) nuk kanë mundur të bëhen

analizat imazherike të gastroskopisë, inçizimi i lukthit dhe kolonoskopia-inçizimi i thellë i zorrëve. Kërkesës i ka ofruar një mori dokumentesh mjekësore të lëshuara nga institucione të ndryshme mjekësore.

Duke vlerësuar këto rrethana të reja, Gjykata Supreme konsideron se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ndaj tani të dënuarit NN., në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse i ka vlerësuar të gjitha rrethanat që parashihen me dispozitat e KPPK-ës, duke marrë si lehtësuese se është person familjar, më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale, faktin se vepra është kryer nga pakujdesia kurse si rrethana rënduese faktin se dukuria e mos përfilljes së obligimeve për sigurimin e kushteve për punëtorët në punë shkakton pasojë të objekti mbrojtës-shëndetin dhe jetën e punëtorëve dhe si rezultat i kësaj ka ardhur deri te vdekja e tani të ndjerit NNi cili ishte i moshës relativisht të re.

Mirëpo, kjo Gjykatë konsideron se rrethanat e përmendura në kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, përkitazi me gjendjen shëndetësore respektivisht sëmundjet e të dënuarit, të cilat argumentohen me dokumentacion voluminoz përkatës: fletëlëshimi i QKUK-Prishtinë Shërbimi i Kardiologjisë nga data 20.04.2016-27.04.2016, fletëlëshimi i Spitalit të Përgjithshëm “Dr.Sami Haxhibeqiri” Mitrovicë, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës, Reparti i Internos, nga data 26.05.2016-30.05.2016, fletëlëshimi i QKUK-Prishtinë Shërbimi i Kardiologjisë me nr.protokoli 3767 nga data 08.07.2016-22.07.2016, me diagnozë përfundimtare Cardiomyopathia chr dilatativa 142, Fibillatio artiorum chr. 148.2, Insuff. cordis NYHA I-II 150, Diabetes mellitus typ. 2 E11, Gastroduodentis chr K29, me përfundim se indikohet implantimi i ICD-së (momentalisht nuk ka elektroda-është në listën e pritjes), po ashtu ka indikacion për transplantim të zembrës, janë rrethana plotësisht të reja dhe se nuk kanë qenë të njohura për Gjykatën në kohën e marrjes së aktgjykimit të formës së prerë.

Prandaj, Gjykata Supreme, gjithnjë duke u bazuar në raportet mjekësore, vlerëson se këto rrethana janë të asaj peshe dhe rëndësie që, sikur të kishin qenë të njohura në kohën e shqiptimit të dënimit pa dyshim do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të butë.

Nga sa u tha më lartë dhe në bazë të nenit 431 par.6 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Pzd.nr.164/2016, më 20.12.2016

Procesmbajtësi,

Kryetarja e kolegjit

Formulari 103

AKTVENDIM ME TË CILIN REFUZOHET KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT

(Neni 431 të KPPK-së)

Pzd.nr.143/2016

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: NN. kryetare e kolegjit, NN. dhe NN. anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional NN., procesmbajtës, në çështjen e të dënuarit NN. nga _____, për shkak të veprës penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365 par.3 lidhur me par.1. dhe mbajtja në pronësi kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën e të dënuarit NN., në seancën e kolegjit mbajtur më 31.10.2016, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të dënuarit NN., për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, të shqiptuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____ Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.140/2016 dt. 05.04.2016, ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.245/2016 dt. 16.06.2016

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____ - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.140/2016 dt. 05.04.2016, i dënuar NN. është shpallur fajtor për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, nga neni 365 par.3 lidhur me par.1 dhe mbajtja në pronësi kontroll dhe posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim unik në kohëzgjatje prej 2(dy) vite, dënim i cili nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 3(tri) viteve i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale, e cila në rast revokimit të dënimit me kusht, do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.02.2016 deri me datën 15.03.2016.

Të dënuarit i është konfiskuar revolva me numër serik 7404 me një karikator dhe një fishek, mjet këto që janë kryer me veprat penale, dhe e njëjta të shndërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Gjithashtu është detyruar i dënuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës në fjalë, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor t'i paguaj në shumën prej 100 (njëqind) €, brenda afati prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi .

Të dëmtuarit NN, NN,NN dhe NN. për realizimin e kërkesë pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.245/2016 datë 16.06.2016, duke vendosur në procedurë të ankimimit, ka pranuar si të bazuara ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore- DKR në _____, PKR. nr 140/2016 datë 05.04.2016, duke e ndryshuar aktgjykimin në fjalë vetëm sa i përket vendimit mbi dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarit NN., për veprën penale shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga nenin 365 par. Nën. 3. lidhur me par 1 të KPRK-së, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.02.2016 deri me datën 15.03.2016. Ndërsa për veprën penale mbajtjeje në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga nenin 374 par. 1 të KPRK-së, ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) €, të cilin dënim është obliguar që t'a paguaj në afat 3 (tre) muaj në këste të barabarta. Nëse i dënuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 € t'i llogariten me një ditë burgim.

Kërkesë për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur i dënuari NN. me pretendime se është fëmijë më i madh në familje, jeton me nënën e sëmur , vëllaun të moshës 17 vjeçar dhe motrën e moshës 14 vjeçare se është i vetmi anëtar i familjes i cili punon herë pas herë punë private, dhe se është përdorur për veprën penale të cilën e ka kryer duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepër të njëjta apo të ngjashme, duke i prezantuar Gjykatës disa raporte mjekësore nga Klinika Kirurgjike Aloka, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, kërkesën në fjalë ta miratojë si të bazuar dhe aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj, ashtu që të dënuarit, NN. t'i shqiptojë dënim dukshëm më të ulët.

Gjykata Supreme në bazë të neni 429 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), i shqyrtoi shkresat e lëndës, dhe pasi që vlerësoi kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, propozimin e Gjykatës Themelore në _____ Departamenti i për Krime të Rënda Kp.nr.760/16 dt. 09.09.2016, Prokurorisë Themelore në _____ në PP.nr.97/2016 datë 31.08.2016 dhe Prokurorisë së Shtetit KZDJ.nr.144/16 datë 29.09.2016, të cilat kanë propozuar që kërkesa të refuzohet si e pa bazuar, gjeti se:

Kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nuk është e bazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPPK-së, parashihet që zbutja e dënimit të shqiptuar me aktgjykim të formës së prerë lejohet kur paraqiten rrethanat që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të ulët.

Gjykata Supreme në e Kosovës në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikojnë në një dënim më të butë.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, si gjykata e shkallës së parë gjithashtu edhe ajo e shkallës së dytë me rastin e shqiptimit të dënimit si rrethana lehtësuese kanë marrë parasysh faktin se i dënuari e ka pranuar fajësinë, sjelljen shumë korrekt në gjykatë, se është i pa gjykuar më parë, pendimin e thellë pas kryerjes së veprës penale dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë më kurrë veprime të kundërligjshme. Atëherë pretendimet se i dënuari është fëmiu më i madh në familje, jeton me nënën e sëmur, vëllain të moshës 17 vjeçar dhe motrën e moshës 14 vjeçare se është i vetmi anëtar i familjes i cili punon herë pas herë punë private, Gjykata mund t'i vlerësohen si rrethana të reja të cilat nuk janë vlerësuar nga gjykatat me vendim të plotëfuqishëm, megjithatë këto rrethana nuk janë të asaj natyre të cilat në kuptim të dispozitës së lartë përmendur ligjore e justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, duke pasur parasysh peshën e veprave penale, e në veçanti shkallën e përgjegjesisë penale e të dënuarit me rastin e kryerjes së veprës penale.

Meqë, i dënuari nuk ka paraqitur rrethana tjera të cilat kishin me ndikuar në zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit, kjo Gjykatë gjen se në rastin konkret nuk ka kushte ligjore për aprovimin e kërkesës.

Nga arsyet e dhëna, u konstatua se kërkesat për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit nuk janë të bazuara dhe si të tilla në bazë të dispozitës së nenit 431 par. 6 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pzd.nr.143/2016 datë 31.10.2016

Procesmbajtës,

Kryetare e kolegjit,

Sqarim: 1.Gjykata themelore ia dërgon kërkesën prokurorit të shtetit, i cili duhet të jap përgjigje të arsyetuar, Gjykata themelore vërteton se a ekzistojnë shkaqe për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, e pastaj shkresat me propozimin e arsyetuar ia dërgon Gjykatës Supreme të Kosovës.

2. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues të gjykatës themelore e hudh kërkesën që nuk është në pajtim me nenin 376 të këtij Kodi.

Formulari 104

AKTVENDIM PËR REVOKIMIN E AKTVENDIMIT ME TË CILIN ËSHTË APROVUAR KËRKESA PËR ZBUTJE TË JASHTËZAKONSHME TË DËNIMIT

KP.nr. ____/____

Gjykata Supreme e Kosovës me kolegjin gjyqësor në përbërje prej NN. kryetar, NN. dhe NN. anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale D.R. procesmbajtëse, në çështjen penale e të pandehurit M.M. për shkak të veprës penale të vjedhjes të parashikuar nga neni 325 par. 1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorit Shtetëror të zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit Pp.nr. 100/____ datë____, që të revokohet aktvendimi i mëhershëm Pzd.nr.200/2006 datë 30.9.2006, në seancën e kolegjit të mbajtur më 15.7.2008, muarr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet kërkesa e Prokurorit Shtetëror të zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe revokohet aktvendimi i kësaj Gjykate, Pzd.n.r 200/____ datë 30.4.____, me të cilin të pandehurit M.M., i është zbutur dënimi në mënyrë të jashtëzakonshme i cili është shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në____, PDP.nr. 250/____ datë 15.4.____.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, PDP.nr. 250/ _____ datë 15.4._____, i pandehuri M.M. është dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh, për shkak të veprës penale të vjedhjes parashikuar me nenin 3256 par. 1 të KPK-së.

Me aktvendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pzd.nr. 200/ _____ datë 30.9._____. është aprovuar kërkesa e të dënuarit M.M. dhe aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Themelore në _____, PDP.nr.250/ _____ datë 15.4._____, është ndryshuar përkritazi me vendimin për dënimin, ashtu që të dënuarit i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Aktvendimi është i mbështetur në certifikatën mjekësore i lëshuar nga mjeku specialist B.J. nga data 01.02._____, në të cilin është theksuar se i dënuari para se të fillojë mbajtjen e dënimit ka pësuar një fatkeqësi në punë në të cilën ka dëmtuar rëndë boshtin kurrizor, me pasojë paaftësi të përhershme të punës.

Nga aktgjykimi i Gjykatës Themelore në _____, PDP.nr.1120/ _____ nga data 5.12._____, është vërtetuar se i pandehuri B.J. nga _____, me aktgjykim të formës së prerë është gjykuar, për shkak të veprës penale falsifikimi i dokumentit zyrtar, të parashikuar nga neni 435.par.1 , të KPK-së, për arsye se si mjek i institucionit shëndetësor në të cilin ka punuar në dokumentin zyrtar-certifikatën mjekësore të datës 01.08._____, të cilën ia ka dhënë pacientit M.M.tani të gjykuarit , ka shënuar të dhëna të pavërteta për lëndimin e rëndë të boshtit kurrizor.

Meqenëse nga aktgjykimi i plotfuqishëm i theksuar më lartë rezulton se aktvendimi i kësaj Gjykate, me të cilin është aprovuar kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, është i bazuar në dokument të rrejshëm, janë përmbushur të gjitha kushtet , që ky aktvendim të revokohet, për ç'arsye kërkesa e Prokurorit Shtetëror është aprovuar.

Procesmbajtësja,

Kryetari i kolegjit,

Sqarim: Edhe pse KPPK-ës, i viti 2004 edhe ky në aplikim, nuk e parashohin një situatë të tillë, zbutja e dënimit që është bërë me veprime abuzive , duhet patjetër të revokohet(*dispozitën për revokimin e aktvendimeve të tilla e përmbante LPP-e që ishte në aplikim deri në vitin 2004*).

Formulari 105

KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË
(Neni 432. të KPK-së)

GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

P R I S H T I N Ë

Në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N. i cili me aktgjykimin e formës së prerë është gjykuar për shkak të veprës penale plaçkitja e mjeteve motorike, të parashikuar nga neni 346. par 1. të KPK-ës, në bazë të nenit 432. të KPPK-ës, paraqes;

KËRKESË PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

Kudër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit me aktvendimin PDP.nr.____/____ datë _____,

-për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.2.nënp.2,1.lidhur me nenin 434.par.2.nënp.2.3. të KPPK-ës.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës _____ PDP..nr.____ datë _____, është gjykuar i pandehuri N.N. për shkak të veprës penale plaçkitja e mjeteve motorike, të parashikuar nga neni 346. Par 1. të KPK-ës, dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, ekzekutimi i të cilit është shtyrë për 2 (dy) vjet.

Të pandehurit aktgjykimi i është dorëzuar më 10.02.2015, ndërsa mbrojtësit të tij i është dorëzuar më 12.01.2015.Mbrojtësi i të pandehurit ankesën kundër aktgjykimit e ka paraqitur më 20.02.2015 .

Gjykata e Apelit duke vepruar sipas ankesës së Prokurorit të Shtetit, me aktvendimin PDP.nr.____/____ e ka hedhur ankesën si të pas afatshme , me arsyetim se nga momenti i

dorëzimit të aktgjykimit mbrojtësit të pandehurit ,12.01.2015 e deri në dorëzimin e ankesës në gjykatë, më 20.02.2015, kanë kaluar më tepër se një muaj ditë, ndërsa afati i ankesës ndaj aktgjykimit është 15 ditë.

Me veprime të tilla Gjykata e Apelit në _____, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale , të parashikuara nga neni 384.par.2.nënp.2,1.lidhur me nenin 434.par.2.nënp.2.3. të KPPK-ës, nga se sipas neni 478.par.4.i KPPK-ës, afati i ankesës rrjedhe nga momenti i dorëzimit të vendimit gjyqësor të pandehurit , e jo nga momenti i dorëzimit të aktgjykimit mbrojtësit të pandehurit, siç gabimisht ka vlerësuar Gjykata e Apelit.

Në të shtruarat më lart:

Propozoj

Që Gjykata Supreme e Kosovës, për arsye të përshkruara më sipër, e në bazë të neni 432.par.1.nënp. 1.2.të KPPK-ës, të anuloj aktvendimin e Gjykatës së Apelit , PDP.nr. _____ datë _____, dhe çështjen ta kthejë të njëjtës gjykatë, për të vendosur lidhur me ankesën .

Mbrojtësi i të pandehurit ,

Formulari 106

ZYRA E KRYEPROKURORIT TË SHETIT

PPML.NR. _____ / _____

Datë _____

P R I S H T I N Ë

KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË
(Neni 432. të KPK-së)

GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

PRISHTINË

Në çështjen penale ndaj të pandehurit N.N. i cili me aktgjykimin e formës së prerë është liruar nga akuza, për shkak të veprës penale plaçkitja e mjeteve motorike, të parashikuar nga neni 346. par 1. të KPK-ës, në bazë të nenit 432. të KPPK-ës, paraqes;

KËRKESË PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

Kudër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në _____ PDP.nr.____/____ datë _____ dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PADP.nr.____/_____

-për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.2.nënp.2,1. lidhur me nenin 361 të KPPK-ës.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore _____ PDP..nr.____ datë _____, i pandehuri N.N., nga _____ është liruar nga akuza, se me datën _____ duke e vërejtur se i dëmtuari NN. e kishte lënë të hapur veturën e ti të markës BMW X6. me targa të regjistrimit _____ është futur në makinë dhe pasi çelësi ishte në fole , e ka vënë në lëvizje atë dhe është nisur për të bërë gjiro nga shkolla, mirëpo ndërkohë është takuar nga i dëmtuari dhe i është marr vetura , me këtë do të kryente veprën penale plaçkitja e mjeteve motorike, të parashikuar nga neni 346. par 1. të KPK-ës.

Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur ma ankesën e prokurorit të prokurorisë themelore në _____, me aktgjykimin PADP.nr____/____,datë_____, ka refuzuar ankesën dhe ka vërtetuar aktgjykimin e ankimuar , duke vlerësuar se ankesa e prokurorit e paraqitur për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale është e pabazuar.

Të dy aktgjykimet janë t paligjshme për arsyet si në vijim :

Dispozitat e nenit 361 par.1.të KPPK-ës, është parashikuar që gjykata aktgjykimin e vet e bazon vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar sipas dispozitës së cituar më sipër , ngase aktgjykimin e vet e ka bazuar në dëshminë e të dëmtuarit NN. edhe pse dëmtuari nuk është dëgjuar në shqyrtim gjyqësor dhe as që është lexuar dëshmia e tij e dhënë në procedurën paraprake. Arsyet e aktgjykimit në relacion me faktet vendimtare, bazohen në provat e pa proceduara në shqyrtim, në dëshminë e të dëmtuarit dhënë në procedurën paraprake (*e pa proceduar në shqyrtim gjyqësor*), të cilën gjykata realisht nuk i pranon si të besueshme se i akuzuari pa leje i kishte marr veturën ditën kritike.

Në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të karakterit relativ, të parashikuar nga *neni 384.par.2.nënp.2,1. lidhur me nenin 361 të KPPK-ës*, që kanë qenë, përkatësisht kanë mund të jenë me ndikim në drejtshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit , për shkak se përfundimet e veta për mosekzistimin e provave se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar , i ka mbështetur në dëshminë e të dëmtuarit , dëshminë e të cilit e ka vlerësuar si jo të besueshme edhe pse dëshmia e tij nuk ishte e proceduar në shqyrtimin gjyqësor , ndërsa Gjykata e Apelit aktgjykimin e tillë e ka vërtetuar .

Meqenëse kërkesa është ngritur në dëm të pandehurit NN,

P r o p o z o j

Që Gjykata Supreme, konform nenit 438.par.2.të KPPK-ës, të konstatoj se me aktgjykimet e atakuara me kërkesë , është shkelur ligji në favor të pandehurit.

Prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit

Sqarim: Në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë , parashtruesi nuk duhet vetëm formalisht ti referohet shkeljeve ligjore , por duhet të jap arsye të qarta se në çka i mbështet pretendimet e t'ia për ekzistimin e shkeljeve procedurale apo ligjore , në të kundërtën mund të konsiderohet se kërkesa nuk përmban arsye për pretendimet e ngritura (*edhe pse kërkesa formalisht përmban arsye , por bën fjalë për çështje krejt tjera e jo për bazat nga kërkesa*), ndërsa Gjykata Supreme kufizohet vetëm pretendimet nga kërkesa, dhe nuk shqyrton shkeljet sipas detyrës zyrtare , me përjashtim kur me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara në vendimin kundër të cilit është paraqitur kërkesë, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim me të cilin vendos mbi kërkesën

për mbrojtjen e ligjshmërisë anulon vendimin dhe urdhëron mbajtjen e shqyrtimit të ri gjyqësor në gjykatën e njëjtë ose në gjykatën tjetër themelore.

Formulari 107

NJË FORMË E VENDIMIT GJYQËSOR TË GJYKATËS SUPREME , ME TË CILIN ËSHTË APROVUAR KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË, ËSHTË NDRYSHUAR AKTGJYKIMI I SHKALLËS SË PARË DHE TË DYTË DHE I PANDEHURI ËSHTË LIRUAR NGA AKUZA

Pml.nr.131/2014

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – koleji i përbërë nga gjyqtarët: A. D, kryetar, E. M. dhe N. L., anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale M. Xh., procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit K. K., për veprën penale vrasje në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit K.K, av. F.V., nga Prishtina, të paraqitur kundër aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 149/2013 datë 13.2.2014 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr. 253/2014 datë 10.6.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9 shtator 2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit K. K, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.149/2013 datë 13.2.2014, i vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.253/2014 datë 10.6.2014, ashtu që ky i akuzuar, me aplikimin e dispozitës së nenit 438 pika 1.1 të KPPK,

LIROHET NGA AKUZA

I.Sepse më datën 1.6.2007, rreth orës 11:30, Prishtinë në rrugën _____prapa hotelit “Baci” afër ndërtesës D-2 , së bashku me L.K., me dashje e kanë privuar nga jeta tani të ndjerin N.N., në atë mënyrë që i akuzuari K. K., pasi ishte paralajmëruar nga shoku i tij B. M. se atë ditë do sulmohej nga F.XH. , pas daljes nga provimi klasor në SHM të Mjekësisë në Prishtinë “Ali Sokoli”, nga telefoni i B.M ka thirr tani të akuzuarin L. K. me qëllim që t’i dal në ndihmë, duke i thënë se i nevojitet mbrojtja e tij, me këto fjalë “eja, o sot o kurrë”. I akuzuari L. K., përafërsisht pas 10 minutave, ka mbërrirë në vendin e caktuar, sipas marrëveshjes me të akuzuarin K, dhe pasi që janë takuar duke ecur së bashku rrugës “Fahmi Lladrovci”, prapa hotel “Bacit”, në Prishtinë, i akuzuari K. ka parë F. Xh., i cili kishte një thikë në dorë dhe tani të ndjerin N me një shkop të gjatë përafërsisht 50-100 cm, duke ecur në të njëjtin drejtim, me ç’rast kanë këmbyer disa sharje me ta. I akuzuari K. kur ka vërejtur se ata janë duke u afruar, ka kërkuar nga i akuzuari L., të cilën ai po mbante në çantë. I akuzuari L. nuk ia ka dhënë revolen, por ai në të njëjtën kohë e ka nxjerrë nga çanta e tij revolen, e ka repertuar dhe ka shtënë – një herë në tokë, ndërsa të akuzuarin K e kap për dore e hedhë prapa vetit, e më pas ka shtënë për së dyti herë në drejtim të të ndjerit dhe M. Xh., me ç’rast predha e ka goditë tani të ndjerin në anën e sipërme të majtë, në zonën e mbi nyjës së dorës së majtë dhe i njëjti ka vazhduar në anën e majtë të përparme të kafazit të kraharorit, dhe si pasojë e kësaj goditje është shkaktuar vdekja e menjëhershme e tij. Të akuzuarit K.K dhe L. K., largohen nga vendi i ngjarjes dhe strehon në një shtëpi të pabanuar afër SHF Hasan Prishtina”, me ç’rast i akuzuari L. e heq karikatorin nga revolja, në të cilën i kishte 13 fishekë të të njëjtit kalibër, ndërsa revolen e merr i akuzuari K, i fshijnë gjurmët e të akuzuarit L., i vendos gjurmët e gishtërinjve të tij dhe më pas largohen në drejtime të kundërta,

-me çka në bashkëkryerje do të kryente veprën penale vrasje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK-ës.

I dëmtuari P. N., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bie në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

II.Për shkak të vendimit nga pika I. e dispozitivit të aktgjykimit , ndryshohet aktgjykimi edhe në raport me të dënuarin L. K, ashtu që nga cilësimi juridik hiqet bashkëkryerja , në pjesën tjetër përkitazi me këtë të dënuar dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK, përkitazi me të dënuarin V. K, aktgjykimi i kundërshtuar ngel i paprekur.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.149/2013 datë 13 shkurt 2014, të akuzuarit L.K. dhe K. K. janë shpallur fajtor për veprën penale vrasje në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK dhe secili prej tyre për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK , dhe janë gjykuar; L. K. për veprën penale vrasje në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK, i cakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vitesh, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 1.6.2007 e tutje, kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK, dënimin me gjobë në shumë prej 1.000 €, të cilin është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit; kurse të dënuarin K. K. për veprën penale vrasje në bashkëkryerje nga neni 146 lidhur me nenin 23 të KPK, me dënimin burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vitesh, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej 1.6.2007 gjer më 16.9.2013; kurse për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve të parashikuara nga neni 328 par. 2 të KPK, me dënimin me gjobë në shumë prej 1.000 € , të cilin është i detyruar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarin P. N. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike e ka udhëzuar në kontest civil. I ka detyruar të dënuarit që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës në mënyrë solidarë dhe secili prej tyre shumë prej nga 500 €, në emër të paushallit gjyqësor në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Ndaj të akuzuarit L. K. është shqiptuar dënimi plotësues marrja e revoles e markës “Crvena Zastava 99”, e kal. 9 mm, me nr.serik 120738, e prodhimit jugosllav, me një karikator të zbrazët, si mjet me të cilin është kryer vepra penale.

Ky aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr. 253/2014 datë 10.6.2014.

Kush ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe cilat janë pretendimet nga kërkesa

Kundër aktgjykimit të shkallës së parë dhe atij të shkallës së dytë, mbrojtësi i të dënuarit K. K.i, av. F. V., nga Prishtina, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen, i dënuari K.K. të lirohet nga akuza apo të njëjtit t'i shqiptohet një dënim dukshëm më i butë.

Mbrojtësi i të dënuarit K. K., në kërkesën e tij pretendon se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara me nenin 403 par. 1 pika 12 të KPPK, ngase dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë është i

pakuptueshëm dhe kundërthënës me arsye të dhëna lidhur me faktet vendimtare, sepse i dënuari akuzohet për bashkëkryerje të veprës penale të vrasjes pasi që Prokurori Publik i Qarkut kishte bërë ndryshimin e akuzës, ndërsa dispozitivi është ndryshuar vetëm me një fjalë – fjala shtytje është zëvendësuar me fjalën bashkëkryerje, andaj konsideron se në dispozitiv të aktgjykimit është paraqitur krejtësisht ndryshe gjendja e fakteve vendimtare nga ajo që është vërtetuar në shqyrtimet gjyqësore dhe me rastin e rekonstruimit të vendit të ngjarjes. Mbrojtësi i të dënuarit konteston se provat e vlerësuara në shqyrtimin gjyqësor si dhe konkludimet të cilat i ka nxjerrë në bazë të këtyre provave janë vlerësuar në mënyrë të njëanshme dhe të gabuar kështu që edhe konkludimet kanë pasuar të gabuara, pa mbështetje në provat e administruara gjë që ka quar edhe në shkallën e ligjit penal në dëm të të dënuarit. Mbrojtësi i konteston konkludimet e gjykatës së shkallës së parë se vepra penale e vrasjes është kryer në bashkëkryerje ngase në këtë rast nuk janë përbushur asnjë nga konditat ligjore që ligji parasheh, mungon elementi subjektiv dhe ai objektiv, dhe sipas mbrojtësit i mbrojturi i tij as nuk e kishte dëshiruar pasojën dhe as që kishte kontribuar që ajo të shkaktohet.

Opinion i prokurorit të shtetit , lidhur me kërkesën

Ndaj kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit është përgjigjur Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.91/2014 datë 4.7.2014, në të cilën ka propozuar që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë së mbrojtësit të të dënuarit K.K të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë konform dispozitës së nenit 435 të KPPK dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Përfundimet e gjykatës së shkallës së parë

*Nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me bashkëkryerjen theksohet, po citojmë; “Meqenëse se i dënuari(akuzuari) K. e thërret për ndihmë të dënuarin(akuzuarin) L., i tregon personat të cilët kanë dashur ta sulmojnë, i kërkon revolen dhe tenton që t’ia marrë atë, shpie në përfundim të pakontestueshëm se ai jo vetëm që ka qenë **bashkëkryerës** por edhe është pajtuar me **pasojën** !!!! (sipas rezonit të gjykatës së shkallë së parë qenka e mundur bashkëkryerja edhe kur kryesi nuk e dëshiron pasojën, nuk pajtohet me pasojën!????) , bazuar edhe në faktin se i dënuari K. fare nuk i ka njohur as të ndjerin e as dëshmitarin M. Xh. me të cilët asnjëherë më parë nuk ka pasur mosmarrëveshje” , përfundon citati ?.*

Përfundimet e Gjykatës së Apelit

Ndërsa Gjykata e Apelit në përgjigjet e saj lidhur me pretendimet ankimore thekson, po citojmë: “ I dënuari K. K. i ka paraprirë konfliktit dhe ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në kryerjen e veprës penale të vrasjes së të ndjerit, ngase ai ka ftuar në ndihmë të dënuarin L. K., për shkak të mosmarrëveshjes me M. Xh., ia tregon personat të cilët janë duke e sulmuar me ç’rast i ndjeri kishte një shkop në dorë, ndërsa M. një thikë, në atë moment i dënuari L. nxjerr nga çanta revolen me të cilën shtënë në drejtim të të dëmtuarve dhe një predhë e godet tani të ndjerin, ndërsa i dënuari K. nuk ka ndërmarrë veprime që të pengoj të dënuarin L. të shtënë në drejtim të të ndjerit”, përfundimi i citatit.

Sipas këtij aktgjykimi Gjykata e Apelit e konsideron si bashkëkryerës të dënuarin K. për faktin se nuk e ka penguar të dënuarin L. që ai të shtien me revole dhe me këtë sipas kësaj gjykate ai është pajtuar me shkaktimin e pasojës-vrasjen e të ndjerit nga i akuzuari i parë.

Përfundimet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës edhe në aktgjykimin Ap.nr. 26/2012 datë 8.8.2012 (si gjykatë e shkallës së dytë), kur kishte anuluar aktgjykimin e ankimuar edhe tani me rastin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë (si gjykatë e shkallës së tretë) konstaton:

Rrjedha e ngjarjes me pasoja tragjike?

Nuk janë kontestuese faktet se i dënuar K. kishte konflikt me M.Xh., i cili ditën kritike i kishte treguar B. M. se posedonte një thikë dhe se kishte ndërmend që po atë ditë të sqarohej me të dënuarin K., dhe këtë paralajmërim B.ia kishte përcjellë të dënuarit K. Po ashtu nuk janë kontestuese faktet se i dënuari për këto rrethana e kishte njoftuar me telefon të dënuarin tjetër – L., meqenëse ishte i frikësuar për jetën e tij ngase kërcënimi ishte serioz . I dënuari i dyte ishte paraqitur në vendin ku është zhvilluar ngjarja, por aty afër ishte edhe i ndjeri me të cilin i dënuari K. nuk kishte asnjë konflikt, që mbante një shkop në dorë dhe M. me të cilin V. ishte në konflikt, që posedonte një thikë dhe aty ka filluar debati në mes të dënuarve në njërën anë dhe të dëmtuarve në anën tjetër, nga një distancë prej më se 20 m, me ç’rast debati ka arritur në atë shkallë të acarimit sa që i dënuari L. kishte nxjerrë revolen dhe i kishte mbajtur në shënjestër të ndjerin dhe M., dhe në ndërkohë e përdor armen, duke shtënë një herë në tokë kurse herën tjetër në drejtim të të dëmtuarve, e shtënë që kishte qenë fatale për të ndjerin N.

Mënyra e tillë e zhvillimit të ngjarjes kritike nuk kontestohet nga askush .

Cili ishte roli dhe kontributi i të akuzuarit K, para gjatë dhe pas përfundimit të kësaj ngjarje tragjike?

I akuzuari K, pasi ishte në konflikt me M. Xh. dhe pasi që kishte marr paralajmërimin se ai do të sulmohet nga ky i fundit me armë të ftohët, ka kërkuar ndihmë për ta mbrojtur nga sulmi i paralajmëruar i M., nga fqinji i tij tani i dënuari L. që është shumë normale dhe njerëzore, ngase këtë do e bënte çdokush i cili ndodhet para një sulmi të tillë të paralajmëruar të rrezikshëm dhe

konkret, sulm i cili edhe ishte realizuar nga ana e M. , i cili tani këtë të dënuar po e përcillte me thikë në dorë.

I akuzuari L. pasi ishte njoftuar nga i akuzuari K. se është i rrezikuar nga një person, kishte arritur në vendin e ngjarjes i armatosur me revole dhe pasi i kishte parë M. me thikë në dorë dhe të ndjerin me një shkop në dorë, me të cilin i akuzuari K. kurrë më parë s'kishte qenë në konflikt, , ka nxjerrë revolen nga çanta dhe pas një dueli verbal kishte shtënë një herë në tokë, dhe të dytën herë në drejtim të personave me të cilët verbalishtë po konfliktoheshin e cila e shtënë ishte edhe e kobshme për tani të ndjerin.

Pas vrasjes së të ndjerit , ata së bashku ishin larguar, duke u strehuar në një shtëpi ku i akuzuari K, pas kishte vërejtur tronditjen e rëndë psikike të të akuzuarit L. dhe duke ndjerë peshën e fajit se ai u bë shkaktar që e futi në telashe të dënuarin L., kishte përgatitur planin për ta pranuar veprën penale, duke fshi gjurmët e vijave papilare të L. nga revolja dhe duke i vendosur gjurmët e t'ia, dhe si rrjedhojë më pastaj ishte paraqitur në polici ku kishte pranuar autorësinë e vrasjes edhe pse ai vet nuk ishte vrasësi .

A mund këto veprime të të dënuarit K. në rrethana të tilla të vihen nën normën juridike të bashkëkryerjes ?

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme në situatën e tillë jo që nuk ekziston bashkëkryerja nga ana e të dënuarit K. por as format tjera të bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë për arsyet si në vijim;

Neni 31 i KPK, bashkëkryerjen e definon kështu : “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thellësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”.

Nga përshkrimi ligjor i këtij instituti rezulton se për ekzistimin e bashkëkryerjes në mënyrë kumulative duhet të shprehet elementi subjektiv i cili konsiston në vendimin e përbashkët për kryerjen e veprës penale dhe kryerja e veprës penale së bashku.

Vendimi i përbashkët për kryerjen e veprës penale konsiston në faktin se të gjithë bashkëkryerësit janë të vetëdijshëm dhe e dëshirojnë së bashku kryerjen e veprës. Ky parakusht qartë rezulton nga formulimi i ligjit në të cilin thuhet “dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale”. Mirëpo në raste të caktuara bashkëkryerja mund të shprehet edhe në rastet kur nuk ka ekzistuar marrëveshja paraprake, por ajo në ndërkohë, gjatë kryerjes është shprehë.

Kryerja e veprës penale së bashku është element objektiv i bashkëkryerjes i cili është tregues se vepra penale është kryer nga dy apo më shumë persona. Kryerja e veprës penale së bashku më së shpeshti shprehet në rastet kur veprimin e kryerjes e ndërmarrin shumë persona. Mirëpo, në bazë të së nenit 31 të KPK, si bashkëkryerës konsiderohen edhe personat të cilët në

mënyrë vendimtare, thelbësisht kontribuojnë në kryerjen e veprës penale. Si bashkëkryerës do të konsiderohet edhe ai person i cili e ka ndërmarrë vetëm një pjesë të kryerjes së veprës penale të caktuar (psh dy persona godasin me thikë personit, ndërsa i treti e mbanë viktimën).

Në rastin konkret nuk është përmbushur asnjë nga kushtet ligjore që i parasheh ligji, nuk ekzistonte vullneti i përbashkët për të shkaktuar pasojën –për të vra të ndjerin, këtë dashje paraprakisht nuk e kishte as i akuzuari L., por dashja tek ky kishte lind aty për aty, pas konfliktit verbal dhe pasi kishte vërejtur se këta persona kanë ndërmend ta sulmojnë të akuzuarin K. I akuzuari K. nuk e kishte thirr të akuzuarin L. për ta mbrojtur nga i ndjeri, ngase me të nuk kishte asnjë konflikt, por nga i dëmtuari M.. I akuzuarin K. jo që nuk kishte marr pjesë në veprimin e kryerjes (nuk kishte asgjë në duar) por as nuk kishte kontribuar në shkaktimin e pasojës, ngase distanca në mes të viktimës dhe vrasësit ishte mbi 20 m dhe objektivisht s’kishte mundësi të kontribuonte në shkaktimin e pasojës (ai nga frika e sulmit nga i dëmtuari M. ishte fshehur pas të akuzuarit L.). Edhe nën supozimin se i akuzuari K. ishte dakorduar – marr vesh me të akuzuarin L. për ta vrarë të ndjerin- elementi subjektiv (*u tha më sipër marrëveshje e tillë nuk ekzistonte ngase ai nuk kishte asgjë të keqe me të ndjerin*) ai nuk merr pjesë në veprimin e kryerjes (nuk shtien në të) dhe nuk kontribuon në shkaktimin e vdekjes së tij (nuk e mban, nuk e pengon të ik etj – “nuk ka pushtet mbi veprën”, nuk bëhet fjalë për bashkëkryerje, ngase mungon elementi i dytë (elementi objektiv).

Në këtë ngjarje tragjike nuk është përmbushur asnjë nga elementet ligjore dhe jo çdo veprim në një ngjarje me pasoja tragjike dhe jo çdo prezencë në vendin ku dikush privohet nga jeta dikë e bënë bashkë-kryes, siç ka rezonuar gjykata e shkallës së parë (se meqë e paska ftuar të dënuarin L. e paska dëshiruar pasojën) pa u përmbushur kumulativisht elementi subjektiv dhe objektiv, apo rezoni akoma ma i çuditshëm i Gjykatës së Apelit “se meqë nuk e paska parandaluar të dënuarin L. që të shtie në të ndjerin, ai qenka bashkëkryerës !!!”, sipas rezonit alogjik të Gjykatës së Apelit, çdo person i cili ka mundësi për ta parandaluar dikë që të shtie në viktimën dhe nuk e bënë atë, ai qenka bashkë-kryes !!!.

Në rastin konkret dhe nga rrethanat e dhëna, nuk ekziston as forma tjetër e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë- *shtytja dhe ndihma*, ngase i dënuari K. nuk ka ndikuar te i dënuari L. që ai të merr vendim për të vrarë të ndjerin. U tha më sipër, ky nuk kishte konflikt me të dhe nuk ka kërkuar nga i dënuari L. që të vras as të dëmtuarin M., por vetëm ta mbroj atë nga sulmi i tij, i cili po pasonte, që ishte i atëçastshëm (ishte me thikë në dorë) edhe pse në distancë prej 20 m nga ky. Në rastin konkret nuk kishte as ndihmë ngase ndihma jepet para dhe gjatë kryerjes së veprës penale, përjashtimisht pas kryerjes së veprës penale, nëse ndihma e tillë paraprakisht i është premtuar kryesit. I dënuari K. me asgjë nuk ia kishte lehtësuar të dënuarit L. kryerjen e vrasjes së të ndjerit, edhe pa i treguar fare se kush po e kërcënon, ai i kishte parë ata, u potencua më lartë, M. ishte me thikë, e i ndjeri me një shkop në dorë dhe vinin në drejtim të të dënuarit K. dhe këto rrethana nuk janë kontestuese.

Çështja e bashkëkryerjes si institut në të drejtën penale , nuk vlerësohet me atë se kush ishte shkaktar që filloi konfliktin, i cili përfundoj fatalisht për të ndjerin (**po rezulton se kështu e kanë vlerësuar bashkëkryerjen paditësi-prokurori, gjykata e shkallë së parë dhe ajo e shkallë së dytë**) por me atë se a janë përmbushur kushtet subjektive dhe objektive që kërkohen me ligj, siç u përshkruan më lartë. Iniciator i konfliktit po rezulton të jetë i dëmtuari M., po mos t'i ishte kërcënuar ai me thikë të dënuarit K., ai nuk do thërriste në ndihmë të dënuarin L., por ky nuk mund të konsiderohet bashkëkryerës .

Si përfundim thirrja e tani të dënuarit L. nga i dënuari K.për ta mbrojtur nga sulmi i rrezikshëm i M. Xh. , ardhja e këtij të fundit i armatosur dhe privimi nga jeta i tani të ndjerit me të cilin K nuk ishte në konflikt dhe nuk e kishte thirr ndihmën për të, nuk e bëjnë atë në asnjë variant bashkëkryerës, siç gabimisht ka gjetur gjykata e shkallë së parë dhe ajo e Apelit.

Veprimet e të akuzuarit K. eventualisht do mund të vlerësoheshin , në kuadër të veprës penale dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale, të parashikuar nga neni 388 të KPK, ngase dyshohej se e ndihmoi kryesin e veprës penale duke tentuar t'i fsheh gjurmët e veprës penale, dhe veprës penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë, të parashikuar nga neni 390 par.3. të KPK, ngase ekzistonte dyshimi i arsyeshëm se ai te organet e ndjekjes e paraqiti veten si kryes të vrasjes edhe pse këtë ai nuk e kishte bërë, mirëpo nga prokurori publik nuk ishte akuzuar për këto vepra penale dhe tanimë, për këto vepra penale është arritur afati parashkrimit absolut.

Me qenëse gjykata ndryshoi aktgjykimin dhe të dënuarin K. e liroi nga akuza, ndryshoi edhe aktgjykimin që ka të bëjë me të dënuarin L. K., duke ia hequr nga cilësimi juridik bashkëkryerjen , ngase u tha më sipër në rastin konkret nuk bëhet fjalë për bashkëkryerje.

Nga arsyet e parashtruara më lartë rezulton se gjykata e shkallës së parë gabimisht i ka vlerësuar provat të cilat kanë imponuar edhe aplikimin e gabuar të ligjit penal në dëm të të dënuarit , në çka me të drejt i referohet mbrojtësi me kërkesë për mbrojtje të ligjshmerisë.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë e në bazë të nenit 438 par. 1 pika 1.1. të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Pml.nr. 131/2014, më 9 shtator 2014.

Procesmbajtësja,

Kryetari i kolegjit,

Formulari 108

AKTGJYKIM ME TË CILIN KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË REFUZOEHET SI E PABAZUAR (456 të ish KPPK-s tani neni 437)

KML.nr.131/2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: A. D, kryetar, F. H. dhe N. L., anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale M. Xh., procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit M.L, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 297.par.3 lidhur me para.1.të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit M.K, av. D.R., nga Prishtina, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm , PAKR.nr. 200/2014 datë 10.01.2011, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9 maj 2012, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet *si e pa bazuar* kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë , e mbrojtësit të të dënuarit M.L. av. D.R.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____,dega në _____ P.nr. _____ datë _____ është shpallur fajtor i pandehuri M.L. për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik , të parashikuar nga neni 297.par.3 lidhur me para.1.të KPK, dhe është dënuar me një (1) muaj burgim.

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri N.N. në afatin ligjor ka ushtruar ankesë duke atakuar aktgjykimin për të gjitha bazat ligjore, me vërejtje se arsyet e ankesës duhet t'ia paraqes gjykatës më vonë.

Me ftesën e gjykatës së shkallës së parë i pandehuri ankesën e tij e ka plotësuar , duke dhënë arsye përkitazi për të gjitha bazat ligjore për të cilat e ka atakuar aktgjykimin e shkallës së parë , me ç'rast edhe ka kërkuar që të jetë i informuar për seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë , në kuptim të nenit 475 të KPPK-s.

Edhe pse i pandehuri në plotësimin e ankesës së tij ka kërkuar që të jetë i informuar për seancën e kolegjit, gjykata e shkallës së dytë nuk ka vepruar sipas kësaj kërkesë nuk e ka informuar të pandehurin derisa në seancën e mbajtur më 17.08.2011, pa prezencën e të pandehurit ankesën e tij e ka refuzuar dhe aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

I pandehuri kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë me pretendim se gjykata e shkallës së dytë duke mos informuar të pandehurin për seancën e kolegjit ka shkelur dispozitat e nenit 475 të KPPK-s, dhe se i ka cenuar të drejtën në mbrojtje.

Gjykata Supreme duke shqyrtuar gjitha shkresat e lëndës lidhur me kërkesën e ngritur, ka gjetur se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të pandehurit është e pabazuar dhe të njëjtën ka refuzuar për këto arsye:

Sipas nenit 475 të KPPK-s, në procedurën e shkurtuar (sumare)për seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë informohen i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nëse është dënuar me dënim burgimi dhe nëse palët në afatin e ankesës ose përgjegjës në ankesë kanë kërkuar që të jetë i informuar, ose nëse Kryetari i kolegjit ose kolegjii gjen se prania e palëve do të ishte e dobishme për sqarimin e çështjes.

Nga shkresat e lëndës rezulton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të pandehurit i është dorëzuar më 10.05.2011 që nënkupton se afati për ankesë i ka skaduar me datën.18.05.2011.

Te gjendja e tillë e çështjes , ndërsa me interpretimin e drejtë të dispozitës së nenit 475 të KPPK-s, rezulton se i pandehuri kërkesën për njoftim për seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë është dashur ta dorëzoj më së largu gjer më 18.05.2011, në të cilën datë do t'i skadonte afati për ankesë. Meqenëse i pandehuri këtë kërkesë e ka paraqitur më 23.05.2013 edhe atë me parashtrësën në të cilën i ka dhënë arsyet për pretendimet ankimore, pa mëdyshje rezulton se kërkesën për tu informuar lidhur me seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë ka qenë e pas afatshme. Duhet të kihet parasysh se afati nga dispozita e cituar është afat prekluziv dhe nuk ekzistojnë mundësit ligjore për zgjatjen e tij.

Meqenëse kërkesa e të pandehurit për ta informuar për seancën e kolegjit të gjykatës së shkallës së dytë është e pa afatshme, gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar që nuk e ka informuar të pandehurin për datën e mbajtjes së seancës së kolegjit. Nga ato që u theksuan del se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë Ap.nr. ____ datë ____ nuk është shkelur ligji siç pa të drejtë potencohet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, paraqitur nga ana e të pandehurit.

Nga arsyet e parashtruara, në bazë të nenit 456 të KPPK-s, është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,

Formulari 109

AKTGJYKIM ME TË CILIN KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË APROVOHET SI E BAZUAR

(neni 438.par.2.të KPPK-s vetëm konstatohet shkelja e ligjit)

KML.nr. ___/___

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: A. D, kryetar, F. H. dhe N. L., anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale M. Xh., procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit F.K, për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit të parashikuar nga neni 332 par.1. të KPK-s., duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e prokurorit shtetërorë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë PPL.nr.57/2013 datë.20.03.2014, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm , PADP.nr. 357/2013 datë 10.01.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20 tetor 2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Konstatohet se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit. PADP.nr.357/2013 datë10.01.2014, është shkelur ligji në favor të pandehurit .

Arsy e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë P.r. 159/2011, i akuzuari F.K është shpallur fajtor për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit, të parashikuar nga neni 332 par.1. të KPK-s(tani 392), dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej një(1) muaji.

Vendimi i Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën

Duke vendosur sipas ankesës së të pandehurit F.K. gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin PADP.nr.357/2013 datë10.01.2014, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që të pandehurin e ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit të parashikuar nga neni 332 par.1. të KPK-s.

Gjykata e shkallës së dytë ka konkluduar se në veprimet e të pandehurit nuk janë plotësuar tiparet qenësore të veprës penale të falsifikimit të dokumentit parashikuar nga neni 332 par.1. të KPK-s , nga se për ekzistimin e kësaj vepre penale është e domosdoshme që dikush të krijoj dokumentin e falsifikuar ose të ndryshojë ose të ndryshojë dokumentin e vërtetë me qëllim që dokumentin e tillë ta përdorë si të vërtetë, ndërsa në rastin konkret i pandehuri ka hequr tabelat e regjistrimit nga një automjet i aksidentuar dhe pa kurrfarë ndryshimi i ka vendos në automjetin e tij.

Mjeti i jashtëzakonshëm-kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë

Prokurori i Shtetit ka ngritur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë PADP.nr.357/2013 datë10.01.2014, me pretendim se me këtë aktgjykim është shkelur ligji penal në favor të pandehurit, andaj ka propozuar që Gjykata Supreme në bazë të nenit 438.par.2 të KPPK-s, të konstatoj se me aktgjykimin e atakuar është shkelur ligji në favor të të akuzuarit.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi shkresat e çështjes dhe vlerësoi pretendimet të paraqitura në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë , dhe konstatoi se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit shtetërorë të Kosovës, PPL.nr.57/2013 datë.20.03.2014, *është e bazuar.*

Figura e veprës penale falsifikimi i dokumentit

Tabelat e regjistrimit të automjetit janë dokumente publike , të cilat i jep organi kompetent shtetëror dhe të cilat shërbejnë për identifikimin e automjetit të caktuar. Në veprimet e të pandehurit F.K. që i ka hequr tabelat e regjistrimit të aksidentuar për identifikimin e të cilit kanë shërbyer dhe i ka vendosur këto tabela pa leje dhe evidencë të organit kompetent në automjetin e tij , i ka konsumuar të gjitha elementet të veprës penale falsifikimi i dokumentit

parashikuar nga neni 332 par.1. të KPK-s , nga se realisht bëhet fjalë për përdorimin e dokumentit të rrejshëm si të vërtetë.

Rezulton se gjykata e shkallës së dytë, ka marrë qëndrim të kundërt juridik nga ai i gjykatës së shkallës së parë dhe në përputhje me këtë qëndrim, me aktgjykimin PADP.nr.357/2013 datë10.01.2014, e ka liruar të pandehurin N.N. nga akuza për veprën e cituar penale dhe në këtë mënyrë ka shkelur ligjin në favor të pandehurit.

E kufizuar nga ligji, gjykata vetëm konstatoi shkeljen

Meqenëse kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është paraqitur në dëm të pandehurit, ndërsa ligji është shkelur në favor të tij, Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit . 438.par.2. të KPPK-ës, me këtë aktgjykim vetëm ka konstatuar ekzistimin e shkeljes së ligjit penal , duke mos prekur vendimin e formës së prerë.

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,

Formulari 110

**AKTGJYKIM ME TË CILIN KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË
APROVOHET SI E BAZUAR ANULOHEN AKTGJYKIMET E GJYKATAVE TË
ULËTA)**

(NENI 457 PAR.1.PIKA2. ISH KPPK-s)

PML.nr. ___/___

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: A. D, kryetar,F. H. dhe N. L., anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale M. Xh., procesmbajtëse, në çështjen penale të të dënuarit B.M., për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje të parashikuar nga neni 190.par.2.të KPK-s., duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë e të pandehurit , të paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës Themelore –Departamenti i përgjithshëm në Prishtinë PDP.nr 587/2013.datë 15.02.2013 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm , PADP.nr.221. /2013 datë 20.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20 maj 2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore –Departamenti i përgjithshëm në Prishtinë PDP.nr 587/2013.datë 15.02.2013 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm , PADP.nr. 221/2013 datë 20.11.2013, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Rrjedha e procesit

Gjykata Themelore –Departamenti i Përgjithshëm në Prishtinë , me aktgjykimin PDP.nr 587/2013.datë 15.02.2013, ka shpallur fajtor M.B. për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje të parashikuar nga neni 190.par.2.të KPK-s., dhe e ka gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit me aktgjykimin e saj PADP.nr.221. /2013 datë 20.11.2013, e ka refuzuar ankesën e të pandehurit si të pabazuar ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

I pandehuri ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë me aktgjykimin e shkallës së parë dhe të dytë me pretendim se me këto aktgjykime janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384.par.1.pika 1.1. lidhur me nenin 311 të KPPK-s, nga se me datën 15.02.2013 , shqyrtimi gjyqësor është mbajtur para trupit të ndryshuar gjykues , ndërsa dëshmitarët të cilët janë dëgjuar në shqyrtimet e mëhershme nuk janë dëgjuar sërish dhe as që janë lexuar dëshmitë e tyre.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, duke i shqyrtuar shkresat e çështjes dhe duke i vlerësuar pretendimet nga kërkesa ka gjetur se ajo është e bazuar, për arsye si në vijim:

Në këtë çështje penale shqyrtimi gjyqësor i udhëhequr nga gjyqtari L.T. është mbajtur më 10.06.2014, në të cilën janë dëgjuar dëshmitarët; S.K, F.H dhe N.K. si i dëmtuar.

Shqyrtimi gjyqësor të mbajtur më 15.02.2013, është udhëhequr nga gjyqtari i vetëm B.L.(për arsye se gjyqtari L.T kishte dhënë dorëheqje nga funksioni i gjyqtarit) andaj ky gjykim është mbajtur para gjyqtarit tjetër. Në këtë shqyrtim janë dëgjuar dëshmitarët K.B. dhe L.L.,

ndërsa nuk janë dëgjuar sërish dëshmitarët e dëgjuar më herët dhe as që në procesverbalin mbi shqyrtimin gjyqësor është konstatuar se janë lexuar dëshmitë e tyre, ashtu si urdhërojnë dispozitat e nenit 311.par.1.të KPPK-s, ndërsa në dëshmitë e këtyre dëshmitarëve është i bazuar aktgjykimi.

Sipas dispozitës së cituar ligjore të KPPK-ës, shqyrtimi gjyqësor i cili është shtyrë duhet të fillojë rishtas, nëse është ndryshuar përbërja e trupit , mirëpo, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendos që dëshmitarët dhe ekspertët të mos dëgjoen përsëri por të lexohen dëshmitë e tyre të cilat ata i kanë dhënë në shqyrtimet e mëhershme.

Meqenëse se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat nenit 311 par.1 . të KPPK-s, aktgjykimi është përfshirë me shkelje të dispozitave ligjore , nga neni 384.par.2.nënp.2.1.lidhur me nenin 311 par .1 të KPPK-ës, të cilat shkelje janë esenciale me natyrë absolute .

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar sipas ankesës së të pandehurit , nuk i ka evituar shkeljet e theksuara edhe pse është dashtë ta bëjë sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394.par.1.pika.1.1. të KPK-ës, me çka ka shkelur dispozitën e nenit.394 par.1.pika.1.1.idhur me nenin 384.par.1.pika 1.1 .të KPPK-ës.

Nga të shtruarat më lart, Gjykata Supreme në bazë të nenit. 438.par.1. pika. 1.2.të KPPK-s, ka vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,

PROCEDURA PENALE NDAJ TË MITURVE
(Kodi Penal i Drejtësisë Për Të Mitur –KPDM)

Formulari 111

**AKTVENDIM PËR BASHKIMIN E PROCEDURËS NDAJ TË MITURIT DHE
MADHORIT**
(neni 47.par.2. KPDM)

PM.nr. ___ / ___

Gjykata Themelore në _____ me trupin gjykues për të mitur , në përbërje prej N.N. Gjyqtar për të mitur, si kryetar i trupit dhe gjyqtarëve porotë N.N. dhe F.F. si anëtarë të trupit me procesmbajtësen M.M. në çështjen penale e të miturit P.M., për shkak të veprës penale vrasje nga neni 178 të KPK, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të shtetit të Prokurorisë Themelore në _____ për bashkimin e procedurave, në seancën e kolegjit të mbajtur më _____ , ka marr:

A K T V E N D I M

Sipas çështjes penale e të miturit P.M., dhe madhorit L.M. , nga _____, për shkak të veprës penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 178 të KPK-ës, do të udhëhiqet procedurë e përbashkët me madhorët pranë Gjykatës Themelore në _____.

A r s y e t i m i

Në bazë të aktvendimit të plotfuqishëm të Prokurorit të Prokurorisë Themelore Departamenti për të Mitur në _____, PPM.nr.____ datë____, është duke u zhvilluar procedura përgatitore ndaj të miturit P.M, nga _____, për shkak të veprës penale vrasjes,të parashikuar nga neni 178 të KPK-ës, a në bazë të aktvendimit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore Departamenti Për Krime të Rënda, HP.nr.____ datë _____, janë duke u zbatuar hetimet kundër të pandehurit Z.K. për shkak të veprës së njëjtë penale.

Prokurori i Prokurorisë Themelore Departamenti Për të Mitur në _____, me parashitë PP.nr.____ datë _____, ka propozuar që procedura ndaj të miturit P.M. dhe madhorit L.M. të bashkohet dhe të udhëhiqet një procedurë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, meqë është e nevojshme me qëllim të sqarimit të gjithanshëm të çështjes.

Kolegji për të mitur ka shqyrtuar propozimin e Prokurorit i Prokurorisë Themelore Departamenti Për të Mitur si dhe shkresave të lëndës dhe ka gjetur se propozimi është i bazuar.

Nga provat e tanishme të mbledhura ekziston dyshimi i bazuar se i mituri P.M. dhe babai i tij L.M. me datë _____, rreth orës _____, kanë privuar nga jeta tani të ndjerin M.H. në shtëpinë e tij. Ngjarja ka ndodhur natën. Dëshmitarë nuk ka. I pandehuri L.M. mbrohet se veprën penale e ka kryer në mbrojtje të nevojshme ndërsa i mituri P.M. konteston se ai ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale të vrasjes.

Duke pasur parasysh faktet e vërtetuara , rezulton të jetë i bazuar propozimi i Prokurorit të Prokurorisë Themelore- Departamenti për të Mitur , që me qëllim të ndriçimit të gjithanshëm të çështjes , është e nevojshme të zhvillohet një procedurë e përbashkët.

Meqenëse janë përmbushur kushtet ligjore që të bashkohet procedura ndaj të miturit P.M. me procedurën kundër madhorit L.M., është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në bazë të nenit 47 par.2 të KPDM.

GJYKATA Themelore në _____ Departamenti për të mitur

Datë ____ PM.nr. ____ / ____

Procesmbajtësi,

Kryetari i trupit,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesë Gjykatës

së Apelit , në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Sqarim :

Propozim të arsyetuar për bashkimin e procedurave në situata të tilla mund të paraqesë edhe mbrojtësi i të miturit.

Formulari 112

INFORMATA E PROKURORIT PUBLIK SE NUK DO E FILLOJ PROCEDURËN
PENALE KUNDËR TË MITURIT

(neni 56. KPDM)

PROKURORIA THEMELOR NË _____,DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

PPM.nr. _____

Dt. _____

P r i s h t i n ë

ORGANIN E KUJDESTARISË NË _____

Ju informojmë se për shkak të oportunitetit nuk do e filloj procedurën përgatitore ndaj të miturit M.P. nga _____, për shkak të veprës penale të kanosjes të parashikuar nga neni 185.par.2.të KPK-ës.

Formulari 113

KALLZIM PENAL PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PREGADITORE NDAJ TË MITURIT

(neni 95. KPDM dhe neni 78 të KPPK-ës)

STACIONI POLICOR NR.3

Nr. _____

Dt. _____

P r i s h t i n ë

PROKURORISË THELORE NË _____

DEPARTAMENTIT PËR TË MITUR

P R I S H T I N Ë

Në bazë të neni 95 të KPDM, dhe neni 78 të KPPK-ës i paraqes Prokurorisë këtë,

KALLZIM PENAL

Kundër të miturit M.F. nga i ati _____ dhe e ëma _____, i lindur më _____, në _____, ku dhe jeton nxënës i klasës së dhjetë i Shkollës së Mesme _____, për shkak të veprës penale të grabitjes parashikuar nga neni 329.par.1 të KPK-ës.

I mituri dyshohet se me datën _____ rreth orës 22,00, në afërsi të Shkollës _____, ka kryer veprën penale të grabitjes në dëm të dëmtuarës L.B. nga _____, rruga ____nr.____, në atë mënyrë që befaz ka sulmuar të njëjtën duke kap për flok ia ka rrëmbyer çantën që e kishte me vete dhe është larguar nga vendi i ngjarjes, e dëmtuara në çantën e saj kishte 1 telefon të markës Samsung në vlerë prej 200 €, portofolin me të holla 200 €, kishte një palë syze delli në vlerë prej 100 €.

Kallëzimi penal mbështet në njohjen e të miturit nga ana e të dëmtuarës, gjetja e sendeve të grabitura te i mituri, certifikata për lëndime të lehta trupore që ka pësuar e dëmtuara, pranimi i veprës penale nga ana e të mituri.

Në bazë të këtyre fakteve dhe provave që e mbështesin kallëzimin penal konsiderojmë se ekziston bazë e mjaftueshme që ndaj të miturit të fillohet procedura përgatitore.

Ushtruesi i kallëzimit penal

Inspektori V.V.

Formulari 114

AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASAVE TË DIVERSITET NDAJ TË MITURIT (NENI 18.KPDM)

PPM.nr. _____ 2014

Prokurori Shtetërorë i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-departamenti për të mitur ,N.N, me procesmbajtësin N.N, në çështjen penale e të miturit N.N. nga .Prishtina rr."Xh.Mustafa" nr.____, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor, të parashikuar nga neni 188.par.2.lidhur me paragrafin 1.pika 1.1.të KPK-s, me datë 10.11.2014.mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të miturit N.N.nga babi X.X dhe e ëma X.X, e lindur X.i lindur më 2.3.1998 , në Prishtinë ,ku edhe jeton , nxënës i klasës së dhjetë i shkollës _____, i padënuar më parë , konform nenit 17 dhe 18 të Kodit Penal Drejtësia Për Të Mitur:

I.Pezullohet ndjekja penale

II.Shqiptohet masa e diversitetit

Pajtimi në mes të miturit dhe të dëmtuarit dhe kërkimi i faljes të dëmtuarit ;

Këshillimi psikologjik , njëherë në muaj për gjashtë muaj rresht .

A r s y e t i m

Ndaj të miturit NN.Policia e Kosovës , stacioni nr.1.në Prishtinë, ka paraqitur kallëzim penal, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor të parashikuar nga neni 188.par.2.lidhur me paragrafin 1.pika 1.1.të KPK-s.

Prokurori i shtetit NN, pasi shqyrtoi kallëzimin penal , shkresat tjera të lëndës e veçmas anketën sociale të përpiluar nga Shërbimi Sprovues i Republikës së Kosovës ,nr.____, datë _____, dhe mori në pyetje të miturin në prezencën e mbrojtësit të tij av.NN, prindin e tij NN, vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kondidat ligjore që ndaj të miturit t'i shqiptohen masat e diversitetit për arsytet si më poshtë:

I mituri dyshohet se ka kryer vepër penale për të cilat me ligj mund të shqiptohet dënim me burgim deri në tri (3) vjet, se veprën mund ta ketë kryer me dashje , se jeta e tij e gjer tanishme ka qenë e rregullt dhe nuk ka pas asnjë sjellje asociale, si në rrethin familjar po ashtu edhe jashtë rrethit familjar. Sa i përket shkollës nuk ka pas asnjë vërejtje nga ana e mësim dhënësve apo shokëve të klasës , përkundrazi të gjithë flasin me admirim për sjelljen e tij shembullore. Rasti kur ndodhi konflikti me të dëmtuarin N.N. ishte një situatë ku i mituri kishte reaguar vrullshëm dhe pa kontroll, për shkak të një shakaje pa tendencë fyerje që i kishte bërë i dëmtuari .I mituri ka pranuar përgjegjësinë për veprën e kryer ,është pajtuar me palën e dëmtuar , ndërsa prindërit e tij janë pajtuar për shqiptimin e masës së diversitetit dhe janë zotuar se obligimet ndaj ti do i zbatojnë me përpikëri dhe në kohë që prokurori i cakton.

Në situatën e tillë dhe në praninë e fakteve të përshkruara më parë, konsiderojmë se këto masa të diversitetit do të jenë të mjaftueshme për rehabilitimin dhe riintergrimin e të miturit në shoqëri dhe nuk është oportune fillimi i procedurës penale ndaj të miturit .

Nëse i mituri si përmbushë obligimet e përcaktuara , ndaj tij mund të filloj ndjekja penale.

Ngase u tha më sipër, konform nenit 18. Të Kodit Të Drejtësisë Për Të Mitur u vendos si në dsipozitiv.

PROKURORIA HEMELEORE-DEPARTAMENTI PËR TË MITUR _____

PPM.nr. _____, datë _____

Procesmbajtësi,

P r o k u r o r i,

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Sqarim :

Këtë masë mund ta shqiptoj edhe trupi gjykues për të mitur (*neni 52.par.2.të Kodit Penal Drejtësisë Për Të Mitur*)

Formulari 115

AKTVENDIM PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PREGADITORE NDAJ TË
MITURIT
(*neni 55 i KPDM*)

HPM.nr. _____

Prokurori Publik i Prokurorisë Themelore e në _____, Departamenti për të mitur, me procesmbajtësin L.L. , në çështjen penale ndaj të miturit H.B., nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes të parashikuar nga neni 325. par.1. të KPK-s, duke vendosur sipas kallëzimit penal të Shërbimit Policor të Kosovës me datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të miturit H.B., nga i ati L.B dhe e ëma F.B., e lindur më _____, në _____, ku dhe jeton nxënës i klasës 11 , të Shkollës së Mesme _____, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale,

FILLOHET PROCEDURA PËREGATITORE, MË DATË _____

për arsye se;

Më datë _____ rreth orës 12,00, është fut në oborrin e të dëmtuarit M.L. , dhe nga aty ka marrë disa robe që ishin duke u tharë dhe një palë atlete sportive të markës Nike, në vlerë prej 120 €, dhe të njëjtat sende i ka sjellë në shtëpinë e tij, të cilat sende pastaj nga ana policore janë marrë të miturit dhe janë sjellë të dëmtuarit.

Me çka kishte për të kryer vepre penale të vjedhjes të parashikuar nga neni 325. par.1. të KPK-ës .

A r s y e t i m

Inspektori i Stacionit Policor nr.3, me datë _____, ka paraqitur kallëzim penal kundër të miturit H.B., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale të vjedhjes të parashikuar nga neni _____ të KPK.

Prokurori pas shqyrtimit të kallëzimit penal dhe provave në të cilën është bazuar kallëzimi ka ardhur në përfunduar se në këtë çështje penale duhet të fillohet procedura përgatitore me qëllim të procedimit të provave të propozuara eventuale për të parë se ndaj të miturit duhet të ushtrohet propozimi apo eventualisht të pushohet procedura.

Nga të ushtruarat më lart , në bazë të nenit _____, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Procesmbajtësi,

Prokurori Publik,

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Sqarim: *Parimi oportunitetit të të miturit*, për veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se tre (3) vjet ose me gjobë, prokurori mund të vendosë të mos fillojë procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshim i bazuar se i mituri ka kryer vepër penale, nëse prokurori mendon se nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura kundër të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojave për të dëmtuarin, si edhe të të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale.

Formulari 116

PROPOZIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKUESE TË MBYKËQYRJES NGA ANA E PRINDIT
(63 KPDM)

PROKURORIA THEMELOR NË _____, DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

PPM.nr. _____

Dt. _____

P R I S H T I N Ë

TRUPIT GJYKUES PËR TË MITUR TË GJYKATËS THEMELORE

P R I S H T I N Ë

Ndaj të miturit . F. R. i biri i N dhe F e gjinisë B. lindur më dt. _____ në _____ , rruga “Drenica 1” nr. 40, ku edhe jeton, nxënës i klasës së dhjetë të shkollës së mesme , i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, kosovar, në bazë të nenit 63 par.1. të KPDM-r, ushtroj:

PROPOZIM

PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKUESE-MBIKQYRJA E SHTUAR NGA ANA E PRINDIT

S E P S E, më dt. _____ rreth orës 17:10 në _____ , rruga “Vilam Voker” në afërsi të tregut me emrin “Fatoni”, ka mbajtur pa leje një revole me gaz të markës Zastava 635 me nr. serik T-6410978 , të cilën diku para dy javë ditësh e kishte blerë nga një person i panjohur për çmimin prej 30 €, ashtu që me rastin e bastisjes së tij nga ana e policisë të njëjtit i është gjetur dhe konfiskuar e njëjta revole.

- me këtë ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 376 par. 1 të KPK-së.

Andaj,

PROPOZOJ

Që Trupi gjykues për të mitur i asaj gjykate të caktoj dhe të mbajë shqyrtim gjyqësor në të cilën të ftohen:

- Prokurori I SHTETIT
- I mituri si dhe përfaqësuesi i tij ligjor sipas adresës së lartshënuar. .
- Përfaqësuesi i Shërbimit Sprovues të Kosovës - regjioni i Prishtinës.
- Që gjatë procedurës së administrimit të provave të nxirret si provë:
- korporadelikti - revolja e lartcekur,
- fotodokumentacioni i kësaj revoleje ,
- lista e marrjes së sendeve e dt. 03.06._____ .

Pas mbajtjes së seancës kryesore të miturit F. R të i shqiptohet masa edukuese e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit.

A r s y e t i m i

Pas zhvillimit të procedurës përgatitore në çështjen penale PPM nr. 1-1/_____ ndaj të miturit F.R , janë siguruar të gjitha provat me të cilat pa mëdyshje vërtetohet se i mituri ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, ashtu si figuron në dispozitivin e këtij propozimi për shqiptimin e masës edukuese.

I mituri. F.R , në deklaratën e tij të dhënë në prokurori e pranon faktin se të njëjtën revole e ka blerë para nja 2 javë dite për çmimin prej 30 € prej një tifozi të plisave përpara datës 03.06.2014 kur policia ja ka gjetur dhe konfiskuar të njëjtën revole dhe se të njëjtën e ka mbajtur pa leje valide. Nga kjo deklaratë e të miturit shihet çartë se i njëjti vërtetë është kryes i kësaj vepre penale.

Pos tjerash kjo gjendje faktike e kësaj qeshjeje penale bindshëm vërtetohet në bazë të korporadeliktit-revoles me gaz e cila gjendet në shkresat e lëndës, foto dokumentacionit të kësaj revoleje si dhe listës së marrjes së sendeve të dt. 03.06.2014.

Sa i përket të dhënave që kanë të bëjnë me personalitetin e të miturit F.R, si dhe shkallës së zhvillimit shpirtëror të tij, është siguruar anketa sociale e Shërbimit Sprovues të Kosovës, ku në të njëjtën anketë ekipi profesional i këtij shërbimi ka propozuar që gjykata të miturit F.R t'ia shqiptojë masën edukuese - disiplinore- qortimin gjyqësor ku ne si prokurori konsiderojmë se plotësisht e arsyeshme është që të njëjtit të i shqiptohet masa edukuese e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit përmes së cilës masë edukuese në tersi do të arrihej qëllimi i masave edukative i parashikuar në nenin 16 të KPDM-r.

PROKURORI I SHTETIT

Formulari 117

AKTVENDIM I GJYQTARIT PËR TË MITUR PËR PUSHIM TË PROCEDURËS NDAJ TË MITURIT (Neni 69. i KPDM)

Pm.nr. _____

Gjyqtari për të miturit i Gjykatës Themelore në _____ L.F. me procesmbajtësin P.R., në çështjen penale të miturit L.L., nga _____, për shkak të veprës penale të dhunimit në tentativë, të parashikuar nga neni 230 par.1 .lidhur me nenin 28 të KPK, sipas propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ PPM.nr. _____ datë _____, ka marrë me datën _____, këtë

A K T V E N D I M

*Hedhet propozimi i prokurorit të Prokurorisë Themelore dhe **pushohet procedura penale**, ndaj të miturit L.L., nga _____, i lindur _____, për shkak të veprës penale të dhunimit në tentativë të parashikuar nga neni 230 par.1 .lidhur me nenin 28 të KPK-ës.*

Shpenzimet e procedurës në shumë prej 150 €, bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Me aktvendim të njoftohet Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____ e dëmtuara A.Sh. dhe i mituri L.L.

A r s y e t i m i

Ndaj të miturit L.L., janë zbatuar hetimet për shkak të veprës penale të dhunimit parashikuar nga neni 230 par.1 të KPK, ndaj të dëmtuarës A.Sh.

Pas zbatimit të procedurës përgatitore Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____ me parashitësën PPM.nr. _____ datë _____, ka paraqitur propozim që ndaj të miturit të shqiptohet dënimi.

Gjyqtari për të mitur pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se ndaj të miturit nuk mund të shqiptohet dënimi për faktin se nga raporti i repartit të neuropsikiatrisë të

QKUK-së në Prishtinë nr. _____ datë _____, është vërtetuar se i mituri L.L. ka ngecje në zhvillimin mendor dhe zhvillimi shpirtëror i tij i përgjigjet zhvillimit shpirtëror nën moshën 10 vjeçare.

Meqenëse zhvillimi shpirtëror i këtij të mituri nuk i përgjigjet moshës së tij, por moshës së fëmiut nën moshën 10 vjeçare, ndaj tij nuk mund të shqiptohet dënimi në kuptim të nenit 33. të KPDM.

Nga të shtruarat në kuptim të nenit 69 të KPDM-r, lidhur me nenin 358 par.1.nënp.1.3 të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Për shpenzimet e procedurës është vendosur në kuptim të nenit 75. të KPDM.

GJYKATA THEMELORE NË _____ DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

PM.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,

P.R

Gjyqtari për të mitur,

R.F.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën së

Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 118

AKTVENDIMI I TRUPIT GJYKUES PËR TË MITUR PËR PUSHIMIN E PROCEDURËS PENALE NDAJ TË MITURIT (neni 73. KPDM)

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për të Mitur, në trupin gjykues në përbërje prej F.K. kryetar i trupit dhe B.B dhe J.J. anëtarë të trupit, me procesmbajtësen N.H., në çështjen penale të miturit V.B., për shkak të veprës penale të vjedhjes parashikuar nga neni 325 par.1 të KPK, me rastin e propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit për të Mitur PP.nr. _____ datë _____, në shqyrtimin e mbajtur më _____, në

prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Shtetërore K.M., e të miturit V.B., mbrojtësit të tij M.S., avokat nga Prishtina, përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë M.M., prindit-babait të miturit K.B., muarr dhe të njëjtën ditë publikoj këtë

A K T V E N D I M

Ndaj të miturit V.B., nxënës i Shkollës së Mesme të “Bujqësisë” në Prishtinë, i lindur më _____ në Prishtinë nga i ati K.B., dhe e ëma D. e gjinisë H. me vendbanim në rrugën “Hoxhë Tasimi” nr.12/7 ,

Në bazë të nenit 73. të KPDM,

PUSHOHET PROCEDURA PENALE

I dëmtuari V.V., për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Shtetërore e Prokurorisë Themelore në Prishtinë , ka paraqitur propozim ndaj të miturit K.B., për shqiptimin e masës edukuese , për arsye se më _____, ka hyrë në shtëpinë e të dëmtuarit e cila ishte e hapur dhe aty ka marrë një telefon Ajfon 5 në vlerë prej 500 €, një palë atlete të markës xhordanka në vlerë prej 100 €, dhe një sako nga lëkura në vlerë prej 150 €, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme, me çka ka kryer veprë penale të vjedhjes të parashikuar nga neni 325 par.1 të KPK.

Ekzistimi i veprës së përshkruar penale të cilën e ka kryer i mituri vërtetohet me pranimin e tij , me dëshminë e të dëmtuarit L.K., dhe me vërtetimin mbi marrjen e sendeve nga i mituri i cili me rastin e kontrollimit të shtëpisë janë gjetur te ai dhe janë kthyer te i dëmtuari.

Në relacion me ekzistimin e veprës penale e cila me propozimin e Prokurorit Shtetëror i vihet ngarkesë të miturit K.B. nuk ka qenë kontestues asnjë fakt, andaj gjykata ka gjetur që ai ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 i KPK.

Në kohën e kryerjes së veprës penale i mituri sipas moshës ishte i mitur i ri ndërsa në kohën e gjykimit ishte bërë madhor i ri.

I mituri rrjedh nga një familje jo e plotë ngase babai i ka vdekë në aksident komunikacioni, jeton me të ëmën dhe 5 fëmijë të mitur, më i vogli i moshës 7 vjeçar dhe këto jetojnë nga një pension prej 150 €.

I mituri është në Shkollën e Mesme të “Bujqësisë”.

Duke vendosur për këtë rast gjykata ka pas parasysh propozimin e Shërbimit Sprovues dhe Qendrës për Punë Sociale dhe duke marrë parasysh vlerësimin e dhënë nga ana e Prokurorit Shtetëror në fjalën përfundimtare, në sjelljen e të miturit pas kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e mirë të tij të tanishme, ka fituar bindje se i mituri nuk do të përsëris veprën penale.

Meqenëse veprën penale e ka kryer si i mitur i ri ndërsa tani është madhor i ri (19 vjeç) gjykata ka gjetur se ndaj madhorit të ri mund të zhvillohet procedura gjyqësore për veprën penale të kryer si i mitur nën moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet vetëm nëse vepra penale është e dënueshme me më shumë se pesë (5) vite burgim, ndërsa për veprën penale nga neni 325 të KPK-ës, për të cilën ngarkohet madhori i ri mund të shqiptohet dënim deri në tri (3) vjet burgim, andaj me aplikimin e nenit 73. par.2. Lidhur me nenin 9 par.1 dhe.2, të KPDM-r, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Në kuptim të nenit 463.par.3 të KPPK-ës, gjykata të dëmtuarin e ka udhëzuar në kontestin civil.

Procesmbajtësi,

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari,

N.H.

F.K.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën së

Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 119

**AKTVENDIMI I TRUPIT GJYKUES PËR TË MITUR PËR PUSHIMIN E
PROCEDURËS PENALE NDAJ TË MITURIT, KUR NUK ËSHTË PROVUAR SE I
MITURI KA KRYER VEPRËN PENALE**

(neni 73. KPDM)

PPM.nr. _____/

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për të Mitur, në trupin gjykues në përbërje prej F.K. kryetar i trupit dhe B.B dhe J.J. anëtarë të trupit, me procesmbajtësen N.H., në çështjen

penale të miturit K.B., për shkak të veprës penale të grabitjes të parashikuar nga neni 329 par.3 lidhur me para.1.lidhur me nenin 31. të KPK-s, me rastin e propozimit për shqiptimin e dënimit me burgim për të mitur, të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit për të mitur PP.nr._____ datë _____, në shqyrtimin e mbajtur më _____, në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Shtetërore K.M., e të miturit K.B., mbrojtësit të tij T.H., avokat nga Prishtina, përfaqësuesit ligjor-nënës së tij L.B., përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë M.M., publikoj këtë ,

A K T V E N D I M

Ndaj të mituri P.T, i lindur më 10.03.1996 , në Prishtinë ku edhe jeton në lagjen “NN” nr .156, nga i ati SH.T dhe e ëma S.T e vajzërisë K, nxënës i klasës së dytë të gjimnazit “NN” në Prishtinë,

PUSHOHET PROCEDURA PENALE

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari L.D. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur propozim për shqiptimin e dënimit me burgim , ndaj të miturit , për arsye se së bashku me dy persona tjerë të paidentifikuar, më datën 15.10.2012 , rreth orës 23 kishin hyrë në minimarketin “Solun” i cili është i dislokuar në rrugën “ Xh.M” nr.23/12 në Prishtinë pronë e të dëmtuarit G.J. i mituri kishte qëndruar para hyrjes së minimarketit për të bërë roje , personat me maska nënë kërcënimin e thikës e kishin detyruar që ta hap kasën dhe tua jap pazarin ditor në shumë prej 3000 €, pas marrjes së parave ishin larguar në drejtim të panjohur, me çka kanë kryer në bashkëveprim me dy persona tjerë veprën penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329.par.3.lidhur me par.1. lidhur me nenin 31. të KPK-s. Pranë këtij propozimi ka mbet deri në fjalë përfundimtare.

I mituri sikundër në procedurën përgatitore ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor , e kishte mohuar kryerjen e veprës penale, ishte mbrojtur se në kohën kur është kryer vepra penale kishte

qenë në Republikën e Shqipërisë, dhe nuk është e vërtetë se ndonjëherë ka biseduar e as që është parë nga dëshmitari natën kritike kur është kryer grabitja , dhe nuk shoqërohej e as komunikon me dëshmitarin , për faktin se ai është problematik, pastaj merret me veprime të ndryshme kriminale .

Dëshmitari F.Z. në procedurën përgatitore kishte deklaruar se ai personalisht e ka vërejtur të miturin duke bërë roje , në kohën kur ai po kthehej në shtëpi nga një ndej , mirëpo nuk e kishte ditur se kënd po e priste , por kur pas disa ditësh kishte hyrë na marketin e të dëmtuarit dhe ai i kishte treguar për këtë grabitjen atij kinse ju kishte kujtuar se atë natë e kishte vërejtur të miturin duke bërë roje, por se edhe në koluare ishte përfolur se njëri nga grabitësit kishte qenë pikërisht i mituri dhe kur ky kishte biseduar me të, ai e kishte pranuar se me dy shokë të tij e kanë grabitur të dëmtuarin por ju kishte kërcënuar se nëse tregon do e pësoj keq.

I dëmtuari XH.M. ka përshkruar mënyrën e kryerjes së grabitjes , mirëpo ai nuk ka mundur t'i identifikoj kryesit e grabitjes, por sipas tij pas një muaj dite tek ai ka ardh dëshmitari FZ.dhe i ka treguar se njëri nga kryesit e grabitjes është i mituri P.T, dhe së bashku me të kanë shkuar në polici dhe i kanë paraqitur këto të dhëna.

Nga anketa sociale e Shërbimit Sprovues të Republikës së Kosovës rezulton: Se i mituri ka lindur dhe rritur në një familje me dy prindërit e arsimuar , të punësuar, me gjendje të mirë ekonomike , është fëmijë i katër i këtyre prindërve , i mituri nuk kishte probleme shëndetësore , në familje ekzistojnë raporte të shëndosha në të gjitha segmentet , gjer më tani i mituri asnjëherë nuk ka treguar ndonjë sjellje devijante, në familje në lagje apo në shkollë. Sipas deklaratës së kujdestarit të klasës i mituri nuk qëndron mirë me mësimet , por ka sjellje të mira në shkollë nuk ka pas asnjë vërejtje nga pedagogët e shkollës.

Nga provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, gjykata vërtetoi këtë gjendje të fakteve: Nuk është kontestuese dy persona të maskuar dhe të paidentifikuar, më datën 15.10.2012 , rreth orës 23 kishin hyrë në minimarketin “Solun” i cili është i dislokuar në rrugën “ Xh.M” nr.23/12 në Prishtinë pronë e të dëmtuarit G.J. dhe nënë kërcënimin e thikës e kishin detyruar që ta hap kasën dhe tua jap pazarin ditor në shumë prej 3000 €, pas marrjes së parave ishin larguar në drejtim të panjohur. Kontestues është fakti se a ishte në mesin e grabitësve edhe i mituri siç pretendon prokurori i shtetit , apo ai nuk ishte fare në shoqërim me personat që kishin grabitur të dëmtuarin ashtu siç pretendon i mituri dhe mbrojtësi i tij. Nga provat e procedura rezulton qartë se i mituri nuk ishte i pranishëm fare natën kritike në Prishtinë, nga se nga raporti nr.____ datë _____ lëshuar nga zyra e pikës kufitare të Morinës, del se i mituri së bashku me prindërit e tij kishin hyrë në Republikën e Shqipërisë më 14.10 2012 dhe ishin kthyer nga Shqipëria më 16.10.2012, por këtë fakt nuk e kishte prezantuar në procedurën përgatitore ngase nuk ju kishte kujtuar bazuar në atë se procedura penale ndaj tij kishte filluar jo në kohën kur ata kishin qenë në Shqipëri por shumë më vonë. Përpos “alibit” që nuk mund të kontestohet , në favor të mbrojtjes së të mitur shkon edhe dëshmia e dëshmitarit F.Z. i cili në shqyrtimin gjyqësor kishte

deklaruar se në procedurën përgatitore kur është pyetur si dëshmitar ka gënjyer, ngase pronari i ka dhënë 20 € për ta informuar atë për kryesit e mundshëm dhe kurrë nuk ka biseduar me të miturin për këtë çështje dhe nuk e dinë se kush kanë qenë personat që e kanë kryer grabitjen, pastaj nga kamerat që kishin regjistruar lëvizjet natën kritike shiheshin dy persona të maskuar por nuk vërehej personi i tretë i pamaskuar siç kishte deklaruar i dëmtuari.

Duke i analizuar provat veç e veç dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën, gjykata erdhi në përfundim se me asnjë provë nuk janë provuar tezat nga propozimi i prokurorit të shtetit se njëri nga grabitësit ishte i mituri, ngase del të jetë fakt i pakontestueshëm se i mituri nuk kishte qenë fare në Prishtinë natën kritike kur është kryer grabitja.

Meqenëse gjykata e pushoi procedurën penale ndaj të miturit, ngase me asnjë provë nuk u provua se ai kishte kryer grabitjen konform nenit 463.par.3 të KPPK-ës, vendosi që shpenzimet e procedurës në shumë prej _____ të mbesin ngarkesë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është bazuar në nenin 75 të KPDM.

Nga të shtruar më lart u vendos si në dispozitiv të aktvendimit në mbështetje të nenit 73.par.2 të KPDM.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

PM.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,
N.H.

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari
F.K.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën së

Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Formulari 120

AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKUESE NDAJ TË MITURIT (neni 27.KPDM)

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për të Mitur, në trupin gjykues në përbërje prej F.K. kryetar i trupit dhe B.B dhe J.J. anëtarë të trupit, me procesmbajtësen N.H., në çështjen penale të miturit K.B., për shkak të veprës penale të vjedhjes parashikuar nga neni 325 par.1 të KPK, me rastin e propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit për të Mitur PP.nr. _____ datë _____, në shqyrtimin e mbajtur më _____, në

prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Shtetërore K.M., e të miturit K.B., mbrojtësit të tij T.H., avokat nga Prishtina, përfaqësuesit ligjor-nënës së tij L.B., përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë M.M., dhe të njëjtën ditë publikoj këtë

A K T V E N D I M

Ndaj të miturit K.B., me nofkën Uragani nga i ati L. dhe e ëma L. e lindur Sh. i lindur më _____ në Prishtinë ku edhe jeton lagja “Vranjevci” nr.15, shtetas i Republikës së Kosovës i pa punë ka kryer shkollën fillore gjendjes së varfër ekonomike, në bazë të nenit 27.par.2. të KPDM,

I SHQIPTOHET MASA EDUKUESE DËRGIMI NË ENTIN EDUKUES NË LIPJAN.

Në entin edukues i mituri do të qëndrojë 1 vit.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesën buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari L.D. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur propozim për shqiptimin e masës edukative dërgimi në Entin Edukues ndaj të miturit K.B, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë parashikuar nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPK. Pranë këtij propozimi ka mbet deri në fjalë përfundimtare.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimit të provave të proceduara gjykata ka vërtetuar:

I mituri K.B., i lindur më _____, ka kryer shkollën fillore dhe nuk ka vazhduar më tutje është i papunë. Pas shkurorëzimit të prindërve të tij , sipas vendimit gjyqësor ai ka ngel të jetojë me nënë të tij, e cila ka qenë e papunësuar. Pas përfundimit të shkollës fillore i mituri nuk ka vazhduar shkollimin e mëtejshëm për shkak të rezultateve të dobëta që ai ka në shkollën fillore.

I mituri me datë _____, diku rreth orës 22,00, ka thyer dritaren e banjës në katin e parë në shtëpinë e dëmtuarit B.B., është futur në banjë pastaj ka depërtua në dhomën e ndejës aty ka gjetur një sirtar i mbyllur me dry ku mbahej ari dhe byzhinteria e të dëmtuarës e ka thyer atë dhe nga kutia ka marrë tre varëse ari në vlerë prej 500 €, ka marrë pesë unaza ari në vlerë prej 450 €, një orë femre e pruar në arë në vlerë prej 300 €, një orë burrash të markës “Rolex” në shumë

prej 2.000 €, dhe ka dal nga shtëpia , dhe pastaj disa nga sendet i ka shit në vende të ndryshme dhe personave të ndryshëm.

Gjendja faktike e përshkruar është vërtetuar nga pranimi i plotë i të miturit, me dëshminë e dëmtuarës , pastaj në bazë të procesverbalit mbi këqyrjen e vendit të ngjarjes fotodokumentacionit të vendit të ngjarjes , dhe në bazë të regjistrit të sendeve të cilat janë gjetur te i mituri.

I mituri është person i shëndosh fizikisht dhe psikikisht, zhvillimi i tij shpirtëror i përgjigjet moshës së tij, me çka është vërtetuar në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit të neuropsikiatrisë S.B.

Në veprimet e të miturit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së rëndë parashikuar nga neni 327 par.1 pika 1.1. të KPK.

Në bazë të provave të proceduara dhe të dhëna të mblledhura rezulton se i mituri në atë masë ka ndërprerë lidhjen me familjen që e ëma nuk është në mundësi që të realizojë çfarëdo mbikëqyrje ndaj tij.

Sipas mendimit të Shërbimit Profesional të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë ndaj të miturit duhet aplikuar masat institucionale edukative.

Duke marrë parasysh peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së saj, moshën e të miturit dhe shkallën e zhvillimit shpirtëror, e cila sipas mendimit të ekspertit i përgjigjet moshës së tij, pastaj se i mituri ka ndërprerë çdo lidhje me prindërit e tij, ashtu që as nëna e as babai të cilët edhe pse janë të ndarë nuk kanë mundësi që të ushtrojnë kurrfarë mbikëqyrje të tij, këtë ata e kanë deklaruar me dëshminë e dhënë gjatë procedurës përgatitore si dhe propozimin e shërbimit profesional të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, gjykata ka ardhur në përfundim se ndaj të miturit duhet shqiptuar masa e dërgimit në Entin Edukues.

Në Entin Edukues i mituri do të qëndrojë 1 vit, dhe me këtë masë sipas vlerësimit të gjykatës më së mirë do arrihet qëllimi i shqiptimit të masave edukuese të përcaktuara me nenin 19.të KPDM.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 75.të KPDM, ndërsa vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontestin civil është i mbështetur në nenin 463.par.3 të KPPK-ës.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI PËR TË MTIUR

PM.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,
N.H.

Kryetari i trupit gjykues-Gjyqtari
F.K.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën së
Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së
aktvendimit.

Formulari 121

AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS EDUKUESE NDAJ TË MITURIT
DËRGIMI NË ENTIN EDUKUES KORREKTUES
(neni 28.KPDM)

PKRM.nr. ____/

Gjykata Themelore në _____, Departamenti për të Mitur, në trupin gjykues në përbërje prej F.K. kryetar i trupit dhe _____ dhe _____. anëtarë të trupit, me procesmbajtësen _____, në çështjen penale të miturit _____, për shkak të veprës penale të vrasjes, të parashikuar nga neni 178 të KPK-s, sipas propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____ - Departamentit për të Mitur PPKRM.nr. _____ datë _____, në shqyrtimin gjyqësor jo publik, i mbajtur më _____, në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Shtetërore _____, e të miturit _____, mbrojtësit të tij _____, avokat nga _____, përfaqësuesit ligjor-babait të tij _____, përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në _____, mori dhe të njëjtën ditë publikoj këtë,

A K T V E N D I M

Ndaj të mituri _____, i biri i _____ dhe _____mbiemri i vajzërisë së nënës _____, i lindur më 10.09.1998,në _____, ku edhe jeton, rruga e “Vellushës” nr._____, shtetas i Kosovës, ka kryer vitin 10 të shkollës së mesme _____, gjendet në paraburgim prej datës _____

SHQIPTOHET MASA EDUKUESE

DËRGIMI NË ENTIN EDUKUES KORREKTUES.

Në entin edukues - korrektues , i mituri do të qëndrojë pesë(5) vite.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesën buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari _____ . për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet në kontestin civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Shtetërore e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur propozim për shqiptimin e masës edukative dërgimi në Entin Edukues Korrektues PPM.nr. _____ datë _____, ndaj të miturit _____ . për shkak veprës penale të vrasjes të parashikuar nga neni 178 të KPK-ës.

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nga i cili ishte i përjashtuar publiku dhe pas dëgjimit të miturit , pastaj të dëmtuarve _____, si dhe provave tjera dhe pas vlerësimit të këtyre provave ka gjetur se i mituri :

Më datën 20.12.2013, rreth orës 16,30, në oborrin e shkollës së mesme , e ka privuar nga jeta të miturin G.M. i lindur më 01.02.1998, të cilin e ka qëlluar katër herë me thikë, me teh të gjatë 12 cm, në pjesën e djathtë të qafës dhe të gjoksit, dhe me këtë i shkaktuar lëndime serioze në arterien e qafës , ku viktimi vdiq si rezultat i gjakderdhjes së brendshme dhe të jashtme të shkaktuara nga prerjet me thikë të organeve vitale.

Version i mbrojtja së të miturit

I mituri e ka pranuar se ka privuar nga jeta bashkë moshatarin e tij G.M. me të cilin po atë ditë (para dite) në oborrin e shkollës kishin pas një përplasje fizike, për shkak të një vaje , por ishte arsyetuar se atë ditë nuk shkoi në shkollë me qëllim që ta sulmoj të ndjerin , por që të sqarohen për konfliktin që kishin pas me të atë dita para momentit tragjik, dhe sipas tij ai në atë moment pa shkas ishte sulmuar nga tani i ndjeri, dhe në mbrojtje e sipër e kishte goditur me thikë .

Vlerësimi i mbrojtjes së të miturit

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të miturit si dhe mendimin e mbrojtësit të tij , dhe ka gjetur se mbrojtja e tyre është e pabazuar , për arsye si në vijim :

Provat e proceduara

Dëshmitarët NN. ka deklaruar se isha duke punuar në oborrin e shkollës , ka vërejtur të miturin S.S. edhe me dy persona tjerë që po pritnin dikë te dalja nga oborri i shkollës, ja ka tërhequr vëmendjen prania e të miturit në oborr të shkollës , ngase atë e ka njohur si nxënës jo të sjellshëm dhe problematik , posa ka rënë zili dhe përfunduar mësimi , të parët që kanë dalë nga shkolla, ka qenë tani i ndjeri me shoqen e tij të klasës V.Z. kur ata kanë arritur te dalja nga oborri i shkollës , pa asnjë shkas dhe pa asnjë bisedë ka sulmuar tani të ndjerin i pandehuri me thikë , i ndjeri ka tentuar të ikë, por nuk ka mundur ta shmang sulmin e të pandehurit, ka vrapuar shpejt ne drejtim të tyre për ta parandaluar goditjen e mëtejme ndaj tani të ndjerit, kur i mituri ka vërejtur dëshmitarin ka ikur , tani i ndjeri është rrëzuar në tokë i mbuluar ë gjake , me shpejtësi e kanë futur në një makinë, por fatkeqësisht ai kishte ndërruar jetë rrugës për në emergjencë. Në mënyrë identike ka deklaruar e dhe V.Z, nxënëse e klasës njëmbëdhjetë të shkollës së mesme _____, e cila kishte deklaruar se të ndjerin e kishte shokë të klasës dhe me të shoqërohej, ndërsa shpeshherë ngacmohej nga tani i pandehuri i mitur në mënyrën më vulgare dhe sipas saj tani i ndjeri shpesh herë i shmangej shoqërimit me të , ngase i kishte frikë të pandehurit të mitur pasi që njihej si problematik, dhe për shkak të sjelljeve të tij ishte përjashtuar nga shkolla. Ditën kritike me të përfunduar mësimi kishin dalë të parët nga klasa me tani të ndjerin, dhe kur ishin ofruar afër daljes nga oborri i shkollës, e kanë vërejtur tani të pandehurin e mitur i cili shoqërohej edhe me dy djem tjerë të cilët nuk i ka njohur , i cili menjëherë e ka sulmuar të ndjerin, ka tentuar të ndërhyj por e ka shtyrë dhe rrëzuar për toke, dhe në shpejtësi e ka goditur disa herë tani të ndjerin, dhe kur në drejtim të tij ka vrapuar roja e shkollës, ka ikur nga vendi i ngjarjes , G. është rrëzuar në tokë duke e mbajtur qafën nga ku i rridhte gjake, me shpejtësi është futur në një makinë por fatkeqësisht gjatë rrugës për në emergjencë kishte vdekur, të ndjerin e ka përshkruar si nxënës të mirë shumë të sjellshëm dhe të edukuar.

Gjykata nuk i ka besuar dëshmisë së të miturit në pjesën ku ai pretendon se u sulmua pa shkas nga tani i ndjeri , ngas dëshmitarët NN. dhe N.N. në mënyrë identike deklaruan se i mituri të ndjerin po e priste tek dera hyrjes për në shkollë, dhe me të arritur aty e ka sulmuar pa i thënë asnjë fjalë të vetme .Dëshmitë e tyre ishin identike dhe objektiviteti i këtyre dëshmitarëve nuk është vënë në mëdyshje me asnjë provë, ngase nuk është kontestuese fakti se i mituri me të tani ndjerin ishin konfliktuar po atë ditë para dite dhe ishte gjakosur nga tani i ndjeri , i cili duke u mbrojtur nga sulmi i paprovokuar i të miturit, e kishte goditur me grusht dhe e kishte gjakosur, kishin intervenuar disa nxënës që ishin aty dhe i kishin ndarë .I mitur ishte larguar nga shkolla ishte armatosur me armë të ftoftë- me thikë dhe e kishte pritur të ndjerin pas përfundimit të mësimit dhe e kishte sulmuar , kjo rrjedhë e ngjarjes nuk është konstatuar nga askush , e që shpi në përfundim logjik se i mituri e sulmoi të ndjerin me thikë pa i dhënë ky asnjë shkas, për shkak përplasjes që kishin mes vete para momentit tragjik.

Deklarimi i përfaqësuesit ligjor të të miturit

Në shqyrtimin gjyqësor është dëgjuar edhe babi i të pandehurit të mitur H.S. i cili ka deklaruar se i mituri është fëmiju i parë i tij, se ka pas një jetë të rregull deri para 2 vitesh, kur i mituri ka filluar të shoqërohet me disa persona me të kaluar kriminale dhe ka filluar që së bashku me ta të kryej veprime të paligjshme, kem bërë përpjekja për ta edukuar mirë dhe për ta shmangur nga kjo rrugë, por fatkeqësisht nuk ja kem arritur, ngase ai përkundër premtimeve të shumta se do tërhiqet definitivisht nga jeta e tilla e parregullt, ai prapë vazhdon me veprime të tilla kriminale (*rrahje të shpeshta, vjedhje, kërcënime etj.*). Kohën e fundit edhe në familje ka filluar të shkaktoj konflikte, me ne si prind të tij por edhe me fëmijët tjerë, ka deklaruar i dëshpëruar se nuk ka asnjë mundësi të ndikoj të i mitur për ta parandaluar në veprime të tilla.

Deklarimi i përfaqësuesit ligjor të të ndjerit

Dëshmitari B.M, baba i të ndjerit G. ka dëshmuar se i akuzuari e kishte kërcënuar disa herë djalin e tij për faktin se ai shoqërohej me shoqen e klasës V.Z. dhe disa herë ka qenë i detyruar që djalin e tij tani të ndjerë ta shoqëroj në shkollë ose nga shkolla në shtëpi, për këtë ka informuar edhe kujdestarin e klasës së të ndjerit edhe babin e të pandehurit të mitur, mirëpo ndaj tij përpos përjashtimit nga shkolla nuk është ndërmarr as një masë tjetër, iu ka bashkangjitur ndjekjes penale dhe ka paraqitur kërkesën pasurore- juridike

Vlerësimi i shërbimit sprovues

Lidhur me personalitetin e të miturit shërbimi sprovues ka përpiluar anketën sociale, ku ne detaje përshkruan personalitetin e të miturit, sipas kësaj ankete rezultoi se i mituri jeton në bashkësi familjare me dy prindërit e tij, një vëlla dhe një motër në _____, në një banesë dy dhomë she me kushte modeste për të jetuar, babi është punëtorë në një kompani sigurim, ndërsa e ama pastruese në një kompani pastrimi, të cilët realizojnë të ardhura solide për një jetë normale. I mituri nuk ka pas ndonjë problem shëndetësor nga lindja e gjer më sot. I mituri qysh në përfundim të shkollës fillore ka shfaqur devijime sociale, si konflikte të shpeshta me shokët e klasës por edhe me arsimtarët e tij, disa herë është qortuar nga drejtoria e shkollës. Shkollën fillore e ka përfunduar me suksese të mjaftueshëm. I mituri është regjistruar në shkollën e mesme _____ në vitin _____ edhe aty ka vazhduar me veprime të njëjta asociale dhe për shkak të një rrahje që kishte shkaktuar në klasë me një nxënës të po asaj klase, si dhe konfliktin fizik me kujdestarin e tij S.V. ai është përjashtuar nga shkolla, me vendimin nr. _____, datë _____.

Ekzaminimi mjekoligjor për llogaritshmërinë e të miturit

I mituri ju kishte nënshtuar observimit neuropsikiatrik, dhe komisioni mjeko ligjor në raportin me shkrim nr.12-2013, datë _____ kishte konstatuar se i mituri i ka të ruajtura qendrat psiko- motorike dhe ka qenë plotësisht i aftë në kohën e kryerjes së veprave penale dhe tani te ai nuk vërehet asnjë defekt në sferën e intelektit “.

Gjykata duke i analizuar të gjitha provat një nga një dhe në lidhshmëri me njëra tjetrën , ka ardh në përfundim se i mituri privoi të ndjerin nga jeta në mënyrën siç u përshkrua më sipër, dhe në rrethana të tilla janë plotësuar të gjitha elementet esenciale të veprës penale të vrasjes , të parashikuar nga neni 178 të KPK-s.

Duke marrë parasysh peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së saj, moshën e të miturit dhe shkallën e zhvillimit shpirtëror, e cila sipas mendimit të ekspertit i përgjigjet moshës së tij, pastaj se i mituri ka manifestuar sjellje të rënda asociale në të gjitha aspekte , manifeston një agresivitet të papërmbajtur edhe nuk heziton të konfliktohet me çdo kënd që ai e vlerëson se po e pengon , shkaktimi i problemeve në familjen e tij , pastaj kryerja e veprave penale të vjedhjeve në vazhdimësi , tregojnë qartë se ndaj tij nuk është e mjaftueshme asnjë masë tjetër, përpos dërgimit në Entin Edukues Korrektues .

Në Entin Edukues i mituri do të qëndrojë pesë(5) vite, dhe me këtë masë sipas vlerësimit të gjykatës më së mirë do arrihet qëllimi i shqiptimit të masave edukuese të përcaktuara me nenin 19.të KPDM.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në nenin 75 të KPPK. ndërsa vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarës në kontestin civil është i mbështetur në nenin 463.par.3 të KPPK-ës.

Nga të shtruarat më lart, në kuptim të nenit 73.par.3.të KPDM, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTNI PËR TË MITURT

PKRM.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i trupit gjykues për të mitur

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, nëpërmjet kësaj gjykate.

Sqarim: Për situatat për të cilat në procedurat ndaj madhorëve (*sipas KPPK-ës*) do merrej aktgjykim lirues apo refuzuese , te të miturit merret aktvendim për pushimin e procedurës (*nuk ka aktgjykim lirues as refuzues*), pastaj kur gjykata të miturit i shqipton cilën do nga masat edukative , i mituri nuk shpallet fajtor dhe përkrimi i veprës penale (*ngjarjes*) nuk bëhet në dispozitiv por në arsyetim. (*neni 73.par. 3i KPDM*)

Formulari 122

AKTVENDIM PËR ZAVENDËSIMIN E MASËS EDUKUESE

(*neni 128.KPDM*)

Gjykata Themelore në Prishtinë në kolegjin për të mitur , në përbërje prej Gjyqtarit K.B. kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve porot J.F. dhe T.H. si anëtar të kolegjit me procesmbajtësen L.A., në çështjen penale të miturit H.G., pas dëgjimit të Prokurorit Shtetëror, të organit të kujdestarisë-Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, të miturit H.G, dhe nënës së tij , në seancën e mbajtur më _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Të miturit H.G, i zëvendësohet masa edukuese, dërgimin në Entit Edukues Korrektues, i shqiptuar me aktvendimin e kësaj gjykate PM.nr. _____ datë _____, me masën edukuese mbikëqyrje e shtuar nga organi i kujdestarisë në Prishtinë, ashtu që kjo masë do të zgjasë 1 vit.

A r s y e t i m i

Qendrës Edukuese Korrektuese në Lipjan, ka kërkuar që masa edukuese e shqiptuar ndaj të miturit nga gjykata, t'i zëvendësohet me një masë më të lehtë, për faktin se i mitur gjatë ekzekutimit të masës edukuese dërgimi në Entin Edukues Korrektues , ka kryer shkollën fillore, ka pas sjellje korrekte me personelin e institucionit por edhe me të miturit tjerë , dhe me përpikëri i ka përbushur të gjitha detyrimet që atij i janë caktuar.

Përpos raportit të Qendrës Edukuese Korrektuese , gjykata ka dëgjuar të miturin, prindin e tij, avokatin mbrojtës, prokurorin dhe shërbimin sprovues , dhe ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për zëvendësimin e masës institucionale me atë të mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë, i parashikuar nga neni 25 par.1 të KPDM-së, për këto arsye:

I mituri H.G, gjatë kësaj kohe ka kryer shkollën fillore, dhe për gjithë kohën që ka qëndruar atje (*për 2 vite*) nuk ka kryer asnjë vepër penale të re, dhe ka pas sjellje shembullore si me personelin po ashtu edhe me të miturit të tjerë , nëna e të miturit B.G, është deklaruar se dëshiron që ajo të kujdeset vet për te dhe ka mundësi që atë edhe ta angazhojë në punë , ndërsa vet i mituri ka dhënë deklarime premtuese se do punësohet, se kur më nuk do të kryej vepër penale, prokurori shtetit ne mendimin e tij është shprehur se është e panevojshme që i mituri të qëndroj edhe më tej në Entin Edukues Korrektues , edhe shërbimi sprovues, duke pasur parasysh sjelljet e të miturit në institucion dhe jetën e mëparshme të të miturit , ka shprehur mendimin se janë plotësuar kushtet për zëvendësimin e masës ndaj të mituri.

Për arsyet e përshkruara më sipër , gjykata gjen se me aplikimin e masës edukuese mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë, do të arrihet qëllimi i shqiptimi të masave edukuese ndaj të miturit , i cili së shpejti do arrijë moshën madhore , ai njëkohësisht do jetë i detyruar që t'i përmbahet planit dhe programit të përpiluar nga Shërbimi Sprovues në Prishtinë, në të kundërtën , gjykata është e autorizuar që përsëri t'i shqiptojë masën e dërgimit në Entin Edukues Korrektues.

Duke gjetur se me masën edukuese të mbikëqyrjes së shtuar nga organi i kujdestarisë nga neni 25 par.1 të KPDM-r, do të realizohet qëllimi i shqiptimit masa edukuese, të parashikuara nga neni 19 të KPDM-r, gjykata në bazë të nenit 128 par.5 të KPDM-r, vendosi si në dispozitiv të aktvendimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

PM.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetari trupit gjykues për të mitur

L.A.

K.B.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e

Apelit në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas marrjes së aktvendimit

nëpërmjet kësaj gjykate.

Formulari 123

AKTVENDIM PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT TË MASËS EDUKATIVE (neni 128 KPDM)

Gjykata Themelore në Prishtinë në kolegjin për të mitur në përbërje prej Gjyqtarit K.B. kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve porot J.F. dhe T.H. si anëtar të kolegjit me procesmbajtësen L.A., në çështjen penale të miturit D.M., pas dëgjimit të Prokurorit Shtetëror, të organit të kujdestarisë-Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë, të miturit D.M. dhe nënës së tij, në seancën e mbajtur më _____, mur këtë:

A K T V E N D I M

Pushohet ekzekutimi i masës edukuese dërgimi në Entin Edukues Korrektues, ndaj të miturit D.M., nga Prishtina, i shqiptuar me aktvendimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për të Mitur në Prishtinë PM.nr.20/2012 datë 05.10.2012.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për të Mitur, me aktvendimin PM.nr.20/2012 datë 05.10.2012, ndaj të miturit D.M., nga Prishtina, ka shqiptuar masën edukative dërgimin në Entin Edukues Korrektues në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh, për shkak të veprës penale të grabitjes parashikuar nga neni 329 par.1 të KPK. I mituri është pranuar në Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan më 15.05.2013.

Drejtori i Qendrës Edukuese Korrektuese me parashtresën nr.10/2014 të datës 15.11.2014, ka paraqitur propozim që të pushohet ekzekutimi i mëtejshëm i masës edukuese korrektuese ndaj të miturit, nga se vlerëson se është arritur sukses përkritazi me riedukimin e të miturit D.M., i cili në ent me sukses ka kryer zejen e metalo gdhendësit dhe ka arritur kualifikimin metalo -gdhendës.

Prokurori i Shtetit në Prishtinë, prindërit e të miturit dhe organi i kujdestarisë, kanë përkrahur propozimin e Drejtorisë së Entit.

Duke vendosur sipas propozimit të Drejtorisë së Entit Edukues Korrektues në Lipjan gjykata ka gjetur:

Propozimi është i bazuar.

I mituri D.M., ka kaluar në Entin Edukues Korrektues 2 vite dhe i ka mbushur 19 vjet. Në ent ka kryer zejen e metalo gdhendësit dhe është pajisur me diplomë për këtë zeje. Gjatë kohës së qëndrimit në ent, ka pas sjellje shembullore dhe ka arritur shprehi pune. Absolutisht janë evituar sjelljet e tija asociale për të cilat ai ka qenë i dërguar në Entin Edukues Korrektues. Në ent në tërësi është arritur riedukimi dhe risocializimi i të miturit si dhe aftësimi i tij përjetë dhe punë të pavarur.

Meqenëse janë përmbushur kushtet nga neni **129 par.5 të KPDM-r**, (*kanë pushuar arsyet për aplikimin e mëtejme të masës edukative institucionale*), u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTI PËR TË MITUR

PM.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,

Kryetari trupit gjykues për të mitur

L.A.

K.B.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e

Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditësh pas marrjes së
aktvendimit nëpërmjet kësaj gjykate.

Formulari 124

PROPOZIM PËR DËNIM NDAJ TË MITURIT
(*neni 63 kpdm*)

PROKUROIA E SHTETIT E PROKURORISË THEMELORE

PPM.nr. _____

Më. _____

PRISHTINË

GJYKATËS THEMELORE _____

TRUPIT GJYKUES PËR TË MITUR

PRISHTINË

Në bazë të nenit 63 të KPDM-r, paraqes këtë :

PROPOZIM PËR DËNIM

Ndaj të miturit L.K. i lindur më _____ në _____ nga i ati B. dhe e ëma Z. e gjinisë K. Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës me vendbanim të përhershëm në Prishtinë rr. _____ nr. _____, ka kryer shkollën fillore nuk ka vazhduar shkollimin e mesëm gjer më tani nuk është shqiptuar ndonjë masë edukative ose burgim për të mitur, për arsye se,

Për arsye se më datë _____, rreth orës 21,00, afër shkollës së mesme “Sami Frashëri” në Prishtinë ka pritur të dëmtuarën e cila po kthehej nga shkolla në shtëpi dhe një vend ku nuk kishte ndriçim ka sulmuar atë nga dora i ka rrëmbyer një zingjirë dore të arit në vlerë prej 300 €, pastaj një varëse të arit nga qafa në vlerë prej 250€, me dhunë i ka marrë çantën në të cilën ajo kishte një telefon Ajfon 5S në vlerë prej 500 €, me qëllimi të vetit t'i sjellë përfitim të kundërligjshëm ligjor.

Me këtë ka kryer vepër penale të grabitjes, të parashikuar nga neni 329 par.1 i KPK, për këtë,

PROPOZOJ

Që në kuptim të nenit _____ të KPDM-r, pranë kësaj Gjykate të caktohet dhe të mbahet shqyrtimi gjyqësor, në të cilin duhet ftohen.

1. Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë,

2. I mituri L.K.

3. Mbrojtësi i të miturit R.T.

4. Prindërit e të miturit sipas adresës nga shkresat e lëndës. 5. Përfaqësuesi i Shërbimit Sprovues i Kosovës.

6. Përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë.

Që në procedurën provuese të lexohen: **a).** vërtetimi për dorëzimin e sendeve të dëmtuarës me datë _____, **b).** procesverbali mbi dëgjimin e të dëmtuarës, **c).** raportit për identifikimin e gjurmëve të gishtrinjëve (*vijave papilare*) nga i mituri L.K., **d).** raportit të amnezës sociale të cilën e ka bërë Qendra Sociale në Prishtinë.

A r s y e t i m i

Në këtë çështje penale është zhvilluar procedura përgatitore ndaj të miturit L.K, dhe i mituri pasi që është ballafaquar me prova të pakontestueshme ka pranuar në tërësi veprën penale, me arsyetim se për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike ai ka qenë i detyruar të braktisë shkollën dhe pastaj të merret me veprime kriminele.

I mituri veprën penale e ka kryer si i mitur i rritur, rrjedh nga një familje e plotë, babai i tij është i punësuar një kompani private si roje sigurimit dhe realizon të ardhura mujore prej 250 € në muaj, dhe me këtë pagë mbanë familjen 5 anëtarëshe, ndërsa të ëmën e ka amvise dhe nuk e kanë çështjen e zgjidhur të banimit por jetojnë në një shtëpi me qira.

Nga amneza sociale rezulton se i mituri ka qenë nxënës i dobët i shkollës fillore, ka pas mungesa të shumta dhe konflikte të shpeshta me personelin e shkollës, gjithashtu edhe si fëmijë në moshën 14 vjeçare sipas tregimeve të Drejtorit të Shkollës Fillore “Elena Gjika” në Prishtinë ai ka treguar prirje kriminele, për faktin se disa herë u ka vjedh sende personale nga çana e nxënësve, dhe për shkak të sjelljeve të tij janë shqiptuar masa disiplinore në kuadër të shkollës, e meqenëse këto masa nuk kanë arritur efektin e duhur, por ai ka vazhduar me sjellje të njëjta, i mituri definitivisht është përjashtuar nga shkolla me datë _____.

Nga raporti i psikologut rezulton se zhvillimi shpirtëror i të miturit sillet në kufij të moshës së tij.

Duke pas parasysh personalitetin e të miturit sjelljen e gjertanishme të tij shkallën e përgjegjësisë penale, si dhe peshën e veprës së kryer penale, propozojmë që ndaj të shqiptohet dënimi, ngase asnjë masë tjetër nuk do kishte efekte në aspektin e risocializimit dhe përmirësimit të të miturit.

Nga të shtruarat ky propozim është i arsyeshëm dhe në ligj i bazuar.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në Prishtinë

T.L.

Formulari 125

AKTGJYKIM ME TË CILIN TË MITURIT I SHQIPTOHET DËNIMI (neni 73. KPDM)

PM.nr. _____

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për të Mitur, në trupin gjykues për të mitur në përbërje prej gjyqtari Sh.M. si kryetar trupi dhe gjyqtarëve porot L.M. dhe H.B., si anëtar të trupit , me procesmbajtësen S.K. , në çështjen penale e të miturit V.K., nga Prishtina, për shkak të veprës penale të grabitjes të parashikuar nga neni 329 par.3.lidhur me par.1. të KPK, me rastin e propozimit të Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për të Mitur për dënim, PPM.nr.____ datë____, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nga i cili ka qenë i përjashtuar publiku , i mbajtur më _____, në prezencën e Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në Prishtinë M.K., e të miturit , mbrojtësit të tij B.B, avokat nga Prishtina, babait të të miturit dhe përfaqësuesit të Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë N.K, mori dhe të njëjtën ditë publikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I mituri V.K., i lindur më _____, në Prishtinë, nga i ati B.K, dhe nëna L.K., e vajzërisë M., Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, me vendbanim në rrugën “Xhemajl Mustafa” nr.25/2 , ka kryer Shkollën Filllore , në paraburgim prej _____,

ËSHTE FAJTOR

1.Për arsye se me datë _____, rreth orës 24,00, duke vepruar si grup së bashku me të fëmijët S.S. dhe R.S(*që të dy nën moshën 14 vjeçare*), kanë sulmuar S.P., i cili vet dhe i dehur po kthehej në atë kohë nga kafeneja, dhe duke përdorë forcën –duke e goditur me grushta , kanë marrë nga ai , orën e dorës të markës “Kontinental” në vlerë prej 300 €, dhe një telefon mobil të markës “Samsung” në vlerë prej 200 €, me qëllim që vetit t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme.

Me çka ka kryer veprë penale të grabitjes të parashikuar nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPK.

2.Me datë _____ rreth orës 10,00, me S.S. dhe R.S(*nën moshën 14.vjeçare*), në Prishtinë , afër Muzeut të Kosovës , në rrugën që shpie te xhamia e madhe, kanë pritë të dëmtuarat L.K. dhe H.K., dhe që të dyjave me dhunë ua kanë marrë çantat e dorës, në të cilat ato kishin secila nga një telefon mobil të markës “Ajfon 4” , në vlerë prej nga 100 €, dhe nga një portofol me kartela krediti dhe para të gatshme e dëmtuara S.S. 200 €, ndërsa e dëmtuara R.S. 50 €, me qëllim që vetit t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme.

Me çka ka kryer veprë penale të grabitjes të parashikuar nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 të KPK.

3.Me datën _____ rreth orës 21,00, po me të njëjtit persona kanë thyer me dhunë derën e banesës së të dëmtuarit B.L., ku ai dhe anëtarët e familjes nuk ndodheshin në banesë, dhe aty nga sirtarët e një tavoline ka marrë 5 unaza , 1 varëse qafe me dimensione 1.5 metra në vlerë të përgjithshme prej 1.000 €, me qëllim që vetit t’i sjellë përfitim të dobisë pasurore.

Me çka ka kryer veprë penale vjedhje të rëndë, parashikuar nga neni 327 par.1 pika 1.1 të KPK.

Andaj gjykata në bazë të nenit 73.par.4. të KPDM, nenit 365 të KPPK-ës,

E GJYKON

Me dënim burgimi për të mitur në kohëzgjatje prej dy (2)vitesh.

Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej ___dhe tutje.

I mituri obligohet që t’i paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 250 €, dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Shtetërore e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ka paraqitur propozim për dënim PPM.nr. _____ datë _____, ndaj të miturit V.K. për shkak dy veprave penale të grabitjes të parashikuar nga neni 329 par.3.lidhur me par.1. të KPK-ës, pranë këtij propozimi ka ngel edhe në fjalën përfundimtare.

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor nga i cili ishte i përjashtuar publiku dhe pas dëgjimit të miturit V.K., pastaj të dëmtuarve S.P, L.K., H.K dhe B.L, si dhe provave tjera dhe pas vlerësimit të këtyre provave ka gjetur se i mituri V.K., ka kryer veprën penale e cila është përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit.

I mituri si në procedurën përgatitore po ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar se ka kryer grabitjen edhe në rastin e parë edhe në rastin e dytë së bashku me dy të fëmijët tjerë të cilët ishin nën *moshën 14 vjeçare*, mirëpo ishte mbrojtur se grabitja nuk ishte e planifikuar, por kishte ndodhur rastësisht për faktin se ai ishte në vështirësi të mëdha ekonomike , i ka shkëputur të gjitha relacionet me prindërit e tij të cilët janë ndarë dhe më tepër jetonte te xhaxhai përkatësisht te dajët e tij, dhe duke jetuar në këto kushte e kanë detyruar që të ndërmarrë këto veprime kriminale.

Gjykata ka vlerësuar mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtësit e tij dhe ka gjetur se mbrojtja është e pabazuar në pjesën ku i mituri deklaroi se nuk e kishte planifikuar grabitjen, për arsyet si në vijim :

I dëmtuari S.P., ka përshkruar se mbrëmjen kritike ai po kthehej nga një kafene dhe ishte pak i dehur , kishte vërejtur të miturin me dy persona tjerë që po pritnin skaj rrugës, dhe në momentin kur është afruar afër tyre që të tre e kanë sulmuar furishëm dhe sendet ia ka marrë i mituri i cili ishte edhe më i rritur, po edhe fizikisht më i fuqishëm se dy tjerë , sipas këtij të dëmtuari po nga ky i mitur ka marrë edhe goditje të shumta në trup. Në të njëjtën mënyrë janë deklaruar edhe dy të dëmtuarat L.K. dhe H.K., kanë deklaruar se mbrëmjen kritike po ktheheshin nga shkolla nga se mësonin në turnin e tretë dhe pak para arritjes në vendin kritik, kanë vërejtur në formë suliete(*hije*) personat që po pritshin skaj rrugës, në fillim kanë menduar se ato po loznin , mirëpo kur janë afruar aty ato me shpejtësi kanë dalë nga errësira i kanë sulmuar dhe ua kanë marrë me dhuna çantat si dhe sendet me vlerë nga trupi, kanë deklaruar se është dalluar për sjellje të vrazhda, arrogancë dhe paskrupullsi i mituri , i cili nga sharjet, kërcënimet, goditjet, ka shkaktuar tmerr tek ato dhe akoma i ndiejnë pasojat e këtij sulmi, sipas tyre nga pozicioni ku ishin të vendosur këta tre persona linte përshtypje se ato kishin organizuar prit apriori me qëllim që të presin viktimat kur të kalojnë aty pari, meqenëse ishte vend më pak i frekuentuar dhe i

përshtatshëm për t'i sulmuar dhe për t'i grabitur kalimtarët . Në atë pjesë edhe para rastit kritik ka ngjarë disa grabitje, në mënyrë të njëjtë janë sulmuar nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore dhe janë grabitur, sipas gjitha gjasave ky ka qenë grupi i njëjtë i cili ka kryer aktivitete kriminele në atë pjesë, sipas deklaramit të tyre nga momenti që ky i mitur është arrestuar në këtë pjesë më nuk ka ngjarë grabitje të tilla.

Meqenëse vepra penale është kryer në përbërje të grupit, sipas vlerësimit të gjykatës me veprimet e të miturit V.K., përmbahen të gjitha elementet e veprës penale të grabitjes parashikuar nga neni 329 par.3 lidhur me par.1. të KPK-ës.

Nga amneza sociale që ka përpiluar shërbimi profesional i Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë nr.____ datë _____, rezulton se i mituri rrjedh nga një familje prindërit e të cilit janë divorcuar dhe sipas vendimit gjyqësor i mituri ka ngel nën përkujdesje të nënës së tij e cila nuk është e punësuar, gjithashtu nga kjo amnezë rezulton se i mituri kahe ka treguar devijime asociale duke shkaktuar probleme të kohëpaskohshme në shkollë në formë të konfliktit me shokët me arsimtarët e tij pastaj nuk kanë qenë raste të rralla kur ai ka marrë gjësende nëpër çanta të nxënësve, ashtu që nga raporti që kjo qendër ka marrë nga drejtoria e shkollës del se ndaj tij disa herë janë shqyrtuar vërejtjet si dhe para përjashtim nga shkolla. Për shkak të sjelljes së të miturit në shkollë disa herë janë ftuar në bisedë edhe prindërit e tij, por ata kanë deklaruar se përkundër përpjekjeve që ato po bëjnë për ta shmangë të miturin nga këto sjellje devijante deri më tani nuk ia kanë arritur. I mituri së fundi po thuhet se ka shkëput kontaktet me prindërit e tij dhe më tepër është dhënë bredhjeve, rrugëve, lokaleve të natës konflikteve të ndryshme deri dhe te përplasja me policinë , dhe se ata(*prindërit*) nuk kanë asnjë mundësi që të ndikojnë te i mituri që ai të përmirësohet përkatësisht që të shmanget nga sjelljet e tij asociale.

Shërbimi profesional i Qendrës për Punë Sociale është i mendimit se duke pas parasysh shkallën e devijimit asocial të të miturit pastaj bredhjet e tij nga një qytet në qytet tjetër, shkëputjet absolute të kontakteve me prindërit e tij dhe me familjarët e tij, çdo masë edukative do ishte pa efekt në rrethana të këtilla, dhe sipas këtij shërbimi vetëm dënimi me burgim mund të kishte efekt pozitiv në drejtim të rehabilitimit dhe resocializimit të të miturit.

Gjykata ka gjetur se në rrethana të këtilla janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që ndaj të miturit t'i shqiptohet dënimi me burgim për të mitur , duke vlerësuar se burgimi kohor prej 2 vitesh është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për arritjen e qëllimit të shqiptimit të sanksionit penal dhe konsideron se kjo kohë është e mjaftueshme që ai të përmirësohet , dhe të kthehet si anëtarë i dobishëm i shoqërisë

Gjykata në bazë të nenit 83.të KPK-ës, të miturit në dënimin e shqiptuar i ka llogaritur edhe kohën në paraburgim prej _____ e tutje.

Meqenëse të dhënat në këtë procedurë nuk kanë afuar bazë të mjaftueshme për vendimin në pikëpamje të kërkesës pasurore juridike, gjykata në bazë të nenit 463.par.3.të KPPK-ës , i ka udhëzuar të dëmtuarit në kontest civil për realizimin e kërkesave të tyre.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në nenin 75. të KPDM-ës.

Nga të shtruarat më lart, në kuptim të nenit 73.par.4.të KPDM-r, dhe nenit 365 të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTNI PËR TË MITUR,

PM.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi,

S.K.

Kryetari i trupit gjykues për të mitur,

Sh.M.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit

në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh pas marrjes së aktgjykimit

nëpërmjet kësaj gjykate.

Sqarim: 1.Për vepra penale në bashkim gjykata shqipton vetëm një masë edukative ose vetëm dënim me burgim për të mitur kur kushtet ligjore për shqiptimin e dënimit të tillë janë përmbushur dhe gjykata konstaton se ai duhet të shqiptohet, në të njëjtën mënyrë veprohet edhe në rastet kur i mituri ka kryer vepër tjetër penale para ose pas shqiptimit të masës edukative ose të burgimit për të mitur(*neni 37 i KPDM*). Dmth. për bashkim veprash penale ndaj të miturit nuk aplikohen dispozitat e nenit 80 të KPK-ës , për shqiptimin e dënimit unik ndaj kryeseve madhorë .

2.Gjykata mund ta obligoj të miturin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe për kompensimin e dëmit që i ka shkaktuar të dëmtuarit vetëm nëse i ka shqiptuar dënim , por jo edhe kur i ka shqiptuar masat edukative, mirëpo nëse i mituri ka të ardhura të veta financiare ose pronë, gjykata mund ta urdhërojë të miturin t'i paguajë shpenzimet e procedurës dhe ta plotësojë kërkesën pasuroro- juridike madje edhe kur është shqiptuar masa edukative.

PROCEDURAT E VEÇANTA

Formulari 126

NJË FORMË E AKTGJYKIMIT PËR DHËNIEN E URDHËRIT NDËSHKIMOR (neni 495)

PDP.nr. ____/

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE _____, përmes gjyqtarit .N, me sekretaren juridike N, në lëndën penale kundër të pandehurit N, nga fshati _____, komuna e _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes në tentativë , të parashikuar nga neni 325 par. 2. Lidhur me neni 28 të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorit të Prokurorisë Themelore _____ PP.nr. ____ të datës _____, duke vendosur sipas kërkesës së PPK _____ për dhënie e urdhrit ndëshkimor, më datën _____, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari N, i lindur më N, në _____, student i viti të IV.të fakultetit _____ me vendbanim në fshatin _____, komuna e _____, shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, gjer më tani i padënuar ,

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se me datë _____, rreth orës 10,00 është futur në parfumerinë “ Boos ” me seli në _____, dhe duke e shfrytëzuar mungesën e punëtores N. e cila kishte dalë në fqinjësi , me qëllim që vetit t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme ka marrë 1 parfum të llojit “Calvin Klein” 100 ml. në vlerë prej 40€ dhe ka dal jashtë, por aty është ndaluar nga roja e një lokali tjetër është thirrë policia dhe pas kontrollit të çantës së saj i është gjetur parfumi i vjedhë.

-me çka ka kryer veprën penale të vjedhjes në tentativë , të parashikuar nga neni 325 par. 2. Lidhur me nenin 28 të KPK-ës,

Andaj, në bazë të neneve 495 të KPPK-ës, si dhe nenit 325.par.2.të KPK-ës, të akuzuarit i shqipton ,

URDHËRIN NDËSHKIMOR

Dënim me gjobë në shumë prej 300 €, (treqind euro) të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri dënim me gjobë nuk e paguan në afatin e lënë i nijeti do t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që çdo 20 € do t'i llogaritet një dit burgim.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj në emër të paushallit gjyqësor 20 €,

A r s y e t i m i

Prokurori i Prokurorisë Themelore në _____, me aktakuzën PP.nr. ____ datë _____, ka akuzuar të pandehurin N.N. nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes në tentativë , të parashikuar nga neni 325 par. 2. Lidhur me nenin 28.të KPK-ës , dhe ka propozuar që ndaj të pandehurit t'i shqiptohet urdhri ndëshkimor dënim me gjobë.

Gjykata pasi shqyrtoi aktakuzën dhe provat në të cilat është mbështetur aktakuza, vendosi që të shqiptoj urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të aktgjykimit, ngase në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor.

Nga shkresat e çështjet nuk dalin kontestuese faktet se i pandehuri ka marr parfumin me qëllim të përvetësimit të tij , edhe pse ai në deklarin e dhënë në polici është mbrojtur se i duhej urgjent një parfum dhe meqë nuk ishte punëtorja në dyqan e mori atë me qëllim që më pas të kthehet e të bëjë pagesën, ngase nga dëshmia e dëshmitarit N. roje e lokaleve që gjenden në këtë kompleks tregtar tek “qafa” rezulton se i pandehuri e ka përcjellë punëtoren N. e cila ka shkuar tek një shoqe e saj , i pandehuri është futë në shpejtësi në lokal gjithnjë duke e përqendruar shikimin ka punëtorja, se mos po kthehet , e ka marr parfumin e ka futë në gji dhe me nxitim ka dal jashtë ku është ndal nga roja , dhe nuk ka pranuar fare se ishte në lokal por meqenëse kishte rastisë afër një patrullë policia , i pandehuri është ndalur është futë në një lokal dhe ati ka pranuar se ka marr këtë parfumin .

Gjykata me rastin e caktimit të dënimit mori për bazë peshën e veprës penale, rrethanat personale të kryesit , rezulton se ai për herë të parë kishte ardh në konflikt me ligjin , gjendjen materiale të të pandehurit , është i papunë (student) por veçmas pasojën , nuk kishte dëm për të dëmtuarin , ngase parfumi iu mur dhe ju kthye pronarit po atë ditë, dhe e dënoi si në dispozitiv me bindje se me këtë dënim do arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksioneve penale në dimensionin individual dhe atë gjeneral.

Me rastin e matjes së paushallit gjyqësor gjykata ka marrë parasysh ndërlukshmërinë dhe kohëzgjatjen e procedurës, si dhe rrethanat pasurore të të pandehurit, në kuptim të nenit 450 par. 3.të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Datë ____ P.nr. ____ / ____

Procesmbajtësi,

Gjyqtari,

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri ka të drejtë kundërshtimi, në

afat prej 8 ditësh kësaj gjykate.

Sqarim:

Nëse i akuzuari ka paraqitur kundërshtim kundër aktgjykimit për dhënin e urdhrit ndëshkimor , me rastin e vendosjes së çështjes në shqyrtim gjyqësor, duhet të vendoset edhe për aktgjykimin e mëhershëm për dhënien e urdhrit ndëshkimor. Nëse nuk sqarohet çështja e aktgjykimit për dhënien e urdhrit ndëshkimor, atëherë për çështjen e njëjtë do i kishim dy aktgjykime në fuqi .

Formulari 127

AKVENDIM PËR SHQIPTIMIN E VËREJTJES GJYQËSORE
(neni 498. KPPK)

P.nr. ____/ __

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në _____ gjyqtari i vetëm N.N. me procesmbajtësin N.N. , në çështjen penale e të pandehurës N.N. nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325 par. 2. të KPK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____, PP.nr. ____ datë ____, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e Prokurorit N.N. dhe të pandehurit mori dhe po të njëjtën ditë shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura N.N. nga _____

ËSHTË FAJTORE

Për arsye se me datë _____, rreth orës 10,00 në marketin “Driloni” në _____, me qëllim që vetit t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme ka marrë 4 çokollata 3 pako mish në sasi prej 3 kilogramësh , në atë mënyrë që sendet e përmendura i ka vendosur në çantën dhe i ka dhënë djalit të saj të mitur me qëllim që ai këto t’i nxjerr nga marketi pa i paguar dhe me këtë ka kryer veprë penale vjedhje të parashikuar nga neni 325.par.2. të KPK-ës ,

Andaj gjykata, në bazë të nenit i 498 të KPPK-s, lidhur me nenin 86 të KPK-ës, të pandehurës i *sh q i p t o n*,

VËREJTJEN GJYQËSORE

E pandehura është detyruar në emër të shpenzimeve gjyqësor të paguajë 20 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor 5 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m i

Prokurori i Prokurorisë Themelore në _____, me aktakuzën PP.nr. ____ datë ____, ka akuzuar të pandehurës N.N. nga _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes, të parashikuar nga neni 325 par. 2. të KPK-ës . Pranë aktakuzës ka ngelur deri në përfundimin e shqiptimit gjyqësor përfaqësuesi i saj.

E pandehura në mbrojtjen e saj ka theksuar se i ka përvetësuar sendet e theksuar në propozim akuzë , por këtë e ka bërë për faktin se ka gjendje të vështirë ekonomike , nga se është e papunësuar, ka në mbajtje bashkëshortin e sëmurë dhe 5 fëmijë . Me rastin e pranimit të veprës penale e pandehura ka shprehur pendim të thellë për këtë veprim të paligjshëm.

Mbrojtjen e të pandehurës e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët H.H. dhe J.K. të cilët e kanë vërejtur vjedhjen kur i pandehuri çantën ia dha djalit të saj të mitur , i cili të njëjtën e ka nxjerr jashtë parketit.

E pandehua me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore ka marrë sendin e huaj të luajtshëm në vlerë prej 14 €, ashtu që në veprimet e saja qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes , të parashikuar nga neni 325 par. 2. të KPK-ës

E pandehura gjer më tani nuk ka qenë i dënuar , është e papunësuar ka në mbajtje bashkëshortin e papunë, të sëmurë dhe 5 fëmijë të mitur, më i madhi i moshës 8 vjeçar , veprën penale e ka pranuar , të cilën rrethanë gjykata i ka marrë si rrethanë lehtësuese , dhe ka ardhur në përfundim se vepra penale është kryer në rrethana të tilla lehtësuese , e që veprën e bëjnë veçanërisht të lehtë, për ç' arsye të pandehurës i ka shqiptuar vërejtjen gjyqësore, në kuptim të nenit 498. të KPPK, lidhur me nenin 86 të KPK-ës.

Në bazë të nenit 453 të KPPK-ës e pandehura është obliguar që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj 20 €, aq sa i janë paguar edhe dëshmitarëve të dëgjuar.

Me rastin e matjes së paushallit gjyqësor gjykata ka marrë parasysh ndërlukushmërinë dhe kohëzgjatjen e procedurës, si dhe rrethanat pasurore të të pandehurit, në kuptim të nenit 450 par. 3. të KPPK.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Datë ____ P.nr. ____ / ____

Procesmbajtësi,

Gjyqtari,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në Gjykatën e

Apelit , në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Sqarim: Me ish ligjin e procedurës penale që ishte në fuqi deri në vitin 2004 në Kosovë, vërejtja gjyqësore shqiptohet me aktvendim, ku i pandehuri nuk shpallet fajtorë, tani me Kodin e ri të Procedurës Penale, vërejtja gjyqësore shqiptohet me aktgjykim, për këtë arsye i pandehuri duhet të shpallet fajtor , kështu shprehet edhe dispozita e nenit 499 paragrafi 2. Të KPPK-ës.

Formulari 128

PROKURORIA THEMELORE –DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA NË

PPKR.nr. _____

Dt. _____

GJYKATËS THEMELORE –DEPARTAMENTIT PËR

KRIME TË RËNDA _____

Në bazë të nenit 512. të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 89 të KPK-s, paraqesë këtë:

**PROPOZIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM
PSIKIATRIK ME NDALIM NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR**

Ndaj: NN., nga i ati N. dhe e ëma N e gjinisë N. i lindur më , në _____ku edhe tani jeton, lagja “_____” rruga “_____” nr.4, i pa martuar, ka në paraburgim prej dt._____

S E P S E

I dëmtuari, dr. P.L., gjatë viti 2012-2013 disa herë ka ekzaminuar të pandehurin dhe ka konstatuar se ai është psikikisht i sëmurë, e të cilën diagnoz i pandehuri e ka konstatuar jo të saktë dhe për këtë ai më 20.shtator 2013 e ka pritur të dëmtuarin në koridorin e spitalit neuropsikiatrik, nga parapa e ka goditur me thikë në pjesën e djathtë të kraharorit , duke i shkaktuar plagë shpuese 4.cm, dhe pas kësaj është larguar në drejtim të panjohur, të dëmtuarit i është dhënë ndihma mjekësore ne emergjencë në qendrën spitalore në _____, e pastaj si rast urgjent është dërguar në QKUK-s , ku ka qëndruar për shërim një muaj ditë.

Me këtë ka kryer veprën penale vrasje në tentativë të parashikuar nga neni 178.lidhur me nenin 28 të KPK-s.

Andaj,

PROPOZOJ

-Të caktohet seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën të ftohen:

-Prokurori i shtetit i prokurorisë themelore në _____.

-I pandehuri NNi cili për momentin gjendet në paraburgim në _____,

-I dëmtuari-dëshmitari NN.ga _____ lagja _____,rruga “_____” nr. 4.

-Prindërit e të pandehurit: _____ nga _____ lagja _____,rruga “_____” nr. 4.

-Ekspertët e psikiatrisë nga Klinika e psikiatrisë të QKUK në Prishtinë:Dr.NN. ,Dr.NN. dhe Dr. NN.

Gjatë procedurës së administrimit të provave të nxirren si prova:

- fotodokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës e që i referohet vendit të ngjarjes,
- mjete me të cilën është kryer vepra penale-thika e cila është e bashkangjitur në shkresa të lëndës,
- Mendimi i ekspertit mjeko-ligjor dr. _____ lidhur me llojin dhe natyrën e lëndimeve të shkaktuara trupore të të dëmtuarit _____
- raporti mbi gjendjen e shëndetit mendor të pandehurit _____, përpiluar nga ekspertët e Klinikës së Psikiatrisë me nr.prot. _____ i dt. _____ si dhe
- dokumentacioni mbi trajtimin e mëparshëm mjekësor që i referohet të pandehurit _____.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të pandehurit NN. të i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

A r s y e t i m i

Gjatë hetimeve të zbatuara ndaj të pandehurit NN. është vërtetuar se ai , më datë _____ e ka pritur të korridorin e klinikës neuropsikiatrike të dëmtuarin dr. _____, i cili gjatë vitit _____ disa herë e kishte kontrolluar dhe kur i dëmtuar ka ardhur, e ka sulmuar duke e goditur me thikë në pjesën e djathtë të kraharorit , me që rast i shkaktuar plagë shpuese 4.cm, dhe pas kësaj është larguar në drejtim të panjohur.

I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk ka dëshiruar që të dëmtuarin ta privojë nga jeta por vetëm ta lëndojë lehtë nga se nuk është pajtuar me vlerësimet e të dëmtuarit si neuropsikiatër përkitazi me gjendjen shpirtërore të tij, pasi që, me diagnozën e dhen e ka shpallë atë të çmendur, dhe me këtë i ka shkaktuar dëm të madh dhe i ka pamundësuar jetë normale në komunitet.

Gjatë hetimit të pandehurin e ka ekzaminuar ekipi mjeko-ligjor të neuropsikiatrisë dhe psikologut dhe është konstatuar se i pandehuri vuan nga psikoza paranoike , dhe për këtë në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë absolutisht i pallogaritshëm, nga se nuk ka mund ta kuptojë rëndësinë e veprës së tij dhe as që ti kontrolloj veprimet e tij. Meqenëse sëmundja ka rrjedh kronike, ekziston rreziku që i pandehuri ta përsëris kryerjen e veprës penale në gjendje të pallogaritshme, ashtu që sipas mendimit të komisionit profesional është e domosdoshme që ndaj të pandehurit të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Konstatimi i tillë i ekspertëve është i mbështetur edhe në sjelljen e të pandehurit ____ . jo vetëm në raport me të dëmtuarin me rastin e kryerjes së veprës penale vrasjes në tentativë , por edhe gjatë kohës së qëndrimit të tij në paraburgim, për të cilën kohë ai shumë herë ka sulmuar edhe të paraburgosurit të tjerë, që shpie në përfundim se gjendja e tij psikike është e tillë që kërkon domosdoshmërisht izolimin e tij, për të evitimin e rrezikut real , që i pandehuri për shkak të gjendjes psikike të tij, të rrezikoj jetën dhe pasurinë e të tjerëve nëse ndodhet në liri.

Për arsye të paraqitura më sipër , ky propozim është i arsyeshëm dhe i bazuar në ligj.

Prokurori i Prokurorisë Themelore _____

Formulari 129

AKTVENDIM PËR SHQIPTIMIN E MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK ME NDALIM NË INSTITUCIONIN SHËNDETSOR

(neni 507 KPPK, NENI 89 I kpk-s)

PDKR.nr..nr._____/_____

Gjykata Themelore në _____, në trupin gjykues i përbërë: nga H.L, si kryetar i trupit, gjyqtarit M.J. dhe gjyqtarëve K.K. N.N. anëtarë të trupit, me bashkëpunëtorin profesional S.B, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të pandehurit K.B, nga _____, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë , të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28.të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit publik të Prokurorisë Themelore në _____ P.P.nr.____/____, datë____, në shqyrtimin publik gojor të mbajtur më _____, në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore S.B., të pandehurit K.B. mbrojtësit të tij G.M dhe të dëmtuarit A.Z, mori dhe po këtë dit publikisht komunikoi këtë,

A K T V E N D I M

I pandehuri K.B., student nga _____ rr.” Sheshi i lirisë” nr._____ i lindur më 2.maj._____ në _____,nga i ati S. dhe e ëma SH, e lindur P, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim në spitalin e Burgut të Qarkut në _____.

Për arsye se :

Më _____ në _____, ka tentuar ta privoj nga jeta dr. P.L., i cili disa herë gjatë viti _____ eka ekzaminuar të pandehurin dhe ka konstatuar se ai është psikikisht i sëmurë, e të cilën diagnoz i pandehuri e ka konstatuar jo të saktë, dhe për këtë e ka pritur të dëmtuarin në hollin e spitalit neuropsikiatrik, nga parapa e ka goditur me thikë në pjesën e djathtë të kraharorit , duke i shkaktuar plagë shpuese 4.cm dhe pas kësaj është larguar.

Me çka ka kryer veprën penale vrasje në tentativë, të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPPK,

Andaj Gjykata në bazë të nenit 514.par.3.të KPPK-ës, nenit 89 dhe 178, lidhur me nenit 28 të KPK-ës i,

SHQIPTON

Masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Lëshimin nga institucioni shëndetësor gjykata do ta urdhëroj kur vërtetohet se qëndrimi i mëtejshëm në institucion shëndetësor është i panevojshëm.

Shpenzimet e procedurës bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

Prokuroria Shtetërore e Prokurorisë Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda ka paraqitur propozim PP.nr. ____/____ nga data _____, që ndaj të pandehurit K.B., të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor për arsye se në gjendje të pallogaritshme ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, në mënyrën siç është përshkruar në dispozitiv të aktvendimit. Pranë këtij propozimi ka mbetur edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Gjykata Themelore në shqyrtimin gjyqësor ka dëgjuar të pandehurin K.B., pastaj ka proceduar këto prova: ka dëgjuar të dëmtuarin S.Sh. si dëshmitar, ka dëgjuar ekspertin e mjekësisë ligjore neuropsikiatrin dr.F.M., ka lexuar mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të neuropsikiatrisë dr.F.M., dhe dr.L.L., dhe psikologun e Klinikës B.L., ka lexuar raportin e ekspertit të kirurgjisë përkitazi me lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari si dhe raportin e pneumofiziologut për kontrollin dhe shërimin e të pandehurit si dhe ka shqyrtuar si provë thikën me të cilën i pandehuri kishte kryer veprën.

Të gjitha provat e proceduara si dhe mbrojtjen e të pandehurit gjykata në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme i ka vlerësuar një nga një dhe lidhshmëri me njëra tjetrën.

I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk ka dëshiruar që të dëmtuarin ta privojë nga jeta por vetëm ta lëndojë lehtë nga se nuk është pajtuar me vlerësimet e të dëmtuarit si neuropsikiatër përkitazi me gjendjen shpirtërore të tij.

Gjykata mbrojtjen e këtillë e ka vlerësuar të papranueshëm për arsye si më poshtë:

Në bazë të dëshmisë së të dëmtuarit S.Sh. të cilën gjykata e ka dëgjuar si dëshmitarë është vërtetuar se babai i të pandehurit si mik i tij e ka lutur që ta kontrolloj të pandehurin me çka ai ka pranuar dhe disa herë gjatë viti _____ e ka kontrolluar dhe ka gjetur se te i pandehuri është në pyetje çrregullimet serioze psikiatrike. Ditën kritike kur ka kaluar nëpër korridorin e klinikës së neuropsikiatrisë, ju ka ofruar i pandehuri dhe befasisht me thikë e ka goditur në pjesën e majtë të kraharorit duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore më pas është larguar nga korridori dhe ka ikur në drejtim të panjohur.

Në bazë të dëshmisë së të dëmtuarit dhe raportit të ekspertit të kirurgjisë nga data _____, është vërtetuar se i dëmtuari në këtë rast ka pësuar lëndime të rënda trupore në formë shpuese në thellësi prej 7 cm, të rrezikshme për jetë në momentin e shkakimit. Nga raporti i ploumofiziologut i cili ka qenë mjek ordinar në shërimin e të dëmtuarit gjatë muajit nëntor të vitit _____, shihet se nga lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari kishte pas një infeksion mushkërisë dhe për këtë arsye ka qëndruar në shërim në këtë repart 1 muaj ditë.

Duke analizuar provat e mësipërme, ndërsa duke pas parasysh cilësinë e mjetit dhe lokacioni i lëndimeve, në pjesët e organeve vitale, kjo gjykatë pa mëdyshje ka gjetur se i pandehuri ka tentuar që të dëmtuarin ta provojë nga jeta dhe me këtë ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-ës.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të pandehurit se mjete të cilin e ka përdorur i pandehuri nuk ka qenë i përshtatshëm që të shkaktojë vdekjen e të dëmtuarit, mirëpo ka gjetur se këto pretendime janë të pabazuara dhe të papranueshme dhe se nuk bëhet fjalë për mjet të papërshtatshëm. Në të kundërtën, me këqyrjen e brishtë gjykata ka ardhur në përfundim të sigurt se mjete të përdorur ka qenë i përshtatshëm që me të kryhet vepra penale e vrasjes.

Në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekipit të mjekësisë ligjore të neuropsikiatrisë dhe psikologut është vërtetuar se i pandehuri vuan nga psikoza paranoike, dhe për këtë në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë absolutisht i pallogaritshëm, nga se nuk ka mundur ta kuptojë rëndësinë e veprës së tij dhe as që të kontrollojë veprimet e tij. Meqenëse sëmundja ka rrjedh kronike, ekziston rreziku që i pandehuri ta përsëris kryerjen e veprës penale në gjendje të pallogaritshme, ashtu që sipas mendimit të komisionit profesional është e domosdoshme që ndaj të pandehurit të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Eksperti i psikiatrisë dr.F.M., në shqyrtimin gjyqësor mendimin dhe konstatimin e ka plotësuar edhe me këto konstatime: sjellja të cilën e ka manifestuar i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale tregojnë dhe plotësojnë fotografinë e psikozës paranoike nga se ai është nën presionin e idesë se ai po ndiqet dhe kështu që ai tenton që të lirohet nga kjo ndjekje, andaj, duke goditur të dëmtuarin me brishtë prerës në pjesën e gjoksit, ka qenë i bindur se e ka evituar

rrezikun nga ndjekja e mëtejme gjërë përfundimi i këtillë eksperti ka ardhur duke pasqyruar deklarimin e të pandehurit menjëherë pas sulmit që i ka bërë të dëmtuarit “e tani jemi baraz”.

Te i pandehuri është formuar ideja se i dëmtuari me diagnozat të pasakta po e ndjek, i preokupuar me këtë ide ka shkuar te i dëmtuari dhe e ka goditur në mënyrën si u përshkrua më lart me bindje se me këtë do evitohet rrezikun e ndjekjes së mëtejme nga ana e të dëmtuarit.

Ekspertët kanë dhënë mendimin dhe konstatimin pas kontrollimit neurologjik dhe psikiatrik të pandehurit si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të disponueshëm dhe të dhënave të mbledhura nga personat të cilët më herët e kanë njohur të pandehurin, d.m.th. pas një observimi kompleks të pandehurit, ndërsa në harmoni me rregullat e shkencës së neuropsikiatrisë.

Meqenëse nuk ka pas prova që do vinin në dilemë objektivitetin e mendimit dhe konstatimit të ekspertëve, gjykata mendimin dhe konstatimin e ka pranuar si të besueshëm.

Nga të shtruarat, sipas gjetjes së gjykatës i pandehuri ka tentuar ta privojë nga jeta të dëmtuarin S.Sh., në mënyrën si është përshkruar në dispozitiv të aktvendimit, dhe me këtë ka kryer veprë penale të vrasjes në tentativë, ndërsa në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i pallogaritshëm.

Në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertëve është vërtetuar se i pandehuri është i rrezikshëm për rrethin dhe është e domosdoshme dërgimi i tij në institucionin e mbyllur me qëllim të shërimit të detyrueshëm psikiatrik ku do të qëndrojë derisa të vërtetohet se qëndrimi i mëtejme i tij në institucionin shëndetësor është i panevojshëm.

Meqenëse i pandehuri nuk është shpallur fajtor, është vendosur që shpenzimet e procedurës, të bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore.

Nga të shtruarat më lart, e në bazë të nenit 514 par.3 të KPPK, ka vendosur si në dispozitiv.

Procesmbajtësi,

Kryetari i trupit gjykues,

S.B.

H.L.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa, në Gjykatën e

Apelit, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Formulari 130

SHQIPTIMI I DËNIMIT DHE MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK, TË PANDEHURIT I CILI VEPRËN PENALE E KA KRYER NË GJENDJE TË PËRGJEGJËSISË ESENCIALISHT TË ZVOGËLUAR

P.nr.1230/2014

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në _____, Departamenti për krime të rënda , në trupin gjykues i përbërë: nga H.L, si kryetar i trupit, gjyqtarit M.J. dhe K.K. anëtarë të trupit, me bashkëpunëtorin profesional S.B, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të pandehurit K.B, nga _____ për shkak të veprës penale vrasje në tentativë, të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28.të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ P.P.nr. _____ datë _____, në shqyrtimin publik gojor të mbajtur më _____ në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore S.B., të pandehurit K.B. mbrojtësit të tij G.M dhe të dëmtuarit A.Z, mori dhe publikisht komunikoi këtë,

A K T G J Y K I M

I pandehuri K.B., student nga _____ rr.” Sheshi i lirisë” nr.15/3-2, i lindur më 2.maj.1980 në _____, nga i ati S. dhe e ëma SH, e lindur P, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës, në paraburgim në spitalin e Burgut të Qarkut në _____, prej _____ e deri më _____.

ËSHTË FAJTOR

Për arsye se me _____, në _____, ka tentuar ta privoj nga jeta dr. P.L., i cili disa herë gjatë viti _____ e ka ekzaminuar të pandehurin , dhe ka konstatuar se ai është psikikisht i sëmurë, e të cilën diagnozë i pandehuri e ka konstatuar jo të saktë, dhe për këtë ditën kritike e ka pritur të dëmtuarin në hollin e spitalit neuropsikiatrik dhe pas debatit të shkurtër rreth trajtimit të tij dhe terapisë së përcaktuar nga ana e mjekut ordinar , ka nxjerrë nga xhepi një thikë

flutur dhe e ka goditur të dëmtuarin në pjesën e djathtë të kraharorit , duke i shkaktuar plagë shpuese 4.cm dhe pas kësaj është larguar.

Me çka ka kryer veprën penale vrasje në tentativë, të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-ës,

Andaj gjykata në bazë të nenit 515 par.1. të KPPK-ës dhe nenit 90 par.1.nenit 75.të KPK-ës e,

G J Y K O N

Më 3 (tri) vjet burgim, në të cilin i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim në spitalin e burgut të _____ prej _____ e deri _____.

Ndaj të akuzuarit shqiptohet edhe masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, e cila masë ka për tu zbatuar para fillimit të mbajtjes së dënimit.

I akuzuari detyrohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale 123.€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor 150 €, në afat prej 15.ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Shtetërore e Prokurorisë Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP.nr. ___/___ nga data _____, ndaj të pandehurit K.B.për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë, të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK, ka propozuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit , por edhe t'i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, pasi që veprën penale e ka kryer në gjendje të përgjegjësisë esencialisht të zvogëluar.

Gjykata Themelore në shqyrtimin gjyqësor ka dëgjuar të pandehurin K.B., pastaj ka proceduar këto prova: ka dëgjuar të dëmtuarin S.Sh. si dëshmitar , ka dëgjuar ekspertin e mjekësisë ligjore neuropsikiatrin dr.F.M., ka lexuar mendimin dhe konstatimin e ekspertëve të neuropsikiatrisë dr.F.M., dhe dr.L.L., dhe psikologun e Klinikës B.L., ka lexuar raportin e ekspertit të kirurgjisë përkitazi me lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari si dhe raportin e

pneumofiziologut për kontrollin dhe shërimin e të pandehurit si dhe ka shqyrtuar si provë thikën me të cilën i pandehuri kishte kryer veprën.

Të gjitha provat e proceduara si dhe mbrojtjen e të pandehurit gjykata në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të kujdesshme i ka vlerësuar një nga një dhe lidhshmëri me njëra tjetrën.

I pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk ka dëshiruar që të dëmtuarin ta privojë nga jeta por vetëm ta lëndojë lehtë nga se nuk është pajtuar me vlerësimet e të dëmtuarit si neuropsikiatër përkitazi me gjendjen shpirtërore të tij, dhe ditën kritike u provokua nga mjeku ngase kinse e fye atë duke i thënë “*largoi mor i krisur se s’mund të merrem unë vetëm me ty*”, meqë është ndier i fyer nga ai ka humb kontrollin dhe e ka goditur me thikë atë.

Gjykata mbrojtjen e këtillë e ka vlerësuar të papranueshëm për arsye si më poshtë:

Në bazë të dëshmisë së të dëmtuarit S.Sh. të cilën gjykata e ka dëgjuar si dëshmitarë është vërtetuar se babai i të pandehurit si mik i tij e ka lutur që ta kontrolloj të pandehurin me çka ai ka pranuar dhe disa herë gjatë viti _____ e ka kontrolluar dhe ka gjetur se te i pandehuri është në pyetje çrregullimet serioze psikiatrike. Ditën kritike kur ka kaluar nëpër korridorin e klinikës së neuropsikiatrisë, ju ka ofruar i pandehuri dhe befasisht me thikë e ka goditur në pjesën e majtë të krahorit duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore më pas është larguar nga korridori dhe ka ikur në drejtim të panjohur. Ka deklaruar se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike.

Në bazë të dëshmisë së të dëmtuarit dhe raportit të ekspertit të kirurgjisë nga data _____, është vërtetuar se i dëmtuari në këtë rast ka pësuar lëndime të rënda trupore në formë shpuese në thellësi prej 7 cm, të rrezikshme për jetë në momentin e shkaktimit. Nga raporti i ploumofiziologut i cili ka qenë mjek ordinar në shërimin e të dëmtuarit gjatë muajit nëntor të vitit _____, shihet se nga lëndimet që i ka pësuar i dëmtuari kishte pas një infeksion mushkërisë dhe për këtë arsye ka qëndruar në shërim në këtë repart 1 muaj ditë.

Duke analizuar provat e mësipërme, ndërsa duke pas parasysh cilësinë e mjetit dhe lokacioni i lëndimeve, në pjesët e organeve vitale, kjo gjykatë pa mëdyshje ka gjetur se i pandehuri ka tentuar që të dëmtuarin ta provojë nga jeta dhe me këtë ka kryer veprën penale të vrasjes në tentativë parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-ës.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të pandehurit se mjete të cilin e ka përdorur i pandehuri nuk ka qenë i përshtatshëm që të shkaktojë vdekjen e të dëmtuarit, mirëpo ka gjetur se këto pretendime janë të pabazuara dhe të papranueshme dhe se nuk bëhet fjalë për mjet të papërshtatshëm, ngase sipas ekspertit mjekoligjor, tehu me dimensione prej 10 cm, mund t’i godas të gjitha organet vitale duke përfshirë edhe zemrën, ndërsa në rastin konkret i kishte depërtuar në mushkërinë e djathtë, e që shpie në përfundim të sigurt se mjete i përdorur ka qenë i përshtatshëm që me të kryhet vepra penale e vrasjes.

Në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekipit të mjekësisë ligjore të neuropsikiatrisë dhe psikologut është vërtetuar se i pandehuri vuan nga psikoza paranoike e përkohshme , dhe për këtë në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm penalisht , mirëpo përgjegjësia penale e tij ka qenë e zvogëluar esencialisht . Meqenëse sëmundja ka rrjedh kronike të kahershme (*e pa trajtuar në aspektin mjekësor*), ekziston rreziku që i pandehuri ta përsëris kryerjen e veprës penale në gjendje të pallogaritshme, ashtu që sipas mendimit të komisionit profesional, për tu evituar çdo rrezik i mundshëm që i pandehuri në situata të tilla të veproj , pa kontroll dhe gjykim kritik , është e domosdoshme që ndaj të pandehurit të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në institucionin e kujdesit shëndetësor .

Eksperti i psikiatrisë dr.F.M., në shqyrtimin gjyqësor mendimin dhe konstatimin e ka plotësuar edhe me këto konstatime: sjellja të cilën e ka manifestuar i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale tregojnë dhe plotësojnë fotografinë e psikozës paranoike të përkohshme nga se ai asesi nuk pajtohej me diagnozën e përcaktuar nga mjeku dhe po vlerësonte se kishte trajtim jo korrekt nga ana e mjekut , andaj pas një debat të shkurtër rrethe kësaj çështje , ka ndërmarr veprimin ndaj të dëmtuarit .

Ekspertët kanë dhënë mendimin dhe konstatimin pas kontrollimit neurologjik dhe psikiatrik të pandehurit si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të disponueshëm dhe të dhënave të mbledhura nga personat të cilët më herët e kanë njohur të pandehurin , d.m.th. pas një observimi kompleks të pandehurit, ndërsa në harmoni me rregullat e shkencës së neuropsikiatrisë.

Meqenëse nuk ka pas prova që do vinin në dilemë objektivitetin e mendimit dhe konstatimit të ekspertëve , gjykata mendimin dhe konstatimin e ka pranuar si të besueshëm.

Sipas gjetjes së gjykatës, i pandehuri ka tentuar ta privojë nga jeta të dëmtuarin S.Sh., në mënyrën si është përshkruar në dispozitiv të aktvendimit, dhe me këtë ka kryer veprë penale të vrasjes në tentativë , të parashikuar nga neni 178.lidhur me neni 28 të KPK-ës, ai në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i përgjegjshëm, mirëpo shkalla e përgjegjësisë së tij ishte e zvogëluar *esencialisht*.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat relevante për matjen e dënimit, dhe si rrethanë lehtësuese ndaj të pandehurit mori për bazë faktin se gjer më tani nuk ka qenë i dënuar , se veprën penale e ka kryer në gjendje të përgjegjësisë *esencialisht* të zvogëluar , sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale, ka shprehë keqardhje për dëmin që i ka shkaktuar të dëmtuarit, ndërsa në anën e tij nuk gjeti asnjë rrethanë rënduese , për këtë arsye, *duke i aplikuar dispozita për zbutje të dënimit nga neni 76.par.1.nënp.1.1.të KPPK-ës, e dënoj si në dispozitiv të aktgjykimit , me bindje se me një dënim të tillë(të zbutur nën minimumin e posaçëm të përcaktuar me ligj) do arrihet qëllimi i shqiptimit të sanksioneve penale sipas nenit 41.të KPK-ës , në të gjitha segmentet e tij .*

Në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertëve është vërtetuar se i pandehuri me këtë shkallë të zvogëluar të përgjegjësisë për shkak të sëmundjeve të përkohshme psikike, paraqet rrezik për rrethin , dhe se është e domosdoshme trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në institucionin e kujdesit shëndetësor (*mbyllur*), me qëllim të shërimit të detyrueshëm psikiatrik ku do evitohen çdo rrezik që i pandehuri në të ardhmen të ndërmarr veprimet të paligjshme .Për këtë arsye Gjykata të pandehurit krahas dënimit i shqiptoi edhe masën e trajtimit të detyrueshëm , të cilës do i nënshtrohet para se të mbaj dënimin

Në bazë të nenit 453 të KPPK-ës, i pandehuri është obliguar që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj 550 €, aq sa i janë paguar ekspertëve dhe dëshmitarëve të dëgjuar, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor 100 €.Me rastin e matjes së paushallit gjyqësor gjykata ka marrë parasysh ndërlukshmërinë dhe kohëzgjatjen e procedurës, si dhe rrethanat pasurore të të pandehurit, në kuptim të nenit 450 par. 3.të KPPK.

Nga të shtruarat më lart, e në bazë të nenit 514 par.3 të KPPK, ka vendos si në dispozitiv.

Procesmbajtësi,

Kryetari i trupit gjykues,

S.B.

H.L.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në Gjykatën e

Apelit , në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Formular 131

AKTVENDIM PËR PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT TË MASËS SË TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË INSTITUCIONIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR (neni 176 LPESP)

KP.nr. _____

Gjykata Themelore _____, në kolegjin e përbërë prej N.N. kryetar kolegji, N.N. dhe N.N. anëtarë të kolegjit, me procesmbajtësen N.N. , në çështjen ndaj të pandehurit N.N., për shkak të veprës penale vrasje në tentativë , të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 KPK-së , duke vendosur sipas propozimit të Qendrës për Psikiatri Gjyqësore në _____ nr. _____, datë _____, që të ndërprehet

aplikimi i mëtutjeshëm i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në institucionin e kujdesit shëndetësor nga neni 89 par.1. të KPK-ës, pas marrjes së propozimit me shkrim të Prokurorit të Shtetit në Prokurorinë Themelore në _____, më datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit N.N. nga _____, ndërprehet zbatimi i mëtejme i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor , nga neni 89 i KPK-së, i shqiptuar me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në _____, PKR.nr. _____/ datë _____, ashtu që i përmenduri ka për t'u liruar nga Qendra e Neuropsikiatrisë në _____.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në _____,PKR.nr. _____, datë _____, të akuzuarit N.N. nga _____ i është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor , nga neni 89 i KPK-së, për shkak të veprës penale vrasje në tentativë, të parashikuar nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPK-së.

Ekipi mjeko ligjor pranë Qendrës së Neuropsikiatrisë në të cilën po aplikohet masa e trajtimit ndaj të pandehurit me parashtrësën nr. _____ datë _____, ka propozuar që të ndërprehet zbatimi i mëtejme i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në institucionin e tipit të mbyllur, pasi që shërimi ka përfunduar me sukses.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në _____, me parashtrësën KP.nr. _____ datë _____, ka propozuar që të ndërprehet zbatimi i mëtejme i masës së trajtimit të detyrueshëm.

Gjykata Themelore ka shqiptuar propozimin e ekipit mjeko ligjor nga Qendra e Neuropsikiatrisë në _____, qëndrimin e Prokurorit të Shtetit dhe shkresat tjera penale, dhe ka gjetur se propozimi është i bazuar.

Nga propozimi i ekipit mjeko ligjor të Qendrës së Neuropsikiatrisë në _____, se ndaj të pandehurit N.N. masa e trajtimit të detyrueshëm aplikohet prej

datës _____, për shkak të skizofrenisë akute, se shërimi prej dy vitesh ka treguar rezultate pozitive, se te i sëmuri janë të qarta indikatorët e shërimit të plotë, ashtu që qëndrimi i tij në liri më nuk paraqet rrezik për rrethin ku ai jeton.

Sipas nenit 178.paragrafit 4 të Ligjit Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në institucionin e tipit të mbyllur, gjykata e ndërprente kur vërtetonte se ka pushuar nevoja për shërimin dhe ruajtjen e kryerësit të veprës penale në institucionin shëndetësor.

Meqenëse në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore që të ndërpritet zbatimi i mëtejshëm i masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, në bazë të nenit 176.par.6. të Ligjit Për ekzekutimin e Sanksioneve Penale është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit.

Meqenëse nga raporti i ekipit mjeko ligjor të Qendrës së Neuropsikiatrisë në _____, shihet se nuk ka nevojë që ndaj të pandehurit të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm në liri nga neni 90. të KPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Data _____

KP.nr. _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

N.N

N.N.

Sqarim: Dispozitat nga Ligji Për ekzekutimin e sanksioneve penale që e rregullojnë çështjen e ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik (172-179) në asnjë dispozitë nuk bënë fjalë për ankimimet (*mjetet juridike*) ndaj vendimeve gjyqësore, qoftë kur ndryshohet qoftë kur pushohet masa, mirëpo konsideroj se duhet lejuar ankesa bazuar në standardin se “*nëse nuk është e ndaluar është e lejuar*”, psh çfarë do të ndodhte kur gjykata i ka pushuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor, nga neni 89 i KPK-së, por i ka caktuar masën e trajtimit të detyrueshëm në liri, nga neni 90 i KPK-ës, pa pas nevojë për këtë masë?.

Formular 132

PROCEDURA E EKSTRATDIMIT

(Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Fushën Penale)

AKTVENDIM ME TË CILIN REFUZOHET KËRKESA PËR EKSTRADIM (Neni 26. LBJNDÇP)

Gjykata Themelore _____, në kolegjin në përbërje prej gjyqtarëve M.M., kryetar kolegji, P/P dhe N.P, si anëtar kolegji, me bashkëpunëtorin profesional F.P. si procesmbajtës, në çështjen penale të të pandehuri L.K. nga _____, duke vendosur sipas kërkesës së Shtetit të Danimarkës për ekstradimin e të pandehurit, në seancën e kolegjit të mbajtur më _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet lutja e Shtetit të Danimarkës për ekstradimin e shtetasit danez L.K. në Republikën e Danimarkës.

A r s y e t i m

Shteti i Danimarkës, nëpërmjet Ambasadës, ka paraqitur më datë _____, lutjen për ekstradimin e shtetasit danez L.K. nga _____, ndaj të cilit është dhënë urdhër për paraburgim nga ana e Gjykatës Themelore në Kopenhagë, P.nr. 180/ datë _____, për shkak të veprës penale të vjedhjes , të parashikuar nga neni 170 par. 1 të Ligjit Penal të Danimarkës.

Duke vendosur sipas lutjes për ekstradimin e të huajit gjykata ka vlerësuar dokumentet e shkruara shkresat e veprimeve hetimore që janë zbatuar lidhur me këtë çështje dhe ka gjetur se nuk janë përmbushur supozimet ligjore për ekstradimin e të huajit.

Në urdhër për paraburgim lëshuar nga Gjykata Themelore në Kopenhagë P.nr. 180/ _____ datë _____, është theksuar se paraburgimi caktohet për faktin se ekziston dyshimi

i bazuar se L.K. së bashku me dy persona tjerë më datë _____, ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 170 par. 1 të Ligjit Penal të Danimarkës.

I pyetur nga gjyqtari i procedurës paraprake i kësaj Gjykate më datë _____ L.K. ka deklaruar se më datë _____ nuk ka qenë në Danimarkë dhe në atë kohë nuk ka mundur ta kryejë veprën penale. Me shikimin në dokumentin e udhëtimit (*pasaportë*) lëshuar nga organi kompetent në Kopenhagë është vërtetuar se më datë _____ (*kur ai akuzohet se ka kryer veprën penale të vjedhjes*) rezulton se ka kaluar kufirin Kroaci – Mali i Zi dhe kjo vërehet në bazë vulës hyrëse që janë vendosur në dokumentin e udhëtimit nga organet kufitare.

Meqenëse ka prova se personi ekstradimi i të cilit kërkohet më datë _____, nuk është ndodhur në Kopenhagë, nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka kryer veprën penale të vjedhjes nga neni 170 par. 1 të Ligjit Penal të Danimarkës, andaj nuk janë përmbushur supozime ligjore të parashikuara në nenin 26 paragrafi 1. të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale.

Për këtë arsye në kuptim të nenit 27. të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE

Kp.nr. _____ datë _____

Procesmbajtësi

Kryetari i kolegjit,

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi , është e lejuar ankesa , në afat prej tri (3)

ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës Apelit të

Kosovës , nëpërmjet kësaj Gjykate.

Formular 133

AKTVENDIM ME TË CILIN VËRTETOHET EKZISTIMI I SUPOZIMEVE LIGJORE PËR EKSTRADIMIN E SHTETASIT TË KOSOVËS

(Neni 27.paragrafi 1.të LPJNDÇP)

Gjykata Themelore _____, në kolegjin në përbërje prej gjyqtarëve M.M., kryetar kolegji, P.P dhe N.P, si anëtar kolegji, me bashkëpunëtorin profesional F.P. si procesmbajtës, në çështjen penale të të pandehurit M.D _____, duke vendosur sipas lutjes së Republikës së Shqipërisë, për ekstradimin e të pandehurit në seancën e kolegjit të mbajtur më _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Vërtetohet se janë përmbushur parakushtet ligjore për ekstradimin e shtetasit të Kosovës M.D., Shtetit Shqiptar për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale falsifikim të dokumentit,të parashikuar nga neni _____ par. _____ të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

A r s y e t i m

Shteti Shqiptar, nëpërmjet Ambasadës së saj në Prishtinë ka paraqitur lutje për dorëzimin e M.D. nga _____, Republika e Kosovës, për të cilin është dhënë urdhër për paraburgim nga ana e Gjykatës së Tiranës, P.nr. _____ datë _____, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit parashikuar nga neni _____ të Kodit Penal të Shqipërisë.

Duke vendosur lidhur me lutjen për dorëzimin e shtetasit të Kosovës, kolegji ka shqyrtuar shkresat e çështjes, të dhënat që janë siguruar lidhur me rastin, dhe ka gjetur se janë përmbushur të gjitha presupozimet ligjore për dorëzimin e shtetasit të Kosovës konform nenit 27. të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në fushën penale.

Me lutje për dorëzimin e shtetasit të Kosovës janë bashkangjitur: Urdhër për paraburgim, ekstrakt nga teksti i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Përkundër faktit se i pandehuri është shtetas i Republikës së Kosovës, e që paraqet pengesë për ekstradim, kjo pengesë është eliminuar, ngase ekziston *Marrëveshja mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për ekstradime të ndërsjella* në situata të caktuara, pastaj vepra penale të cilën e ka kryer i pandehuri është parashikuar edhe si vepër penale në Kodin Penal të Kosovës neni 398, par. 2. dhe nuk është arritur afati i vjetërsimit. Nga hetimet që i ka kryer gjyqtari i caktuar nga ana e kësaj Gjykate, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe për këtë vepër penale nuk është gjykuar nga ndonjëra gjykatë e Republikës së Kosovës dhe as që është duke u zhvilluar ndonjë procedurë penale në Kosovë për veprën e tillë e që do ishte pengesë për esktradim.

Meqë janë përmbushur kushtet ligjore për dorëzimin e shtetasi të Kosovës, në kuptim të nenit 27 të *Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Fushat Penale*, është vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE N. _____

Më datë _____ Kp/ _____

Procesmbajtësi

Kryetari i kolegjit,

KËSHILLA JURIDIKE:Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa, në afat prej tri (3)

ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës Apelit të

Kosovës ,nëpërmjet kësaj Gjykate.

PROCEDURA PËR REVOKIMIN E DËNIMEVE ALTERNATIVE

Formular 134

NJË FORMË E DISPOZITIVIT TË AKTVENDIMIT PËR PUSHIMIN E PROCEDURËS PËR REVOKIMIN E DËNIMIT ME KUSHT

(neni 519. kppk-ës)

Kp.nr. ___/___

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin shqyrtues i përbërë: nga T.P, si kryetar kolegji, S.R. dhe B.K. anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Z.Z, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të gjykuarit B.B, nga _____ për shkak të veprës penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, të parashikuar nga neni 252 par.1. të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ PP.nr. ___/___ datë _____, pas mbajtjes së seancës së kolegjit shqyrtuese, me pjesëmarrjen e prokurorit të Prokurorisë themelore Sh.Sh, të dëmtuarës dhe të gjykuarit, më _____ mori këtë,

A K T V E N D I M

Kundër të gjykuarit B.B. nga _____, pushohet procedura për revokimin e dënimit me kusht, të shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____ P.nr. ___/___ datë _____.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, nr. _____ datë _____, i pandehuri N.N. nga _____, është shpallur fajtor për veprën penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, të parashikuar nga neni 252 par.1. të Kodit Penal të Kosovës, dhe është gjykuar me dënim burgimi prej katër(4) muajsh, ekzekutimi i të cilit në kuptim të nenit 51 të KPK-ës, i është shtyrë për një vit, me kusht që në këtë afat të mos kryejë veprë penale dhe përfaqësuesit ligjor të të miturit N.N. t'i paguajë shumën e papaguar të alimentacionit në shumë prej 800 euro, në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____ në parashtrësën KP.nr. _____ / _____ datë _____, ka propozuar që dënimi me kusht që i është shqiptuar të dënuarit të revokohet, për arsye se i pandehuri në afatin e lënë, nuk i ka paguar përfaqësuesit ligjor shumën e prapambetur në emër të mbajtjes për të miturin N.N. në shumë prej 800 euro.

Kolegji ka shqyrtuar propozimin e Prokurorit të Prokurorisë Themelore _____, provat e siguruar nga gjyqtari kësaj gjykate që është caktuar për ndërmarrjen e veprimeve procedurale, ka analizuar shkresat tjera të kësaj çështje penale, dhe ka gjetur se :

Propozimi për revokimin e dënimit me kusht është i pabazuar.

Sipas nenit 56 paragrafit 2. të KPK-së, nëse i dënuari në afatin e lënë nuk përmbush detyrimin e posaçëm që i ka caktuar gjykata në aktgjykim, gjykata mundet mund të revokojë dënimin me kusht, më së largu në afat prej një viti pasi të ketë kaluar afati i përmbushjes.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në _____, P.nr. _____ / _____, është bërë i plotfuqishëm më 15.11.2014 (*i pandehuri ishte i detyruar që shumën e papaguar të alimentacionit ta paguaj në afat prej një muaji nga dita kur aktgjykimi ka marrë formën e prerë*), afati një vjeçar për përmbushje ka kaluar më 15.12.2015, ndërsa propozimi i Prokurorit të Shtetit për revokimin e dënimit me kusht është dorëzuar më datë **15.04.2016**.

Meqenëse më datë **15.12.2015**, ka kaluar një vit, nga dita kur i dënuari ka qenë i detyruar t'i kompensojë alimentacionin e papaguar, ndërsa propozimi për revokim është dorëzuar më **15.04.2016**, nuk ekziston më mundësi ligjore që aktgjykimi me kusht të revokohet, andaj në bazë të nenit 56. paragrafi 2, të KPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Da _____ Kp.nr. _____

Procesmbajtësi,

Z.Z.

Kryetari i kolegjit,

T.P.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi , është e lejuar ankesa , në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Formulari 135

NJË FORMË E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN CAKTOHET AFAT I RI PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE

Kp.nr. ____/____

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin shqyrtues i përbërë: nga T.P, si kryetar kolegji, S.R. dhe B.K. anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Z.Z, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të gjykuarit S.Z. nga _____ për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë , të parashikuar nga neni 333.par.1.të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas kërkesës së të gjykuarit që t'i caktohet afati i ri për përmbushjen e obligimeve , pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me pjesëmarrjen e prokurorit të prokurorisë themelore M.M., të gjykuarit dhe i dëmtuari, më _____ mori këtë,

A K T G J Y K I M

Të gjykuarit S.Z.nga _____, i caktohet afati i ri për përmbushjen e obligimeve sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____ P. ____/____, datë _____, ashtu që dëmin që ia ka shkaktuar të dëmtuarit me vepër penale, në shumë prej 2000 € , ka për ta paguar më së largu gjerë më 31.12.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në _____, P.nr. _____ datë _____, i pandehuri N.N. nga _____, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, të parashikuar nga neni 333.par.1.të Kodit Penal të Kosovës, dhe është dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) muaji, ekzekutimi i të cilit në kuptim të nenit 51 të KPK-së, është shtyrë për një vit, me kusht që i pandehuri brenda këtij afati të mos kryejë tjetër vepër penale dhe të dëmtuarit N.N. nga _____, t'i paguajë dëmin në shumë prej 2000 euro, në afat prej tre muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Ky aktgjykim është bërë i plotfuqishëm më datë _____.

Me parashitjen nga data _____ i dënuari ka propozuar që t'i caktohet afat i rij për përmbushjen e obligimeve në drejtim të kompensimit të dëmit, ngase pa fajin e tij detyrimin e caktuar nuk ka mundur ta përmbushë në kohë. Ka theksuar se ka të ardhura mesatare në shumë prej 250 euro, me të cilën mban përpos vetës edhe bashkëshorten dhe katër fëmijët e tij prej moshës 3 deri në moshën 12 vjeç, se ka pas të sëmure fëmijën i cili ka qëndruar disa ditë i shtrirë në QKUK, kështu që ka pasur edhe shpenzime shtesë për shpenzimet e shërimit.

Gjykata ka zbatuar veprimet procedurale dhe ka konstatuar se pretendimet e të dënuarit janë të sakta.

Në seancën e kolegjit Prokurori i Shtetit, ka propozuar që propozimi i të dënuarit të aprovohet, ndërsa i dëmtuari ka propozuar që i njëjti të refuzohet.

Meqenëse në bazë të veprimeve të zbatuara procedurale, është vërtetuar se i dënuari pa fajin e tij nuk ka qenë në mundësi që në afat t'i përmbush obligimet lidhur me kompensimin e dëmit, në kaptim të nenit 55 par.1 të KPK-së, është vendosur si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Data _____ Kp.nr. _____

Procesmbajtësi,

Z.Z.

Kryetari i kolegjit,

T.P.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi , është e lejuar ankesa , në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Formulari 136

NJË FORMË E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN HIQET KUSHTI

Kp.nr. ____/____

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin shqyrtues i përbërë: nga T.P, si kryetar kolegji, S.R. dhe B.K. anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Z.Z, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të gjykuarit P.K. nga _____ për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë , të parashikuar nga neni 333.par.1.të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ PP.nr. ____/____ datë _____, pas mbajtjes së seancës së kolegjit, me pjesëmartjen e prokurorit të prokurorisë themelore M.M., të gjykuarit dhe të dëmtuarës , më _____ mori këtë,

A K T G J Y K I M

I. *Refuzohet propozimi i prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ për revokimin e dënimit me kusht,PP.nr. ____/____ datë _____, të shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____ P.nr. ____/____ datë _____.*

II. *Hiqet kushti i caktuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____ PDP.nr. ____/____ datë _____, sipas të cilit i gjykuari P.K.. ka qenë i detyruar që në afat prej tre (3) muajsh , pasi që aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm, t'ia kompensoj dëmin të dëmtuarës L.V. nga _____ , në shumë prej 3000 €.*

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, i pandehuri P.K. nga _____, është shpallur fajtor për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, të parashikuar nga neni 333.par.1.të Kodit Penal të Kosovës, dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, ekzekutimi të cilit në kuptim të nenit 51 të KPK-së, është shtyrë në afat prej 1 (një) viti, me kusht që në këtë afat të mos kryejë veprë të re penale dhe në afat prej tre(3) muajsh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të kompensoj dëmin të dëmtuarës në shumë prej 3000€.

Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore me parashtresën PP.nr. _____ datë _____, ka propozuar që të revokohet dënimi me kusht i shqiptuar të akuzuarit, pasi që i njëjti në afatin e lënë nuk i ka përmbushur obligimet përkatësisht nuk i ka kompensuar dëmin që i ka shkaktuar të dëmtuarës.

Në dëshminë e dhënë më datë _____, i dënuari ka theksuar se kushtin të caktuar me aktgjykimin e formës së prerë përkitazi me kompensimin e dëmit, nuk ka qenë në mundësi ta përmbush dhe nuk është në gjendje ta përmbush as tani. Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit është larguar nga puna dhe nuk ka marrëdhënie pune, ka gjendje të varfër ekonomike, asnjë anëtar i familjes nuk i punon, ndërsa vetë ka probleme shëndetësore, ngase ka pësuar aksident trafiku në prill të vitit _____, dhe me këtë i është zvogëluar ndjeshëm aftësia e punës. Ka propozuar që kushti t'i hiqet, ngase nuk është në mundësi ta përmbush këtë detyrim.

Kolegji shqyrtues ka shqyrtuar propozimin e Prokurorit, përgjigjen të dënuarit, ka analizuar shkrësat e çështjes penale, dhe ka gjetur, se kushti që i dëmtuari t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar me veprë penale të dëmtuarës duhet hequr. Me zbatimin e veprimeve procedurale në tërësi janë vërtetuar thëniet e të dënuarit se nuk ka marrëdhënie pune të përhershme, se ka në mbajtje bashkëshorten, prindërit dhe katër fëmijët, se ka gjendje të varfër ekonomike, dhe se për shkak të lëndimeve që i ka marrë në një aksident trafiku, ka ardhur deri të zvogëlimi i aftësive punuese *(60% ka ngelur invalid)*.

Faktet e vërtetuara sipas bindjes së gjykatës tregojnë se i dënuari pa fajin e tij nuk është në mundësi ta përmbush kushtin në relacion me detyrimin për kompensimin e dëmit, të shkaktuar me veprën penale, andaj në kuptim të nenit 55. të KPK-së, është vendosur që kushti të hiqet, që dënimi me kusht të ngelet në fuqi pa këtë detyrim, por e që nuk ka ndikim në përmbushjen e detyrimeve të theksuara jashtë procedurës penale *(në procedurën përbarimore)*.

Meqenëse kushti është hequr propozimi i Prokurorit të Shtetit për revokimin e dënimit me kusht është refuzuar si i pabazuar.

GJYKATA THEMELORE NË _____

Kp.nr. _____ Data _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

Z.Z.

T.P.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi , është e lejuar ankesa , në afat prej tri ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Formulari 137

NJË KOPJE E AKTGJYKIMIT ME TË CILIN REVOKOHET GJYKIMI ME KUSHT

Kp.nr. ____/____

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin shqyrtues i përbërë: nga T.P, si kryetar kolegji, S.R. dhe B.K. anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Z.Z, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të gjykuarit L.M. nga _____ për shkak të veprës penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, të parashikuar nga neni 252 par.1. të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në _____ PP.nr. ____/____ datë _____, pas mbajtjes së seancës së kolegjit shqyrtues, me pjesëmarrjen e prokurorit të Prokurorisë themelore G.S. të dëmtuarës dhe të gjykuarit, më _____ mori këtë,

A K T G J Y K I M

Revokohet gjykim me kusht, ashtu dënimi burg në kohëzgjatje prej një (1) muaji, i shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____ P.nr.____/____ datë _____, të gjykuarit L.M. nga _____ ka për tu ekzekutuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, nr. _____ datë _____, i pandehuri L.M. nga _____, është shpallur fajtor për veprën penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, të parashikuar nga neni 252 par.1. të Kodit Penal të Kosovës, dhe është gjykuar me dënim burgimi prej katër(4) muajsh, ekzekutimi i të cilit në kuptim të nenit 51 të KPK-ës, i është shtyrë për një vit, me kusht që në këtë afat të mos kryejë veprë penale dhe përfaqësuesit ligjor të të miturit N.N. t'i paguajë shumën e papaguar të alimentacionit në shumë prej 800 euro, në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____ me parashitësën KP.nr._____/_____ datë _____, ka propozuar që dënimi me kusht që i është shqiptuar të dënuarit të revokohet, për arsye se i pandehuri në afatin e lënë nuk i ka paguar përfaqësuesit ligjor shumën e prapambetur në emër të mbajtjes për të miturin N.N. në shumë prej 800 euro.

Kolegji ka shqyrtuar propozimin e Prokurorit të Shtetit, deklarinimin e të pandehurit, ka analizuar provat e siguruar nga gjyqtari i caktuar për këtë çështje dhe të gjitha shkresat e çështjes penale dhe ka gjetur :

Se propozimi për revokimin e dënimit me kusht është i bazuar.

Me dëgjimin e të dënuarit dhe zbatimin e veprimeve procedurale nga gjyqtari i kësaj gjykate , është vërtetuar se me aktgjykimin e plotfuqishëm PDP.nr._____, datë _____ i gjykuari nuk i ka paguar të ëmës së të miturit Q. Deri më 31. 12.2016 alimentacionin e prapambetur dhe as kërkesat e mëvonshme të arritura edhe pse ai është i punësuar në bankën “Procredit “ me seli në _____ dhe realizon të ardhura mujore prej 800€.

Sipas nenit 56 paragrafit 2. të KPK-së, nëse i dënuari në afatin e lënë nuk përmbush detyrimin e posaçëm që i ka caktuar gjykata në aktgjykim , gjykata mundet të revokoj dënimin me kusht . Në rastin konkret i gjykuari nuk e ka përmbushur obligimin në afatin e lënë me aktgjykimin e plotfuqishëm, e as që ka treguar gatishmëri për ta paguar nëse gjykata i ciklon afat

të ri të përmbushjes , ai as nuk e ka pa të arsyeshëm që të paraqitet në seancën e kolegjit edhe pse është thirrë në mënyrë të rregullt , nga kjo qartë rezulton se ai jo që nuk ka mundësi por nuk dëshiron ta përmbush detyrimin e përcaktuar me aktgjykimin e plotfuqishëm.

më së largu në afat prej një viti pasi te ketë kaluar afati i përmbushjes .

Nga sa u tha më sipër , gjykata në kuptim të nenit 55 të KPK-ës dhe nenit 519.par.4.i KPPK-ës, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit .

GJYKATA THEMELORE NË _____

Kp.nr. _____ Data _____

Procesmbajtësi,

Z.Z.

Kryetari i kolegjit,

T.P.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi , është e lejuar ankesa , në afat prej tri (3)

ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit,

nëpërmjet kësaj Gjykate.

PROCEDURA PËR MARRJEN E VENDIMIT PËR SHLYERJEN E DËNIMIT

NGA EVIDENCA (neni 520 KPPK-s)

Formulari 138

NJË FORMË E AKTVENDIMIT PËR SHLYERJEN E DËNIMIT ALTERNATIV-DËNIMIT ME KUSHT SIPAS DETYRËS ZYRTARE

Kp.nr. _____/

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin gjyqësor i përbërë: nga T.P, si kryetar kolegji, S.R. dhe B.K. anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Z.Z, si procesmbajtës,

në lëndën penale ndaj të gjykuarit B.B, nga _____ për shkak të veprës shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, të parashikuar nga neni 252 par.1. të Kodit Penal të Kosovës, në seancën e kolegjit të mbajtur _____ mori këtë,

A K T V E N D I M

Vërtetohet shlyerja e dënimit me kusht sipas aktgjykimit të gjykatës Themelore në _____ PDP.nr. _____ / _____, datë _____, me të cilën i akuzuar B.B. nga _____, nga babai S. Dhe e ëma Gj, i lindur më _____, në _____, është gjykuar për shkak të veprës penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, të parashikuar nga neni 252 par.1. të Kodit Penal të Kosovës, dhe është gjykuar me dënim burgimi prej katër(4) muajsh, ekzekutimi i të cilit në kuptim të nenit 51 të KPK-ës, i është shtyrë për një vit, me kusht që në këtë afat të mos kryejë veprë penale dhe përfaqësuesit ligjor të të miturit N.N. t'i paguajë shumën e papaguar të alimentacionit në shumë prej 800 euro, në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Shlyerja e dënimit me kusht ka për tu zbatuar në evidencën e të dënuarve.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, nr. _____ datë _____, i pandehuri L.M. nga _____, është shpallur fajtor për veprën penale shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës, të parashikuar nga neni 252 par.1. të Kodit Penal të Kosovës, dhe është gjykuar me dënim burgimi prej katër(4) muajsh, ekzekutimi i të cilit në kuptim të nenit 51 të KPK-ës, i është shtyrë për një vit, me kusht që në këtë afat të mos kryejë veprë penale dhe përfaqësuesit ligjor të të miturit N.N. t'i paguajë shumën e papaguar të alimentacionit në shumë prej 800 euro, në afat prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nga provat e proceduara është vërtetuar se i gjykuar në afatin e verifikimit (*sprovimit*)

nuk ka kryer ndonjë veprë tjetër penale, dhe në afatin e lënë i ka përmbushur detyrimet e posaçme që gjykata atij i ka caktuar me dënimin me kusht. Ndërsa sipas nene 522 të KPPK-ës, kur dënimi alternativ nuk revokohet pas një (1) viti nga dita e pushimit të kohës së verifikimit, gjykata e cila ka gjykuar në shkallë të parë merr aktvendim me të cilin e shlyen dënimin.

Nga sa u tha më sipër , gjykata në kuptim të nenit 522 të KPPK-ës , vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit .

GJYKATA THEMELORE NË _____

Kp.nr. _____ Data _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

Z.Z

T.P.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi , është e lejuar ankesa , në afat prej tri (3) ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet kësaj Gjykate.

Formulari 139

NJË FORMË E KËRKESËS PËR SHLYERJEN E DËNIMIT NGA EVIDENCA

Gjykatës Themelore në

OBJEKTI : *Kërkesë për shlyerjen e dënimit nga evidenca e të dënuarve*

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, PDP.nr. _____ / _____ datë _____ jam shpallë fajtor për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë , të parashikuar nga neni 333.par.2.të Kodit Penal të Kosovës, dhe jam gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti , dënimin e kam mbajtur në Burgun e Dubravës në Istog.

Për kohën e mbajtjes së dënimit kam pas sjellje të mira dhe asnjë herë nuk kam ardh ndesh me rendin shtëpiak dhe nuk kam pas asnjë vërejtje për ndonjë sjellje në kundërshtim me rendin shtëpiak në burg.

Më _____ e kam përfunduar mbajtjen e dënimit me burgim dhe pas katër (4) muajve janë punësuar në kompaninë e sigurimeve “Skifterat” me seli në _____, ku edhe tani punoj , në kompaninë ku punoj jam i vlerësuar si punëtor i sjellshëm dhe kam relacione të shkëlqyera si na raport me eprorët ashtu edhe me punëtorët tjerë.

Pas mbajtjes së dënimit nuk kam ardh në konflikt me ligjin dhe nuk kam konsumuar as edhe ndonjë kundërvajtje .Jam martuar ndërkohë dhe po presim lindjen e fëmijës së parë, bashkëshortja gjithashtu punon si infermiere në ordinancën “Dielli” me seli në _____.

Meqenëse edhe gjatë kohës së mbajtjes së dënimit në institucionin penitenciar , por edhe gjatë daljes nga ky institucion kam pas sjellje të mira, konsideroj se janë përbushur kushtet ligjore që dënimi në kuptim të nenit 104 të KPK-ës, të shlyhet nga evidenca.

Më _____

paraqitësi i kërkesës,

N.N.

Formulari 140

NJË FORMË E AKTVENDIMIT PËR SHLYRJEN E DËNIMIT NGA EVIDENCA ME KËRKESËN E TË DËNUARIT

Kp.nr. ____/

Gjykata Themelore në _____, në kolegjin gjyqësor i përbërë: nga T.P, si kryetar kolegji, S.R. dhe B.K. anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Z.Z, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të gjykuarit N.N, nga _____për shkak të veprës për asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë , të parashikuar nga neni 333.par.2.të Kodit Penal të Kosovës, në seancën e kolegjit të mbajtur _____ mori këtë,

AKTVENDIM

Dënimi me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti ,i shqiptuar të pandehurit N.N. nga _____ me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____ datë _____, ka për tu shlyer nga evidenca e të dënuarve.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, PDP.nr. _____ / _____ datë _____ N.N. nga _____ është shpallë fajtor për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë , të parashikuar nga neni 333.par.2.të Kodit Penal të Kosovës, dhe është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Pas një viti e gjysmë, nga mbajtja e dënimit , i dënuari ka paraqitë kërkesë për shlyerjen e dënimit në të cilën ka theksuar: Më _____ e ka përfunduar mbajtjen e dënimit me burgim dhe pas katër (4) muajve është punësuar në kompaninë e sigurimeve “Skifterat” me seli në _____, ku edhe tani punon , në kompaninë ku punon është i vlerësuar si punëtor i sjellshëm dhe ka relacione te shkëlqyera si na raport me eprorët ashtu edhe me punëtorët tjerë.

Pas mbajtjes së dënim nuk ka ardh në konflikt me ligjin dhe nuk kam konsumuar as edhe ndonjë kundërvajtje .

Nga veprimet e ndërmarra thëniet nga kërkesa e të dënuarit janë vërtetuar. Nga raporti i Institucionit ku i dënuari ka mbajtur burgun nr. _____ datë _____, rezulton se sjellja e të dënuarit gjatë kohës së mbajtjes së burgut ka qenë pa asnjë vërejtje. Nga raporti i stacionit policorë në _____, datë rezulton se i dënuar ka pas sjellje të mirë dhe nuk është skeduar as për kundërvajtje. Nga shkresa e kompanisë “Skifterat” datë _____-, rezulton se i dënuar ka sjellje të shkëlqyera me të gjithë.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore në _____ me parashtrësën KP.nr. _____ / _____ datë _____, ka shprehë mendimin se kërkesa është e bazuar dhe ka propozuar që të miratohet .

Pas vlerësimit të kërkesës së të dënuarit , të dhënave të grumbulluara gjatë ndërmarrjes së veprimeve procedurale, si dhe mendimi i prokurorit të shtetit, gjykata ka gjetur se janë përmbushur kushtet nga neni 104.i KPK-ës, që të shlyhet dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, PDP.nr. _____ / _____ datë _____ N.N. Sjellja e të dënuarit gjatë mbajtjes së dënimit dhe pas mbajtjes së

dënimit, si dhe natyra e veprës penale të cilën e ka kryer, janë të tilla që justifikojnë shlyerjen e dënimit.

Nga sa u tha më sipër , gjykata në kuptim të nenit 523 të KPPK-ës , vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit .

GJYKATA THEMELORE NË _____

Kp.nr. _____ Data _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

Z.Z.

T.P.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi , është e lejuar ankesa , në afat prej tri (3)

ditësh, nga dita e marrjes së aktvendimit, Gjykatës së Apelit,

nëpërmjet kësaj Gjykate.

Formulari 141

PROCEDURA PËR KOMPENSIM PËR SHKAK TË PARABURGIMIT OSE DËNIMIT TË PALIGJSHËM

KËSHILLIT GJYQËSOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

OBJEKTI: *Kërkesë për kompensimin e dëmit*

Me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut -----, P.nr. _____ datë _____, jamë shpall fajtor për shkak të veprës penale të grabitjes të parashikuar nga neni 329. par.1. të LPK-së dhe jamë dënuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh. Kundër këtij aktgjykimi kamë parashtruar ankesë, e cila me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.nr. _____ datë _____, është refuzuar si e pabazuar. Pas shkuarjes në mbajtje të dënimit i kam paraqitur Gjykatës Themelore në _____, kërkesë për rishikimin e procedurës meqë kam siguruar prova se veprën penale e ka kryer personi tjetër.

Kërkesa ime është aprovuar, është lejuar rishikimi i procedurës me aktvendimin e Gjykatës , Kp.nr. _____ datë _____.

Në procedurën e rishikuar (*përsëritur*) jam liruar nga aktakuza me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës _____, P.nr. _____ datë _____. Në mbajtje të dënimit dhe në paraburgim kam qëndruar gjithsej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj.

Në momentin e privimit nga liria kam punuar në Ndërmarrjen “Pastrimi” në _____ dhe kam marrë të ardhura mujore në shumë prej 400 euro.

Për shkak të gjykimin të padrejtë kam pësuar dëm për fitimin e humbur në Ndërmarrjen “Pastrimi” në shumë prej _____ euro.

Meqenëse unë jam me profesion hidraulik përpos punës në ndërmarrje kam punuar pas orarit të punës në instalimin e ujit e që për muaj kam realizuar deri në 500 euro dhe të gjitha këto janë paraqitur te organet tatimore edhe në këtë aspekt kam humbur _____ euro.

Së fundi për shkak të udhëheqjes së procedurës penale dhe gjykimin të padrejtë gjatë gjithë kohës kam përjetuar vuajtje shpirtërore të intensitetit të lartë ngase asnjëherë më parë nuk kam qenë në konflikt me ligjin, nuk janë përgjigjur para gjykatës e që sipas mendimit dhe vlerësimit tim më është shkaktuar dëm jo material në shumë prej _____ euro.

Vlera e përgjithshme e dëmit që kam pësuar për shkak të këtij procesi dhe dënimi kap shumën prej _____ euro.

Sipas nenit 525 . të KPPK-ës, të drejtë në kompensimin e dëmit për shkak të gjykimin të padrejtë mes tjerave i takon edhe personit të cilit i janë shqiptuar sanksioni penal, ndërsa më vonë me mjete të jashtëzakonshme është liruar nga akuza.

Meqë më takon e drejta në kompensimin e dëmit kërkoj nga institucioni përkatësisht Këshilli Gjyqësor që në kuptim të nenit 525 të KPPK-ës , të më paguajë shumën prej _____ euro, në të kundërtën, nëse institucioni nuk vendos brenda 3 (tre) muajsh, unë do të paraqes padi për kompensimin e dëmit gjykatës së rregullt.

Sqarim :

Të drejtën e kompensimit e kanë të gjithë ata që janë dënuar pa bazë, me përjashtim të rasteve nga neni 525.nënp.1.1 dhe 1.2 dhe nga paragrafi 2.Kërkesa duhet të paraqitet në afat prej tri(3) vitesh pas formës së prerë të aktgjykimin të shkallës së parë me të cilin i akuzuar është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e të vendimit me të cilin hudhet aktakuza ose pushohet procedura. Për kërkesën vendosë komisioni i themeluar nga KGJK-ës, nëse i dënuari nuk pajtohet me shumën e ofruar të kompensimit nga komisioni ka të drejt të paraqes padi në gjykatë për kompensim.

Formulari 142

PROCEDURA PËR DHËNIEN E LETËRSHTIMIT (neni 534 i KPPK-s)

URDHËRESË PËR DHËNIEN E LETËRSHTIMIT (Neni 535 të KPPK)

PPH. _____ / _____

Gjyqtari i procedurës paraprake M.M. me bashkëpunëtorin profesional A.F. si procesmbajtës, në çështjen penale e të pandehurit B.B., për shkak të veprës penale të grabitjes parashikuar nga neni 329. par. 1 të KPK-ës, duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore _____ më datë _____, jep këtë:

U R D H Ë R E S Ë S

Për të pandehurin B.B. nga _____, nga i ati B dhe e ëma N, i lindur më 15.11.1983 në _____, komuna _____, me vendbanim të përhershëm në Rr. "Hajdar Dushi" nr. 13/3, me profesion elektrikist, i dënuar edhe më parë për veprën penale të vjedhjes së rëndë, me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës _____ P.nr. _____, datë _____, ka për t'u lëshuar

LETËRSHTIMI

Pas gjetjes se i pandehuri duhet të sillet në Gjykatën Themelore në _____.

Letër shtimin duhet ta jep Shërbimi Policor i Kosovës në _____.

A r s y e t i m

Pranë Prokurorisë Shtetërore të Prokurorisë Themelore në _____, udhëhiqet procedurë penale kundër të pandehurit B.B., nga _____, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale të grabitjes , të parashikuar nga neni 329.par.1, të KPK-ës.

Gjatë veprimeve para penale me rastin e dhënies së deklaramit në polici i pandehuri është deklaruar se jeton në Prishtinë, Rr. E “Bledit” nr. 12/45. Mirëpo, kur Prokurori i ka dërguar ftesë e njëjta i është kthyer atij me konstatim se i pandehuri nuk ndodhet në adresën e theksuar. Ka rezultuar se i pandehuri ka lëshuar edhe vendin e punë në Kompaninë e Sigurimeve “Besa Securit” dhe ka shkuar në drejtim të panjohur.

Me kërkesë të Prokurorit Stacioni Policor nr. 4 në Prishtinë ka kërkuar vendndodhjen e të pandehurit, por nuk ka mundur ta gjejë çka është konstatuar në shkresën nr. 13/12 të datës 15.10.2012. Me aktvendimin e kësaj Gjykate PPH.nr. _____ datë _____, kundër të pandehurit është caktuar paraburgimi në bazë të nenit 187. par. 1.nënp.1.1 dhe nënp.1.2.1 të KPK-ës.

I pandehuri ndodhet në arrati. Kundër të njëjtit udhëhiqet procedurë për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën mund të shqiptohet dënimi mbi 2 (dy) vjet burgim.

Meqenëse janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për dhënien e letërshtimit në kuptim të nenit 535 të KPPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE N. _____

PPH.nr. _____, më datë _____

Procesmbajtësi

Gjyqtari i procedurës paraprake

PROCEDURA PËR DHËNIEN E SHPALLJES

(neni 536 i KPPK-s)

Formulari 143

URDHËRESË PËR DHËNIEN E SHPALLJES

(Neni 536 i KPK)

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore _____ me procesmbajtësin P.P. në lëndën penale të pandehurit M.M. nga _____, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik parashikuar nga neni _____, par. _____ të KPK, më datë _____, murr këtë:

U R D H Ë R E S Ë S

Me qëllim të gjetjes së automjetit të markës “Pasar” me tabela të regjistrimit _____, ngjyrë metalike, pronë e të pandehurit M.M. nga _____, jepet

SHPALLJE PUBLIKE

Me rastin e gjetjes së automjetit i njëjti duhet t’i dorëzohet Prokurorit Shtetëror të Prokurorisë Themelore në _____.

Urdhëresën do e zbatoj Stacioni Policor nr. 3 në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Prokurorisë Shtetërore të Prokurorisë Themelore në _____, janë duke u zbatuar hetime ndaj të pandehurit M.M. për shkak të dyshimit

të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik parashikuar nga neni _____ të KPK.

Duke vendosur sipas propozimit të Prokurorit të Shtetit gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore _____, ka caktuar paraburgimin ndaj të pandehurit në kuptim të nenit _____ par. _____.

I pandehuri pas aksidentit të komunikacionit ka ikur nga vendi i ngjarjes. Është gjetur nga ana e Shërbimit Policor dhe i është dorëzuar gjyqtarit të procedurës paraprake. Mjeti me të cilin i pandehuri ka shkaktuar aksidentin nuk është gjetur. Meqenëse mjeti me të cilin e ka drejtuar i pandehuri kur është shkaktuar aksidenti nuk është gjetur, cili është qëndrimi në lidhje penale për të cilin janë duke u zbatuar hetimet, është vendosur si në dispozitiv të kësaj Urdhërese, në bazë të nenit 336 par. 1 të KPPK.

Prokurori Shtetëror i Prokurorisë Themelore

Hp.nr. _____, datë _____

Procesmbajtësi,

Prokurori Shtetëror,

PROCEDURA E EKZEKUTIMIT TË SANKSIONIT PENAL

(Ligji Për ekzekutimin e Sankcioneve Penale)

Formulari 144

LUTJA PËR SHTYERJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNIMIT ME BURG

(Neni 20. të Ligjit për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale)

GJYKATËS THEMELORE NË _____

-Kryetarit-

OBJEKTI: Lutje për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit

Me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në _____, P.nr15/ datë _____, jam shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhjes të parashikuar nga neni 325 par.1., të KPK-ës dhe jam gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1(një) viti.

Më datë 3 maj të vitit _____, kam pranuar nga kjo Gjykatë ftesën që të paraqitem për të shkuar në mbajtje të dënimit më datë _____.

Unë jam student i vitit të III-të të Fakultetit Teknik-Dega e Makinerisë dhe tani jemi në prag të provimeve të afatit të qershorit. Për këtë arsye kërkoj nga kryetari që të ma shtyjë vuajtjen e fillimit të dënimit së paku për 3 (tre) muaj, me qëllim që t'i përgatis dhe t'i nënshtrohem provimeve të afatit të qershorit.

Provë: *Indeksi nr. _____, lëshuar nga Fakulteti Teknik-Dega e Makinerisë*

Prishtinë.

Meqenëse janë përmbushur kushtet nga neni 20.par.1.nënp.1.t8të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit lus kryetarin e gjykatës që të më shtyjë fillimin e mbajtës së dënimit deri më 10 korrik të vitit 2012.

Datë: _____

I dënuari S.B.

Formulari 145

NJË FORMË E AKTVENDIMME TË CILIN REFUZOHET LUTJA PËR SHTYERJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNIMIT ME BURGIM

(neni 23 LESP)

Ed.nr.____/2013

Kryetari i Gjykatës Themelore në _____ F.F., duke vendosur sipas lutjes së të dënuarit M.B. nga _____, për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim, në bazë të nenit 23 par. paragrafi 2.nënp.2.3. të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale më datë _____ mori këtë:

AKTVENDIMI

Refuzohet si e pabazuar lutja e të dënuarit M.B. nga _____, për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit, sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në P.nr. _____/2013 datë _____.

I dënuari është i detyruar që ditën në vijim pas pranimit të këtij aktvendimi t'i paraqitet Gjykatës Themelore në _____, me qëllim të fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim.

A r s y e t i m

I dënuari M.B., nga _____, komuna _____, ka paraqitur kësaj Gjykate lutje për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim, në të cilën ka theksuar se ndodhet në vllugun e punimeve bujqësore dhe se (*korrije dhe shirjeve*) dhe se është i vetmi fuqi punëtorë në shtëpinë e tij dhe me që jeton nga bujqësia shkuarja e ti në burg në këto rrethana, do e dëmtonte familjen e tij në aspektin e përfundimit të punimeve bujqësore, ngase nuk ka anëtarë tjetër të familjes që do merrej me punë bujqësore.

Gjykata nuk përfilli lutjen e të dënuarit, ngase nga provat që i ka proceduar ka ardhur në përfundim se i dënuari jeton në bashkësi familjare me babain i cili është i aftë për punë, nënën dhe tre vëllezër madhor, andaj del se pretendimi i tij, se është fuqi e vetme punëtorë është I pabazuar.

Nga të shtruara më lartë, gjykata në përputhje me nenin 23.par.2.nënp.2.3. të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë kryetarit

të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate

në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

Sqarim :

Ligji Për Ekzekutimin e Sanksioneve në nenin 23.paragrafi 2.ka përdorë shprehjen e hedh në rastin se lutja është e pasafatshme, e paraqitur nga personi i paautorizuar por edhe kur i dënuari

nuk ka paraqitur prova, *konsideroj se* lutja do duhej refuzuar kur kryetari vendos meritorisht për të , aq më parë kur edhe neni 25.par.2. i ligjit të cituar e përmend shprehjen “*nëse edhe pas refuzimit të dytë*”Parashtrësa hedhet për arsye –pengesa procedurale, mirëpo kur për të vendoset meritorisht ajo ose pranohet ose refuzohet .

Formulari 146

AKTVENDIM MBI SHTYRJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNIMIT ME BURGIM

(*neni 20.LESP*)

ED.nr. _____ 2013

Kryetari i Gjykatës Themelore në _____ F.F., duke vendosur sipas lutjes së të dënuarit L.S. nga _____, për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim, në bazë të nenit 20 par. 1 .nënp.1.8. të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale , më datë _____ mori këtë:

A K T V E N D I M

Shtyhet fillimi i mbajtjes së dënimit me burgim sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në _____, P.nr. _____ datë _____, e të dënuarit L.S. nga _____, në afat prej 2 (dy) muajsh.

I dënuari është i detyruar që me këtë aktvendim dhe thirrjen që ka pranuar nga kjo Gjykatë t’i paraqitet Qendrës Edukuese Korrektuese në Dubravë më datë _____ me qëllim të mbajtjes së dënimit.

I dënuari L.S. nga _____, i ka paraqitur kësaj Gjykate lutje për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim në të cilën ka theksuar se është student i vitit të II-të të Fakultetit Teknik – Drejtimi i Arkitekturës dhe se tani ndodhet në fazën e afatit qershor të provimeve dhe me shkuarjen e tij në mbajtjen e dënimit do e dëmtonte në aspektin e humbjes së mundësisë për t’iu nënshtruar provimeve në këtë afat, për këtë ka dorëzuar ID-në nr. _____, me

të cilën rezulton se është student i Fakultetit Teknik si dhe fletë paraqitjen nga e cila del se i ka paraqitur gjashtë provime në afatin e qershorit.

Kryetari i gjykatës duke i shqyrtuar pretendimet e paraqitura në lutje dhe provat tjera që janë bashkangjitur lutjes së ID-në nr. _____, fletëparaqitjen për paraqitjen e provimeve, ka gjetur se në rastin konkret ekzistojnë shkaqet e arsyeshme për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit në kuptim të nenit 20.par.1.nënp.1. të LESP.

Nga të shtruara më lartë konform nenit _____ par. _____, të ligjit të cituar u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës F.F.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë kryetarit

të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate

në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit

Formulari 147

ANKESA NDAJ AKTVENDIMIT ME TË CILIN ËSHTË REFUZUAR LUTJA PËR SHTYERJEN E FILLIMIT TË MBAJTJES SË DËNIMIT

(Neni 24. LESP)

GJYKATËS THEMELORE NË _____

Për kryetarin e Gjykatës së Apelit Prishtinë

Kundër aktvendimit të kryetarit të Gjykatës Themelore në _____, Ed.nr. _____, datë _____, në bazë të nenit 24. të LESP, në afatin ligjor paraqes.

A N K E S Ë

Me aktvendimin e kryetarit të Gjykatës Themelore në _____, Ed.nr. _____, datë _____, është refuzuar si e pabazuar lutja ime për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit me burgim, me çka jam dënuar me aktgjykimin e Gjykatës

Themelore në _____, P.nr. _____ datë _____, meqë nuk i plotësoj kushtet ligjore të parashikuar nga neni 20.par.nënp.1.1. të LESP.

Vendimin e vet kryetari i Gjykatës e ka mbështetur në mendimin e mjekut _____ ekspertit S.S. i cili në bazë të shikimit të dokumentacionit mjekësor që i është bashkangjitur lutjes ka gjetur se nuk ekzistojnë arsye mjekësore për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit.

Konsideroj se aktvendimi i atakuar nuk është i mbështetur në ligj për arsye si në vijim:

Nga raporti mjekësor i Qendrës Spitalore në _____ datë _____ numri i raportit _____ shihet se lëndimi është i rëndë, se plaga me vështirës dhe më ngadalësi po shërohet, që është sigurisht pasojë e diabetit nga i cili vuaj, se gjendja e këtyre lëndimeve akoma është akute dhe nuk është e sigurt se sa do të zgjasë kjo gjendje. Nga kjo qartë rezulton se unë nuk jam në gjendje të punojë e as ta mbajë dënimin.

Mjeku ka dhënë mendimin në bazë të dokumentacionit mjekësor që i është bashkangjitur lutjes, duke mos u thelluar shumë në këtë dokumentacion ndoshta edhe duke konsideruar si të vjetër. Mirëpo, mjeku-eksperti ka pasur mundësi që në bazë të kontrollimit të lëndimeve të mija të vërtetojë gjendjen reale të shëndetit tim dhe sigurisht atëherë nuk do të jepte mendim se nuk ekzistojnë arsyet mjekësore për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit, për këtë arsye,

P r o p o z o j

Që kryetari i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për arsyt e përshkruara më lartë dhe në bazë të nenit _____, par. _____ të LESP, ta ndryshojë aktvendimin e kryetarit të Gjykatës Themelore në _____, Ed.nr. _____ datë _____, dhe të ma shtyjë fillimin e mbajtjes së dënimit me burgim, ose këtë aktvendim ta anuloj dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Në _____

Datë _____

I dënuari N.B.

Formulari 148

AKTVENDIM I KRYETARIT TË GJYKATËS SË APELIT LIDHUR ME ANKESËN (neni 24.LESP)

E.Agj.nr. _____/2014

Kryetari i Gjykatës së Apelit Prishtinë N.N., në çështjen e shtyrjes së fillimit të mbajtjes së dënimit të të dënuarit L.S. nga _____, duke vendosur sipas ankesës të të dënuarit paraqitur ndaj aktvendimit të kryetarit të Gjykatës Themelore _____, Ed.nr. _____ datë _____ më _____ mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të dënuarit L.S. nga _____, ndërsa aktvendimi i kryetarit të Gjykatës Themelore _____, Ed.nr. _____, datë _____, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e kryetarit të Gjykatës Themelore _____, Ed.nr. _____ datë _____, është refuzuar lutja e të dënuarit L.S. për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, sipas aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore _____, Ed.nr. _____ datë _____.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ankesë ka paraqitur i dënuari për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe ka propozuar që aktvendimi i atakuar të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shtyhet fillimi i mbajtjes së dënimit për 2 (dy) muaj .

Kryetari i Gjykatës së Apelit ka shqyrtuar ankesën, aktvendimin e shkallës së parë si dhe shkresat tjera të çështjes dhe ka gjetur:

Ankesa është e pabazuar.

Në ankesë pa të drejtë thuhet se janë përmbushur konditat ligjore për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit në kohë të pacaktuar për shkak të problemeve shëndetësore që i dënuari ka, veçmas për shkak se plaga që ka në këmbën e majtë nuk i është sanuar si pasojë e sëmundjes së diabetit, ngase nga mendimi i ekspertit rezulton se përkundër faktit se i dënuari ka një plagë dhe ajo akoma nuk është shëruar plotësisht e njëjta nuk është e natyrës që do t'i sillte vështirësi të dënuarit që të fillojë mbajtjen e dënimit ngase lëndimet e tilla nuk kërkojnë ndonjë trajtim special dhe terapia mund t'i ofrohet në institucionin edukues korrektues. Nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit qartë rezulton se nuk ka indikacione mjekësore që do të justifikonin shtyrjen e mbajtjes së dënimit me burgim.

Për arsyet e përshkruara më lartë konform nenit 24.par.2. të LESP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sqarim :

Ligji Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përpos që parashih mundësinë e ushtrimit të ankesës kryetarit të Gjykatës së Apelit (*neni 24*), nuk i ka rregulluar mënyrat e vendosjes nga ana e kryetarit të Gjykatës së Apeli lidhur me ankesën, përkundër këtij vakumi ligjorë konsideroj se kryetari përpos mundësive tjera (*ta refuzoj ankesën*) duke e pranuar ankesën si të bazuar mund ta ndryshoj aktvendimin e kryetarit të gjykatës themelore dhe t'ia shtyjë mbajtjen e dënimit të dënuarit, nëse gjen se janë plotësuar kushte ligjore për shtyrje.

PROCEDURA PËR FALJE

(Ligji Për Faljen)

Formulari 149

LUTJE PËR FALJE

Ministritë së Drejtësisë në Prishtinë

OBJEKTI : *I dënuari* _____ *Lutje për falje.*

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore _____, P.nr _____ datë _____, i cili është vërtetuar edhe me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Ap.nr. _____ datë _____, jam gjykuar për shkak të veprës penale të vrasjes në tentativë, të parashikuar nga neni 179 lidhur me nenin 28 të KPK-së, me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh. Në dënimin e shqiptuar më është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej _____ deri më _____.

Në mbajtje të dënimit ndodhem në Qendrës Korrektuese Edukuese në Dubravë prej _____, ashtu që kam mbajtur 2/3 e dënimit. Veprën penale të vrasjes në tentativë e kam kryer në një gjendje delikate shpirtërore për shkak të provokimeve të shpeshta që po i bënte i dëmtuari gruas sime F.F., kam tentuar disa herë që nëpërmes njerëzve të ndikojë te i dëmtuari që të pushojë së provokuari të bashkëshortes sime mirëpo ajo ka qenë e pa efekt , ngase ai edhe më tej ka filluar me të njëjtat sjellje dhe duke mos u shmangur nga këto provokime edhe atëherë kur unë isha në shoqërinë e gruas sime. Ditën kritike sjellja e tillë arriti kulminacionin e mos durimit tek unë dhe në një moment fatkeq duke mos qenë në gjendje që të gjykojë drejtë dhe të kontrolloj sjelljet e mija nxora revolen dhe shtënë disa herë në drejtim të të dëmtuarit duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore.

Vetë procesi gjyqësor që është zhvilluar ndaj meje si dhe pjesën e dënimit që gjer më tani e kam mbajtur, tek unë kanë ndikuar në aspektin pozitiv deri në atë masë sa që qëllimi i dënimit është arritur. Këtë e vërteton edhe sjellja ime në Entin Edukues Korrektues në Dubravë.

Pas shkuarjes sime në mbajtje të dënimit në familjen time ka ndodhur një tragjedi, ngase në një aksident komunikacioni ka humbur jetën bashkëshortja ime F.F., kështu që katër fëmijët e mijë të mitur më i madhi nga këto vajza L.F. i ka vetëm 17 vjet kanë ngelur në mëshirën e askujt.

Për këtë arsye kërkoj nga Presidenti i Shtetit që ta ma fal pjesën e mbetur të dënimit.

Datë _____

Parashtruesi B.E.

Enti Edukues Korrektues - Dubravë

PROCEDURA PËR KTHYERJEN E SENDIT

Formulari 150

AKTVENDIM PËR KTHYERJEN E PASAPORTËS

Kp.nr. _____

Gjykata Themelore _____ në kolegjin në përbërje prej B.B kryetar kolegji, L.B. dhe K.H. anëtar kolegji, me procesmbajtësen F.S., në çështjen penale kundër të akuzuarit Z.F., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, të parashikuar nga neni 378, par. 9. lidhur me par.1 të KPK-së, duke vendosur sipas lutjes së të akuzuarit për t'ia kthyer dokumentin e udhëtimit-pasaportën, në bazë të nenit 28 par.1, të Ligjit për Dokumentet e Udhëtimit, në seancën e kolegjit të mbajtur më _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.I lejohet kthyerja e dokumentit të udhëtimit-pasaporta të akuzuarit Z.F. nga babai H. nëna L. e lindur B. i lindur më _____ në _____, i cili me aktgjykimin akoma jo të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore _____ P.nr. 112/2014 datë 31.9.2014, është gjykuar për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.par.9.lidhur me par.1 të KPK-së, në kohëzgjatje prej 1 (një) viti burgim.

II.Pranohet shuma prej 20.000 euro që ka ofruar i akuzuari si garanci se pas kryerjes së punëve në botën e jashtme do të kthehet në vendlindje.

III.Kjo shumë nga pika II. do të vendoset në depozitën e Gjykatës Themelore _____.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin akoma jo të plotfuqishëm të Gjykatës Themelore _____, P.nr. 112/2014 datë 31.9.2014, i pandehuri Z.F. është shpallur fajtor

për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378.par.9.lidhur me par.1.të KPK-së dhe është gjykuar me dënim burgimi në afat prej 1 (një) viti.

I akuzuari Z.F. i ka paraqitur kësaj Gjykate lutjen që t'i lirohet dokumenti i udhëtimit-pasaporta e cila i është dorëzuar në Stacionin Policor nr. 4 në Prishtinë, duke theksuar se pasaporta është e domosdoshme ngase i duhet urgjent të udhëtoj në botën e jashtme, ngase është fjala për punë e cila kërkon prezencën e tij, ndërsa si dorëzani se do të kthehet në Kosovë ka ofruar 20.000 euro.

Kësaj lutje i ka bashkangjitur edhe shkresën e ndërmarrjes _____ me seli në _____, në të cilën është theksuar se ekziston nevoja e udhëtimit urgjent në botën e jashtme e menaxherit kryesor të tregtisë së jashtme e tani të akuzuarit Z.F, me qëllim të inspektimit të disa punëve që është duke i kryer kjo kompani në Zvicër.

Kolegji penal i kësaj Gjykate duke vendosur në bazë të nenit 180.par.5 të KPPK-ës, ka gjetur se lutja e të akuzuarit është e bazuar, andaj mori vendim si në dispozitiv.

Përfundimi i këtillë mbështetet në shkaqet që i akuzuari i ka theksuar në lutjen e tij të cilat janë edhe të mbështetura në shkresën e Kompanisë _____ me seli në _____, andaj mund t'i lejohet kthimi i dokumentit të udhëtimit-pasaportës të akuzuarit Z.F, e kjo edhe për faktin se i akuzuari ka ofruar *dorëzani* (garancion)se pas kryerjes së punëve në botën e jashtme do të kthehet në vendlindje , dhe të cilën dorëzani (*garancion*)kolegji i kësaj Gjykate e ka pranuar.

Procesmbajtësi,

F.S.

Kryetari i kolegjit,

B.B.

KËSHILLA JURIDIKE. Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë

Gjykatës së Apelit në afat prej 3 ditësh nëpërmjet
të kësaj Gjykate.

LITERATURA

PJESA E PËRGJITHSHME:

- Austen L. Parrish: Dennis T. Yokoyama. Effective Lawyering - A Checklist Approach to Legal Writing & Oral Argument. ch.1(2d ed. Carolina Academic Press 2012).
- Nadia E. Nedzel, " Legal Reasoning, and Writing for International Graduate Students, ch. 3 (3d. Wolters Kluwer Law Busines in New York 2012).
- Fejzullah Hasani, gjyqtar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Prof. James Moliterno, Prof. As. Dr. Valentina Hoxha, USAID, Projekti për Mbështetjen e Drejtësisë në Kosovë "Shkrimi, Arsjetimi dhe Hulumtimi Ligjor"(Instituti Gjyqësor i Kosovës në Prishtinë, 2008).
- Mirela Bogdani " Shkrimi & Arsjetimi Ligjor (cikël leksionesh -Tiranë, 2015
- Sokol Berberi "Arsjetimi dhe Shkrimi Ligjor (Ribotim- Tiranë, 2012).
- L'Heureux-Dube, Claire. "The Dissenting Opinion: Voice of the Future?."Osgoode Hall Law Journal38.3 (2000) : 495-517.
<http://digitalcommons.osgoode.yorku.ca/ohlj/vol38/iss3/4>
- Writing Reasoned Decisions and Opinions: A Guide for Novice, Experienced, and Foreign Judges S.I. STRONG.
- Making your case: The art of persuading judges, Justice Antonin Scalia and Bryan E. Garner, ThomsonWest, May 2008, p.109.9.
- Anderson, D. Schum and William Twining, Analysis of Evidence, fq. 60-62 (Botimi i dytë. Cambridge 2005).
- Curtin, Alifya V. and Solomon, Lisa and Lebovits, Gerald, Ethical Judicial Opinion Writing (Spring 2008). Georgetown Journal of Legal Ethics, Vol. 21, p. 237, 2008. Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract>.
- Judicial Writing Manual 1991, Federal Judicial Center.
- [http://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/judicial-writing-manual-2d-fjc-2013.pdf/\\$file/judicial-writing-manual-2d-fjc-2013.pdf](http://www.fjc.gov/public/pdf.nsf/lookup/judicial-writing-manual-2d-fjc-2013.pdf/$file/judicial-writing-manual-2d-fjc-2013.pdf)
- missourilawyershelp.org/wp-content/uploads/2015/06/What-is-IRAC.pdf
- Trautman, Lawrence J. and Taylor, Cathy L. and Ford, Janet, Irac! Irac! Irac!: How to Brief a Supreme Court Opinion (August 21, 2016). Available at SSRN: <https://ssrn.com/abstract=2827285>

- See, e.g., Oberster Gerichtshof, 10 December 1992, 15 0s 150 / 92; 4 June 1996, 11 0s 59 / 96 and 20 March 2001, 11 0s 141 / 00.

Orin S. Kerr, How to Read a Legal Opinion, 11 GREEN BAG 2d 51 (2007)

PJESA E LIDHUR ME ZBATIMIN E LPK-SË

Faik Brestovci, Iset Morina & Rustem Qehaja, E Drejta Procedurale Civile-Procedura Kontestimore, Prishtinë 2017.

Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile I dhe II, Prishtinë 2006.

Faik Brestovci, E Drejta Procedurale Civile Ndërkombëtare, Prishtinë 2000.

Faik Brestovci, Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Prishtinë, 2004.

Arsen Janevski & Tatjana Zoroska-Kamilovska, e Drejta Procedurale Civile-E Drejta Kontestimore, Shkup 2009.

Flutra Kolaj-Tafaj & Asim Vokshi, Procedurë Civile, Pjesa I, Tiranë 2003.

Iset Morina & Selim Nikçi “Komentari” Ligji për Procedurën Kontestimore, Prishtinë 2012.

Osman Ismaili, Fillet e së Dretës, Prishtinë, 2004.

Radomir Llukiq & Budimir Koshutiq, Fillët e së Dretës, Prishtinë 1986.

Radomir D. Llukiq, Metodologjia e së Drejtës, Prishtinë 2012.

Steven J. Burton, Hyrje në të Drejtën dhe Arsyetimin Ligjor, Tiranë 2000.

Enver Hasani & Ivan Cukalovic, “Komentari” Kushtetuta e Republikës së Kosovës, botimi I, Prishtinë 2013.

Muahrrem Shala, Albert Zogaj, Valon Totaj & Zenel Leku, Doracaku i Gjyqtarëve për Procedurën Kontestimore, Prishtinë 2015.

Mit’hat Shamiq, Si shkruhet vepra shekncore, Shkup, Prishtinë, Tiranë 2006.

Kadri Bicaj, Metodologjia dhe Shkrimi Ligjor, Prishtinë 2012.

Majlinda Nishku, Si shkruajm, Procesi dhe Shkrimi Funkcional, Tiranë 2004.

Petraq Çuri, E Drejta Procedurale Civile & Noteria, Tiranë 2008.

Jani Vasili, Procedura Civile, Tiranë 2010.

Arta Vorpsi, Procesi i rregullt ligjor në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, Tiranë 2011.

Marek Antonio Noëicki, Rreth Konventës Evropiane, Tiranë 2003.

Michael A. Cunniff & Albert Zogaj, Moduli-Shkathësitë e Arsytimit dhe Shkrimit Ligjor për Gjyqtarë, IGJ Prishtinë 2013.

Fejzullah Hasani, James Moliterno & Valentina Hoxha, Shkrimi, Arsytimi dhe Hulumtimi Ligjor, Prishtinë 2008.

Mirela Bogdani, Shkrimi & Arsytimi Ligjor, Tiranë 2015.

Zëegert & H.Kotz, Njohuri për të Drejtën e Krahasuar, Tiranë 1994.

Sokol Berberi, Arsytimi dhe Shkrimi Ligjor, Tiranë 2012.

Vehbi Miftar, Shkrimi Akademik, Prishtinë 2013.

Jeffrey Joëll QC & Jonathan Cooper, Të Kuptuarit e Parimeve mbi të Drejtat e Njeriut, Oxford dhe Portland, Oregon 2001.

Rija Hanski & Markku Suki, Hyrje në Mbrojtjen Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Prishtinë 2001.

Ëilliam H. Putman, Legal Analysis and Ēriting, SHBA 2009.

Pamela R. Tepper, Basic Legal Ēriting for Paralegals, SHBA 2009.

Ēolfgang Benedek, Kuptimi i të Drejtave të Njëriut-Manula për Arsimimin për të Drejtat e Njëriut, tiranë 2000.

Peter Bydlinski, E Drejta Civile, Vëllimi I, Pjesa e Përgjithshme, Vjenë 2013.

Abdulla Aliu, E Drejta Civile, Prishtinë 2013.

Zyra e Komisarariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në Bashkëpunim me Odën Ndërkombëtare të Avokatëve, Të Drejta e Njeriut në Administrimin e Drejtësisë, Tiranë 2003.

Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut-Këshilli i Evropës, E Drejta për një Proces të Drejtë Gjyqësor-Një Udhëzues për Implementimin e nenit 6 të KEDNJ.

Gjykata Supreme e Kosovës, Buletini i Praktikës Gjyqësore, Prishtinë, 2011, vëllimi 1.

Gjykata e Apelet, Buletin i Praktikës Gjyqësore 1, Prishtinë 2015.

Gjykata e Apelit, Buletin i Praktikës Gjyqësore 2, Prishtinë 2016.

Gjykatat e Qarkut Kosovë, Buletini i Praktikës Gjyqësore, Prishtinë, 2011, vëllimi 2.

Gjykata Supreme e Kosovës, Përmbledhje e Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Rastet Pronësore, Prishtinë, 2011.

AKTE, KODE, LIGJE, RREGULLORE DHE RAPORTE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Themelore të Njeriut, 1950.

Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, shpallur me datën 09.08.2010, GZ.79/24.08.2010, që ka hy në fuqi me 01.01.2013.

Ligji për Procedurën Kontestimore

Ligji për Procedurën Përmbartimore

Ligji për procedurën Jokontestimore

Ligji për Zgjidhjen e Kolizionit të Ligjeve me dispozita e shteteve tjera në marrëdhëniet e caktuara- Gazeta Zyrtare të RSFJ nr.43/82 dhe me përmirësimin në nr.72/82.

Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve

Ligji nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.8, e datës 08.04.2013.

Kodi i Etikes Profesionale për Gjyqtarë, 2016

Rregullorja, 04/2016 Për Përcaktimin e Sjelljeve të Pahijshme

Ligji për Procedurën Kontestimore, (i vjetri)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Rastin nr. KI72/12, Prishtinë, më 07. Dhjetor 2012.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Rastin nr. KI18/16, më datë 15 korrik 2016.
Gjykata Supreme e Kosovës, Rev. Nr.15/2015, të datës 11.05.2015
Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me vendimin Ac.nr.1761/13, dt. 10.03.2017
Gjykata Supreme e Kosovës, me Rev.nr.182/2016, dt.04.10.2016.
Gjykata e Apelit e Kosovës, AC.nr.3732/13, të datës 16.12.2016
Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me vendimin Ac.nr.3390/14, dt. 13.03.2017
Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me vendimin Ac.nr.3732/13, dt. 16.12.2016
Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i përgjithshëm, C.nr.3135/12, dt.05.02.2014
Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.421/2007, dt.11.02.2011
Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 1236/13, . 29.10.2014
Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1304/13, dt.11.07.16
Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.503/12 , dt. 02.12.2014
Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.61/09, dt.02.10.2012.
Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.2101/05, 10.02.2011.
Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr.2661/05, 20.06.2011
Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1499/05, dt.07.10.2013
Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.711/08 dt.22.05.2012
Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.699/09, dt.11.12.2013
Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2955/12, dt.18.12.2012
Gjykata Komunale në Prishtinë, C.nr. C.nr. 1257/10, dt.06.10.2011.
Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.244/11, dt.24.04.2013
Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.545/12-Pr.1, dt.21.11.2013
Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, c.nr.1033/13, dt.05.11.2013
Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2103/13, dt.22.10.2013
Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.411/09, dt.22.07.2014

Programi i USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP) mbështet Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) në rritjen e efikasitetit, gjykatat në përmirësimin administratës dhe menaxhimin e rasteve, si dhe integrimin në Sistemin e Drejtësisë në Kosovë të gjykatave në Veri.

I publikuar nga:

Akademia e Drejtësisë dhe Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID) përmes Programit për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë në Kosovë (JSSP).

Adresa:

Akademia e Drejtësisë
Rr. "Muharrem Fejza" p.n. - Prishtinë
Tel. +381 38 200 18 660
Fax +381 38 512 095
e-mail: infoad@rks-gov.net
web: <https://ad.rks-gov.net>